

# ENVER HOXHA

VEPRA

14



**PROLETARE TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNI!**

# **ENVER HOXHA**

**VEPRA**

**BOTOHET ME VENDIM TE KOMITETIT  
QENDROR TE PARTISE SE PUNES TE  
SHQIPERISE**



**ENVER HOXHA**



INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE - LENINISTE  
PRANË KQ TE PPSH

# ENVER HOXHA

VËLLIMI

14

QERSHOR 1956 - QERSHOR 1957

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»  
TIRANË, 1973



## PARATHËNIE PËR VËLLIMIN 14

Vëllimi i 14-të i Veprave të shokut Enver Hoxha përfshin shkrime të periudhës qershor 1956 — qershor 1957 ku ndër të tjera hyjnë: Fjala në mbledhjen solemne me rastin e 15-vjetorit të themelimit të PPSH (8 Nëntor 1956), Diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike mbi gjendjen e krijuar nga kundërrevolucioni në Hungari, mbi gjendjen në Poloni, mbi veprimtarinë e udhëheqjes Jugosllave (13 nëntor 1956), Teza të KQ të PPSH mbi bazën e të cilave u zhvilluan bisedimet me udhëheqësit sovjetikë në Moskë për gjendjen në Hungari, në Poloni dhe ndërhyrjet e udhëheqjes jugosllave (25-26 dhjetor 1956), Raporti i mbajtur në Plenumin III të KQ të PPSH «Mbi gjendjen ndërkombëtare dhe detyrat e Partisë» (13 shkurt 1957), Raporti i mbajtur në mbledhjet e Byrosë Politike dhe të Plenumit të KQ të PPSH më 27 dhe 30 prill 1957 «Mbi vizitën e delegacionit të Partisë dhe të qeverisë në Bashkimin Sovjetik» (27 prill 1957), Diskutime në mbledhje të Byrosë Politike e të Sekretariatit të KQ të PPSH, artikuj të botuar në shtypin komunist të huaj, biseda, letra e telegrame përsëndetjeje etj. Një pjesë e shkrimeve të këtij vëllimi botohen për herë të parë.

Në materialet e kësaj periudhe pasqyrohet lufta e

Partisë për zbatimin e detyrave të Kongresit III të PPSH. Në to trajtohen probleme të kolektivizimit të mëtejshëm të bujqësisë dhe të ndërtimit të socializmit në fshat, të forcimit ekonomik dhe organizativ të kooperativeve bujqësore, të rritjes së mirëqenies së masave punonjëse mbi bazën e industrializimit të mëtejshëm dhe të përparimit të gjithanshëm të bujqësisë, të forcimit të fuqisë mbrojtëse të atdheut dhe rritjes së vigjilencës revolucionare, probleme që lidhen me drejtimin më të përsosur të ekonomisë, me forcimin e aparatit shtetëror në luftë të vazhdueshme kundër burokratizimit.

Në këtë vëllim gjithashtu trajtohen probleme që kanë të bëjnë me forcimin e unitetit ideologjik, organizativ dhe politik të radhëve të Partisë, të edukimit të punonjësve, të forcimit dhe të ngritjes në një nivel më të lartë të rolit udhëheqës të Partisë në luftën për ndërtimin e socializmit.

Është periudha e fushatës së tërbuar që shpërthyen imperialistët dhe revizionistët pas Kongresit XX të PK të BS kundër marksizëm-leninizmit, nën maskën e luftës kundër «stalinizmit», e «kultit të individit», kundër «dogmatizmit» etj.

Në materialet e këtij vëllimi del në pah qëndrimi konsekuent internacjonalist i Partisë sonë, lufta parimore kundër imperializmit dhe revizionizmit modern, lufta për ruajtjen dhe forcimin e unitetit të lëvizjes komuniste ndërkombëtare e të kampit socialist, për mbrojtjen e ideve të marksizëm-leninizmit.

Grupi i Hrushovit, duke shfrytëzuar prestigjin dhe autoritetin e PK të BS e të shtetit sovjetik, bënte pre-

sion të vazhdueshëm mbi udhëheqjet e partive të tjera komuniste për t'u imponuar kursin revizionist të Kongresit XX, organizonte komplete për të larguar nga udhëheqja e partive të gjithë ata që kundërshtonin përhapjen e këtij kursi. Klika e Titos nga ana e saj bënte zhurmë të madhe për të ashtuquajturën rrugë jugosllave të ndërtimit të socializmit, bënte thirrje dhe ndërhynte me të gjitha mënyrat për të shpejtuar procesin e degjenerimit të partive marksiste-leniniste dhe për të minuar rendin socialist.

Në këto rrethana, në parti të ndryshme komuniste e punëtorë dolën elementë oportunistë, u rehabilituan elementë antiparti, shumë prej të cilëve njiheshin botërisht si kundërrevolucionarë.

Gjendjen e nderë të krijuar në gjirin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare e shfrytëzuan imperialistët. Ata nxitën, përhapën dhe organizuan kundërrevolucionin në ato vende socialiste ku revizionistët kishin krijuar një truall të përshtatshëm. Kështu imperializmi ndërkombëtar dhe revizionistët organizuan së bashku revoltën kundërrevolucionare në Poznan të Polonisë, në qershor të vitit 1956, si dhe kryengritjen kundërrevolucionare në Hungari, tetor-nëntor 1956. Kundërrevolucioni në Hungari ishte pjellë e revizionistëve jugosllavë e sovjetikë, të cilët bashkëpunonin ngushtë dhe koordinonin veprime që në fakt ishin kundërrevolucionare.

Partia jonë për këto probleme kishte kontradikta me udhëheqjen sovjetike të cilat ia vinte në dukje në rrugë partie, nëpërmjet letrash dhe bisedimesh direkte. Por në atë kohë PPSH nuk mund të dilte hapur kundër

udhëheqjes sovjetike dhe tezave revizioniste të Kongresit XX të PK të BS pasi dalja hapur në atë kohë kundër Kongresit XX do t'u shërbente vetëm armiqve të komunizmit, të cilët kishin shpërthyer një sulm të tërbuar kundër marksizëm-leninizmit, kundër kampit socialist dhe sidomos kundër Bashkimit Sovjetik, si shtet i parë socialist i krijuar nga V.I. Lenini dhe J.V. Stalini.

Tehun kryesor në këtë periudhë Partia e drejtonte kundër revizionistëve jugosllavë, të cilët mbanin flamurin e sulmit kundër marksizëm-leninizmit. Por siç del dhe në dokumentat e botuara në këtë vëllim nuk ishte e vështirë të nënkuptohej që kjo luftë drejtohej kundër revizionizmit që shfaqej në çdo formë e në çdo vend a në çdo parti, duke mos përjashtuar aluzionet edhe për qëndrimet oportuniste të udhëheqjes hrushoviane të BS.

Qëndrimi i vendosur marksist-leninist i PPSH për problemet e mëdha parimore që lindën në lëvizjen komuniste ndërkombëtare pas Kongresit XX, vendosmëria për të ruajtur të paprekur vijën e vet të përgjithshme revolucionare, ngjallën shqetësim në udhëheqjen e PK të BS. Grupi i Hrushovit shpresonte se PPSH do t'i nënshtrohej diktatit të tij, por pasi dështoi në përpjekjet për t'iu imponuar me anën e diktatit, ai përdori për një kohë lajkat dhe premtimet për ndihma të gjithanshme. Por as presioni as «ndihmat» nuk e lëkundën vendosmërinë e udhëheqjes marksiste-leniniste të PPSH për të mbrojtur deri në fund vijën e përgjithshme revolucionare të Partisë sonë.

Në rrethanat e krijuara nga planet agresive të imperialistëve e veprimtaria kundërrevolucionare e revizionistëve të ndryshëm, Komiteti Qendror i Partisë poro-

---

*sitte komunistët e të gjithë punonjësit të forconin unitetin, vigjilencën revolucionare e luftën në frontin ideologjik, që në këtë kohë merrnin më shumë se kurrë një rëndësi të dorës së parë.*



**NGA FJALA NË MITINGUN E ORGANIZUAR  
NË VLORË ME RASTIN E VIZITËS  
SË DELEGACIONIT QEVERITAR  
TË RDP TË KORESË<sup>1</sup>**

30 qershor 1956

Shokë,

Me gëzim të madh ne përshëndesim sot miqtë tanë të shtrenjtë që kanë ardhur nga Koreja e largët heroike për t'u njohur me popullin tonë, për të biseduar me ne si miq e vëllezër dhe për ta forcuar edhe më shumë miqësinë e thellë që na lidh.

Populli shqiptar e do me gjithë zemër popullin korean, sepse ne kemi pasur një histori pothuaj të njëjtë, kemi vuajtur shumë nga pushtuesit e huaj dhe kemi luftuar gjithnjë për liri, jemi çliruar pothuaj në një kohë me ndihmën e mikut tonë të madh, Bashkimit Sovjetik, dhe ecim në një rrugë të përbashkët, në rrugën e socializmit. Vërtet ne jemi shumë larg njëri-tjetrit, brigjet tona i lag deti Adriatik këtu në Mesdhe, kurse

---

<sup>1</sup> Delegacionin qeveritar të RDP të Koresë që vizitoi në këtë kohë vendin tonë e kryesonte Kryetari i Kabinetit të Ministrave të RDP të Koresë Kim Ir Sen.

brigjet e Koresë lagen nga Deti i Verdhë në oqeanin Paqësor. Por kjo nuk mund të jetë një pengesë që ne të njohim njëri-tjetrin, të jemi miq dhe zemrat tona të rrahin për një qëllim, për paqen e socializmin. Shqipëria dhe Koreja gjenden me mijëra kilometra larg, mjaft të kujtojmë se kur këtu është mesditë në Kore është natë. Por ç'tregon kjo, shokë? Kjo tregon sa e madhe është miqësia jonë, që nuk njeh largësi dhe asnjë pengesë, sepse ne frymëzohemi nga ideale të përbashkëta, nga idetë e marksizëm-leninizmit, flamurit tonë të lavdishëm.

Disa vjet më parë, pakkush te ne dinte ndonjë gjë për Korenë, për këtë vend të bukur, me një kulturë të vjetër dhe me një popull heroik. Imperialistët e kishin fshirë Korenë nga harta e botës. E njëjta gjë mund të thuhet edhe përsa i përket njohjes së vendit tonë në Kore. Sigurisht kjo nuk ishte as për faj të popullit tonë, as të popullit korean. Po tani? Mund të themi me bindje të plotë se tani te ne, edhe në malësitë më të largëta, s'ka njeri që nuk e ka dëgjuar emrin e Koresë, luftën heroike të popullit korean për liri dhe për ndërtimin e socializmit. Populli ynë i do trimat. Ai ka dëgjuar shumë për luftën heroike të popullit korean dhe prandaj populli ynë ka një simpati të veçantë për trimërinë, heroizmin dhe sakrificat e mëdha të popullit korean. Populli i Vlorës, ashtu si gjithë populli ynë, ka ndjekur me interesim të madh përpjekjet heroike të burrave e grave të Koresë gjatë luftës që shpërthyen agresorët imperialistë për qëllimet që njihen tash nga bota mbarë.

Miqtë tanë koreanë e dinë se Vlora është një nga vatrat më të shënuara të luftërave për liri e pavarësi



kombëtare dhe të traditave revolucionare të popullit tonë. Populli trim e i pamposhtur i Vlorës dhe i labërisë, ashtu si gjithë populli shqiptar, ka luftuar vazhdimisht për liri kundër pushtuesve imperialistë, kundër okupatorëve fashistë e nazistë. Vlora, shokë të shtrenjtë, është si qyteti juaj hero Vonsan, i njohur për traditat revolucionare të klasës së tij punëtore, për rezistencën trime kundër imperializmit japonez, për luftën heroike kundër agresorëve amerikanë. Dhe sot, si Vlora si Vonsani po ndërtohen më të bukura se ç'kanë qenë, po ngrihen si qytete industriale dhe skela të dorës së parë, ku, bashkë me jetën e re, rritet dhe kalitet në luftë për ndërtimin e socializmit klasa punëtore e të dy vendeve, klasa udhëheqëse e shteteve tona popullore. Populli i Vlorës që ka një histori plot me tradita lufte e trimërie, ka shprehur gjithnjë dhe shpreh edhe sot në këtë miting simpatinë dhe miqësinë e tij me popullin korean.

Kur filloi agresioni kundër Koresë, ne e dënuam atë dhe përkrahëm luftën e drejtë të popullit Korean. Ne e dinim se atje, në Kore, luftohej për çështjen e paqes në botë, edhe për paqen në vendin tonë, prandaj ne me zemër u gjendëm gjithmonë afër popullit korean dhe vullnetarëve trima kinezë, që luftuan aq heroikisht kundër agresorëve. Populli shqiptar e përsëndeti me gjithë zemër fitoren përfundimtare të popullit korean, ndalimin e luftës. Ne e përsëndetëm fitoren e popullit korean, si një fitore tonën, sepse ajo qe një fitore mbi agresorët që duan të prishin paqen në botë. Populli korean u dha një mësim të mirë agresorëve imperialistë, u tregoi atyre se popujt që njohën lirinë dhe që kanë

një udhëheqëse besnike siç është Partia e Punës e Koresë, janë të pathyeshëm dhe se agresorët nuk mund t'i vënë lehtë në veprim planet e tyre të luftës. Agresorët e panë se në përpjekjen që bënë për të ndezur luftën në Lindjen e Largme në fillim u ngeci sharra në gozhdë dhe aventura e tyre u kushtoi shtrënjtë. Përjetë popujt e botës do t'i jenë mirënjohës popullit korean për këtë mësim të madh që u dha agresorëve!

Ne gëzohemi tani edhe për sukseset që po arrin Republika Demokratike Popullore e Koresë për rindërtimin e vendit, për rindërtimin e qyteteve e të fshatrave, për ndërtimin e fabrikave e të uzinave të reja, për sukseset e punëtorëve e të fshatarëve koreanë, të cilët, si dje në luftë, po tregojnë përsëri heroizëm në veprën e madhe të rindërtimit, në të cilën ndihmohen nga Bashkimi Sovjetik, Republika Popullore e Kinës dhe nga vendet e tjera të demokracisë popullore. Ne i urojmë nga zemra popullit vëlla korean fitore të reja, shërimin sa më shpejt të plagëve të luftës dhe ndërtimin e jetës së re socialiste! I udhëhequr me urtësi e besnikëri nga Partia e tij e Punës me shokun Kim Ir Sen në krye populli korean do të korrë me siguri fitore të mëdha në të gjitha fushat e jetës. Ne i urojmë atij që të realizojë edhe dëshirën e tij të thellë, bashkimin e gjithë Koresë!

Ne i kuptojmë shumë mirë përpjekjet që bën sot populli korean për rindërtimin e vendit të tij, për zhvillimin e ekonomisë popullore dhe për mirëqenien e popullit. Edhe populli ynë ka përqëndruar tani të gjitha forcat për zhvillimin e ekonomisë, për të përmirësuar jetën e tij. Partia jonë e Punës ka si ligj të saj më të

lartë kujdesin e vazhdueshëm për mirëqenien e popullit, për të përmirësuar kushtet materiale, për të ngritur nivelin e tij kultural. Këtë detyrë theksoi me forcë edhe Kongresi III i Partisë sonë dhe direktivat e planit të dytë pesëvjeçar frymëzohen nga ky qëllim i lartë i Partisë sonë dhe i qeverisë.

Shokë,

Miq të tanë koreanë erdhën në vendin tonë, ashtu si vajtën edhe në një numër vendesh të tjera të demokracisë popullore, të frymëzuar nga qëllimi për të forcuar miqësinë dhe për t'i shërbyer çështjes së paqes. Takimi ynë dhe bisedimet tona do t'i shërbejnë forcimit të miqësisë midis popujve tanë dhe çështjes së paqes.

Vendet tona janë vende socialiste dhe politika e tyre e jashtme është për ruajtjen e paqes. Gjithë përpjekjet tona janë përqëndruar tani për të siguruar paqen, për të larguar rrezikun e një lufte të re. Suksese të mëdha janë arritur në këtë drejtim.

Populli shqiptar, ashtu si dhe populli korean, do të bëjë çdo gjë që do të jetë në dorën e tij për të ndihmuar në çështjen e sigurimit të paqes. Ja pse ne, duke forcuar miqësinë tonë dhe duke shprehur pikëpamjet tona të përbashkëta për çështjet e ndryshme ndërkombëtare, i shërbejmë njëkohësisht çështjes së paqes, dhe prandaj këtë takim tonë ne e quajmë me të drejtë një kontribut për paqen.

Shokë, ne falenderojmë me gjithë zemër shokun Kim Ir Sen dhe shokët e tjerë koreanë për vizitën që

bënë ata në vendin tonë, sepse ajo do të forcojë edhe më shumë miqësinë tonë.

Rroftë populli heroik korean dhe udhëheqja e tij e lavdishme, Partia e Punës e Koresë, Komiteti i saj Qendror me shokun Kim Ir Sen në krye!

Rroftë miqësia e popullit shqiptar me popullin korean!

Rroftë kampi ynë i socializmit e i paqes me Bashkimin Sovjetik në krye, mikun e madh dhe çlirimtarin e të dy popujve tanë!

Rroftë paqja në botël

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 159 (2428), 1 korrik 1956*

*Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i Popullit», Nr. 159 (2428), 1 korrik 1956*

**LETËR FALENDERIMI KQ TË PK TË KINËS  
PËR AKORDIMIN E NJË KREDIE SUPLEMENTARE  
RP TË SHQIPËRISË**

**10 korrik 1956**

**KOMITETIT QENDROR TË PARTISË KOMUNISTE  
TË KINËS**

*P e k i n*

Nëpërmjet ambasadorit të Republikës Popullore të Kinës në Tiranë, Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë mori letrën tuaj, me anën e së cilës na njoftoni se keni pranuar të plotësoni kërkesën tonë për një kredi suplementare prej 30 milion rublash për periudhën e planit të dytë pesëvjeçar të vendit tonë.

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave i Republikës Popullore të Shqipërisë e pritën me kënaqësi këtë njoftim dhe ju falenderojnë nga zemra për këtë ndihmë bujare dhe vëllazërore, të cilën ne e çmojmë si një shprehje të miqësisë së ngushtë e të paprekshme që bashkon të dy popujt tanë dhe njëkohësisht si një kontribut shumë të

rëndësishëm në realizimin me sukses të planit tonë të dytë pesëvjeçar.

Në sytë e popullit shqiptar dhe të Partisë sonë kjo ndihmë ka një vlerë akoma më të madhe për faktin se ata e dinë mirë se sa të mëdha janë vetë nevojat e Republikës Popullore të Kinës në këtë periudhë të transformimit dhe të ndërtimit të saj socialist.

Brenda kohës më të shkurtër, organet tona qeveritare do të zhvillojnë bisedime me shokun ambasador për të përcaktuar masat konkrete lidhur me përdorimin e kreditit në fjalë.

Duke ju falenderuar edhe një herë për gatishmërinë e madhe që tregoni për t'i dhënë përkrahjen tuaj shumë efektive popullit shqiptar, ju dërgojmë urimet tona më të mira për fitore të reja në ndërtimin e socializmit në Kinë!

Me përshëndetje komuniste!

Për Komitetin Qendror të PPSH  
Sekretari i Parë

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## **LETËR KOMITETEVE TË PARTISË NË LIDIJE ME KONTRAKTIMIN DHE GRUMBULLIMIN E TEPRICAVE TË DRITHËRAVE TË BUKËS**

**21 korrik 1956**

### **GJITHË KOMITETEVE TË PARTISË**

Problemi i sigurimit të bukës ka preokupuar vazhdimisht Partinë dhe qeverinë tonë. Megjithatë ky nuk është arritur të zgjidhet në vend por është dashur çdo vit të importohen sasi të mëdha drithi. Detyra kryesore që vuri Kongresi III i PPSH për bujqësinë në pesëvjeçarin e dytë është sigurimi i bukës në vend. Kjo do të arrihet natyrisht duke realizuar me sukses sipërfaqet e mbjella, rendimentet e planifikuara dhe grumbullimin ritmik të drithërave të bukës me anën e tatimit në natyrë, të ujemit dhe sidomos me anën e blerjes së tepricave fshatarësisë. Në vitin 1960 grumbullimi i drithërave të bukës si total do të jetë 209,2 për qind në krahasim me vitin 1955, por, ndërsa grumbullimi i detyrueshëm do të rritet vetëm 6 për qind (dhe kjo për efekt të shtimit të tokave), grumbullimi nëpërmjet blerjes së tepricave do të jetë 266 për qind më i madh se në vitin 1955.

Kuptohet se realizimi i këtij fondi kërkon patjetër një punë të madhe nga organet e Partisë, të pushtetit dhe nga organet e grumbullimit në qarqe, rrethe e fshatra. Rezultatet e gjashtëmujorit të parë të këtij viti tregojnë se përpjekjet në këtë drejtim nuk kanë qenë të kënaqshme. Plani i grumbullimit të tepricave në këtë gjashtëmujor u realizua vetëm 59,3 për qind, me një deficit prej rreth 50 000 kv. drithëra buke. Veçanërisht keq kanë ecur qarku i Gjirokastrës me 30,1 për qind, ai i Elbasanit me 45,2 për qind, rrethi i Lushnjës me 25,5 për qind, i Fierit me 50 për qind etj.

Edhe pas Kongresit III të Partisë problemi i tepricave nuk u muar në dorë me seriozitetin e duhur. Në mjaft qarqe e rrethe konstatohen të meta dhe mendime jo të drejta në lidhje me këtë çështje. Ka tendenca që të përqëndrohet vëmendja vetëm në realizimin e detyrimeve, duke pritur që realizimi i tepricave të bëhet pa ndonjë organizim dhe përpjekje të veçantë. Çështja është që të dallohen mirë këto probleme. Grumbullimi i detyrueshëm duhet realizuar me çdo kusht dhe në një kohë sa më të shkurtër, ashtu sikurse duhet realizuar patjetër edhe ujemi i SMT-ve apo i mullinjve etj. Por detyrimet janë ligje të përcaktuara me urdhëresa të qeverisë, prandaj ato janë plane të detyrueshme për çdo kooperativë bujqësore dhe për çdo fshatar individual dhe këto plane kooperativat bujqësore dhe fshatarët individualë detyrohen t'i shlyejnë brenda afateve të përcaktuara në fletëdetyrimet përkatëse. Pa dyshim, që të arrihet kjo, kërkohet një punë e gjerë politike e bindëse me fshatarësinë nga ana e organizatave të Partisë dhe një mobilizim i gjithanshëm i punonjësve të



pushtetit e të grumbullimit. Këtë nuk duhet ta nënvleftësojmë në asnjë mënyrë edhe për vetë faktin se s'mund të flitet për grumbullim tepricash pa shlyer më parë fshatari detyrimet e tij ndaj shtetit.

Por ndryshe qëndron çështja me grumbullimin e tepricave. Shteti edhe për këtë ka një plan, i cili u dërgohet rregullisht organeve të pushtetit në qarqe, rrethe e fshatra. Por ky plan nuk ka karakterin e planit të grumbullimeve të detyrueshme përsa u përket masave dhe sanksioneve ligjore. Grumbullimi i tepricave kërkon organizimin sa më të mirë dhe shpjegimin sa më konkret e praktik të leverdisshmërisë që ka çdo fshatar apo kooperativë duke i shitur shtetit teprica. Kjo kërkon një punë më të madhe politike e bindëse nga ana e organeve të Partisë dhe masa konkrete nga ana e organeve shtetërore, siç është kontraktimi me kohë, dhënia e rregullt e paradhënieve, furnizimi i fshatarësisë me prodhime të industrisë e të artizanatit, organizimi sa më i mirë i tregëtisë ambulante në fshat e të tjera masa të këtij lloji. Fshatarit i duhet shpjeguar me kujdes edhe leverdia që ka ai kur ia shet tepricat shtetit me çmime të larta. Nga ana tjetër, fshatarit i duhet shpjeguar se vërtet plani i tepricave nuk është i detyrueshëm me ligj si plani i grumbullimeve të detyrueshme, për mosrealizimin e të cilit parashikohen edhe sanksione e masa të tjera ligjore, por shitja e tepricave shtetit duhet të kuptohet si një detyrë e rëndësishme që ka fshatarësia, e në radhë të parë kooperativat bujqësore, ndaj shtetit dhe klasës punëtore. Shteti i demokracisë popullore e ka ndihmuar dhe e ndihmon vazhdimisht fshatarësinë për zhvillimin e ekonomisë bujqë-

sore dhe përmirësimin e kushteve të jetesës, me traktorë e maqina, me kredit agrar, me farëra, damazë të zgjedhur, me plehra kimike, me kanale ujitëse e kulluese, me teknikë, kuadro etj. Pa ndihmën e shtetit as që mund të mendohet ngritja dhe zhvillimi i ekonomisë bujqësore. Gjithashtu fakti se tepricat nuk janë njëlloj si detyrimet, nuk e largon aspak organizatën e Partisë dhe organin shtetëror nga përgjegjësia për realizimin në kohë të planit të tepricave. Për ata plani i tepricave është plan shtetëror, i detyrueshëm për zbatim, si çdo plan tjetër. Ndryshimi qëndron në rrugën që duhet ndjekur për realizimin e këtij plani. Në këtë rast, vendin kryesor e zë puna politike, bindja e fshatarëve dhe organizimi sa më i mirë i tregëtisë midis qytetit dhe fshatit. Por që të arrihet kjo duhet vlerësuar mirë rëndësia e tepricave. Në këtë punë, si kudo, ne duhet të na udhëheqin mësimet e Leninit të madh, i cili, në lidhje me këtë problem, thotë:

*«Nëpunësi i grumbullimit deri tani dinte vetëm një direktivë kryesore: të mbledhte 100 për qind të tepricave të produkteve bujqësore. Sot direktiva është ndryshe: të mbledhë 100 për qind të tatimit brenda një afati sa më të shkurtër, pastaj të mbledhë edhe 100 për qind të tjera, duke i shkëmbyer me produkte të industrisë së madhe dhe të vogël. Ai që mbledh 75 për qind të tatimit dhe 75 për qind (nga qindëshi i dytë), duke i shkëmbyer me produkte të industrisë së madhe e të vogël, ai bën një punë më të dobishme për shtetin, se sa ai që mbledh 100 për qind të*

*tatimit dhe 55 për qind (nga qindëshi i dytë), me anën e shlcëmbimit»<sup>1</sup>.*

Ky problem do të gjejë zgjidhje në rast se komitetet e Partisë do të tregojnë kujdesin e duhur për të organizuar mirë tregëtimin e mallrave për fshatin. Në këtë rast është e nevojshme që të shqyrtohet puna e kooperativave të shitblerjes në fshat për të siguruar ato mallra për të cilat ka më shumë kërkesa nga fshatarët, sidomos materiale ndërtimi. Në këtë drejtim duhet të sigurohet gatishmëria e prodhuesve për t'iu përgjegjur kësaj detyre të rëndësishme duke prodhuar më shumë e më mirë mallra për fshatin.

Natyrisht një mbështetje e fortë për realizimin e detyrave të përmendura është zhvillimi i kolektivizimit të bujqësisë, shtimi nga dita në ditë i kooperativave bujqësore. Por edhe këtu nuk duhen nënvleftësuar në asnjë mënyrë detyrat që u përmendën më lart, ashtu sikurse nuk duhet harruar edhe vetë natyra e dyfishtë e fshatarit që ekziston akoma edhe te vetë anëtari i kooperativës.



Duke marrë parasysh se detajimi i planit të tepricave në çdo kooperativë bujqësore dhe fshat është bërë me të meta nga mjaft komitete ekzekutive të rretheve,

---

<sup>1</sup> V. I. Lenin. Veprat, vëll. 32, f. 420.

e shohim të nevojshme të theksojmë çështjet kryesore që duhen pasur parasysh në llogaritjen dhe detajimin e planit të tepricave.

Në radhë të parë, duhet të nisemi nga parimi që kooperativistët të marrin më shumë të ardhura në lekë për ditë-pune dhe drithë aq sa të plotësojnë nevojat për bukë. Së dyti, duhet të mbahet parasysh që të sigurohet 100 për qind çdo familje kooperativiste me bukë, pastaj të merren teprica. Së treti, plani i tepricave për çdo kooperativë dhe fshat duhet të mbështetet në bazë të llogaritjeve për nevojat e bukës 200-250 kg. për frymë si mesatare për gjithë rrethin. Kështu që diferencimi midis kooperativave dhe fshatrave të një rrethi duhet të jetë i tillë që në mesatare të mos e tejkalojë normën e mësipërme.

Sasia e tepricave që i mbetet kooperativës për t'i shitur shtetit, nxirret me anën e bilancit të prodhimit e të nevojave të bukës për kooperativën. Bilanci përfshin:

I. — Burimet për kooperativën: këto përbëhen nga prodhimi që parashikohet të realizohet (dhe që del duke shumëzuar sipërfaqen e mbjellë dhe hamullore — me rendimentin përkatës) dhe nga të ardhura të tjera që mund të ketë kooperativa (nga duhani, pambuku etj.).

II. — Nevojat për kooperativën: këto përfshijnë nevojat për bukë për gjithë frymët e kooperativës, detyrimin ndaj shtetit, ujemin e SMT-ve e të mullinjve, nevojat për kafshët dhe rezervat që parashikon statuti, si edhe nevojat e farës për vjeshtën dhe pranverën.

III. — Mbetja për t'u tregëtuar: kjo përbën tepriçën që rezulton midis burimeve dhe nevojave.

Këtu duhet pasur parasysh edhe problemi se ka ekonomi në kooperativë që kanë shumë frymë në familje dhe me ditët e punës që realizojnë nuk arrijnë të sigurojnë sasinë e nevojshme për bukë. Në këtë rast kooperativa nga sasia rezervë që mban, 2-5 për qind sipas rastit, u jep me atë çmim që ia ka shitur shtetit atyre familjeve që nuk e plotësojnë nevojën e bukës. Në fund të vitit kooperativa u ndan anëtarëve të saj, mbështetur në ditët e punës, të holla, bereqet etj. Në këtë rast, atyre ekonomive që u mungon pjesërisht buka, në vend që t'u japë gjithë të hollat, u jep, pjesërisht në vend të tyre, bereqet nga ajo sasi që mbajti si rezervë. Kështu vlera e ditës së punës duhet të jetë e tillë që të sigurojë bukën e shumicës së anëtarëve dhe një pjese të vogël të tyre t'u kompesohet nga rezerva.

Planin e tepricave që merr kooperativa bujqësore nga komiteti ekzekutiv i rrethit, zakonisht duhet ta përfshijë në planin e vet ekonomiko-financiar, pasi të jetë shqyrtuar dhe diskutuar nga organizata bazë e Partisë. Për këtë vit, meqenëse plani i tepricave në shumë raste nuk është përfshirë në planin ekonomiko-financiar të kooperativës, duhet që organizata bazë ta shqyrtojë më me hollësi, duke llogaritur zë për zë bilancin e burimeve dhe të nevojave. Pasi kanë bërë këtë llogari, kryetari i kooperativës, sekretari i organizatës bazë dhe i deleguari i pushtetit, shtrohet problemi i tepricave në organizatën e Partisë, e cila vendos të zbatohet plani i caktuar. Organizata e Partisë e bind kryesinë dhe asamblenë e kooperativës për t'i shitur shtetit këto teprica (të paktën 80-90 për qind të tyre, siç u angazhua p.sh. qarku i Gjirokastrës). Organizata e Partisë bilancin e

hollësishëm e bën për veten e saj dhe nuk e analizon në asamble të kooperativës, sepse atëhere mund të lindin pikëpamje të gabuara se mos «tani tepricat po bëhen si detyrimi», «po caktohet buka me racion» e të tjera shfaqje të tilla që nuk janë të drejta e as të lejueshme dhe që në fakt bëhen pengesë për zhvillimin e mëtejshëm të kolektivizimit. Pasi bindet, kryesia e shtron çështjen në asamble, u shpjegon anëtarëve rëndësinë e problemit, në mënyrë që edhe ata ta kuptojnë drejtësinë e kësaj pune dhe të pranojnë shitjen e tepricave të mundshme shtetit me çmime të larta shtetërore dhe me shkëmbim mallrash industriale.

Po japim një shembull të marrur nga puna e një organizate në një kooperativë bujqësore të vendit. Ja si paraqitet bilanci i kësaj kooperative:

### I. — *Burimet*:

1) Nga prodhimi i planifikuar drithëra buke kv. 3 000	
2) Nga stimulacioni i duhanit	» » » 280
	-----
	Gjithsejt kv. 3 280

### II. — *Nevojat*:

1) Për nevojat e bukës të anëtarëve drithëra buke kv. 830	
2) Detyrim ndaj shtetit	» » » 330
3) Detyrim ndaj SMT-ve	» » » 250
4) Ushqim për kafshë	» » » 100
5) Nevojat e farës	» » » 190
6) Rezervë (4 për qind)	» » » 150

Gjithsejt nevoja drithëra buke kv. 1 850

III. — *Teprica* 3 280 — 1 850 = 1 430 kv.

Në rast se angazhimi i organizatës është për t'i shitur shtetit 90% të tepricave, atëhere fondi i tepricave për t'u kontraktuar është:  $1\ 430 \times 90\% = 1\ 287$  kv. drithë. Synimi i organizatës bazë të Partisë duhet të jetë që të arrijë të grumbullojë të gjitha tepricat.

Duhet theksuar që të mos kufizohet puna vetëm në kooperativat bujqësore, ashtu sikurse po ndodh në shumë rrethe. Shumicën dërmuese të prodhimit në fshat e ka fshatarësia individuale. Prandaj organizatat e Partisë duhet të punojnë më intensivisht me këto ekonomi.

Kuptohet se llogari të tilla nuk mund të bëhen me fshatarësinë individuale, por megjithkëtë organizata bazë e Partisë në fshat mund të bëjë llogari aproksimative dhe mund të përcaktojë se cilët fshatarë kanë dhe cilët nuk kanë teprica, në mënyrë që për realizimin e planit të tepricave që ka marrë nga rrethi të përqëndrojë punën e saj, sidomos me ato ekonomi që kanë teprica për t'i shitur shtetit.

Me këtë rast duhet të kemi parasysh se sasi të tepricave që u rezultojnë kooperativave nga bilancet e mësipërme, vlejnë për të gjitha disponibilitetet deri në korrik të vitit 1957, d.m.th. nga të njëjtat teprica duhet të realizohet, përveç gjashtëmujorit të dytë të këtij viti, edhe kontraktimi e grumbullimi i planifikuar për gjashtëmujorin e parë të vitit 1957. Puna e kontraktimit të tepricave duhet të bëhet paralelisht me detajimin e planit dhe llogaritjen e tyre në çdo kooperativë bujqësore dhe fshat, duke përcaktuar në mënyrë të konkretizuar në kontratë edhe nevojat për furnizimin e fshatarësisë si dhe kushtet e favorizimet e tjera, si para-dhëniet, transportin etj.

Komitetet e Partisë duhet ta drejtojnë konkretisht dhe në mënyrë operative problemin e tepricave, detajimin e planit nga komiteti ekzekutiv i rrethit, konkretizimin e tij në çdo kooperativë e fshat, kontraktimin me organet grumbulluese dhe dorëzimin e tepricave.

Rëndësi e veçantë duhet t'i vihet emulacionit dhe garave midis fshatrave, lokaliteteve dhe rretheve. Të ndiqen me kujdesin më të madh garat, emulacioni dhe angazhimet e marrura. Të organizohet nxjerrja e fletërrufeve, buletineve informative lokale mbi rezultatet e garave, të cilat t'u lexohen fshatarëve nga anëtarët e Partisë ose të bashkimit të rinisë.

Gjithë Partia duhet ta konsiderojë si një nga detyrat më të rëndësishme të fushatës së grumbullimeve problemin e tepricave dhe të mobilizohet për realizimin me sukses të kësaj detyre kaq të madhe.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*



## MARRËDHËNIE TË SHËNDOSHA MIDIS DY POPUJVE MUND TË VENDOSEN VETËM MBI BAZËN E PARIMEVE MARKSISTE-LENINISTE

*Bisedë me të dërguarin e jashtëzakonshëm dhe ministër  
fuqiptotë të RFP të Jugosllavisë<sup>1</sup>*

**4 gusht 1956**

Partia jonë ka dashur dhe dëshiron të vendosen marrëdhënie të mira miqësore me Jugosllavinë. Këtë e theksoi edhe Kongresi III i Partisë sonë. Por më lejoni t'ju flas hapur, t'ju them se udhëheqja jugosllave nuk i ka lexuar me gjakftohtësi dokumentat e kohëve të fundit të forumeve e të organeve të Partisë sonë pse, po t'i lexonte dhe t'i gjykonte kështu, do të dilte me

---

<sup>1</sup> Më 4 gusht 1956, i dërguari i Jugosllavisë me porosi të KQ të LKJ në takimin që pati me shokun Enver shprehu mosaprovimin e udhëheqësve jugosllavë për vlerësimin që u bënte Partia jonë marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë të viteve 1944-1948. Ata propozonin që Partia jonë të dilte me një deklaratë zyrtare me anën e së cilës të pranonte se vitet 1944-1948 ishin vitet e miqësisë e të marrëdhënieve të mira midis të dy vendeve dhe se në veprimtarinë e udhëheqjes jugosllave ndaj Partisë e vendit tonë nuk kishte asnjë gabim. Partia jonë i bëri

konkluzione të tjera. Ne mendojmë se ato çka thuhet për Jugosllavinë në këto dokumenta janë plotësisht të drejta, marksiste-leniniste dhe shumë të urta, e theksoj edhe një herë se ato janë shumë të urta. Komiteti Qendror i Partisë sonë nuk u ndryshon asnjë presje atyre që janë thënë dhe mendon se nuk ka vend për asnjë deklaratë tjetër.

Partia jonë nuk ka pasur frikë t'i njohë ndershmërisht në mënyrë marksiste-leniniste gabimet e saj, por s'do të ishte marksiste-leniniste sikur ajo të heshte për gabimet tuaja. Është e vërtetë se gjatë periudhës 1944-1948 dhe gjatë gjithë Luftës nacional-çlirimtare ne kemi pasur miqësi shumë të ngushtë dhe kjo për arësye të luftës sonë kundër armikut të përbashkët dhe jo për natyrën «specifike» të zhvillimit tonë siç pretendoni ju. Partia jonë mendon se zhvillimi i luftës sonë, forcimi i pushtetit dhe i Partisë nuk u bë në rrugë «specifike» dhe pa pasur shembull tjetër, por u bë në rrugë normale marksiste-leniniste dhe duke pasur shembullin e Bashkimit Sovjetik dhe të Partisë Bolshevike. Shembulli i Partisë Bolshevike na ndihmoi për krijimin e Partisë sonë Komuniste, tash Partia e Punës; ne ndërtuam pushtetin tonë popullor duke u mbështetur në përvojën e Bashkimit Sovjetik, ne krijuam Ushtrinë Nacional-Çlirimtare duke ndjekur shembullin e Ushtrisë Sovjetike dhe luftuam heroikisht, por çlirimi

---

të njohur udhëheqjes jugosllave se ky ishte një pretendim absurd dhe një kërkese për të hequr dorë nga qëndrimi parimor. Shoku Enver me fakte e dokumenta zbuloi edhe një herë veprimtarinë antimarksiste të KQ të LKJ ndaj vendit tonë.

ynë do të ishte i pamundur pa luftën dhe fitoren e Ushtrisë së lavdishme Sovjetike mbi fashizmin. Nuk ka asnjë dyshim se kështu ka qenë dhe për ju.

Është fakt që ne, komunistët shqiptarë, e kemi dashur sinqerisht popullin jugosllav, partinë tuaj dhe fjalimet e mia që përmendët ju, e vërtetojnë këtë tezë. Por ky fakt nuk duhet të shërbejë për të mbuluar gabimet tuaja gjatë periudhës 1944-1948. Më lejoni të them vetëm disa prej tyre:

Më 1944 një farë oficeri i ushtrisë jugosllave, Velimir Stojnić, që më vonë u emërua ambasador i Jugosllavisë, ndërhyri në mënyrë të palejueshme në punët e Partisë sonë. Këtë gjë e vërtetojnë protokollat e Komitetit Qendror të Partisë sonë. Ju keni botuar materiale kundër nesh. Një letër që ju ka shkruar Nako Spiru është mbajtur e fshehur nga Komiteti Qendror i Partisë suaj, kurse rregullisht, në rrugë marksiste-leniniste dhe në konditat e marrëdhënieve miqësore që ekzistonin në mes dy partive tona, Komiteti Qendror i Partisë Komuniste Jugosllave duhej që menjëherë këtë letër ta denonconte pranë Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Shqiptare. Ai jo vetëm që nuk e ka bërë këtë, por bile më vonë e shfrytëzoi atë dhe me anë të Savo Zllatiçit, përfaqësues i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Jugosllave, i bëri shantazh Nako Spirut dhe e akuzoi përpara udhëheqjes sonë si armik. Krimet e Koçi Xoxes kundër Partisë dhe shtetit tonë filluan menjëherë pas Plenumit të Beratit, ku përfaqësuesi juaj ndërhyri brutalisht në punët e Partisë sonë. Të gjitha këto çfarë janë? Pse është vepruar kështu? I dërguari jugosllav tha: «këto janë gabime taktike të

disa shokëve ndaj të cilëve janë marrë masa». Ju mund të keni marrë dhe masa, për ne nuk ka rëndësi kjo, për ne ka rëndësi fakti që vija e ndjekur nga partia juaj kundrejt Partisë sonë ka qenë e gabuar.

Le të marrim kërkesën tuaj për dërgimin e divizionit të ushtrisë jugosllave në Shqipëri. Ju më thoni se dërgimi i këtij divizioni u kërkua nga Kristo Themelko në Beograd, se gjoja situata në Shqipëri ishte e rëndë etj. Ne i njohim gabimet e Kristo Themelkos, por ne kemi një telegram nga Rankoviçi, i cili i kërkonte Koçi Xoxes dërgimin e divizionit në Shqipëri. Por, se mos ishte çështja vetëm e një divizioni për të dërguar në Shqipëri, ju mendoni të dërgoni disa divizione. Në Shqipëri në këtë kohë kishit dërguar gjeneral Kupreshanin, i cili ofendoi Ushtrinë tonë Nacional-Çlirimtare duke thënë se ajo nuk do t'i rezistonte dot sulmit agresiv grek më shumë se dy ditë. Ne ia hodhëm poshtë këto pretendime atij, por gjeneral Kupreshanin në emër të udhëheqjes jugosllave e paraqiti situatën kaq kërcënuese nga ana e Greqisë sa që tha se në Beograd ishte vendosur të dërgoheshin divizione jugosllave nga ana e Malit të Zi, Kosovë e Metohisë dhe Maqedoni në drejtim të Korçës.

Natyrisht ne u kërkuam këtyre përfaqësuesve jugosllavë, Kupreshanin dhe Savo Zllatiç, të na thoshin nëse do të respektohej Traktati i miqësisë dhe i ndihmës reciproke dhe nëse Jugosllavia do të hynte në luftë në rast se Shqipëria sulmohej nga Greqia. Ata u përgjegjën se jo. Çfarë tregojnë këto çështje?

Po marrëdhëniet ekonomike që u vendosën midis dy vendeve tona a ishin të drejta apo të shtrembra?

Ju pyes për këto sepse, siç thotë, ju kërkon t'i rishikon ato, prandaj na thoni a ishin të drejta, marksiste-leniniste, apo jo? Ne nuk e mohojmë ndihmën tuaj, por duhet thënë se gazetat tuaja edhe tani bëjnë zhurmë për 20 000 ton drithë të dhënë nga Jugosllavia dhe e paraqitin çështjen sikur kjo e paska mbajtur me frymë popullin shqiptar.

Ne nuk bëjmë tregëti kurrë me gjakun e shokëve tanë, por të mos harrojmë se me qindra nga shokët tanë ranë për çlirimin e Jugosllavisë, eveniment ky i vetëm në historinë e popullit shqiptar. Për këtë nuk flitet, por flitet vetëm për 20 000 ton drithë. Kur flasim për marrëdhëniet ekonomike nuk është fjala vetëm për atë pak ndihmë konkrete, por në radhë të parë është çështja e formave të marrëdhënieve dhe mënyra se si jepej kjo ndihmë.

Ju keni pasur marrëdhënie ekonomike me Bashkimin Sovjetik dhe vendet e demokracisë popullore, ata ju kanë ndihmuar, por a keni pasur me ta forma të tilla marrëdhëniesh si ato që keni dashur të vendosni me ne, siç qenë propozimet për parifikimin e monedhës, heqjen e kufirit doganor etj.? Këto kanë qenë marrëdhënie në rrugë normale, shoku ministër, apo në rrugë jonormale dhe antimarksiste? Po propozimi juaj për bashkimin e Shqipërisë me Jugosllavinë a ishte në rrugë marksiste apo antimarksiste? Ne themi se të gjitha këto ishin antimarksiste. Letra e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Shqiptare drejtuar Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Jugosllave për të sqaruar këto çështje mbeti pa përgjegje. Pse nuk u përgjegjët? Këto çështje që ju thashë janë kryesoret, këto kanë qenë

gabimet tuaja, por ka edhe shumë gjëra të vogla që unë nuk dua t'i përmend. Megjithkëtë, në qoftë se udhëheqja jugosllave dëshiron t'i diskutojmë këto çështje, ne jemi gati, ne nuk humbasim asgjë. Për këtë arsye unë thashë se ato që janë thënë në dokumentat e Partisë sonë jo vetëm që janë të drejta dhe marksiste-leniniste, por janë edhe shumë të urta.

Partia jonë dëshiron përmirësimin e marrëdhënieve me Jugosllavinë, por redaktorët e radio Beogradit edhe tani kohët e fundit akuzojnë Partinë tonë dhe personalisht mua si armiq të përhershëm të Jugosllavisë. Duhet të dijë redaktori i radio Beogradit dhe të gjithë ata që punojnë si ai, se urdhërin që u dha Partia jonë divizioneve të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare për të çliruar Malin e Zi, Kosovën, Bosnjën dhe Hercegovinën e kam firmuar unë, po të isha unë armik i popujve të Jugosllavisë nuk do ta bëja këtë. Duhet të dihet nga të gjithë se Partia jonë dhe udhëheqja e saj e kanë dashur dhe e duan popullin jugosllav jo për hatrin e ndokujt e të radio Beogradit, por pse ashtu na e dikton ndërgegjia jonë marksiste-leniniste, pse ashtu na mësojnë Partia dhe interesat e Partisë dhe të popullit tonë.

Ju thoni se do të jeni objektiv në raportimin që do t'i bëni udhëheqjes suaj për këto që biseduam, kjo ka rëndësi, sepse përfaqësuesit diplomatikë të një shteti ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e marrëdhënieve midis dy vendeve, por duhet thënë se personeli i legatës jugosllave nuk vepron në këtë frymë, por në mënyrë armiqësore karshi vendit dhe Partisë sonë. Disa prej tyre shëtisin nëpër rrugët e Tiranës krah për krah me armiq të Partisë.

Ju thatë gjithashtu se radio Beogradi ka bërë gabim, se Jugosllavia e ka çmuar ndihmën e popullit shqiptar dhe të Partisë së tij, dhe se unë jam i vetmi njeri i dekoruar jashtë Jugosllavisë me Urdhërin e Heroit të Popujve të Jugosllavisë; por le të mos shkojmë larg, kohët e fundit gazeta satirike jugosllave «Jezh», në kohën kur Mareshali Tito priti ministrin shqiptar në Beograd, nxori një karikaturë të poshtër kundër udhëheqjes sonë. Gazeta «Jezh» dhe të gjithë ata që mendojnë si «Jezhi» gabojnë rëndë kur thonë se në udhëheqjen e Partisë sonë ka përçarje, ata duhet të dinë se uniteti në Partinë dhe në udhëheqjen tonë është i çelniktë dhe nuk ka forcë në botë që ta rrezikojë. Udhëheqja jonë dhe gjithë Partia, siç e thashë, janë për përmirësimin e marrëdhënieve me Jugosllavinë, por në rrugën marksiste-leniniste dhe jo në tjetër rrugë.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbajtur në këtë takim  
që gjendet në AQP*

**DISA VËREJTJE RRETH KAPITULLIT 41  
«RENDI EKONOMIK I VENDEVE EVROPIANE  
TË DEMOKRACISË POPULLORE»**

*Tekst i «Ekonomisë Politike», botim i dytë rus.,  
i plotësuar<sup>1</sup>*

**20 gusht 1956**

1. — Në faqen 600 të tekstit thuhet: «Shqipëria nga pikëpamja ekonomike ishte një vend i prapambetur me mbeturina të shumta të rendit patriarkalo-gjinor».

Në faqen 608 thuhet: «Në disa vende (në Shqipëri) në fshat ekzistojnë akoma mbeturina të marrëdhënieve patriarkale»:

Në rastin e parë kur flitet për mbeturina të rendit patriarkalo-gjinor është pasur parasysh Shqipëria e paraçlirimit; ndërsa në rastin e dytë është fjala për

---

<sup>1</sup> Këto vërejtje rreth tekstit të «Ekonomisë Politike» i janë dërguar D. T. Shepillovit me kërkesën e tij.



ditët tona kur flitet për sektorin ekonomik të prodhimit të vogël të mallrave.

Ne mendojmë se, si në rastin e parë ashtu edhe në të dytin, pohimi mbi ekzistencën në vendin tonë të mbeturinave të rendit gjinor nuk është i drejtë pasi është në kundërshtim me realitetin historik.

Është e vërtetë se në literaturën e botuar para çlirimit (brenda dhe sidomos jashtë vendit), ka qenë shumë e përhapur pikëpamja se gjoja në viset malore të Shqipërisë së Veriut sundonin marrëdhëniet e gjinisë, se ato gjendeshin akoma në fazën e ekonomisë primitive natyrale, se këtu nuk kishte shkëmbim të mallrave dhe qarkullim të parasë, se malësorët e Veriut gjendeshin në fazën e marrëdhënieve patriarkale etj. Shkurt në shkrimet e historiografëve borgjezë (sidomos të atyre të huajve) është pohuar se në malësitë e Veriut rendi shoqëror i përgjigjej tipareve të demokracisë gjinore, fundi i fundit, në shthurje e sipër.

E vërteta është se popullsia e këtyre krahinave gjendej në kushte shoqërore-ekonomike më të prapambetura se popullsia e pjesës tjetër të Shqipërisë. Por megjithatë bazat ekonomiko-shoqërore të rendit fisnor këtu ishin zhdukur prej kohësh (të paktën që në fillim të shekullit XIX). Prej kohësh këtu kanë ekzistuar lidhjet e rregullta të ekonomisë fshatare me tregun, gjejmë të vendosur pronën private mbi veglat dhe mjetet e prodhimit, mbi tokën, zhvillimin e ekonomisë monetare dhe të mallit, shitjen dhe blerjen e tokës, dhënien e saj me qira, përdorimin e argatëve me mëditje. Ndërsa gjatë sundimit turk dhe pas çlirimit të vendit nga ky

sundim një pjesë e madhe e fshatarëve të varfër të këtyre krahinave kishin filluar të siguronin mjetet e jetesës duke shitur fuqinë e tyre punëtore në qytet.

Pra bazat ekonomike dhe shoqërore të rendit gjinor ishin zhdukur prej kohësh edhe në këto krahina më të prapambetura të vendit tonë.

Po ashtu nuk i përgjigjet realitetit edhe pohimi tjetër se sot në fshatin tonë ekzistojnë mbeturina të marrëdhënieve patriarkale.

2. — Në botimin e parë të tekstit në faqen 575 thuhet: «Shtetëzimi i industrisë së madhe e të mesme, i transportit, i mjeteve të komunikacionit e të tjera, në vendet evropiane të demokracisë popullore u bë me disa intervale. Masat vendimtare në këtë fushë u morën në Poloni më 1946, në Bullgari dhe Shqipëri më 1947, në Hungari, Çekoslllovakia dhe Rumani më 1948».

Në botimin e dytë të tekstit në faqen 603 thuhet: «Shtetëzimi i industrisë së madhe dhe të mesme, i transportit, i mjeteve të komunikacionit e të tjera, në vendet evropiane të demokracisë popullore u bë me disa intervale. Shtetëzimi filloi në vitet 1945-1946 dhe në përgjithësi mori fund në vitet 1947-1948».

Si në botimin e parë të tekstit ashtu edhe në të dytin data e shtetëzimit të mjeteve kryesore të prodhimit për Shqipërinë nuk është e saktë. Në vendin tonë shtetëzimi i industrisë së madhe e të mesme, i mjeteve të transportit, i mjeteve të komunikacionit nuk ka filluar në vitin 1945-1946, si në vendet e tjera, por qysh në vitin 1944. Ajo mori fund kryesisht jo në vitet 1947-1948 por qysh në vitin 1946. Këtë gjë e vërtetojnë të

dhënat e procesit të shtetëzimit të industrisë së madhe e të mesme në vendin tonë:

Viti 1944 (para çlirimit)	indus. private	100%	indus. shtet.	0%
» 1944 pas	»	97%	»	3%
» 1945	»	83%	»	17%
» 1946	»	11%	»	89%

Qysh në vitin 1946 vendi ynë kishte hyrë në etapën e revolucionit socialist dhe në të ekzistonin të gjitha tiparet e periudhës së kalimit nga kapitalizmi në socializëm.

3. — Në paragrafin «karakteri i revolucionit demokratiko-popullor», karakteristikat, format dhe rrugët e këtij revolucioni janë të përgjithshme. Në këto karakteristika nuk del në fakt specifika e revolucionit në vendet e ndryshme. Në karakteristikat e përgjithshme të revolucionit demokratiko-popullor, mbulohet, për shembull, origjinaliteti i zhvillimit të këtij revolucioni në vendin tonë, i cili, pa dyshim, u zhvillua ndryshe nga revolucioni, të themi, në Çekoslovakia, Rumani ose Hungari.

Dihet se në Shqipëri që me krijimin e Partisë Komuniste Shqiptare (sot Partia e Punës e Shqipërisë), Partia jonë ishte e vetmja që organizoi, pregatiti dhe udhëhoqi kryengritjen e armatosur të popullit kundër pushtuesve të huaj fashistë, italianë e gjermanë. Borgjezia e madhe dhe çifligarët e vendit tonë u bashkuan me pushtuesit fashistë dhe e bënë kauzë të përbashkët me ta skllavërimin e popullit dhe pushtimin e vendit. Në kushtet e krijuara PKSHE diti të sigurojë deri në çli-

rim jo vetëm udhëheqjen e vetme të luftës kundër pushtuesve fashistë për çlirimin e vendit, por dhe ta shkrijë këtë luftë me luftën e klasës kundër borgjezisë e çifligarëve që ishin bashkuar me okupatorin dhe kishin tradhëtuar interesat jetike të popullit dhe të atdheut. Si pasojë pas çlirimit të vendit nga pushtuesit e huaj PKSH ishte e vetmja Parti që erdhi në fuqi, që kishte në dorë drejtimin e vendit dhe që nuk e ndau pushtetin me asnjë parti tjetër. Pra vendi ynë, nën udhëheqjen e PKSH për vendosjen e pushtetit popullor, ndoqi rrugën e luftës së armatosur si kundër pushtuesve fashistë ashtu edhe kundër borgjezisë së madhe e çifligarëve vendës.

Për këtë arsye, pas çlirimit, në vendin tonë u krijuan kushte më të favorshme se në vendet e tjera të demokracisë popullore për kalimin në revolucionin socialist.

Në vendin tonë, në fillim të saj, etapa e revolucionit socialist mplekset me etapën e revolucionit demokratiko-borgjez (periudha 1945-1946, ka qenë periudha e reformave ekonomike-shoqërore që, në përgjithësi, i përkisnin revolucionit demokratiko-borgjez por që njëkohësisht i përngjisnin edhe revolucionit socialist. P.sh. ndërsa kryhej reforma agrare paralelisht vazhdonte edhe shtetëzimi i industrisë, financave etj.). Prandaj ne mendojmë që specifika e revolucionit në vendin tonë duhet të dalë ashtu siç është realiteti historik.

4. — Të dhënat statistikore që jepen në faqen 607 të tekstit në lidhje me peshën specifike të sektorit socialist në të ardhurat nacionale në vendin tonë në vitin 1952 nuk janë të sakta. Ato duhen korrigjuar në këtë

mënyrë: në vend të rreth 70 për qind që figuron në tekst të bëhet 45,2 për qind.

5. — Në faqen 607 të tekstit nuk ka të dhëna për Shqipërinë në lidhje me peshën specifike të prodhimit industrial dhe për atë të tregëtisë me shumicë e me pakicë në vitin 1952. Këto mungesa mund të plotësohen në këtë mënyrë: pesha specifike e formës socialiste në prodhimin industrial në vitin 1952 zinte 98 për qind, në tregëtinë me shumicë — 100 për qind dhe në tregëtinë me pakicë — 84,6 për qind.

Gjithashtu në faqen 612 të tekstit nuk ka të dhëna se sa është tejkaluar niveli i prodhimit industrial të Shqipërisë më 1955 në krahasim me paraluftën (1938) dhe në faqen 616 të tekstit nuk ka të dhëna mbi zhvillimin e arësimit e të kulturës në krahasim me paraluftën.

Këto mund të plotësohen në këtë mënyrë: në Shqipëri prodhimi global i industrisë më 1955 ka qenë 10,5 herë më shumë në krahasim me 1938. Ndërsa para lufte në Shqipëri nuk kishte asnjë institut të lartë, në vitin 1953 kishte 6 institute të larta me 857 studentë. Në vitin 1955, në krahasim me vitin 1938, numri i nxënësve në shkollat fillore ishte 266,9 për qind, numri i nxënësve në shkollat shtatëvjeçare ishte 889,7 për qind, numri i nxënësve në shkollat e mesme 551,3 për qind. Në vitin 1955 në Shqipëri kishte 6 institute të larta me 1 595 studentë.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**UDHËHEQJA E PARTISË NË QARKUN E ELBASANIT  
DUHET TË ORGANIZOJË MË MIRË PUNËN PËR  
TË ZBATUAR SI DUHET DIREKTIVAT DHE  
UDHËZIMET E KOMITETIT QENDROR**

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

23 gusht 1956

Edhe unë dëshiroj të them disa fjalë për punën e Partisë në qarkun e Elbasanit. Duke e krahasuar gjendjen e këtij qarku me kohën e mëparshme, del se ka pasur dhe ka përparime dhe përmirësime, por mund dhe duhej të ecej akoma më përpara. E them këtë për arsye se Elbasani ka tradita kulturele, se ai nuk ndodhet larg kryeqytetit dhe ndjen nga afër ndihmën e Partisë e të qeverisë. Qarku i Elbasanit ka një rëndësi të madhe. Në këtë qark, krahas bujqësisë, ka edhe in-

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje të Byrosë Politike u diskutua «Mbi punën e Partisë me fshatin në qarkun e Elbasanit» në bazë të raporteve të paraqitura nga Byroja e Komitetit të Partisë të qarkut të Elbasanit dhe ekipi i Komitetit Qendror të PPSH.

dustri e mjaft ndërmarrje të tjera ekonomike. Megjithkëtë, duhet pranuar se puna e Partisë nuk është e kënaqshme, propaganda e saj nuk është në lartësinë e duhur, shtypi i përditshëm i Partisë, «Zëri i Popullit», «Bashkimi», gazetat dhe revistat e tjera, nuk shfrytëzohen në rregull. Duhet të keni parasysh, shokë, që të organizoni konferenca, por është më mirë që këto të jenë më të pakta dhe më interesante. T'i jepet rëndësi veçanërisht propagandës së vogël, agjitacionit individual dhe për këtë të gjenden forma të përshtatshme në bazë të kushteve jo të njëjta në zona e fshatra të ndryshme.

Partia në këtë qark, në radhë të parë duhet të kuptojë mirë çështjet ekonomike, të cilat nuk mund të zgjidhen në mënyrë administrative. Çështja është që komiteti qarkor duhet të drejtojë më mirë organizatën e Partisë, që ajo të njohë si duhet problemet e bujqësisë, të kulturës etj., dhe të thellohet në kuptimin e vendimeve të qeverisë, të cilat janë edhe vendimet e Partisë. Këto çështje janë të lidhura me realizimin e planit, prandaj duhet t'u kushtojmë një kujdes të madh.

Qarku i Elbasanit nuk është më shumë fanatik dhe më pak patriot se sa qarqet e tjera, por disa dobësi që vihen re shpjegohen me të metat e punës drejtuese të Partisë. Kështu, duke mos aktivizuar sa duhet mësuesit e fshatit, ndodh që në këtë qark të ngrihen gjatë këtij viti 8 xhami. Po kështu ndodh edhe me shtëpitë e kulturës e sallat e leximit, shumë nga të cilat janë lënë pasdore dhe të rinjtë s'kanë se ku të grumbullohen, të edukohen e argëtohen.

Mund të duket sikur Komiteti i Partisë i qarkut të Elbasanit i jep më tepër rëndësi problemeve të bujqësisë, por në të vërtetë nuk është kështu. Fakti që nuk u kërkohet sa duhet llogari komunistëve të fshatit për të zbatuar deri në fund detyrat që shtrohen para tyre, tregon se komitetet dhe organizatat e Partisë në këtë qark nuk punojnë si duhet edhe për bujqësinë.

Udhëheqja e Partisë në qark duhet të organizojë më mirë punën për të zbatuar si duhet direktivat dhe udhëzimet që jep Komiteti Qendror. Çdo lëshim sado i vogël në këtë drejtim, dëmton shumë punën. Të marrim për shembull çështjen e hamulloreve që nuk janë realizuar. Për këtë problem faji është i komitetit të Partisë, i cili nuk ka marrë me kohë masa për të zbatuar udhëzimet e Komitetit Qendror dhe të qeverisë. Përderisa korrjet, shirjet dhe grumbullimi nuk fillojnë e nuk mbarojnë në kohën e duhur, edhe plani i hamulloreve nuk ka si të realizohet. Partia ka forca dhe mundësi të tilla që problemeve t'u dalë përpara, të përgatitet dhe të mobilizohet për realizimin e tyre. Po të ishte organizuar mirë puna, tokat e mbjella me grurë do të ishin li-ruar me kohë dhe SMT-ja do të fillonte punimin e tyre.

Një çështje tjetër e rëndësishme është ajo e grumbullimit të tepërive. Me sa duket, edhe për këtë është bërë një punë deri diku formale. Në qoftë se komiteti i Partisë nuk di nëse ka ose jo mallra me të cilat do të tërhiqen tepricat, nëse kanë vajtur ose jo në vend këto mallra, grumbullimi i tepërive është vështirë të realizohet. Prandaj, për të siguruar tepricat, ju, shokët e Komitetit qarkor të Partisë, duhet t'i sugjeroni Komitetit Qendror dhe qeverisë se ç'mallra kërkohen fshata-



rët, sepse nevojat e fshatarësisë rriten dita-ditës. Këto nevoja duhen parë në perspektivë për të ardhshmen. Në këtë mënyrë të veprohet qysh tani që po hartohet plani i vitit 1957. Ne nuk i kemi mundësitë që në çdo fshat artizanati të organizojë prodhimin e tullave e të tjegullave, për këtë duhet të nxiten edhe fshatarët që t'i prodhojnë vetë. Ndërsa për lëndën e drurit, Ministria e Industrisë duhet të marrë masa serioze për të plotësuar deficitet që janë krijuar, nga ana tjetër të merren masat që lënda e drurit të transportohet me automjete. Gjithashtu Partia të organizojë mirë edhe transportin primitiv për t'i shërbyer fshatarit. Në qoftë se kooperativat nuk e sigurojnë këtë lloj transporti, atëherë vështirësohet dërgimi i mallrave në zonat e thella dhe, për pasojë, tërheqja e tepricave. Për të gjitha këto çështje komiteti i Partisë duhet menjëherë të organizojë kontrollin. Byroja Politike vendosi që plani i tepricave të bëhet duke parashikuar grumbullimin e 75 për qind të tyre, por njëkohësisht u theksua që Partia duhet të përpiqet të grumbullojë edhe ato 25 për qind që u mbeten fshatarëve. Kjo nuk është një punë e lehtë. Duhet të luftohet që tepricat të grumbullohen jo vetëm nga kooperativat, por edhe nga fshatarët individualë.

Lidhur me SMT-të, Partia ka theksuar kurdoherë se ato janë një armë e rëndësishme në duart e saja për kolektivizimin në fshat. Punonjësit e SMT-ve duhet të jenë agjitorët kryesorë të Partisë për të propaganduar të mirat e kolektivizimit. Prandaj Partia duhet t'u japë rëndësi të madhe SMT-ve dhe të futë në radhët e punonjësve të tyre disiplinë të fortë.

Unë bëra një pyetje se si jetojnë fshatarët e Çer-

menikës, për arsye se kjo krahinë dhe zonat e tjera malore të Elbasanit, janë të varfëra. Detyra e Partisë është që të punojë për të përmirësuar më tepër jetesën e fshatarëve të këtyre zonave. Duke marrë parasysh se në qarkun e Elbasanit do të fillojë puna për nxjerrjen e mineralit të hekurit, Partia duhet të fillojë qysh tani një fushatë të madhe për të siguruar nga këto zona krahë pune. Vendosija e fshatarëve të varfër në marrëdhënie pune me shtetin, si në miniera, në ferma dhe në sharrat duhet të jetë një mjet për zhdukjen e prapambetjes dhe për përmirësimin e jetesës së tyre.

Edhe puna e Partisë me organizatat e masave në qarkun e Elbasanit nuk ecën mirë. Udhëzimet që ka dhënë Partia në këtë drejtim nuk po zbatohen si duhet. Është e domosdoshme që edhe për këtë të punohet më mirë.

Kemi bindje se puna e Komitetit të Partisë në qarkun e Elbasanit tani e tutje do të jetë më e gjallë dhe më e mirë, se komunistët dhe gjithë punonjësit do të mobilizohen më shumë për të ecur përpara në luftë me prapambetjen, për të realizuar me sukses detyrat që na shtrohen në të gjitha fushat.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## NGA FJALA NË PRITJEN E DHËNË NGA AMBASADA E RP TË SHQIPËRISË NË PHENIAN

13 shtator 1956

I dashur shoku Kim Ir Sen,  
Të dashur shokë dhe miq,

Ditët e qëndrimit të delegacionit tonë në RDP të Koresë kaluan shumë shpejt, ashtu siç kalojnë kur njeriu ndodhet midis miqsh të shtrenjtë.

Ne i shprehim mirënjohjen Qeverisë së RDP të Koresë që na krijoi të gjitha mundësitë për të vizituar vendin tuaj të admirueshëm, për t'u njohur sa më mirë me gjurmët e luftës së egër që nuk janë zhdukur akoma plotësisht. Ato janë akuza të pamëshirshme kundër agresorëve imperialistë, që me hekur e zjarr deshën të shkatërronin atdheun tuaj të lavdishëm, popullin e lirë korean, që ndërtonte socializmin në atdheun e tij, në RDP të Koresë. Por agresorët u thyen me turp nga populli i pamposhtur korean dhe nga vullnetarët trima të popullit të madh kinez.

Sot RDP e Koresë po rindërtohet me ritëm të shpejtë, ajo po ngrihet më e bukur dhe më e fortë se përpara dhe ecën me vendosmëri në rrugën e socializmit, e rre-

thuar nga kujdesi dhe përkrahja vëllazërore e Bashkimit Sovjetik, e RP të Kinës dhe e vendeve të tjera të kampit socialist.

Ne jemi prekur thellësisht nga pritja vëllazërore, nga dashuria aq e zjarrtë dhe spontane e popullit të kryeqytetit të lavdishëm, Phenian, dhe e gjithë popullit korean kudo që shkuam. Kjo na ka bërë përshtypje të jashtzakonshme dhe do të mbetet e paharruar në zemrat dhe në mendjet tona. Gjatë këtyre ditëve, delegacioni ynë qeveritar vizitoi qytete të ndryshme, ndërmarrje industriale, kooperativa bujqësore dhe qendra kulturele. Ne shkuam në Hidrocentralin e Suphungut, një nga më të mëdhenjtë në botë, të cilin agresorët imperialistë u munduan ta shkatërronin, por që sot është rindërtuar, po zgjerohet dhe është bazë e fuqishme për industrializimin dhe zhvillimin e përgjithshëm të RDP të Koresë.

Në Phenian, Kuson, Hamhin dhe Hinnam ne vajtëm në fabrika të prodhimit të maqinave, të plehrave kimike, të tekstileve e të tjera. Me kënaqësi të veçantë ne pamë një industri të rëndë të fuqishme që keni dhe që po zgjerohet akoma më shumë, si bazë e sigurtë e ndërtimit socialist të vendit.

Ne vizituam fabrikën e plehrave kimike në Hinnam, sistemin e vaditjes në Anxhu, dhe konstatuam se ç'rëndësi i jepet zhvillimit të bujqësisë, e cila luan një rol të madh në ngritjen e mirëqenies materiale të popullit dhe në sigurimin e lëndëve të para për industrinë.

Kudo na ra në sy kujdesi i partisë dhe i qeverisë suaj për të përmirësuar vazhdimisht kushtet e jetesës së popullit. Neve na ka lënë përshtypje të thellë niveli

kultural dhe talenti i popullit tuaj në fushat e ndryshme të krijimit.

Ne u njohëm me klasën punëtore heroike koreane, shtyllë e partisë, që ka ditur të grumbullojë rreth vetes dhe të drejtojë në luftën për liri dhe socializëm të gjitha masat punonjëse dhe forcat patriotike të vendit. Disiplina dhe organizimi në punë që vumë re në uzinat dhe fabrikat, janë shprehje e ndërgegjes së lartë politike dhe e aftësive të klasës suaj punëtore dhe e të gjithë popullit korean.

Në vendosmërinë dhe entuziazmin e zjarrtë të punëtorëve, fshatarëve dhe intelektualëve, të rinisë suaj të mrekullueshme, ne pamë forcën e Partisë së lavdishme të Punës, ne pamë unitetin e çelniktë të popullit rreth partisë së tij të dashur, rreth Komitetit të saj Qendror marksist-leninist me shokun Kim Ir Sen në krye, që dje e udhëhoqi në fitoren e luftës së madhe çlirimtare dhe sot po e udhëheq në fitore të reja, në ndërtimin e jetës së re, ndërtimin e socializmit. Ky unitet është garancia më e madhe e së ardhshmes së lumtur të popullit korean. Me një parti të tillë në krye, me një udhëheqje të tillë, populli korean do të jetë kurdoherë fitimtar.

Kur të kthehemi në atdhe, të gjitha këto do t'ia tregojmë popullit shqiptar. Ne do t'i flasim popullit tonë për miqësinë kaq të zjarrtë që gjetëm këtu te ju, për punën krijuese të popullit të talentuar korean që me plot entuziazëm e vendosmëri dhe me besim të pakufishëm në Partinë heroike të Punës të Koresë dhe në qeverinë e tij demokratike, ndërton të ardhshmen e tij të lumtur. Ne do t'i shpiem popullit tonë ndjenjat e

dashurisë vëllazërore që ushqen populli vëlla korean për popullin shqiptar.

Gjatë qëndrimit tonë në vendin tuaj, ne mësuam nga lufta dhe eksperiencia juaj në mbrojtjen e paqes dhe në ndërtimin e socializmit dhe eksperiencia juaj do t'i vlejë popullit tonë, Partisë dhe qeverisë sonë. Bisedimet që delegacioni ynë pati me ju, shokë udhëheqës të RDP të Koresë, qenë shumë të frutshme për zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve dhe të bashkëpunimit vëllazëror midis dy vendeve tona. Përfundimet e bisedimeve tona do të priten me kënaqësi nga populli shqiptar si dhe nga populli korean sepse ato forcojnë miqësinë tonë reciproke, ato forcojnë çështjen e paqes dhe të socializmit.

Ne konstatojmë me kënaqësi edhe një herë se politika paqësore e të dy shteteve tona demokratike që udhëhiqen nga marksizëm-leninizmi përkrah politikën e uljes së tensionit ndërkombëtar dhe të forcimit të paqes në botë, që ndjek Bashkimi Sovjetik, RP e Kinës dhe i gjithë kampi socialist, në të cilin bëjnë pjesë si RDP e Koresë ashtu dhe RP e Shqipërisë.

Në kohën e sotme kur socializmi është bërë sistem botëror dhe tërheq masat qindramilionëshe të popujve, që luftojnë kundër kolonializmit, kundër luftës, që duan dhe kurdisin qarqet agresive imperialiste, kundër shfrytëzimit kapitalist, politika marksiste-leniniste e paqes dhe e miqësisë midis popujve sa vjen gjen përkrahjen më të zjarrtë në të katër anët e botës.

Rruga e lavdishme që çeli Revolucioni i madh socialist i Tetorit ka bashkuar mbi 900 milion njerëz, ajo do të bashkojë gjithë njerëzimin. Parashikimet gjeniale të

Leninit po bëhen realitet. E ardhshmja është e komunizmit.

Ne i urojmë me gjithë zemër popullit vëlla korean, Partisë së Punës të Koresë dhe qeverisë së RDP të Koresë suksese të reja edhe më të mëdha në ndërtimin paqësor të vendit, u urojmë fitore të plotë në përpjekjet e tyre të drejta për bashkimin paqësor të atdheut, për ndërtimin e socializmit në RDP të Koresë!

Sigurojmë popullin korean se te populli shqiptar ai ka një mik besnik përjetë.

Më lejoni, shokë, të ngre këtë doli për lavdinë e marksizëm-leninizmit, për miqësinë tonë të pavdekshme, për lulëzimin e RDP të Koresë, për Partinë e lavdishme të Punës të Koresë, për Qeverinë e RDP të Koresë, për udhëheqësin dhe birin më të dashur të popullit korean, shokun Kim Ir Sen, dhe për shokët e tjerë udhëheqës të popullit vëlla korean!

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 224 (3433), 14 shtator 1956*

*Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i Popullit», Nr. 224 (3433), 14 shtator 1956*

## NGA PËRSHËNDETJA NË KONGRESIN VIII TË PARTISË KOMUNISTE TË KINËS

18 shtator 1956

Të dashur shokë delegatë,

Më lejoni t'ju sjell përshëndetjet më të zjarrra vëllazërore të Partisë së Punës dhe të të gjithë popullit shqiptar juve dhe, nëpërmjet jush, Partisë Komuniste të lavdishme të Kinës dhe gjithë popullit të madh vëlla kinez.

Kongresi juaj VIII, i cili është një ngjarje historike për popullin kinez, ka një rëndësi të madhe ndërkombëtare. Nga punimet e tij, nga eksperiencia juaj e madhe, ne do të nxjerrim mësimë shumë të vlefshme që do të na shërbejnë në luftën tonë për ndërtimin e socializmit.

Në raportet që u mbajtën në kongres ne pamë rrugën e lavdishme nëpër të cilën ka kaluar Partia Komuniste e Kinës nën udhëheqjen e Komitetit të saj Qendror me shokun Mao Ce Dun në krye, ne pamë perspektivat e shkëlqyera që hapen përpara popullit kinez. Partia Komuniste heroike e Kinës për 35 vjet e ka udhëhequr me vendosmëri popullin kinez në luftën çlirimtare shumëvjeçare kundër imperializmit dhe reaksionit të



brendshëm. Nën udhëheqjen e saj triumfoi revolucioni kinez, populli i madh 600 milionësh u çlirua një herë e përgjithmonë nga zgjedha shekullore dhe u bë zot i vërtetë i fateve të tij. Partia Komuniste e Kinës, duke u mbështetur në mësimet e marksizëm-leninizmit, me urtësi po e drejton popullin kinez drejt ndërtimit të socializmit, drejt transformimit të Republikës Popullore të Kinës nga një vend i prapambetur agrar në një shtet të fuqishëm industrial.

Republika Popullore e Kinës ka dalë në arenën ndërkombëtare si një fuqi e madhe, e cila po ushtron çdo ditë e më shumë një influencë të konsiderueshme. Sot, për çdo njeri, është e qartë se pa Kinën Popullore nuk mund të zgjidhet asnjë problem i rëndësishëm ndërkombëtar. Prandaj këmbëngulja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe e disa qeverive që janë nën presionin e tyre për t'i mohuar popullit të madh kinez vendin plotësisht të merituar në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, është një absurditet i pathemeltë. Ne jemi të bindur se shpejt do t'i jepet fund kësaj padrejtësie, ashtu siç do t'i jepet fund edhe zgjidhjes së çështjes së çlirimit të ishullit kinez, Taivanit, e të bashkimit të tij me Republikën Popullore të Kinës, që është çështje e rëndësishme e popullit kinez.

Shokë,

Mijëra kilometra larg jush, në brigjet e detit Adriatik, populli shqiptar, i udhëhequr nga Partia e tij e Punës, po me atë entuziazëm dhe heroizëm që ka luftuar

për çlirimin e vendit nga okupatorët dhe nga sundimi i feudoborgjezisë, lufton për ndërtimin e socializmit, për lulëzimin e atdheut të tij. Gjatë 12 vjetëve që nga çlirimi te ne janë arritur mjaft suksese. Prodhimi industrial është rritur 10 herë e gjysmë në krahasim me paraluftën, vendi ynë i prapambetur agrar u kthye në një vend agraro-industrial. Suksese të mëdha janë arritur edhe në zhvillimin e kulturës. U zhduk analfabetizmi në gjithë popullsinë nën 40 vjeç. Arësimi fillor në të gjithë vendin dhe ai 7-vjeçari në qytete e shumë fshatra janë bërë të detyruar, u ngritën për herë të parë institute të larta, po zhvillohen me sukses letërsia dhe artet.

Kongresi III i Partisë sonë aprovoi direktivat e planit të dytë pesëvjeçar. Me planin e dytë pesëvjeçar ne hedhim një hap të ri në rrugën e ndërtimit të socializmit, në rritjen e prodhimit industrial dhe bujqësor. Një nga detyrat themelore të këtij plani përveç zhvillimit të mëtejshëm të industrisë sonë, është shtrirja e kolektivizimit të bujqësisë, zgjidhja përfundimtare e çështjes së riorganizimit të saj mbi baza socialiste. Populli dhe Partia jonë do t'i plotësojnë me nder këto detyra.

Populli ynë është i sigurtë në të ardhshmen e tij, sepse atë e udhëheq në rrugën e socializmit Partia e tij marksiste-leniniste, sepse e ndjen veten të rrethuar nga dashuria dhe nga ndihma e vazhduar dhe e pakursyer e Bashkimit Sovjetik, e Kinës së madhe dhe e popullit të saj heroik dhe e të gjitha vendeve të demokracisë popullore. Populli ynë ushqen një dashuri të pakufishme për popujt e këtyre vendeve. Përkrah tyre populli ynë prej 1 milion e 400 mijë vetësh rron i lirë, u reziston me

guxim të gjitha presioneve të armiqve, ndërton me sukses jetën e re socialiste, ekonominë dhe kulturën e tij të përparuar.

Shokë,

Një miqësi e thellë e lidh popullin shqiptar me popullin vëlla kinez. Të dy popujt tanë i bashkon gjaku i derdhur kundër armiqve të përbashkët, kundër imperialistëve, për liri dhe pavarësi; ne na bashkojnë interesat, qëllimet dhe idealet e përbashkëta. Ne së bashku luftojmë për të ardhshmen nën një flamur, nën flamurin e marksizëm-leninizmit, nën flamurin e internacionalizmit proletar. Popujt tanë përfaqësojnë popullin më të madh dhe atë më të voglin në numër, si edhe pikat më ekstreme gjeografike të kampit të socializmit, por asnjëra dhe as tjetra nuk mund të jenë pengesë për një miqësi të vërtetë, për një bashkëpunim të ngushtë në interes të të dy vendeve tona, siç është miqësia jonë e pavdekshme.

Populli shqiptar me interesim të madh ndjek luftën e popullit të lavdishëm kinez për ndërtimin e socializmit. Ai krenohet dhe gëzohet pa masë për fitoret tuaja, të cilat i konsideron si fitoret e veta. Populli shqiptar i është mirënjohës popullit vëlla kinez dhe Partisë së tij Komuniste për ndihmën e madhe që i jep popullit tonë për ndërtimin e së ardhshmes së tij. Ne ju sigurojmë se populli ynë dhe Partia e tij e Punës do të shtojnë miqësinë dhe dashurinë e tyre për ju; te vendi dhe populli ynë ju keni kurdoherë një mik besnik dhe të sinqertë.

Më lejoni, të dashur shokë, që në emër të Komitetit

Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, t'ju uroj me gjithë zemër punë të mbarë në punimet e këtij kongresi, suksese gjithnjë më të mëdha në punën tuaj për ndërtimin socialist të Kinës.

Rroftë Kongresi VIII i Partisë Komuniste të Kinës!

Rroftë populli i madh kinez, Partia Komuniste e lavdishme e Kinës dhe Komiteti i saj Qendror me shokun Mao Ce Dun në krye!

Rroftë miqësia e pathyeshme midis popullit shqiptar dhe popullit të madh kinez!

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 227 (2496), 19 shtator 1956*

*Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i Popullit», Nr. 227 (2496), 19 shtator 1956*

**FJALA NË MITINGUN E ORGANIZUAR NË TIRANË  
ME RASTIN E KTHIMIT TË DELEGACIONIT TË PPSH  
QË MORI PJESË NË KONGRESIN VIII  
TË PK TË KINËS**

**7 tetor 1956**

Të dashur shokë e shoqe,  
Qytetarë të Tiranës,

Siç e dini, një delegacion i Partisë sonë të Punës mori pjesë në Kongresin VIII të Partisë Komuniste të Kinës. Ne patëm nderin e madh që të përfaqësojmë Partinë tonë heroike dhe të njihemi nga afër me popullin e madh kinez.

Kina Popullore është një vend i madh, ajo ka një popull të mrekullueshëm, luftëtar e trim, punëdashës dhe ndërtimtar, të aftë e të zgjuar dhe mbi të gjitha një popull shumë të dashur e modest. 15 ditë që vazhdoi punimet e tij kongresi i partisë atje u bë bilanci i fitoreve të arritura nga populli kinez dhe u caktuan detyrat për të ardhshmen. Që nga Kongresi VII kishin kaluar plot 11 vjet. Gjatë kësaj kohe, nën udhëheqjen e Partisë së tij të lavdishme Komuniste, populli kinez ka arritur një sërë suksesesh me rëndësi historike. Më 1949 ai u çlirua plotësisht nga zgjedha e imperialistëve dhe e klikës së

Çan Kai Shisë, ai realizoi reformën agrare dhe me sukses përfundoi revolucionin demokratiko-borgjez, si rezultat i të cilit u likuiduan çifligarët e vendit, filloi etapën e revolucionit socialist dhe tani po ndërton me shpejtësi socializmin. Në rrugën e ndërtimit të socializmit populli kinez ka bërë hapa viganë, si në fushën e bujqësisë ashtu edhe në atë të industrisë, tregëtisë, artizanatit, të kulturës dhe të arteve.

Kolektivizimi i bujqësisë pothuajse ka marrë fund definitivisht në të gjithë vendin. Mbi 90 për qind e industrisë dhe e tregëtisë janë transformuar në socialiste, ato i përkasin shtetit të diktaturës popullore. Me hapa të shpejtë po zhvillohet kultura, po shtohet numri i shkollave dhe përgatiten mundësitë për realizimin në të ardhshmen të arësimit fillor të detyruar. Populli kinez me entuziazëm lufton për zbatimin e vijës së Partisë, ai me besim dhe optimizëm ecën përpara drejt së ardhshmes së lumtur.

Gjatë qëndrimit tonë në Kinë ne vizituam shumë qytete. Ne, veç Pekinit, ishim në Nankin, në Shangai, Tientsin, Dajren, Mukden, Port-Artur dhe Anshan; ne ishim në fabrika e uzina të ndryshme, në kooperativa bujqësore e shkolla, biseduam me punëtorë, me fshatarë dhe me njerëz të artit e të kulturës. Kudo, te të gjithë, ne vumë re entuziazmin, besimin në të ardhshmen, dashurinë e madhe që ushqenin ata për Partinë e tyre Komuniste, për shokun Mao Ce Dun. Në kontaktet me popullin kinez ne pamë se çfarë energjish të pashtershme zotëron ai popull i lavdishëm, se ç'duar të arta ka ai, se sa të shkëlqyera janë perspektivat e tija.

Kongresi VIII i Partisë Komuniste të Kinës aprovoi

direktivat e planit të dytë pesëvjeçar. Ato parashikojnë zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë dhe të industrisë. Duke i dhënë rëndësi në radhë të parë zhvillimit të industrisë së rëndë, do të krijohet mundësia për industrializimin socialist të vendit. Më 1962, me prodhimet e saj, Kina do të sigurojë 70 për qind të të gjithë maqinerisë dhe të pajisjeve industriale që nevojiten për ndërtimin socialist të vendit. Jeta e popullit do të përmirësohet me shpejtësi. Të ardhurat nacionale do të rriten 50 për qind në krahasim me planin e parë pesëvjeçar, ndërsa paga e punëtorëve dhe e nëpunësve, si dhe të ardhurat e fshatarësisë, do të rriten 25-30 për qind më tepër. Nuk ka dyshim se këto detyra do të realizohen plotësisht nga punonjësit kinezë.

Kongresi VIII i Partisë Komuniste të Kinës tregoi lidhjet e ngushta që ka partia me popullin e madh kinez. Në të tri raportet që u mbajtën, u theksua se forca e partisë qëndron në lidhjet e saja me masat e gjera të punëtorëve dhe të fshatarëve. Prandaj detyra e partisë është t'i forcojë këto lidhje, të bashkojë masat në luftë për socializmin, të marrë mendimin e tyre për çdo çështje dhe t'i mobilizojë ato për realizimin e detyrave të mëdha që shtrohen përpara vendit.

Politika e drejtë që ka ndjekur Partia Komuniste e Kinës ka bërë që masat e gjera të popullit të bashkohen me partinë, ka bërë që edhe të gjithë elementët progresistë, patriotë, të shtresave të ndryshme të borgjezisë nacionale dhe të intelektualëve të njohin udhëheqjen e partisë dhe krah për krah me punonjësit, të luftojnë për lulëzimin dhe përparimin e Kinës Popullore.

Lidhjet e ngushta të Partisë Komuniste me popullin

ne i pamë kudo që shkuam; ne i pamë në parakalimin dhe në manifestimin popullor që u bë në Pekin me rastin e festës kombëtare, më 1 tetor. Parakalimi madhështor i ushtrisë tregoi forcën e madhe të Kinës Popullore, teknikën e saj të fuqishme dhe disiplinën shembullore. Qindra mijëra vetë, pas ushtrisë, manifestuan dashurinë e tyre për partinë dhe vendosmërinë për të ardhshmen. Entuziazmi i papërshekrueshëm i manifestuesve na bëri përshtypje të jashtzakonshme. Populli e ndjente veten zot të fateve të tij. Ai, pasi fitoi lirinë, i udhëhequr nga partia e tij e lavdishme, po ndërton shoqërinë socialiste.

Shokë,

Te populli kinez ne kemi një mik të shtrenjtë dhe shumë të dashur. Në zemrat e punonjësve kinezë është ngulur thellë dashuria për popullin tonë. Këtë ne e pamë kudo: te punonjësit e Pekinit, punëtorët e Shangait apo të Anshanit, te kooperativistët e ushtarakët dhe te secili që takuam gjatë qëndrimit tonë në Kinë. Të gjithë me vëmendje na dëgjonin kur u flisnim për popullin dhe vendin tonë, interesoheshin për jetën te ne, dinin shumë gjëra për sukseset që ka arritur populli ynë në luftën e tij për socializmin.

Këtë dashuri dhe interesim për vendin tonë ne e pamë edhe te udhëheqësit e Partisë Komuniste dhe të shtetit kinez. Ne patëm takime me shokët Mao Ce Dun, Çu En Lai, Çu De e të tjerë. Të gjithë folën me simpati për popullin tonë dhe na porositën t'i transmetojmë atij



përschendetjet e tyre miqësore. Veçanërisht një dashuri të madhe ka për vendin tonë shoku Mao Ce Dun. Ai e quajti popullin tonë një popull heroik, luftëtar. Ai foli me shumë simpati për Partinë tonë të Punës, për qëndrimin e drejtë dhe vijën e saj konsekuente marksiste-leniniste. Ai na tha se në rrugën e tij të ndërtimit të socializmit populli shqiptar do të ketë, si kurdoherë, ndihmën vëllazërore të popullit kinez. Kjo është detyra jonë internacionaliste, tha ai, ndaj popullit shqiptar.

Le ta ruajmë, shokë, dhe ta shtojmë gjithnjë e më shumë këtë miqësi të shtrenjtë, e cila lidh popullin tonë me popullin vëlla kinez!

Idetë fitimtare të marksizëm-leninizmit i kanë bashkuar popujt tanë përjetë njëri me tjetrin. Së bashku, popujt tanë, duke ndihmuar njëri-tjetrin, do të ndërtojnë socializmin. Së bashku ata luftojnë për të mbrojtur paqen në botë.

Rroftë Republika Popullore e Kinës, Partia e saj Komuniste me shokun Mao Ce Dun në krye!

Rroftë miqësia e popullit tonë me popullin kinez!

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 244 (2513), 8 tetor 1956*

*Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i Popullit», Nr. 244 (2513), 8 tetor 1956*

Rëndësi ka që të sqarojmë masat në bazë të orientimeve të Kongresit III të Partisë sonë dhe të mësimëve që dolen në Konferencën e Tiranës. Të afrohen më shumë njerëzit me Partinë dhe të punojnë. Në këtë drejtim Partia jonë duhet të luftojë si kurdoherë kundër burokratizmit. Natyrisht, burokratizmin nuk duhet ta kuptojmë sikur shfaqet vetëm në punën me letra e shkresa. Jo. Ai shfaqet jo vetëm në drejtim të zbatimit të detyrave shtetërore, por edhe në çështje të punës politike, të zbatimit të vijës politike të Partisë, shfaqet në të gjitha format e vjetëruara të punës. Të marrim, për shembull, mbledhjet apo konferencat që zhvillohen. Pse ka mjaft njerëz që nuk vijnë në këto konferenca ose mbledhje? Kjo ndodh sepse disa njerëzve u duket sikur i dinë të gjitha çështjet dhe s'kanë shumë nevojë të mësojnë e të përfitojnë nga mbledhjet apo konferencat.

Në rrugën tonë për fitoren e revolucionit dhe ndërtimin e socializmit ne kemi mendime të kundërta me partinë polake apo hungareze, por këto nuk mund t'i zgjidhim duke hyrë në konflikt me to. Ne e kemi për detyrë të mbrojmë marksizëm-leninizmin, që përshkon tejpertej vijën e Partisë sonë, ta propagandojmë këtë vijë dhe të mos pajtohemi me ata që thonë se vija jugosllave është e mirë. Ne nuk kemi frikë të themi si gabimet tona, ashtu dhe gabimet e të tjerëve, sepse vija e Partisë sonë është ndërtuar plotësisht mbi bazat e marksizëm-leninizmit.

Në mënyrë të organizuar ne duhet të propagandojmë sistemin tonë, sukseset që kemi arritur në të gjitha fushat dhe të sqarojmë si duhet masat punonjëse. Sa për partitë e tjera, t'u themi njerëzve tanë se kjo është

punë e tyre, se ato parti kanë format e veta, ashtu si ne që kemi format tona, të cilat janë të drejta dhe na kanë dhënë rezultate të mira. Po të zbatohen kurdoherë si duhet format tona të punës, do të korren rezultate, prandaj ne i kemi mbrojtur dhe do t'i mbrojmë ato. Por kjo s'do të thotë se format e punës ne nuk do t'i ndryshojmë. Në punën politike, organizative e kudo, ato do të ndryshojnë në vartësi me kushtet e reja, me detyrat që shtrohen, me problemet që duhen zgjidhur.

Në qytetin e Tiranës, një rëndësi të madhe ka puna për edukimin e intelektualëve, kujdesi i Partisë për zhvillimin e tyre politik, ideologjik, kultural, ndihma që u duhet dhënë atyre për të jetuar e punuar si revolucionarë. Kjo është e domosdoshme. Në kryeqytet ka një numër jashtëzakonisht të madh mësuesish, shkrimtarësh, artistësh etj. Ka prej tyre të mbyllur në vetëvete, që ruajnë pikëpamje të gabuara, të cilat organizata e Partisë duhet t'i njohë, me qëllim që të orientohet, të dijë të ndërtojë punën e vet. Por në punën me intelektualët ka raste që bëhet një politikë sektare. Nuk them që ata t'i futim të gjithë në Parti, se anëtarë të Partisë do të pranohen ata që plotësojnë kushtet dhe e meritojnë këtë titull të lartë, por është çështja që intelektualët t'i aktivizojmë më shumë, që njerëzve pa parti, patriotëve, t'u japim më tepër besim. Besimi ndaj njerëzve pa parti i bën ata që të jenë zjarr dhe të mobilizohen në punë me të gjitha forcat. Këtë ta kuptojnë mirë jo vetëm drejtuesit, por të gjithë komunistët. Të luftohen në këtë drejtim shfaqjet e arrogancës, të përbuzjes dhe mospërfilljes që tregohen shpeshherë ndaj disa intelektualëve. Qëndrimet sektare janë të huaja për Partinë tonë.

Parimet t'i ruajmë, t'i zbatojmë drejt dhe me vendosmëri. T'i studjojmë thellë këto çështje dhe të bëjmë kthesë, pse kështu do të kemi rezultate më të mira. Bazën e kemi të fortë, vetëm duhet më shumë punë edukative me komunistët dhe punonjësit.

Vija e Partisë sonë ka qenë dhe është një vijë marksiste-leniniste. Armiku do të përpiqet të pengojë zbatimin e kësaj vije të drejtë të Partisë, ai do t'i konsiderojë dobësitë e disave sikur janë dobësi të politikës së përgjithshme të Partisë. Qëndrimet oportuniste të disa elementëve, që nuk e kuptojnë drejt zbatimin në praktikë të vijës së Partisë dhe, si pasojë, kalojnë nga e djathta, armiku do të përpiqet t'ia atribuojë vijës së Partisë. Në qoftë se në zbatimin e kësaj vije ka njerëz që gabojnë, që bien në oportunizëm ose sektarizëm, këto janë gabime të njerëzve të veçantë dhe jo të Komitetit Qendror. Komiteti Qendror asnjëherë nuk ka gabuar në vijë.

Po ta shikojmë më me kujdes çështjen duke bërë një analizë më të thellë, do të vëmë re se gabime në zbatimin e drejtë të vijës së Partisë nuk ka vetëm këtu në Tiranë, po edhe në rrethe të tjera. Kudo ka anë të mira, ka suksese, po ka dhe mungesa në organizimin e punës edukative të Partisë. Format e edukimit kanë dhënë rezultate, po këto nuk janë të mjaftueshme. Po t'i zgjerojmë më shumë format dhe të thellojmë e të përmirësojmë më tej përmbajtjen e tyre duke shtuar edhe ndihmën për Komitetin e Partisë të Tiranës, rezultatet do të jenë më të mëdha dhe kryeqyteti do t'i japë tonin gjithë punës së Partisë në vendin tonë.

Prandaj shokët të mendojnë edhe për forma të tjera

të punës politike me masat dhe jo vetëm duke organizuar konferenca. Ja, për shembull, te ne ka akoma njerëz që nuk e kanë parë Kombinatin e Tekstileve «Stalin». Është organizuar ndonjëherë, bie fjala, vajtje e gjithë mësuesve të kryeqytetit për të parë fabrikat e këtij kombinati ose fabrikën e këpucëve etj.? Po të bëhen vizita të tilla nuk është nevoja të shoqërohen me ndonjë konferencë, po drejtori ose tekniku t'u flasë diçka vizitorëve jo në kuptimin teknik, po në mënyrë politike, t'u thotë atyre: «Ja stofrat që më parë s'i prodhohim në vend, ja dhe gjithë këta punëtorë e punëtore që punojnë në këtë vepër, për të cilën edhe ju keni dhënë kontributin tuaj, pse keni mësuar gjithë këta njerëz që punojnë këtu». Pra, të ngrihen e të inkurajohen elementët intelektualë, të cilët të jenë nën influencën e plotë të Partisë sonë.

Kërkesa për të aktivizuar më shumë intelektualët do të gjejë rezistencë në disa komunistë, bile dhe në disa drejtues të komiteteve të Partisë, por ne jemi të bindur se në punë e sipër problemi do të kuptohet më mirë. Në këtë proces, natyrisht, do të bëhen edhe gabime, por të mos kemi frikë nga gabimet, prej tyre do të mësojmë. Edhe çështja e përgjegjësive lidhet me gabimet që bëhen. Ka raste që duket një farë druajtje për t'u dhënë përgjegjësi shokëve nën pretekstin se «nuk dinë», «ky nuk e bën» etj. Disa shokë në vend që të veprojnë me inisiativë dhe me përgjegjësi, shpeshherë mendojnë të pyesin më të madhin, ose komitetin e Partisë. Kështu krijohet mendimi se më përgjegjësi, më i madhi, ose komiteti i Partisë, i dinë të gjitha. Por nuk ka njeri që të mund t'i dijë të gjitha gjërat. Prandaj shtrohet detyra që të mësojmë vazhdimisht.

Kemi arritur në një stad të tillë zhvillimi që kërkesat e masave shtohen gjithnjë e më tepër. Këto kërkesa ka mundësi të përballohen duke përsosur vazhdimisht organizimin, format dhe metodat e punës. Prandaj le të na shërbejë ky diskutim që iu bë çështjeve të edukimit ideologjik në Tiranë për ta përmirësuar më tej këtë punë në të gjithë vendin. Duke u bazuar në vijën dhe direktivat e drejta të Partisë sonë, të përdorim kurdoherë forma të reja pune, të gjallërojmë veprimtarinë ideo-politike dhe edukative me komunistët dhe masat. Ne duhet të punojmë më shumë dhe më mirë e kurdoherë si revolucionarë.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## LETËR DËRGUAR SHOKUT MARSEL KASHEN

[Tetor] 1956

Shumë i dashur dhe i nderuar shoku Kashen,

Unë përfitoj nga rasti i kthimit nga pushimet që kaloj në Shqipëri shoku Monmuso për t'Ju shkruar këto radhë dhe për t'Ju thënë se sa e dashur është për ne dhe na bën të lumtur të dimë për Ju se jeni mirë me shëndet. Me gjithë zemër ne Ju urojmë, shumë i dashur shok dhe mik, jetë të gjatë, të lumtur!

Ne ruajmë një kujtim të paharruar nga qëndrimi Juaj midis nesh. Partia jonë dhe populli ynë Ju janë mirënjohës, sepse qëndrimi Juaj i shkurtër te ne ka qenë në të njëjtën kohë një ndihmë shumë e çmueshme për forcimin e pozitave të Partisë sonë dhe të vendit tonë në planin ndërkombëtar. Artikujt Tuaj në gazetën «Hymanite» e kanë ndihmuar shumë vendin tonë sepse ishin shkrime që dilnin nga zemra e njërit prej militantëve më të mëdhenj të lëvizjes punëtore ndërkombëtare dhe të një militanti të shquar komunist, i cili është jo vetëm krenaria e Partisë Komuniste Franceze, por e të gjitha partive komuniste e punëtore të botës së tërë.

Shumë i dashur shoku Kashen,

Unë nuk do të doja t'Ju lodhja duke Ju shkruar gjatë mbi zhvillimin e vendit tonë, sepse e di që shoku Monmuso do t'Ju tregojë ato që ka parë dhe ka konstatuar te ne, po kështu edhe Zhan Bako, që është mjeshtër për këtë çështje, dhe do të jetë një tablo objektive e gjendjes te ne sepse shoku Monmuso është një militant i vjetër, plot me eksperiencë, me një zemër të artë dhe që e do me pasion popullin tim të vogël dhe vendin tim.

Shumë i dashur shoku Kashen,

Unë e di që Ju i kuptoni më mirë se çdo njeri tjetër dëshirat e pangopura të të rinjve. E mirë, pra, ja, ne do të donim që Ju të vinit prapë te ne për të kaluar pushimet e ardhshme dhe nuk do të kënaqeshim me një qëndrim të shkurtër, por të qëndronit disa muaj dhe së bashku me të gjithë familjen Tuaj dhe me cilindo shok që është i dashur për ne dhe që është afër Jush.

Ne e quajmë këtë një nder të madh për Partinë tonë dhe për popullin tonë që shikon te Ju një nga miqtë më besnikë.

Ju lutem, shoku Kashen, t'u transmetoni shokëve Moris, Zhak, Raimond dhe të gjithë të tjerëve urimet e mia më të mira, shëndet të mirë dhe lutju atyre nga ana ime që të mos e harrojnë premtimin për të ardhur në Shqipëri.

Shumë i dashur shoku Kashen,

Ju lutem të pranoni në emër të Komitetit tonë Qendror dhe në emrin tim personal përshëndetjet më të përzemërta; ne do të donim me gjithë zemër t'Ju shtër-



ngonim në krahët tanë, sikurse thotë populli ynë, dhe Ju urojmë një jetë të gjatë si atë të maleve, siç thotë një fjalë e popullit!

Me shumë respekt dhe dashuri për Ju  
Në të mirën Tuaj

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas  
origjinalit në frëngjisht që  
gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë*

## **DISA ÇËSHTJE NË LIDHJE ME MARRËDHËNIET MIDIS VENDEVE TË KAMPIT SOCIALIST**

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH*

**3 nëntor 1956**

Këtë mbledhje të Byrosë Politike po e zhvillojmë për të biseduar disa çështje në lidhje me marrëdhëniet midis vendeve të kampit tonë socialist.

Ne të gjithë jemi në dijeni për zhvillimin e ngjarjeve në Hungari dhe në Poloni. Por lidhur me këtë është për t'u vënë në dukje se nga ana e Bashkimit Sovjetik, si në rrugë partie, ashtu dhe në rrugë shtetërore, deri tani nuk na është thënë asgjë rreth këtyre ngjarjeve.

Para 20 ditësh na erdhi një letër nga KQ i PK të Bashkimit Sovjetik, ku na thuhet se do të shkojë në Poloni një delegacion i tyre i përbërë nga shokët Hrushov, Molotov, Kaganoviç dhe Mikojan. Në këtë letër theksohet se gjendja në Poloni është e rrezikshme për kampin socialist, veçanërisht për Bashkimin Sovjetik, dhe premtohet se në të ardhshmen do të na mbajnë për

çdo gjë në korrent të ngjarjeve. Por pas kësaj letre nuk kemi asgjë të re prej tyre, asnjë informatë.

Ngjarjet që zhvillohen në Hungari ne i kemi marrë vesh nga transmetimi që bën vetë radioja e këtij vendi, nga ato fare pak gjëra që ka dhënë radio Moska, agjencia TASS dhe radiot e vendeve të tjera të kampit tonë. Radioja çekoslovakë ka transmetuar disa informacione, nga të cilat ka që ngjarjet në Hungari cilësohen siç mendojmë ne, si një lëvizje kundërrevolucionare, që kërkon të shkatërrojë pushtetin e demokracisë popullore në Hungari dhe të sjellë në fuqi kapitalistët. Ndërsa agjencia TASS ka dhënë vetëm deklaratën e qeverisë sovjetike si dhe disa gjëra të vogla. Në komunikatën e parë që dëgjuam thuhej se kundërrevolucioni në Hungari u shtyp dhe në Budapest u vendos qetësia etj. Mirëpo fakti është se qetësia nuk është vendosur dhe nga radiot e Perëndimit dëgjojmë se në Hungari po shkojnë ushtri nga Bashkimi Sovjetik e Rumania, të cilat kanë zaptuar aerodromet hungarezë dhe kanë rrethuar Budapestin<sup>1</sup>.

Për Partinë e Punës të Shqipërisë dhe udhëheqjen e saj ka qenë dhe është e qartë se, pavarësisht nga disa gabime që mund të jenë bërë në Hungari në çështjet ekonomike, siç mund të jetë mosmbajtja parasysh e proporcioneve midis degëve të ekonomisë, gjë që, natyrisht,

---

<sup>1</sup> Siç doli qartë më vonë, grupi i Hrushovit ngurronte t'i hidhte në veprim trupat sovjetikë për të shtypur kundërrevolucionin. Vetëm përballë presionit të madh nga poshtë dhe sidomos kur pa se Hungaria po dilte jashtë sferës së ndikimit të tij, ai u detyrua më në fund të lejonte Ushtrinë Sovjetike të shkonte në ndihmë të mbrojtësve të revolucionit hungarez.

ka rënduar në nivelin e jetesës së popullit, ekzistonte mundësia e korigjimit dhe e ndreqjes së tyre, ashtu siç është vepruar edhe gjetiu. Rakoshi me disa shokë të tjerë mund të kenë përgjegjësi për gabime të tilla, por mendimi im është se fajet e tyre nuk janë aq të rënda dhe të mëdha saqë ai me shokë të hiqeshin fare nga udhëheqja. Vetëm në një gjendje ku ekziston fryma antimarksiste dhe antirevolucionare kundër pushtetit popullor dhe kampit të socializmit, siç ndodh në fakt në Hungari, mund të skartoheshin elementë komunistë si Rakoshi me shokë, që kanë një aktivitet dhe të kaluar të gjatë revolucionare.

Veprimet e elementëve antimarksistë në Hungari, që s'kanë asnjë lidhje me marksizmin, janë veprime fashiste dhe kanë qind për qind përkrahjen e reaksionit dhe të imperializmit. Megjithëse këta elementë e fshehin dhe e maskojnë veprimtarinë e tyre, nuk mungojnë provat që tregojnë se ata kanë organizuar dhe nxitur zhvillimin e ngjarjeve kundërrevolucionare, duke minuar edhe pozitat e elementëve të shëndoshë në Partinë e Punonjësve Hungarezë. Këta elementë antimarksistë, nën maskën e disa gabimeve që, siç thashë, mund të ndreqeshin, manevruan dhe morën në dorë fuqinë, duke e shpënë Hungarinë në një gjendje katastrofale.

Ne kemi mundësi që këto çështje t'i gjykojmë më me kompetencë dhe gjakftohtësi, sepse nuk na mungon eksperiencia e intrigave dhe e manevrave të klikës së Titos kundër vendit tonë. Kundërrevolucioni në Hungari është nxitur nga titistët jugosllavë, të cilët nuk munguan të flasin se gjoja në Hungari janë bërë gabime të rënda ndaj disa njerëzve, që, sipas tyre, janë dënuar

padrejtësisht nga «banda e Rakoshit». Kush na qenkan këta njerëz? Një nga këta është Imre Nagi.

Kur kaluam për në Moskë<sup>1</sup> ne patëm në Budapest një takim me shokët e Byrosë Politike të Partisë së Punonjësve Hungarezë. Midis të tjerash ata na thanë se kur Imre Nagi kishte ditëlindjen e tij ftoi 150 vetë, në mes të të cilëve edhe anëtarë të KQ e ministra. Një anëtar i të KQ që kishte pyetur në duhej ose jo të shkonte në festën e ditëlindjes së Imre Nagit, i është dhënë kjo përgjigje: «vendos vetë me inisiativën tënde!». Në këtë rast unë pyeta: «pse nuk i thatë copë se Imre Nagi është armik dhe s'duhet të shkosh për darkë te ai?» «Po ja, më thanë, e lamë në ndërgjegjen e tij, ta gjykojë e ta vendosë vetë». Ja, shokë, një nga momentet që tregon se ç'situatë e rëndë është në Hungari. Është e qartë se Imre Nagi përkrahet për t'iu kundërvënë Rakoshit dhe pjesës së shëndoshë të partisë. Megjithatë u manevrua në mënyrë të tillë që Imre Nagi të udhëheqë kundërrevolucionin. Në këtë çështje del se Rakoshi ka pasur të drejtë.

Njerëzit si Janosh Kadari, Rajku dhe të tjerë si këta, kanë punuar për të likuiduar Partinë e Punonjësve Hungarezë. Këta njerëz nuk kanë qenë kurrë marksistë, ne dimë se çfarë intrigash kanë kurdisur ata në bashkë-

---

<sup>1</sup> Është fjala për Konferencën e Këshillit të Ndihmës Ekonomike Reciproke që u zhvillua në Moskë në qershor 1956. Duke udhëtuar për Moskë delegacioni ynë qëndroi një natë në Budapest. Në mbrëmje u takuan me delegacionin tonë shokët e Byrosë Politike të Partisë së Punonjësve Hungarezë, përveç Rakoshit, Hegedushit dhe Geros, të cilët ishin nisur me tren për në Moskë.

punim me klikën e Titos, prandaj kundër tyre Rakoshi ka mbajtur qëndrim të drejtë.

Gabimi i udhëheqjes së partisë në Hungari është se nuk u mbajt fort dhe nuk mobilizoi partinë dhe popullin, për të goditur si duhet tentativat e armiqve të fshehtë dhe të hapët, përkundrazi u bënë një sërë lëshimesh derisa në Hungari plasi kundërrevolucioni.

Në këtë situatë, ne, anëtarët e Byrosë Politike, që u ndodhëm në Tiranë, u mbledhëm, diskutuam dhe morëm disa vendime për forcimin e mëtejshëm të organeve të Sigurimit të Shtetit dhe të ushtrisë. Këto masa mendojmë se janë të domosdoshme. Në këto momente kritike neve nuk na lejohet të qëndrojmë të pakujdesshëm, pavarësisht se gjendja në vendin tonë është e fortë. Partia jonë është e qartë dhe qëndron në pozita jashtëzakonisht të forta dhe të shëndosha, siç e keni parë edhe ju vetë në aktivet e rretheve dhe në mbledhjet e zhvilluara në bazë. Megjithatë, ne duhet të jemi vazhdimisht zgjuar dhe në këmbë, të gatshëm e vigjilentë dhe të mësojmë nga këto ngjarje që po ndodhin në vende të tjera të kampit tonë socialist.

Lidhur me Poloninë<sup>1</sup> ne kemi diskutuar edhe një herë tjetër. Mendimi im është se ngjarjet në këtë vend po zhvillohen në disfavorin e kampit tonë. Në Republikën Popullore të Polonisë ka ardhur në fuqi Gomulka me shokë. Po cili është Gomulka?

Gomulka është një element që ka qenë në burg për veprimtari antiparti, për pikëpamje të djathta në drej-

---

<sup>1</sup> Imperializmi ndërkombëtar dhe revizionistët organizuan së bashku revoltën kundërrevolucionare në Poznan të Polonisë në qershor të vitit 1956.

tim të ekonomisë etj. Tani ky element u rehabilitua dhe u zgjodh sekretar i parë. Në fjalimet që ka mbajtur Gomulka na kanë rënë në sy disa probleme. Cilat janë disa prej tyre? Gomulka ka atakuar çështjen e kooperativave bujqësore se gjoja ato nuk janë rentabël. Ne nuk ndërhyjmë në punët e tyre, por duam të themi se s'jemi dakord me një pikëpamje të tillë. Gabimet që mund të jenë bërë në Poloni në drejtim të kolektivizimit, nuk duhet t'i atribuohen sistemit të kolektivizimit sikur ky na genka i keq. Po ta kishte fajin sistemi i kolektivizimit, atëhere kooperativat bujqësore do të ishin në gjendje të keqe edhe në vendin tonë.

Po kështu, në fjalimet e Gomulkës duket një tendencë e tillë që ai s'ka konsideratë për udhëheqësit e partive të tjera. Ai ka thënë se sekretarët e parë të partive të tjera kanë qenë si hënëza të Stalinit, me një fjalë satelitë të tij. Kështu siç thotë Gomulka flasin vetëm radiot reaksionare.

Një tendencë tjetër e Gomulkës është aluzioni që bën ai duke thënë se edhe Bjeruti ka gabuar. Këtë gjë Gomulka nuk e thotë haptazi, po kërkon që të shihet veprimtaria e të gjithë njerëzve. Nga sa dimë ne, Bjeruti ka qenë një nga udhëheqësit më të shquar të proletariatit botëror dhe të popullit polak. Ai e ka mbrojtur klasën punëtore polake në situatat më të vështira. Bjeruti ka qenë partizan i flaktë i miqësisë së ngushtë të proletariatit dhe popullit polak me punëtorët dhe popullin e Bashkimit Sovjetik dhe me Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik.

Krejt ndryshe është Gomulka. Ai me shokë erdhën në fuqi me një program të caktuar dhe me parullat për

«independencën dhe sovranitetin e vërtetë të Polonisë, për demokratizimin e mëtejshëm të partisë dhe të vendit, për çlirimin e Polonisë». Po nga kush vinin gjithë këto rreziqe? Kuptohet vetëvetiu nga Bashkimi Sovjetik.

Elementë me këto pikëpamje të djathta dhe trociste ndaj Bashkimit Sovjetik dhe Partisë Komuniste të tij, kanë zhvilluar në Poloni demonstrata antisovjetike. Prandaj për ne është e qartë se ata që janë tani në fuqi në Poloni, si Gomulka me shokë, janë kundërrevolucionarë. Këtë e tregojnë, përveç të tjerave, edhe masat që merren atje për të hequr nga udhëheqja e partisë disa shokë që kanë luftuar për çlirimin e popullit polak dhe për socializmin. Prej tyre ka që janë skartuar ose po skartohen duke i hequr nga Byroja Politike dhe në vendin e tyre kanë vënë njerëz me pikëpamje antimarksiste.

Me sa kuptojmë e marrim vesh ne, në Poloni janë kundër qëndrimin të Ushtrisë Sovjetike në vendin e tyre. Në qoftë se tani atje flitet mirë për Ushtrinë Sovjetike, kjo bëhet për shkak të interesave imediate, sepse është edhe çështja nacionale, frika nga ndonjë sulm gjerman, prandaj nuk e kanë lehtë të flasin hapur kundër Ushtrisë Sovjetike, përkundrazi, udhëheqja polake lëshon parulla demagogjike, me qëllim që të gënjejë popullin dhe komunistët e paqartë politikisht e të forcojë pozitat e saja. Sigurisht në Poloni nuk është shuar dashuria për Bashkimin Sovjetik.

Në Poloni ka edhe disa çështje të tjera siç është ajo e kultit të individit, që kërkojnë ta shfrytëzojnë shumë elementë, të cilët janë nga ata që kultin e individit e kanë në bark për veten e tyre. Populli ynë thotë mirë se këta njerëz qimen në syrin e tjetrit e shohin,



po traun në syrin e tyre nuk e shohin. Njerëz të tillë, nën maskën e gabimeve të kultit të individit, kërkojnë të bëhen shumë gjëra.

Këto janë çështje që i përkasin t'i zgjidhë partia në Poloni, por ne kemi mendimet tona, të cilat mund dhe duhet t'i themi, pse kështu do të mbrojmë edhe miqësinë që ekziston midis vendeve tona, që bëjnë pjesë në kampin e socializmit. Në qoftë se Gomulka do të ecë kështu, le të vazhdojë, ne do të ecim në rrugën tonë. Megjithatë kemi interesa të mëdha, interesa të përgjithshme të të gjithë kampit dhe nuk duhet të japim shkak për t'u acaruar marrëdhëniet, po parimet do t'i mbrojmë deri në fund.

Mund të ketë edhe gjëra të tjera në Poloni, të cilat ne nuk i dimë, por një gjë e dimë me siguri: udhëheqja e sotme polake me Gomulkën në krye është kundër Bashkimit Sovjetik, kundër Ushtrisë Sovjetike dhe kundër kampit socialist. Këtë e tregojnë shumë të dhëna. Por në Poloni nuk ndodhi si në Hungari, rrokullisja e ngjarjeve u frenua, sepse polakët u treguan më të zot nga hungarezët. Megjithatë faktet provojnë se edhe në Poloni rreziku vazhdon të ekzistojë. Dhe Titua në këto ngjarje nuk mungon së vepruari. Është fakt se parullat dhe pikëpamjet teorike të polakëve dhe të hungarezëve përngjasin shumë me ato të jugosllavëve. Për të gjitha këto ngjarje që zhvillohen sot në Poloni, nga ana e Bashkimit Sovjetik ka gjithashtu një heshtje të madhe. Qeveria Sovjetike na dërgon letrën që i ka drejtuar Nehruse dhe Sukarnos për çështjen e Egjiptit, e cila nuk është dhe aq urgjente, ndërsa për ngjarjet që ndodhin në Hungari e në Poloni nuk na vë fare në dijeni.

Për të gjitha këto çështje, unë kam biseduar me Krillovin, ambasadorin sovjetik në Tiranë, po nuk e di nëse ai ua transmeton ose jo vërejtjet tona partisë dhe qeverisë së tij. Ne kemi parasysh edhe çfarë na ka thënë Suslovi në lidhje me Hungarinë, po sikur nuk na mbushet mendja me ato që thotë ai. Ai na ka thënë se punët në Hungari paskëtaj do të shkojnë mirë, sepse tani në udhëheqje ka unitet dhe se Imre Nagi ka bërë një autokritikë të mirë. Ai na tha gjithashtu se edhe me Jugosllavinë punët kanë për të shkuar mirë, sepse kishte biseduar me Titon në Krime, se Gerua do të shkonte në Beograd në krye të një delegacioni për bisedime me jugosllavët. Këto pikëpamje të Suslovit ishin një përgjegje që na u vu përballë pikëpamjeve tona, sepse ne i thamë se me rënien e Rakoshit, në Komitetin Qendror të Partisë së Punonjësve Hungarezë nuk ka unitet.

Po kështu kemi biseduar edhe me Krillovin, edhe për disa vështirësi ekonomike që ka vendi ynë. Me këtë rast kërkuam që të ndihmohemi, që Rumania të na japë misër, sepse kemi nevojë për bukë, por deri tani asnjë përgjegje nuk na është dhënë. Krillovit i thamë gjithashtu edhe për disa pikëpamje që dëgjojmë nga radiot, se Rumania dhe Çekoslovakia po ndihmojnë Hungarinë me ilaçe, veprime këto që ne nuk i shohim të drejta, sepse edhe Imre Nagi i thotë haptazi se për cilët janë këto ilaçe, pra ata i hedhin një çikë vaj çështjeve, ndërsa ne s'po ndihmohemi as me misër për bukë. Por Krillovit i thashë se çështjen e popullit ne do ta mbrojmë deri në fund se do të rrimë edhe pa bukë e pa këpuçë dhe të tjerët nuk i lëmë të hyjnë dhe të shijnë si të duan në vendin tonë.

Në këtë gjendje të vështirë, kur në Afrikën e Veriut po bëhet luftë, kur Egjipti është në flakë, ne duhet të luftojmë edhe do të punojmë me këmbëngulje, me forcat tona që të përballojmë çdo situatë, sado e rrezikshme qoftë. Gabime nuk do të bëjmë, atdheun, revolucionin dhe socializmin do t'i mbrojmë. Të gjitha këto ne ia kemi thënë vazhdimisht Krillovit, ai dëgjon dhe nuk shfaq asnjë mendim, shprehet vetëm me dy fjalë: «drejt i shtroni ju këto çështje» dhe asgjë më tepër.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## MBI NGJARJET NË HUNGARI

### *Teza për artikull<sup>1</sup>*

4 nëntor 1956

Ç'po ndodh tani në Hungari? Terror si në kohën e Hitlerit dhe demagogji. Propaganda imperialiste e trumbeton këtë si «triumfin e demokracisë».

— Qeveria e Nagit nuk është e ligjshme, nuk përfaqëson vullnetin e popullit. Ajo i hapi dyert reaksionit dhe partive të vjetra reaksionare.

— Përpjekje për restaurimin e klasave të vjetra sunduese.

— Shpërndarja e Partisë së Punonjësve Hungarezë — kulmi i këtij aksioni.

— Populli hungarez nuk mundi me forcën, unitetin dhe vendosmërinë e tij t'i mbyllte rrugën kundërrivolucionit fashist. Kjo është tragjedia e tij. Imperialistët dhe armiqtë e brendshëm me demagogji kërkonin gjoja ndreqjen e gabimeve. Në të vërtetë ata donin ma-

---

<sup>1</sup> Në bazë të këtyre tezave u pregatit kryeartikulli: «Populli hungarez dërmoi komplotin fashist», botuar në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 269 (2538), 5 nëntor 1956.

shtrimin e masave, diskreditimin e udhëheqësve, krijimin e pakënaqësive, nxitjen e turbullirave, kundërrevolucionin.

— Ndryshimet e shpejta dhe të shumta në udhëheqje e lanë partinë dhe vendin pa udhëheqje të fortë, pa shtab drejtues.

— Hungaria në udhëkryq: ose reaksioni do të merrte me dhunë e demagogji pushtetin dhe të likuidonte demokracinë popullore, ose punonjësit hungarezë do të gjenin forca të mundnin reaksionin dhe të ecnin në rrugën e revolucionit.

— Tani punonjësit hungarezë po e dënojnë komplotin. Ata nuk lejuan të vendosej diktatura fashiste. Forcat e shpëtimit u gjetën. Ata nuk mund t'i linin që tokat t'i merrnin kulakët dhe fabrikat padronët.

— Shqetësimi i popujve dhe i yni për zhvillimin e ngjarjeve në Hungari. Punonjësit e botës e përshëndesin me gëzim fitoren mbi kundërrevolucionin fashist.

Imperialistët bëjnë zhurmë të madhe pse janë tërbuar nga dështimi që pësuan. Por ata s'do t'ia arrijnë qëllimit. Ata janë përgjegjës për ngjarjet në Hungari. Veprimet në këtë vend ishin përgatitur e drejtoreshin nga imperialistët.

— Financimi i qeverisë së Nagit nga SHBA. Por ata u gëzuan para kohe.

— Ngjarjet në Hungari, shpresat për të organizuar turbullira në vendet e tjera të demokracisë popullore, agresioni në Egjipt, janë pjesë të të njëjtit plan, që kërkojnë ta hedhin njerëzimin në një kasaphanë të re.

— Mësimet që duhen nxjerrë nga ngjarjet e Hungarisë.

1) Klasat shfrytëzuese nuk i dorëzojnë pa luftë pozitë e tyre. Ato, të përkrahura edhe nga reaksioni i jash-tëm, do të përpiqen të rivendosin skllavërinë kapitaliste.

2) Prandaj populli ynë do të forcojë edhe më shumë lidhjet e tija rreth PPSH dhe pushtetit popullor, do të forcojë vigjilencën, do të jetë i pamëshirshëm kundër armiqve etj.

— Të përmendet entuziazmi i madh dhe uniteti që shpreh populli me rastin e festës së Revolucionit të Tetorit dhe 15-vjetorit të themelimit të Partisë, dënimi nga ana e tij i komplotit fashist në Hungari, i agresionit në Egjipt.

— Një mbyllje e përgjithshme: të tregohet se socializmi marshon përpara.

*Botohen për herë të parë  
sipas shënimeve që gjenden  
në Arkivin Qendror  
të Partisë*

## PARTIA E PUNËS E SHQIPËRISË MBUSH 15 VJET<sup>1</sup>

8 Nëntor 1956

Më 8 Nëntor 1956 mbushen 15 vjet nga dita e themelimit të Partisë Komuniste Shqiptare, sot Partia e Punës e Shqipërisë.

E lindur në kushtet e Luftës së dytë botërore, kur vendi ynë ishte nën sundimin e pushtuesve fashistë, ajo u rrit dhe u çelënikos si një parti revolucionare, marksiste-leniniste, në luftë të ashpër kundër armiqve të jashtëm e të brendshëm.

Pushtuesit fashistë, veglat e tyre dhe të gjithë armiqtë e Partisë, që në ditët e para të formimit të saj, kanë tentuar me të gjitha mënyrat ta godasin atë dhe të përçajjnë unitetin e saj. Por ajo i theu kurdoherë me vendosmëri sulmet e armiqve dhe, duke ndjekur me besnikëri mësimet e pavdekshme të marksizëm-leninizmit, u rrit gjithmonë më e fortë dhe u bë forca e vetme udhëhoqëse e vendit, e rrethuar me dashuri të thellë nga masat e gjera të popullit tonë.

Rezultatet e mëdha që ka arritur populli ynë, çli-

---

<sup>1</sup> Artikull i botuar në gazetën «Pravda».

rimi i vendit, vendosja e pushtetit popullor, transformimet rrënjësore politiko-ekonomiko-shoqërore, sukseset e arritura në ndërtimin e jetës së re, në zhvillimin ekonomik e kultural të vendit tonë, janë merita e madhe e udhëheqjes së drejtë dhe besnike të Partisë së Punës të Shqipërisë, e cila nuk ka interesa më të larta se interesat e klasës punëtore, se interesat e të gjithë punonjësve të vendit.

Në zgjidhjen me sukses të detyrave të mëdha Partia e Punës e Shqipërisë është udhëhequr kurdoherë nga parimi leninist se forcimi i unitetit ideologjik, politik e organizativ i Partisë, përbën forcën e pathyeshme të një partie marksiste-leniniste dhe se lidhja e ngushtë me masat dhe besnikëria ndaj parimeve të marksizëm-leninizmit janë kushti themelor për ndërtimin e një vije të drejtë dhe për zbatimin e saj me sukses. Partia jonë dhe populli shqiptar nuk kanë shkelur dhe nuk do të shkelin kurrë në dërrasë të kalbur, ku kërkojnë t'i tërheqin dhe t'i gënjejnë komunistët dhe popujt disa pseudomarksistë, me parullat e tyre të një «socializmi specifik», të një demokracie, që bie erë çdo gjë, por jo proletare, dhe të një organizimi gjoja të ri, por që është i vjetër sa edhe Trocki.

Vetëm nën udhëheqjen e Partisë së Punës të Shqipërisë dhe me ndihmën e Bashkimit Sovjetik populli shqiptar, që vazhdimisht ka luftuar për pavarësi dhe liri, për herë të parë në historinë e tij, rron i lirë e sovran dhe ka fatet në duart e tija.

Partia mobilizoi, organizoi, udhëhoqi popullin tonë në Luftën nacional-çlirimtare. Fitoret e Ushtrisë Sovjetike kundër ushtrisë hitleriane, armikut të përbashkët



të popujve tanë, i dhanë një zhvillim të hovshëm Luftës nacional-çlirimtare të popullit shqiptar.

Për Partinë tonë çështja e pushtetit ka qenë, që në ditët e para të luftës, problem themelor i revolucionit popullor. Partia jonë në ndërtimin e pushtetit u bazua në leninizmin, dhe ajo ka qenë dhe është kundër të gjithë atyre që pretendojnë se kanë shpikur forma dhe organizime të reja pushteti socialist. Këto forma të reja, le t'i ruajnë ata për vete, për Partinë dhe popullin tonë shembulli i Bashkimit Sovjetik është shembull i madh. Partia dhe populli ynë në çdo kohë do të përfitojnë edhe nga eksperiencat e çdo vendi tjetër që ndërton socializmin, duke u bazuar mbi marksizëm-leninizmin.

Me çlirimin e plotë të Shqipërisë, mbi gërmadhat e pushtetit të vjetër, u ngrit pushteti i ri, pushteti i popullit, bazat e të cilit ajo i hodhi që gjatë Luftës nacional-çlirimtare, në formën e këshillave nacional-çlirimtare.

Vendosja e pushtetit popullor dhe forcimi i tij i vazhdueshëm, krijuan kushtet e nevojshme dhe të domosdoshme për të arritur suksese të mëdha në zhvillimin e ekonomisë së re popullore, në përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të jetesës së masave të gjera punonjëse.

Pjesëmarrja e gjerë në zgjedhjet e organeve qendrore e lokale të pushtetit popullor, në punët e administrimit të vendit dhe rritja e aktivitetit krijues të masave të gjera të popullit, flasin qartë për forcën e pathyeshme dhe vitalitetin e madh të pushtetit të ri popullor në Shqipëri.

Para lufte ekonomia e Shqipërisë ishte shumë e

prapambetur. Lufta kundër pushtuesve fashistë i shkaktoi dëme shumë të mëdha popullit shqiptar. Në periudhën e parë pas çlirimit, Partia e Punës udhëhoqi masat e punonjësve në ndërtimin e ekonomisë së vendit të shkatërruar nga lufta.

Të gjitha këto rezultate të punës vetëmohuese të popullit, të udhëhequr nga Partia, krijuan bazën e shëndoshë për ecjen e vendit tonë përpara. Kongresi i Partisë që u mbajt në maj të këtij viti, bëri bilancin e punës për realizimin e planit të parë pesëvjeçar dhe aprovoi direktivat e planit të dytë pesëvjeçar. Kongresi III i Partisë sonë përcaktoi drejt çdo gjë, çdo gjë u bazua dhe u zgjidh duke u mbështetur në parimet marksiste-leniniste. S'ka dyshim se atyre që s'mendojnë si marksistë nuk iu pëlqyen këto zgjidhje të drejta. Ata do të dëshironin që Partia jonë t'u përulej falsitetit, kërcënimit, shantazhit dhe megalomanisë së disave. Këta natyrisht i kanë bërë hesapet gabim me shqiptarët që kurrë nuk u janë përlur padrejtësive dhe shantazheve dhe kurrë nuk do t'u përlen.

Detyrat e planit të parë pesëvjeçar për të transformuar vendin tonë nga një vend agrar i prapambetur në një vend agraro-industrial në përgjithësi u realizuan me sukses. Gjatë këtij pesëvjeçari u krijua industria jonë e re, që është baza kryesore për zhvillimin e ekonomisë sonë popullore, për përmirësimin e bujqësisë dhe për rritjen e vazhdueshme të mirëqenies materiale e të nivelit kultural të popullit tonë.

Në vitin 1955 vëllimi i përgjithshëm i prodhimit industrial u rrit gati 11 herë më shumë se në vitin 1938 ose 179 për qind më shumë se në vitin 1950. Shumë

degë të industrisë kanë pasur rritje të konsiderueshme. Kështu p.sh. prodhimi i industrisë së kromit u rrit 17 herë në krahasim me vitin 1938 ose 234 për qind me 1950, ai i qymyrgurit — 54 herë në krahasim me vitin 1938 ose 5 herë me 1950, prodhimi i industrisë mekanike — 5 herë në krahasim me 1950, industria elektrike — 10 herë në krahasim me vitin 1938 ose 5 herë me 1950 etj. Edhe prodhimi i mallrave të konsumit është rritur në mënyrë të konsiderueshme gjatë kësaj periudhe dhe është rritur 26 herë në krahasim me 1938 ose 7 herë me 1950.

Megjithëse në pesëvjeçarin e parë nuk u arrit të nxirret bujqësia plotësisht nga prapambetja, rezultatet në lëmin e bujqësisë, në krahasim me të kaluarën, janë të mëdha dhe përbëjnë një bazë të shëndoshë për zhvillimin e mëtejshëm të saj. Prodhimi i përgjithshëm bujqësor u rrit 38 për qind, sipërfaqet e mbjella — 13 për qind, u futën kultura të reja si pambuku, panxhari i sheqerit, u rrit prodhimi i duhanit dhe u zgjerua kolektivizimi i bujqësisë.

Në bazë të rritjes së prodhimit industrial e bujqësor është rritur niveli i jetesës së masave. Në fund të vitit 1955 të ardhurat kombëtare u rritën rreth 70 për qind, paga reale e punëtorëve rreth 20 për qind dhe të ardhurat e fshatarësisë rreth 30 për qind.

Detyra kryesore e planit të dytë pesëvjeçar është zhvillimi i mëtejshëm i industrisë, sidomos i industrisë së minierave, kryesisht në bazë të përdorimit të plotë të kapaciteteve prodhuese ekzistuese, dhe mobilizimit të rezervave të brendshme, si dhe zhvillimi i shpejtë i bujqësisë kryesisht në bazë të riorganizimit të prodhimit

bujqësor mbi bazat socialiste dhe duke u mbështetur në këtë të arrihet përmirësimi i mëtejshëm i gjendjes materiale dhe ngritja e nivelit kultural të popullit shqiptar.

Plani i dytë pesëvjeçar shënon një rritje të mëtejshme të mirëqenies materiale e kulturele të masave punonjëse. Të ardhurat kombëtare do të rriten 53 për qind në krahasim me vitin 1955, paga reale e punëtorëve do të rritet jo më pak se 25 për qind dhe të ardhurat e fshatarësisë jo më pak se 38 për qind kundrejt vitit 1955.

Një rëndësi të veçantë Kongresi III i Partisë i kushtoi ngritjes së shpejtë të bujqësisë, si kusht i domosdoshëm për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë dhe për përmirësimin e kushteve të jetesës së popullit. Kongresi III përcaktoi qartë se e vetmja rrugë për ta nxjerrë definitivisht bujqësinë tonë nga prapambetja është rruga e kolektivizimit, në bazë të parimit leninist të vullnetit të lirë të fshatarëve. Drejtësinë e këtij vendimi të Partisë sonë e vërteton fakti i rritjes së shpejtë të kolektivizimit. Sot në Shqipëri ka 813 kooperativa bujqësore sipërfaqja e të cilave është baras me 32 për qind të sipërfaqes së tokës së mbjellshme të Republikës.

Plani i dytë pesëvjeçar është një program i madh luftarak, që do të zhvillojë më tej ekonominë dhe kulturën e popullit, qëllimi kryesor dhe i vetmi i të cilit është të shtohet mirëqenia e popullit, të ngrihet standardi i popullit. Për realizimin e kësaj detyre të madhe janë mobilizuar e luftojnë sot Partia dhe të gjithë punonjësit e vendit tonë.

**Komunistët dhe i gjithë populli shqiptar e festojnë**

15-vjetorin e themelimit të Partisë së Punës të Shqipërisë me besim të patundur për të ecur më tej në rrugën e ndërtimit të socializmit, me perspektiva të qarta për ndërtimin e socializmit në Shqipëri dhe të vendosur më shumë se kurrë në radhët e kampit të madh e të fuqishëm të socializmit, që udhëhiqet nga Bashkimi Sovjetik.

Së bashku me përvjetorin e themelimit të Partisë, komunistët dhe populli shqiptar festojnë 39-vjetorin e Revolucionit të madh socialist të Tetorit, që, si gjithë njerëzimit, edhe popullit shqiptar i hapi rrugën e shpëtimit. Partia jonë do të udhëhiqet si kurdoherë nga mësimet e lavdishme të Leninit të madh. Partia jonë do të jetë kurdoherë në kundërshtim me ata pseudo-marksistë, që, duke shfrytëzuar luftën e drejtë kundër kultit të individit, mundohen të denigrojnë Partinë e lavdishme të Leninit dhe duke e bërë këtë të ngrenë kultin e Partisë së tyre dhe të formave gjoja të tyre të reja. Këta të ashtuquajtur shokë, me të ashtuquajtura parulla socialiste, përpiqen të shohin qimen në syrin e tjetrit, po nuk shohin traun në syrin e tyre. Veçse leninistët e vërtetë s'janë kurrë qorra, dhe dinë të dallojnë qimen në syrin e tyre, dhe e spastrojnë syrin, por dinë njëkohësisht të dallojnë jo vetëm traun në syrin e tjetrit, por edhe qimen. Njerëzit, thotë populli ynë, nuk hanë bar, dhe ca më pak marksistët.

Partia dhe populli shqiptar kanë një dashuri të madhe e të pakufishme për Bashkimin Sovjetik, sepse ai i çliroi nga zgjedha e pushtesve dhe i ka ndihmuar e po i ndihmon në çdo fushë, pa interes e në mënyrë vëllazërore, për të ndërtuar një jetë të re dhe më të mirë.

Miqësia me Bashkimin Sovjetik është në themelet e ekzistencës së lirë të popullit tonë, në themelet e pavarësisë dhe të sovranitetit të Republikës Popullore të Shqipërisë. Populli shqiptar do ta ruajë këtë miqësi si dritën e syve, do ta forcojë gjithmonë më shumë dhe as nuk ka as nuk do të ketë kurrë forcë në botë që të mundë ta çënojë këtë sado pak.

Ashtu si deri sot, Partia e Punës dhe populli shqiptar do të vazhdojnë të luftojnë në miqësi të ngushtë me Bashkimin Sovjetik, me Kinën e madhe dhe me vendet e tjera të kampit socialist për forcimin e paqes e të bashkëpunimit midis popujve, për fitoren e socializmit.

Asnjë tentativë e armiqve nuk do ta shmangë dot popullin shqiptar nga kjo rrugë. Ai gjithmonë më shumë do ta çelnikosë bashkimin e tij rreth Partisë së Punës, udhëheqjes së tij të sigurtë e besnike, për të ndërtuar me sukses socializmin.

*Botuar për herë të parë në gazetën «Pravda», Nr. 313 (13976).*

*8 nëntor 1956*

*Botohet me disa shkurtime sipas origjinalit që gjendet në*

*Arkivin Qendror të Partisë*

## FJALA ME RASTIN E 15-VJETORIT TË THEMELIMIT TË PPSH

8 Nëntor 1956

Shokë dhe shoqe,

Më lejoni që në emër të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë t'ju përshëndes dhe t'ju uroj nga zemra me rastin e 15-vjetorit të themelimit të Partisë sonë të dashur dhe të 39-vjetorit të Revolucionit të madh socialist të Tetorit.

8 Nëntori, dita e themelimit të Partisë sonë, dhe 7 Nëntori, dita e Revolucionit të lavdishëm socialist, nuk janë vetëm dy data që kanë qëlluar rastësisht afër njëra-tjetrës, por janë dy data, dy ngjarje të mëdha që janë e do të mbeten të lidhura përjetë në historinë e popullit shqiptar. Në të njëjtën kohë me 15-vjetorin e themelimit të Partisë, populli dhe Partia jonë festojnë së bashku me popullin sovjetik dhe me punonjësit e gjithë botës edhe përvjetorin e 39-të të Revolucionit të madh socialist të Tetorit, sepse drita e Tetorit të madh u ka ndriçuar dhe do t'u ndriçojë kurdoherë rrugën punonjëse dhe të gjitha masave të shtypura të botës për të fituar të drejtat demokratike, lirinë, për të marrë në duart

e veta fatin e tyre. Sa më tepër kalojnë vitet nga dita e fitores së Revolucionit të madh socialist të Tetorit aq më e qartë, më e madhe dhe vendimtare bëhet rëndësia e këtij revolucioni vigan, që hapi një epokë të re në historinë botërore, epokën e socializmit, epokën e shembjes së sistemit të turpshëm kolonial e imperialist.

Krijimi i Partisë sonë dhe fitoret e revolucionit popullor në vendin tonë janë të lidhura ngushtë me fitoren e Revolucionit të madh socialist të Tetorit. Pas Revolucionit të Tetorit rilindi shpresa e shpëtimit për popullin shqiptar. Influenca e këtij revolucioni i dha një hov të ri ngjarjeve politike në Shqipëri, zgjoi ndërgjegjen kombëtare, i dha zjarr lëvizjes revolucionare të forcave demokratike popullore të vendit tonë.

Më 8 nëntor 1917 Kongresi II i Sovjetëve të deputetëve punëtorë, ushtarë dhe fshatarë të Rusisë, duke aprovuar dekretin «Mbi paqen», vendosi likuidimin e diplomacisë së fshehtë dhe botimin e traktateve të fshehta imperialiste. Midis traktateve të botuara nga Këshilli i Komisarëve të Popullit të Rusisë Sovjetike ishte dhe Traktati i fshehtë i Londrës i 26 prillit 1915 i përfunduar midis fuqive të Antantës.

Lajmi mbi botimin e këtij traktati u përhap si vetëtimë duke ngjallur një valë të fuqishme zemërimi në popullin tonë. Lëvizja kundër Traktatit të Londrës, kundër imperialistëve italianë etj. përfshiu të gjithë vendin. Kurrë ndonjëherë deri atëhere ndërgegjgjia kombëtare e popullit tonë nuk kishte gjetur një shprehje kaq të gjallë dhe të fortë, kurrë nuk ishte arritur një bashkim kaq i shëndoshë i popullit shqiptar, siç u arrit pas Revolucionit të Tetorit, nën influencën e politikës leni-



niste antiimperialiste, kur qeveria sovjetike i tregoi botës fytyrën e vërtetë shtazarake të imperializmit. Revolucioni i Tetorit u hapi sytë masave të popullit tonë dhe u tregoi cilët ishin miqtë e vërtetë të Shqipërisë. Emri i udhëheqësit të madh të Revolucionit të Tetorit, V.I.Leninit, u bë i njohur në të gjithë vendin tonë dhe populli filloi ta quajë atë «xhaxha Lenini».

Nën influencën direkte të Revolucionit të Tetorit lëvizja revolucionare demokratike dhe antiimperialiste shkoi duke u forcuar dhe duke marrë një karakter gjithnjë më të organizuar. Kongresi i Lushnjës, në janar të vitit 1920, që dënoi Traktatin e Londrës dhe u shpreh hapur kundër imperializmit, duke mos pranuar asnjë mandat ose protektorat mbi Shqipërinë, Lufta heroike e Vlorës, po në vitin 1920, që përfundoi me dëbimin e pushtesve italianë, janë prova të gjalla të rritjes së lëvizjes nacional-çlirimtare të popullit shqiptar pas Revolucionit të Tetorit. Rritja e lëvizjes revolucionare në vendin tonë shpuri në Revolucionin demokratik borgjez të Qershorit 1924, revolucion që pati një jehonë mjaft të madhe në popujt fqinjë të Ballkanit dhe në Evropë, por që u mposht nga forcat e feudalëve me Ahmet Zogun në krye, i sjellë në fuqi nga imperialistët.

Pas fitores së Revolucionit të Tetorit rritet jo vetëm lëvizja demokratike, por edhe lëvizja punëtore, e cila shkrihet në lëvizjen e përgjithshme revolucionare antif feudale dhe antiimperialiste. Klasa jonë punëtore ishte një klasë e vogël, e shpërndarë, pa eksperiencë, por ajo kishte gjithë të ardhshmen përpara dhe me fitoren e Revolucionit të Tetorit asaj i hapeshin perspe-

ktivita të qarta në rrugën e saj; ajo kishte mbështetjen e lëvizjes së fuqishme botërore të proletariatit, kishte tani mbështetjen dhe eksperiencën e klasës punëtore fitimtare të Ruisë, luftëtares pararojë në lëvizjen punëtore ndërkombëtare. Sipas mësimëve të organizatorit dhe udhëheqësit të Revolucionit, V.I.Leninit, sipas eksperiencës së Partisë dhe të klasës punëtore të Ruisë, filloi të organizohej dhe të hidhej në aksion edhe klasa jonë e vogël punëtore në krye të fshatarësisë sonë heroike dhe të pamposhtur. Për të parën herë pas Revolucionit të Tetorit, u formuan shoqëritë e punëtorëve dhe të zanatçinjve në Korçë, Shkodër, Tiranë, u organizuan greva dhe demonstrata të punëtorëve kundër sipërmarrësve dhe tregëtarëve kapitalistë. Veçanërisht, kur u kthye nga Bashkimi Sovjetik Ali Kelmendi, lëvizja punëtore dhe idetë komuniste marksiste-leniniste u përhapën në të gjitha qendrat kryesore të vendit. U forcuan grupet komuniste, të cilat, me gjithë gabimet dhe boshllëqet e tyre, mundën të preगतित्तिन terrenin për krijimin e Partisë Komuniste në vendin tonë.

Më kot u munduan klasat sunduese të vendit, të cilave po u afrohej fundi i pushtetit të tyre, të merrnin të gjitha masat, që nga propaganda dhe deri te terrori më i egër, për të ndaluar përhapjen e dritës së Revolucionit socialist të Tetorit në Shqipëri. Nga ana tjetër, agjentët e kapitalizmit ndërkombëtar, të veshur me maskën e socialistit dhe të komunistit, arqiomarksistët, trockistët, oportunistët si Zai Fundo, Aristidh Qendro, Niko Xoxe, Andrea Zisi, Anastas Lula, Sadik Premte dhe të tjerë, bënë të gjitha përpjekjet për të mos lënë

të zinin rrënjë idetë e marksizëm-leninizmit në vendin tonë, për të penguar organizimin dhe zgjerimin e lëvizjes punëtore. Duke përhapur lloj-lloj teorish, të huaja për komunizmin, duke falsifikuar të vërtetën mbi Bashkimin Sovjetik, ata kishin për qëllim të ngjallnin në masat tona punonjëse mosbesim në rrugën e socializmit që kishte çarë klasa punëtore me fshatarësinë e Rusisë në Revolucionin socialist të Tetorit, dhe në këtë mënyrë të bënin të dështonte krijimi i Partisë Komuniste Shqiptare, udhëheqëses së vërtetë të popullit shqiptar.

Republikën sovjetike, pjellën e Revolucionit të madh të Tetorit, Lenini e quante fener që u ndriçon rrugën gjithë proletarëve dhe masave të shtypura të botës. Pas fitores së Revolucionit të Tetorit Lenini shkruante:

*«... ne jemi krenarë që na ka takuar fati të fillojmë ndërtimin e shtetit sovjetik, të fillojmë në këtë mënyrë një epokë të re në historinë botërore, epokën e sundimit të një klase të re, që është e shtypur në të gjitha vendet kapitaliste dhe që kudo po marshon drejt një jete të re, drejt fitores mbi borgjezinë, drejt diktaturës së proletariatit, drejt çlirimit të njerëzimit nga zgjedha e kapitalit, nga luftërat imperialiste»<sup>1</sup>.*

Ngjarjet që kanë ndodhur pas Revolucionit socialist të Tetorit i vërtetojnë më së miri këto parashikime të Leninit. Qindra milion punonjës në shembullin e punonjësve sovjetikë i këputën vargojtë e kapitalizmit, ve-

---

<sup>1</sup> V. I. Lenin. Veprat, vëll. 33, f. 41.

ndosën pushtetin e tyre dhe sot ndërtojnë socializmin. Socializmi është kthyer në një sistem botëror. Bashkimi Sovjetik nuk është më një ishull i veçuar në mes të shteteve kapitaliste. Tani nën flamurin e socializmit, ndërtojnë jetën e re më tepër se një e treta e njerëzimit. Idetë e socializmit po përhapen me forcë të madhe dhe të pandalshme, ato i përqafojnë gjithnjë e më shumë miliona njerëz në vendet kapitaliste.

Nën influencën e Revolucionit të Tetorit lufta nacional-çlirimtare e popujve kolonialë u zhvillua me një forcë që nuk ishte parë kurrë ndonjëherë, kjo luftë e shpuri në një krizë të thellë vdekjeprurëse gjithë sistemin kolonial të imperializmit.

*«Në këtë çështje, shkruante Lenini në vitin 1921, Revolucionin ynë i Tetorit ka hapur një epokë të re në historinë botërore»<sup>1</sup>.*

Dhe kjo epokë e re që kishte parashikuar Lenini tani ka filluar. Sot sistemi kolonial ndodhet në shturje e sipër. Shumica dërmuese e vendeve të Azisë, prej qindra milion njerëzish, që deri dje lëngonin nën shtypjen e egër imperialiste, nën sistemin e turpshëm të kolonializmit, paraqiten tani në arenën botërore si shtete sovranë. Këto ndryshime rrënjësore në Azi dhe zgjimi i popujve të Afrikës e kanë vënë në rendin e ditës likuidimin e plotë të sistemit kolonial.

Përpara kësaj gjendjeje, forcat e reaksionit imperialist, të alarmuara, janë ngritur me të gjitha forcat

<sup>1</sup> V. I. Lenin. Veprat, vëll. 33, f. 42.

e tyre për t'i larguar punonjësit nga rruga e vërtetë e luftës për interesat e veta, për të helmuar zemrat e tyre dhe për të ngjallur mosbesim në fitoren e kauzës së paqes dhe të socializmit, për të ruajtur pozitat e tyre skllavëruese në vendet koloniale dhe të varura.

Armiqtë e socializmit mundohen të spekulojnë me vështirësitë e përkohshme dhe me të metat; ata po çirren e përpiqen të diskreditojnë idetë e mëdha të marksizëm-leninizmit, të përçajnë vendet socialiste. Armiqtë e komunizmit, duke u mbështetur në agjenturën e tyre dhe në mbeturinat e klasave shfrytëzuese të mundura, duke mashtruar edhe njerëz të ndershëm, por të papjekur politikisht, përpiqen të zgjojnë ndjenjat shoviniste, të dobësojnë lidhjet midis vendeve socialiste. Por përpjekjet e tyre janë të kota dhe po dështojnë të gjitha.

Sot përpara të gjitha partive tona komuniste dhe gjithë lëvizjes punëtore ndërkombëtare shtrohet me forcë akoma më të madhe që, së bashku me të gjitha forcat paqedashëse që janë kundër shpërthimit të një lufte të re, të bashkuar gjithnjë më ngushtë, të shtojmë vigjilencën, të ruajmë e të forcojmë unitetin e klasës punëtore dhe të luftojmë për të prishur planet e imperialistëve luftënxitës.

Në këtë situatë të re Partia jonë, duke e forcuar gjithnjë e më shumë kompaktësinë dhe unitetin e radhëve të saja, do ta forcojë vazhdimisht solidaritetin dhe bashkëpunimin me partitë e tjera motra komuniste dhe punëtore në luftën kundër rrezikut të një lufte të re, në luftën kundër forcave antipopullore, që synojnë të shtypin lëvizjet revolucionare dhe përparimtare, në

luftën për ndërtimin e socializmit në vendin tonë. Ajo do të mprehë vazhdimisht vigjilencën revolucionare dhe do të mbajë gjithnjë lart flamurin e lavdishëm marksist-leninist të internacionalizmit proletar. Ajo është plotësisht e bindur se idetë e marksizëm-leninizmit, mësimet e Revolucionit të Tetorit kanë triumfuar dhe do të triumfojnë kurdoherë, se as shpifjet as sulmet e armiqve nuk mund të ndalojnë ecjen përpara të zhvillimit historik të njerëzimit drejt komunizmit.

Lavdi Revolucionit të madh socialist të Tetorit!

Më 8 Nëntor 1941 u themelua për herë të parë Partia e lavdishme Komuniste Shqiptare. Momenti nacional ishte në favor të themelimit të Partisë. Populli kishte vuajtur nën kërbacin e bejlerëve, të çifligarëve, të kulakëve dhe të regjimit barbar e tradhëtar të Ahmet Zogut. Mbi të gjitha u shtua thundra e okupatorëve fashistë italianë dhe gjermanë që kishin sulmuar Evropën dhe Bashkimin Sovjetik. Rruga patriotike dhe internacionaliste që duhej të ndiqnin komunistët e grupeve ishte të bashkoheshin në një parti të vetme dhe në krye të popullit ta udhëhiqnin këtë në luftën e shenjtë për një Shqipëri të lirë, demokratike dhe popullore.

Klasa jonë punëtore, sido që shumë e vogël për arësye të zhvillimit të dobët të kapitalizmit dhe të industrisë në vendin tonë, e kuptoi rolin e saj historik. Që gjatë regjimit të Zogut ajo kishte manifestuar me forcë kundër shtypjes e shfrytëzimit, për liritë demokratike dhe ekonomike. Ekzistonte, pra, në vendin tonë një bërthamë revolucionare dhe luftarake.

Nga ana tjetër fshatarësia jonë ishte një forcë e madhe revolucionare me tradita luftarake, e gatshme

në çdo moment të ngrinte krye kundër feudalëve dhe borgjezisë, ajo ishte gati të luftonte kundër okupatorëve fashistë dhe të shkundte zgjedhën shekullore. Çështja e çlirimit të atdheut dhe çështja e tokës u bënë për fshatarësinë tonë një problem jetik, të cilin ajo ishte e bindur se vetëm me armë në dorë do ta zgjidhte. Nga eksperiencia e historisë së kaluar punëtorja, fshatarësia, rinia trime dhe gratë heroike të vendit tonë, i gjithë populli shqiptar, kishin nxjerrë konkluzione të rëndësishme për krijimin e fortë të unitetit të popullit, për krijimin e aleancës së shëndoshë në mes të punëtorëve dhe të fshatarëve nën udhëheqjen e klasës punëtore dhe se vetëm të bashkuar duhet t'i godasim pa mëshirë okupatorët dhe tradhëtarët.

Në momentet tragjike për vendin tonë të okupuar nga fashistët, komunistët e grupeve hodhën poshtë mosmarrëveshjet e tyre dhe u afruan afër popullit me aksione të gjera masash. Ata goditën pa mëshirë trockistët dhe provokatorët që ishin futur në radhët e tyre, që kishin frenuar krijimin e frontit popullor antifashist që në kohën e Zogut, kur vendi ynë kërcënohej nga okupacioni, dhe më vonë, për të sabotuar formimin e Partisë Komuniste, zhvillonin një aktivitet të madh politik, teorik dhe organizativ. Këta trockistë dhe tradhëtarë u aktivizuan edhe më shumë për ta penguar luftën e popullit shqiptar.

Por, komunistët internacionalistë shqiptarë e shihnin të domosdoshëm dhe jetik themelimin e Partisë së tyre. Ata e kishin të qartë rolin e Bashkimit Sovjetik në luftën kundër agresorëve fashistë dhe ishin të bindur se shpëtimi i popullit tonë do të vinte nga Bashkimi

Sovjetik dhe nga lufta që do të bënte vetë populli i udhëhequr nga një parti marksiste-leniniste. Organizimi i rezistencës, aksionet e guximshme kundër okupatorëve dhe sulmi tradhëtar i hitlerianëve kundër Bashkimit Sovjetik krijuan të gjitha kushtet për themelimin e Partisë, për mposhtjen e trockistëve dhe për kapërcimin e të gjitha vështirësive.

Në konferencën e grupeve, për shumë ditë me radhë komunistë të zot sulmuan me rreptësi trockistët Anastas Lula, Sadik Premte etj. që mbronin me këmbëngulje teoritë trockiste, menshevike dhe likuidatore, që mbronin tezat e okupatorëve dhe të kuislingëve dhe që përfaqësonin çka ishte e huaj për proletariatin dhe për Partinë Komuniste. Tezat e Anastas Lulës, Sadik Premtes, Zef Malës, Aristidh Qendros, Zai Fundos dhe provokatorëve të tjerë u shqelmuar në këtë mbledhje historike të 8 Nëntorit të vitit 1941 dhe triumfuan tezat marksiste-leniniste.

Në orët e vona të natës, të datës 8 Nëntor, si sot 15 vjet më parë, u themelua Partia Komuniste Shqiptare dhe u zgjodh Komiteti i saj Qendror Provizor, të cilit iu ngarkua barra historike të organizonte Partinë, të caktonte programin.

Që në ditët e para të lindjes së saj Partia jonë doli me një program të qartë që konsistonte në një luftë të paprerë dhe pa kompromis kundër okupatorëve dhe tradhëtarëve, në organizimin e popullit për kryengritje të përgjithshme. Në programin e Partisë ishte krijimi i ushtrisë heroike të popullit, e cila do të luftonte deri në fund për çlirimin e Shqipërisë, që populli të merrte pushtetin në duart e tija duke shkatërruar nga



themeli pushtetin e borgjezisë dhe të okupatorëve dhe në vend të tij të ngrihej pushteti i ri i këshillave nacional-çlirimtare, që të vendosej në vendin tonë demokracia popullore dhe pas çlirimit të Shqipërisë të zbatoheshin reforma të mëdha shoqërore dhe ekonomike për popullin.

Pra, duke vënë në krye të programit të vet Luftën nacional-çlirimtare kundër pushtuesve fashistë, Partia Komuniste Shqiptare vendosi shumë drejt dhe drejtësia e këtij vendimi u vërtetua në jetë. Thirrjes së Partisë për luftë kundër okupatorëve fashistë dhe tradhëtarëve të vendit ju përgjegj i madh e i vogël. I gjithë populli, klasa punëtore e lavdishme, fshatarësia jonë heroike, rinia jonë e mrekullueshme dhe heroike, inteligjencia patriotike, gratë trime të vendit tonë, të gjithë rrokën armët dhe luftuan me heroizëm e vetëmohim që nuk kishte shembull deri atëhere në historinë e lavdishme të popullit tonë.

Vite me radhë partizanët e lavdishëm të Shqipërisë lanë nam si brenda ashtu edhe jashtë vendit tonë. Vite me radhë partizanët e lavdishëm të Shqipërisë, në kushte të pabarabarta me forcat e armikut, i goditën për vdekje okupatorët dhe tradhëtarët. Vite me radhë malet, fushat, qytetet dhe kasollet e fshatarëve u bënë çerdhe të zjarra të Luftës nacional-çlirimtare. Ushtria jonë e lavdishme Popullore, kuadrot e saj udhëhoqës, të kalitur në beteja të përgjakshme, të farkëtuar me ndjenjat më të kulluara dhe me virtytet më të larta të popullit tonë, çliruan atdheun e dashur nga robëria shekullore, i dhanë popullit lirinë, pavarësinë, e bënë atë zot të fateve të tij dhe sovran.

Fitorja e popullit tonë mbi okupatorët fashistë dhe tradhëtarët e vendit, ashtu sikurse e të gjithë popujve të tjerë që fituan lirinë, u bë e mundshme sepse frymëzohej dhe ndihmohej nga lufta legjendare heroike e Ushtrisë Sovjetike e cila dërmoi hordhitë nazi-fashiste që kishin invaduar Evropën.

Në 29 Nëntor 1944 flamuri i popullit valoi krenar dhe i lirë në atdheun tonë të lirë, në atdheun shqiptar, për të cilin kishin luftuar me shekuj gjyshërit tanë të lavdishëm.

Ushtria jonë nuk u ndal vetëm me çlirimin e Shqipërisë, por ajo kreu edhe një detyrë të lartë internacionaliste, krah për krah me partizanët trima jugosllavë ajo sulmoi okupatorët fashistë në Mal të Zi, Bosnje, Hercegovinë, Kosovë e Metohi, luftoi dhe derdhi gjak për çlirimin e popujve të Jugosllavisë, për miqësinë me popujt jugosllavë.

Sot ushtria jonë e lavdishme është më e fortë se kurrë. Forcat tona të lavdishme të Sigurimit të Shtetit dhe të kufirit janë si kurdoherë të gatshme dhe vigjilente për të mbrojtur atdheun nga çdo rrezik, për të mbrojtur fitoret e popullit, socializmin, lirinë dhe pavarësinë e atdheut tonë.

Populli shqiptar dhe Partia e tij e Punës që edukuan forcat e mbrojtjes, që i rritën ato në beteja të përgjakshme për liri, i rrethojnë ato kurdoherë me dashuri dhe me kujdesin më të madh. Për popullin dhe për Partinë ushtari dhe oficeri, qofshin këta në shërbim aktiv, qofshin në lirim, konsiderohen si bijtë e tyre nga më të mirët, nga më heroikët, nga më të lavdishmit.

Partia jonë Komuniste që në fillim u krijua si një

parti e tipit të ri, e bazuar në marksizëm-leninizmin, si një parti e klasës punëtore dhe e masave punonjëse. Ajo proklamoi që në fillim se nuk ishte një parti e tipit të vjetër e ngjashme me partitë socialdemokrate të Internacionales së dytë, në të cilën mbretëronte oportunizmi, grupazhi dhe tradhëtia e interesave të klasës punëtore.

Që partia e klasës punëtore të kryente detyrën e madhe historike, që t'i shërbente popullit dhe ta çonte atë në fitoren e plotë, në radhë të parë ajo duhej të organizohej në bazë të parimeve organizative marksiste-leniniste, të lidhej ngushtë me popullin dhe të ndiqte me besnikëri mësimet e Leninit të madh. Duke pasur parasysh mësimet e Leninit të madh, Partia që në ditët e para shtroi si detyrë mbushjen e radhëve të saja me elementë të klasës punëtore, të fshatarëve të varfër, të shtresave punonjëse dhe të vuajtura të qyteteve e të fshatrave. Për ta kryer këtë detyrë si duhet, Partia ngrinte me forcë pajisjen e anëtarëve të saj me teorinë marksiste-leniniste.

Në mënyrë të veçantë dhe me forcë të madhe që në themelimin e saj Partia i vuri rëndësi çështjes së sigurimit të unitetit të saj, unitet të cilin Lenini e ka quajtur një nga kushtet më themelore sepse vetëm kështu Partia do të kapërcente vështirësitë dhe do të udhëhiqte me sukses proletariatin dhe të gjithë punonjësit për të përmbysur kapitalizmin dhe për të ndërtuar socializmin.

Në Partinë tonë u likuidua menjëherë shthurja e disiplinës që ekzistonte në radhët e grupeve komuniste dhe u vendos disiplina e çelniktë dhe e vetëdijshme, u vendos disiplina dhe nënshtrimi ndaj vendimeve të shumicës së Partisë nga ana e anëtarëve të saj dhe në këtë

drejtim Partia jonë udhëhoqej nga eksperiencia e Partisë Bolshevike dhe nga mësimet e Leninit i cili thoshte:

*«Po e përsëris, eksperiencia e diktaturës ngadhnjimtare të proletariatit në Rusi u ka treguar qartazi... se centralizimi absolut dhe disiplina shumë e fortë e proletariatit janë një nga kushtet kryesore të fitores mbi borgjezinë»<sup>1</sup>.*

Lufta e vendosur dhe parimore, që kishte bërë Partia Bolshevike kundër armiqve të brendshëm, u mësoi komunistëve shqiptarë se një parti e vërtetë e klasës punëtore mund ta ruajë unitetin e saj dhe mund të forcohet vetëm në luftë të vazhdueshme kundër të gjithë armiqve të partisë që mundohen ta largojnë partinë nga rruga e marksizëm-leninizmit dhe ta shkatërrojnë atë. Prandaj Partia, që në ditët e para të themelimit të saj, vuri detyrë të dorës së parë ruajtjen e unitetit ideologjik dhe organizativ të Partisë, dhe flaku jashtë saj të gjithë fraksionistët, tarafxhinjtë dhe njerëzit e pandërgjegjshëm, likuidoi liberalizmin dhe shfaqjet oportuniste. Partia jonë gjatë gjithë jetës së saj ka luftuar kundër elementëve deviatorë, tradhëtarë dhe shkatërrues, të cilët kanë pasur për qëllim të thyenin unitetin e Partisë dhe të udhëheqjes së saj për ta mposhtur Partinë, për ta hedhur atë në pellgun e oportunizmit dhe për të shkatërruar pastaj fitoret e popullit.

Në këtë drejtim ka punuar banda tradhëtare e Koçi Xoxes dhe e Pandi Kristos që me krimet e tyre kanë

<sup>1</sup> V. I. Lenin. Veprat, vëll. 31, f. 9.

dashur të shkatërronin unitetin e Partisë, ta ndërronin Partinë tonë marksiste-leniniste në një parti borgjeze dhe të zhduknin kështu regjimin e demokracisë popullore. Këto qëllime kanë pasur gjithashtu edhe Sejfulla Malëshova, Ymer Dishnica, Bedri Spahiu, Tuk Jakova, Liri Gega, Dali Ndreu, Vehip Demi, Pajo Islami dhe të tjerë armiq të Partisë e të socializmit. Por Partia jonë i ka goditur pa mëshirë të gjithë këta armiq dhe ka ruajtur si sytë e ballit unitetin e saj, i cili është më i fortë se kurdoherë dhe i bën ballë të gjitha tentativave të armiqve të jashtëm dhe të brendshëm që kërkojnë të dëmtojnë interesat jetike të popullit shqiptar.

Që në ditët e para Partia i mësoi anëtarët e saj dhe gjithë popullin të jenë kurdoherë vigjilentë. Faktet tregojnë se Partia dhe populli ynë nuk i mbyllën kurrë sytë dhe i goditën pa mëshirë të gjithë komplotistët dhe armiqtë e jashtëm e të brendshëm që kërkonin t'i rrëmbenin popullit fitoret nga duart. Në çdo moment lufta e Partisë dhe e popullit tonë ka qenë dhe do të jetë e pamëshirshme kundër elementëve antiparti, kundër tradhëtarëve të atdheut dhe kauzës së shenjtë të popullit. Për armiqtë e tij populli dhe Partia jonë do të jenë kurdoherë të gatshëm t'u japin atyre në çdo moment mësimin e merituar.

Jemi larg ditëve kur Partia jonë përbëhej vetëm prej 200 vetësh. Ajo tani ka afro 50 mijë anëtarë. Në të bëjnë pjesë djem dhe vajza nga më të mirët e popullit, nga më besnikët, nga më heroikët. Partia jonë që gëzon dashurinë e madhe të popullit shqiptar është bërë mburoja e çelniktë e interesave të tij jetike. Komunistët që nga fillimi i luftës i zbatuan me nder të gjitha dety-

rat që u ngarkoi Partia. Ata kurrë nuk iu shmangën këtyre detyrave, kurrë nuk e përlyen emrin e Partisë, por edhe me litar në grykë, përpara torturave dhe plumbave të okupatorëve e tradhëtarëve bërtitnin «Rroftë populli!», «Rroftë Partia!». Ky program luftarak i Partisë, kjo qëndresë heroike e anëtarëve të saj ngriti peshë të gjithë popullin shqiptar dhe tronditi okupatorët e tradhëtarët.

15 vjet kanë kaluar që nga themelimi i Partisë Komuniste Shqiptare, sot Partia e Punës e Shqipërisë. Gjatë këtyre 15 vjetëve, Partia jonë në krye të popullit ka kaluar një rrugë të lavdishme plot rreziqe dhe vështirësi, ka kapërcyer prova të rënda, por ajo ka qenë kurdoherë në shërbim të plotë të popullit, ka qenë e lidhur ngushtë me popullin, ka luftuar deri në fund për popullin dhe ka dalë fitimtare. Me të drejtë Partia jonë gëzon sot besimin dhe dashurinë e të gjithë popullit punonjës dhe konsiderohet prej tij si forca drejtuese e Republikës Popullore të Shqipërisë, e aftë dhe heroike për të udhëhequr ndërtimin e socializmit që i siguron popullit lumturinë dhe begatinë.

15 vjetët e Partisë sonë kanë treguar se Partia e Punës e Shqipërisë është një parti marksiste-leniniste që mbështetet fort në parimet marksiste-leniniste, që mbështetet fort në masat e popullit dhe që shpreh aspiratat më të shenjta të këtyre masave. Partia jonë nuk ka interesa të tjera veç atyre të popullit, gjithnjë ajo është mbështetur në masat dhe ka mbajtur lidhje të forta me to. Ndryshe nuk mund të shpjegohen fitoret e revolucionit tonë popullor dhe sukseset e arritura për ndërtimin e socializmit. Partia organizoi që në kohën e luftës një Front të gjerë Nacional-Çlirimtar, ku mo-

rën pjesë të gjitha forcat antifashiste, u vunë në lëvizje energji revolucionare të popullit, u krijua një unitet i shëndoshë dhe u kalit një patriotizëm i madh në masat e gjera të popullit. Partia e dinte se Luftën nacional-çlirimtare dhe ndërtimin e socializmit do t'i kryenin masat e popullit dhe jo vetëm kuadrot e Partisë. Në këtë front duhej të merrnin pjesë dhe morën të gjithë patriotët pa dallim shtrese, feje, origjine, klase që kishin pikëpamje politike të ndryshme, por që në radhë të parë pranonin luftën kundër okupatorit dhe tradhëtarëve nën drejtimin e Partisë dhe ishin për krijimin e demokracisë popullore. Me këtë program të qartë, Partia i sqaronte njerëzit e ndershëm se interesat e atdheut kërkonin që më parë të luftohej dhe të mposhtej armiku kryesor, fashizmi dhe tradhëtarët që shtypnin punëtorin, fshatarin, inteligjencien patriote, tregëtarët e vegjël e zanatçinjtë dhe të gjitha shtresat e varfëra të qytetit dhe të fshatit. Këtë vijë të qartë dhe të drejtë Partia e konkretizoi në Konferencën e Pezës. Klasa punëtore që në ditët e para të luftës u hodh me vendosmëri në luftë dhe kuptoi rolin historik drejtues të saj, ajo kuptoi se Partia Komuniste Shqiptare ishte detashmenti pararojë i organizuar i saj. Fshatarësia e varfër dhe e mesme e përqafoi gjithashtu politikën e drejtë të Partisë për luftë dhe kuptoi se Lufta nacional-çlirimtare që udhëhiqte Partia Komuniste ishte lufta e klasës punëtore në aleancë të ngushtë me fshatarësinë për çlirimin dhe për demokracinë. Kjo luftë nuk pajtohej me interesat e klasave sunduese. Prandaj qëllimet dhe tradhëtia e klasave sunduese gjatë Luftës nacional-çlirimtare u përcaktuan nga kushtet dhe pozitat shoqërore

të tyre. Feudoborgjezia për të ruajtur privilegjet që i kërcënoheshin nga hovi revolucionar i popullit, u bashkua dhe u shit te okupatori. Borgjezia e pasur fshatare u bashkua edhe ajo me organizatat tradhëtare, «Ballin Kombëtar» dhe «Legalitetin». Një hendek i madh po hapej dhe lufta do të bëhej gjithmonë më e ashpër gjatë revolucionit popullor. Partia Komuniste forcoi besimin e fshatarësisë së varfër dhe të mesme se vetëm duke luftuar nën udhëheqjen e klasës punëtore, ajo do të realizonte aspiratat e saja. Platforma që parashitroi Partia në Konferencën e Pezës dhe krijimi i Frontit Nacional-Çlirimtar, ishte një fitore e madhe e politikës tej pamëse të Partisë.

Partia ka kërkuar me këmbëngulje prej anëtarëve të saj që të jenë të parët në luftë, të parët në punë dhe shembull në jetë, se vetëm kështu masat do të shohin te komunistët dhe te Partia në tërësi udhëheqjen e tyre. Dhe populli e pa gjatë këtyre 15 vjetëve se Partia jonë është udhëheqësja besnike e tij. Nga eksperiencia e tyre masat janë bindur për drejtësinë e politikës së Partisë, prandaj i kanë shtërnguar ngahera e më shumë radhët rreth saj. Partia jonë krijoi lidhje të forta me masat, sepse ajo nuk e harroi kurrë se forca e saj qëndron pikërisht atje. Ajo luftoi kundër çdo gjëje që i dobësonte këto lidhje, kundër mosbesimit në masat, nënvleftësimit të rolit të tyre, sektarizmit e mendjemadhësisë në kuadrot. Kurdoherë, në momentet më të vështira të jetës së saj, Partia u është drejtuar masave dhe ato vazhdimisht e kanë mbështetur politikën e Partisë, prandaj ajo ka fituar gjithmonë. Ajo ka krijuar lidhje të organizuara me masat me anën e Frontit Demokratik, kë-



shillave popullore, bashkimeve profesionale, Bashkimit të Grave të Shqipërisë, Bashkimit të Rinisë së Punës etj. Këto lidhje janë të pathyeshme, sado që armiqtë, si gjatë luftës edhe më vonë, janë përpjekur ta ndajnë Partinë nga masat, ta izolojnë, por asnjëherë kjo nuk u ka ecur, këto përpjekje kanë dështuar dhe Partia i ka çelnikosur lidhjet me popullin.

Duke i hedhur një sy rrugës së përshkuar nga Partia jonë në këta 15 vjet të jetës së saj mund të thuhet se lidhja me masat është një karakteristikë dalluese e saj.

Detyra e madhe që i shtrohet Partisë sonë edhe për të ardhshmen është ta ruajë këtë traditë të shkëlqyer, t'i forcojë lidhjet e saja me masat ashtu si na porositi Kongresi III i Partisë sonë. Në këtë çështje Partia udhëhiqet nga tezat marksiste-leniniste se masat janë krijuese të historisë, se janë ato që realizojnë transformimet e mëdha shoqërore dhe sa më të thella që kërkohet të bëhen këto transformime aq më e gjerë duhet të jetë pjesëmarrja e masave në realizimin e tyre.

Vendi ynë gjendet tani përpara transformimeve të mëdha. Në industri kërkohet të ngrihet rendimenti në punë, të shfrytëzohen rezervat e brendshme, të prodhohet me cilësi të mirë dhe kosto të ulët. Në fshat po ecet me ritëm të shpejtë drejt kolektivizimit, kërkohet të zhvillohet një bujqësi intensive, të zhvillohet një ekonomi e gjithanshme dhe të rriten shumë prodhimet bujqësore e blegtorale. Këto detyra nuk mund të realizohen pa pjesëmarrjen e gjerë të masave, pa inisiativën e tyre krijuese, pa i hapur rrugë të gjera zhvillimit të kësaj inisiative. Neve na kërkohet tani që në këto kushte të reja, të gjejmë mjetet dhe format e punës që i tër-

heqin masat e gjera të qytetit dhe të fshatit në realizimin e detyrave të mëdha që na dalin përpara.

Partia i ka kritikuar dhe do t'i kritikojë fort të gjithë ata komunistë që janë mësuar të japin vetëm urdhëra dhe të mos dëgjojnë zërin e masave, të mos mësojnë prej tyre. Dhe është fakt se këto sëmundje i kanë zënë disa shokë duke u bërë kështu pengesë në punën e Partisë e të pushtetit. Duhet, pra, të luftojmë me forcë kundër këtyre shfaqjeve të huaja për komunistët dhe të kërkojmë që të bëhet një punë e gjerë, e organizuar mirë me të gjitha masat e popullit. Partia jonë ka folur gjithnjë për lidhjet me masat, për të dëgjuar zërin e tyre dhe për të mësuar prej tyre, po ka raste që këto mbeten formale, të thata. Kërkohet që ky parim i lartë i Partisë të zbatohet më mirë, shumë më mirë në jetë. Të konsultohemi me masat kur marrim vendime, sepse vetëm kështu vendimet do të jenë plotësisht të drejta, do të shprehin mendimet dhe eksperiencën e masave dhe do të gjejnë aprovimin dhe mbështetjen e plotë të tyre.

Fronti Demokratik është një mjet i fuqishëm që e lidh Partinë me masat, që i bashkon masat më të gjera të punonjësve rreth Partisë. Fronti te ne ka tradita të forta organizimi e pune, si dhe në luftën për çlirimin e atdheut, ashtu edhe sot për ndërtimin e socializmit. Partia duhet ta gjallërojë akoma më shumë këtë levë që e lidh atë me masat, të mos e nënvleftësojë atë. Ashtu si duhet Partia të forcojë përherë e më shumë të gjitha organizatat e tjera të masave që në formë të organizuar e lidhin Partinë me popullin. Partia duhet të luftojë gjithashtu çdo shfaqje sektare e jo në vijën e Partisë

në lidhje me elementët jokomunistë, me patriotët që e duan atdheun e tyre dhe punojnë për të mirën e tij, veçanërisht me intelektualët që i kanë vënë dijenitë e tyre në shërbim të popullit. Të afrohen akoma më shumë, ashtu si thekson kurdoherë Partia, të gjithë këta njerëz, të aktivizohen, të trajtohen drejt, të krijohet për ta një atmosferë e ngrohtë dhe ta ndjejnë kurdoherë veten afër Partisë dhe zot të vendit të tyre, për fatet e të cilit duhet të interesohen vazhdimisht.

Partia ka porositur gjithnjë dhe porosit që, ata të cilët janë të paqartë duhet t'i sqarojmë me durim, ata që lëkundën duhet t'i bindim në drejtësinë e vijës së Partisë, ata që janë nën influenca të huaja t'i shkëputim nga këto influenca dhe vetëm armiqtë t'i demaskojmë e t'i godasim pa mëshirë. Detyra e Partisë është që të sqarojë njerëzit për rrugën e drejtë të saj, t'i aktivizojë dhe t'i tërheqë që të punojnë të gjithë për ndërtimin e socializmit, për të mirën e popullit.

Njerëzit e Frontit dhe të gjithë punonjësit e duan vendin e tyre me dashuri të zjarrtë, ata i vënë me vullnet të mirë aftësitë e tyre në shërbim të popullit. Sigurisht, ata do të shtojnë edhe më shumë kontributin e tyre në çështjen e mbrojtjes së pavarësisë së atdheut dhe të ndërtimit të socializmit. Të tillë janë me mijëra e mijëra anëtarë të këshillave popullore e të kryesive të organizatave të masave, aktivistë të tyre, punëtorë të pararojës e bujq të përparuar, teknikë, inxhinierë, agronomë, mjekë e specialistë të tjerë, mësues e njerëz të artit e të kulturës e kështu me radhë. Gjithë këta njerëz punojnë e punojnë mirë, kanë aftësi në punë, janë lidhur fort si mishi me koskën me Partinë, sepse ata kanë parë kurdo-

herë se politika e Partisë ka qenë e drejtë dhe ka shprehur me besnikëri interesat më të thella të tyre.

Kongresi III i PPSH i kushtoi një kujdes të madh lidhjes së Partisë me masat, duke theksuar se kjo është një çështje themelore për Partinë tonë dhe duke kërkuar që të luftohet çdo shfaqje burokratizmi që pengon lidhjet e Partisë me masat. Detyra jonë është që ta zbatojmë akoma më mirë në praktikë këtë direktivë të Partisë, duke përmirësuar metodën e punës së Partisë me masat. Të punojmë shumë për ngritjen e ndërgjegjes së tyre politike për të ngritur në radhë të parë veprimtarinë e tyre në drejtimin e punëve të shtetit, sepse kjo është e domosdoshme për fitoren e socializmit dhe për realizimin me sukses të planit të dytë pesëvjeçar.

Partia jonë organizoi dhe udhëhoqi me besnikëri luftën e popullit shqiptar kundër okupatorëve fashistë e njëkohësisht edhe kundër feudalëve dhe borgjezisë reaksionare që gjatë luftës bënë kauzë të përbashkët me okupatorët kundër popullit. Në fakt populli e shikonte qartë se e gjithë administrata e vjetër zogiste dhe institucionet e pushtetit fashist u vunë në shërbim të pushtuesve, kundër popullit dhe Partisë sonë të re. Historia e së kaluarës e kishte bindur popullin shqiptar se megjithëqë disa herë ai e kishte fituar luftën për çlirimin nacional, nuk ishte çliruar nga shtypja e shfrytëzimi, klikat feudalo-borgjeze kishin vazhduar t'i pinin gjakun dhe më në fund kishin shitur tokën amëtare dhe i kishin hapur dyert imperialistëve të huaj.

Prandaj populli e mbështeti pa rezerva direktivën e Partisë për ngritjen e pushtetit të ri popullor e demokratik të këshillave nacional-çlirimtare. Direktivat dhe

masat që mori Partia tregojnë se sa drejt shtrohej ngritja e pushtetit popullor, në baza marksiste-leniniste, në rrugë revolucionare, sipas shembullit të Sovjetëve. Dhe në fakt prej tyre u formua shteti i punëtorëve e i fshatarëve, duke u kalitur në zjarrin e Luftës nacional-çlirimtare, duke ndjekur një rrugë revolucionare.

Për realizimin e programit të ri ndërtimtar, Partia i tregoi popullit rrugët e reja për forcimin e mëtejshëm të pushtetit popullor. Gjatë këtyre 12 vjetëve, në vendin tonë u realizuan transformime rrënjësore në jetën ekonomike e kulturele të vendit. Pushteti popullor, si armë e fuqishme në duart e masave, jo vetëm dërmoi rezistencën e klasave të përmbysura, por tërhoqi masat e gjera punonjëse në punën paqësore për ndërtimin e bazave të socializmit. Njëpërmjet këshillave popullore realizohet pjesëmarrja e gjerë e masave në qeverisjen e vendit. Këshillat popullore, që mishërojnë traditat më të mira të këshillave nacional-çlirimtare, shërbejnë sot si organe të regjimit tonë të demokracisë popullore, si një formë e veçantë e organizimit shtetëror të diktaturës së proletariatit. Ato e kanë treguar veten plotësisht të përshtatshme dhe të afta për kryerjen e detyrave që shtrou ndërtimi i socializmit.

Kongresi III i Partisë, duke pasur parasysh punën e madhe ndërtimtare gjatë planit të dytë pesëvjeçar, theksoi edhe një herë nevojën e forcimit të mëtejshëm të pushtetit popullor, e lidhjeve më të ngushta me masat, e zhvillimit të inisiativës së këshillave popullore dhe e aktivizimit sa më të gjerë të masave rreth tyre, nevojën që të luftohet më me vendosmëri kundër burokratizmit, nevojën e përmirësimit të metodës së

drejtimit të ekonomisë nga ana e organeve të pushtetit, e respektimit me përpikmëri të ligjshmërisë socialiste. Zgjedhjet e reja të këshillave popullore që do të zhvillohen më 2 dhjetor të këtij viti do t'i japin një hov të ri punës së tyre fisnike në shërbim të popullit e të socializmit. Drejtësia e politikës së Partisë sonë, forca gjallëruese e pushtetit tonë popullor, kanë bërë që Parti, pushtet dhe popull të jenë një dhe të pandarë, kanë bërë që në vendin tonë të jetë krijuar uniteti i çelniktë i popullit rreth Partisë dhe qeverisë, që armiqtë e kanë zili dhe me çdo mjet përpiqen ta dëmtojnë. Por a mund të zënë vend parullat e armikut përpara këtij realiteti të mrekullueshëm në Shqipëri? Jo, kurrë! Patriotizmi i madh i popullit, që vetë e krijoi këtë realitet, nuk do të lejojë kurrë që armiku ta dëmtojë. Në çdo moment, dhe veçanërisht tani, vigjilenca e popullit dhe e Partisë duhet të jetë e madhe për të mbrojtur fitoret e arritura. Krahas me vigjilencën, duhet gjithashtu të mobilizohen të gjitha energjitë në punë, të zhduken gabimet në punë, pse po të themi se jemi pa gabime, ne nuk do të jemi realistë, por këto gabime në punën tonë, ashtu si na mëson Partia, ne çdo herë t'i zhdukim shpejt, të mos i përsëritim dhe të mësojmë prej tyre.

Shokë dhe shoqe,

Sikurse në të gjithë aktivitetin e saj, ashtu edhe për ndërtimin e socializmit në Shqipëri, Partia jonë e mori eksperiencën e Partisë Bolshevike si shembullin më të mirë, si mbështetjen kryesore, si rrugën më të

drejtë, duke e zbatuar këtë eksperiencë në mënyrë krijuese dhe jodogmatike, në bazë të kushteve konkrete të vendit tonë.

Pas çlirimit, detyra imediate e Partisë ishte konsolidimi i pushtetit popullor, përfundimi i revolucionit demokratiko-popullor dhe kalimi në ndërtimin e bazave të socializmit. Fakti që Partia jonë nuk e ndau pushtetin me parti të tjera politike, që ajo ishte e vetmja parti politike në fuqi, fakti që ajo, në të gjithë veprimtarinë e saj gjeti mbështetjen pa rezerva të masave të gjera punonjëse të vendit, fakti që ajo diti ta zbatonte në mënyrë krijuese marksizëm-leninizmin, të gjitha këto bënë të mundur që, në një periudhë relativisht të shkurtër, në periudhën e viteve 1945 dhe 1946, të zbatoheshin me sukses të gjitha masat dhe reformat që kishin të bënin me përfundimin e revolucionit demokratiko-popullor dhe me përgatitjen për kalimin në ndërtimin e bazave të socializmit.

Përveç trashëgimeve të hidhura nga e kaluara lufta i shkaktoi humbje të rënda vendit tonë. Ne dolëm nga Lufta e dytë botërore me këtë bilanc të tmerrshëm: 7,3 për qind e popullsisë mbeti e vrarë, e plagosur dhe e humbur, 21 për qind e shtëpive të fshatarësisë u dogj dhe u shkatërrua, mbi 1/3 e blegtorisë u asgjësua, të gjitha qytetet u dëmtuan rëndë, të gjitha fabrikat u shkatërruan ose dolën jashtë përdorimit, të gjitha mjetet e komunikacionit u shkatërruan, e gjithë ekonomia e vendit u paralizua. Për të mbyllur të gjitha këto plagë të rënda të luftës, për të rindërtuar ekonominë e shkatërruar nga lufta, Partisë dhe popullit tonë iu desh një punë e madhe vetëmohuese dhe krijuese. Pa rindër-

tuar ekonominë e shkatërruar nga lufta, as që mund të mendohej për fillimin e ndërtimit të ekonomisë socialiste të planifikuar.

Partia jonë ka mësuar nga eksperiencia e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe e ka provuar nga eksperiencia e saj e përditshme se socializmi mund të ndërtohet vetëm duke siguruar udhëheqjen dhe drejtimin e Partisë mbi të gjithë jetën politike, ekonomike dhe shoqërore të vendit, se socializmi nuk mund të ndërtohet pa një industri të fuqishme që të bëhet baza ekonomike për zhvillimin e pandërprerë të të gjitha degëve të tjera të ekonomisë popullore, se socializmi nuk mund të ndërtohet pa kolektivizimin e bujqësisë, se ndërtimi i socializmit ka si qëllim kryesor përmirësimin e vazhdueshëm të gjendjes materiale dhe ngritjen e nivelit kultural të masave punonjëse.

Në ndërtimin e socializmit në vendin tonë, Partia jonë ka pasur kurdoherë parasysh faktorët subjektivë dhe objektivë që vështirësojnë ose lehtësojnë ndërtimin e socializmit në rrethanat tona konkrete. Pikënisja e ndërtimit të socializmit në vendin tonë nga një gjendje ekonomike dhe kulturele shumë e prapambetur, mungesa e kuadrove teknike, vështirësitë e krijuara nga rrethimi kapitalist, vështirësitë e ndryshme dhe të shumta të rritjes — të gjitha këto kanë qenë pengesa serioze që e kanë vështirësuar punën tonë në ndërtimin e socializmit. Ekzistenca dhe ndihma e vendeve socialiste, rritja e hovshme e peshës specifike të socializmit në botë, si rezultat i daljes së socializmit nga kuadri i një shteti të vetëm, ndryshimi i raportit të forcave në arenën ndërkombëtare në favor të socializmit dhe në



dëm të kapitalizmit, mundësia për të përfituar drejt-përdrejt nga eksperiencia më e mirë për ndërtimin e socializmit, nga eksperiencia e Bashkimit Sovjetik, vendosmëria e Partisë sonë për ndërtimin e socializmit dhe kalitja e ndërgjegjes së komunistëve e të popullit në shkollën e madhe të Luftës nacional-çlirimtare, uniteti leninist i mendimit dhe i veprimt të Partisë sonë për zbatimin në praktikë të vijës së saj të përgjithshme marksiste-leniniste, uniteti i pathyeshëm i Partisë me masat e popullit, patriotizmi i shkëlqyer i popullit tonë dhe gatishmëria e tij e vendosur për të vajtur pas Partisë për ndërtimin e socializmit — të gjithë këta faktorë kanë qenë vendimtarë për kapërcimin e vështirësive, për arritjen e sukseseve kolosale në ndërtimin e socializmit dhe janë garanci për ruajtjen e pavarësisë së atdheut tonë dhe për triumfin e ndërtimit të socializmit në Shqipëri.

Si rezultat i plotësimit në përgjithësi me sukses të planit të parë pesëvjeçar, vendi ynë u transformua nga një vend agrar i prapambetur në një vend agraro-industrial. Ne krijuam industrinë tonë të re, socialiste, e cila është bërë bazë e shëndoshë për të ndihmuar zhvillimin e mëtejshëm të të gjitha degëve të ekonomisë popullore. Ajo administrohet dhe drejtohet nga kuadrot e rinj të vendit të formuar në universitetet e Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të demokracisë popullore dhe të edukuar me kujdes nga Partia.

Në vitin 1955 vlera e prodhimit të përgjithshëm industrial ka qenë gati 11 herë më e madhe se në vitin 1938. Ajo çka prodhohej në 12 muaj të vitit 1938 në muajin shtator të këtij viti u prodhua në 29 ditë dhe

në fund të pesëvjeçarit të dytë, në vitin 1960, do të prodhohet në dy javë.

Në vitin 1955, në krahasim me vitin 1938, industria jonë ka prodhuar më tepër: naftë 93 për qind, qymyr guri rreth 53 herë, mineral kromi rreth 17 herë, energji elektrike rreth 8 herë, lëndë druri të sharruar rreth 33 herë, çimento 4 herë, tekstile të pambukta 51 herë, sapun 137 për qind etj. Në vitin 1955, Shqipëria prodhonte qymyr guri, naftë, mineral bakri dhe mineral kromi për çdo frymë të popullsisë më tepër se sa prodhonin në vitin 1954 Greqia, Turqia ose Italia.

Gjatë pesëvjeçarit të parë, si rezultat i përpjekjeve të mëdha të klasës punëtore për të zotëruar teknikën e re të pajisjeve tona industriale, është rritur vazhdimisht rendimenti i punës në të gjitha degët e industrisë. Rendimenti i punës në pesëvjeçarin e parë është rritur 66,7 për qind në sektorin e industrisë dhe të minierave, ose 60,1 për qind në industrinë e naftës, - 150,3 për qind në industrinë e bakrit, - 47,3 për qind në nxjerrjen e qymyrgurit, - 23,1 për qind në industrinë elektrike, -135,7 për qind në industrinë e drurit, - 25 për qind në industrinë e materialeve të ndërtimit, - 45,4 për qind në industrinë e veshmbathjes, - 37,8 për qind në industrinë ushqimore etj.

Karakteristikë e zhvillimit të industrisë në vendin tonë është se pothuaj të gjitha lëndët e para prodhohen në vend. Zhvillimi i industrisë në vendin tonë ka perspektiva të mëdha, sidomos industria e minierave, pasi nëntoka jonë është e pasur në minerale. Industria jonë e re është e rendimentit të lartë, kurse kuadrot e pro-

dhimit industrial janë të rinj, pa eksperiencën e nevojshme për përdorimin racional të të gjitha kapaciteteve prodhuese të industrisë. Këtej del se ne kemi shumë rezerva të brendshme të papërdorura në industri, sikurse në të gjithë sektorët e tjerë të ekonomisë popullore. Këtej del se detyra e përdorimit maksimal të kapaciteteve prodhuese të industrisë sot është detyrë e dorës së parë dhe plotësimi i kësaj detyre do të arrihet kryesisht duke kualifikuar kuadrot vazhdimisht dhe në mënyrë sistematike për të zotëruar teknikën moderne që kanë në duar.

Në pesëvjeçarin e dytë 1956-1960, vëllimi i përgjithshëm i prodhimit industrial do të rritet 92 për qind, me një ritëm mesatar vjetor prej 13,8 për qind, rendimenti i punës do të rritet 62 për qind, kurse kostoja e prodhimit do të ulet 18 për qind në industrinë nacionale dhe 25 për qind në industrinë lokale e në artizanat. Për të realizuar me sukses këto detyra të mëdha kërkohet përmirësimi i vazhdueshëm i metodës së drejtimit të ekonomisë nga organet ekonomike, shtetërore dhe të Partisë, duke e drejtuar ekonominë konkretisht, duke luftuar sistematikisht për zhdukjen e burokratizmit, duke përgatitur dhe kualifikuar kuadrot, duke vendosur një regjim të rreptë kursimi dhe duke përmirësuar cilësinë e prodhimit.

Viti 1956 është viti i parë i pesëvjeçarit të dytë. Rezultatet dhjetëmuajore të këtij viti në realizimin e planit të prodhimit industrial janë në përgjithësi të kënaqshme dhe, siç duket, plani i këtij viti do të realizohet dhe do të tejkalohet. Por duhen akoma përpjekje në të gjithë sektorët e industrisë, veçanërisht

në sektorin e industrisë së drurit dhe të industrisë së materialeve të ndërtimit.

Nën drejtimin e Partisë fshatarësia punonjëse, në aleancë të ngushtë me klasën punëtore, ka korrur suksese të dukshme në zhvillimin e bujqësisë. Prodhimi i përgjithshëm bujqësor në pesëvjeçarin e parë u rrit 37 për qind, sipërfaqet e mbjella u rritën 13 për qind, prodhimi i drithërave të bukës - 53 për qind, rendimenti i grurit - 6 për qind, i misrit - 62 për qind, i orizit - 58 për qind, i pambukut - 47 për qind, i duhanit - 113 për qind etj. Në vitin 1955 bujqësia jonë prodhoi më shumë se në vitin 1950: grurë 38 për qind, oriz 219 për qind, pambuk 77 për qind, panxhar sheqeri 1 679 për qind, duhan 332 për qind, perime 89 për qind dhe patate 14 për qind. Në vitin 1955 kundrejt vitit 1938, numri i kafshëve njëthundrakë arriti në 105 për qind, numri i gjedhëve në 108 për qind, numri i dhenve në 110 për qind, numri i dhive në 109 për qind, i derrave në 562 për qind, i bletëve në 127 për qind etj.

Duke përdorur metodën leniniste të bindjes së fshatarësisë, Partia ka ndjekur një vijë të drejtë në ndërtimin socialist të bujqësisë. Viti 1956 është viti i kthesës në drejtim të shpejtimit të kolektivizimit të bujqësisë, në bazë të vendimit të Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë të vitit të kaluar<sup>1</sup> dhe të Kongresit III të Partisë. Sot kemi mbi 820 kooperativa bujqësore përveç kolektivave bujqësore. Ndërsa në vitin 1950 sektori socialist përbënte vetëm 8 për qind të sipërfaqeve të mbjella, sot

<sup>1</sup> Është fjala për vendimin e Plenumit XVI të KQ të PPSH që u mblodh më 27-28 dhjetor 1955.

ai ka arritur në 39 për qind. Fshatarësia i përgjigjet me entuziazëm detyrës së ndërtimit socialist të ekonomisë bujqësore.

Në pesëvjeçarin e parë të ardhurat e fshatarësisë u rritën 35 për qind, mijëra traktorë të SMT-ve i shërbejnë fshatarësisë; qindra milion lekë kredi i ka dhënë shteti fshatarësisë, më tepër se 10 për qind e numrit të përgjithshëm të familjeve fshatare kanë bërë shtëpi të reja me punën e tyre dhe me ndihmën e shtetit; në pesëvjeçarin e parë pothuajse të gjitha shtëpitë e djegura dhe të shkatërruara nga lufta u ndërtuan nga shteti për fshatarësinë. Politika e drejtë që ndjek Partia në lidhje me fshatarësinë ka bërë që masat punonjëse të fshatit të mbështetin pa rezerva politikën e Partisë dhe të qeverisë, aleancën me klasën punëtore, ndërtimin e socializmit.

Plani i dytë pesëvjeçar shtron si detyrë kryesore nxjerrjen e bujqësisë nga prapambetja. Për të realizuar këtë detyrë të vështirë duhet punë e madhe nga e gjithë Partia, nga shteti dhe nga populli. E vetmja rrugë për nxjerrjen definitive të bujqësisë nga prapambetja, është rruga e kolektivizimit të bujqësisë, e mekanizimit të punimeve bujqësore, e ngritjes së nivelit agroteknik, e përdorimit maksimal të rezervave të mëdha që fshihen në gjirin e bujqësisë sonë. Prandaj duhet të vazhdohet hovi i madh revolucionar që është dukur këtë vit në fshatarësinë punonjëse për vazhdimin e shpejtimit të kolektivizimit të bujqësisë, për të ngritur sa më shumë kooperativa dhe kolektiva bujqësore në bazë të parimit leninist të vullnetit të lirë të fshatarëve.

Për të realizuar me sukses detyrën historike të

shpejtimit të kolektivizimit të bujqësisë, duhet të mprehim vigjilencën kundër elementëve armiq që përpiqen ta pengojnë shpejtimin e ndërtimit socialist në fshat. Kulakët në vendin tonë, me gjithë kufizimin ekonomik e politik të drejtë që u kemi bërë, nuk i kanë humbur akoma shpresat për ta kthyer rrotën e historisë prapa dhe për të rivendosur privilegjet e tyre të humbura. Ata i mbajnë veshët hapët sikurse të gjithë reaksionarët e tjerë, për të dëgjuar avazin e ndonjë Imre Nagi që përfaqëson interesat e tyre, bile ata këtë vit kanë filluar të mbulojnë punën e tyre armiqësore me parulla të majta në mënyrë demagogjike. Kulaku të flet sot për nevojën e «demokratizimit» të regjimit, për nevojën e «vullnetit të lirë» të fshatarit për formimin e kooperativave bujqësore, «për normat leniniste» në Parti dhe në shtet, për nevojën e luftës kundër «kultit të individit» etj. Të gjitha këto bëhen me qëllim për të minuar pushtetin popullor, për të minuar unitetin e popullit me Partinë, për të minuar rolin drejtues të Partisë. Por Partia jonë ka qenë dhe do të jetë kurdoherë vigjilente kundër armiqve, Partia dhe populli ynë dinë të dallojnë armikun dhe të marrin masa kundër tij.

Fshatarësia punonjëse ka qenë mbështetja kryesore e Partisë sonë gjatë Luftës nacional-çlirimtare dhe sot ajo është aleatja e klasës punëtore, e lidhur si mishi me thoin me Partinë dhe me pushtetin popullor. S'ka dyshim se ajo do të mobilizohet me të gjitha forcat e veta për të realizuar detyrat madhështore të Kongresit III të Partisë, për nxjerrjen e bujqësisë nga prapambetja që në pesëvjeçarin e dytë, për prodhimin e drithërave të nevojshme për të siguruar bukën e popullit në vend.

për të shtuar prodhimin e bimëve industriale për sigurimin e industrisë me lëndë të para, për të shtuar dhe përmirësuar furnizimin e popullit me produkte bujqësore. Fshatarësia duhet të mobilizohet për mbledhjen dhe grumbullimin e pambukut dhe të bimëve të tjera të vona, për të shpejtuar mbjelljet e vjeshtës të këtij viti që janë prapa. Kjo është detyrë urgjente e këtij viti.

Në pesëvjeçarin e dytë investimet do të rriten 27 për qind dhe ndërtimet do të rriten 16 për qind. Rritja e investimeve dhe e ndërtimeve në këtë shkallë siguron zhvillimin e industrisë, të bujqësisë, të kulturës dhe të gjithë sektorëve të tjerë në masën e përcaktuar nga plani i dytë pesëvjeçar. Me qindra janë ndërmarrjet dhe objektet e ndërtuara në pesëvjeçarin e parë. Për realizimin me sukses të detyrave të pesëvjeçarit të dytë në sektorin e ndërtimeve kërkohet që të përmirësohet rrënjësisht cilësia në ndërtim dhe të ulet në mënyrë të ndijshme kostoja. S'ka dyshim se punonjësit e ndërtimit do t'i realizojnë me sukses detyrat që u ka caktuar Partia.

Krahas me zhvillimin e sektorëve të tjerë të ekonomisë popullore, është zhvilluar edhe transporti. Në vitin 1955 janë transportuar mbi 13 herë më tepër mallra me automjete se në vitin 1938 dhe afro 33 herë më tepër pasagjerë. Pesëvjeçari i dytë shtron si detyrë zhvillimin e mëtejshëm të transportit me anën e shtimit të mjeteve të transportit dhe të shfrytëzimit të tyre racional. Punonjësit e transportit kanë detyra të vështira dhe të ndërlikuara përpara. Ata duhet të mobilizohen me të gjitha forcat e tyre për realizimin e këtyre detyrave.

Realizimi i detyrave të mëdha të pesëvjeçarit të

dytë kërkon nga e gjithë Partia, nga pushteti dhe nga populli mobilizim të përgjithshëm dhe punë të palodhshme. Përsa i përket ndihmës së jashtme plani i dytë pesëvjeçar mund të thuhet se, në përgjithësi, është siguruar. Por ne duhet të mobilizohemi akoma më tepër për të zhdukur të metat tona të shumta në drejtimin e ekonomisë, për të zhdukur burokratizmin në punën tonë të përditshme, për të forcuar ndjenjën e përgjegjësisë personale në njerëzit, për të forcuar disiplinën shtetërore dhe të Partisë në punë. Lufta për përgatitjen dhe kualifikimin e kuadrove, për zbulimin dhe përdorimin e mundësive tona të brendshme, për rritjen e rendimentit dhe uljen e kostos janë drejtimet kryesore ku duhet të përqëndrohet vëmendja jonë në pesëvjeçarin e dytë.

Pushteti popullor krijoi marrëdhënie të reja në prodhim. Klasa punëtore dhe fshatarësia punonjëse sot punojnë për veten e tyre dhe jo për klasat shfrytëzuese. Gjendja e përgjithshme ekonomike sot, në krahasim me të kaluarën, është përmirësuar në mënyrë të dukshme.

Sukseset e mëdha në rimëkëmbjen e ekonomisë popullore dhe në ndërtimin socialist janë arritur me punën e palodhur dhe vetëmohuese të klasës punëtore, fshatarësisë punonjëse dhe inteligjencies popullore. Popullit tonë iu desh të kapërcente vështirësi të mëdha ekonomike për të arritur të gjitha këto suksese madhështore. Por ai ka qenë i ndërgjegjshëm për nevojën e kapërcimit të këtyre vështirësive, i ka kapërcyer ato me punë, me djersë e mundim dhe sot e prek me dorë rezultatin e punës së vet. Populli e sheh se ç'pasuri të çmueshme krijoi ai me duart e tija të arta: qindra



fabrika dhe ndërmarrje industriale, qytete të tëra të reja, kënetat e thara, rrugë të reja automobilistike dhe hekurudha, shkolla e spitale, dhjetëra mijëra ndërtesa banimi, fusha të sistemuara e pjellore, çdo gjë ai e ka ndërtuar me duart e veta.

Si rezultat i rritjes së prodhimit industrial e bujqësor, të ardhurat nacionale në pesëvjeçarin e parë janë rritur 70 për qind, paga reale e punonjësve është rritur 20 për qind, kurse të ardhurat e fshatarësisë janë rritur, sikurse u tha më lart, 35 për qind. Në vitin 1955, vëllimi i përgjithshëm i qarkullimit të mallrave të tregëtisë ka qenë rreth 358 për qind në krahasim me vitin 1938 dhe 191 për qind në krahasim me vitin 1950. Mbi 82 për qind e vëllimit të përgjithshëm të qarkullimit të mallrave të tregëtisë bëhet nga tregëtia socialiste, 10,3 për qind nga tregu fshatar dhe vetëm 7,6 për qind nga tregu privat.

Në vitin 1955 popullsia ka marrë nëpërmjet rrjetit të tregëtisë socialiste, në krahasim me vitin 1950, mallra të tregëtisë në këtë sasi: bukë 125 për qind, sheqer 182 për qind, yndyrna 215 për qind, makarona 147 për qind, fasule e oriz 173 për qind, mish 142 për qind, sapun 185 për qind, kripë 111 për qind, tekstile të pambukta 195 për qind, tekstile të leshta 227 për qind, këpucë 263 për qind etj.

Në vitin 1954 u ulën çmimet e mallrave të konsumit, nga e cila popullsia përfiton 300 milion lekë çdo vit dhe në prill të vitit 1956 u bë një ulje tjetër e çmimeve nga e cila popullsia përfitoi 1,5 miliard lekë.

Por, me gjithë përmirësimin e vazhdueshëm dhe të dukshëm të gjendjes materiale të masave punonjëse.

në krahasim me të kaluarën, niveli i përgjithshëm ekonomik i vendit tonë është akoma prapa. Realizimi me sukses i detyrave të planit të dytë pesëvjeçar do të bëjë që gjendja jonë ekonomike të përmirësohet akoma më tepër. Kongresi III i Partisë vendosi që çdo vit në pesëvjeçarin e dytë të bëhen ulje çmimesh. Dhe kjo do të bëhet patjetër. Komiteti Qendror i Partisë dhe qeveria kanë vendosur që më 1 janar të vitit 1957 të ngrihen rrogat e punonjësve që kanë paga të ulëta. Gjithashtu të ngrihen edhe pensionet e ulëta. Njëkohësisht qeveria po studjon mundësitë për një ulje të ndijshme të çmimeve të mallrave të konsumit për t'u bërë para afatit të caktuar nga Kongresi III i Partisë, në mënyrë që nga kjo ulje e çmimeve, nga ngritja e pagave dhe e pensioneve popullsia të përfitojë jo më pak se 1 miliard e 100 milion lekë në vit. Veç kësaj, këto ditë u hoq taksa mbi fshatarësinë për prerjen e druve për nevoja vetjake dhe për shitje si dhe për gjethet për bagëtinë dhe do të hiqet fare edhe pagesa në spitalet për punonjësit që janë në marrëdhënie pune me shtetin dhe të atyre të organizatave shoqërore. Ulja e çmimeve kërkon mobilizim të përgjithshëm të të gjithë punonjësve të prodhimit për uljen e kostos, shtimin e prodhimit dhe përmirësimin e cilësisë. Ulja e kostos së prodhimit është burimi kryesor për uljen e çmimeve. Plani i dytë pesëvjeçar parashikon që të ardhurat nacionale në këtë pesëvjeçar të rriten 53 për qind, paga reale e punonjësve të rritet 25 për qind dhe të ardhurat e fshatarësisë të rriten rreth 38 për qind. Këto janë detyra shumë të mëdha që mund të realizohen vetëm me punë të palodhur. Partia jonë është e bindur dhe ka besim të plotë

se klasa punëtore, fshatarësia punonjëse dhe inteligjencia popullore do të vënë të gjitha forcat e tyre për të realizuar planin e dytë pesëvjeçar, për të bërë të mundshëm përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes materiale të vendit.

Përmirësimi i vazhdueshëm i gjendjes materiale dhe ngritja e nivelit kultural të masave punonjëse ka qenë kurdoherë qëllimi kryesor i të gjithë punës së Partisë dhe të shtetit.

Gjatë ekzistencës së pushtetit popullor suksese shumë të mëdha janë arritur në zhvillimin kultural të popullit, revolucioni kultural në vendin tonë po triumfon. Në vitin 1955, në krahasim me vitin 1938, numri i shkollave fillore ka qenë mbi 338 për qind, numri i shkollave 7-vjeçare - 31 herë, numri i shkollave të mesme rreth 273 për qind, përveç 6 instituteve të larta të krijuara për herë të parë në vendin tonë nga pushteti popullor. Sot analfabetizmi është zhdukur për moshat deri në 40 vjeç dhe mbi 15 për qind e popullsisë mësojnë në shkollat fillore, shtatëvjeçare, të mesme, në institute të larta dhe në shkollat e natës. Në qoftë se në vitin 1938 në vendin tonë kishte vetëm 17 kinema me 4 800 vende, sot ka rreth 70 kinema me gati 21 500 vende. Ne kemi sot 9 institucione artistike si teatri, filarmonia etj. që më parë nuk ekzistonin fare. Arti, kultura, sporti lulëzojnë me hov të madh në vendin tonë.

Si rezultat i masave të rëndësishme që ka marrë pushteti popullor për përmirësimin e shëndetit të popullit, gjendja shëndetësore e popullit është në përgjithësi e kënaqshme. Kjo duket nga shifrat që tregojnë

rritjen natyrale të përvjetshme të popullsisë. Kështu në qoftë se në vitin 1938 rritja natyrale e popullsisë ka qenë 16,9 për çdo 1 000 banorë, në vitin 1955 ajo ka arritur në 29 për çdo 1 000 banorë, kurse në vitin 1953, sipas të dhënave zyrtare, rritja natyrale e popullsisë për çdo 1 000 banorë ka qenë 11,2 në Greqi, 7,4 në Itali etj.

Vëllimi i përgjithshëm i investimeve në sektorët social-kulturalë në pesëvjeçarin e dytë do të jetë 15,3 për qind mbi të gjitha investimet e shtetit, ose 54,7 për qind më tepër se në pesëvjeçarin e parë. Në pesëvjeçarin e dytë do të ndërtohen mbi 25 për qind më tepër sipërfaqe e banueshme se në pesëvjeçarin e parë për punonjësit e qyteteve dhe të qendrave të punës.

S'ka asnjë dyshim se realizimi me sukses i detyrave të pesëvjeçarit të dytë do të bëjë që atdheu ynë të lulëzojë më tepër, që vendi ynë të hedhë një hap tjetër të madh përpara në ndërtimin e socializmit. Suksesi për realizimin e planit të dytë pesëvjeçar mund të arrihet me një mobilizim të përgjithshëm të të gjithë Partisë dhe popullit. Komunistët duhet të jenë kurdoherë në ballë të luftës për realizimin e planit të shtetit, për realizimin e detyrave të mëdha të pesëvjeçarit të dytë, të ecin kurdoherë në gjurmët e traditave të lavdishme të Luftës nacional-çlirimtare ku ata ishin të parët, sepse lufta për ndërtimin e socialimit nuk është më pak e rëndësishme se Lufta nacional-çlirimtare që ne bëmë. Klasa punëtore, rinia jonë heroike, fshatarësia punonjëse, inteligjencia popullore, të gjithë si një trup i vetëm, rreth Partisë së tyre besnike, duhet të vazhdojnë akoma më me hov marshimin e tyre triumfues përpara dhe vetëm përpara për ndërtimin e socializmit

në rrugën tonë të ndriçuar nga eksperiencia e Bashkimit Sovjetik.

Shokë dhe shoqe,

Partia e Punës me vijën e saj të drejtë, me vendimet e saj të urta dhe të vendosura bëri që Shqipëria e re të dalë në arenën ndërkombëtare si një shtet i lirë, i pavarur dhe sovran. Dikur, në regjimet antipopullore, Shqipëria jo vetëm që nuk përfillej fare, por ajo merrej nëpër këmbë dhe ishte bërë plaçkë tregu nga imperialistët, nga fashistët, nga feudoborgjezia tradhëtare, të cilët, të gjithë sot, mjaulljnë dhe derdhin lot krokodili se gjoja Shqipëria ka humbur lirinë dhe sovranitetin. Sigurisht që të mposhteshin këta armiq të egër të vendit tonë u desh Lufta heroike nacional-çlirimtare e popullit shqiptar, u deshën përpjekjet, sakrificat e panumërta dhe vigjilenca e madhe e popullit, e Partisë së Punës dhe e qeverisë gjatë gjithë periudhës pas çlirimit.

Është fakt se populli shqiptar i kapërceu të gjitha këto vështirësi dhe sot ai ka pozita ndërkombëtare të forta e të paprekshme. Ai sot nuk mund të injorohet nga kurrkush, ai merr pjesë aktive në zhvillimin e ngjarjeve ndërkombëtare, bën pjesë në kampin e fuqishëm të socializmit që udhëhiqet nga Bashkimi Sovjetik dhe është anëtar i Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Qarqet e ndryshme imperialiste dhe armiqtë e popullit kanë përdorur dhe përdorin çdo mjet për të kthyer përsëri gjendjen e vjetër të shtypjes së egër feudalo-borgjeze dhe të sundimit të huaj, të copëtojnë

atdheun dhe të asgjësojnë fitoret historike të popullit shqiptar. Por të gjitha këto plane armiqësore të imperialistëve janë shpartalluar nga populli ynë heroik dhe do të mposhten përsëri në të ardhshmen, sepse Partia jonë e ka edukuar popullin të mbrojë me vigjilencë fitoret dhe të godasë pa mëshirë armiqtë e tij. Politika e vjetër e imperialistëve dhe e kolonialistëve «përça dhe sundo» vazhdon të jetë kurdoherë baza e politikës së kolonizatorëve të rinj.

Partia e Punës e Shqipërisë e edukon popullin e vet të vërë të gjitha forcat dhe të luftojë për forcimin e unitetit të kampit tonë, sepse armiqtë e socializmit, qofshin këta të hapët ose të maskuar, goditjet e tyre i drejtojnë kundër Bashkimit Sovjetik dhe kampit të socializmit.

Imperialistët amerikanë, dhe reaksioni ndërkombëtar që organizoi kundërrevolucionin në Hungari, kishin për qëllim nxjerrjen e Republikës Popullore të Hungarisë nga rruga e socializmit dhe futjen e këtij vendi nën diktaturën fashiste të hortistëve.

Populli shqiptar i ndoqi me dhimbje ngjarjet e hidhura që u zhvilluan në këtë vend mik. I gjithë populli shqiptar i urren armiqtë e jashtëm imperialistë, të cilët me banditin Imre Nagi në krye, kurdisën këtë komplot të brendshëm kundër popullit mik hungarez, gënjyen një pjesë të punonjësve hungarezë dhe organizuan kundërrevolucionin në Hungari me qëllim që të vendosej regjimi i urryer i princërve, kontëve, Vatikanit, kapitalistëve, imperialistëve, pseudodemokratëve. Të gjitha këto banda të organizuara nga imperialistët amerikanë me dollarët e tyre kanë pasur për qëllim të

shkatërronin regjimin e demokracisë popullore, t'u rrëmbenin punëtorëve fabrikat, t'u rrëmbenin tokat fshatarëve dhe t'i hiqnin popullit pushtetin nga duart dhe ta lidhnin Hungarinë pas qerres së imperialistëve.

Populli vëlla hungarez e shtypi kundërrevolucionin me luftën e tij dhe sigurisht ai do të zbulojë e do të demaskojë të gjitha fijet e këtij rrjeti konspiratorësh që, duke u maskuar nën parullën e një «demokratizimi të mëtejshëm të vendit dhe të Partisë», kanë dashur të shkallmonin demokracinë popullore dhe të likuidonin Partinë e Punonjësve Hungarezë. Populli vëlla hungarez, klasa punëtoresh hungareze, komunistët internacionalistë hungarezë do të dinë sigurisht të nxjerrin mësim nga kjo tragjedi e madhe që ngjau në atdheun e tyre.

Në Hungari u duk qartë se kush fshihej nën format shurdhuese organizative me tituj ultrarevolucionarë. Në këto forma të reja organizimi e komitete gjoja revolucionare, fshihej kapitalisti i djeshëm, i egër si më parë, fshihej fashisti, hortisti, fshihej imperializmi gjakatar, në fshat fshihej kulaku, beu dhe agai hungarez, të etshëm për gjakun e fshatarëve punonjës që kishin ndërtuar me djersë dhe me gjak jetën e re socialiste në kooperativat bujqësore dhe që bandat e kundërrevolucionit me Imre Nagin e shokët e tij në krye u përpoqën me terror t'ia shkatërronin.

Tragjedia e popullit hungarez do të jetë sigurisht një mësim i madh për të gjithë njerëzit e ndershëm në botë, do të jetë një mësim për të gjithë ata që i zë gjumi mbi dafina dhe që përpara fjalëve të bukura të imperialistëve dhe të reaksionit, përpara parullave demagogjike, humbasin vigjilencën dhe e zëvendësojnë

këtë me oportunizëm dhe me butësi të rrezikshme.

Populli shqiptar është me popullin vëlla hungarez dhe do ta ndihmojë atë me të gjitha çka mundet për të shëruar plagët që i shkaktuan fashistët. Ai i uron popullit hungarez fitore të plotë dhe shpartallimin e rrufeshëm e të pamëshirshëm të komplotistëve fashistë nën çdo maskë që ata janë fshehur dhe që do të përpiqen të fshihen tani që e humbën davanë.

Uniteti i klasës punëtore është një kusht i domosdoshëm për fitoren e socializmit. Qysh në dokumentin e parë programatik të marksizmit, në Manifestin e Partisë Komuniste, që shpallur kushtrimi i zjarhtë «Proletarë të të gjitha vendeve, bashkohuni!». Ky solidaritet i punëtorëve të të gjitha vendeve është kyçi i fitoreve të popujve dhe i ndërtimit të socializmit. Ky bashkim u bën ballë sulmeve të imperializmit dhe nuk është aspak kundër interesave kombëtare siç bërtasin kasnecët e borgjezisë.

Kombinimi i detyrave internacionale me detyrat nacionale është baza e lëvizjes punëtore të çdo vendi. Të harrosh të parën dhe të punosh që ta shkëputësh klasën punëtore dhe popullin nga ky parim i madh marksist-leninist duke i predikuar «komunizmin nacional», «socializmin specifik» e shumë parulla të tjera bombastike do të thotë të largohesh nga marksizëm-leninizmi dhe ta shmangësh popullin nga rruga e ndërtimit të socializmit. Imperialistët dhe veglat e tyre bëjnë çmos për të larguar vëmendjen e punonjësve nga çështjet e mëdha parimore. Ata flasin mbi çështjen e bashkekzistencës paqësore, por në mënyrën e tyre dhe me qëllim që të shuhet vigjilenca e punonjësve kundër



rrezikut të imperialistëve, kundër përgatitjeve të tyre për luftë, kundër luftës së klasës, kundër reaksionit të jashtëm dhe të brendshëm që s'i hedh kollaj armët në goftë se s'ia këput pa mëshirë duart.

Ata që sot çirren për «demokracinë», për «sovrانيتetin» kanë vepruar vazhdimisht si shovinistë kundër vendit tonë, janë përpjekur t'i imponojnë popullit tonë vullnetin dhe politikën e tyre. Por populli shqiptar i ka mposhtur këta dhe kurrë vendi ynë nuk e ka ndjerë veten e tij kaq të lirë, të pavarur dhe sovran sa sot, kurrë nuk ka qenë më i sigurtë se sot, kurrë populli ynë nuk ka jetuar më mirë se sot që ka marrë pushtetin në duart e tija.

Popujt e dinë mirë se ç'fshihet prapa të ashtuquajturës ndihmë amerikane. Mund të çirren radiot e Amerikës pse populli shqiptar e refuzoi ndihmën amerikane, por populli ynë mendon se kjo ndihmë rrezikon jetën dhe lirinë e tij. Ata le ta dinë se populli shqiptar nuk ka nevojë për këtë ndihmë.

Partia jonë dhe populli shqiptar nuk kanë shkelur dhe nuk do të shkelin kurrë në dërrasë të kalbur dhe nuk do të gënjehen nga parullat e «socializmit popullor», «socializmit revolucionar», ose nga parullat e një farë «demokracie» që bie erë çdo gjë, por jo proletare.

Lufta e partive tona komuniste dhe punëtore për ngritjen e rolit të masave, për aktivizimin sa më të gjerë të tyre është e drejtë dhe e shëndetshme. Nën maskën e luftës kundër kultit të individit, imperialistët dhe borgjezia veprojnë në mënyrë intensive dhe dinake me qëllim që të godasin çështjen e socializmit dhe lëvizjen punëtore ndërkombëtare. Partia jonë do të

jetë kurdoherë vigjilente dhe do të luftojë të gjithë ata që kërkojnë të ngrenë kulte të reja, duke goditur Partinë tonë, partitë motra komuniste e punëtore dhe Partinë e lavdishme të Leninit. Këta njerëz të sëmurë përpiqen të shohin qimen në syrin e tjetrit, po ata nuk shohin traun në syrin e tyre, dhe zhvillojnë një luftë të paprincipitë për të sabotuar punën krijuese të masave dhe të partive komuniste e punëtore. Veçse leninistët nuk janë qorra dhe dinë të dallojnë qimen në syrin e tyre, ta pastrojnë syrin, por njëkohësisht ata dinë të dallojnë jo vetëm traun në syrin e tjetrit por edhe qimen. Njerëzit, thotë populli ynë, nuk hanë bar dhe ca më pak marksistët. Komunistët shqiptarë do t'i luftojnë pa mëshirë të gjithë këta elementë denigrues dhe falsë. Prandaj sot më shumë se kurrë Partisë sonë i shtrohet detyra të forcojë luftën e saj parimore dhe të vendosur për ta mbajtur pastër teorinë marksiste-leniniste, për të forcuar ideologjikisht dhe organizativisht radhët e saja, për të forcuar solidaritetin ndërkombëtar të punonjësve dhe ajo konsideron se lufta për mbrojtjen e parimeve marksiste-leniniste, lufta e mbështetur mbi këto parime është e vetmja luftë e drejtë.

Në marrëdhëniet ndërkombëtare Partia dhe qeveria jonë kanë ndjekur dhe do të ndjekin me këmbëngulje dhe në mënyrë konsekuente politikën leniniste të paqes dhe të miqësisë midis popujve në bazë të barazisë, respektit reciprok, pavarësisë, integritetit dhe të sovranitetit, të mosndërhyrjes në punët e brendshme dhe të përfitimit reciprok.

Forcimi i miqësisë së sinqertë që lidh vendin tonë dhe popullin shqiptar me popujt vëllezër të Bashkimit

Sovjetik, të Kinës së madhe Popullore, të Polonisë, Çekoslovakisë, Hungarisë, Rumanisë, Bullgarisë, Republikës Demokratike Gjermane, Koresë, Mongolisë, Vietnamit, është një nga detyrat kryesore për popullin, Partinë dhe qeverinë tonë. Prandaj këtë miqësi do ta ruajmë dhe do ta forcojmë çdo ditë e më shumë. Ne do ta ruajmë dhe do ta forcojmë çdo ditë e më shumë miqësinë e popullit tonë me popullin vëlla jugosllav në rrugën e drejtë marksiste-leniniste që përcaktoi Kongresi III i Partisë.

Një manifestim i shkëlqyer i miqësisë së madhe që lidh popullin tonë me popullin kinez, ishte pritja që iu bë delegacionit tonë qeveritar dhe të Partisë në RP të Kinës. Populli shqiptar ka te populli heroik dhe i lavdishëm i Kinës një mik dhe vëlla të shtrenjtë besnik, që e do dhe e ndihmon me gjithë zemër popullin tonë. Një pritje gjithashtu miqësore iu bë delegacionit tonë të Partisë dhe qeverisë nga populli i RDP të Koresë dhe ai i RP të Mongolisë.

Qeveria jonë që ndjek një politikë paqeje kërkon të rrojë në marrëdhënie të mira me të gjitha shtetet që respektojnë të drejtat e popullit tonë sovran. Vendi ynë sot është anëtar i Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe ka marrëdhënie diplomatike me njëzet shtete të Evropës, të Azisë dhe të Afrikës dhe këto marrëdhënie po i zgjeron edhe me shtetet e tjera në bazë të parimeve të bashkekzistencës paqësore. Qeveria jonë ka shpallur vazhdimisht se dëshiron që vendi ynë të rrojë në miqësi dhe në fqinjësi të mirë dhe të zhvillojë marrëdhëniet miqësore, ekonomike e kulturele në bazë të respektimit të pavarësisë, të sovranitetit, të barazisë, të mosdër-

hyrjes në punët e brendshme të njëri-tjetrit dhe të përfitimit reciprok me të gjithë fqinjët e vendit tonë dhe me të gjitha ato shtete që e dëshirojnë një gjë të tillë. Qeveria shqiptare do të bëjë të gjitha përpjekjet e mundshme, si kurdoherë, në këtë drejtim.

Populli ynë dhe qeveria shqiptare çmojnë se vendosja e marrëdhënieve diplomatike me Republikën e Indisë, me Egjiptin, Sudanin, Sirinë dhe vendet e tjera arabe kanë krijuar mundësi të reja për zgjerimin e marrëdhënieve ndërkombëtare të Republikës Popullore të Shqipërisë dhe për forcimin e paqes. Pjesëmarrja e vendit tonë për herë të parë në panairin e Damaskut, mikpritja e madhe dhe e përzemërt e popullit sirian treguan mundësitë e reja të zhvillimit të miqësisë në mes vendeve tona dhe për shkëmbime ekonomike e kulturele shumë të dobishme. Ne, si popull që ka bërë të njëjtën luftë për liri e që ka lidhje të vjetra dhe miqësore me popujt arabë, kemi përshëndetur me gëzim të madh çlirimin nga zgjedha koloniale e një sërë popujsh të Azisë dhe të Afrikës.

Populli shqiptar është i indinjuar dhe i revoltuar nga sulmi barbar i imperialistëve anglo-franko-izraelitë kundër popullit vëlla heroik egjiptian, i cili mbron me vetëmohim, lirinë, pavarësinë dhe sovranitetin e tij. Imperialistët anglo-francezë, duke shkelur çdo ligj ndërkombëtar dhe çdo ndjenjë njerëzore, po shkatërrojnë me zjarr e me hekur qytetet dhe kulturën egjiptiare, po vrasin barbarisht popullin, po djegin fshatra dhe qytete të një vendi paqësor, i cili ka qenë dhe është në të drejtën e tij. U duk edhe një herë qartë e lakuriq fytyra e egër e imperialistëve dhe e kolonizatorëve, që

për të mbajtur popujt e botës nën zgjedhë dhe për t'u thithur gjakun, nuk ndalen të shpallin luftë dhe të hedhin botën në zjarrin e një kasaphane tjetër të tmerrshme. Agresorëve duhet t'u ndalet dora. Me të drejtë i gjithë populli shqiptar aprovoi të drejtën legjitime të Egjiptit në shtetëzimin e shoqërisë së kanalit të Suezit, kalimi lirisht i të cilit nga të gjitha anijet e shteteve të ndryshme, u sigurua plotësisht nga qeveria egjiptiane. Sulmi barbar i imperialistëve anglo-franko-izraelitë kundër Egjiptit dënohet nga i gjithë populli ynë, i cili, në fabrika, në ara, në shkolla, shpreh solidaritetin e tij të plotë me kauzën e drejtë të popullit egjiptian dhe të të gjithë popujve arabë. Populli shqiptar ngre zërin e tij dhe kërkon ndalimin e menjëhershëm të luftës dhe tërheqjen e agresorëve nga toka egjiptiane. Populli shqiptar uron dhe është i bindur se kauza e drejtë e popullit egjiptian dhe e të gjithë popujve arabë do të triumfojë. Populli shqiptar ka qenë kurdoherë për kauzën e tyre të shenjtë të lirisë, dhe sot është akoma më afër tyre në këto momente të rënda por të lavdishme për ta.

Shokë dhe shoqe,

Politika e Partisë dhe e qeverisë sonë ka qenë dhe do të mbetet një politikë e drejtë marksiste-leniniste për çelnikosjen e bashkimit të shëndoshë dhe vëllazëror të popullit shqiptar, për mbrojtjen deri në fund të integritetit tokësor të atdheut, të sovranitetit dhe të pavarësisë për ndërtimin e socializmit, jetës së lumtur

dhe të begatshme të popullit tonë. Manifestimet e fuqishme të masave të gjera të popullit, me rastin e 15-vjetorit të themelimit të Partisë sonë heroike, treguan edhe një herë sa ngushtë është lidhur Partia me popullin, sa i qëndron ajo besnike çështjes së popullit. Në fabrika, në ara, në shkolla, kudo ku punohet, ku mësohet, ku krijohet, i madh e i vogël, që nga patrioti plak i kohëve të Rilindjes dhe deri te pionieri i vogël, me zjarr dhe me entuziazëm të papërshkruar shprehin gëzimin e tyre për atdheun që lulëzon dhe për farkëtarin e kësaj jete të lumtur e të gëzuar të popullit, Partinë e lavdishme të Punës të Shqipërisë. Republika Popullore e Shqipërisë, nën udhëheqjen e Partisë së saj të Punës, sot po lulëzon, po përparon. Uniteti i popullit dhe i Partisë është faktori i këtyre sukseseve. Marksizëm-leninizmi që ndjek Partia jonë e Punës me besnikërinë më të madhe bën që kauza e socializmit të triumfojë. Prandaj ta ruajmë dhe ta çelnikosim çdo ditë e më shumë unitetin e Partisë me popullin, të ruajmë unitetin e Partisë sonë marksiste-leniniste si sytë e ballit.

Lavdi popullit heroik shqiptar!

Lavdi Partisë heroike të Punës të Shqipërisë, farkëtueses të të gjitha fitoreve të popullit tonë!

Lavdi marksizëm-leninizmit!

Me flamurin e lavdishëm të Partisë, përpara për të korrur fitore të reja për popullin!

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 273 (2542), 9 nëntor 1956*

*Botohet me disa shkurtime sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## NË ASNJË MËNYRË NE NUK DO TË LËSHOJMË NË PARIMET

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH*

**13 nëntor 1956**

Sot na kanë ardhur edhe dy letra të tjera që janë këmbyer midis Titos dhe shokut Hrushov<sup>1</sup>. Në këtë mbledhje të Byrosë Politike, unë mendoj që këto letra t'i lexojmë dhe, njëkohësisht, t'ju raportoj edhe mbi bisedimin që kam pasur sot me ambasadorin sovjetik, Krillov. Pastaj të diskutojmë të gjithë dhe, në përfundim, të shohim cili është mendimi ynë i përbashkët, ç'propozime ka nga ana jonë, ç'qëndrim do të mbajmë ne në momentin aktual dhe në të ardhshmen lidhur me këto çështje të rëndësishme.

E them qysh në fillim se momentet që kalojmë ja-

---

<sup>1</sup> Është fjala për letrën që Tito i drejtoi Hrushovit më 8 nëntor 1956 si dhe përgjegjen e Hrushovit dërguar Titos më 9 nëntor 1956 në vazhdim të letrave të tyre të mëparshme, duke filluar nga data 4 nëntor, që bëjnë fjalë për çështjen hungareze, mbrojtjen e tradhëtarit Imre Nagi me shokë etj.

dhe të begatshme të popullit tonë. Manifestimet e fuqishme të masave të gjera të popullit, me rastin e 15-vjetorit të themelimit të Partisë sonë heroike, treguan edhe një herë sa ngushtë është lidhur Partia me popullin, sa i qëndron ajo besnike çështjes së popullit. Në fabrika, në ara, në shkolla, kudo ku punohet, ku mësohet, ku krijohet, i madh e i vogël, që nga patrioti plak i kohëve të Rilindjes dhe deri te pionieri i vogël, me zjarr dhe me entuziazëm të papërshkruar shprehin gëzimin e tyre për atdheun që lulëzon dhe për farkëtarin e kësaj jete të lumtur e të gëzuar të popullit, Partinë e lavdishme të Punës të Shqipërisë. Republika Popullore e Shqipërisë, nën udhëheqjen e Partisë së saj të Punës, sot po lulëzon, po përparon. Uniteti i popullit dhe i Partisë është faktori i këtyre sukseseve. Marksizëm-leninizmi që ndjek Partia jonë e Punës me besnikërinë më të madhe bën që kauza e socializmit të triumfojë. Prandaj ta ruajmë dhe ta çelnikosim çdo ditë e më shumë unitetin e Partisë me popullin, të ruajmë unitetin e Partisë sonë marksiste-leniniste si sytë e ballit.

Lavdi popullit heroik shqiptar!

Lavdi Partisë heroike të Punës të Shqipërisë, farkëtueses të të gjitha fitoreve të popullit tonë!

Lavdi marksizëm-leninizmit!

Me flamurin e lavdishëm të Partisë, përpara për të korrur fitore të reja për popullin!

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 273 (2542), 9 nëntor 1956*

*Botohet me disa shkurtime sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*



## NË ASNJE MËNYRË NE NUK DO TË LËSHOJMË NË PARIMET

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH*

13 nëntor 1956

Sot na kanë ardhur edhe dy letra të tjera që janë këmbyer midis Titos dhe shokut Hrushov<sup>1</sup>. Në këtë mbledhje të Byrosë Politike, unë mendoj që këto letra t'i lexojmë dhe, njëkohësisht, t'ju raportoj edhe mbi bisedimin që kam pasur sot me ambasadorin sovjetik, Krillov. Pastaj të diskutojmë të gjithë dhe, në përfundim, të shohim cili është mendimi ynë i përbashkët, ç'propozime ka nga ana jonë, ç'qëndrim do të mbajmë ne në momentin aktual dhe në të ardhshmen lidhur me këto çështje të rëndësishme.

E them qysh në fillim se momentet që kalojmë ja-

---

<sup>1</sup> Është fjala për letrën që Tito i drejtoi Hrushovit më 8 nëntor 1956 si dhe përgjegjen e Hrushovit dërguar Titos më 9 nëntor 1956 në vazhdim të letrave të tyre të mëparshme, duke filluar nga data 4 nëntor, që bëjnë fjalë për çështjen hungareze, mbrojtjen e tradhëtarit Imre Nagi me shokë etj.

në shumë serioze dhe kritike, prandaj shokët duhet të mendohen thellë dhe të diskutojnë, duke peshuar mirë fjalët që do të thonë, me qëllim që të gjejnë një zgjidhje të drejtë marksiste-leniniste të çështjeve, kurdoherë në interes të Partisë sonë, të popullit tonë, të revolucionit e të socializmit. Natyrisht, këto probleme mendoj se duhet të qëndrojnë brenda për brenda nesh, sepse është çështja të mbrojmë Bashkimin Sovjetik.

*Pasi lexohen letrat e këmbÿera midis Presidiumit të KQ të PK të BS dhe të KQ të LKJ, shoku Enver vazhdon:*

Unë sot bisedova me shokun Krillov. Për disa çështje të letrave të fundit që nuk janë të qarta, i bëra disa pyetje Krillovit. Një nga këto pyetje që i drejtova atij është kjo: Në letra nuk shihet një qëndrim i prerë nga ana e KQ të PK të BS dhe as që bëhet ndonjë aluzion në lidhje me fjalët që thotë Titua mbi «disa njerëz të ligj», a mund të na thoni gjë mbi këtë çështje? Krillovi u përgjeggj: «Jo, nuk kam ç'të them» dhe asgjë më shumë nuk foli.

Çështja e dytë për të cilën pyeta Krillovin ishte kjo: Në letër thuhet se KQ i PK të BS është përpjekur që Janosh Kadari të jetë sekretar i parë i Partisë së Punonjësve Hungarezë, mirëpo ne nuk jemi të qartë se ku është formuar KQ i Partisë së Punonjësve Hungarezë, në Krime? Si u përgjeggj Krillovi? Ai u përgjeggj duke thënë: «Jo, por çështja do të jetë kështu që shokët hungarezë kanë shkuar në Krime dhe kanë biseduar se kush duhet të jetë në udhëheqjen e tyre, ndërsa KQ i PK të BS ka thënë se do të ish më mirë të ishte Kadari».

Atëherë unë i thashë Krillovit se kjo do të thotë që KQ i PK të BS nuk është për Geron, por për Kadarin. Dhe ai u përgjegj: «Po, kështu del nga letra». Në këtë rast i drejtova pyetjen tjetër: Po si shpjegohet që sekretar i parë doli Gerua? Përgjegjia e Krillovit ishte: «E zgjodhi Plenumi i Partisë së Punonjësve Hungarezë». Për ta mbyllur këtë çështje unë i thashë ambasadorit sovjetik se qeveria e Janosh Kadarit është formuar në bashkëpunim të ngushtë midis KQ të PK të BS dhe Titos dhe ai e pranoi këtë duke thënë: «Po, kështu rezulton».

Ndërkaq e njoha me shqetësimin tonë duke i thënë se Byroja Politike e KQ të Partisë së Punës të Shqipërisë e ka konsideruar këtë çështje shumë të rëndësishme dhe prandaj po diskuton gati çdo natë. Mendimi im personal, që është edhe mendimi unanimitet i Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë sonë, bie në kundërshtim me veprimet e udhëheqjes së PK të BS dhe të Titos, që, midis të tjerash, bisedojnë edhe se nga kush duhet të përbëhet qeveria hungareze. Pastaj Krillovi më pyeti se ç'mendim kemi ne për vajtjen e Imre Nagit në Rumani<sup>1</sup>, a jemi dakord?

Kësaj pyetjeje unë iu përgjegjja kështu: Ne kemi deklaruar dhe deklarojmë se Imre Nagi është një tradhëtar, që i ka hapur dyert fashizmit. Titua ka deklaruar

---

<sup>1</sup> Pas dështimit të kundërrevolucionit në Hungari tradhëtar i Imre Nagi u muar në mbrojtje nga revizionistët jugosllavë. Për këtë qëllim ai u strehua në ambasadën jugosllave në Budapest. Më vonë, me ndërhyrjen e udhëheqjes hrushoviane sovjetike u dërgua në Rumani.

se «Imre Nagi është me ne», kurse ne shqiptarët themi se Imre Nagi me shokë janë antisovjetikë. Si është e mundur që një tradhëtar, i cili ka vrarë ushtarë sovjetikë, u ka bërë thirrje imperialistëve për ta ndihmuar në kundërrevolucion, të vejë sot në Rumani, në një vend mik? Shokët sovjetikë në këtë çështje bëjnë një lëshim të madh. Më përpara ata i thanë Titos që «Nagi është më mirë të kishte shkuar në ambasadën amerikane», kurse tani i thonë «na e jep neve për ta dërguar në Rumani»! Kjo s'na duket aspak e drejtë. Ne themi se po shkoi Nagi në Rumani është njësoj sikur shkoi në Bashkimin Sovjetik. Prandaj, shoku Krillov, vazhdova unë, ne nuk mund të vihem kundër popullit dhe Partisë sonë, të cilët s'janë dakord me përkrahjen që i bëhet Imre Nagit. Mendimi ynë është se i kemi shtruar drejt në popullin dhe Partinë tonë këto ngjarje të situatës së tanishme. Këtë çështje ne po e ngremë shoqërisht duke ia thënë Bashkimit Sovjetik se nuk jemi dakord. Nesër, ne mund të shkojmë edhe më tej në vlerësimin e ngjarjeve të Hungarisë, pse kështu jemi konsekuentë me vijën tonë të drejtë, por sot flasim me aq të dhëna sa kemi dhe sa nënkuptojmë nga letrat që këmbehen midis KQ të PK të BS dhe KQ të LKJ.

Në letrën e tij Titua na quan ne «njerëz të ligj» dhe kundër socializmit. Ne këtë nuk e pranojmë në asnjë mënyrë. Përkundrazi, ne jemi njerëz të mirë, marksistë-leninistë të vendosur deri në fund për çështjen e socializmit. Në të vërtetë Titua është kundër socializmit dhe për këtë flasin shumë fakte.

I theksova Krillovit se pikëpamjet tona mbi të gjitha këto çështje i di mirë KQ i PK të BS, sepse ne ia

kemi shprehur vazhdimisht. E pyeta: është kështu? Dhe mora përgjegjen: «Po, ashtu është». Pastaj i thashë: a keni raportuar ju mbi pikëpamjet tona sa herë kemi biseduar? «Po, u përgjegj ai, kam raportuar për të gjitha».

Është e qartë, shokë, se KQ i PK të BS e di fare mirë që ne, përveç ndërhyrjes së imperializmit në Hungari, themi (dhe për këtë jemi të bindur qind për qind), se në organizimin e kundërrevolucionit të Hungarisë kanë gisht edhe Titua me shokë. Ku bazohemi ne për këtë? Bazohemi në fakte. Kemi edhe eksperiencën tonë, e cila na mëson se Titua me shokët e tij, gjatë këtyre tetë vjetëve, janë përpjekur edhe përpiqen të hedhin në erë Partinë dhe Republikën tonë Popullore. Ata, jo vetëm më parë, po edhe tani që po përmirësohen marrëdhëniet e tyre me Bashkimin Sovjetik dhe vende të tjera socialiste, vazhdojnë komplotimin kundra Partisë, popullit dhe shtetit tonë. Këtë gjë PK e BS e di. Ajo është e informuar nga ana jonë që klika e Titos ndërhyr brutalisht në punët tona të brendshme dhe synon të likuidojë Partinë dhe pushtetin tonë popullor.

Në këtë mënyrë, Titua me shokë nesër do të vazhdojnë të luftojnë më me forcë kundër nesh. Prandaj ne nuk mund të jemi dakord me qëndrime të tilla që mbahen ndaj Titos. Megjithatë, ne kemi pritur një vit e gjysmë, dy vjet, që klika e Titos të pushojë veprimtarinë armiqësore kundër Partisë dhe vendit tonë, por ajo s'e ka bërë një gjë të tillë, përkundrazi, vazhdon të veprojë kundër Shqipërisë dhe për këto ne kemi shumë fakte. Por ne nuk gjunjëzohemi. Do të vazhdojmë të ecim në këtë rrugë të drejtë marksiste-leniniste që jemi, parimet do t'i mbrojmë deri në fund.

Shokut Krillov i shtrova edhe çështjen që ne kemi një muaj të tërë që po ju themi përditë se jemi krejtësisht të painformuar dhe s'dimë asgjë për ngjarjet që ndodhin në disa vende të kampit tonë. Keni ardhur ndonjëherë të na thoni gjë përsa ju kemi kërkuar? «Jo, u përgjegj Krillovi, me përjashtim të këtyre letrave që ju kam sjellë».

Duke vazhduar bisedën, i thashë se, siç kemi deklaruar edhe herë të tjera, ne nuk e quajmë me vend që zhvillohen gjithë këto bisedime me Titon, ndërsa neve nuk na sqarohet asgjë mbi ngjarjet që po zhvillohen në gjirin e kampit tonë, për të cilat jemi shumë të interesuar. Pse ndodh kjo, sepse jemi një vend i vogël? Marksizëm-leninizmi nuk njih vend të madh ose të vogël. Çështjet parimore e kemi për detyrë t'i mbrojmë të gjithë. Prandaj, së pari, ne mendojmë se duhet të ishim vënë me kohë në korrent mbi këto ngjarje me rëndësi parimore dhe, së dyti, sepse këto janë të lidhura shumë ngushtë dhe me çështjen tonë, me mbrojtjen e socializmit dhe të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Parimet tona dhe interesat e popullit shqiptar kërkojnë që ne të mbrojmë unitetin e Partisë sonë dhe marksizëm-leninizmin, popullin tonë, Bashkimin Sovjetik dhe Partinë Komuniste të tij. Në këto çështje ne mendojmë se nuk kemi gabuar dhe nuk do të gabojmë asnjëherë. Kërkova nga Krillovi që mendimet tona t'ua shkruajë shokëve të KQ të PK të BS. Ai u përgjegj se e kuptonte mirë situatën tonë.

Në fund, si në të kaluar, Krillovi më pyeti: «Po gjyqin e Dali Ndreut, do ta zhvillonin?». Mua më duket se kjo nuk ishte një pyetje e rastit, por mund të jetë

bërë me qëllim, sepse atij në ia kemi treguar se cili është Dali Ndreu dhe ç'dokumenta kemi në duar për këtë tradhëtar. Përgjegjia ime ishte kjo: Po, gjyqin e Dali Ndreut e kemi përgatitur, do ta bëjmë dhe do të marrim vendim, sepse ai është tradhëtar dhe agjent i një fuqie të huaj. Në rast se Titua do të vazhdojë të veprojë kundër nesh, siç po bën, megjithëse përpiqet ta mbulojë veprimtarinë e tij armiqësore, ne nuk do të mungojmë ta tregojmë të vërtetën me incizime në manjetoфон duke sjellë shumë fakte. Mjaft i kemi duruar titistët, të cilët jo vetëm vazhdojnë të na dëmtojnë, por edhe na akuzojnë se ne qenkemi njerëz të ligj dhe kundër socializmit! «E kuptoj gjendjen tuaj» përfundoi Krillovi, më falenderoi dhe iku.

Tani, shokë të Byrosë, t'i gjykojmë këto çështje, sepse janë mjaft serioze. Mendoj se ne nuk duhet të zbutim qëndrimin tonë parimor duke rënë dakord për vajtjen e Imre Nagit në Rumani, siç shkruan KQ i PK të BS. Si është e mundur që të përkrahet një njeri, i cili i hapi dyert kundërrevolucionit në Hungari? Po kështu, të bëhen gjithë këto përçapje për t'i fshehur Titos gabimet e tij të rënda që ka bërë dhe vazhdon të bëjë, më duket se kjo nuk është e lejueshme, kjo nuk është një vijë konsekuente, e drejtë dhe revolucionare. E theksoj edhe një herë se unë i deklarova Krillovit që nuk jemi dakord me këto çështje. Këto gjëra që po ndodhin neve nuk na pëlqejnë, sepse nuk po shohim perspektivën se ku shkojmë. Dhe për të gjitha çështjet që diskutojmë, nuk na është thënë asgjë, që ne të bindemi se cilat janë përfitimet që po shkojmë në këtë rrugë.

Edhe për ngjarjet e Polonisë ne po presim ndonjë

fjalë. Një muaj më parë na është thënë se atje gjendja është jashtëzakonisht e rëndë për kampin tonë dhe për Bashkimin Sovjetik, por qysh atëhere e deri tani nuk kemi asnjë lajm tjetër. Në revistën sovjetike «Kohët e Reja» lexuam një artikull, në të cilin, midis të tjerash, thuhet se Bashkimi Sovjetik është plotësisht dakord me ato që po ndodhin në Poloni. Edhe Gomulka ka deklaruar se udhëheqja e BS është dakord me të. Në bisedën që pata me Krillovin i thashë se nga shtypi polak mësojmë që janë duke u kthyer në Poloni oficerë të Andersit, njerëz të ikur, siç kemi edhe ne, që hedhin trakte dhe shpërndajnë material propagandistik, njerëz që nesër mund të hedhin edhe bomba e të na vrasin. Si është e mundur që ne të mbahemi në errësirë e të mos na thuhet gjë për të gjitha këto që po ndodhin në Poloni? Kjo nuk është e drejtë. Ne jemi shumë të interesuar të mësojmë të vërtetën. Krillovi u përgjeggj se kërkesa juaj është e drejtë. Atëhere, i thashë unë, ju lutem ia transmetoni edhe këtë pikëpamje që kemi ne KQ të PK të BS.

Është e qartë se kështu siç po zhvillohet situata, mund të ketë konsekuenca të tjera, prandaj problemi që na shtrohet është: do të shkelim parimet, do të heshtim, apo do të ecim përpara duke mos u pajtuar me qëndrime të gabuara?

Cili është mendimi im për të ecur më tej? Unë insistoj që ne të ecim në bazë të parimeve që kemi caktuar, sepse kemi të bëjmë me çështje që janë shumë delikate. Por, pavarësisht se nuk jemi dakord me disa çështje që ngre KQ i PK të BS, mendimet e kundërta të mos i nxjerrim jashtë, pse kjo është në dëm të Bashkimit



Sovjetik e të kampit socialist. Nga ana tjetër, mendimi im është që të mos bëjmë lëshime të tilla, siç kërkon të bëjë udhëheqja e PK të BS, sepse këto janë qëndrime të theksuara oportuniste. Në këto situata të rënda, sipas mendimit tim, një rol jashtëzakonisht të madh luajnë intrigat titiste jugosllave, një nga qëllimet e të cilëve është të krijojnë konflikte midis dy partive tona dhe të gjitha partive të tjera komuniste e punëtore, që mbrojnë marksizëm-leninizmin, t'i komprometojë dhe t'i hedhë ato në kundërshtim me njëra-tjetrën, me qëllim që situata të zhvillohet në favor të tyre.

Prandaj e them edhe një herë që të diskutojmë mirë seriozisht e me përgjegjësi të plotë, të jemi të matur në çdo hap që do të bëjmë, të parashikojmë si duhet zhvillimin e ngjarjeve më tej, sepse mund të ndodhin edhe gjëra të papritura, duam s'duam ne, rrethanat nuk dimë ç'do të na imponojnë.

Krillovi nuk na thotë asgjë. Vetëm një është fjala e tij: «Pravilno», (drejt). Edhe kur shton më tepër fjalët e tij janë këto: «E kuptoj situatën tuaj, po nuk kemi ndonjë lajm nga Moska». Për fjalimin që mbajta unë kohët e fundit<sup>1</sup> ai tha se ishte «silnij» (i fortë) dhe asgjë më shumë.

Përsa i përket çështjes për të shkuar ose jo në Bashkimin Sovjetik me qëllim që të sqarohemi për këto probleme, unë po mendohem të shkojmë apo të mos shkojmë. Në parim ne kemi të drejtë të shkojmë në

---

<sup>1</sup> Është fjala për fjalimin e shokut Enver Hoxha mbajtur në mbledhjen solemne me rastin e 15-vjetorit të themelimit të PPSH më 8 Nëntor 1956. Shih në këtë vëllim f. 83.

Bashkimin Sovjetik, sepse jemi përpara çështjeve të mëdha e shumë të rëndësishme që na takojnë si neve, ashtu dhe kampit tonë, çështje të cilat nuk i kemi të qarta. Ky sqarim është i nevojshëm edhe për faktin se ne duhet t'ia themi haptas mendimet tona udhëheqjes së PK të BS, ashtu siç bëme edhe atëhere, kur s'ishim dakord për vajtjen e Hrushovit në Jugosllavi dhe vlerësimet që ai i bëri Titos. Ne i kemi shfaqur pikëpamjet tona, të cilat i janë transmetuar KQ të PK të BS, prandaj le t'ia themi edhe tani. Por, në praktikë, të mbajnë parasysh se duke vajtur në BS mund të na dalin gjëra, për të cilat ne nuk duhet të bëjmë asnjë lëshim në parime. Puna mund të arrijë deri atje sa t'ia themi udhëheqjes sovjetike: «Ej, ku po shkoni, shokë, ne jemi në kundërshtim me këto lëshime që bëhen nga ana juaj». Kjo do të ndodhë po të mendojmë një të njëmijtën se shokët sovjetikë nuk do t'i kuptojnë e korrigjojnë lëshimet e tyre.

Por ne kemi shpresa se do të merremi vesh. Artikulli<sup>1</sup> i fundit që u shkrua nga ana jonë, ku tregohet qartë pikëpamja që kemi ne në të gjitha çështjet parimore lidhur me ngjarjet e Polonisë dhe të Hungarisë u botua në «Pravda» tërësisht, pa asnjë ndryshim. Kjo tregon se Partia jonë është në rrugë të drejtë, prandaj ne, këto ditë, mund të shkruajmë edhe disa artikuj të tjerë, në plan ideologjik në frymën e shkrimeve dhe të fjalimeve të fundit, që u kanë djegur shumë jugoslla-

---

<sup>1</sup> Është fjala për artikullin e shokut Enver Hoxha «Partia e Punës e Shqipërisë mbush 15 vjet», botuar në gazetën «Pravda», më 8 Nëntor 1956. Shih në këtë vëllim f. 75.

vëve. Kështu do të mbrojmë deri në fund marksizëm-leninizmin.

Ne kemi të drejtë të hedhim një hap më përpara në çështjen e demaskimit të veprimtarisë së Titos dhe klikës së tij. Pavarësisht se ne nuk jemi dakord me BS, kritikën ndaj udhëheqjes sovjetike ne t'i bëjmë duke thënë se nuk jemi dakord me qëndrimet e saj oportuniste në çështjen jugosllave, por mendoj të mos e acarojmë shumë punën, të mos i nxjerrim jashtë kundërshtimet tona me udhëheqjen sovjetike, sepse Bashkimin Sovjetik duhet ta mbrojmë pse ekziston rreziku që t'i jepen armë armikut, sidomos në këto situata, kur imperialistët dhe borgjezia kanë shpërthyer një fushatë të shfrenuar kundër BS dhe kur nuk mungojnë parulla të hapëta antisocialiste dhe në disa vende të kampit socialist si në Hungari e në Poloni. E kam fjalën që ta gjykojmë mirë problemin. Ne ua kemi thënë shokëve sovjetikë kundërshtimet tona që kemi me ta dhe ata i dinë pozitën dhe qëndrimet që mbajmë ne. Në këto rrethana, po të mos na thërresin për të biseduar e për të sqaruar, atëherë neve na bie detyra të kërkojmë të shkojmë në Bashkimin Sovjetik, pse ndryshe, duke mos shkuar, ka të ngjarë që të mbetemi në vend, gjë që nuk është e drejtë. Pra unë parimisht jam dakord të shkojmë në Moskë dhe t'i themi udhëheqjes së PK të BS që deri sot nuk kemi qenë në kundërshtim me ju, por tani në disa çështje kemi mendime të tjera.

*Pasi diskutuan të gjithë shokët e Byrosë Politike lidhur me çështjet që u përmendën më sipër, shoku Enver vazhdoi:*

Unanimiteti në Byronë Politike për këto probleme

është i plotë. Kjo ka rëndësi vendimtare për Partinë tonë dhe ndërtimin e socializmit në Shqipëri. Mendoj se ky qëndrim parimor që mban udhëheqja e Partisë sonë do të japë kontributin e vet edhe në drejtim të partive të tjera. Pse e them këtë? E them sepse, sikundër jeni shprehur kurdoherë, lufta kundër titizmit është një çështje parimore nga më kryesoret. Titizmi duhet demaskuar. Në këtë çështje qëndrimi i shokëve sovjetikë, pas Kongresit XX, është i tillë që rreziku i titizmit nënvleftësohet, nuk vlerësohet si duhet. Po i hidhet një cipë e madhe dhe e errët ideologjisë titiste, veprimtarisë agjenturale dhe intrigave të saja. Na thuhet se kjo është taktikë (qoftë vetëm taktikë!), por edhe si taktikë, po ta marrim, neve na duket e dyshimtë dhe e gabuar. Partia jonë nuk e ka bërë këtë, po qëndron si parti marksiste-leniniste, ne jemi për miqësinë me Jugosllavinë, por parimet nuk i shkelim.

Shokët sovjetikë kanë nënvleftësuar jo vetëm rrezikun titist, por edhe qëndrimin e drejtë të Partisë sonë. Partia jonë i ka vënë në dijeni ata dhe u ka treguar me fakte qëndrimin e vet edhe për gjënë më të vogël, duke u dalë borxhit. Në rast se shokët sovjetikë të dhënat tona i kanë mbyllur në sirtar, kjo është përgjegjësia e tyre. Susllovi ka thënë se udhëheqja e PK të BS i di çështjet tona me Jugosllavinë. Po me sa duket, mendimet dhe qëndrimet tona ata i kanë marrë si çështje të vogla lokale duke thënë vetëm se «shokët shqiptarë kanë të drejtë» dhe pastaj kanë shtuar «tani Titua bëri autokritikë», prandaj, sipas tyre, ky myteber mund të jetë me ne.

Të marrim çështjen e të ashtuquajturit kult të

individit të Stalinit. Nga kjo përfitoi imperializmi, i cili filloi një aktivitet të tmerrshëm për të denigruar Bashkimin Sovjetik dhe gjithë kampin tonë. Imperializmi është organizatori kryesor i luftës kundër BS në lidhje me «kultin e individit të Stalinit», por mendojmë se Titua është dora e djathtë e tij dhe synon të shkatërrojë kampin e socializmit.

Faktet dhe dokumentat nuk mungojnë për të treguar ato që janë bërë nga imperializmi dhe Titua. Koha ka provuar veprimtarinë e tyre të spiunazhit kundër vendeve tona socialiste. Ka apo s'ka Titua marrëveshje me imperializmin për këto gjëra, këtë s'e dimë, po faktet janë të tilla që ai është vegël e tij, ndërsa Bashkimi Sovjetik po e neglizhon këtë çështje. Mundet që shokët sovjetikë ta rishohin këtë qëndrim të tyre ndaj Titos, dhe në këtë dëshirojmë, por situatat që kanë krijuar titistët janë mpleksur kaq keq, sa që ndoshta sovjetikët nuk dinë si të dalin. Ne nuk mund ta kuptojmë një qëndrim të tillë oportunist ndaj titistëve nga ana e shokëve të vjetër bolshevikë.

Mirë e thanë të gjithë shokët e Byrosë që folën se qëndrimi i Partisë sonë është i drejtë. Në asnjë mënyrë ne nuk do të lëshojmë në parimet, qoftë edhe një milimetër. Në këto çështje mjaft delikate ne duhet ta ruajmë prestigjin e Bashkimit Sovjetik dhe të PK të tij, por çështjet parimore do t'i mbrojmë, qoftë edhe sikur të mbetemi vetëm. Ne me siguri nuk do të mbetemi vetëm për shumë kohë, në rast se bëjmë një luftë të drejtë për mbrojtjen e parimeve.

Nëse tani e do puna të mos e themi haptazi se Titua dhe shokët e tij po shkatërrojnë kampin tonë, do të vijë.

dita që këtë ta themi haptazi. Derisa ne mbështetemi fort në marksizëm-leninizmin, Partia dhe populli ynë e kuptojnë qartë pse, për shembull, jemi kundër që Imre Nagi të strehohet në Rumani. Me këtë rast propozoj që në fjalimin e Mehmetit<sup>1</sup> të bëjmë një shtojcë në lidhje me Imre Nagin ku të thuhet që Partia jonë dhe populli ynë janë të bindur se ata që e strehojnë ose e mbështetin këtë tradhëtar, nuk ndihmojnë në ndërtimin e socializmit. Ne po ia themi copë popullit se ai është armik dhe tradhëtar. Po të pyetemi pse e pranon Dezhi ta strehojë në Rumani, ne do të themi se kjo është punë për të, ne s'jemi dakord me këtë qëndrim. Në rast se kërkohet më shumë, atëhere t'i themi Partisë që këto çështje ne i kemi shtruar dhe biseduar me miqtë, të cilëve u kemi thënë mendimin tonë të kundërt, po kurdoherë, shokë, të mbajmë parasysh që të ruajmë interesat e PK të BS. Në rast se komunistët do të na pyesin përse nuk na keni thënë edhe neve, mund t'u përgjigjemi se nuk kanë qenë momentet dhe me siguri Partia do të na thotë që keni menduar e vepruar mirë.

Zemra na e do që këto ngjarje të kthehen për së mbari kur të shkojmë e t'i bisedojmë në BS, po mundet që të mos jemi në një mendje me ta. Në rast se do të ndodhë kështu, në asnjë mënyrë ne nuk duhet ta cë-

<sup>1</sup> Është fjala për raportin që do të mbahej nga Kryetari i Këshillit të Ministrave të RPSH, shoku Mehmet Shehu në mbledhjen e Kuvendit Popullor më 14 nëntor 1956 lidhur me vizitën e *delegacionit qeveritar* të RP të Shqipërisë në RP të Mongolisë dhe RDP të Koresë. Në këtë fjalim flitet edhe për pritjen që iu bë në Kinë *delegacionit të Partisë së Punës të Shqipërisë*, kryesuar nga shoku Enver Hoxha, që mori pjesë në Kongresin VIII të Partisë Komuniste të Kinës.

nojmë leninizmin. Por, të jesh mik me gjithë zemër i tjetrit, nuk mund të mos ia thuash gabimet e tij, sigurisht në rrugën marksiste-leniniste. Sikur udhëheqja sovjetike të na thotë: «More shokë, të gjitha këto që thoni ju shqiptarët janë të drejta, ne kemi gabuar rëndë, por në rast se deklarojmë që kemi gabuar, atëhere a nuk do të krijohet një situatë e favorshme për imperializmin?» Natyrisht, po të arrijmë të kuptohemi kështu, atëhere jemi në rregull dhe do të flasim për perspektivën, sepse ne e kuptojmë që armiku s'duhet të përfitojë. Po kjo është dëshira jonë. Do të ndodhë kështu apo jo, këtë do ta tregojë koha. Të shohim, a do të thonë shokët sovjetikë se cili është Titua. Kjo e të tjera duhen vënë në vend, ndryshe nuk mund të ecet. Të vazhdojë kështu, kjo është katastrofë.

Nga të dhënat që kemi ne, dimë edhe këtë gjë: anëtarët e KQ të PK të BS që ishin në vendin tonë me pushime janë shprehur kundër Titos, kundër qëndrimeve që mbahen në favor të tij, për të cilat ata kanë thënë se nuk na duken në rregull. Prandaj shokë, të qëndrojmë siç kemi qëndruar, të patundur. Dhe ne kështu do të qëndrojmë deri në fund, pa rënë në gabime. Vetëm duhet të matemi shumë, të ruajmë si kurdoherë gjakftohtësinë dhe, kur të themi një gjë, ta vulosim se kështu është dhe jo ndryshe. Këto janë çështje me rëndësi shumë të madhe. Të gjithë e dinë se sa e duam ne Bashkimin Sovjetik, po edhe atje mund të gabojë ndonjë njeri, dy ose tre, por nuk është lehtë të gabojë e gjithë PK e BS. Ne e kuptojmë mirë se klika e Titos dëshiron izolimin tonë nga BS, që ne të biem në kundërshtim të hapët me PK të BS. Prandaj ne t'i sqarojmë me urtësi e drejtësi

mosmarrëveshjet që kemi me shokët sovjetikë, rrahjen e mendimeve e lejon edhe marksizëm-leninizmi, po kurrë ashtu siç mendon e vepron Toliati<sup>1</sup>.

Si përfundim, mund të themi se të gjithë jemi dakord për çështjet që diskutuam, gjithashtu jemi dakord edhe për vajtjen e një delegacioni në Moskë pasi të presim edhe disa ditë. Po çështja është gjithashtu edhe kush do të shkojë në Moskë, të marrim parasysh që të mos ikin të tërë shokët.

Tani si e gjykoni, a duhet të vëmë në dijeni Komitetin Qendror për këto çështje apo të presim edhe ca. Unë them që tani për tani, për arësyet që përmendëm, këto çështje t'i mbajmë brenda për brenda Byrosë Politike. Shokët e Plenumit të KQ, në vija të përgjithshme, janë në korrent, janë të orientuar.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

---

<sup>1</sup> Është fjala për pikëpamjet antimarksiste që kishte filluar të shfaqte Palmiro Toliati. Ai kishte shprehur pikëpamjen se «sistemi socialist ka degjeneruar», kishte shprehur pikëpamje jo të drejta në lidhje me rolin ndërkombëtar të Bashkimit Sovjetik dhe rëndësinë universale të eksperiencës sovjetike, kundër ekzistencës së një qendre të vetme të lëvizjes komuniste ndërkombëtare, kundër të ashtuquajturit kult të personit të Stalinit duke thënë se ai ishte pasojë e vetë sistemit socialist. Ai kishte pikëpamje jo të drejta në lidhje me rolin udhëheqës të klasës punëtore dhe nuk dënonte pikëpamjet antimarksiste të udhëheqjes jugosllave.



## PER FJALIMIN E TITOS NE PULA

### *Teza për artikull<sup>1</sup>*

19 nëntor 1956

— Në fjalimin e Titos paraqiten pikëpamje që janë në kundërshtim me marksizëm-leninizmin dhe internacionalizmin proletar.

— Rreth ngjarjeve në Hungari. Ajo që ndodhi nuk është si thotë ai «një kryengritje e gjithë popullit» etj., por një komplot kundërrevolucionar që kishte për qëllim të përmbyste regjimin e demokracisë popullore dhe të vendoste diktaturën fashiste.

— Kur armiqtë u demaskuan, doli e qartë se ç'fshihet prapa parullave «për demokracinë e vërtetë», «për mirëqenien e masave» etj., doli qartë fytyra e përgjakur e kundërrevolucionit hungarez.

— Fshati që duket nuk do kallauz. Si mund të jetë

---

<sup>1</sup> Në bazë të këtyre tezave u pregatit artikulli redaksional «Në lidhje me fjalimin e mbajtur kohët e fundit të Josif Broz Titos», botuar në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 285 (2554), 23 nëntor 1956.

«kryengritja e gjithë popullit»? Që të vendoset diktatura e përgjakshme e Hortit? Që në krye të qeverisë të vihet Mindzenti? (daljen e tij nga burgu e përshëndeti shtypi jugosllav).

— Ngjarjet që ndodhën në Hungari s'janë as «revolta spontane», as i kanë rrënjët atje ku thotë J.B.Titua. Komunistët dhe punonjësit hungarezë do ta analizojnë deri në fund komplotin. E vërteta nuk humbet.

Titua i ngarkon shumë të tjerët me përgjegjësi, por s'thotë asgjë për përgjegjësinë e imperialistëve, të emigrantëve dhe armiqve të tjerë. Faktet vërtetojnë se komploti fashist në Hungari u organizua nga imperialistët, nga reaksionarët e brendshëm e të jashtëm hungarezë me kryebanditin Imre Nagi në krye.

Këta janë përgjegjës për masakrat, djegiet, për tërë tragjedinë hungareze.

— Si u bë e mundur që kundërrevolucioni në Hungari shpërtheu tani dhe jo më përpara. Gabimet e udhëheqjes nuk mund ta justifikojnë kurrë kundërrevolucionin kundër regjimit të demokracisë popullore. Imperialistët i shfrytëzuan gabimet e bëra dhe shpërthyen fushatën demagogjike, jo për të ndrequr gabimet, por për të diskredituar Partinë e Punonjësve Hungarezë.

Ky presion ngjalli konfuzion e pakënaqësi, nxiti tendencat antisocialiste, inkurajoi hortistët dhe njerëzit e Ferenc Nagit etj.

Ndryshimet e njëpasnjëshme të udhëheqjes e lanë partinë dhe vendin pa një shtab drejtues, të fortë e besnik. Këtu është shkaku që punonjësit hungarezë nuk mundën t'ia mbyllnin me kohë rrugën kundërrevolucionit.

— Titua e shpjegon qëndrimin e tij ndaj ngjarjeve të Hungarisë pasi, siç thotë ai, është kundër çdo ndërhyrjeje të një shteti në punët e brendshme të një shteti tjetër.

Por kush duhet të dënohet? A nuk duhet të dënohen imperialistët që organizuan komplotin fashist e që tani po përpigën të ndërhyjnë nëpërmjet OKB-së?

— Të gjitha forcat përparimtare të botës e përshëndetën fitoren e popullit hungarez dhe ndihmën që i dha atij Ushtria Sovjetike. Vetëm imperialistët shpifën me qëllim që të fshehin ndërhyrjen e tyre.

— J.B.Titua polemizon me nervozizëm me ata që mendojnë se influenca e Jugosllavisë ndihmoi në përgatitjen e ngjarjeve që ndodhën në Hungari. Kush është i pastër s'ka pse të shqetësohet. Imre Nagi strehohet në ambasadën jugosllave në Budapest. Si mund të shpjegohet kjo? Si mund të justifikohet përpara popullit hungarez e të tjerëve? Deri në fund shtypi jugosllav ribotonte shkrimet e klubit «Petëf» që kishin një karakter të hapët kundërrevolucionar. Po kjo si shpjegohet?

— Cilat janë dhe ç'fshihet prapa pikëpamjeve të Titos mbi «kultin e individit», «stalinizmin», «stalinianët» etj.?

Stalini ishte një marksist dhe organizator i madh, ai ka merita të mëdha në ndërtimin socialist, në mbrojtjen e leninizmit, në luftën kundër armiqve të klasës punëtore etj. Në qoftë se ndokush përpigjet që nën maskën e gabimeve të Stalinit, të shuajë vigjilencën revolucionare të partive tona për të mbrojtur marksizëm-leninizmin dhe për të luftuar kundër ideologjive të huaja e deviacioneve, ai gabohet rëndë.

— Titua ka ngritur flamurin dhe i përdor termat «stalinizëm» e «stalinianë» për të goditur sistemin sovjetik, regjimin e demokracisë popullore, partitë komuniste, marksizëm-leninizmin.

Ndarja në «stalinianë» dhe «jostalinianë» ka për qëllim të ngjallë konfuzion dhe të mbjellë përçarje. Titua arrin të thotë se «s'ka garanci që socializmi do të zhvillohet drejt» derisa «partitë e ndryshme, stalinianët mbajnë akoma pozitat e tyre» dhe shton se këta duhen përmbysur. Dhe këtë ai e deklaron tani kur imperialistët përpiqen të përçajnë kampin socialist dhe kanë filluar një sulm të egër me demagogji e terror kundër partive komuniste.

Imperialistët kanë krijuar një sistem të tërë paktesh politike, ushtarake, ekonomike etj., që kërcënojnë paqen, janë shumë të interesuar për të përçarë forcat përparimtare me qëllim që të realizojnë planet e tyre.

— Pretendimet për «rolin ndërkombëtar» të Jugosllavisë, për «influcencën pozitive» të saj etj., Titua deklaron: «tani është çështje nëse në partitë komuniste do të triumfojë kursi i ri, i cili filloi në Jugosllavi, ose do të fitojë kursi stalinian», «Jugosllavia nuk guxon të ndrydhet në lëvozhgën e vet, ajo duhet të punojë në të gjitha drejtimet që të triumfojë fryma e re». Shtypi jugosllav pretendon se «rruga jugosllave e socializmit është e vetmja rrugë e vërtetë» bile gati e vetmja për të gjitha vendet.

Ata që i thonë këto vuajnë nga mungesa e modestisë dhe kujtojnë se janë bërë qendra e lëvizjes revolucionare botërore.

Këto deklarata janë në kundërshtim të hapët me

marksizëm-leninizmin. Jugosllavët që thërresin për rrugët e veçanta të kalimit në socializëm tani i vënë partitë përpara dilemit fals: ose të ndjekin «kursin e ri», d.m.th. rrugën titiste, ose «kursin e vjetër, rrugën staliniane».

**Për partitë marksiste-leniniste ka vetëm një vijë të përgjithshme të drejtë, që është vija e marksizëm-leninizmit.**

— Eksperienca tregon se me gjithë bashkësinë e tipareve dhe ligjeve të përgjithshme kryesore, format, metodat dhe ritmet e kalimit në socializëm kanë edhe ndryshime që kondicionohen nga kushtet konkrete të zhvillimit të tyre.

Kjo eksperiencë e vlefshme që pasuron teorinë tonë si dhe praktikën duhet të shkëmbehet duke u mbështetur në bazat e parimeve marksiste-leniniste e të internacionalizmit proletar. Por Partia jonë tregohet e urtë e vigjilente, sepse nën parullat e «socializmit nacional» e «specifik» bëhen përpjekje për të na larguar nga vija e përgjithshme marksiste-leniniste.

— Se cilën rrugë do të ndjekin jugosllavët, do të mbajnë këtë, apo atë formë, kjo është punë e tyre. Pavarësisht se na pëlqejnë ose jo ne nuk përzihemi në punët e tyre. Por Titua dhe shtypi jugosllav që janë partizanë të «rrugëve të ndryshme të kalimit në socializëm» dhe të «mosndërhyrjes në punët e brendshme», i vënë vetes për detyrë që «rrugën e format jugosllave» t'ua imponojnë edhe partive të tjera, bile me «luftë të gjatë e të vështirë». Bile ata që nuk i përqafojnë këto i quajnë «stalinianë» dhe bëjnë thirrje për t'i përmbysur e për t'i zëvendësuar me partizanë të «kursit të ri». Por

kjo s'do të ngjasë, fuqia e marksizëm-leninizmit është e pamposhtur.

— Barazia dhe mosndërhyrja në punët e brendshme është një parim i madh marksist-leninist. Udhëheqësit jugosllavë flasin shumë për «mosndërhyrjen», por bëjnë të kundërtën. Titua thotë se «ne nuk u angazhuam shumë që të hiqet një ekip i tillë si Rakoshi e Gero», thotë se «zëvendësimi i Rakoshit me Geron që gabim» etj. Kush vendos se kush duhet të jetë në krye të Hungarisë, populli dhe partia hungareze apo Titua?

— Të hidhen poshtë sulmet që bëhen kundër Partisë sonë. Ato bëhen sepse ajo mbron me vendosmëri vijën e saj marksiste-leniniste, pavarësinë dhe lirinë e popullit tonë, miqësinë me Bashkimin Sovjetik dhe kampin e socializmit.

Partia jonë i ka mbrojtur dhe do t'i mbrojë gjithmonë me besnikëri parimet marksiste-leniniste, pavarësisht se kjo nuk u pëlqen dhe i zemëron ata që i braktisin këto parime.

Mënyrat që përdor Titua për t'u hapur rrugë teorive të kalbura që janë hedhur poshtë nga vetë jeta dhe lufta për të mbrojtur marksizëm-leninizmin, nuk mund të kenë sukses.

— Të flitet për qëndrimin antimarksist e shovinist të udhëheqësve jugosllavë kundër Partisë dhe popullit tonë, për ndërhyrjet e njohura në punët e brendshme të Partisë e të shtetit tonë.

Ne jemi treguar të duruar dhe kemi bërë përpjekje që marrëdhëniet tona të vendoseshin në baza të shëndosha. Por udhëheqësit jugosllavë vazhduan në rrugën e vjetër dhe na u përgjegjën me sharje, me ndërhyrje e

komplete për të minuar Partinë e pushtetin popullor.

Ndërnyrjet e udhëheqësve jugosllavë në Shqipëri tregojnë se fjalët e Titos për mosndërhyrje në punët e brendshme dhe realiteti nuk përputhen.

— Komunistët dhe populli shqiptar indinjohen shumë për këto veprime të udhëheqësve jugosllavë.

— Më në fund të thuhet qartë se në qoftë se Titua mendon që Shqipëria mund të goditet lehtë pse ajo është një vend i vogël, ai gabohet rëndë. Shqipëria nuk është ajo që ishte dje, ajo ka zot popullin, që është i lidhur si çeliku me Partinë dhe pushtetin e tij.

Titua duhet ta dijë se ato që i kaluan në Hungari, në Shqipëri nuk do të kalojnë, ato që ndodhën atje, në Shqipëri s'do të ndodhin kurrë.

— Ne do të nxjerrim mësimë nga ngjarjet e Hungarisë por jo ato që «na këshillohen».

— Ne do të mbrojmë marksizëm-leninizmin, do të demaskojmë demagogjinë e armikut, sepse helmi i ideologjisë së huaj nuk është më pak i rrezikshëm se topat e armikut, do të forcojmë vigjilencën, do të bashkojmë më fort bashkimin e popullit rreth Partisë etj.

*Botohen për herë të parë sipas shënimeve që gjenden në Arkivin Qendror të Partisë*

## LETËR DY KOMPOZITORËVE AZERBAJXHANAS

15 dhjetor 1956

Të nderuar shokë Nazirova dhe Amirov,

Letrën tuaj e mora dhe ju falenderoj me gjithë zemër për vëmendjen e treguar për këngët popullore shqiptare dhe për punën tuaj krijuese në këtë drejtim.

Unë bashkohem plotësisht me mendimin tuaj, se ndërmjet muzikës të të dy popujve tanë ka shumë gjëra të përbashkëta dhe kjo nuk është e rastit. Të dy popujt tanë kanë vuajtur njëllor në të kaluarën nën zgjedhën e regjimeve antipopullore, ata njëllor kanë luftuar për çlirimin e tyre kombëtar dhe shoqëror. Shumë këngë popullore azerbajxhanase dhe shqiptare shprehin luftën plot vetëmohim të popujve tanë në të kaluarën për realizimin e aspiratave të tyre.

Populli azerbajxhanas realizoi ëndrrat e tija shekullore në saje të triumfit të Revolucionit të madh socialist të Tetorit në Rusi dhe vendosjes së pushtetit sovjetik edhe në vendin e tij. Edhe populli shqiptar e fitoi lirinë dhe pavarësinë e tij vetëm 12 vjet më parë, në saje të luftës së tij vetëmohuese kundër armiqve të jashtëm e të brendshëm dhe të fitores vendimtare të



Ushtrisë çlirimtare Sovjetike në Luftën e dytë botërore.

Tani këngët tona i këndojnë të kaluarës historike dhe jetës së sotme të mrekullueshme e të ndritur të popujve tanë, të ardhshmes edhe më të ndritur të vendeve tona. Ka gjithashtu shumë gjëra të përbashkëta në këngët shqiptare dhe azerbajxhanase, sikurse edhe në këngët e të gjithë popujve sovjetikë.

Populli shqiptar do t'i dëgjojë me shumë gëzim veprat tuaja me tema popullore shqiptare që na keni dërguar me këtë rast dhe do të ishim shumë të gëzuar të na dërgoni edhe në të ardhshmen prodhime të tilla artistike.

Ju uroj suksese të mëtejshme në punën tuaj fisnike!

*Enver Hoxha*

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë.*

**TEZA<sup>1</sup> TË KQ TË PPSH MBI BAZËN E TË CILAVE  
U ZHVILLUAN BISEDIMET ME UDHËHEQËSIT  
SOVJETIKË NË MOSKË NË TAKIMET E BËRA  
MË 25 DHE 26 DHJETOR 1956<sup>2</sup>**

**25 dhjetor 1956**

**Qëllimi i ardhjes së delegacionit të KQ të PPSH:**

- a) Për të shkëmbyer mendime e për t'u sqaruar, brenda mundësive, mbi situatat ndërkombëtare të krijuara dhe qëndrimet që duhet të mbajmë.
- b) Si i kupton dhe i interpreton Partia jonë ngjarjet ndërkombëtare dhe ç'qëndrim mendon ajo se duhet të mbajë tani dhe në të ardhshmen.
- c) Çështja jugosllave, marrëdhëniet me vendin dhe

---

<sup>1</sup> Tezat botohen si në origjinal, pa sqarime plotësuese duke qenë se problemet që ngrihen në to janë trajtuar në këtë vëllim dhe në vëllimet e tjera të veprave të shokut Enver, në Dokumentat Kryesore të PPSH si dhe në Historinë e PPSH dhe janë të njohura për lexuesit tanë.

<sup>2</sup> Këto bisedime u bënë në takim in e parë me Suslov in ku morrte pjesë edhe Brezhnjev i e Ponomarjov i dhe në takimin e dytë me Hrushovin, ku ishin të pranishëm edhe Suslov i e Ponomarjov i.

me Partinë tonë. Si e kuptojmë ne çështjen jugosllave dhe propozime në lidhje me këtë çështje.

### **Pse ne kërkojmë të bisedojmë me KQ të PK të BS?**

Bashkimi Sovjetik është shteti i parë socialist me një eksperiencë të pasur nga e cila ne kemi mësuar gjithnjë. Bashkimi Sovjetik e ndihmoi popullin tonë të çlirohej, ka mbrojtur sovranitetin e fitoret e tija dhe e ka ndihmuar në ndërtimin e socializmit. Ne mendojmë se kështu duhet t'i shikojnë dhe t'i duan Bashkimin Sovjetik dhe Partinë Bolshevike, të gjithë ata që janë marksistë dhe internacionalistë. Kush përpiqet të mbulojë qëndrimin e sinqertë ndaj Bashkimit Sovjetik dhe Partisë së Leninit, me pretekstin se gjoja mos akuzohet për satelit, ai gabon rëndë. Ne mendojmë se me mbrojt Bashkimin Sovjetik sidomos tani është çështje kryesore, vendimtare; duke mbrojtur atë mbron socializmin, paqen.

Me parullat antimarksiste të hapëta dhe të maskuara kemi kohë që jemi mësuar, që prej vitit 1943, siç do ta themi edhe më poshtë.

Për çka ndjejmë dhe mendojmë Partia na ka edukuar t'ia themi haptazi Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Prandaj ne do ta themi haptazi çdo gjë, qoftë kjo e drejtë ose e gabuar, qoftë e ëmbël ose e thartë.

Ku kemi gabim, ju lutemi të na e thoni hapët dhe të na bindni se kjo ka një rëndësi të veçantë për vendin tonë, i cili, megjithëse është i vogël, ka një pozitë shumë delikate.

Ne do të jemi shumë të kujdesshëm në mbrojtjen e

parimeve marksiste-leniniste, në mbrojtjen e atdheut tonë dhe të Bashkimit Sovjetik. Të gjitha çështjet që ngjasin në kampin tonë na interesojnë në mënyrë të veçantë, aq më tepër si pjesëtarë të vendeve të Traktatit të Varshavës. Megjithëse roli i vendit tonë është i vogël, dhe as na shkon kurrë në mendje të kemi ndonjë pretendim të tepërt, e drejta e kërkon që dhe ne të vihem në korrent për çdo gjë. Shumë gjëra kanë ndodhur, por ne kemi qenë krejt të izoluar, më vonë u vumë fare pak në korrent (disa telegrame që keni shkëmbyer me Titon). Ju ndoshta e gjykoni më mirë, por mendojmë se nuk do të ishte ndonjë krim, po do të ishte më e drejtë, qoftë edhe për informim, që Këshilli Politik i Traktatit të Varshavës të ishte mbledhur ose të mblidhet.

**Edhe qëndrimet politike dhe masat që po merren për këto situata të vështira, duke e gjykuar nga pikëpamja jonë, janë marrë dhe merren të shkëputura, pa u konsultuar me të gjitha partitë. Në qoftë se janë bërë konsultime me partitë e tjera dhe Partia jonë është lënë mënjanë, kjo nuk është e drejtë. Ne mendojmë se qëndrimet e njëjta në këto momente janë të domosdoshme, ndryshe mund të bëhen gabime, dikush mund t'ia shkelë gazin motorit më tepër nga sa duhet, disa ia shkelin aq sa duhet, por disa të tjerë s'ia shkelin fare. Ne jemi të gjithë, besojmë, të një mendimi. Kurse armiku kërkon që ne të kemi divergjenca. Ne duhet të tregohemi të bashkuar e të fortë dhe forca jonë qëndron në pikëpamjet e njëjta. Atëhere ta tregojmë forcën tonë.**

## I

## ÇËSHITJA JUGOSLLAVE

Në dritën e këtyre ngjarjeve do të na lejoni ta fillojmë çështjen me Jugosllavinë, pse mendojmë se kjo ka një rëndësi shumë të madhe për socializmin, për unitetin e kampit tonë dhe veçanërisht për Shqipërinë.

S'do të themi ndonjë gjë të re për Jugosllavinë dhe për marrëdhëniet e Partisë e të popullit tonë me të, se ju jeni në dijeni të të gjithave dhe vlerësimi që i është bërë nga ana juaj qëndrimit të Partisë sonë ndaj Jugosllavisë ka qenë i drejtë.

Në lidhje me këto ngjarje dhe me ashpërsimin e marrëdhënieve me Jugosllavinë, ju lutem të na falni dhe të keni durim se do të bëjmë disa përsëritje, por të jeni të sigurtë, se këto që do të themi do të bazohen në fakte, do të jenë reale, s'do të jenë të shtyra nga pasioni dhe as do të jenë subjektive. Ne mendojmë se çështjet në mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë s'janë çështje regjionale, mosmarrëveshje të vogla dhe joparimore, të cilat mund të ndreqen kollaj, këto janë çështje që i përkasin kampit tonë, janë parimore, të koklavitura. Këto duhet të shërbejnë për të gjykuar çështjen jugosllave në dritën e vërtetë, në rast se ne dëshirojmë ta zgjidhim drejt atë. Në rast se Titua mendon se duke na sharë ne nga Pula, e likuidoi Shqipërinë dhe rendin socialist në vendin tonë, ai gabohet rëndë. Çështja e Shqipërisë është shumë e rëndë, shumë e koklavitur dhe nuk likuidohet lehtë, jo me të shara, por as me manu militari.

**Tash më lejoni të hyj konkretisht në temë:**

**Pikëpamjet jugosllave gjatë periudhës së luftës.**

- Fronti Nacional-Çlirimtar mbi Partinë.
- Fronti, organizatë pa kufi ku të përfshihe-  
shin edhe reaksionarë.

**Periudha 1944-1948.**

- Plenumi i Beratit;
- Kritika kundër Partisë sonë;
- Akuzat për sektarizëm;
- Futja e «nacionalistëve»<sup>1</sup> në front (ç'u bënë  
më vonë këta elementë);
- Dobësimi i rolit të Partisë;
- Shqipëria duhej të varej politikisht dhe eko-  
nomikisht nga Jugosllavia.

**Komploti i drejtuar nga Vel [imir] Stojniçi.**

- Ngritja dhe mbështetja e Koçi Xoxes dhe e  
elementëve projugosllavë (Fjalimi i Velo Stoj-  
niçit në Berat).
- Letra e N. Spirut drejtuar KQ të PKJ.
- Tentativat për rifutjen në KQ të elementëve  
projugosllavë.

**Pas çlirimit çështjet e Partisë u sabotuan nga Koçi Xoxe.**

- Partia u vu nën kontrollin e Sigurimit të  
Shtetit.

**Plenumi VIII dhe rruga ku po e futnin jugosllavët  
Shqipërinë.**

Persekutimet e shokëve nga më të mirët. Vetë-

---

<sup>1</sup> Është fjala për disa të ashtuquajtur nacionalistë reaksio-  
narë që kishin bashkëpunuar me pushtuesit fashistë.

vrasja e Nako Spirut dhe përgjegjësia e jugosllavëve. Prgatitja e likuidimit të shokëve të tjerë të udhëheqjes, (pregatitja e dosieve të fshehta në Ministrinë e Punëve të Brendshme, përgjegjësia e Koçi Xoxes, e këshilltarëve jugosllavë dhe e Rankoviçit personalisht).

**Çorganizimi i ekonomisë sonë kombëtare.** Si duhej të zhvillohej ajo sipas tyre? Si apendiks dhe plotësuese e ekonomisë jugosllave. Dëshën të vendosnin një regjim shfrytëzimi kolonial. Zhvillimi i industrisë injorohej. Zhvillimi i naftës sabotohej. Bujqësia të zhvillohej vetëm në drejtim të prodhimit të pambukut dhe të bimëve industriale. Misri duhej të likuidohej, grurë të mbillej pak. (Gjoja Jugosllavia kishte bukë dhe për ne). Koopeativizmi nuk duhej zhvilluar. Grumbullimi i prodhimeve bujqësore do të bëhej nëpërmjet një sistemi të gabuar dhe me forcë (komunizmi i luftës).

**Tregëtia të bëhej dhe u bë vetëm me Jugosllavinë.**

**Importet me çmimet e brendshme të mallrave me pakicë të tregut jugosllav.**

**Eksporti me çmime ndërkombëtare (!)**

**Kredia jugosllave fryhej me anën e këtyre çmimeve.** Ndihma ekonomike u kufizua me disa punishte të vjetra dhe të sabotuara. Kredia jo e cilësuar.

**Shoqëritë e përbashkëta: —** Natyra e tyre shfrytëzuese, mënyra e investimit të kapitaleve në to.

**Format e organizimit:**

— Shkohej drejt bashkimit, planet e përbashkëta (dokument i Kidriçit). Komiteti mikst qeveritar gjoja për koordinimin e planeve në Tiranë dhe Beograd.

Parifikimi i monedhës. Heqja e doganave.

Moslejimi i asnjë marrëdhënie, e çdo natyre goftë, me vendet e tjera të demokracisë popullore.

— (Si e konsideruan ata ndihmën e Bashkimit Sovjetik dhe marrëveshjen me Bullgarinë).

Diskreditimi i Bashkimit Sovjetik dhe përpjekjet për shkëputjen e Partisë e të rinisë nga BS.

Veprimtaria armiqësore në rini dhe sabotimi i punës së rinisë.

**Propozimi për federatën Ballkanike.**

**Propozimi për Bashkimin e Shqipërisë me Jugosllavinë (përgjegjia jonë).**

**Propozimi i Zllatiçit për marrëdhënie si me Beneluksin<sup>1</sup>.**

Marrëdhëniet me KQ të PKJ në Byronë Informativë ashpërsoheshin, por ne s'dinim ç'bëhej atje.

Lufta e demokratëve grekë (qëndrimi ynë dhe i jugosllavëve).

**Lidhjet ushtarake, bashkimi i ushtrisë.** Komanda e përbashkët, armatimet, rregulloret (luftë kundër këshilltarit sovjetik, kundër meje, Mehmetit, Hysniut etj.).

**Puna e gjeneralit Kupreshanin dhe propozimi për dërgimin e divizioneve të ushtrisë jugosllave në Shqipëri.**

**Kërkesa e Rankoviçit për dërgimin e divizionit të ushtrisë jugosllave. Qëllimi.**

**Kundërshtimi ynë. Kritikkat e Zllatiçit.**

**Largimi i oficerëve jugosllavë.**

---

<sup>1</sup> Beneluks — Emërtimi i shkurtuar i bashkimit ekonomik midis Belgjikës, Hollandës dhe Luksemburgut, i krijuar në vitin 1944.



**Prerja e marrëdhënieve.** Letrat e VKPB [PK (b) e BS]

**Pse ne u solidarizuar plotësisht me Inform Byronë.**  
**Konkluzioni i gjithë kësaj periudhe dhe vlerësimi i çështjes jugosllave në dritën e këtyre fakteve.**

**Periudha e prishjes së marrëdhënieve.**

— Jugosllavët vazhduan veprimtarinë armiqësore kundër vendit tonë. Mbrojtja jonë.

**Periudha e përmirësimit të marrëdhënieve.**

— Dëshira jonë ishte të përmirësoheshin marrëdhëniet.

**Përse ne kërkuam që të mbledhej Byroja Informative para se të shkonte delegacioni sovjetik në Beograd?<sup>1</sup>**  
 Me qëllim që të thoshim edhe ne fjalën tonë (p.sh. Dezhinuk e dinte si ishin zhvilluar marrëdhëniet tona me Jugosllavinë).

**Ne mendonim dhe mendojmë se të dy palët në rrugën marksiste duhet të njihnin gabimet.** Kjo u bë në mënyrë të njëanshme. Ç' rezultoi? Jugosllavëve iu bënë lëshime parimore në këtë çështje. Atyre iu rrit mendja. Megjithëse kishin gabuar rëndë fajin na e hodhën neve. Qëndrimin tonë të drejtë e përdorën si armë për të vazhduar luftën kundër nesh.

Ne u ndernim dorën, ata na shanin, na diskredito-

---

<sup>1</sup> Në maj të vitit 1955, KQ i PPSH i dërgoi një letër KQ të PK të BS me anën e së cilës u shpreh kundër vajtjes së Hrushovit në Jugosllavi dhe kundër rehabilitimit të udhëheqjes jugosllave. Ai kërkoi që shqyrtimi i këtyre çështjeve të bëhej në një mbledhje të partive pjesëmarrëse të Byrosë Informative, ku të ftohej edhe PPSH për të thënë fjalën e saj.

nin, bënin punë agjenturale si më parë, gjoja nën parullën e pajtimit.

Kongresin XX ata e shfrytëzuan për të na luftuar. Kongresi III i PPSH — qëndrimi ynë.

Ne kemi pasur durim për dy vjet me radhë, por ishim të sigurtë se koha do të na jepte të drejtë.

**Komploti kundër Partisë dhe shtetit tonë.**

Përpjekjet për të rrëzuar udhëheqjen e Partisë sonë dhe për shkëputjen e Shqipërisë nga kampi socialist.

— Konferenca e Tiranës — Puna agjenturale.

Dali Ndreu, Liri Gega, Tuk Jakova.

— Fjalimi i Titos në Pula zbuloi haptazi qëllimet e tyre.

— Sulmet e titistëve në lidhje me Hungarinë.

— Sulmet e Vidiçit<sup>1</sup>.

Ç'i shtyn jugosllavët kundër vendit tonë?

Pikëpamjet antimarksiste, shoviniste. Marrja e masave nga ana jonë.

(Si e priti Partia dhe populli ynë përgjegjen që u dhamë udhëheqësve jugosllavë).

Si është situata te ne. Zgjedhjet e fundit provë e madhe e unitetit Parti-popull.

Thëniet e Goshnjakut lidhur me grumbullimin e

<sup>1</sup> Nënsekretari i shtetit për punët e jashtme i RFPJ Dobrivoje Vidiç në kohën e zhvillimit të kundërrevolucionit në Hungari u deklaroi atashëve të shtypit të Bullgarisë, Shqipërisë, Çekoslovakisë etj., se ato që ndodhën në Hungari do të ndodhnin patjetër edhe në vendet e tjera socialiste.

trupave jugosllave në kufirin hungarez dhe qëllimi i tyre<sup>1</sup>. Masat që ne do të marrim në qoftë se ata veprojnë si tha Goshnjaku.

Mendimi ynë për kërkesën e armëve që i ka bërë Jugosllavia Bashkimit Sovjetik.

A mund të thuhet se jugosllavët mbrojnë çështjen tonë kur ata bëjnë pjesë në Paktin e Ballkanit dhe luftojnë kundër partive marksiste-leniniste dhe kampit socialist?

Ne s'kemi besim se në Jugosllavi shkohet drejt ndërtimit të socializmit. Udhëheqësit jugosllavë janë revizionistë; diversion në lëvizjen komuniste. Veprimtaria e tyre revizioniste duhet demaskuar ideologjikisht.

Qëndrimi ynë i ardhshëm dhe lidhjet me jugosllavët.

## II

### ÇËSHITJA HUNGAREZE

Çështja hungareze na ka preokupuar dhe interesuar shumë si vend mik, aleat dhe pse ne e lidhnim atë çka ndodhte atje me Jugosllavinë.

**Përshtypja jonë e përgjithshme për Hungarinë jo e mirë.**

---

<sup>1</sup> Sekretari i shtetit për mbrojtjen i RFPJ, Ivan Goshnjak, deklaroi më 23 nëntor 1956 se gjatë ngjarjeve në Hungari trupat e ushtrisë jugosllave ishin grumbulluar në kufirin hungarez dhe ishin gatë për ndërhyrje.

Mungonte uniteti i mendimit dhe i veprimit në parti. Këto përshtypje ua komunikuam shokëve hungarezë. Na siguruan se punët do të shkonin më mirë.

U gjendëm krejtësisht të shkëputur kur u zhvilluan ngjarjet në Hungari. Telegrami i KQ të PK të BS në lidhje me gjendjen në Poloni nuk u shoqërua me sqarim të mëtejshëm. Në Hungari plasi kundërrevolucioni, Ushtria Sovjetike nuk ndërhynte, pastaj ndërhyri, u tërhoq nga Budapesti dhe prapë ndërhyri.

Ne duhej t'i lidhnim ngjarjet në Poloni e në Hungari dhe i lidhëm. Mendojmë se janë të njëjta, me nuanca dhe përjashtime të ndryshme.

**Ç'mendojmë ne për ngjarjet në Hungari.**

**1. Gabimet e udhëheqjes kanë influencuar.**

Këto gabime i njohim pak, për të mos thënë aspak.

- a) Gabimet ekonomike. Gabime të tilla ka pasur dhe në vende të tjera, por janë ndrequr.
- b) Shkelja e ligjshmërisë. Në qoftë se janë lejuar shkelje, ato duhej të ndreqeshin menjëherë. Mendojmë se shokët hungarezë këtë s'e bënë si duhet. Si u procedua në rehabilitimin e Rajkut nuk e dimë, por organizimin e funeralit për varrimin e eshtrave të tija e quajmë gabim.
- c) Dobësia në parti dhe përgjegjësia e udhëheqjes.

Qëndrimi i partisë ndaj Nagit është i pafalshëm.

Në përgjithësi jemi dakord me analizën që i bënte gazeta «Pravda» gjendjes në Hungari, por kemi dhe rezervë përse u përket gabimeve të Rakoshit dhe Geros.

S'jemi në një mendje me «Pravdën» kur thotë se Titua i ka bërë një analizë të mprehtë çështjes hungareze.

2. **Puna minuese e udhëheqjes jugosllave**, jo vetëm kundër Rakosh-Geros, por kundër gjithë situatës në Hungari, kundër gjithë sistemit, siç e quajnë ata.

**Këto të dyja janë arësytet që kontribuan dhe i lanë fushë kundërrevolucionit dhe fashizmit.**

**Për ne puna minuese e jugosllavëve është arësyeja kryesore e kësaj gjendjeje. Ata kërkonin:**

- a) Diskreditimin e udhëheqjes.
- b) Sjelljen në fuqi të njerëzve të tyre.
- c) Diskreditimin e vijës së mëparshme hungareze — politike, ekonomike, shoqërore.
- d) Shkëputjen e Hungarisë nga kampi ynë, nga Bashkimi Sovjetik dhe nga Traktati i Varshavës.
- e) Zhvillimin e Hungarisë në rrugën e Jugosllavisë, nën influencën e saj, dhe shndërrimin në një vend agrar dhe hambar për Jugosllavinë.

Kjo ishte në interes të reaksionit ndërkombëtar, këtë kërkonte të bënte dhe imperializmi me vendet socialiste.

**Largimin e Rakoshit nga udhëheqja e quajmë gabim.** Pas largimit të tij udhëheqja hungareze u çorientua dhe veprimet e saj kontribuan, me ndërgjegje ose pa ndërgjegje, që të arriheshin këto rezultate.

**Udhëheqësit hungarezë** qoftë nga frika, qoftë nga besimi, kishin mendimin se çdo shpëtim do t'u vinte nga Titua, nga bisedimet që do të bëheshin me Titon.

**Këtë përshtypje na lanë më vonë edhe telegramet tuaja mbi bisedimet që janë bërë me Titon në Brioni**

dhe në Jalta, për çështjet hungareze, për udhëheqësit dhe udhëheqjen hungareze.

Ne nuk e kuptojmë pse ishte kjo frikë ndaj udhëheqjes jugosllave dhe ky besim te Titua, sa t'u lihej atyre të vendosnin për fatin e një vendi socialist dhe pjesëtar i Traktatit të Varshavës.

**Nuk e kuptuam dhe nuk e kuptojmë** as tash përse Titua është marrë si arbitër për çështjet hungareze, kur shohim se vërejtjet tona modeste as që u përfillën, megjithëse jemi një vend pjesëtar i kampit socialist, dhe çështja e Hungarisë, sido që s'kemi asnjë pretendim se ne do ta ndreqim situatën, na dhimbsej më shumë neve se jugosllavëve.

**Siç rezultoi më vonë**, ju jeni konsultuar me partitë e tjera të vendeve të demokracisë popullore për çështjen hungareze, kurse Partinë tonë e keni lënë mënjanë. Edhe këtë nuk e kuptojmë dhe sigurisht e quajmë jo të drejtë, veçanërisht kur çështja hungareze lidhet kaq ngushtë me jugosllavët dhe jugosllavët me ne.

**Ç'mendojmë ne për ndërhyrjen e Ushtrisë Sovjetike.**

**E drejtë, por të ndërhynte një herë e mirë dhe të bënte spastrim radikal, duke mbështetur shokët hungarezë të pastër, marksistë, internacionalistë, pro kampit socialist, pro partisë së tyre.**

**Mendojmë se këtu ka pasur lëkundje, hezitime.** Titua ka luajtur rolin e vet.

**Ç'mendojmë për diskreditimin e udhëheqjes Rakosh-Gero.**

Mendojmë se në këto momente ka qenë gabim. Së bashku me ta:

a) U godit e gjithë vija.

b) U goditën udhëheqësit dhe me mijëra kuadro besnikë.

Kjo vështirësoi situatën aktuale. Situata paraqitet e vështirë edhe për të ardhshmen, pse ndërhyrjet e Titos dhe të reaksionit do të vazhdojnë. Kundër tyre duhet të luftohet me këmbëngulje dhe këtë nuk mund ta bëjnë veçse kuadrot e vjetër të partisë, pra ata pro Rakoshit dhe Geros etj.

**Mendimi ynë për qeverinë e Kadarit dhe për vetë Kadarin.**

— Bashkëpunimi i tij me Nagin.

— Deri ku është i lidhur ai me udhëheqësit jugosllavë?

— Sa do të dijë ai ta organizojë partinë dhe të bashkojë komunistët?

Qëndrimi ynë ndaj Nagit.

Çështja e ndërhyrjes jugosllave (Goshnjaku).

### III

#### ÇËSHTJA POLONEZE

**Përshtypja jonë në mbledhjen e Këshillit Ekonomik dhe gjykimi i përgjithshëm i çështjes<sup>1</sup>.**

<sup>1</sup> Në mbledhjen e Këshillit Ekonomik të vendeve socialiste përfaqësuesit e Polonisë deklaruan se do të ulin tempet e zhvillimit të industrisë së rëndë sidomos të asaj minerale me pretekstin se zhvillimi i saj gjoja kishte keqësuar gjendjen ekonomike të punëtorëve të minierave.

Fjalimi i Cirankieviçit në Sejm<sup>1</sup>.

**Procedurën që polonezët** ndoqën për punimet e materialeve të Kongresit XX ne nuk e aprovuam — përshlypjet që ajo krijoi.

**Vajtja e Bulganinit dhe e Zhukovit**, sido që s'patëm asnjë informatë, na ngrohu pak dhe shpresuam se punët po rregulloheshin.

**Telegrami njoftonte vajtjen e delegacionit dhe asnjë sqarim tjetër.**

**Çdo gjykim yni është i bazuar mbi të dhënat e shtypit.**

Për Poloninë kemi heshtur, por s'jemi dakord për ç'ka ngjarë dhe si zhvillohen punët atje.

**Rruga që ndoqi dhe që ndjek Polonia s'është një rrugë e drejtë marksiste, është nacionaliste.**

**Rehabilitimi i Gomulkës** u shndërrua në akuzë kundër Bjerutit, domethënë ndërtimi i socializmit në Poloni në format e mëparshme paska qenë «i gabuar», «i gabuar» paska qenë kolektivizimi i bujqësisë dhe krijimi i industrisë polake.

**Ne mendojmë se gabime mund të kishte pasur**, por prishjen e kooperativave dhe kritikën kundër ngritjes së industrisë së rëndë etj., ne nuk mund t'i kuptojmë dhe nuk mund të jemi dakord me to.

**U hapën të gjitha burgjet me pretekstin pse qenka**

---

<sup>1</sup> Në mbledhjen e Sejmimit që u mbajt në 24 tetor 1956 me-njëherë pas Plenumit VIII të KQ të PPB të Polonisë, Cirankieviçi, kryeministër i Polonisë në atë kohë, mbrojti tezat revizioniste të këtij plenumi.



shkelur ligjshmëria. Ne nuk mund ta besojmë që të jetë shkelur kaq rëndë ligjshmëria socialiste.

Ta kuptosh rolin e partisë ndryshe nga përcaktimi i Leninit, këtë s'e pranojmë.

Të pranohen gjithë kundërrevolucionarët që vijnë nga jashtë, kjo është të futësh zjarrin në shtëpi.

Qëndrimi ndaj fesë, futja e saj zyrtarisht në shkolla e gjetkë as në një demokraci borgjeze s'është bërë në këtë shkallë. Të vijë në fuqi një udhëheqje gjoja marksiste, me parulla ultrademokratike, që në të vërtetë janë antisocialiste, me pretekstin se populli paskej humbur lirinë dhe sovranitetin, të cilat ia kishte shkelur BS, kjo është armiqësore. Prandaj udhëheqja aktuale poloneze për ne është antimarksiste, jointernacionaliste dhe fjalët për marrëdhënie me BS dhe vendet socialiste janë false. Polonia po shkon në rrugën e shkëputjes nga kampi ynë.

Polonia po shkon në rrugën e Jugosllavisë, në rrugën e lidhjeve graduale me impërialistët. Ata pajtohen me reaksionin e brendshëm dhe të jashtëm dhe shkojnë drejt degjenerimit të regjimit socialist. Ata janë socialshovinistë, socialdemokratë, pra jomarksistë e jointernacionalistë.

*Botohen për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## TA RUAJMË UNITETIN TONË TË FORTË PSE KY ËSHITË JETIK

*Nga raporti i mbajtur në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi bisedimet që u zhvilluan në Moskë midis delegacionit të PPSH dhe udhëheqësve të PK të BS»<sup>1</sup>*

3 janar 1957

Në këtë mbledhje të Byrosë Politike menduam të raportojmë mbi rezultatet e bisedimeve të delegacionit tonë me udhëheqjen e PK të BS.

Në radhë të parë, dëshiroj të theksoj se kudo që shkuam u tregua një dashuri dhe besim shumë i madh ndaj Partisë sonë.

---

<sup>1</sup> Siç u diskutua dhe u vendos në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH, që u zhvillua më 13 nëntor 1956, shkoi në Moskë delegacioni i PPSH i kryesuar nga shoku Enver Hoxha. Delegacioni i PPSH shtroi para udhëheqjes sovjetike probleme politike që lidheshin me ngjarje që rodhën pas Kongresit XX, çështjen e Jugosllavisë, të kundërrevolucionit në Hungari dhe të gjendjes në Poloni. Gjatë bisedës, udhëheqja sovjetike në dukje bëri përpjekje për të zbutur dhe për të justifikuar gabimet dhe qëndrimet e saj oportuniste. Nuk mungoi edhe presioni e arroganca e Hrushovit për të shtypur kritikën e drejtë të

Pritja jonë filloi që në Odesë, ku ne u takuam dhe zhvilluam bisedime të shkëputura me ata që kishin dalë për të na uruar mirëseardhjen. Por, natyrisht, rëndësi kanë bisedimet tona me shokët e Presidiumit të KQ të PK të BS, në të cilat ne shtruum gjerë e gjatë dhe hollësisht pikëpamjet e Partisë sonë, ashtu sikurse na kishte porositur Byroja Politike.

Që në fillim të bisedës me udhëheqjen sovjetike ne kërkuam që, brenda mundësive, të sqarohemi mbi situatën ndërkombëtare të krijuar kohët e fundit. Konkretisht ne u thamë se duam të bisedojmë tri çështje: çështjen jugosllave, hungareze e poloneze. Për të tria këto çështje ne, siç ramë dakord në Byro<sup>1</sup>, shtruum pikëpamjet e PPSH se si i interpreton ajo këto ngjarje, çfarë qëndrimi ka mbajtur dhe ç'qëndrim mendon të mbajë në të ardhshmen. Theksuam se për këto çështje ne kemi edhe propozimet tona.

Pa hyrë akoma në thelbin e çështjeve, për të cilat shkuam të bisedojmë në Moskë, ne i thamë udhëheqjes sovjetike se përse kërkojmë të sqarohemi me të. Theksuam se ç'është BRSS për popullin dhe për Partinë tonë dhe se nuk na vjen mirë që për disa çështje parimore të mos kemi pikëpamje të njëjta. Por ne nuk mund të

---

PPSH, por shoku Enver me gjakftohtësi dhe guxim vazhdoi t'i parashtrrojë udhëheqjes sovjetike pikëpamjet e PPSH. Kjo e shqetësonte klikën e Hrushovit, e cila u përpoq të marrë me të mirë delegacionin e PPSH, duke bërë lajka e një radhë prem-timesh për ndihma ekonomike.

<sup>1</sup> Shih diskutimin në Byronë Politike më 13 nëntor 1956 dhe «tezat» e bisedimeve të delegacionit të PPSH në Moskë më 25 dhe 26 dhjetor 1956 botuar në këtë vëllim f. 131, 156.

rrimë pa i thënë mendimet tona. Këtë pozitë të drejtë dhe të hapur të Partisë sonë ndaj PK të BS dhe BRSS ne nuk kemi frikë ta fshehim nga armiqtë tanë të përbashkët.

Duke shprehur ndjenjat e dashurisë që ushqejnë populli ynë dhe Partia jonë për Bashkimin Sovjetik, ne u thamë atyre se në bisedim me ta do të flasim si shokë, si marksistë, si internacionalistë, pa formula diplomatike dhe theksuam se kështu duhet ta shohin Bashkimin Sovjetik të gjithë ata që i thonë vetes marksistë-leninistë. Kush dëshiron të mbulojë dashurinë ndaj BRSS nën pretekstin se mos imperialistët e akuzojnë si sate-lit të BRSS, mendojmë se gabon, sepse për imperialistët është njësoj, i thua hapët ose tërthorazi mendimet ndaj BRSS, ata prapëseprapë të akuzojnë duke thënë se «je i varur nga Bashkimi Sovjetik». Disa njerëz që tremben se mos akuzohen si të varur nga Bashkimi Sovjetik dhe nuk flasin sinqerisht me të, këtë e bëjnë për të fshehur jointernacionalizmin, por antimarksizmin e tyre. Prandaj, në rast se fshihet qëndrimi i vërtetë është më keq, sepse dëmtohet më shumë çështja jonë.

Ne mendojmë se në çdo kohë, po sidomos tani, BRSS duhet të mbrohet nga të gjithë e me të tëra forcat. Këtë e themi jo se BRSS është i dobët dhe ka nevojën e ndihmës sonë, po sepse në këtë situatë është e nevojshme si kurdoherë ndihma e përbashkët, prandaj ne mendojmë se kjo është një çështje kryesore, vendimtare. Kur mbrojmë BRSS, ne mendojmë se kemi mbrojtur Partinë dhe popullin tonë, kemi mbrojtur marksizëm-leninizmin, socializmin. Prandaj, vumë në dukje, se ne, me zemër të hapur, çdo gjë do t'ia themi

Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, sepse nuk kemi tjetër kujt t'ia qajmë hallet tona, dhe mendimet tona, të drejta ose të gabuara, të ëmbla ose të tharta, duhet t'i themi, pasi këto gjëra që ngjasin kanë një rëndësi të veçantë për Partinë dhe vendin tonë. Këtë e themi jo se vendi ynë luan ndonjë rol të madh në problemet ndërkombëtare, sepse ne jemi një vend i vogël, po duhet të marrim parasysh pozitën e Shqipërisë, që është shumë delikate. Prandaj, kur Partia jonë mban këto qëndrime, në rast se nuk kemi të drejtë, duhet të na thuhet haptazi dhe të bindemi përse.

Pasi thamë këto fjalë, hymë në temën e bisedimit.

Ne i thamë udhëheqjes sovjetike se Partia dhe populli ynë interesohen për të gjitha çështjet e kampit tonë. Neve na interesojnë edhe problemet e tjera që ngjasin në botë, po më shumë dëshirojmë të bisedojmë për çështje që kanë të bëjnë me disa nga vendet e kampit të socializmit<sup>1</sup> dhe çështje që janë të lidhura me Traktatin e Varshavës.

Sigurisht roli i vendit tonë në Traktatin e Varshavës është i vogël, por megjithatë kemi të drejtë të themi se si pjesëtarë të këtij traktati mendojmë se duhet të jemi me doemos në dijeni të të gjitha çështjeve. Këtë e themi sepse duam të dimë se si është puna që ne nuk u njofuam fare përse ndodhën të gjitha këto ngjarje në Hungari e gjetkë, të cilat kanë karakter të rëndësishëm ndërkombëtar dhe janë të lidhura me kampin tonë të socializmit. Ne themi se kemi qenë të izoluar dhe të painformuar. Ne jemi vënë shumë pak në dijeni, vetëm

---

<sup>1</sup> Është fjala për Hungarinë e Poloninë.

nëpërmjet disa telegrameve të këmbyera midis jush dhe Titos. Kemi mendimin se nuk do të ishte gabim në rast se do të ishim më mirë të informuar edhe ne.

Duke thënë këto fjalë, ne shfaqëm edhe mendimin se në këto situata duhet të ishte mbledhur Këshilli Politik i Traktatit të Varshavës. Këtë e themi se të gjitha këto qëndrime politike dhe masa që janë marrë në këto situata të vështira dhe të ndërlikuara na duken si të shkëputura dhe do të ishte më mirë të zhvilloheshin konsultime. Në rast se këto konsultime midis KQ të PK të BS dhe partive të tjera janë bërë, ndërsa Partia jonë është lënë mënjanë, kjo nuk është aspak e drejtë dhe ne e quajmë gabim<sup>1</sup>. Për këtë ne bazohemi në fjalët e Shepillovit, i cili ka thënë se këto çështje janë biseduar në mbledhje e konsultime.

Partia jonë mendon se në momentet që kalojmë janë të domosdoshme qëndrime të njëjlojta, ndryshe mund të bëhen gabime, sepse dikush mund ta shkelë gazin shumë, disa mund të jenë të matur dhe disa të mos e shkelin gazin fare. Në rast se ne nuk konsultohemi për qëndrimin e njëjlojtë që duhet të mbajmë, atëhere armiku mund të mendojë se midis nesh ka përçarje dhe kështu nuk paraqitet si duhet realiteti, që ne

<sup>1</sup> Faktet tregonin se Hrushovi nuk donte të konsultohet me PPSH për shkak se e dinte pak a shumë qëndrimin e PPSH ndaj udhëheqjes jugosllave. Kurse ai kishte gjetur një gjuhë të përbashkët me Titon me të cilin bashkëpunonte ngushtë dhe koordinonte veprime që në fakt ishin kundërrevolucionare. Kështu për shembull udhëheqja sovjetike nuk ishte më pak përgjegjëse se klika e Titos për përgatitjen e kundërrevolucionit në Hungari dhe pas disfatës u mundua me çdo mënyrë të mbulonte gabimet dhe fajet e saj të rënda.

jemi të fortë, të bashkuar, me pikëpamje të njëjta, të cilat na bëjnë ne të jemi akoma më të bashkuar dhe shumë më të fortë. Atëhere, kur çështja është kështu, përse të mos e tregojmë forcën tonë, përse të mos dalim me pikëpamje të njëjta, përse të mos konsultohemi me njëri-tjetrin?

Në lidhje me këto ngjarje u thamë atyre: na lejoni të themi edhe ne pikëpamjen e Partisë sonë. Ne dëshirojmë që më parë ta fillojmë bisedimin nga çështja jugosllave, sepse kjo çështje ka një rëndësi të madhe për socializmin, për unitetin e kampit dhe veçanërisht për vendet tona.

Marrëdhëniet e Partisë dhe të popullit tonë me Jugosllavinë ne ia kemi vënë në dukje me hollësi udhëheqjes sovjetike. Por ju lutemi kini durim që do të bëjmë edhe një herë përsëritjen e këtyre çështjeve. Këto që do të themi janë të bazuara, reale, të faktuara dhe nuk janë shtyrë nga pasione, si mund të mendojë ndonjë, nuk janë mendime subjektive, as çështje regjionale, por janë çështje parimore të koklavitura që mendojmë se i përkasin kampit të socializmit.

U folëm shokëve sovjetikë mbi organizimin e fraksionit, punën e Velimir Stojnićit, të Koçi Xoxës etj., përgjegjësinë e titistëve për vetëvrasjen e Nakos, persekutimin e shokëve në Plenumin VIII, likuidimin e shokëve të tjerë të udhëheqjes me anë të përgatitjes së dosjeve, qëllimin për ta bërë Shqipërinë një regjim kolonial të tyre, sabotimin e naftës, të bujqësisë, të tregëtisë, treguam karakterin e shoqërive të përbashkëta, qëllimet në planifikim, për parifikimin e monedhës, heqjen e doganës, për të mos pasur marrëdhënie me

vendet e tjera, veç Jugosllavisë; u thamë si na trajtuan jugosllavët kur ne përfundam një marrëveshje me BRSS dhe me Bullgarinë etj. Pastaj u përmendëm se të gjitha këto synonin bashkimin e Shqipërisë me Jugosllavinë dhe u treguam dokumentin e Boris Kidriçit, që flet për konsiderimin e Shqipërisë si «republikë e shtatë».

Folëm pastaj për lidhjet ushtarake, për qëllimet e jugosllavëve që donin të likuidonin vendin tonë me anën e komandës së përbashkët, armatimit, aplikimin e rregulloreve ushtarake jugosllave, luftës kundër meje, Mehmetit dhe Hysniut<sup>1</sup>, për ardhjen e divizioneve jugosllave në Shqipëri, për likuidimin e Partisë dhe të in-dipendencës së vendit tonë. Dhe kjo gjë u vërtetua më vonë: sulmi kundër Shqipërisë u bë nëpërmjet provokacioneve të gushtit nga monarko-fashistët grekë më 1949. Këtë sulm ushtria jonë e përballoi me heroizëm.

Kjo përgatitje e jugosllavëve, ne mendojmë se nuk kishte për qëllim vetëm likuidimin e vendit tonë, por ishte edhe një përgatitje për një provokacion të madh me karakter ndërkombëtar. Kjo duket qartë në faktin se jugosllavët janë lidhur me një pakt me qeverinë e Greqisë që i bëri varrin ushtrisë demokratike greke. Pra këtu kemi një intrigë të madhe ndërkombëtare.

Këto i lidhëm edhe me fjalët e Goshnjakut, i cili pohoi vetë me gojën e tij se në kufi të Hungarisë jugosllavët kishin grumbulluar ushtri për të ndërhyrë në Hungari; u thamë shokëve sovjetikë se Partia jonë i konsideron ata provokatorë të mëdhenj në shkallë ndërkombëtare, sepse një akt i tillë donte të thoshte luftë,

<sup>1</sup> Shih «tezat» e bisedimeve të delegacionit të PPSH në Moskë më 25 dhe 26 dhjetor 1956 botuar në këtë vëllim, f. 156.



pasi shkelej Traktati i Varshavës dhe ne patjetër do të hynim në luftë kundër tyre, për ndërhyrjen që do të bënin.

Partia jonë mendon se qëndrimi dhe masat tona në lidhje me këto çështje kanë qenë të drejta dhe duhet të kemi kujdes se derisa ata ishin gati për një provokacion të tillë në shkallë ndërkombëtare, një hap si ky mund ta përsëritin edhe kundër vendit tonë, sepse në Jugosllavi klika e Titos mban shumë fashistë shqiptarë. Nuk përjashtohet mundësia që këta tradhëtarë, jugosllavët mund t'i futin një ditë në vendin tonë dhe pas tyre ndërhyjnë edhe ushtria jugosllave, gjoja me parullën për të shpëtuar socializmin në Shqipëri.

Goshnjaku kërkon armë nga BS. Ne mendojmë se Jugosllavisë nuk duhet t'i jepet asnjë armë, sepse do të jetë një tragjedi e madhe që populli shqiptar të vritet nga tanket dhe aeroplanët e ndërtuar në Bashkimin Sovjetik. Jugosllavia kërkon të mbrohet me këto armë, po nga kush? Ata e dinë se kampi ynë nuk i sulmon. Frikën jugosllavët duhet ta kenë nga vendet kapitaliste. Atëhere nëse është kështu, le të shkëputen fare prej tyre dhe kampi ynë do t'i sigurojë edhe me armë. Po Partia jonë mendon se këto armë atyre u duhen kundër nesh, sepse Titua është i lidhur me imperializmin nëpërmjet të ashtuquajturit Pakt të Ballkanit. Ai me të gjitha partitë tona është në luftë, ai është në luftë me PK të BS, me Partinë tonë, ai ka qenë edhe është kundër të gjitha partive komuniste. Këto fakte vërtetojnë se klika e Titos është e lidhur me imperialistët dhe të gjitha këto qëndrime që mbajnë ata janë blofe, janë për të përfituar kohë.

U folëm përse ne u solidarizuar plotësisht me Rezolutën e Byrosë Informative, sepse ne i quajtëm plotësisht të drejta gjithshka thuhej atje për Jugosllavinë; për ne çështjet që ngriheshin në rezolutë ishin të bazuara, ne i kishim provuar poshtërsitë e tyre mbi kurrizin tonë.

Megjithatë u thamë se jemi për përmirësimin e marrëdhënieve me Jugosllavinë vetëm në rrugën marksiste-leniniste. Mirëpo Partia jonë mendon se në këtë drejtim janë bërë gabime parimore. Jugosllavët jo vetëm nuk bëjnë autokritikë për gabimet e tyre të rënda, por po vazhdojnë në rrugën e gabuar dhe ndaj tyre po bëhen lëshime.

Po ç'ngjau duke bërë këto lëshime? Atyre u është rritur më shumë mendja duke menduar se nuk kishin gabuar<sup>1</sup>. Ne u nderëm dorën sinqerisht jugosllavëve, po ata, gjatë gjithë kësaj periudhe, kanë vazhduar të na shajnë e diskreditojnë. Ata kanë shkruar plot artikuj, kanë botuar karikatura kundër nesh dhe vazhdojnë, si edhe më parë, punën e tyre agjenturale. Të gjitha këto ata i bëjnë duke përfituar nga rruga që po ndiqet me ta për pajtim.

Në vazhdim, u shpjeguam se si udhëheqja jugosllave ka shfrytëzuar Kongresin XX të PK të BS dhe çështjen e kultit të individit të Stalinit. U folëm për Kongresin III të Partisë sonë, ku çështja jugosllave u shtrua siç na

---

<sup>1</sup> Në këtë drejtim, ndikoi shumë edhe qëndrimi i Hrushovit, i cili, kur shkoi në Jugosllavi në maj të vitit 1955, pa marrë pëlqimin e partive të tjera, pranoi të përulet përpara Titos duke deklaruar se «ishin kryer gabime të rënda kundrejt PKJ dhe udhëheqjes jugosllave»(!).

këshilloi udhëheqja sovjetike, natyrisht duke mos pranuar të rehabilitohet Koçi Xoxe dhe veprimtarinë e tyre ndaj nesh, por duke pranuar përmirësimin e marrëdhënieve në rrugë shtetërore. Në këtë drejtim ne jemi tërëguar të duruar dhe gjakftohtë. Megjithatë, jugosllavët vazhduan dhe organizuan komplotin kundër shtetit dhe Partisë sonë. Pra, ata kanë po ato qëllime që kanë pasur përpara 1948-s kundër Shqipërisë, për likuidimin e saj. Me këtë rast ne u folëm pak për Konferencën e Partisë të qytetit të Tiranës si dhe për grupin agentural të Dali Ndreut, Liri Gegës dhe të Petro Bullatit, për fjalimin e Titos në Pula, për sulmin e Vidiçit dhe për qëllimin e jugosllavëve me këto sulme. Për këto çështje ne morëm masa, u thamë shokëve sovjetikë, Titos iu përgjegjëm. Sipas mendimit tonë përgjegjia që i dhamë atij ka një çikë terma të forta, po është e drejtë, ata e meritojnë një përgjegje të tillë për të gjitha ato që na kanë bërë.

Pastaj ne u shpjeguam se cili është qëndrimi i Partisë dhe i popullit tonë në këto situata të vështira. Kur ne u shprehëm haptazi për qëndrimin antimarksist të udhëheqjes jugosllave, populli u solidarizua dhe u bashkua më fort rreth Partisë. Shembull i këtij uniteti janë zgjedhjet e fundit të këshillave popullore, ku u duk edhe një herë se sa të lidhur janë midis tyre Partia dhe populli ynë, se si ata i kanë shqelmuar së bashku intrigat antimarksiste të jugosllavëve. Ne këto zgjedhje i bëmë për herë të parë me fletëvotimi.

Ne u folëm shokëve sovjetikë edhe për çështjen e Kosovës. U thamë se popullsia shqiptare në Jugosllavi

është mjaft e madhe. Në lidhje me këtë problem theksuam se Partia jonë ka mbajtur qëndrim internacjonalist, me durim dhe gjakftohtësi, sepse udhëheqja jugosllave që është antimarksiste, nacionaliste dhe shoviniste, me shqiptarët e Kosovës ndjek një politikë më të keqe nga ajo që kanë ndjekur krajlët serbë. U treguam se sa të ashpër dhe gjaksorë kanë qenë jugosllavët në Kosovë, ata kanë vrarë me mijëra kosovarë, bile edhe në tokën tonë, duke i quajtur ballistë. Po të mos kishte shkuar Ushtria jonë Nacional-Çlirimtare në Jugosllavi më 1944, atje do të ishte bërë gjakderdhje akoma më e madhe, po divizionet tona nuk e lejuan një gjë të tillë. Këtë politikë shfarosjeje ne e quajmë një genocid<sup>1</sup>. Kosovarët jo vetëm vriten, futen nëpër burgje dhe shpërndahen nëpër vende të ndryshme të Jugosllavisë, por klika e Titos po bën edhe krime të tjera të mëdha kundër tyre, duke i dërguar në Turqi, gjë që as Caldarisi nuk e ka bërë, sepse grekët, kur i persekutuan shqiptarët e Çamërisë më 1945, i hodhën në kufirin tonë, po nuk i vranë dhe as në Turqi nuk i dërguan, kurse jugosllavët po i shpërngulin. Në lidhje me këtë çështje, u thamë se ne kemi mbajtur qëndrim të drejtë dhe theksuam se kjo është një çështje shumë e rëndë, e cila duhet të ndalohej.

Në përfundim të fjalës sonë për çështjen jugosllave, në bazë të fakteve, ne u thamë si konkluzion se Partia jonë mendon që duhet të hiqet krejtësisht besimi ndaj Titos dhe klikës së tij, se ata janë antimarksistë, troc-

---

<sup>1</sup> Genocid (greqisht) — nga genos — racë dhe (lat.) caedo — me vra. Krim që bëhet me qëllim që të asgjësohet një grup kombëtar, etnik, racial ose fetar.

kistë, antileninistë. Ata duan të likuidojnë socializmin dhe kampin tonë, ata duan të sabotojnë unitetin e klasës punëtore ndërkombëtare në favor të imperializmit.

Pas këtij konkluzioni theksuam qëndrimin tonë ndaj Jugosllavisë duke u thënë: Ne nuk do të jemi shkaktarë të prerjes së marrëdhënieve, po do të përpiqemi të mbajmë marrëdhënie shtetërore dhe tregëtare në rrugë të drejtë marksiste-leniniste, po në asnjë mënyrë nuk do të kemi lidhje partie me ta, sepse ata nuk janë komunistë. Ne do t'u ruhemi provokacioneve të tyre, do të mbajmë gjakftohtësinë, Partinë e vendin tonë do t'i mbrojmë, përpjekjet e klikës së Titos, për të dobësuar situatën në vendin tonë, do t'i luftojmë dhe çdo provokimi që ata do të na bëjnë me anën e shtypit, do t'i përgjigjemi.

Tani t'ju informoj pak se çfarë biseduam për çështjen hungareze.

U thamë se kjo çështje na ka preokupuar shumë sepse Hungaria është një vend mik dhe aleat dhe se, përveç arsyeve të tjera, Jugosllavia ka një pjesë të madhe të përgjegjësisë dhe të organizimit të kundërrevolucionit në Hungari. Ne u thamë, gjithashtu, përshtypjet tona për Partinë e Punonjësve Hungarezë, të cilat ua kemi vënë në dukje edhe shokëve të KQ të Hungarisë. Theksuam se ishim shumë të shkëputur në lidhje me ngjarjet që u vërtetuan edhe në Hungari.

Pastaj folëm për Ushtrinë Sovjetike. Ne jemi dakord që Ushtria Sovjetike ndërhyri në Hungari dhe do të ishte mirë që këtë ta bënte dhe më përpara<sup>1</sup>. U thamë

---

<sup>1</sup> Në Hungari ndodheshin të vendosur trupa sovjetikë, por grupi i Hrushovit ngurronte t'i hidhte në voprlm për të

pastaj ç'mendonim ne për çështjen e Hungarisë, për Rakoshin, Geron, po duke u theksuar se ne s'dimë shumë gjëra, s'jemi të informuar konkretisht që të gjykojmë se sa janë përgjegjësitë e tyre. Por u thamë se na duket e çuditshme që Kadari e quan klika kriminale Rakosh-Gero, kurse ne e dimë që këta nuk janë të tillë, por janë elementë internacionalistë që e duan Bashkimin Sovjetik dhe komunizmin. Ne nuk i dimë gabimet e tyre deri në atë shkallë sa të cilësohen kriminelë. Nga ana tjetër, ne nuk dimë që nga ana ekonomike Hungaria të ketë qenë në një situatë serioze (edhe ata pohuan se situata ekonomike në Hungari nuk ka qenë e rëndë).

Ne nuk jemi dakord me analizën që ka bërë Titua për çështjen hungareze, sepse jugosllavët, mendojmë, kanë dorë në organizimin e kundërrevolucionit. Si kanë vepruar ata? Duke u bazuar në eksperiencën tonë, ne mendojmë se, në radhë të parë, jugosllavët janë përpjekur të diskreditojnë Rakoshin për të diskredituar bashkë me të vijën politike dhe ekonomike si dhe sistemin e demokracisë popullore në Hungari, ta shkëputin Hungarinë nga kampi ynë, nga Bashkimi Sovjetik dhe ta hedhin atë në fillim gjoja në pozita neutrale e më vonë, me forma të tjera, ta lidhnin me imperializmin. E gjithë kjo punë do të bëhej me qëllim që Hungaria të hynte në rrugën jugosllave, që Jugosllavia të bëhej udhë-

---

shtypur kundërrevolucionin. Vetëm përballë presionit të madh nga poshtë dhe sidomos kur pa se Hungaria po dilte jashtë sferës së ndikimit të tij, ai u detyrua më në fund të lejonte Ushtrinë Sovjetike të shkonte në ndihmë të mbrojtësve të revolucionit hungarez.

heqësja e këtyre vendeve, të cilat do të bëheshin edhe hambar për Jugosllavinë, ashtu sikurse ishte qëllimi ndaj Shqipërisë. Pra taktika e jugosllavëve është e njëjlojtë dhe kjo duhet të konsiderohet si një punë armiqësore e tyre për minimin e kampit të socializmit. Ne u thamë se këto gjëra nuk kanë si të ndodhin rastësisht, po janë të përgatitura dhe të organizuara që më parë.

U thamë gjithashtu se ç'mendojmë ne për qeverinë e Kadarit, kush është ai. Qëndrimi ynë ndaj tij ka qenë prudent, ne kemi folur për qeverinë e tij, por, në qoftë se ajo do të japë prova, ne do shohim e do bëjmë, mund të ndryshojmë qëndrimin tonë ndaj saj. U thamë edhe për qëndrimin tonë ndaj Imre Nagit, për Traktatin e Varshavës etj.

Pas Hungarisë folëm për çështjen e Polonisë. U thamë se duke mos e ditur mirë situatën, ndaj Polonisë kemi mbajtur një qëndrim shumë të rezervuar pasi na mungonin informatat, në muajin tetor kemi marrë vetëm një telegram për gjendjen e ndërlikuar që ishte krijuar në Poloni dhe një komunikatë. Pastaj treguam përshtypjen tonë nga mbledhja e Këshillit Ekonomik, për fjalinë e Cirankieviçit. U thamë shokëve sovjetikë se si është e mundur që të jetë marksiste-leniniste një udhëheqje, e cila vjen në fuqi me anën e një lëvizjeje anti-socialiste, proimperialiste, me parulla kundër Bashkimit Sovjetik, siç është udhëheqja polake me Gomulkën në krye? Kjo na duket e çuditshme. Të shohim kush është Gomulka. Ne dimë që ai ka bërë gjithë ato gabime për të cilat ka qenë edhe në burg. Ju lutemi, u thamë, na i tregoni si janë këto punë, se ne nuk kemi marrë asnjë

lajm. Ne u thamë se në Poloni janë hapur burgjet, janë liruar kriminelë, kisha polake ka marrë liri veprimi dhe mësimi i fesë po vihet në shkolla që as në shumë shtete borgjeze nuk e kanë. U folëm për tendencat antisocialiste në Poloni etj. Më në fund u thamë edhe një herë kush është Gomulka, nga sa e njohim ne, dhe ku po shkon Polonia dhe dyshojmë se mos edhe ajo shkon në rrugën e Titos.

Të gjitha këto shokët sovjetikë i dëgjuan me shumë vëmendje. Pasi folëm ne, dëgjuam edhe ata dhe, kur ishte e nevojshme, pyesnim ose thoshnim përsëri pikëpamjen tonë.

Duke biseduar me Hrushovin lidhur me çështjen e marrëdhënieve tona me Jugosllavinë, ai na tha që të kemi kujdes e të jemi gjakftohtë. Ne iu përgjegjëm se jemi përpjekur e do të përpiqemi të jemi gjakftohtë, por punën agjenturale të Titos nuk do ta lejojmë. E themi këtë sepse klika e tij nuk ka pushuar asnjëherë punën agjenturale kundër nesh. Të gjithë agjentët që kanë aktivizuar jugosllavët, kanë pasur tendencë të likuidojnë Partinë dhe pushtetin tonë popullor, ose të paktën, sipas tyre, ne të vihemi në pozita të tilla që të marrim masa të rënda administrative duke futur sa më shumë njerëz në burgje, me qëllim që në vendin tonë të krijohet një atmosferë e nderë. Edhe kjo është një taktikë që ndjekin jugosllavët.

Çështjen e masave administrative ne e kemi pasur dhe e kemi parasysh, përpiqemi të bëjmë diferencimin e nevojshëm duke përdorur, në radhë të parë, bindjen me njerëzit e popullit dhe masat administrative për armiq të, siç janë edhe agjentët jugosllavë.



Le të marrim çështjen e Dali Ndreut dhe të Liri Gegës. Këta të dy e kishin mbushur kupën dhe u tregova të gjithë historinë e tyre. Ata ishin agjentë të Titos, por dështuan në qëllimet e tyre, sepse u kapën në kufi dhe nuk mundën të arratiseshin. Sikur ata të kishin kaluar në Jugosllavi kjo do të ishte e rrezikshme, sepse Dali Ndreu ishte edhe gjeneral i ushtrisë sonë dhe dinte shumë gjëra, të cilat shtonin mundësitë e jugosllavëve për të organizuar një sulm kundër nesh. Prandaj si të mos merrnim masa kundër agjentëve të tillë?

Hrushovit i shtrua edhe çështjet ekonomike, ashtu sikurse kishim biseduar në Byronë Politike, si për çështjen e heqjes së triskave, ashtu dhe për çështjen e kredisë.

Përsa i përket gjendjes në Jugosllavi, kur biseduam me Suslovin, ai na tha: «Në lidhje me qëndrimet e fundit të udhëheqjes së LKJ, KQ i PK të BS po përgatit një letër për t'ia drejtuar asaj, e cila, pasi të aprovohet nga Presidiumi i KQ, do t'ju dërgohet edhe juve për dijeni».

Pastaj ata na pyetën si qëndron çështja e një dokumenti që u ka dhënë jugosllavëve një anëtar i KQ të Partisë së Punës të Shqipërisë. Këtë informatë të rreme atyre ua ka dhënë Titua, por ne u përgjegjëm se kjo është shpifje, s'është aspak e vërtetë. Në këtë rast shokët sovjetikë u skandalizuan dhe thanë se «këtë gjë do ta shënojmë në letrën që do t'i dërgojmë Titos».

Midis të tjerash drejtuam edhe këtë pyetje: Përse quhet klika kriminale Rakoshi-Gero dhe a ndihmon kjo në bashkimin e të gjithë komunistëve hungarezë? U

përgjegj Suslovi, i cili tha: «Gabimet e Rakoshit dhe të Geros krijuan në Hungari një situatë të vështirë në parti dhe në popull. Këto gabime ishin aq të rënda sa kishin krijuar një pakënaqësi të madhe në punëtorë e komunistë».

Mirëpo, meqënëse këto fraza sikur nuk na bindnin, kërkuam të dimë se cilat ishin konkretisht gabimet e Rakoshit e të Geros? Kësaj pyetje Suslovi iu përgjegj duke thënë: «Nuk ishin të lidhur me masat, nuk njihnin gjendjen e tyre, nuk kishin punuar sistematikisht për forcimin e partisë dhe për zbatimin e të gjitha normave leniniste të saja. Kanë bërë gabime në lëmin e ekonomisë, me gjithë këshillat që u janë dhënë nga ne. Pastaj në çështjen nacionale reaksioni ka luajtur një rol me rëndësi për të nxitur ndjenjat shoviniste të njerëzve, sepse mjaft hungarezë ndodhen në Rumani, në Jugosllavi dhe në Çekoslovakia dhe kjo e ka lehtësuar shumë punën shoviniste të reaksionit. Ka pasur edhe dobësi të theksuara në drejtim të edukimit politik dhe ideologjik, shkelje të rënda të ligjshmërisë socialiste». Ne përsëri kërkuam mundësisht të na jepej ndonjë shembull. Dhe atëhere Suslovi na dha si «shembull» Rajkun duke thënë se «ai u quajt spiun pa pasur dokumenta që ta vërtetonin këtë».

Atëhere ne shtruum pyetjen tjetër: A është biseduar ndonjëherë me Rakoshin, a janë këshilluar ata për këto që na thuhen edhe neve? Ata na u përgjegjën: «Rakoshi nuk pranon kurrë këshilla».

Një pyetje tjetër që bëmë ishte kjo: A mund të na thoni se ç'njeri është Kadari? Na u përgjegjën se «Kadari është njeriu më pozitiv në shokët hungarezë, nuk

është njeriu i Titos, tani ka mbështetjen e Ushtrisë Sovjetike dhe gradualisht në Hungari do të forcohet situata». Pastaj na rekomanduan që ne të shkruajmë në shtypin tonë shqiptar, sepse nuk kemi shkruar për Kadarin! Ne nuk e pranuan këtë mendim dhe u thamë se nuk jemi dakord me vlerësimin që ju i bëni Kadarit, i cili ka qenë me tradhëtarin Imre Nagi. Me sa pamë ne, pikëpamja e tyre ishte që Kadari duhet mbrojtur, sepse, sipas tyre, Titua lufton kundër qeverisë së tij.

Në përfundim të temës mbi Hungarinë shokët e udhëheqjes sovjetike na thanë se «ngjarjet hungareze na erdhën papritur. Çështjet duheshin zgjidhur me shpejtësi të madhe, konsultime me partitë e tjera nuk kishim mundësi të bënim». Këtu unë ndërhyra me pyetjen: Siç u gjend koha për t'u këshilluar me Titon, a nuk kishte mundësi të gjendej koha që të viheshim edhe ne në dijeni? Ata thanë: «Për Kadarin nuk u këshilluam me Titon, atij i thamë vetëm se nuk ka vend qeveria e Nagit». Pastaj ne përmendëm se në letrën e sovjetikëve flitet që ata kanë biseduar edhe për udhëheqjen hungareze dhe kërkuam të na shpjegojnë si është kjo çështje? Na u përgjegj Ponomarjovi, i cili tha: «Po, në letër është shkruar për këtë» dhe me kaq u mbyll edhe çështja hungareze.

Lidhur me Poloninë, gjithashtu, ne drejtuan pyetjen: Ç'mund të na thuhet që Gomulka ka hequr gjithë ata oficerë të mirë, miq të Bashkimit Sovjetik, të cilët po ndiqen? Lidhur me këtë Suslovi na tha: «Gomulka u mbështet te njerëzit që njihte dhe se nuk është ai fajtor që janë bërë gjithë ato gjëra. Edhe më përpara Gomulkës, edhe tani në Poloni ka njerëz më të ligj»

(bëri aluzion për Cirankieviçin, Moravskin dhe Zambrovskin<sup>1</sup>).

Kur ne pyetëm se si shpjegohen pikëpamjet dhe parullat antisovjetike në Poloni, Suslovi na tha: «Këto kanë ndodhur në mënyrë spontane, situata ishte shumë e acaruar dhe tani Gomulka po merr masa të stabilizojë gjendjen». Si shembull solli zëvendësimin e njerëzve jo të mirë në organet udhëheqëse të partisë «me njerëz të vjetër dhe të sigurtë», për shembull në Varshavë ka ardhur sekretar i parë i komitetit të partisë të qytetit ai që ishte përpara. Kështu është vepruar edhe në organe të tjera udhëheqëse të partisë.

Pas kësaj bëmë një pyetje tjetër: Si duhet ta konsiderojmë deklaratën e Gomulkës për kishën dhe për bujqësinë? Suslovi na u përgjeggj: «Gomulka erdhi në fuqi kur forcat e reaksionit patën fituar pozita dhe udhëheqja kishte humbur kontrollin mbi shtypin. Këtë qëndrim që ka mbajtur shtypi polak nuk e ka frymëzuar Gomulka. Ne nuk jemi dakord për shumë gjëra që ndodhin atje, po shihet se Gomulka po mban qëndrime të drejta<sup>2</sup>, pro kampit të socializmit, po përpiqet për forcimin e miqësisë me Bashkimin Sovjetik. Ai na nder dorën, prandaj ne nuk duhet ta shtyjmë te jugosllavët, duhet ta ndihmojmë të marrë në dorë fuqinë. Sa për kishën, kjo është një manevër përpara zgjedhjeve, prandaj ata po i japin gjoja rëndësi lirisë së klerit». Ne u

<sup>1</sup> Ish-anëtarë të Byrosë Politike të Partisë Punëtore të Bashkuar Poloneze, elementë revizionistë.

<sup>2</sup> Koha provoi drejtësinë e parashikimit të Partisë sonë se Gomulka ishte një revizionist, i cili, pasi u shtrydh si limoni nga ana e revizionistëve sovjetikë, u hodh në koshin e plehrave.

thamë se një gjë e tillë nuk është e drejtë dhe na duket shumë e rrezikshme.

Më në fund, Suslovi na tha: «Është e vërtetë se në Shqipëri nuk kemi ardhur, sepse te ju s'ka pasur ndonjë çështje urgjente, që nuk priste, po mos mendoni se ju kemi harruar. Hrushovi dhe Malenkovi kanë shkuar në të gjitha demokracitë popullore, me siguri do të vijë koha dhe ne do të vizitojmë vendin tuaj».

Dëshiroj t'ju them edhe disa vërejtje që u bëmë shokëve sovjetikë në lidhje me qëndrimet e gabuara të ambasadorit sovjetik në Tiranë, Krillov.

Së pari, u thamë se me rastin e 39-vjetorit të Revolucionit të madh socialist të Tetorit, u organizua në Tiranë një manifestim masiv prej 50-60 mijë vetësh. Ambasada sovjetike ishte lajmëruar me kohë për këtë manifestim. Po ç'ndodhi? Populli që manifestonte ka qëndruar më se gjysmë ore përpara ambasadës sovjetike, por asnjë prej punonjësve të saj nuk doli. Ka qenë zakon që në këto raste, ambasadorët e mëparshëm, si Çuvakini e Levickini të dilnin në ballkon të ambasadës dhe të përshëndetnin me dorë, por Krillovi nuk e bëri një gjë të tillë. Megjithkëtë, një delegacion që doli nga masa shkoi dhe hyri në ambasadën sovjetike për të uruar me rastin e festës. Në krye të delegacionit ishin sekretarët e komitetit të Partisë të Tiranës e shokë të tjerë. Krillovi u bë i sëmurë dhe nuk doli derisa manifestuesit u larguan.

Kur Mehmeti ia vuri në dukje shoqërisht këtë gjë Krillovit, ky i tha: «Nuk jam dakord që të zhvillohen demonstrata të tilla, sepse në turmë mund të ketë edhe

elementë armiq». Por Mehmeti me të drejtë iu përgjegj se në manifestime të organizuara nga Partia jonë nuk mund të ndodhë asgjë, sepse demonstron populli dhe s'ka vend për armiqtë. Megjithatë, Krillovi mbajti mendimin e tij të gabuar.

Së dyti, theksuam një moment tjetër, atë që shokëve besoj se u kujtohet: kur do të bëhej mbledhja e Kuvendit Popullor dhe do të fliste kryeministri<sup>1</sup>, Krillovi kishte menduar që pikërisht ato ditë të shkonte në Korçë, sepse «do të shihte fushatën e mbjelljeve». Megjithëse ai ishte i njoftuar, ne e kujtuam përsëri që të na nderonte me pjesëmarrjen e tij në zhvillimin e punimeve të Kuvendit Popullor. Po si na u përgjegj Krillovi? Ai na tha: «Mirë, do ta lë udhëtimin për në Korçë, sepse sekretari i parë i këtij rrethi është deputet dhe do të jetë në Tiranë». Kjo do të thotë se Krillovi e la udhëtimin meqënëse do të mungonte sekretari i parë dhe jo se do të mblidhej Kuvendi Popullor.

Së treti, kur u zhvillua mbrëmja solemne në Teatrin Popullor me rastin e 29 Nëntorit, në të cilën foli shoku Beqir Balluku, Krillovi iku nga llozha e caktuar për përfaqësuesin e BRSS dhe shkoi në llozhën e ambasadorit kinez, duke ndenjur prapa krahëve të tij. Asnjë njeri nuk e pa ambasadorin sovjetik në këtë mbrëmje solemne, në një kohë që të gjithë të huajt dukeshin që ishin të pranishëm. Edhe këtë qëndrim ne e quajmë një gabim shumë të madh.

Të nesërmen shkuam në darkën që kishte organizuar Komiteti Qendror me rastin e festës së çlirimit

---

<sup>1</sup> Është fjala për mbledhjen e Kuvendit Popullor që u zhvillua më 15 nëntor 1956.

dhe, si zakonisht, ambasadorin sovjetik e vumë përpara të gjithëve, të rrinte në krye, sipas traditës që është krijuar në vendin tonë për përfaqësuesit e popullit sovjetik. Megjithkëtë Krillovi qëndroi në fund. U përpoqëm për ta sjellë në krye po ai, më në fund, na tha se duhet të vijë edhe duajeni<sup>1</sup>. Ne iu drejtuam përsëri duke i thënë se ky është vendi që i takon ambasadorit sovjetik, kurse duajeni do qëndrojë si gjithë përfaqësuesit e tjerë të trupit diplomatik. Me zor erdhi atje ku i thamë ne, por duajenin e mori që e mori nga pas. Në mbrëmje folën shokët Haxhi Lleshi e Mehmet Shehu. Zakonisht ambasadorët sovjetikë kanë ngritur dollin në festat tona, kurse Krillovi në këtë darkë nuk ngriti asnjë dollin. Dollinë e ngriti duajeni, i cili tha dy fjalë.

Kur Krillovi iku mori me vete, gati në mënyrë të detyruar, edhe ambasadorin kinez, i cili i tha të mos nxitonin, pse akoma ishte shpejt, por Krillovi nuk dëgjoi. Ai iku para kohe, bile pa i dhënë dorën as kryeministrit, as shokëve të tjerë, me pretekst se «të nesërmen kishte punë». Po kjo nuk ishte arsyeja.

Natyrisht, neve nuk na vjen mirë që Krillovi mban këto qëndrime. Gabimet e tij përbëjnë një vazhdë, një vijë. Qëndrime të tilla të një përfaqësuesi të BRSS mendojmë se janë të rënda.

Susllovi, kur ia radhitëm të gjitha këto, u habit dhe tha përse ky njeri t'i ketë bërë këto gjëra? Pas kësaj Krillovin e thirrën menjëherë në Moskë.

Tani po them disa fjalë mbi darkën që u shtrua për nder të delegacionit të Partisë sonë në vilën «Gorki»,

<sup>1</sup> Në këtë rast duajeni ishte ambasadori hungarez.

ku ishin të gjithë shokët e Presidiumit të KQ të PK të BS. Hrushovi na njoftoi se do mblidheshim për të biseduar dhe njëkohësisht do të hanim darkë.

Kur filloi darka, akoma pa ngritur dollinë, Hrushovi tha: «Mesdheun duhet ta kemi tonin, ta kemi nën kontrollin tonë dhe çdo lidhje ta bëjmë nëpërmjet Shqipërisë, ku të krijojmë baza të forta nëndetësesh, sepse Shqipëria është e vogël, por ka rëndësi shumë të madhe strategjike. Me instalimet e vendosura në Shqipëri shikohet tërë Mesdheu, të tëra lëvizjet e aeroplanëve etj.»<sup>1</sup>. Hrushovi insistoi shumë për këtë çështje dhe pastaj, duke ngritur dollinë, ai foli për nevojën e vlerësimit të drejtë të situatës që zhvillohet në botë.

Pas dollisë ne biseduam për ardhjen e Hrushovit në Shqipëri. Në këtë bisedim morën pjesë të gjithë shokët e udhëheqjes sovjetike. Shumë prej tyre thanë me shaka: «A vemi një herë të bëjmë një mbledhje të Presidiumit në Shqipëri»? Të gjithë u përgjegjën se s'kanë kundërshtime bile për të bërë edhe mbledhjen e ple-numit<sup>2</sup>.

Kur mori fjalën Molotovi për të ngritur dollinë, midis të tjerash tha: «Unë i përkas asaj kategorie një-rëzish, që, përpara Luftës së dytë botërore, nuk i kanë

<sup>1</sup> Zhvillimi i ngjarjeve më vonë vërtetoi qëllimet e revizionistëve hrushovianë për ta përdorur Shqipërinë si një pikë me rëndësi strategjike në planet e tyre socialimperialiste në Mesdhe.

<sup>2</sup> Të gjitha këto ishin manevrime qesharake të udhëheqjes sovjetike për t'i bërë qejfin delegacionit të PPSH, i cili sipas saj do të përulej dhe nuk do të vazhdonte të bënte kritikë ndaj qëndrimeve të gabuara të klikës hrushoviane.



dhënë rëndësi Shqipërisë. Tani populli ynë mburret që ka një mik kaq luftarak. Shqipëria dhe miqësia jonë me të ka rëndësi simbolike dhe ndërkombëtare. Bashkimi Sovjetik ka shumë miq, po nuk janë të gjithë njësoj. Shqipëria është miku më i mirë i Bashkimit Sovjetik. Ta ngremë këtë doli që BRSS të ketë miq kaq të vendosur dhe besnikë sa Shqipëria».

Në darkë ngritëm doli edhe unë e Hysniu.

Delegacionin tonë e ftuan edhe në mbledhjen e Plenumit të Komitetit Qendror të PK të BS që u zhvillua për çështjet ekonomike<sup>1</sup>. Shokët sovjetikë na thanë se është hera e parë që përfaqësues të një partie motër marrin pjesë në një mbledhje të plenumit të tyre.

Ftesën tonë për të marrë pjesë në këtë plenum, ne mund ta konsiderojmë edhe si përgjegje ndaj vërejtjes që u bëmë se përse nuk janë konsultuar edhe me ne për çështjen hungareze.

Kur Hrushovi foli në plenum për Jugosllavinë, të gjithë hodhën sytë nga ne që ishim në sallë dhe qeshën. Kjo tregon se ata e njohin qëndrimin tonë të drejtë ndaj Jugosllavisë, luftën që zhvillojmë ne kundër titistëve, megjithatë lëshimet e tyre dhe qëndrimet e buta që vazhdojnë të mbajnë ndaj klikës së Titos neve s'na pëlqejnë.

Me pak fjalë, çfarë konkluzionesh mund të nxjerrim nga vajtja e delegacionit të Partisë sonë në Moskë?

Preokupimi i Partisë sonë dhe i udhëheqjes së saj për të gjitha këto ngjarje nuk ka qenë i gabuar. E rë-

---

<sup>1</sup> Në këtë Plenum të KQ të PK të BS u shqyrtua realizimi i planit të vitit 1956 dhe detyrat për vitin 1957.

ndësishtme është që udhëheqja e Partisë sonë në këto çështje ka mbajtur qëndrime të drejta. Sigurisht, kjo nuk na e rrit mendjen, po është një kënaqësi për Partinë tonë, që ka ditur gjatë të gjitha këtyre situatave shumë të vështira, të qëndrojë fort në pozita marksiste-leniniste, të socializmit dhe të komunizmit. Ky është një satisfaksion për punën e Partisë sonë, me qëndrimin e së cilës shokët sovjetikë ishin dakord.

Çështje tjetër që ka rëndësi shumë të madhe është ajo që në këto momente tepër të rëndësishme, uniteti ynë në KQ dhe në Byronë Politike është i fortë, ne jemi në pozita të drejta parimore, jemi thelluar në problemet që dikton koha, kemi parë mirë anët pozitive dhe negative të tyre, pa u lëkundur asnjëherë. Ky unitet mendimi e veprimi reflektohet në të tërë Partinë tonë. Kjo është fitorja më e madhe, më e rëndësishmja dhe më vendimtarja. Ta ruajmë këtë unitet të fortë, pse është jetik për ne.

Në momentet që po kalojmë, populli ynë u lidh akoma më shumë me Partinë e tij dhe ka besim shumë të madh te ajo. Jo vetëm anëtarët e Partisë, por të gjithë punonjësit aprovojnë vendimet e Partisë sonë marksiste-leniniste. Kjo ka forcuar edhe më tepër unitetin e popullit rreth Partisë dhe ka bërë që Partia jonë të zërë një vend të mirë dhe të respektueshëm në radhët e partive të tjera komuniste dhe punëtore të kampit tonë.

Por këto çështje të mos na dehin dhe të na vënë në gjumë. Kjo situatë kërkon luftë kundër armiqve të klasës, kundër titistëve jugosllavë dhe elementëve të tjerë armiq të marksizëm-leninizmit. Lufta vazhdon, ajo

do të thellohet më tej. Prandaj jo vetëm të jemi vigjilentë, po të përgatitemi mirë për t'u dhënë vazhdimisht goditje të vendosura të gjithë armiqve të komunizmit, veçanërisht armiqve të vendit tonë. Të demaskojmë me dokumenta të gjithë veprimtarinë e armikut dhe të udhëheqjes jugosllave, të përçarësve dhe minuesve të marksizëm-leninizmit. Të ngremë më lart edhe nivelin ideologjik të Partisë sonë, megjithëse në këto situata ajo po e tregon veten se është shumë e ngritur politikisht dhe e kupton fare mirë zhvillimin e ngjarjeve në botë.

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**NGA FJALA NË MITINGUN E ORGANIZUAR  
NË SHKODËR ME RASTIN E VIZITËS  
SË DELEGACIONIT QEVERTAR  
TË REPUBLIKËS POPULLORE  
TË BULLGARISË<sup>1</sup>**

24 janar 1957

I dashur shoku Jugov,  
Shokë dhe shoqe,  
Qytetarë të Shkodrës,

Më lejoni që në këtë ditë të shënuar, kur në qytetin tuaj të lashtë ndodhet delegacioni qeveritar i Republikës Popullore motër të Bullgarisë, t'ju përshëndes nga zemra në emër të Komitetit Qendror të Partisë dhe të Qeverisë së Republikës Popullore dhe t'ju uroj suksese sa më të mëdha në punën tuaj të frutshme për ndërtimin e socializmit në vendin tonë.

Vizita e delegacionit qeveritar të Republikës Popullore të Bullgarisë në Shqipëri është një nder dhe ka

---

<sup>1</sup> Delegacioni qeveritar i RP të Bullgarisë që vizitoi vendin tonë kryesohej nga Anton Jugov, në atë kohë Kryetar i Këshillit të Ministrave të RP të Bullgarisë.

rëndësi të madhe për forcimin e mëtejshëm të miqësisë dhe të lidhjeve vëllazërore midis popujve tanë.

Miqësia midis popullit vëlla bullgar dhe popullit shqiptar është shumë e vjetër dhe tradicionale. Të parët tanë kanë luftuar krah për krah për liri dhe populli bullgar ka përkrahur dhe ndihmuar përpjekjet çlirimtare të patriotëve të Rilindjes sonë. Revolucioni i madh socialist i Tetorit i dha një hov dhe një përmbajtje të re miqësisë midis popujve tanë, i shtyu ata të ndiqnin shembullin e punonjësve sovjetikë, u mësoi atyre rrugën për t'u çliruar një herë e përgjithmonë. Mësimet e Revolucionit të Tetorit dhe të Leninit të madh i udhëhoqën popujt tanë në luftën e madhe antifashiste. Lufta çlirimtare e popujve tanë e udhëhequr nga partitë tona komuniste triumfoi. U çlirua vendi nga okupatorët fashistë dhe nazistë. U përmbysën klasat sunduese të vendit. Pushtetin e morën në duar klasa punëtore dhe masat punonjëse. Timoni i jetës politike dhe ekonomike të vendeve tona drejtohet nga pararoja e klasës punëtore — partitë marksiste-leniniste. Pas Luftës së dytë botërore Bullgaria dhe Shqipëria u shkëputën nga vargu i vendeve vasale të imperializmit dhe pushuan së qenuri vegël në duart e atyre që i përdornin si fuçi baruti në Ballkan. Vendet tona u radhitën në kampin e socializmit dhe u kthyen në vatra ku zien puna ndërtime për lumturinë e popujve tanë, për socializmin, për paqen në Ballkan dhe në botë. Këto fitore historike që kanë arritur popujt tanë, të ndihmuar nga Bashkimi Sovjetik dhe nga vendet e tjera të kampit të socializmit, do t'i ruajnë si sytë e ballit. Kjo është fjala dhe besa e popullit tonë. Popujt tanë janë të lidhur me

zemër me njëri-tjetrin, ata i bashkon Traktati i miqësisë, i bashkëpunimit dhe i ndihmës reciproke midis Republikës Popullore të Bullgarisë dhe Republikës Popullore të Shqipërisë. Miqësia midis popujve tanë dhe të gjitha vendeve të tjera të kampit të socializmit, është një miqësi me përmbajtje të re. Kjo miqësi e ka burimin në qëllimet e larta dhe humanitare të rrugës që ndjekin popujt tanë për ndërtimin e socializmit, për një jetë me të mira materiale dhe kulturele më të shumta. Ajo mbështetet në parimet e larta të marksizëm-leninizmit, në principet e solidaritetit dhe të internacionalizmit proletar. Kjo miqësi ka rëndësi për zhvillimin e mëtejshëm ekonomik dhe kultural të vendeve tona, për ruajtjen e pavarësisë së tyre, për ruajtjen e paqes në botë kundër përpjekjeve të imperialistëve për të kthyer të kaluarën, për të provokuar një luftë të re. Kushdo që cënon, dhe në çdo formë qoftë, këtë miqësi dhe këtë aleancë nuk mund të presë veç urrejtjen e popujve tanë, grushtin e rëndë dhe disfatën. Kushdo që cënon unitetin e vendeve të kampit të socializmit, nën çfarëdo ngjyre qoftë, në fakt i shërben imperializmit.

Miqësia midis vendeve të socializmit neve na është e shtrenjtë. Këtë ia mëson vetë jeta popullit shqiptar. Shumë këngë të lashta të Shkodrës u këndojnë bukurive dhe pasurive të Shqipërisë dhe flasin për etjen e armiqve për ta zaptuar. Dhe më përpara armiqtë arrinin ta zaptinin vendin tonë, por kurrë s'u përkul populli shqiptar. Por sot një gjë e tillë s'mund të ndodhë kurrë më.

Të bukura ishin fushat e Shqipërisë edhe më përpara, por prodhonin shumë pak. Pasuria e nëntokës sonë

ishte e panjohur. Po sot? Miniera dhe fabrika po ngrihen anë e kënd Shqipërisë. Fushat tona që po bashkohen pak nga pak në kooperativa i përshkon traktori. Ju i bëtë këto me fuqinë tuaj krijuese nën udhëheqjen e Partisë. Pse nuk u bënë dhe përpara? Populli punonte, frutin e tij e merrnin të tjerët. Armiqtë okupatorë kishin hall të grabitnin dhe jo të ndërtonin. Sot e gjithë pasuria në vendin tonë është e popullit dhe Partia i ka siguruar atij miq të vërtetë që e ndihmojnë me gjithë zemër dhe pa interes, në mënyrë bujare. Jeta e popullit tonë është përmirësuar shumë, ditë më të lumtura na presin megjithëse ne kemi akoma vështirësi, por jemi të bindur se këto do t'i kapërcejmë. Populli ynë punëtor dhe trim nën udhëheqjen e Partisë ka bërë mrekullira ashtu si do të bëjë edhe në të ardhshmen. Në rrugën tonë ne do të kemi ndihmën e vendeve të socializmit. Ne u jemi mirënjohës vëllezërve tanë bullgarë për ndihmën që na japin. Ne do të përfitojmë nga eksperiencia e tyre. Ne përfitojmë shumë nga eksperiencia e kultivatorëve të duhanit bullgar dhe ajo vërehet dhe në fushat e Shkodrës. Ne përfitojmë nga sukseset e kooperativistëve bullgarë. Në rrugën e transformimeve socialiste vendet tona shkëmbejnë eksperiencën me njëri-tjetrin, sepse ata udhëhiqen nga mësimet e marksizëm-leninizmit. Çdo vend e aplikon marksizmin në mënyrë krijuese në përputhje me kushtet konkrete të vendit. Çdo vend e pasuron marksizmin me praktikën e tij. Por të gjitha vendet e kampit të socializmit në ndërtimin e socializmit kanë parasysh dhe eksperiencën e Partisë Komuniste të lavdishme të Bashkimit Sovjetik, sepse ajo është e vlefshme për të gjithë, pse atje u

ngrit për herë të parë shoqëria socialiste. Dhe në fund të fundit, ashtu siç thonë shokët kinezë, revolucionet tona janë vazhdimi i Revolucionit të Tetorit dhe i transformimeve socialiste, që janë kryer në Bashkimin Sovjetik, në kushtet e veçanta të çdo vendi. Tendencat revizioniste-anarkiste-shisioniste që përpiqen të shtrembërojnë marksizëm-leninizmin, në fakt janë antisocialiste dhe nxitin përçarjen midis vendeve të kampit të socializmit dhe lëvizjes komuniste botërore. Ato e kanë buri-min në pikëpamjet e borgjezisë dhe bëhen armë në duart e imperializmit kundër vendeve tona. Imperializmi amerikan përpiqet të vendosë hegjemoninë e tij në botë, të shtypë popujt e lirë me anën e intrigave dhe të luftës. Për këtë arsye në marrëdhëniet ndërkombëtare ne vërejmë një ngritje të tensionit ndërkombëtar. Kundërrevolucioni në Hungari ishte vepër e fuqive imperialiste. Ata dështuan aty me turp ashtu si dështuan në Egjipt<sup>1</sup>. Por imperialistët nuk heqin vetë dorë nga qëllimet e tyre. «Doktrina e Ajzenhauerit»<sup>2</sup> për të nënshtruar vendet e Lindjes së Afërme përmban në vetëvete farën e një lufte të re. Por jo gjithshka varet nga imperialistët. Lëvizja çlirimtare në kolonitë ka marrë

<sup>1</sup> Është fjala për dështimin e agresionit anglo-franko-izraelit kundër Egjiptit në vitin 1956.

<sup>2</sup> Është fjala për programin e politikës së jashtme agresive të qeverisë së SHBA-së në Lindjen e Afërme e të Mesme, i shpallur zyrtarisht më 9 mars 1957, pas nënshkrimit nga presidenti Ajzenhauer të rezolucionit të përbashkët të të dy dhomave të kongresit. Rezolucioni i jep të drejtë presidentit të përdorë forcat e armatosura të SHBA-së në Lindjen e Afërme dhe të Mesme kundër çdo vendi që ndodhet gjoja nën kontrollin e komunizmit ndërkombëtar.



vrull të madh dhe nuk mund të ndalet as me dollarë as me topa, ajo do të triumfojë. Popujt po luftojnë për paqen. Kontradiktat midis shteteve kapitaliste përherë e më shumë ashpërsohen. Të gjithë këta faktorë janë një pengesë për imperialistët. Dhe pengesa më e madhe është forcimi i kampit të socializmit, uniteti i tij.

Shokë,

Gëzimi është shumë i madh dhe i papërshkrueshëm, në këto ditë, anembanë Shqipërisë, pse në gjirin e popullit tonë ndodhen bijtë e popullit vëlla bullgar, i cili në ditët e rrezikshme dhe në ditët e gëzuara është ndodhur afër, krah për krah si mik i popullit tonë. Ne me admirim ndjekim sukseset e shkëlqyera të Bullgarisë motër në ndërtimin e socializmit. Bullgaria ka korrur suksese të panumërta në çdo fushë, atje jeta është zbukuruar, ka përparuar industria, bujqësia, arësimi, kultura.

Bisedimet e delegacioneve qeveritare të Republikës Popullore të Bullgarisë dhe të Republikës Popullore të Shqipërisë po zhvillohen në mënyrën më të përzemërt, si midis vëllezërish, në bazë të parimeve të marksizëm-leninizmit. Ato janë një kontribut i çmueshëm për forcimin e lidhjeve vëllazërore midis popujve dhe vendeve tona, për ndërtimin e socializmit në vendet tona, për ruajtjen e paqes në Ballkan, për forcimin e kampit të socializmit.

Ne falenderojmë me gjithë zemër delegacionin qeveritar bullgar të udhëhequr nga shoku ynë i dashur Anton Jugov, shokët tanë të shtrenjtë përfaqësues të

popullit vëlla, mik dhe aleat bullgar për këtë vizitë miqësore. Ne i falenderojmë ata për ndihmën që i japin popullit tonë në të gjitha fushat. Ne u themi vëllezërve tanë bullgarë se krah për krah me ta dhe me të gjitha vendet e kampit të socializmit ne do të ecim së bashku pa u përkulur nën flamurin e socializmit për lumturinë e popujve tanë, për triumfin e socializmit dhe të komunistit në vendet tona, për triumfin e marksizëm-leninizmit, për mbrojtjen e paqes në botë.

Rroftë miqësia e përjetshme dhe e pathyeshme midis popullit vëlla bullgar dhe popullit shqiptar!

Rroftë populli bullgar, mik dhe vëlla i shtrenjtë i popullit shqiptar!

Rroftë kampi i fuqishëm i socializmit me Bashkimin Sovjetik në krye!

Rroftë internacionalizmi proletar!

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 21 (2608), 25 janar 1957*

*Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**FJALA NË PRITJEN E DHËNË NGA AMBASADA  
E RP TË BULLGARISË ME RASTIN E VIZITËS  
SË DELEGACIONIT QEVERTAR BULLGAR**

**29 janar 1957**

I dashur shoku Anton Jugov,  
Shokë dhe miq të shtrenjtë,

Në radhë të parë dëshiroj të falenderoj nga zemra shokun Anton Jugov për fjalët shumë të përzemërta që tha në drejtim të popullit shqiptar, të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë. Ju e keni parë vetë, gjatë këtyre pak ditëve, të dashur miq e vëllezër bullgarë, se edhe populli shqiptar ushqen të njëjtat ndjenja miqësie ndaj popullit vëlla dhe heroik bullgar, ndaj Partisë së tij Komuniste dhe Qeverisë së Republikës Popullore të Bullgarisë.

Ditët e qëndrimit të delegacionit qeveritar bullgar në Shqipëri kaluan shumë shpejt, por ato do të mbeten të paharruara në mendjen e të gjithë popullit tonë. Vizita juaj i dha forca të reja miqësisë dhe aleancës midis dy popujve vëllezër, ajo do të kontribuojë shumë në forcimin e kampit të socializmit, ajo patjetër do të ketë

efekt pozitiv në çështjen e paqes e të sigurimit në Ballkan e në Evropë.

Mendimi i Partisë dhe i qeverisë sonë është se gjatë këtyre ditëve të dy delegacionet qeveritare kanë bërë një punë shumë të mirë në dobi të popujve tanë, në dobi të çështjes së paqes e të socializmit. Bisedimet në mes të delegacioneve tona si në rrugë shtetërore ashtu edhe në rrugë partie u zhvilluan në një atmosferë jashtzakonisht miqësore dhe vëllazërore dhe çdo çështje e diskutuar midis nesh përfundoi me një unanimitet të plotë pikëpamjesh në mes të dy palëve. Vizita juaj dhe marrëveshjet që nënshkruam janë një ndihmë direkte për Republikën Popullore të Shqipërisë dhe zgjerojnë në mënyrë të frutshme bashkëpunimin tonë në të gjitha fushat.

Republika Popullore e Shqipërisë dhe Republika Popullore e Bullgarisë janë dy vende jo larg njëri-tjetrit, dy vende paqedashëse, dy vende socialiste. Një miqësi shumë e vjetër dhe e përzemërt bashkon popujt tanë, të cilët kanë luajtur një rol vendimtar në çlirimin e popujve të Ballkanit nga zgjedha e otomanëve dhe sot jo vetëm që mburren me traditat e lavdishme çlirimtare të së kaluarës, por ata luajnë një rol të dorës së parë në këtë pjesë të Evropës për qëndrimet e tyre të vendosura socialiste dhe paqësore. Ata tani i lidh akoma më ngushtë qëllimi i përbashkët i socializmit, ata janë pjesëtarë të kampit të madh e të fuqishëm socialist që udhëhiqet nga Bashkimi i lavdishëm Sovjetik.

Populli shqiptar e çmon dhe e do si vëlla popullin bullgar. Çdo shqiptar kur shkon në Bullgari e ndjen veten si në shtëpinë e tij, si në Shqipëri. Kështu e ndjenin

veten patriotët tanë të Rilindjes që gjetën në Bullgari jo vetëm strehë por dhe përkrahje të madhe në luftën e tyre për çlirimin e atdheut nga zgjedha turke. Dhe sot, për çdo qytetar të Shqipërisë socialiste që shkon në Bullgarinë socialiste, ndjenja se ndodhet në shtëpinë e tij është më e gjallë, më e fortë, sepse të dy popujt tanë miqësinë e tyre tradicionale, ndjenjat e vëllazërimit tani i kanë pasuruar dhe forcuar akoma më shumë në luftën e përbashkët nacional-çlirimtare kundër okupatorëve fashistë dhe në luftë për ndërtimin e socializmit.

Prandaj për popullin tonë, për Partinë dhe qeverinë tonë, vizita e delegacionit qeveritar bullgar ka një kuptim dhe një përmbajtje të madhe e jo të zakonshme. Prandaj në Republikën Popullore të Shqipërisë ju, të dashur vëllazër, nuk jeni vetëm delegatë dhe mysafirë të shtrenjtë, ju jeni shokë lufte të një kauze të lavdishme të përbashkët, socializmit.

Luftërat shekullore të popujve tanë për liri e pavarësi u kurorëzuan me fitore të plotë nën drejtimin e partive të tyre komuniste dhe me ndihmën vendimtare të Bashkimit Sovjetik. Sot, po kështu nën drejtimin e partive të tyre marksiste dhe me ndihmën e Bashkimit Sovjetik dhe në bashkëpunim vëllazëror me vendet e tjera socialiste, të dy popujt tanë po ndërtojnë socializmin.

Forca që na bashkon dhe na çon përpara janë parimet e pavdekshme të internacionalizmit proletar, është marksizëm-leninizmi.

Partitë tona marksiste janë ndërtuar dhe janë rritur sipas mësimeve të Leninit, të cilat u janë përshtatur kushteve tona dhe ndriçojnë të gjitha përpjekjet tona

për ndërtimin e jetës së re, në rrugën e socializmit e të komunizmit.

Qarqet agresive imperialiste dhe antimarksistët e ndryshëm, revizionistët, trockistët, të tërbuar nga sukseset e vendeve socialiste dhe nga rritja e influencës së socializmit në botë, kanë mobilizuar të gjitha forcat e tyre dhe kanë shpërthyer sulme e shpifje nga më të poshtrat kundër gjithë kampit socialist, si dhe kundër lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare. Ata kryesisht synojnë të godasin dhe të dobësojnë unitetin e kampit socialist. Por ata nuk do t'i realizojnë ëndrrat e tyre dhe kurdoherë do të pësojnë disfatë.

Ne mendojmë se, si sot dhe kurdoherë, detyrë themelore për partitë tona komuniste e punëtore, për qeveritë dhe për popujt e vendeve socialiste, është ruajtja e pastërtisë së marksizëm-leninizmit nga çdo shtrembërim, është ruajtja dhe forcimi i përhershëm i unitetit të kampit të socializmit, sepse ky unitet është garancia e sigurtë e triumfit të socializmit dhe e paqes në botë. Imperialistët, tradhëtarët e mërgimit dhe radiot ku ata shërbejnë, antimarksistët e çdo kallëpi dhe të çdo ngjyre po çirren kundër atdheut tonë, kundër Partisë sonë të lavdishme marksiste-leniniste. Po ç'rezulton nga të gjitha këto shpifje të poshtra? Asgjë e mirë për armiqtë e popullit tonë dhe të marksizëm-leninizmit. Ato janë bërë leckë të ndotura për popullin tonë, i cili forcohet çdo ditë e më shumë, i cili shtërngon çdo ditë e më fort radhët rreth Partisë së tij të dashur dhe qeverisë së tij.

Sot që socializmi është bërë sistem botëror dhe popujt tanë ndërtojnë me besim të ardhshmen e tyre, forcimi i miqësisë shqiptaro-bullgare kontribuon në çësh-

tjen e përbashkët të paqes dhe të socializmit dhe këtë miqësi. ne do ta ruajmë si një gjë të shtrenjtë, do ta zhvillojmë më tej, do ta çelmosim. Miqësia jonë, uniteti i vendeve tona, kanë provuar rëndësinë e tyre për sigurimin e paqes në Ballkan. Armiqtë e çdo kallëpi kurrë nuk do të kenë sukses me qëllimet e tyre djallëzore të na përçajjnë. Ata do të thyejnë kokën, ata do të demaskohen, ata do të humbasin.

Le të ngremë gotën, shokë, për lavdinë e marksizëm-leninizmit, për miqësinë dhe aleancën midis popullit shqiptar dhe popullit bullgar, për miqtë tanë të shtrenjtë e të nderuar të delegacionit qeveritar bullgar me shokun Anton Jugov në krye!

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 25 (2612), 30 janar 1957*

*Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## MBI ZBATIMIN E ZOTIMEVE TË MARRURA NË KONGRESIN III TË PPSH

*Letër dërguar komiteteve të Partisë në qarqe e rrethe*

11 shkurt 1957

KOMITETEVE TË PARTISË TË QARQEVE  
TË QYTETEVE DHE TË RRETHEVE  
SEKRETARËVE TË PARË TË KOMITETEVE  
TË PARTISË

Nga informatat që ka marrë aparati i Komitetit Qendror të PPSH pranë komiteteve të Partisë, rezulton se ndërsa disa komitete partie kanë bërë përpjekje dhe i kanë realizuar e tejkaluar zotimet që kanë marrë në Kongresin III të Partisë, disa komitete të tjera partie nuk i kanë realizuar zotimet e marrura.

Janë për t'u lavdëruar veçanërisht Komiteti i Partisë i Kombinatit të Naftës «Stalin» dhe ai i Hidrocentralit të Matit, të cilët jo vetëm që i kanë realizuar por edhe i kanë tejkaluar zotimet që kanë marrë në kongres për tejkalimin e planit të vitit 1956. Kështu zotimet që mcri



shoku Jorgji Shuli në emër të Komitetit të Partisë të Qytetit «Stalin», u tejkaluam: prodhimi i naftës nga 5 000 ton mbi planin e vitit 1956 që ishte zotimi u realizua në 25 500 ton, bitumi nga 2 500 ton mbi planin u realizua 7 785 ton, përpunimi i naftës nga 4 000 ton mbi planin në 11 586 ton etj. Komiteti i Partisë i Hidrocentralit të Matit e tejkaloj zotimin duke realizuar planin 64 ditë para afatit në vend të 32 ditëve që ishte zotuar.

Por disa komitete partie nuk i kanë realizuar zotimet që kanë marrë para kongresit të Partisë për vitin 1956. Kështu p.sh.:

1. — Në emër të Komitetit të Partisë të rrethit të Durrësit sekretari i parë i këtij rrethi ka qenë zotuar që në vjeshtë të këtij viti në rrethin e Durrësit do të kolektivizohet e gjithë zona fushore. Ndërsa deri në fund të muajit nëntor rrethi i Durrësit nga 76 fshatra të zonës fushore kolektivizoi vetëm 45 prej tyre, d.m.th. deri në fund të muajit nëntor kishte ngritur vetëm 4 kooperativa të reja bujqësore.

2. — Në emër të Komitetit të Partisë të Lushnjës shoku Petro Magjistari ka qenë zotuar që në vjeshtë të këtij viti në atë rreth do të përfundonte kolektivizimi i bujqësisë në të gjitha fshatrat fushore dhe në disa fshatra të zonës kodrinore. Por në fund të muajit nëntor rezultonte të ishin kolektivizuar 73 fshatra të zonës fushore dhe vetëm 3 në fshatrat e zonës kodrinore, nga 89 fshatra fushore e 43 kodrinore që ka Lushnja. Kështu deri më 30 nëntor rrethi i Lushnjës kishte ngritur vetëm 12 kooperativa të reja bujqësore.

3. — Për Komitetin e Partisë të qarkut të Gjirokastrës, shoku Miho Xhani, sekretar i dytë i Komitetit të

Partisë për qarkun e Gjirokastrës, midis të tjerave ka qenë zotuar që brenda vitit 1956 numri i kooperativave bujqësore do të arrinte në 200, do të shpërndanin mbi 600 ha. tokë disponibël, se kooperativat bujqësore do t'i dorëzonin shtetit 90 për qind të tepricave të drithit dhe fshatarët individualë sa më shumë. Ndërsa deri në fund të vitit këto zotime qarku i Gjirokastrës nuk i realizoi: nga 600 ha. tokë disponibël që duhej të shpërndante ka shpërndarë vetëm 123 ha. tokë, nga 200 kooperativa bujqësore që duhej të arrinin, kanë ngritur vetëm 143. Po kështu plani i tepricave është realizuar vetëm 31 për qind.

Shembujt e mësipërm tregojnë se disa komitete partie i kanë harruar zotimet që janë marrë para Kongresit III të Partisë, se ata janë mjaftuar vetëm me marrjen e zotimeve dhe pastaj nuk kanë ndjekur realizimin e tyre. Këtë gjendje Komiteti Qendror i Partisë nuk mund ta lejojë. Prandaj *porositen byrotë e komiteteve të Partisë të qarqeve e të rretheve që nuk i kanë realizuar zotimet e marrura, ta marrin në shqyrtim këtë çështje në mbledhjen e tyre të parë dhe deri më 10 mars 1957 të njoftohet Komiteti Qendror për arësyet e mosrealizimit të zotimeve për vitin 1956 që kanë marrë në Kongresin III të PPSH.*

Me këtë rast u kujtojmë të gjitha komiteteve të Partisë që të kenë parasysh të ndjekin rregullisht zbatimin e zotimeve që janë marrë në Kongresin III të Partisë si dhe zotimet e tjera të mëvonshme lidhur me këto, pasi një pjesë e tyre janë marrë për vitet 1957, 1958, 1959 dhe 1960. Në qoftë se komitetet e Partisë nuk do të marrin me kohë masat për të mobilizuar

organizatat e Partisë dhe kolektivat punonjëse, më pas do të bëhet i vështirë realizimi i zotimeve të marrura. Komitetet e Partisë duhet t'i kushtojnë kujdes të veçantë plotësimit të zotimeve të marrura para organit më të lartë të Partisë, përpara kongresit, ata duhet ta ndjejnë më mirë përgjegjësinë e madhe që kanë për t'i siguruar popullit gjithshka përcaktohet në planin e dytë pesëvjeçar.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

## «MBI GJENDJEN NDËRKOMBËTARE DHE DETYRAT E PARTISË»

*Nga raporti i mbajtur në Plenumin III  
të KQ të PPSH*

13 shkurt 1957

Shokë,

Byroja Politike e Komitetit Qendror të Partisë e çmoi të nevojshme të paraqitë në këtë plenum një raport mbi gjendjen ndërkombëtare, për arsye se kohët e fundit janë zhvilluar ngjarje të rëndësishme ndërkombëtare që kanë lidhje të drejtëpërdrejtë me çështjen e paqes dhe të socializmit, me luftën për forcimin dhe mbrojtjen e unitetit të kampit të socializmit me Bashkimin Sovjetik në krye dhe me mbrojtjen e marksizëm-leninizmit.

Këto kohët e fundit forcat agresive imperialiste, reaksioni ndërkombëtar dhe elementët antimarksistë dhe revizionistë u hodhën në sulm të hapët kundër kampit të socializmit, kundër partive komuniste dhe punëtorë të vendeve kapitaliste dhe kundër popujve të

Lindjes së Afërme e të Mesme. Qëllimi i imperialistëve ishte dhe është të përçajjnë kampin e socializmit dhe të mposhtin forcat kryesore që u rezistojnë planeve të tyre të luftës e të agresionit. Përppjekjet e imperialistëve pësuan disfatë kudo, por ato nuk mbetën pa influencuar në gjendjen ndërkombëtare dhe kanë shkaktuar një ngritje të re të tensionit në marrëdhëniet midis shteteve.

Duke analizuar aspektet kryesore të zhvillimit të gjendjes ndërkombëtare, ne duhet të shqyrtojmë në radhë të parë çështjet që janë të lidhura me forcimin e unitetit të kampit tonë dhe të nxjerrim konkluzionet e duhura për Partinë tonë, për të forcuar më tej unitetin e radhëve të saja, për të rritur më tej veprimtarinë e saj në luftën për mbrojtjen e interesave të popullit tonë dhe të të gjithë kampit të socializmit, për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit.

Një nga veçoritë dalluese të ngjarjeve në këto vitet e fundit është se gjendja ndërkombëtare gjatë kësaj periudhe ka shënuar ecje përpara, drejt uljes së tensionit ndërkombëtar, por edhe kthesa të përkohshme, që janë refleks i kontradiktave në shkallë ndërkombëtare midis forcave të paqes e të luftës, midis forcave të socializmit dhe të imperializmit.

Ndryshimet e mëdha në raportin e forcave midis socializmit dhe imperializmit, në dobi të socializmit, dalja e socializmit nga kuadri i një shteti të vetëm në një sistem botëror e kanë tronditur nga themelet sistemin kapitalist botëror. Realizimet madhështore të Bashkimit Sovjetik, sukseset e rëndësishme dhe të shpejta të Republikës Popullore të Kinës dhe të vendeve të tjera

të kampit të socializmit kanë treguar epërsinë e pamoheshme të sistemit socialist mbi atë kapitalist.

Politika leniniste e paqes dhe e miqësisë midis popujve, politika e bashkëjetësës paqësore, e ndjekur me këmbëngulje nga vendet e kampit socialist dhe që u përgjigjet interesave jetike të të gjithë popujve, gjeti përkrahjen e shteteve dhe të forcave paqedashëse të botës. Ajo ushtroi një influencë vendimtare në luftën e popujve për paqe, kundër luftës, kundër garës së armatimeve, kundër bloqeve agresive ushtarake, kundër politikës luftënxitëse të imperialistëve, për çarmatimin, për sigurimin kolektiv, për bashkëpunimin ndërkombëtar. Në të kundërtën, politika e monopoleve imperialiste, me ato të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në krye, ka hyrë në kriza: politika e «luftës së ftohtë» dhe e «pozitave të forcës» pësoi dështime të rënda. Lufta nacional-çlirimtare e popujve të shtypur i dha grushte të rënda sundimit kolonial. Brenda sistemit kapitalist u thelluan kontradiktat midis shteteve kapitaliste dhe me dobësimin e pozitave të imperializmit e me keqësimin e gjendjes ekonomike u thellua edhe lufta e klasave brenda çdo shteti kapitalist.

Kuptohet se kjo situatë nuk u pëlqente imperialistëve. Ulja e tensionit ndërkombëtar nuk pajtohet me interesat e qarqeve agresive imperialiste, të cilat bazohen në politikën e forcës dhe nxjerrin fitime kolosale nga gara e armatimeve dhe nga lufta. Në fakt ulja e tensionit ndërkombëtar nuk arrihet me dëshirën e kampit imperialist, por duhet t'i imponohet atij nga raporti i forcave, i ndryshuar në dobi të socializmit, nga forcat e kampit të socializmit, nga përpjekjet e Bashkimit

Sovjetik, të Kinës dhe të vendeve të tjera të kampit të socializmit, si edhe nga përpjekjet e vendeve të pavarura kombëtare, si India, Indonezia, Egjipti, Siria etj., nga vullneti i popujve për paqen.

Qarqet më agresive të imperializmit përgjojnë për të gjetur vendin dhe çastin oportun për të kundërvepruar me qëllim që të ndalojnë këtë proces të rrezikshëm për ta, dhe punojnë në mënyrë shumë aktive për pregatitjen e luftës kundër kampit të socializmit, kundër popujve liridashës.

Në çastin që kujtuan se ishte i përshtatshëm shtetet perëndimore filluan një ofensivë të gjerë kundër kampit të socializmit dhe me agresionin kundër Egjiptit<sup>1</sup> e me kundërrevolucionin në Hungari<sup>2</sup> ato kaluan në veprime të hapëta agresive. Në të njëjtën kohë forcat imperialiste dhe ato të reaksionit ndërkombëtar shpërthyen sulme të egra fashiste kundër partive komuniste e punëtore të vendeve kapitaliste. Të tëra këto goditje ishin pjesë e një komploti të përgjithshëm të fuqive imperialiste për të çarë kampin e socializmit, për të izoluar Bashkimin Sovjetik, për të mposhtur luftën e popujve të shtypur, për të shkatërruar forcat punëtore, me qëllim që, duke asgjësuar pengesat kryesore të politikës së tyre të luftës, t'u hapnin rrugën forcave të reaksionit e të fashizmit, të rivendosnin në këto ven-

---

<sup>1</sup> Agresioni anglo-franko-izraelit kundër Egjiptit u krye më 29-30 tetor 1956. Ky akt përbënte një hallkë tjetër të sulmit të përgjithshëm të imperializmit kundër popujve dhe forcave liridashëse.

<sup>2</sup> Kundërrevolucioni në Hungari shpërtheu më 23 tetor dhe vazhdoi deri më 4 nëntor 1956.

de regjimet koloniale dhe antipopullore, të rifitonin pozitë dhe privilegjet e humbura.

Kampit të socializmit iu desh të përballonte sulme të gjithanshme. Në këtë përpjekje forcat e imperializmit dhe të reaksionit ndërkombëtar dështuan. Ky dështim i imperializmit tregoi edhe një herë se sistemi imperialist është i dënuar nga historia, se e ardhshmeja i përket lirisë së popujve dhe socializmit. Por nga ana tjetër këto ngjarje dëshmojnë se imperializmi nuk heq dorë nga lufta kundër socializmit, se ai do të bëjë të gjitha përpjekjet për të zgjatur jetën e tij. Kampi i socializmit, partitë komuniste dhe punëtorë, popujt paqedashës dhe forcat përparimtare të botës do të nxjerrin mësimë të mëdha nga ngjarjet e fundit.

## 1. — AGRESIONI IMPERIALIST KUNDËR EGJIPTIT

Një nga karakteristikat e gjendjes së sotme ndërkombëtare është ashpërsimi i kontradiktave midis imperializmit dhe vendeve që quhen asnjëherë. Siç dihet, fitorja e Bashkimit Sovjetik kundër fashizmit dhe fitorja e socializmit në Kinë, krijimi i sistemit botëror të socializmit kanë pasur një influencë shumë të madhe dhe të drejtëpërdrejtë në zgjimin e popujve të shtypur e kolonialë, në ngritjen e tyre në luftë për të fituar lirinë dhe pavarësinë, kundër kolonizatorëve imperialistë. Shtetet e vendeve që janë çliruar nga zgjedha imperialiste si Egjipti, Siria etj. janë shtete borgjeze, por nuk janë shtete imperialiste; ato ndjekin politikën e ruajtjes së pavarësisë kombëtare dhe të luftës kundër



imperializmit e kolonializmit. Lufta kundër kolonializmit e imperializmit i afron këto shtete me Bashkimin Sovjetik dhe me kampin e socializmit përgjithësisht, por këto shtete s'janë socialiste, s'bëjnë pjesë në kampin socialist. Prandaj këto shtete quhen shtete të pavarura, asnjane.

Konferenca e Bandungut e vendeve të Azisë e të Afrikës përcaktoi orientimin e tyre të përgjithshëm në marrëdhëniet ndërkombëtare: kundër kolonializmit, për ruajtjen e paqes, për bashkëjetesën paqësore dhe për bashkëpunimin midis shteteve me sisteme të ndryshme shoqërore. Objektivisht qëndrimi i tyre është kundër imperializmit. Popujt e Lindjes së Afërme e të Mesme po zgjerojnë luftën e tyre për të fituar dhe për të përforcuar pavarësinë. Kjo luftë u ka shkaktuar dëme shumë të mëdha kolonizatorëve. Shumë vende arabe janë çliruar dhe të tjerat po luftojnë për të fituar lirinë. Sistemi kolonial është në shthurje të plotë. Kolonializmi francez po jep shpirt. Tunizia dhe Maroku fituan pavarësinë e tyre, kurse Algjeria ka kohë që është në zjarr e në flakë. Populli algjerian lufton me heroizëm për të hequr qafe zgjedhën e urryer të kolonizatorëve francezë, të cilët, duke përdorur liderët e djathtë të partive socialiste franceze me Gi Molenë në krye, kanë shpërthyer atje një terror të pashembullt. Gati gjysina e ushtrisë franceze është angazhuar në Algjeri. Socialistët francezë u demaskuan plotësisht si vegla qorre të imperializmit dhe tradhëtarë të klasës punëtore franceze.

Me vendosmëri luftojnë për forcimin e pavarësisë së tyre vendet më të mëdha arabe. Duke dashur të përforcojnë pavarësinë e tij Egjipti kohët e fundit shtetëzoi

shoqërinë e kanalit të Suezit, e cila përdorej nga fuqitë imperialiste si një mjet shfrytëzimi e shtypjeje kundër popullit egjiptian.

Lufta e Egjiptit dhe e popujve arabë për pavarësi u shkakton dëme të rënda sidomos dy prej fuqive më të mëdha kolonialiste, Anglisë dhe Francës, monopolet e të cilave po humbasin superfitimet kolosale që nxjerrin nga grabitja e pasurive të mëdha të këtyre vendeve. Mjafton të përmendim se vendet e Lindjes së Mesme kanë tri të katërtat e sasisë së vajgurit të njohur në botën kapitaliste. Njëkohësisht duhet theksuar se vendet e Lindjes së Afërme e të Mesme kanë një rëndësi të madhe strategjike në planet e përgjithshme agresive të imperializmit. Për të gjitha këto arsye, shtetëzimi i shoqërisë së kanalit të Suezit u gjet prej imperialistëve si shkas për të filluar sulmin kundër të gjitha vendeve arabe. Dihet se sulmi i Izraelit kundër Egjiptit nuk qe gjë tjetër veçse një provokacion për të arësye-tuar ndërhyrjen imperialiste. Në të vërtetë janë imperialistët anglezë e francezë ata që organizuan dhe shpërthyen agresionin kundër Egjiptit, ndërsa Izraeli s'është veçse koburja në duart e imperialistëve anglo-francezë dhe në dorën e imperialistëve amerikanë sot.

Duke sulmuar Egjiptin, imperialistët anglo-francezë donin t'i hiqnin atij zotërimin e kanalit të Suezit, të mposhtnin rezistencën e Egjiptit dhe, duke mposhtur rezistencën e njërit prej popujve më të mëdhenj arabë, të demoralizonin shtetet e tjera arabe, të çelnin kësh-tu rrugën për të zhdukur pavarësinë e tyre kombëtare dhe të rivendosnin sundimin kolonial. Sulmi kundër Egjiptit ishte hapi i parë i këtij plani.

Siç dihet, agresioni anglo-franko-izraelit kundër Egjiptit dështoi.

Por imperialistët nuk heqin dorë nga planet e tyre për të rivendosur sistemin kolonialist në këto vende. Në realizimin e këtij plani, rolin kryesor, pas dështimit të Anglisë dhe të Francës, e luajnë imperialistët amerikanë. Për këtë flet qartë e ashtuquajtura doktrinë Ajzenhauer.

Presidenti Ajzenhauer, në mesazhin drejtuar kongresit, paraqiti planin e tij, me të cilin u ofron vendeve të Lindjes së Afërme e të Mesme «ndihmë ekonomike», «ndihmë ushtarake» dhe «përdorimin e forcave të armatosura amerikane» në këto vende, për t'i mbrojtur gjoja nga rreziku i komunizmit ndërkombëtar. Në të vërtetë ky është një plan i ri për skllavërimin e popujve arabë.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në kohën kur me të vërtetë ishte në rrezik ekzistenca e këtyre vendeve, kur u sulmua Egjipti nga ushtritë imperialiste anglo-franko-izraelite, nuk ndërmorën asnjë masë në mbrojtje të popullit egjiptian.

Sot, kur pozitave të dy vendeve kryesore kolonialiste, të Anglisë dhe të Francës, u dobësuan, imperializmi amerikan nuk vonoi të shkojë deri atje sa, nën maskën e ndihmës kundër një rreziku që nuk ekziston, të pregatitë ndërhyrjen ushtarake amerikane në vendet arabe. Kuptohet se qëllimi i vërtetë i Shteteve të Bashkuara të Amerikës nuk është mbrojtja e popujve arabë nga «komunizmi ndërkombëtar», por marrja nga ana e tij e pozitave sunduese ekonomike e politike në këto vende, pasi u dëbuan andej Anglia dhe Franca. Kjo po-

litikë përbën një rrezik të madh për paqen në Lindjen e Afërme dhe në botë.

Agresioni anglo-franko-izraelit kundër Egjiptit dhe fitorja e këtij të fundit ashpërsuan kontradiktat midis popujve afrikano-aziatikë dhe imperializmit. Ata e dënuan agresionin dhe përkrahën Egjiptin. Kjo fitore rriti besimin në forcat e tyre, në çështjen e tyre të drejtë; ajo shtoi urrejtjen e tyre kundër imperializmit.

Me qëndrimin demagogjik që mbajtën në Organizatën e Kombeve të Bashkuara kundër agresionit anglo-franko-izraelit, Shtetet e Bashkuara të Amerikës synonin të rritnin influencën e tyre në këto vende. Por shpallja e «doktrinës Ajzenhauer» do ta acarojë luftën e këtyre popujve kundër imperializmit, do t'i ngrejë ata edhe kundër imperializmit amerikan dhe do të shpejtojë procesin e çlirimit të tyre. Popujt arabë nuk do të lejojnë të futen nën një zgjedhë të re, sado që të mundohen imperialistët ta fshehin atë nën maskën e demagogjisë.

Rezistenca e popujve të pavarur afrikano-aziatikë kundër imperializmit gëzon përkrahjen e Bashkimit Sovjetik, të Kinës e të të gjitha vendeve të kampit socialist, si dhe të forcave paqedashëse të botës. Faktet po tregojnë gjithnjë më shumë se situata në këto vende nuk mori kursin që dëshironin të impononin imperialistët. Lufta e tyre kundër imperializmit do të acarohet deri në asgjësimin e plotë të kolonializmit.

Miqësia në mes të popujve arabë dhe vendeve të kampit të socializmit me Bashkimin Sovjetik në krye është një fitore e shkëlqyer, që është arritur në saje

të politikës paqedashëse të vendeve të kampit të socializmit.

Janë vendosur marrëdhënie miqësore në mes të shtetit tonë dhe Republikës së Indisë, të Egjiptit, të Sudanit si edhe me Sirinë, Libanin, Tunizinë etj. Më përpara, vendin tonë s'e peshonte njeri, sepse ai ishte një koloni në duart e ujqërve imperialistë. Sot opinioni i shumë vendeve afrikano-aziatike dhe udhëheqës të shquar të këtyre vendeve janë shprehur me simpati për popullin tonë. Ne mendojmë se Shqipëria u intereson në mënyrë të veçantë popujve arabë për disa arsye të posaçme, por të një rëndësie të dorës së parë, siç janë: 1) Çështja e çlirimit të popullit tonë të vogël nga zgjedha e kolonizatorëve me luftë të armatosur dhe me ndihmën e Bashkimit Sovjetik, çështje që imperialistët dhe kolonizatorët kërkojnë ta errësojnë. 2) Çështja e afirmimit të shtetit tonë të demokracisë popullore si një shtet i pavarur, sovran, shtet që tregoi qëndrueshmëri të madhe, që u rezistoi me heroizëm dhe me sukses të gjitha orvatjeve të panumërta të imperialistëve dhe të shërbëtorëve të tyre, të cilët brenda këtyre 12 vjetëve u përpoqën t'i merrnin popullit fuqinë nga duart, por dështuan në çdo përpjekje të tyre, sepse populli luftoi me heroizëm, pse ishte vigjilent dhe pse shteti ynë kishte mbrojtjen e Bashkimit Sovjetik. 3) Përparimet e mëdha të popullit tonë në ekonomi, në kulturë, në arsim, në çështjet sociale, përmirësimi i jetës së popullit dhe vrulli i pandalshëm i tij për ndërtimin e socializmit, nën udhëheqjen e Partisë së Punës, Parti marksiste-leniniste, kundër së cilës janë përqëndruar bateri të mëdha të imperialistëve, të antimarksistëve, të revizionis-

tëve, të trockistëve e të tjerë. 4) Për opinionin e vendeve arabe është interesant fakti se si në demokracinë popullore të Shqipërisë, ku popullsia në shumicën dërmuese ka qenë e besimit musliman dhe ku shumë zakone e mënyra jetese kanë qenë të ngjashme me të atyre (pse si ne dhe ata kemi vuajtur nën zgjedhën e egër të osmanllinjve shekuj me radhë), është bërë ky përparim i madh, janë zhdukur mbeturinat e këqia të së kaluarës së hidhur, është zhdukur analfabetizmi, është krijuar një industri moderne socialiste, po ndërtohet rendi socialist në fshat dhe gratë kanë hequr perçen dhe shteti, duke qenë afetar i vendosur, toleron dhe nuk prek fenë dhe ndjenjat e besimit të popullit. Të gjitha këto dhe të tjera krijojnë në opinionin përparimtar arab interesim për vendin tonë dhe njëkohësisht një dashuri e simpati të madhe për popullin tonë. Ne i kemi të gjitha mundësitë ta bëjmë tani të njohur edhe më shumë realitetin tonë shqiptar në vendet arabe etj., dhe sigurisht me forcat tona të japim dhe ne kontributin tonë modest në çelnykosjen e miqësisë së këtyre popujve me popujt e kampit socialist. Shembulli i Shqipërisë u shërben këtyre vendeve që ta shohin se marksizëm-leninizmi është fari ndriçues i jetës së begatshme e të lirë të popujve. Shembull për këtë është vetë ekzistenca dhe jeta e lumtur dhe e begatshme e një populli të vogël, siç është populli i vogël shqiptar, që rron i lirë, sovran, i nderuar, i respektuar dhe me të gjitha të drejtat, ashtu si edhe një shtet i madh.

## **2. — DËSHITIMI I KUNDËRREVOLUCIONIT FASHIST NË HUNGARI**

Karakteristika kryesore e gjendjes së sotme ndërkombëtare është lufta e ashpër që po zhvillohet midis të dy kampeve, midis kampit të socializmit dhe kampit imperialist, që po humbet vazhdimisht terren, por që mban akoma pozita të forta.

Forca e kampit të socializmit është faktor kryesor dhe vendimtar për ruajtjen e paqes, pengesë kryesore për planet agresive imperialiste dhe bazë, mbështetje e patundur, e luftës së të gjithë popujve që luftojnë për lirinë dhe pavarësinë e tyre, për ruajtjen e paqes e për zhvillimin paqësor të marrëdhënieve midis shteteve. Për këto arsye qarqet sunduese të shteteve imperialiste ndjekin një politikë lufte kundër kampit socialist dhe në radhë të parë kundër Bashkimit Sovjetik.

Bloku ushtarak i Atlantikut Verior, bazat ushtarake që imperialistët dhe në radhë të parë Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë krijuar rreth Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të tjera të kampit socialist, fondet prej 100 milion dollarësh që kongresi amerikan ka caktuar çdo vit për akte diversioni në vendet tona, propaganda e shfrenuar e ndezjes së luftës kundër vendeve tona, përkrahja dhe mobilizimi i të gjithë renegatëve e tradhëtarëve të socializmit, të gjitha këto e të tjera janë shfaqje të qarta të politikës së luftës kundër kampit të socializmit.

Në mbledhjen e fundit të Këshillit të NATO-s, si metoda kryesore më e mirë dhe më e mundshme e kësaj lufte, u konsiderua organizimi i punës së kundër-

revolucioneve në vendet socialiste për të përçarë këto vende e për të minuar nga brenda pushtetin popullor.

Në planin e komplotit të tyre të përgjithshëm kundër Bashkimit Sovjetik dhe vendeve socialiste një rol të dorës së parë zinte kundërrevolucioni në Hungari, i cili kishte për qëllim të përmbyste pushtetin popullor dhe ta zëvendësonte atë me pushtetin e çifligarëve dhe të kapitalistëve, me diktaturën hortiste-fashiste.

Duke shpërthyer kundërrevolucionin në Hungari, imperialistët njëkohësisht kishin për qëllim të krijonin një vatër lufte dhe agresioni në mes të vendeve të kampit të socializmit, në kufitë e Bashkimit Sovjetik, të Çekosllovakisë e të Rumanisë dhe të përçanin vendet e kampit të socializmit, t'i shkëputnin ato nga Bashkimi Sovjetik për t'i shkatërruar pastaj një e nga një, të përçanin lëvizjen komuniste botërore.

Ndërhyrja e imperialistëve në Hungari është faktori kryesor i kundërrevolucionit. Ata kishin organizuar me kohë banda kriminelësh, hortistësh e fashistësh të regjur, që i futën në tokën e Republikës Popullore të Hungarisë gjatë përgatitjes së kundërrevolucionit. Ata organizuan një propagandë të shfrenuar kundër Bashkimit Sovjetik, kundër kampit socialist, kundër Partisë së Punonjësve Hungarezë, kundër pushtetit popullor në Hungari. Fakte të shumta flasin shumë qartë tani për këtë ndërhyrje të tyre të hapët në Hungari.

Veprimtaria e imperialistëve gjeti mbështetje te armiqtë e brendshëm, te armiqtë e pushtetit popullor, te armiku i klasës. Forcat hortiste në Hungari kanë qenë të shumta. Armiku i klasës, i shpronësuar, por jo i zhdukur, gjatë këtyre 12 vjetëve të pushtetit popullor, nuk



flinte, por punonte dhe priste çastin oportun që, duke pasur ndihmën e imperialistëve, të hidhej në sulm kundër Republikës Popullore të Hungarisë, për të përmbysur pushtetin e popullit dhe për të rivendosur pushtetin e tij kapitalist. Reaksioni i brendshëm mundi të ruajë forcat e tija e të organizohet edhe në konditat e ekzistencës së pushtetit popullor në Hungari, dhe pastaj të kalojë në sulme të hapëta, deri në kryengritje të armatosur, për arësye të dobësive e të mungesës së vigjilencës së udhëheqjes së mëparshme të partisë dhe të shtetit hungarez. Dihet se në fazën e kalimit nga kapitalizmi në socializëm klasat antagonistë nuk zhduken, se armiku i klasës punon dhe përdor çdo mënyrë për të luftuar kundër pushtetit popullor. Që të shtypet armiku duhet të forcohet diktatura e proletariatit, të forcohet vigjilencia revolucionare.

Një rol të rëndësishëm në ngjarjet hungareze, në përgatitjen e shpërthimit e kundërrevolucionit luajtën elementët antimarksistë, oportunistë, tradhëtarë brenda e jashtë radhëve të Partisë së Punonjësve Hungarezë, me Imre Nagin në krye. S'është e para herë që imperializmi përdor forcat e djathta, oportunistët, deviatorët e tradhëtarët në luftën e tij kundër lëvizjes punëtore, kundër lëvizjes komuniste. Rasti i Hungarisë është një provë e re e mobilizimit të të gjitha forcave armike të socializmit në shërbim të imperializmit.

Njëkohësisht duhet theksuar se gabimet e udhëheqjes së mëparshme të partisë e të shtetit hungarez, të cilat krijuan situata jo të mira, ngjallën pakënaqësi në masat punonjëse dhe u shfrytëzuan nga kundërrevolucionarët. Mosnjohja e forcave të reaksionit dhe lëshimet

që u bënë lejuan armiqtë që, nën maskën e luftës kundër gabimeve, të cilat mund dhe duhej të rregulloheshin brenda kuadrit të pushtetit popullor, të mashtrojnë masat punonjëse dhe të shpërthejnë kundërrevolucionin e përgjakshëm dhe të egër.

Por me gjithë këto, planet e armiqve dështuan. Kundërrevolucioni në Hungari u asgjësua. Duke iu përgjegjur thirrjes së qeverisë së punëtorëve dhe të fshatarëve hungarezë, Bashkimi Sovjetik e ndihmoi popullin hungarez për të dërmuar armiqtë e tij, për të shpëtuar lirinë, pavarësinë, pushtetin popullor dhe socializmin. Duke ndihmuar popullin hungarez në luftën e tij kundër armiqve imperialistë dhe armiqve të brendshëm, Bashkimi Sovjetik plotësoi një detyrë të lartë internacionaliste dhe i bëri njëkohësisht një shërbim shumë të madh gjithë çështjes së socializmit, gjithë lëvizjes komuniste botërore.

Duke i cilësuar ngjarjet hungareze ashtu siç ishin, si një kundërrevolucion të shpërthyer nga imperialistët në bashkëpunim me armikun e klasës dhe me elementët antimarksistë e tradhëtarë të klasës punëtore, si Inre Nagi me shokë, Partia jonë mbajti një qëndrim të vendosur dhe të drejtë marksist-leninist. Vlerësimi i Partisë sonë u vërtetua plotësisht i drejtë.

Çdo vlerësim i ngjarjeve hungareze, që nuk bëhet nën prizmin e luftës së klasës, është i padrejtë, antimarksist, dëmton rëndë çështjen e socializmit, ndihmon armiqtë e socializmit, është një qëndrim armiqësor edhe kundër interesave të klasës punëtore dhe të socializmit. Përpyekjet e udhëheqjes së Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë dhe gjithë propaganda e tyre për të shpje-

guar ngjarjet hungareze si një «revolucion popullor të të gjitha masave punonjëse», i shkaktuar jo nga armiqtë, por nga «sistemi politik burokratik dhe nga gabimet e klikës Rakoshi-Gero», jo vetëm nuk kanë asnjë bazë, por janë një orvatje armiqësore për të errësuar gjendjen, për të fshehur e për të mënjanuar luftën e klasave, për të goditur sistemin e demokracisë popullore, për të mbjellë konfuzion në radhët e partive komuniste e punëtores, për të vënë në gjumë vigjilencën e tyre kundër armiqve.

Faktet që shpiten në konkluzionin se udhëheqësit jugosllavë nuk janë të larë në kundërrevolucionin hungarez, por përkundrazi kanë përgjegjësi të madhe për zhvillimin e ngjarjeve në Hungari, janë të shumta:

a) Pas Kongresit XX të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, nën flamurin e luftës kundër «gabimeve të Stalinit» dhe për përhapjen e «rrugës jugosllave» si «e vetmja rrugë e drejtë për ndërtimin e socializmit», oportunistët dhe armiqtë e marksizëm-leninizmit në Hungari shpërthyen një propagandë të madhe për diskreditimin e Partisë së Punonjësve Hungarezë dhe për përçarjen e organizatave të partisë e të shtetit hungarez. Krahas kësaj u bë një fushatë e gjerë për rehabilitimin dhe për ardhjen në krye të partisë e të shtetit hungarez të Imre Nagit si një «njeri i persekutuar pa të drejtë», «si njeriu që duhej të udhëhiqte Hungarinë në situatën e re». Gjithë kjo fushatë u mbështet fuqimisht nga shtypi jugosllav dhe nga njerëzit jugosllavë. Shtypi jugosllav para shpërthimit të kundërrevolucionit ishte i mbushur me lajme e artikuj që bënin fjalë mbi aktivitetin e elementëve antimarksistë, mbi punën armiqë-

sore që zhvillohej në klubin «Petëf» dhe mbi gjithë punën antisovjetike, antisocialiste e revizioniste që zhvillohej në atë kohë në Hungari. Në Budapest agjentët jugosllavë kishin liri të plotë veprimi dhe me grupet e ndryshme antiparti zhvillonin një fushatë të gjerë mbi «ndërtimin specifik të socializmit në Jugosllavi», duke minuar kështu pozitën e Partisë së Punonjësve dhe të qeverisë popullore hungareze.

b) Kur shpërtheu kundërrevolucionin, udhëheqësit jugosllavë qenë të parët që e përshëndetën atë me anë të shtypit e të mesazheve të drejtëpërdrejta të Titos si një revolucion popullor. Ndërsa të gjitha partitë marksiste-leniniste demaskuan hapët kundërrevolucionin dhe Nagin, shtypi jugosllav vazhdimisht e mbrojti qeverinë e Nagit. Jugosllavët kishin vendosur ushtrinë e tyre gjatë kufirit hungarez, gati për ta futur në Hungari. Siç kanë deklaruar zyrtarisht vetë, po të mos kishte ndërhyrë Ushtria Sovjetike më 4 nëntor, ata do të kishin futur ushtrinë e tyre në Hungari. Ja deri ku kishte arritur puna. Hyrja e ushtrisë jugosllave në Hungari do të kishte ndërlikuar jashtëzakonisht shumë situatën ndërkombëtare. Hungaria, pjesëtare e Traktatit të Varshavës, në kohën që kishte shpërthyer një kundërrevolucion fashist, do të sulmohej edhe nga një ushtri e huaj. Atëhere shteteve anëtare të Traktatit të Varshavës, duke përmbledhur dhe Ushtrinë Sovjetike që qe në Hungari, do t'u duhej ta likuidonin këtë sulm armiqësor. Vetëm ndihma e Ushtrisë Sovjetike për shtypjen e kundërrevolucionit evitoi këtë provokacion ndërkombëtar.

c) Në kohën kur u dërmua kundërrevolucionin,

Udhëheqësit jugosllavë mbajtën një qëndrim armiqësor kundër Bashkimit Sovjetik, e dënuan ndihmën që ai u dha punonjësve hungarezë për shtypjen e kundërrevolucionit dhe e quajtën «intervencion». Imre Nagi, i cili thirri trupat imperialiste në ndihmë dhe që sigurishte kishte në plan dhe ndërhyrjen e forcave jugosllave, nën udhëheqjen e të cilit bandat fashiste vranë e varën mijëra komunistë e punëtorë, gjeti strehë në legatën jugosllave në Budapest.

Udhëheqësit jugosllavë dhe propaganda e tyre ishin me të tëra forcat kundër riorganizimit të Partisë Revolucionare të Punëtorëve e Fshatarëve, kundër forcimit të diktaturës së proletariatit. Kardeli foli hapët kundër masave të qeverisë hungareze. Ai kërkoi që pushtetin ta merrnin këshillat territoriale të punëtorëve (të mbushura me kundërrevolucionarë) dhe i ftoi udhëheqësit hungarezë të ndryshojnë rrënjësisht sistemin politik të Hungarisë. Është e qartë se, duke marrë parasysh që në Hungari gjatë vjetëve para kundërrevolucionit ndërtohej socializmi, kërkesa e Kardelit për «ndryshimin rrënjësor të sistemit politik» do të thotë vetëm likuidimi i diktaturës së proletariatit dhe rivendosja e sistemit kapitalist. Me një fjalë, qëndrimi i udhëheqjes e i shtypit jugosllav nuk mund të konsiderohet veçse si një ndërhyrje në punët e brendshme të Hungarisë, për të penguar partinë dhe qeverinë hungareze në zhdukjen e mbeturinave të kundërrevolucionit dhe në normalizimin e situatës.

Kundërrevolucioni i shkaktoi Hungarisë dëme të mëdha materiale, vështirësoi shumë gjendjen ekonomike të popullit, krijoi anarki dhe konfuzion të

madh. Partia u likuidua nga goditjet e kundërrevolucionit, nga përçarjet e brendshme të elementëve anti-marxistë.

Me të gjitha forcat tona të mundshme ne duhet të ndihmojmë popullin hungarez, vëlla dhe aleat, të shërojë sa më shpejt plagët.

### 3. — NGJARJET NË POLONI

Edhe në Poloni, kohët e fundit, kur u rrit veprimtaria armiqësore kundër vendeve të kampit të socializmit, ngjanë gjëra të papëlqyera, të cilat krijuan një situatë të rëndë, sido që ato nuk u zhvilluan si në Hungari.

Forcat reaksionare, elementët e djathtë dhe oportunistë, pas Kongresit XX të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, nën parullat demagogjike të luftës kundër «kultit të Stalinit» dhe «burokratizmit», «për demokratizimin e sistemit socialist», «për një rrugë të re polake», «për barazinë», «për mosdërhyrjen në punët e brendshme», «për sovranitetin dhe independencën nga Bashkimi Sovjetik» etj., filluan një ofensivë të tërbuar për të denigruar Bashkimin Sovjetik, vetë Partinë Punëtore të Bashkuar Poloneze dhe pushtetin popullor në Poloni. Në shtypin polonez, deri edhe në organin e Komitetit Qendror «Tribuna Ludu» u lihej vend gjithnjë më tepër artikujve dhe propagandës nacionaliste borgjeze, propagandës së ideologjisë reaksionare. Më vonë gjendja u bë edhe më e rëndë, derisa reaksioni kaloi në veprime të hapëta armiqësore, në aksione të ar-

matorura, si në Poznan<sup>1</sup>, dhe në akte e demonstrata anti-sovjetike. Elementëve nacionalistë borgjezë iu la rruga e lirë dhe ata, duke përfituar nga disa gabime të vërtetuara në marrëdhëniet e Bashkimit Sovjetik me Poloninë, të cilat duhej të ndreqeshin në rrugë normale, shpërthyen në një fushatë të egër kundër Bashkimit Sovjetik, për të prishur miqësinë e popullit polak me popullin sovjetik, për të ndarë Poloninë nga kampi i socializmit. Forcat reaksionare dhe elementët e djathtë filluan të nënvleftësojnë çdo gjë që ishte arritur në Poloni nën pushtetin popullor dhe, duke spekuluar e duke ekzagjeruar disa vështirësi ekonomike, të krijuara në Poloni gjatë kësaj periudhe, filluan një fushatë të madhe për të revizionuar vetë sistemin politik të demokracisë popullore, për ta zëvendësuar atë me një sistem të ri, që t'i përgjigjej «socializmit të ri», vijës «nacionale», «specifike» polake. Kjo punë armiqësore gjeti shesh të lirë, sepse mungonte uniteti i partisë, sepse udhëheqja ishte e përçarë nga elementët oportunistë dhe nuk mundi t'i luftojë me energji dhe vendosmëri armiqtë dhe demagogët.

Plenumi VIII<sup>2</sup> i Partisë Punëtore të Bashkuar Poloneze u mbajt në një situatë ku predominonin parullat antisovjetike, oportuniste, të djathta. Në plenum u shprehën mendime e u morën edhe disa vendime, që neve nuk na duken të drejta. Partia dhe qeveria polake

---

<sup>1</sup> Është fjala për revoltën kundërrevolucionare të organizuar nga imperializmi ndërkombëtar dhe revizionistët në Poznan të Polonisë në qershor 1956 për të përmbysur rendin socialist e për të rivendosur kapitalizmin në Poloni.

<sup>2</sup> Zhvilloi punimet në tetor 1956.

mund të kenë bërë gabime (këtë e dinë shokët polakë), por ne mendojmë se këto mund të ndreqeshin në rrugë normale e jo të quhej Plenumi VIII «revolucionari polonez i tetorit», «rilindje e Polonisë» etj. Neve na duken të padrejta pikëpamjet dhe vendimet në lidhje me rolin drejtues të partisë në sistemin e diktaturës së proletariatit, në lidhje me marrëdhëniet e partisë me partitë e tjera jomarksiste, me rolin ndërkombëtar të Bashkimit Sovjetik e të eksperiencës sovjetike, me politikën agrare, me kishën katolike etj. Kjo është çështje e brendshme e Partisë Punëtore të Bashkuar Poloneze, por ne si internacionalistë themi se nuk e kemi të qartë pse u hoqën nga byroja politike dhe nga sekretariati shumë shokë që mund të kishin bërë gabime praktike, por që janë revolucionarë të vjetër, besnikë të marksizëm-leninizmit e të Bashkimit Sovjetik. Këtë pyetje e bëjmë edhe për arsye se Partia jonë, kur ka marrë masa ndaj disa udhëheqësve që kishin gabuar, e ka vënë në dijeni Partinë Punëtore të Bashkuar Poloneze në shenjë miqësie dhe solidariteti internacionalist.

Duke u mbështetur në shtypin polak, ne mendojmë se pas Plenumit VIII pati shfaqje jo të drejta. U bënë aktive e konferenca partie, ku në mjaft raste rrëzohehin shokët e vjetër punëtorë dhe zgjidheshin elementë oportunistë. Në organizatën e rinisë filluan diskutime dhe shthurje të mëdha. Gjithë udhëheqja e bashkimeve profesionale u hoq dhe u zëvendësua me të rinj. U larguan nga ushtria shumë oficerë të sprovuar, midis të cilëve edhe Rokosovski dhe filluan të rehabilitohen shumë oficerë, midis të cilëve dhe oficerë të vjetër, oficerë që ishin arratisur jashtë ose që kishin shërbyer në for-



cat ajrore angleze (RAF). U liruan nga burgjet me dhjetëra mijë vetë. U shpërndanë shumë kooperativa bujqësore. U gjallërua aktiviteti i klerit katolik dhe u lejua të jepet mësim feje në shkolla.

Partia jonë nuk ishte drejtpërdrejt e informuar se ç'po ndodhte në Poloni, por duke marrë parasysh këto gjëra, që merrnim vesh nga shtypi zyrtar polak, ne mbajtëm një qëndrim të rezervuar, por të drejtë për këto ngjarje, qëndrim që mund të mos u ketë pëlqyer shokëve polakë. Çështjet që neve s'na u dukën të drejta, në kundërshtim me marksizëm-leninizmin dhe me unitetin e kampit të socializmit ia thamë haptas Partisë dhe mendojmë se bëmë shumë mirë dhe kështu do të veprojme kurdoherë.

Kohët e fundit situata ka bërë disa përmirësime, por megjithkëtë ne mendojmë se ka akoma mjaft gjëra të paqarta. Gomulka ka thënë se në parti tani ka 3 rryma: ata që janë me Plenumin VIII, «konservatorët» dhe revizionistët, të cilët mbajnë akoma pozita të forta në parti. Në shtypin polak vazhdojnë të dalin pikëpamje jo të drejta, antimarksiste e antisovjetike. Ne mendojmë se shokët polakë nuk e çmojnë drejt nevojën e forcimit të diktaturës së proletariatit në situatën e sotme dhe nuk po bëjnë luftë të vendosur kundër reaksionit e ideologjisë së huaj. Siç e tregon edhe shtypi i tyre, ata janë për një qëndrim më të butë ndaj imperializmit, kanë rezerva në lidhje me vlerësimin e rolit ndërkombëtar të Bashkimit Sovjetik e të eksperiencës sovjetike. Udhëheqësit polakë ngulmojnë për «rrugën specifike polake të ndërtimit të socializmit». Deri sot Partia e Bashkuar Punëtore Poloneze nuk ka mbajtur asnjë qëndrim kun-

dër devijimeve serioze oportuniste, revizioniste dhe antimarksiste të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë. Përsa u përket shkaqeve të ngjarjeve hungareze, shokët polakë s'janë dakord me pikëpamjen se imperializmi është shkaktari i tyre kryesor. Përpjekjet e udhëheqësve polakë për të siguruar ndihma nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe nga imperialistët e tjerë neve na duken veprime të dyshimta dhe shumë të rrezikshme, pavarësisht nëse shteti polonez ka apo s'ka aq nevojë për këto ndihma nga amerikanët, të cilët kanë për qëllim vetëm t'i shkatërrojnë dhe t'i skllavërojnë vendet tona socialiste.

Ne shpresojmë se gjendja në Poloni do të shkojë drejt përmirësimit më të madh të saj, se klasa punëtore dhe Partia Punëtore e Bashkuar Poloneze do t'i kapërcejnë këto vështirësi. Ne, në frymën e internacionalizmit proletar, duhet të punojmë, si të gjitha partitë marksiste-leniniste, që të ndihmojmë në përmirësimin e gjendjes në Poloni, në forcimin e pozitave të marksizëm-leninizmit, për të forcuar unitetin e kampit tonë me Bashkimin Sovjetik në krye. Ne do ta ruajmë miqësinë me popullin vëlla polonez, ne do t'i forcojmë lidhjet shoqërore dhe internacionaliste me partinë poloneze dhe sinqeriteti e guximi leninist nuk do të na mungojnë t'ua themi haptas shokëve polonezë çështjet që nuk na bindin dhe nuk i gjejmë të drejta, ashtu sikundër edhe ata mund të na bëjnë vërejtje neve, kur ta shohin të nevojshme.

#### 4. — LUFTA IDEOLOGJIKE DHE SULMET FASHISTE KUNDËR PARTIVE KOMUNISTE TË VENDEVE KAPITALISTE

Bashkë me ofensivën e tyre kundër kampit të socializmit, imperializmi dhe reaksioni ndërkombëtar shpërthyen sulme të egra kundër partive komuniste dhe punëtore të vendeve kapitaliste. Armiqtë përdorën të gjitha metodat e mundshme që nga shfrytëzimi i ngjarjeve hungareze deri te organizimi i grupeve fashiste të sulmit. Partitë komuniste e punëtore të vendeve kapitaliste qëndruan me guxim para sulmeve të armikut dhe vazhdojnë të mbrojnë me vendosmëri interesat e klasës punëtore dhe marksizëm-leninizmin. Por ndërsa propaganda e shfrenuar e reaksionit kundër Bashkimit Sovjetik, kundër ndihmës që ai i dha popullit hungarez dhe sulmet e vagabondëve fashistë nuk mundën të lëkundnin partitë komuniste e punëtore, ato mundën të influencojnë e të tronditin disa elementë në rrethet e miqve të partisë, në radhët e socialistëve të majtë, bile edhe disa komunistë. Këta ishin përgjithësisht intelektualë jo të qëndrueshëm dhe jo të lidhur ngushtë me çështjen e klasës punëtore, me çështjen e socializmit.

Sidomos të egra qenë sulmet e armikut kundër Partisë Komuniste Franceze. I tërë reaksioni francez u turr me urrejtje kundër saj, duke organizuar edhe goditje me anë të grupeve fashiste, sepse te Partia Komuniste Franceze ata shikojnë një pengesë shumë të madhe për qëllimet e tyre. Partia Komuniste Franceze me qëndrimin e saj i theu përpjekjet e armiqve dhe vazhdon të mbrojë me besnikëri marksizëm-leninizmin, çështjen e klasës punëtore, miqësinë me Bashkimin Sovjetik, çësh-

tjen e socializmit. Kjo i ka egërsuar shumë armiqtë, të cilët kohët e fundit, duke u përpjekur të shpërthejnë një fushatë të re antikomuniste, kanë arritur sa të propozojnë në parlamentin francez shpërndarjen e Partisë Komuniste Franceze dhe një sërë ligjesh nga më reaksionaret që kanë pasë ekzistuar në kohën e fashizmit. Por Partia Komuniste Franceze në krye të klasës punëtore, dhe të gjitha forcat demokratike nuk do të lejojnë një akt të tillë. Partia Komuniste Franceze do të dijë të luftojë me kurajë dhe do të bëjë që të dështojnë edhe këto provokacione të reja fashiste. Partia jonë ka një simpati të thellë për Partinë Komuniste Franceze dhe u ka shprehur shokëve francezë ndjenjat e solidaritetit për luftën e tyre heroike.

Elementët antimarksistë, së bashku me reaksionin dhe imperialistët, shpërthyen një ofensivë edhe kundër Partisë Komuniste Italiane. Pas Kongresit XX, kur imperialistët dhe gjithë armiqtë e socializmit u përpoqën të shfrytëzojnë kritikën që iu bënë J.V.Stalinit për të goditur marksizëm-leninizmin dhe partitë komuniste, pati elementë të lëkundshëm në Partinë Komuniste Italiane, që dolën nga binarët, zhvilluan aktivitet kundër partisë, përhapën «teoritë» antimarksiste dhe pikëpamje armiqësore kundër Bashkimit Sovjetik e vendeve socialiste, popullarizuan socializmin «specifik» jugosllav. Disa nga elementët revizionistë e armiq morën pjesë si delegatë në Kongresin VIII<sup>1</sup> të Partisë Komuniste Italiane dhe atje

---

<sup>1</sup> Kongresi VIII i PKI zhvilloi punimet në Romë prej 8 deri 14 dhjetor. Ky kongres revizionoi parimet programatike e taktike të partisë dhe bëri në statutin e partisë ndryshime të tilla që i hapën rrugën degjenerimit të saj.

vollën vrer kundër marksizëm-leninizmit, Bashkimit Sovjetik dhe demokracive popullore. Ndaj këtyre elementëve u mbajt një qëndrim hezitues dhe kjo patjetër dëmtoi.

Siç e dini nga shtypi, për fat të keq vetë shoku Toliati, megjithëse është një udhëheqës revolucionar i njohur, ka shprehur disa pikëpamje jo të drejta. Në intervistën e tij dhënë në qershor 1956 revistës «Nuovi Argumenti» ai ka shprehur pikëpamjen se «sistemi socialist ka degjeneruar». Po në këtë intervistë shoku Toliati ka shprehur pikëpamje jo të drejta në lidhje me rolin ndërkombëtar të Bashkimit Sovjetik dhe me rëndësinë universale të eksperiencës sovjetike; ai ka thënë se sot është objektivisht e pamundur të ketë një qendër të lëvizjes komuniste ndërkombëtare dhe se kjo lëvizje duhet të ketë karakter policentrik. Në Kongresin VIII të Partisë Komuniste Italiane shoku Toliati shprehu pikëpamje jo të drejta në lidhje me atë që ai e quan «imitim servil të eksperiencës sovjetike nga vendet e demokracisë popullore», dhe përgjithësisht në lidhje me gjendjen në vendet e demokracisë popullore. Në intervistën e qershorit Toliati ka shprehur pikëpamje jo të drejta edhe në lidhje me rolin udhëheqës të klasës punëtore, bile dhe në rezolucionin e Kongresit VIII, ku flitet për forcat lëvizëse të revolucionit, nuk përmendet roli udhëheqës i klasës punëtore. Neve gjithashtu nuk na duket i drejtë qëndrimi i shokëve italianë në lidhje me pikëpamjet antimarksiste të udhëheqjes jugosllave. Në Kongresin VIII këto pikëpamje të rrezikshme revisioniste e antimarksiste nuk u dënuan haptas, bile Lui-

xhi Longo, një nga udhëheqësit kryesorë të Partisë Komuniste Italiane, në dhjetor të 1956-s, pas gjithë atyre gjërave që ngjanë, shkroi një artikull të gjatë për eksperiencën jugosllave. Ne këto i themi, shokë, se na duken jo të drejta dhe shpresojmë se shokët italianë do ta forcojnë partinë e tyre në rrugën marksiste-leniniste.



Nga çështjet që u ngritën arrijmë në konkluzionin se veprimtaria e imperialistëve, agresioni kundër Egjiptit, kundërrevolucioni në Hungari, tentativa në Poloni, sulmi kundër partive komuniste dhe punëtore të vendeve kapitaliste etj., tregojnë se imperializmi nuk ka hequr dorë nga përgatitja e një lufte të re. Në radhë të parë planet e tij agresive drejtohen kundër kampit tonë të socializmit. Armiqtë e socializmit, armiqtë e vendeve tona përfitojnë nga çdo dobësim i vigjilencës, nga çdo dobësim i pushtetit popullor, nga çdo e çarë, sado e vogël, e unitetit të kampit tonë. Prandaj detyra jonë është të forcojmë vigjilencën revolucionare, të forcojmë unitetin e kampit tonë me Bashkimin Sovjetik në krye.

Shokë,

Mendoj se është e nevojshme të ndalemi në disa çështje kryesore që dalin nga analiza e zhvillimit të ngjarjeve ndërkombëtare të kohëve të fundit.

## **I. MBI UNITETIN E KAMPIT SOCIALIST**

Ngjarjet e fundit në arcnën ndërkombëtare karakterizohen nga një sulm i gjithanshëm i reaksionit imperialist dhe i gjithë elementëve revizionistë e antimarksi-stë kundër unitetit të vendeve të kampit të socializmit dhe përgjithësisht kundër solidaritetit të lëvizjes komuniste e punëtore botërore. Armiqtë ndjekin taktikën e vjetër të imperializmit «përça e sundo». Udhëheqja jugosllave ka marrë flamurin e përçarjes së lëvizjes komuniste ndërkombëtare dhe të revizionimit të marksizëm-leninizmit nën parullën e përmbysjes së «stalinizmit» e të «stalinistëve».

### **1. — Roli ndërkombëtar i Bashkimit Sovjetik dhe i eksperiencës sovjetike !**

Për të përçarë kampin e socializmit dhe lëvizjen komuniste botërore, imperialistët dhe revizionistët përpiqen, në radhë të parë, që të izolojnë Bashkimin Sovjetik, duke mohuar rolin e tij ndërkombëtar dhe duke e diskredituar atë.

Roli udhëheqës i Bashkimit Sovjetik në të gjithë lëvizjen komuniste është përcaktuar nga konditat historike, ky është një fakt objektiv.

a) Ky rol udhëheqës në radhë të parë lind nga kuptimi i Revolucionit socialist të Tetorit dhe nga rëndësia e tij ndërkombëtare.

E para, dihet se Revolucioni i Tetorit shënoi një

kthesë në historinë e njerëzimit. I pari në histori ai vendosi diktaturën e proletariatit dhe i dha një hov të madh lëvizjes revolucionare të proletariatit botëror. Që nga Revolucioni i Tetorit proletarët e shumë vendeve të tjera në shembullin e punëtorëve rusë dhe me ndihmën e përkrahjen e tyre thyen zinxhirët e kapitalit dhe sot sistemi socialist përmbledh afro një miliard njerëz.

E dyta, Revolucioni socialist i Tetorit që fillimi i krizës së sistemit kolonial. Dyzet vjet pas Revolucionit të Tetorit një popullsi prej afro një miliard e gjysmë njerëz të vendeve koloniale e gjysmëkoloniale është çliruar, sistemi kolonial është në shthurje të plotë.

E treta, Revolucioni socialist i Tetorit ishte njëkohësisht edhe një revolucion në ideologji, sepse ai i dha fund një herë e përgjithmonë sundimit ideologjik të Internacionales së dytë, shënoi fitoren e marksizmit revolucionar në lëvizjen punëtores ndërkombëtare.

b) Roli udhëheqës i Bashkimit Sovjetik në lëvizjen socialiste ndërkombëtare është bërë realitet historik edhe nga vetë karakteri universal që ka eksperiencia sovjetike. Fakti që Bashkimi Sovjetik nga një vend i prapambetur, që ishte para revolucionit, është kthyer tani në një vend të fuqishëm industrial e me kulturë shumë të zhvilluar, fakti që Bashkimi Sovjetik mundi të korrë një fitore të madhe historike botërore, siç ishte fitorja e tij mbi Gjermaninë fashiste dhe Japoninë militariste në Luftën e dytë botërore, vërtetojnë se eksperiencia e Bashkimit Sovjetik, rruga e ndjekur nga ai janë të drejta dhe kanë një rëndësi universale për të gjithë. Eksperiencia e Bashkimit Sovjetik është jo vetëm shembulli i parë, por shembulli më i shkëlqyer i zbatimit të



marksizëm-leninizmit. Por, siç kanë bërë vazhdimisht armiqtë e marksizëm-leninizmit, ashtu edhe tani revizionistët e rinj, në radhë të parë udhëheqësit jugosllavë, përpiqen me çdo mënyrë të mohojnë karakterin universal të eksperiencës sovjetike. Në këtë drejtim spekulohet shumë me kushtet specifike të çdo vendi, me «komunizmin nacional». Asnjë marksist nuk pretendon se çdo gjë e eksperiencës sovjetike duhet të zbatohet në mënyrë shablone dhe absolutisht kudo; megjithatë çështjet themelore të eksperiencës sovjetike kanë karakter universal. Praktika e lëvizjes komuniste botërore dhe e ndërtimit socialist në vendet e demokracisë popullore vërteton fjalët e Vladimir Iliç Leninit se

*«...disa tipare kryesore të revolucionit tonë nuk kanë një rëndësi lokale, të veçantë nacionale, vetëm ruse, por një rëndësi ndërkombëtare»<sup>1</sup>.*

Udhëheqja jugosllave krahas me mohimin e karakterit universal të eksperiencës sovjetike përpiqet të diskreditojë këtë eksperiencë dhe e paraqet «eksperiencën e socializmit jugosllav» si rrugën e vetme të drejtë dhe bile të domosdoshme për të gjitha vendet.

c) Bashkimi Sovjetik është sot fuqi e madhe ekonomike e ushtarake dhe me autoritet të madh ndërkombëtar. Ai është vendi që në kampin e socializmit ka mundësi të ndihmojë më shumë si me eksperiencën e tij, ashtu dhe me mundësitë e tija materiale të gjitha vendet socialiste, bile edhe vendet që po çlirohen nga

---

<sup>1</sup> V. I. Lenin. Veprat, vëll. 31, f. 5.

zgjedha koloniale. Ky rol i Bashkimit Sovjetik është rezultat i natyrshëm objektiv i zhvillimit historik. Ai s'është vendim arbitrar i «stalinistëve» dhe as mund t'i vihet kryqi për hatër të dëshirës së revizionistëve. Këtë rol të Bashkimit Sovjetik e njohin gjithë partitë marksiste-leniniste, çdo komunist. Në artikullin «Përsëri mbi eksperiencën historike të diktaturës së proletariatit» të organit të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës «Zhenminzhibao» thuhet: «Në interes të çështjes së përbashkët të proletariatit të vendeve të ndryshme, të rezistencës së përbashkët ndaj sulmit kundër çështjes së socializmit nga ana e kampit imperialist, të kryesuar nga Shtetet e Bashkuara, dhe të hovit ekonomik e kultural të përbashkët për të gjitha vendet socialiste, ne duhet të vazhdojmë të forcojmë solidaritetin proletar ndërkombëtar me Bashkimin Sovjetik si qendër të tij»<sup>1</sup>.

Gjithashtu Partia jonë, që në lindjen e saj, e ka parë drejt këtë çështje themelore dhe e ka rrënjosur thellë në zemrën e komunistëve e të popullit të vet.

## 2. — Mbi marrëdhëniet midis vendeve socialiste, midis partive marksiste-leniniste dhe mbi internacionalizmin proletar

Imperialistët dhe revizionistët e marksizëm-leninizmit kanë shpërthyer një fushatë të shfrenuar shpifjesh kundër marrëdhënieve të vendeve socialiste dhe partive

---

<sup>1</sup> Artikull i «Zhenminzhibaos», «Përsëri mbi eksperiencën historike të diktaturës së proletariatit». Shih: «Zëri i Popullit», 30 dhjetor 1956.

komuniste me Bashkimin Sovjetik. Si imperialistët, ashtu edhe elementët oportunistë akuzuan Bashkimin Sovjetik se gjoja kishte vendosur marrëdhënie jo të drejta me vendet socialiste, se gjoja i kishte skllavëruar këto vende dhe, si rezultat, ato kishin humbur pavarësinë e tyre. Ata në mënyrë sistematike nxitën ndjenjat nacionaliste dhe antisovjetike. Ata hodhën parulla demagogjike që të fitohej «independenca» ndaj Bashkimit Sovjetik, të vendosçj «sovrانيتeti» i vendit etj. Udhëheqja jugosllave arriti deri atje saqë Josif Broz Tito në fjalimin që mbajti në Pula deklaroi se shkaku kryesor që provokoi ngjarjet kundërrevolucionare në Hungari qenë marrëdhëniet jo të drejta që ishin vendosur midis Bashkimit Sovjetik dhe Hungarisë. Pra, sipas Titos, përgjegjësia bie jo mbi imperializmin, po mbi Bashkimin Sovjetik.

Por dihet, shokë, se marrëdhëniet e vendeve socialiste me Bashkimin Sovjetik janë marrëdhënie të një tipi të ri, që nuk janë parë në histori. Edhe marrëdhëniet tona me Bashkimin Sovjetik mbështeten mbi parimet leniniste të barazisë së plotë të të dy palëve, të ndihmës shoqërore reciproke, të respektimit të sovranitetit kombëtar dhe të mosndërhyrjes në punët e brendshme, mbi parimet e internacionalizmit proletar, mbi parimet e marksizëm-leninizmit.

Vendi ynë, që është vendi më i vogël i kampit të socializmit, më mirë se kushdo tjetër dëshmon për drejtësinë e marrëdhënieve që kanë ekzistuar midis vendeve socialiste. Partia jonë ka deklaruar se marrëdhëniet tona me Bashkimin Sovjetik kanë qenë të drejta. Përkundrazi, imperialistët dhe udhëheqësit jugosllavë, që na kanë

«këshilluar» të çliroheshim nga Bashkimi Sovjetik, janë sjellë ndaj vendit tonë si shovinistë, si kolonizatorë e si armiq.

Miqësia e singertë e popullit tonë me Bashkimin Sovjetik, ndihma e tij vëllazërore, që i ka dhënë Shqipërisë, jo vetëm që e kanë ndryshuar faqen e vendit tonë nga ana ekonomike dhe kulturele, por kanë forcuar besimin e popullit tonë në forcat e veta, kanë forcuar pavarësinë dhe sovranitetin e atdheut tonë. Në ditët e rënda dhe të vështira të pasluftës, kur vendi dhe populli ynë ishin në mjerim, pa bukën e gojës dhe pa veshje në trup, dhe kur pavarësia dhe sovraniteti i atdheut, të fituara me aq gjak dhe sakrifica, kërcënoheshin nga jugosllavët, shokët e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe J.V.Stalini u thanë delegatëve të Komitetit Qendror të Partisë sonë se *«çdo gjë do të kapërcehet, ne do t'ju ndihmojmë të ndërtoni industrinë tuaj, të mëkëmbni bujqësinë, të zhvilloni arësimin dhe kulturën kombëtare»*. Ata na thanë *«duhet të krijoni kuadrot tuaj nacionalë, dhe keni parasysh se specialistët që ne do t'ju dërgojmë, duhet të kthehen shpejt. Shqipëria duhet të ecë me këmbët e veta»*. Vullneti i Partisë dhe i popullit dhe ndihma vëllazërore e Bashkimit Sovjetik u bënë realitet. U ngritën kombinatet e fabrika, u hapën shkolla e institute, u ndërtuan hekurudha e u organizuan SMT, ndërmarrje transporti etj. Shumë kuadro të talentuar sovjetikë i erdhën popullit tonë në ndihmë dhe mësuan kuadrot tanë. Sot, me mijëra kuadro të vendit drejtojnë kombinatet, fabrikat, minierat, shkollat e institutet. Këshilla e Partisë Bolshevike u vu në vend. Eksperienca e Bashkimit Sovjetik ka

udhëhequr kurdoherë njerëzit tanë. Ne do të përfitojmë nga çdo eksperiencë e mirë e vendeve të tjera.

Udhëheqësit jugosllavë kanë deklaruar se Jugosllavia është i pari vend që ka mundur të vendosë marrëdhënie të «drejta» me Bashkimin Sovjetik e se këto marrëdhënie janë «modeli» që duhet të ndiqet edhe nga vendet e tjera, në qoftë se nuk duam t'u japim shkas «turbullirave» të tilla si ato të Hungarisë. Partia jonë si dhe i gjithë populli ynë i kanë hedhur poshtë këto «këshilla», sepse këto në fakt kërkonin të na shkëputnin nga Bashkimi Sovjetik e nga kampi i socializmit, ashtu siç është shkëputur Jugosllavia.

Dihet se imperialistët, të cilët kanë krijuar një sistem të tërë paktesh, blloqesh e aleancash ndërkombëtare si NATO, SEATO, Pakti i Bagdatit etj., janë shumë të interesuar për të përçarë kampin e socializmit, me qëllim që të realizojnë më lehtë planet e tyre. Për këto arsye, detyrë jetike për Partinë tonë është forcimi i unitetit të kampit socialist me Bashkimin Sovjetik në krye, forcimi i fuqisë ekonomike e ushtarake të këtij kampi, forcimi i Traktatit të Varshavës.

Jugosllavia, megjithëse thotë se është kundër blloqeve, është pjesëtare e Paktit të Ballkanit, dhe nëpërmjet Greqisë dhe Turqisë lidhet me paktet agresive të NATO-s dhe me atë të Bagdatit. Me një fjalë udhëheqësit jugosllavë na këshillojnë që të çarmatosemi.

Lenini i madh na mëson se format e lidhjeve dhe të bashkëpunimit ndërkombëtar midis partive komuniste e punëtore ndryshojnë sipas kushteve historike, sipas gjendjes dhe detyrave të reja që dalin para lëvizjes punëtore ndërkombëtare. Në kushtet e sotme është e

domosdoshme që lidhjet dhe bashkëpunimi midis partive komuniste e punëtore të forcohen edhe më shumë, duke u gjetur rrugët dhe format më të përshtatshme. Partitë tona tani preokupohen dhe mendojnë për gjetjen e këtyre formave që të sigurojnë një bashkëpunim e koordinim sa më të ngushtë e efektiv. Nga ana e tyre udhëheqësit jugosllavë kanë ngritur një «sistem të tërë teorik» për të «vërtetuar» se partitë komuniste duhet të jetojnë të përcara dhe secila të punojë me kokë të vet.

E gjithë kjo, po ta shohim të lidhur me teoritë dhe me pretendimet e tyre për «rolin e madh ndërkombëtar të Jugosllavisë» dhe të «rrugës jugosllave të socializmit», do të thotë: tani për tani të shkëputen partitë komuniste nga lidhjet internacionaliste me Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik e të fillojnë lidhjet me Jugosllavinë dhe pastaj të ngrenë ndërkombëtareen me Titon në krye. Këto pikëpamje janë në kundërshtim me internacionalizmin proletar dhe kanë për qëllim të përçajnë lëvizjen komuniste ndërkombëtare.

Detyra e Partisë sonë, ashtu si e gjithë partive motra, është të luftojmë kundër këtyre pikëpamjeve, si edhe kundër të gjitha përpjekjeve të armiqve për të përçarë kampin e socializmit, detyra jonë është të luftojmë me të gjitha forcat për të çelënikosur unitetin e vendeve socialiste dhe të partive komuniste e punëtore motra. Te uniteti qëndron forca jonë.

**II. MBI NEVOJËN E LUFTËS IDEOLOGJIKE PËR MBROJTJEN E MARKSIZËM-LENINIZMIT NGA ORVATJET E OPORTUNISTËVE DHE TË REVIZIONISTËVE**

Ofensiva që ka shpërthyer kundër ideologjisë marksiste-leniniste zhvillohet paralelisht (në mos e koordinuar) nga forcat e imperializmit e të reaksionit, si edhe nga elementët oportunistë e revizionistë me udhëheqësit jugosllavë në krye. Qëllimi i tyre është të shturin radhët e partive komuniste dhe të devijojnë ato nga rruga e drejtë, të përçajnë vendet socialiste dhe partitë komuniste, ta diskreditojnë marksizëm-leninizmin dhe t'ia heqin klasës punëtore këtë busull, këtë armë të domosdoshme për ndërtimin e socializmit. Karakteristika e kësaj luftime është se ajo zhvillohet me parulla «të majta», ajo zhvillohet nën flamurin e revizionimit të marksizëm-leninizmit. Revizionizmi në lëvizjen punëtore lindi atëhere kur marksizmi siguroi fitoren e plotë teorike mbi armiqtë e tij të hapët dhe prandaj këta filluan të luftojnë kundër marksizmit, të maskuar me petkun e marksizmit, nën flamurin e marksizmit. Duke folur për esencën e revizionizmit, Lenini thotë se ai përpiqet ta kthejë marksizmin në një ikonë të shenjtë,

*«... për të marrë nga marksizmi çdo gjë që është e pranueshme për borgjezinë liberale, deri te lufta për reforma, deri te lufta e klasave (pa diktaturën e proletariatit), deri te njohja «e përgjithshme» e «idealeve socialiste» dhe zëvendë-*

*simi i kapitalizmit me një «rend të ri», dhe për të flakur jashtë «vetëm» shpirtin e gjallë të marksizmit, «vetëm» revolucionizmin e tij»<sup>1</sup>.*

Këtë flamur të revizionimit të marksizëm-leninizmit e kanë marrë sot udhëheqësit jugosllavë dhe prandaj imperialistët i konsiderojnë ata si një mjet kryesor për të luftuar komunizmin. Në mbledhjen e fundit të Këshillit të NATO-s, ministri i punëve të jashtme të Republikës Federale Gjermane, Fon Brentano, shtroi që NATO-ja të përkrahte zhvillimin e «titoizmit në vendet e demokracisë popullore», sepse, sipas tij, «kjo metodë është më e frutshme se sa nxitja direkte e kryengritjeve». Të gjitha radiot e Perëndimit vazhdimisht u bëjnë thirrje popujve të kampit të socializmit të përmbysin udhëheqësit e partisë e të shtetit dhe t'i zëvendësojnë me elementë «antistalinistë», që të heqin dorë nga ndërtimi i socializmit «stalinian» dhe të përqafojnë rrugën e socializmit «nacional e specifik» jugosllav. Armiqtë dërgojnë proklamata të firmuara nga kriminelit fashist Sadik Premtja (që tani quhet shefi i seksionit shqiptar të Internacionales së katërt «komuniste»), ku i bëhet thirrje popullit tonë të përmbysë socializmin «burokratik» dhe të ndjekë rrugën e Titos e të Imre Nagit.

Udhëheqësit jugosllavë i paraqitin «teoritë e tyre» si një «zbulim të madh» në shërbim të lëvizjes punëtore e të mbarë njerëzimit, por objektivisht «teoritë» dhe veprimet e tyre i shërbejnë imperializmit për të luftuar

---

<sup>1</sup> V. I. Lenia. Veprat, vëll. 21, f. 233.



marksizëm-leninizmin, partitë komuniste e kampin e socializmit.

Udhëheqësit jugosllavë i paraqitin «teoritë» e tyre si fjalën e re të fundit të marksizmit, por në fakt «sistemi i tyre teorik» është një përzierje e teorive të kalbura të rrymave të ndryshme antimarksiste, duke filluar nga anarkizmi i Prudonit e i Bakuninit dhe duke mbaruar me Trockin, Buharinin e «opozitën punëtore».

Lufta për revizionimin e marksizëm-leninizmit maskohet tani nën tri parulla kryesore demagogjike:

1) Spekullohet shumë me tezën e drejtë marksiste-leniniste për zhvillimin krijues të marksizëm-leninizmit dhe për luftën kundër dogmatizmit.

Marksistë-leninistët e kuptojnë zhvillimin krijues të marksizëm-leninizmit jo si mohim të bazave të tija, por si pasurim të kësaj teorie me konkluzione e teza të reja të nxjerra nga eksperiencia e luftës së klasës punëtore dhe nga zhvillimi i shkencave. Kurse revizionistët, siç do ta shohim dhe më poshtë, mohojnë bazat kryesore të teorisë marksiste-leniniste si p.sh. luftën e klasave, diktaturën e proletariatit, rolin udhëheqës të partisë etj. Por marksizmi është shkencë dhe ligjet objektive të zbuluara prej tij janë të vërteta absolute, si edhe ligjet e zbuluara nga kimia, fizika etj. Prandaj ato s'mund të vjetërohen ose të rrezohen. Megjithatë Vllahoviçi, anëtar i Komitetit Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, e quan marksizmin si «teori të Marksit të vjetër» dhe gazeta «Borba» shkruan se përveç «stalinizmit» ekziston edhe rreziku i «leninizmit dogmatik», të vjetëruar.

2) Spekullohet shumë dhe me tezën e drejtë mar-

ksiste-leniniste se marksizmi duhet të zbatohet në mënyrë krijuese në konditat e veçanta të çdo vendi.

Marksizëm-leninizmi mëson se me gjithë bashkësinë e tipareve dhe ligjeve të përgjithshme kryesore, format, metodat dhe ritmet e kalimit në socializëm të vendeve të ndryshme mundet të kenë ndryshime të kushtëzuara nga konditat konkrete të zhvillimit të tyre. Duke u kapur pas kësaj, revizionistët, nën parullat e «socializmit specifik e nacional», bëjnë përpjekje për të larguar nga rruga e përgjithshme marksiste-leniniste e ndërtimit të socializmit dhe nga eksperiencia e Bashkimit Sovjetik. Marksizmi mëson se çështjet themelore të ndërtimit të socializmit janë të përbashkëta, se ligjet e zhvillimit të shoqërisë nuk kanë kufi nacionalë. Eksperiencia historike tregojnë se çështje të tilla të përbashkëta janë: diktatura e proletariatit, domethënë vendosja e pushtetit politik të klasës punëtore, nën udhëheqjen e partisë marksiste-leniniste, forcimi me çdo mënyrë i aleancës së klasës punëtore me fshatarësinë dhe me shtresat e tjera punonjëse, likuidimi i pronës kapitaliste dhe vendosja e pronës shoqërore mbi mjetet kryesore të prodhimit, organizimi socialist i bujqësisë, zhvillimi i planifikuar i ekonomisë, udhëheqja nga teoria revolucionare marksiste-leniniste, mbrojtja me vendosmëri e fitoreve të revolucionit socialist nga atentatet e ish-klasave shfrytëzuese dhe nga shtetet imperialiste. Rruga e përgjithshme e ndërtimit të socializmit është rruga kryesore, është, si të thuash, bulevardi. Specifikat e këtij ose të atij vendi janë si rrugicat që i ngjiten këtij bulevardi. Të mos ndjekësh këtë rrugë kryesore, rrugën e përgjithshme marksiste-leniniste do të thotë të futesh në qorr-

sokak. Këtë e vërteton edhe eksperiencia e Jugosllavisë.

Është e qartë se «komunizmin nacional» armiqtë e klasës punëtore e shohin si levën më kryesore, me anë të së cilës do të donin të nxirrnin nga binarët vendet socialiste dhe partitë komuniste dhe kështu ta kthenin prapa rrotën e historisë...

3) Gjithë fushata e tërbuar që kanë shpërthyer imperialistët dhe revizionistët kundër marksizëm-leninizmit, kundër komunizmit, bëhet nën maskën e luftës kundër «stalinizmit». Menjëherë pas Kongresit XX të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik armiqtë i frynë pa masë «gabimet» e Stalinit dhe i trumbetuan nga të katër anët për të diskredituar shtetet socialiste, partitë komuniste dhe udhëheqësit e tyre, për të mbjellë konfuzion ideologjik e përçarje në lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Nën presionin e kësaj fushate elementët oportunistë e të lëkundshëm ngritën krye kudo dhe filluan të punojnë me zell kundër partive politike me parulla false e antimarksiste (si «demokratizimi», «destalinizimi», «indipendenca», «mirëqenia e popullit» etj.) për të luftuar udhëheqjet marksiste-leniniste të partive dhe vijën e tyre të drejtë. Partia jonë para kësaj situatë veprroi drejt. Ajo mori masa për të luftuar elementët që nën flamurin e luftës së «kultit të individit» dëshironin të nxirrnin Partinë nga binarët.

Në dritën e ngjarjeve të fundit u vërtetuan edhe një herë sa me vend kanë qenë qëndrimet e Komitetit Qendror të Partisë, që u aprovuan njëzëri nga Kongresi III në lidhje me luftën e drejtë që u është bërë elementëve të ndryshëm oportunistë, trockistë, revizionistë dhe tradhëtarë, të cilët në veprimtarinë e tyre të hapët apo

të maskuar ishin përpjekur të nxirrnin Partinë tonë nga rruga e marksizëm-leninizmit, të goditnin në zemër Partinë dhe diktaturën e proletariatit, për t'i hapur kështu rrugën vendosjes së kapitalizmit dhe zgjedhës imperia-liste. Këtu synonin planet e armiqve të Partisë, të Tuk Jakovës e të Bedri Spahiut, prekursorët e armiqve të tjerë që ngritën veshët në Konferencën e Tiranës e që ushqeshin, në veprën e tyre tradhëtare, nga burimi i legatës jugosllave. Zhvillimi i hidhur i situatës në Hungari, ku shpërtheu kundërrevolucioni, vërtetoi plotësisht drejtësinë e vijës së Partisë sonë dhe veprimtarinë e saj të drejtë dhe tej pamëse.

a) Ne nuk jemi dakord me gjithë ata që e likuidojnë gjithë veprimtarinë revolucionare të Stalinit dhe shohin në të vetëm anë të zeza. Ne mendojmë se Stalini duhet vlerësuar drejt. J.V.Stalini, siç dihet, është një marksist i madh, se ai pas Leninit e mbrojti marksizëm-leninizmin nga të gjithë armiqtë e revizionistët dhe dha një kontribut të çmueshëm në zhvillimin e mëtejshëm të kësaj shkence. Ai ka merita të mëdha në përgatitjen e zhvillimin e Revolucionit të Tetorit, në ndërtimin e shtetit të parë socialist, në fitoren historike mbi invazorët fashistë, në përparimin e lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare. Për të gjitha këto Stalini gëzonte autoritet të madh jo vetëm në Bashkimin Sovjetik, por edhe në të gjithë botën. Stalini në çështjet kryesore, në mbrojtjen e interesave të klasës punëtore e të teorisë marksiste-leniniste, në luftën kundër imperializmit e armiqve të tjerë të socializmit kurrë nuk gaboi, por ishte dhe mbetet shembull.

Dua të theksoj se udhëheqësit jugosllavë, që bëjnë

kaq zhurmë për kultin e individit të Stalinit e kanë kultin me mjekër në vendin e tyre. Bakariçi, anëtar i Komitetit Ekzekutiv të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, në artikullin e tij me rastin e ditëlindjes së Titos, arrin të thotë se veprat «marksiste» të Titos mund të krahasohen vetëm me veprat më të mira të Marksit, Engelsit dhe Leninit, d.m.th. se Titua qëndron më lart se Marksi, Engelsi e Lenini. Prandaj ne themi se zhurma e udhëheqësve dhe e shtypit jugosllav kundër «kultit të individit» të Stalinit nuk bëhet për të luftuar për mbrojtjen e parimeve marksiste-leniniste, por për të diskredituar sistemin socialist, për të diskredituar udhëheqjet marksiste-leniniste të partive komuniste, për të revizionuar marksizëm-leninizmin dhe për t'i hapur rrugën «socializmit jugosllav».

b) Vlerësimi i drejtë i veprimtarisë së Stalinit ka rëndësi, sepse ai për 30 vjet pas Leninit ka qenë në krye të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe ka udhëhequr Bashkimin Sovjetik e lëvizjen punëtoare ndërkombëtare. Armiqtë, duke e nxirë me bojë të zezë Stalinin, s'e kanë hallin te personi, por kanë qëllim të diskreditojnë Bashkimin Sovjetik, sistemin socialist dhe lëvizjen komuniste ndërkombëtare — rrjedhimisht të minojnë besimin e punonjësve ndaj socializmit.

Në fjalimin që mbajti Titua në Pula në nëntor të vitit të kaluar tha: «Qysh në fillim ne kemi thënë se nuk është fjala vetëm për kultin e individit, por për sistemin që bëri të mundur krijimin e kultit të individit, se këtu qëndrojnë rrënjët, se këtu duhet të goditet vazhdimisht dhe me insistim».

Pra, sipas udhëheqësve jugosllavë, kulti i individit lindi nga sistemi sovjetik, prandaj ky sistem duhet revizionuar (në mos përmbysur) dhe duhet zëvendësuar me sistemin «demokratik jugosllav». Dihet se në ç'mulli vete ky ujë. Ideologët e borgjezisë s'po lënë gjë pa bërë për të vërtetuar se «gabimet» e Stalinit janë pjellë e ligjshme e sistemit sovjetik, se ky sistem është një «gabim», një «eksperiment i dështuar», prandaj punonjësit duhet të heqin dorë nga socializmi dhe të punojnë për «kapitalizmin popullor». Këto pretendime të shtrembëra janë hedhur poshtë nga gjithë historia e zhvillimit të sistemit sovjetik, i cili i ka siguruar Bashkimit Sovjetik suksese kolosale, ka dalë fitues nga provat më të vështira historike dhe u shërben si një shembull i shkëlqyer të gjithë punonjësve që luftojnë për t'u çliruar dhe për të ndër-tuar një jetë më të mirë.

c) Flamuri i luftës kundër «stalinizmit» u shërben udhëheqësve jugosllavë dhe gjithë revizionistëve si maskë për të larë hesapet me gjithë kundërshtarët e tyre. Ata veprojnë kështu: tezat e drejta marksiste-leniniste i quajnë «dogmatizëm stalinist», partitë komuniste e udhëheqësit e tyre, që janë besnikë të marksizëm-leninizmit, i quajnë «stalinistë», sistemet tona shtetërore dhe ekonomike i quajnë «burokratizëm stalinist», dhe çdo gjë «staliniste» u dashka likuiduar e zëvendësuar me «antistaliniste». Ndarja e partive dhe e komunistëve në «stalinistë» e «antistalinistë» dhe shpallja e luftës kundër «stalinistëve», siç bëjnë udhëheqësit jugosllavë, i shërben vetëm përçarjes së lëvizjes punëtore.

Duke u kapur nga gabime dhe të meta që ia atribuojnë Stalinit, ata mohojnë tërë rezultatet që kanë arritur

Bashkimi Sovjetik, demokracitë popullore dhe partitë komuniste gjatë këtyre viteve. Ata thonë se shtetet socialiste dhe lëvizja komuniste ndërkombëtare janë në krizë për shkak se vuajnë nga «stalinizmi». Ata propozojnë si rrugëdalje «rrugën jugosllave të ndërtimit të socializmit». Ata thonë se Jugosllavia, për shkak se u shkëput nga kampi i socializmit më 1948, shpëtoi nga «stalinizmi» dhe prandaj vetëm ajo ka gjetur rrugën e drejtë të ndërtimit të socializmit, që tani duhet t'u shërbejë si model të gjitha vendeve. Bëhet reklamë e madhe për ta paraqitur «socializmin jugosllav» si pa asnjë të metë dhe si modelin e vetëm të drejtë, bile si modelin e vetëm të mundshëm për ndërtimin e socializmit nga të gjitha vendet.

Po si qëndron puna në të vërtetë? A ka treguar «rruga jugosllave» ndonjë epërsi? Përkundrazi vetë udhëheqësit jugosllavë pranojnë dobësitë serioze në rendin shoqëror e sidomos në ekonominë e vendit. Ne e dimë se çfarë «demokracie» u siguron UDB-ja punonjësve jugosllavë. Vetë udhëheqësit jugosllavë kanë pohuar shturjen e madhe në Lidhjen e Komunistëve të Jugosllavisë, pasi u dha orientimi që partia të luajë vetëm rol edukativ.

Dihet se kryesorja është riorganizimi i ekonomisë, bazë e gjithë shoqërisë. Udhëheqja jugosllave flet shumë për riorganizimin e ekonomisë jugosllave, por ç'rezultate ka dhënë ajo? Sipas të dhënave jugosllave, rendimenti i punës në Jugosllavi është më i ulët se në vitin 1939. Indeksi i përgjithshëm i çmimeve të shitjes me pakicë më 1955 u ngrit 27 për qind në krahasim me indeksin mesatar të çmimeve të shitjes me pakicë të vitit 1952. Në fshatin jugosllav sundon ekonomia indi-

viduale. Pas riorganizimit të kooperativave bujqësore, gjatë viteve 1953-1955 nga 4 192 kooperativa mbcten 896. Në vitin 1952-1953 mbcten pa u punuar 358 000 ha. tokë, kurse më 1955-1956, 575 000 ha. Prodhimi i drithërave s'ka arritur nivelin e paraluftës dhe deficitin e drithërave për çdo vit arrin 600 000-650 000 ton. Ekonomia jugosllave varet shumë nga ndihmat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, që i kanë dhënë asaj një ndihmë të madhe prej një miliard e dyqind milion dollarësh. Sigurisht imperialistët amerikanë i kanë dhënë këtë ndihmë të madhe Jugosllavisë jo nga dëshira për të ndihmuar ndërtimin e socializmit. A mund të mendosh se imperializmi mund të të ndihmojë të ndërtosh socializmin që t'i pregaritësh varrin sa më shpejt? Aq më pak mund ta paraqitësh këtë «rrugë ndërtimi të socializmit» si modelin më të mirë.

Sidoqoftë është çështje e «komunistëve» dhe e punonjësve jugosllavë të ndjekin këtë ose atë rrugë, të ruajnë format që u duken atyre më të mira. Pavarësisht se këto neve s'na pëlqejnë, ne s'përzihemi në punët e tyre të brendshme. Por Titua dhe shtypi jugosllav, që janë deklaruar partizanë të flaktë të «rrugëve të ndryshme të ndërtimit të socializmit» dhe të mosndërhyrjes në punët e brendshme, tani jo vetëm bëjnë çmos për të reklamuar «rrugën jugosllave» si të vetmen «recetë të mirë», por «teorikisht» e argumentojnë këtë rrugë si objektivisht të domosdoshme për të gjitha vendet tona. Ata thonë se sistemet tona «staliniste» janë në kundërshtim me ligjet objektive dhe prandaj duhet të zëvendësohen patjetër me sistemin e tipit jugosllav, se përndryshe na kërcënon katastrofa e do ta pësojmë si



Hungaria. Konsekuentë të kësaj, Tito e Kardeli e quajtën kundërrevolucionin fashist në Hungari si revolucion për të përmbysur «regjimin stalinist» dhe Maria Vilfan, sekretare e komisionit të jashtëm të Bashkimit Socialist të Punonjësve të Jugosllavisë, e quan këtë «fillimin e rilindjes së Evropës Lindore». Udhëheqësit jugosllavë kanë deklaruar haptas se ata i vënë vetes detyrë t'ua imponojnë rrugën e tyre partive të tjera, bile «me një luftë të gjatë e të vështirë». Dhe ata që nuk pranojnë rrugën jugosllave udhëheqësit e shtypi jugosllav i quajnë «stalinistë» dhe u bëjnë thirrje komunistëve për t'i përmbysur e për t'i zëvendësuar me partizanë të «kursit të ri». Titua në Pula tha se fati i zhvillimit të lëvizjes punëtore varet «nëse në partitë komuniste do të triumfojë kursi i ri, i cili filloi në Jugosllavi... ose do të fitojë përsëri kursi stalinist» dhe më poshtë vazhdon: «Jugosllavia nuk guxon të ndrydhet në lëvozhgën e vet, ajo duhet të punojë në të gjitha drejtimet... që të triumfojë fryma e re».

Duke marrë parasysh këto, del se sa i çuditshëm është pretendimi i udhëheqjes jugosllave e i «Borbës» se ata as që mendojnë t'u imponojnë rrugën e tyre të tjerëve, se ata «akuzohen» pa të drejtë!

Ja, shokë, ç'rrezik paraqit sot revizionizmi. Ja përse Partia jonë dhe gjithë partitë e tjera marksiste-leniniste duhet të shtojnë vigjilencën dhe të godasin me vendosmëri, pa asnjë lëkundje, të gjithë revizionistët dhe renegatët e marksizëm-leninizmit.

Dua të ndalem gjithashtu dhe në disa çështje të tjera themelore të teorisë marksiste-leniniste, rreth të cilave revizionistët orvaten të përhapin konfuzion ideologjik.

## 1. — Mbi rolin e partisë së klasës punëtore në revolucionin socialist dhe në ndërtimin e socializmit

Në Hungari reaksionarët dhe elementët antimarksishtë e antileninistë i përqëndruan bateritë kryesisht kundër Partisë së Punonjësve Hungarezë, shfrytëzuan gabimet e dobësitë e partisë për të diskredituar Komitetin Qendror dhe për ta shthurur dhe përçarë partinë, u përpoqën të diskreditojnë partinë para masave dhe të ndërsejnë kundër saj shtresat e lëkundura dhe të gjithë armiqtë, e larguan partinë nga udhëheqja e shtetit dhe me krijimin e qeverisë së «koalicionit» të Imre Nagit pushteti në fakt u kaloi partive reaksionare e këshillave kundërrevolucionare, që me terror e masakra u përpoqën të shfarosnin komunistët. Kështu në çastet më tragjike populli hungarez mbeti pa udhëheqje dhe nuk qe në gjendje që, me kohë e me forcën e duhur, t'i mbyllte portën kundërrevolucionit fashist. Edhe një herë u vërtetua se pa udhëheqjen e partisë marksiste-leniniste nuk mund të ekzistojë diktatura e proletariatit.

Por tamam në këto çaste udhëheqja jugosllave po përhap pikëpamjet oportuniste në lidhje me mohimin e rolit udhëheqës të partisë. Mihallko Todoroviçi shkruan: «...socializmi ka fituar një bazë politiko-shoqërore shumë më të gjerë. Kjo s'është çështje e disa partive të caktuara, as edhe vetëm e klasës punëtore, por është çështje e shumicës dërmuese të popullit, çështje nacionale e shumë vendeve dhe gati e çdo vendi».

Kardeli thotë: «Roli i partisë kufizohet gjithnjë e

më shumë në një rol edukativ, kështu që shkëputet lidhja prej aparatit të administrimit shtetëror».

Edhe në Poloni elementët reaksionarë si edhe elementët oportunistë nën parullën e demokratizimit po flasin kundër udhëheqjes së partisë dhe në shtypin e tyre dalin pikëpamje të tilla, kurse në plenumin e sindikatave dhe në konferencën nacionale të rinisë u fol shumë për pavarësinë e organizatave të masave nga partia.

Gjithë eksperiencia historike tregon se sa e rrezikshme është të mohosh rolin udhëheqës të partisë së klasës punëtore, që në fakt do të thotë t'ia heqësh klasës punëtore partinë e vet. Udhëheqja e partisë marksiste-leniniste është një domosdoshmëri jetike për kryerjen e revolucionit socialist dhe për ndërtimin e socializmit e të komunizmit, sepse vetëm partia është e armatosur me shkencën marksiste-leniniste, që i jep asaj mundësinë të njohë ligjet objektive të shoqërisë, vetëm ajo është e zonja të drejtjohë e të koordinojë aktivitetin e gjithë organizatave të klasës punëtore. Duke luftuar pikëpamjet e «opozitës punëtore», Lenini shkruante:

*«Marksizmi na mëson — dhe ky mësim... është vërtetuar... në praktikë nga revolucioni ynë — se vetëm partia politike e klasës punëtore, d.m.th. partia komuniste, është në gjendje të bashkojë, të edukojë, të organizojë një pararojë të tillë të proletariatit dhe të të gjitha masave punonjëse, e cila të jetë në gjendje t'u bëjë ballë lëkundjeve të pashmangshme mikroborgjeze të kësaj mase, traditave dhe recidiveve të pashmangshme të pikëpamjeve të ngushta profesionaliste ose të*

*paragjykimeve profesionaliste midis proletariatit dhe të udhëheqë gjithë veprimtarinë e bashkuar të gjithë proletariatit, d.m.th. ta udhëheqë atë politikisht, dhe nëpërmjet tij të udhëheqë të gjitha masat punonjëse. Pa këtë diktatura e proletariatit është e perealizueshme.*

*Kuptimi jo i drejtë i rolit të partisë komuniste në marrëdhëniet e saja me proletariatin pa parti dhe pastaj në marrëdhëniet e faktorit të parë dhe të dytë me gjithë masën e punonjësve është një largim teorik rrënjësor nga komunizmi dhe devijim drejt sindikalizmit dhe anarkizmit, devijim, i cili mban gjallë të gjitha pikëpamjet e grupit të «opozitës punëtore»<sup>1</sup>.*

Ja, shokë, të mohosh udhëheqjen e partisë marksist-leniniste do të thotë ta lësh klasën punëtore pa shtab drejtues, ta çarmatosësh plotësisht klasën punëtore në interes të borgjezisë, ta tradhëtosh klasën punëtore.

Tezën e tij të gabuar, në lidhje me rolin e partisë, Kardeli e justifikon me pretendimin absurd se udhëheqja e partisë «është e papajtueshme me rolin me të vërtetë vendimtar të masave të prodhuesve...» dhe dëshirën e komunistëve për të forcuar partinë e tyre e shpjegon duke thënë se ata janë mësuar «të mos kenë besim te masat». Por klasikët e marksizëm-leninizmit dhe eksperiencia kanë vërtetuar se ekzistenca e partisë jo vetëm nuk e pengon rolin e masave si krijuese të historisë, por se vetëm nën udhëheqjen e partisë komuniste klasa

<sup>1</sup> V. I. Lenin. Veprat, vëll. 32, f. 200-204.

punëtore, gjithë punonjësit, mund të kryejnë me sukses këtë rol.

*«... proletariati, — thotë Engelsi, — bëhet forcë që prej çastit kur ai krijon një parti punëtore të pavarur»<sup>1</sup>.*

Udhëheqësit jugosllavë pikëpamjet e tyre të shtrembëra në lidhje me rolin e partisë i fshehin nën flamurin e kursit «të destalinizimit e demokratizimit». Kardeli thotë se klasa punëtore dhe masat punonjëse duhet të ushtrojnë një influencë të drejtëpërdrejtë mbi sistemin politik jo nëpërmjet partisë ose nëpërmjet udhëheqjes së saj dhe e konsideron udhëheqjen e partisë si personifikimin e despotizmit burokratik. Kjo është në fakt teza e vjetër e «opozitës parimore» gjermane, e trockistëve, e oportunistëve si dhe e ideologëve të borgjezisë, të cilët, duke u nisur nga roli udhëheqës i partisë në sistemin e diktaturës së proletariatit, thoshin se në Bashkimin Sovjetik ekziston jo diktatura e klasës punëtore, por «diktatura e partisë», «diktatura e udhëheqësve»<sup>2</sup>. Qëllimi i tyre ishte të mohonin karakterin demokratik të shtetit socialist dhe të vinin në opozicion masat me udhëheqësit dhe me partinë. Çdo shtet i çdo tipi goftë udhëhiqet nga klasa sunduese nëpërmjet partisë përkatëse. Nga kjo «burokraci» as një shtet s'është i lirë. Pra të pretendosh që të «demokratizosh» vendin, duke as-

<sup>1</sup> K. Marks e F. Engels, Veprat, bot. II rusisht, vëll. 16, f. 69,

<sup>2</sup> Shih: V. I. Lenin. Veprat, vëll. 31, f. 34.

gjësuar udhëheqjen e partisë marksiste-leniniste, do të thotë t'ia lësh drejtimin një partie tjetër. Këtë e vërteton gjithë historia, këtë e vërteton edhe eksperiencia e ngjarjeve të fundit.

## 2. — Mbi rolin e diktaturës së proletariatit në fazën e kalimit nga kapitalizmi në socializëm

Çështja kryesore e çdo revolucioni është çështja e pushtetit. Nga ngjarjet e kohëve të fundit, sidomos nga ngjarjet në Hungari, komunistët nxjerrin mësim të rëndësishme për forcimin e diktaturës së proletariatit, kurse ideologët e borgjezisë e të revizionistëve të marksizëm-leninizmit përfituan nga këto momente për të nxjerrë nga varri të gjitha shpifjet e «teoritë» e kalbura kundër diktaturës së proletariatit. Udhëheqja jugosllave e ka ngritur mohimin e diktaturës së proletariatit në një «sistem teorik». Nga fjalimi i Kardelit në Oslo dhe nga fjalimi i tij i fundit del një konkluzion: të likuidohet «mekanizmi i shtetit të periudhës kalimtare» d.m.th. diktatura e proletariatit. Ai përdor për këtë çdo rast: ngjarjet në Hungari, luftën kundër «stalinizmit» e «burokrazizmit», decentralizimin e «demokracisë së drejtëpërdrejtë prodhuese» jugosllave, bile mallkon diktaturën e jakobinëve, megjithëse Lenini ka thënë se

*«Jakobinët e vitit 1793 kanë hyrë në histori si një shembull i madh i luftës me të vërtetë revolucionare kundër klasës së shfrytëzuesve nga ana e klasës së punonjësve dhe të shtypurve që*

*ka marrë në duart e veta gjithë pushtetin shtetëror»<sup>1</sup>.*

Kardeli e shokët e tij luftojnë kundër teorisë marksiste-leniniste të diktaturës së proletariatit dhe e quajnë këtë luftë kundër «stalinizmit». Po dihet se Marksi në «Kritikën e programit të Gotës» thotë se «*shteti i periudhës së kalimit nga kapitalizmi në socializëm mund të jetë vetëm diktatura revolucionare e proletariatit*»<sup>2</sup>. Marksi e Lenini kanë luftuar kundër anarkistëve e revizionistëve, të cilët kanë dashur t'i heqin klasës punëtore diktaturën e proletariatit, mjetin e domosdoshëm për ndërtimin e shoqërisë komuniste.

a) Pikësëpari diktatura e proletariatit është e domosdoshme për të shpronësuar klasat shfrytëzuese dhe pastaj për të shtypur përpjekjet e këtyre, si edhe ato të shteteve imperialiste, që së bashku kërkojnë me të gjitha mënyrat të rivendosin kapitalizmin.

Ideologët e borgjezisë dhe revizionistët përpiqen ta diskreditojnë diktaturën e proletariatit, duke e akuzuar si një shtet antidemokratik. Diktatura e proletariatit është i vetmi shtet që siguron për herë të parë në histori demokracinë e vërtetë, sepse ajo është pushteti i klasës punëtore në aleancë me fshatarësinë punonjëse për të shtypur pakicën — klasën shfrytëzuese, sepse ajo mbështetet në pronën socialiste mbi mjetet e prodhimit dhe në çlirimin e masave nga shfrytëzimi. Kurse

<sup>1</sup> V. I. Lenini. Veprat, vëll., 25, f. 54.

<sup>2</sup> Shih: K. Marks e F. Engels. Vepra të zgjedhura, vëll. II, f. 23.

demokracia më e përparuar borgjeze është në thelb antidemokratike, është false dhe e gënjeshtërt, sepse ajo është diktatura e pakicës, është armë e borgjezisë për të shtypur e shfrytëzuar shumicën dërmuese të popullsisë. Edhe në periudhën e luftës më të ashpër të klasave, shteti socialist është njëmijë herë më demokratik nga republika më demokratike borgjeze dhe bile as që mund të krahasohet me të. Kjo s'do të thotë se ne pajtohemi me shkeljet e demokracisë e të ligjshmërisë, ato duhet të mos lejohen, se ndryshe dobësohen e minohen vetë themelet e diktaturës së proletariatit, krijohet rreziku për vetë ekzistencën e kësaj diktature. Ne duhet të luftojmë vazhdimisht për të zhvilluar demokracinë socialiste, të forcojmë gjithnjë e më shumë aleancën e klasës punëtore me fshatarësinë punonjëse dhe me masat e tjera punonjëse.

Lidhur me ngjarjet e Hungarisë, armiqtë e socializmit e revizionistët predikojnë se diktatura e proletariatit duhet të liberalizohet, duke «zbutur» sundimin mbi klasat shfrytëzuese, duke u dhënë liri armiqtë të socializmit. Botëkuptimi dhe pikëpamjet e Tuk Jakovës e të Bedri Spahiut ngjasin si dy pika uji me këto predikime. Ngjarjet në Hungari treguan se një politikë e tillë do të thotë që klasa punëtore me duart e saja t'i hapë portat kundërrevolucionit, përmbysjes së pushtetit të klasës punëtore dhe rivendosjes së diktaturës së borgjezisë. Partia jonë kurrë s'ka shkelur në dërrasën e kalbur ku duan ta çojnë revizionistët. Partia jonë është udhëhequr nga mësimet e Leninit, i cili thotë se

*«Diktatura e proletariatit nuk do të thotë*



*se lufta e klasave ka marrë fund, ajo vazhdon në një formë të re dhe me mjete të reja»<sup>1</sup>.*

*«Diktatura e proletariatit është lufta më heroike dhe më e pamëshirshme e klasës së re kundër një armiku më të fuqishëm, kundër borgjezisë, rezistenca e së cilës është dhjetëfishuar nga përmbysja e saj...»<sup>2</sup>.*

*«Diktatura e proletariatit është një luftë e ashpër, e përgjakshme dhe jo e përgjakshme, violente dhe paqësore, ushtarake dhe ekonomike, pedagogjike dhe administrative kundër forcave dhe traditave të shoqërisë së vjetër»<sup>3</sup>.*

Në periudhën e diktaturës së proletariatit, liria dhe demokracia janë të siguruara vetëm për masat e gjera punonjëse, ndërsa për klasat shfrytëzuese të përmbysura por të paasgjësuar, për armiqtë e socializmit, për agjentët e imperializmit ka vetëm sundim, nuk ka liri e demokraci. Lenini i kërkoi regjimit proletar hungarez të vitit 1919 të përdorë

*«... zbatimin e një dhune të ashpër dhe të pamëshirshme, të shpejtë dhe të vendosur... Kush nuk e ka kuptuar këtë, ai nuk është revolucio-*

<sup>1</sup> V. I. Lenin. Veprat, vëll. 32, f. 553.

<sup>2</sup> V. I. Lenin. Veprat, vëll. 31, f. 8.

<sup>3</sup> Po aty, f. 33.

socialist grabit punëtorët» («Nasha Stvarnost», nr. 7, 8, 1956). Ata kërkojnë që ndërmarrjet të hiqen nga duart e shtetit socialist, që shpreh interesat e gjithë shoqërisë, dhe t'u jepen grupeve të prodhuesve ashtu siç kërkonte Prudoni dhe «opozita punëtore». Marksi dhe Engelsi që në Manifestin Komunist kanë thënë se shteti socialist duhet të centralizojë në duart e tija të gjitha mjetet e prodhimit.

Përsa i përket «vetadministrimit të ndërmarrjeve», këshillat punëtore s'e kanë justifikuar veten. Vetë shtypi jugosllav dhe Titua e Kardeli pohojnë se kjo formë administrimi ka lindur tendenca anarkiste, konkurrence, shpërdorim të mjeteve financiare e materiale për gjëra që nuk duhen, shpirtin e spekulimit me anë të koniukturës së çmimeve etj. Vlera e formave të ndryshme të administrimit të ekonomisë matet me faktin se sa ato i ndihmojnë zhvillimit të ekonomisë së vendit. Por gjendja e ekonomisë jugosllave (për të cilën folëm më lart) tregon se çfarë rezultatesh ka dhënë «sistemi i demokracisë së drejtëpërdrejtë» në Jugosllavi. Ekonomia jugosllave zvarriset pas lëmoshave të imperializmit amerikan.

Lenini ka theksuar vazhdimisht se teoria e diktaturës së proletariatit është pjesa më esenciale e marksizmit, se pranimi ose hedhja poshtë e diktaturës së proletariatit përbën diferencën më të thellë midis marksizmit dhe borgjezisë së zakonshme të vogël (si edhe të madhe). Pra, ata që revizionojnë teorinë marksiste mbi diktaturën e proletariatit nën flamurin e luftës kundër «stalinizmit» e «burokratizmit» hedhin poshtë gjithë marksizëm-leninizmin, ata në të vërtetë e tradhëtojnë proletariatin dhe hidhen me borgjezinë.

Jo ta asgjësojmë diktaturën e proletariatit, siç thotë Kardeli, por ta forcojmë sa më shumë, të mos lejojmë dobësimin e saj, «liberalizimin e saj», të mos lejojmë konfuzion e çorganizim në radhët e saja, sepse këtë e dëshirojnë armiqtë tanë.

Udhëheqësit jugosllavë flasin shumë për «shuarjen» e shtetit, por marksizëm-leninizmi mëson se kjo çështje shtrohet vetëm atëhere kur të jetë siguruar fitorja vendimtare botërore e proletariatit mbi borgjezinë dhe të jetë zhdukur kështu rreziku i restaurimit të kapitalizmit. Por sot, përkundrazi, imperialistët dhe forcat kundërrevolucionare me çdo mënyrë përpiqen që të përmbysin shtetet socialiste. Të ngresh çështjen e «shuarjes» së shtetit tani do të thotë ta çarmatosësh klasën punëtore. Nga ana tjetër në Jugosllavi nuk dëgjojmë të merren masa për të dobësuar shtetin. Atëhere cili është qëllimi i predikimeve të Kardelit me shokë?

### 3. — Mbi luftën e klasave në fazën e kalimit nga kapitalizmi në socializëm

Ngjarjet politike të kohëve të fundit, e veçanërisht ato të Hungarisë, shënuan një aspirim të luftës së klasave në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare. Kup-tohet, pra, sa e rrezikshme është në këtë kohë që të çorientosh dhe të nanurisësh klasën punëtore dhe të gjithë punonjësit me «teoritë» e mohimit të luftës së klasave. Udhëheqësit jugosllavë po bëjnë tamam këtë punë. Në fjalimin e fundit Eduard Kardeli, duke «vlerësuar» ngjarjet kundërrevolucionare në Hungari, tha:

«Kuptimi i procesit të zhvillimit socialist vetëm nëpërmjet prizmit të pikëpamjes së revolucionit socialist, domethënë nëpërmjet konfliktit midis proletariatit dhe borgjezisë, është një absurditet ideologjik dhe një kuptim reaksionar në pikëpamje politike» (fjalimi në Skupshtinën Popullore të RPFJ më 7.XII.1956). Kjo do të thotë të hidhet poshtë teoria e luftës së klasave, e cila na mëson se kurdoherë ngjarjet historike duhet të shihen nën prizmin e konfliktit midis proletariatit dhe borgjezisë, nën prizmin e luftës së klasave. Konsekuentë në mohimin e luftës së klasave, udhëheqësit jugosllavë kundërrevolucionin fashist në Hungari, barbarizmat dhe raprezaljet e bandave hortiste i quajtën një «revolucion popullor». Duke lexuar fjalimet e udhëheqësve dhe shtypin jugosllav, krijon përshtypjen se imperializmi, planet amerikane për rivendosjen e kapitalizmit në vendet tona, lufta e klasave nuk ekzistojnë në përgjithësi dhe nuk janë një problem që duhet të tërheqë vëmendjen e partive tona. Jo vetëm kaq, po në materialet e tyre ka pësuar një metamorfozë edhe terminologjia më e zakonshme. Kështu, p.sh., fjala «imperializëm» zëvendësohet me terma të tilla si «politika perëndimore e blloqeve» ose «liria e tipit perëndimor» etj. Për udhëheqësit jugosllavë rreziku nuk qëndron aspak te imperializmi, por te «elementët konservatorë e burokratë», siç quajnë ata të gjitha ato parti dhe ata udhëheqës që nuk janë dakord me pikëpamjet antimarksiste të udhëheqësve jugosllavë.

Marksizëm-leninizmi na mëson se në periudhën kapitaltare lufta e klasave është e pashmangshme. Kjo luftë klasash është një realitet objektiv, që është i lidhur me

ekzistencën e klasave shfrytëzuese apo të mbeturinave të tyre, me ekzistencën e agjentëve të imperializmit, me ekzistencën e sektorit të gjerë të prodhuesve të veçjël, me ekzistencën e mbeturinave kapitaliste në ndërgjegjen e njerëzve dhe, më në fund, me vetë ekzistencën e imperializmit, pra të luftës së klasave në shkallë ndërkombëtare. Në lidhje me këtë ja ç'thotë Lenini:

*«Zhdukja e klasave arrihet me anë të një lufte klase të gjatë, të vështirë dhe të vendosur, luftë e cila pas përmbysjes së pushtetit të kapitalit, pas shkatërrimit të shtetit borgjez, pas vendosjes së diktaturës së proletariatit, nuk zhduket... por vetëm i ndryshon format e saj duke u bërë nga shumë pikëpamje akoma më e ashpër»<sup>1</sup>.*

Jeta ka treguar se duke u forcuar socializmi, duke u rritur forcat e tija si brenda vendit, ashtu edhe në shkallë ndërkombëtare, dobësohet baza ekonomike e mbeturinave të klasave shfrytëzuese, pakësohet çdo ditë e më shumë influenca e tyre politike, bile edhe forcat e tyre numerike vijnë duke u pakësuar, por megjithkëtë lufta e klasave nuk shuhet...

Mirëpo pas Kongresit XX të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik elementët oportunistë e liberalë në disa vende e kuptuan në mënyrë dogmatike dhe oportuniste problemin e luftës së klasave. Kjo solli si pasojë uljen e vigjilencës, ndihmoi armiqtë e socializmit në ato vende, ku këto pikëpamje nuk u goditën në kohën e du-

<sup>1</sup> V. I. Lenin. Veprat, vëll. 29, f. 432.

hur. Partia jonë e ka kuptuar dhe e ka shtruar drejt çështjen e luftës së klasave. Komiteti Qendror dhe organizatat e Partisë goditën me kohë manifestimet oportuniste që u shfaqën në disa raste nga elementë oportunistë të paqëndrueshëm. Partia jonë e shtroi drejt se tendenca e dobësimit të armiqve të brendshëm të klasës, krahas me rritjen e forcave tona, nuk ka asgjë të përbashkët me pikëpamjet oportuniste që mohojnë luftën e klasave, me pikëpamjet armiqësore të tipit të buharinistëve, që e shikonin periudhën e ndërtimit të socializmit si periudhë «paqeje e harmonie» midis klasave, si periudhë «ekuilibri të qëndrueshëm», ku lufta e klasave zhduket. Komiteti Qendror shpjegoi se në këtë periudhë lufta e klasave nuk zhvillohet kurdoherë në vijë të drejtë, ajo ka kthesat e zigzaget e saj. Këtë e vërtetojnë më së miri ngjarjet e këtyre viteve: provokacioni i Berlinit në 1953<sup>1</sup>, ai i Poznanit më 1956 dhe sidomos kundërrivolucioni fashist në Hungari.

### III. MBI MARRËDHËNIET TONA ME JUGOSLLAVINË

Eksperienca e Shqipërisë në marrëdhëniet me Jugosllavinë, më mirë se eksperienca e çdo vendi tjetër, tregon qëndrimin e vërtetë të udhëheqjes jugosllave kundrejt marksizëm-leninizmit, sepse në asnjë vend tjetër ata s'kanë ndërhyrë kaq brutalisht sa në Shqipëri. Udhëheqja jugosllave ka mbajtur ndaj Partisë, shtetit dhe po-

---

<sup>1</sup> Provokacioni i Berlinit u krye më 17 qershor 1953 nga Imperializmi për të vënë në rrezik fitoret e socializmit dhe çështjen e paqes.

pullit tonë një qëndrim antimarksist dhe shovinist. Qëllimi i udhëheqjes jugosllave ka qenë që ta kthejë Partinë tonë nga një parti marksiste-leniniste në një parti oportuniste dhe ta bëjë Shqipërinë republikë të shtetit jugosllav. Këtë e vërtetojnë faktet historike që shkurtimisht po i radhit.

a) Udhëheqja jugosllave më 1944, në prakun e çlirimit të Shqipërisë, me anën e Velimir Stojniçit, ndërhyri në punët e Partisë sonë dhe organizoi në Berat një fraksion të rrezikshëm me qëllim që ta largonte Partinë tonë nga vija e drejtë marksiste-leniniste dhe ta përmbyste udhëheqjen e saj. Udhëheqja jugosllave e akuzoi udhëheqjen e Partisë sonë se kishte zbatuar një vijë jo të drejtë, sektare. Por populli ynë në bazë të kësaj vije arriti fitoren historike mbi pushtuesit e reaksionarët e brendshëm. Vija jugosllave që u përpoq të na impononte Velimir Stojniçi errësonte rolin drejtues të Bashkimit Sovjetik, rolin udhëheqës të Partisë, mohonte luftën e klasave dhe u hapte rrugën prirjeve oportuniste.

Pas Plenumit të Beratit u forcuan pozitat e elementëve antiparti si Koçi Xoxe dhe Sejfulla Malëshova në udhëheqjen e Partisë, të cilët mbështetën futjen e «eksperiencës» jugosllave. Udhëheqja jugosllave e akuzon Partinë tonë se e ka dënuar pa të drejtë Koçi Xoxen dhe e quan këtë «patriot» e «marksist». Po ç'ka bërë Koçi Xoxe? Ai u përpoq të asgjësonte Partinë, duke e fshehur dhe duke e shkrirë në Front. Ai shqelmoi parimet më clementare leniniste të ndërtimit të partisë. Ai e vuri Partinë nën kontrollin e organeve të Sigurimit të Shtetit: 15 mijë dosje të anëtarëve të Partisë u gjetën në arkivën e sigurimit. Në çdo organizatë bazë kishte

rrjet të sigurimit. Ai mbliidhte materiale komprometuese dhe po përgatiste komplotin për zhdukjen fizike të udhëheqësve të Partisë dhe të shtetit. Si ministër i brendshëm ai shkeli ligjshmërinë socialiste në mënyrën më brutale. Ai ishte dakord me planet e udhëheqjes jugosllave për ta bërë Shqipërinë republikë të shtatë të Jugosllavisë dhe vepronte në këtë drejtim. Për të gjitha këto faje Koçi Xoxe jo vetëm s'duhej rehabilituar, por po të qe gjallë, duhej varur.

Udhëheqja jugosllave është përgjegjëse për vetëvrasjen e Nako Spirut. Ky në Berat u përzie me Koçi Xoxen etj., por më vonë kuptoi lojën e jugosllavëve dhe u vu në rrugë të drejtë. Nakua s'pati kurajën t'i tregonte Partisë të vërtetën dhe vrau veten. Ju e dini se vrasja e Nakos e ndërlikoi çështjen dhe intrigat e jugosllavëve dhe të Koçi Xoxes me shokë çuan në Plenumin VIII<sup>1</sup>. Pas këtij plenumi ndërhyrjes jugosllave iu hapën portat më shumë.

b) Marrëdhëniet ekonomike në mes të dy vendeve tona kanë qenë në baza antimarksiste dhe kolonialiste, u shkelën edhe rregullat më elementare të marrëdhënieve midis vendeve sovraane. Më 1946 u krijuan gjashtë shoqëri shqiptaro-jugosllave, por pala jugosllave nuk bëri investimet që i takonin, vetëm merrte fitime nga shfrytëzimi i investimeve ekzistuese shqiptare. Parifikimi i monedhës shqiptare me dinarin jugosllav u bë me një

---

<sup>1</sup> Është fjala për Plenumin VIII të KQ të PKSH që u mbajt në shkurt të vitit 1948. Plenumi u përgatit nga grupi i Koçi Xoxes dhe udhëheqësit revizionistë jugosllavë me qëllim që të mposhtnin PKSH dhe të krijonin truallin për kolonizimin e Shqipërisë.



zhvleftësim të madh të frangut shqiptar, duke humbur të paktën 3,5 lekë për çdo frang. Bashkimi doganor u hapi rrugën organizatave tregëtare jugosllave dhe tregëtarëve privatë për të rjepur rezervat e mallrave në tregun tonë. Shkëmbimi i mallrave në bazë të çmimeve të brendshme e jo me çmimet e tregut ndërkombëtar e dëmtoi rëndë ekonominë tonë.

U krijua komisioni i përbashkët i koordinimit të planeve me në krye Krajgerin, komision që që në fakt qeveri mbi qeverinë e shtetit shqiptar. Ne kemi një dokument të planifikimit të firmuar nga Kidriç, ish-kryetar i Komisionit të Planit të Jugosllavisë, ku Shqipëria figuron si republikë e shtatë jugosllave.

Udhëheqja jugosllave bën zhurmë të madhe për ndihmë ekonomike që Jugosllavia i ka dhënë Shqipërisë, por shifrat e kësaj ndihme janë të fryra nga çmimet e larta të importit. Ndihamat për «industrializimin e Shqipërisë» ishin: maqineritë e shkatërruara të Fabrikës së Sheqerit «Ali Kelmendi» në Korçë që në Jugosllavi kishin dalë jashtë përdorimit, punishtja primitive e litarit në Rrogozhinë, që s'i ka mbetur nishan dhe hekurudha që e ndërtoi rinia jonë heroike. Po të bëjmë llogari se sa morën jugosllavët nga ne e sa ne nga ata, s'dihet kush del borxhli. Po pse jugosllavët nuk thonë gjysmë fjale për luftën heroike të dy divizioneve tona, që ndihmuan në çlirimin e Jugosllavisë?

c) Më 1948 udhëheqja jugosllave na kërkoi që të lejonim hyrjen në Shqipëri të disa divizioneve, gjoja për të mbrojtur Shqipërinë nga agresioni i monarko-fashistëve grekë. Në të vërtetë ata donin që ta bënë fakt të kryer pushtimin e Shqipërisë.

Njerëzit e jugosllavëve pëshpëritnin poshtë e lart për bashkimin e Shqipërisë me Jugosllavinë, si republikë e shtatë. Gjithashtu filloi të bisedohej dhe për Federatën Ballkanike. Ne i shkruam udhëheqjes jugosllave që të shpjegonte qëndrimin e saj në lidhje me këtë çështje, po ajo kurrë nuk na u përgjegj.

ç) Udhëheqja jugosllave gjatë kësaj periudhe u përpoq ta izolonte vendin tonë nga Bashkimi Sovjetik, duke thënë se Shqipëria duhet ta marrë ndihmën dhe eksperiencën sovjetike vetëm nëpërmjet Jugosllavisë, se eksperiencia jugosllave vlen për konditat e Shqipërisë, kurse ajo sovjetike s'i përshtatet, se këshilltarët sovjetikë duhet të ikin. Sidomos pas Plenumit VIII këshilltarët jugosllavë u futën kudo dhe ata punuan kundër zhvillimit të ekonomisë sonë dhe që ta bënin këtë drejtpërdrejt të varur nga Jugosllavia. Udhëheqja jugosllave kërkonte ta izolonte Shqipërinë nga e gjithë bota. Në fakt ne nuk kishim marrëdhënie ekonomike me asnjë vend tjetër veç Jugosllavisë, bile dhe me Bashkimin Sovjetik i kishim të kufizuara. Deri më 1948 ne kishim marrëdhënie diplomatike vetëm me Bashkimin Sovjetik, Jugosllavinë, Bullgarinë, Hungarinë dhe Francën.

Letrat e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Rezolucioni i Informbyrosë i vitit 1948 e ndihmuan Partinë tonë që të shohë qartë synimet e udhëheqjes jugosllave ndaj Partisë dhe vendit tonë.

Kritikat parimore që iu bënë atëhere udhëheqjes jugosllave kanë qenë të drejta. Këtë e vërtetojnë edhe pikëpamjet që ushqejnë tani udhëheqësit jugosllavë.

Gjatë viteve 1948-1953 kemi shkruar e kemi vepru-

ar kundër njëri-tjetrit, si ne, si ata. Nuk është e drejtë që të dalë se gjatë kësaj periudhe ne kemi pasur faj. Ata kanë vepruar kundër republikës sonë me të gjitha mjetet, kanë dërguar me qindra diversantë dhe grupe të armatosura, përveç provokacionit grek të 1949-s<sup>1</sup>. Asnjë shtet armik s'ka zhvilluar një veprimtari kaq të tërbuar kundër vendit tonë sa ajo që zhvilloi udhëheqja jugosllave pas vitit 1948.

Siç dihet, udhëheqja e Bashkimit Sovjetik mori iniciativën për të përmirësuar marrëdhëniet<sup>2</sup> dhe bëri të gjitha përpjekjet në këtë drejtim. Ne atëhere propozuam që para se të fillonin bisedimet e Beogradit, të mbledhej Informbyroja, e cila më 1948 vendosi përjash-timin e Jugosllavisë dhe të analizonte çështjen e jugosllavëve, duke nxjerrë të mirat e të metat e tyre dhe të Informbyrosë. Ne mendojmë se kështu do të kishte qenë drejt, sepse kjo nuk do t'i linte udhëheqësit jugosllavë që të mbulonin gabimet e tyre dhe tërë përgjegjë-

---

<sup>1</sup> Në kohën kur forcat e armatosura greke shkelën kufitë e Shqipërisë (2 gusht 1949) klika titiste ndërmori një lëvizje kërcënuese trupash në kufitë veriorë të Shqipërisë, në rrethin e Strugës e të Ohrit dhe mori përsipër armatosjen e elementëve reaksionarë shqiptarë që ishin përgatitur të dilnin në mal për të organizuar një «kryengritje». Veprimtaria e tyre dështoi.

<sup>2</sup> Është fjala për bisedimet midis delegacionit qeveritar të BRSS dhe qeverisë jugosllave që u zhvilluan në Beograd prej 27 majit deri me 2 qershor 1955. Rezultat i këtyre bisedimeve qe Deklarata e Beogradit, e cila shërbeu për rehabilitimin e klikës titiste, duke hedhur poshtë vendimet e Byrosë Informative e vlerësimet e gjithë partive komuniste e punëtoro lidhur me tradhëtinë e kësaj klike.

sinë t'ua hidhnin vendeve tona dhe të dilnin si flamur-tarë të situatës.

Në fakt inisiativën e Bashkimit Sovjetik ata e shpërdoruan. Autokritikë nuk bënë fare, se gjoja ishin marksistë. Ata duhej të bënin autokritikë, atyre u duhej kërkuar që ta bënin këtë. Ata e shfrytëzuan situatën e re për të zhvilluar aktivitet përçarës e minues kundër partive e shteteve të demokracisë popullore. Legatat jugosllave në vendet e demokracisë popullore u bënë qendra të veprimtarisë agjenturale; ato filluan të grumbullojnë elementët antiparti, oportunistë e të lëkundur dhe, nën flamurin e «destalinizimit», t'i ndërsejnë këta kundër partive për të rrëzuar udhëheqjet marksiste-leniniste të partive tona dhe për t'i zëvendësuar me elementë të tyre, për të zëvendësuar vijën e drejtë me vijën titiste. Ata bashkëpunuan edhe me elementë armiq, si p.sh. në Bullgari me ish-ministrin e punëve të brendshme të qeverisë borgjeze bullgare të paraçlirimit. Pas ngjarjeve në Hungari doli dhe më qartë fytyra e udhëheqjes jugosllave.

Partia jonë mbajti qëndrim të drejtë. Ne deklaruar se jemi gati të përmirësojmë marrëdhëniet në baza marksiste-leniniste dhe jo në bazat e vjetra, antimarksiste (e kaluara s'kthehet më). Por udhëheqësve jugosllavë s'u pëlqeu qëndrimi ynë, sepse ata kërkonin të përsëritnin situatën e 1948-s, kërkonin që ne t'u bënim lëshime parimore: 1) të thoshim se jugosllavët s'kanë asnjë gabim; 2) të rehabilitonim Koçi Xoxen etj. Ne këtë nuk mund ta bënim kurrë. Kjo s'do të ishte marksiste, kjo do të ishte tradhëti ndaj Partisë dhe atdheut tonë.

Ndërkaq udhëheqësit jugosllavë vazhduan me intensitet punën kundër Partisë dhe shtetit tonë. Ata kurrë nuk mund të pajtohen me udhëheqjen e Partisë dhe të shtetit tonë. Ata duan të zëvendësojnë këtë udhëheqje, që mbron me kurajë marksizëm-leninizmin, Partinë dhe pavarësinë e vendit tonë, me ndonjë klikë aventurierësh oportunistë, t'i imponojnë Partisë «vijën jugosllave» dhe Shqipërinë ta bëjnë republikë të shtatë të Jugosllavisë.

Ata zhvilluan dhe zhvillojnë një propagandë të shfrenuar në shtyp dhe në radio kundër vendit tonë, duke e paraqitur gjendjen e Shqipërisë si skëterrë, ku mbretëron terrori dhe varfëria.

Legata jugosllave në Tiranë ka zhvilluar dhe zhvillon punë agjenturale, përpiqet të grumbullojë elementët antiparti dhe të organizojë luftën kundër Partisë sonë. Në pranverën e vitit 1956 udhëheqja jugosllave, me anë të legatës së saj në Tiranë, grumbulloi armiqtë e Partisë, Dali Ndreun, Liri Gegën etj. dhe përgatiti një komplot, që kishte për qëllim të përmbyste udhëheqjen e Partisë e të shtetit dhe ta zëvendësonte me armiq të Partisë. Ata organizuan punën armiqësore në konferencën e Tiranës, por Partia e zbuloi këtë veprimtari armiqësore dhe mori menjëherë masat e duhura.

Vetë ministri jugosllav në Tiranë, Arso Milatoviç, zhvillon propagandë dhe flet kundër politikës dhe gjendjes së Republikës Popullore të Shqipërisë, kundër udhëheqjes së Partisë dhe të shtetit tonë, nxit elementë të dobët në veprimtari armiqësore antishtetërore dhe antiparti dhe merret me veprimtari spiu-

nazhi. Për këtë qëllim, ai është përpjekur me anë pre-  
sioni dhe mjetesh të tjera të shfrytëzojë shtetasit ju-  
gosllavë të vendosur prej kohësh në Shqipëri, me të  
cilët mban kontakte aktive, elementë armiq të Partisë  
dhe të pushtetit popullor, individë të ndryshëm që  
shkojnë për punë zyrtare në legatën jugosllave, ose që  
ai i merr rrugës në maqinën e vet duke lëvizur nëpër  
Shqipëri. Duke shkelur edhe dispozitat zyrtare mbi  
qarkullimin e diplomatëve të huaj në vendin tonë, ai  
ka shkuar pa lejen përkatëse në Vlorë, ku, duke abuzuar  
nga mikpritja e një familjeje patriote, ka kërkuar të  
nxjerrë informata me karakter politik e ushtarak mbi  
bazën detare të ishullit të Sazanit. Po kështu ka shkuar  
në Berat dhe ka fotografuar objekte ushtarake të nda-  
luara dhe ka kërkuar të takohet me Tuk Jakovën.

Një çështje serioze është fakti se në Jugosllavi ka  
3 000 e ca të arratisur shqiptarë, midis të cilëve shumë  
kriminelë fashistë. Duke marrë parasysh zhvillimin e  
ngjarjeve në Hungari, ne kemi të drejtë të mendojmë  
se mund të organizohen edhe provokacione me anën e  
tyre, me qëllim që të gjendet shkak për të sulmuar  
Shqipërinë. Në çastet më tragjike në Hungari, Vidiçi,  
nënsekretar i shtetit për punët e jashtme të Jugoslla-  
visë, u tha atasheve të shtypit të Bullgarisë, të Shqipë-  
risë, të Çekosllovakisë etj.: «Prisni, ato që ndodhën në  
Hungari do të ndodhin patjetër edhe te ju». Prandaj  
Partia jonë është e detyruar të jetë shumë vigjilente  
ndaj udhëheqjes jugosllave.

Udhëheqja jugosllave mban një qëndrim shovinist  
e çnjerëzor ndaj popullsisë së Kosovës. Gjendja në këtë  
krahinë është e mjerueshme, udhëheqja jugosllave atje

po ndjek një politikë shfarosjeje. Me dhjetëra mijëra kosovarë detyrohen të lënë tokën dhe shtëpinë për të emigruar në Turqi. Këtë politikë s'e kanë bërë as krajlët e Serbisë. Ajo bën çmos për ta kthyer Kosovën në një bazë kundër Shqipërisë, në një bazë për të bashkuar Shqipërinë nëpërmjet Kosovës me Jugosllavinë.

Shtypi jugosllav në Kosovë e Metohi po zhvillon çdo ditë një propagandë të poshtër shpifëse kundër Partisë dhe Republikës sonë Popullore, saqë «Zëri i Amerikës» ia ka zili. Bëhet pyetja nga ana jonë: përse kjo propagandë kaq e poshtër dhe sidomos e posaçme në Kosovë e Metohi kundër regjimit popullor të Shqipërisë? Vallë a do të vazhdojë gjatë të rrjedhin kështu ndotësira në kanalet e ujërave të zeza të shtypit jugosllav? Për ne është e qartë ku synon udhëheqja jugosllave. Ajo kujton se po i gënjen shqiptarët e Kosovës mbi realitetin e vendit tonë, por edhe në qoftë se mund të ketë të tillë që të jenë gënjyer, shtypi ynë e ka për detyrë internacionaliste të sqarojë të gënjyerit nga propaganda e ndyrë nacionaliste, shoviniste, fashiste.

Partia jonë ka mbajtur dhe mban qëndrim të drejtë për çështjen e Kosovës, një qëndrim marksist, internationalist. Por ne s'mund të mos vëmë në dukje qëndrimin shovinist të udhëheqjes jugosllave në Kosovë për të vërtetuar edhe një herë se ajo është në pozita antimarksiste dhe antinjerëzore kundrejt shqiptarëve të Kosovës.

Si konkluzion, shokë, mund të themi se qëndrimi i udhëheqjes jugosllave kundrejt vendit tonë është haptas antimarksist e shovinist, se ajo gjatë 13 vjetëve ka ndërhyrë sistematikisht në punët e brendshme të Par-

tisë e të shtetit tonë, me qëllim që të realizojë planet e saj kolonialiste ndaj vendit tonë. Këto plane kanë dështuar në saje të qëndrimit të vendosur të Partisë sonë. Kjo gjë e bën udhëheqjen jugosllave që ta sulmojë Shqipërinë më me tërbim se vendet e tjera. Arësye tjetër që udhëheqësit jugosllavë luftojnë me kaq tërbim kundër Partisë sonë është se Shqipëria është dokumenti që tregon pozitën e tyre antimarksiste e shoviniste, që vërteton se tezat e tyre për mosndërrhyrje, për barazi etj. janë vetëm demagogji. Dhe ata duan të zhdukin dëshmitarët që vërtetojnë këtë, ashtu si përpiqet vrasësi të zhdukë gjurmat e krimit.

Gjatë gjithë raportit doli se ç'përfaqësojnë udhëheqësit e sotëm jugosllavë. Ata janë në pozita antimarksiste, ata përpiqen të revizionojnë marksizëm-leninizmin, luajnë një rol përcarës në gjirin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare dhe të kampit të socializmit, ndërhyjnë në punët e partive për të asgjësuar udhëheqësit e tyre, për të minuar partitë komuniste e punëtore dhe për të imponuar të ashtuquajturën vijë jugosllave. Se sa e rrezikshme është bërë përhapja e «teorive» të tyre helmuese dhe e veprimtarisë së tyre armiqësore e vërtetojnë faktet e shumta që u përmendën, duke përmbledhur edhe punën e tyre armiqësore ndaj vendit tonë si edhe rolin e tyre në zhvillimin e ngjarjeve në Hungari. Ata përpiqen të nxitin elementët revizionistë në Poloni, të aktivizojnë elementët oportunistë të Partisë Komuniste Italiane dhe futen kudo që gjejnë të çara. Ata janë shumë aktivë.

Veprimtaria antimarksiste, përcarëse dhe armiqësore që po zhvillojnë udhëheqësit jugosllavë, paralelisht



me veprimtarinë agresive të imperialistëve kundër kampit socialist, përbën një rrezik të madh për gjithë lëvizjen punëtore. Objektivisht kjo veprimtari u shërben planeve të imperializmit. Është e ditur se imperialistët amerikanë i kanë dhënë Jugosllavisë një miliard e dyqind milion dollarë jo nga dëshira për të ndihmuar ndërtimin e socializmit, po sepse shpresojnë ta përdorin Jugosllavinë kundër kampit të socializmit. Që pas vitit 1948 është zhvilluar degjenerimi ideologjik i udhëheqjes jugosllave dhe atje është rritur një brez kuadrosh që mbajnë qëndrim armiqësor ndaj Bashkimit Sovjetik e kampit tonë socialist.

Do të ishte shumë gabim të nënvleftësohej dëmi që mund të sjellë puna përçarëse e udhëheqësve jugosllavë, duke menduar se ata s'kanë kaq forcë. Forca e tyre qëndron në faktin që ata janë antimarksistë dhe prandaj «teoritë» dhe «veprimtaritë» e tyre mbështeten nga të gjithë elementët oportunistë e të lëkundshëm, nga të gjithë armiqtë e socializmit. Në një farë mënyre ata kanë pasur disa rezultate, që, megjithëse të përkohshme, kanë dëmtuar shumë rëndë çështjen e socializmit, si në Hungari.

Ç'qëndrim duhet të mbajmë ndaj tyre? Ne mendojmë se ata nuk do të bëjnë kthesë drejt rrugës marksiste-leniniste. Këtë e themi me plot bindje, sepse mësimet e këtyre trembëdhjetë vjetëve na kanë mësuar të mos u besojmë gënjeshtreve dhe demagogjisë, që kanë pasur për qëllim shkatërrimin e Partisë sonë marksiste dhe të regjimit tonë popullor. Marksistët mund të gabojnë, por kur i njohin gabimet bëjnë kthesë dhe vijnë në binarë. Udhëheqësit e tanishëm jugosllavë

s'janë marksistë derisa jo vetëm s'shohim të bëjnë asnjë kthesë, po thellojnë akoma më shumë punën e tyre anti-marksiste. Mjafton të këndosh artikullin e «Borbës», ku bëhet fjalë për kongresin e tyre të ardhshëm, për të nxjerrë konkluzionin që ky kongres do të bëjë summin e teorisë antimarksiste e revizioniste të një partie në fuqi për të dhënë një vijë, e cila, sipas tyre, duhet të ndiqet nga të gjitha partitë dhe nga të gjitha vendet. Koha dhe veprimet e udhëheqjes jugosllave deri tani nuk na kanë provuar se ne kemi qenë të gabuar në mendimet tona. Le të na i provojë koha dhe veprimet e tyre të ardhshme nëse janë të gabuara këto pikëpamje dhe ne do të jemi gati, si kurdoherë, pse jemi marksistë, të pranojmë nëse gjykimet tona mbi jugosllavët nuk kanë qenë të drejta.

Duke marrë parasysh të gjitha këto në qëndrimin tonë kundrejt udhëheqjes jugosllave, ne duhet të udhëhiqemi kurdoherë nga parimet marksiste-leniniste, pa bërë asnjë lëshim dhe pa lejuar që të cënohen ato, duke pasur gjithmonë parasysh interesat e përgjithshme të lëvizjes komuniste ndërkombëtare dhe të vendit tonë.

Marrëdhënie partie me ta ne nuk dëshirojmë të kemi në këto kushte, por ne do të punojmë për të ruajtur dhe për të forcuar ndjenjat e miqësisë së sinqertë me popujt jugosllavë, do të vazhdojmë rrugën për normalizimin dhe përmirësimin e marrëdhënieve shtetërore midis vendit tonë e Jugosllavisë, mbi parimet e barazisë e të mosndërhyrjes në punët tona të brendshme.

Ne duhet të jemi shumë vigjilentë kundrejt udhëheqjes jugosllave dhe të gjitha përpjekjeve të tyre. Luftën ideologjike kundër pikëpamjeve të tyre revizio-

niste ne jo vetëm nuk do ta zbusim, por do ta forcojmë edhe më tepër, me qëllim që maska demagogjike të shkatërrohet dhe t'i pritët hovi punës shkatërruese të elementëve antimarksistë, që përpiqen të helmojnë me «teoritë» e huaja partitë dhe vendet tona, që të na nxjerrin nga rruga e drejtë marksiste-leniniste, të përçajnë kampin e socializmit dhe lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Qëndrimi kundrejt tyre, pra, duhet të jetë i vendosur, parimor, pa asnjë lëkundje, pa asnjë iluzion, sepse lëshimet e liberalizmi vetëm dëm mund t'i sjellin çështjes sonë.

Nga ana tjetër, ne duhet të jemi gjithmonë gjakftohtë në marrëdhëniet me Jugosllavinë, të mos biem në provokacione, por nga pozita parimore ta kritikojmë udhëheqjen jugosllave, të bëjmë luftë ideologjike e politike kundër saj dhe t'i bëjmë të njohur Partisë e popullit gjendjen e vërtetë në Jugosllavi me pasojat katastrofale të së ashtuquajturës vijë jugosllave.

Shokë,

Sulmi që shpërtheu imperializmi për të ndryshuar zhvillimin e ngjarjeve dhe për të përmirësuar pozitat e tija dështoi.

Kjo periudhë ka qenë një periudhë e vështirë për lëvizjen punëtore ndërkombëtare. Lenini ka thënë se lëvizja revolucionare s'është bulevardi i Nevës. Sulmi i kombinuar i imperializmit, i forcave reaksionare fashiste dhe i revizionistëve kishte për qëllim të përçante unitetin e kampit socialist, unitetin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

edhe me armë (për këtë duhet të jemi të fortë e të gatshëm kurdoherë), por ne duhet edhe në të ardhshmen të ndjekim me vendosmëri rrugën për uljen e tensionit ndërkombëtar, të përpiqemi të mbrojmë paqen. Këtë gjë e bën të mundshme gjendja objektive e raportit të forcave në botë. Këtë gjë e kërkojnë interesat jetike të popujve tanë, që i kanë vënë vetes detyrën të ndërtojnë socializmin, këtë e kërkojnë interesat e mbarë popujve të botës. Por këtë politikë ne do të mund ta zbatojmë me sukses vetëm po të jemi të fortë dhe të bashkuar si një trup i vetëm. Forca dhe uniteti i kampit të socializmit janë faktori kryesor për mbrojtjen e paqes, të lirisë së popujve dhe të përparimit të njerëzimit. Detyra jonë është të rritim vigjilencën kundër armikut të klasës, i cili punon me çdo mënyrë kundër rendit të demokracisë popullore dhe pret rastin e volitshëm për ta goditur atë. Forcimi i vigjilencës, forcimi i lidhjeve të Partisë me masat janë mjete të fuqishme për të luftuar kundër armiqve, për të mos lejuar që ata të prekin sado pak rendin demokratik popullor. Çdo dobësim i rendit tonë demokratik është një lëshim që i bëhet armikut. Prandaj forcimi i pushtetit popullor, që luan rolin e diktaturës së proletariatit, është detyra kryesore e tanishme.

Detyra kryesore e Partisë është të forcojë unitetin e saj ideologjik, organizativ dhe politik, të forcojë e të ngrejë në një nivel më të lartë rolin e saj udhëheqës në luftën për ndërtimin e shoqërisë së re socialiste. Uniteti i Partisë duhet të forcohet dhe të ruhet si sytë e ballit, pse ai është baza e fuqisë së saj. Uniteti i udhëheqjes së Partisë, uniteti i gjithë Partisë në çdo kohë

ka qenë i çelniktë. Si dhi të zgjebosura janë eliminuar përnjëherë dhe me unanimitet të plotë të gjithë ata elementë deviatorë dhe armiç të Partisë, që kanë ngritur veshët për të dobësuar këtë unitet të çelniktë. Forcimi i këtij uniteti ka shkuar gjithnjë duke u rritur. Në çastet e turbullta dhe të rrezikshme të kohëve të fundit, uniteti i gjithë Partisë rreth Komitetit Qendror dhe Byrosë së tij Politike ka qenë i shkëlqyer, i çelniktë, i pamposhtur. Ta ruajmë, ta forcojmë edhe më shumë në rrugën marksiste këtë unitet të çelniktë, garanci e vërtetë e fitoreve të Partisë dhe të popullit.

Në situatën e sotme ka një rëndësi të dorës së parë forcimi i luftës ideologjike kundër pikëpamjeve revizioniste e antimarksiste, forcimi i luftës për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit. Në luftën kundër socializmit elementët antimarksistë, oportunistë e revizionistë luajnë një rol të madh. Dihet se në kushte të caktuara dhe në kohë të ndryshme del në plan të parë herë një formë e luftës së klasave e herë një tjetër. Në kushtet e tanishme në plan të parë ka dalë lufta në fushën ideologjike. Prandaj puna e Partisë për edukimin politik e ideologjik të anëtarëve të Partisë dhe të të gjitha masave merr një rëndësi të dorës së parë, natyrisht pa harruar punën në drejtimet e tjera. Në ditët tona armiqtë e marksizmit punojnë zakonisht në mënyrë të maskuar; ata e veshin veprimtarinë e tyre revizioniste, oportuniste me frazeologji të majta, me parulla «marksiste». Prandaj edhe vigjilenca jonë duhet të jetë gjithnjë më e mprehtë. Le të kemi kurdoherë parasysh fjalët e Leninit të pavdekshëm, i cili thoshte:

*«Mos u besoni frazave, shihni më mirë kush përfiton nga kjo!»<sup>1</sup>.*

Mbrojtja e marksizëm-leninizmit kërkon sot të demaskohet dhe të luftohet në radhë të parë propaganda antimarksiste dhe revizioniste e udhëheqësve jugosllavë. Lufta ideologjike nuk duhet të nënvleftësohet në asnjë mënyrë, sepse helmi i ideologjisë së huaj përdoret nga armiqtë e socializmit për të çarmatosur klasën punëtore. Ngjarjet e fundit vërtetuan se sa dëme të mëdha mund t'i vijnë klasës punëtore kur dobësohet sado pak lufta ideologjike, sa shumë e shfrytëzojnë armiqtë neglizhencën e palejueshme në këtë fushë.

Të gjitha forcat e Partisë dhe të masave duhet të mobilizohen për të realizuar planin e shtetit, sepse kështu ne forcojmë edhe gjendjen politike të brendshme, rritim fuqinë e vendit tonë. Ekonomia jonë popullore po zhvillohet dita-ditës. Vitin që kaloi u shënuan suksese të rëndësishme. Prodhimi i përgjithshëm industrial u realizua 102,2 për qind dhe sektori i ndërtimeve e realizoi planin 105 për qind. Të pakënaqshme duhen konsideruar rezultatet në tregëtinë shtetërore dhe kooperative, si dhe në sektorin e transportit, të cilët nuk realizuan planin. Bujqësia, që zë një vend të rëndësishëm në ekonominë tonë, shënoi një kthesë të madhe përpara i përket kolektivizimit, por duhet thënë se prodhimet, me gjithë rritjen në krahësim me vitet e përparshme bujqësore në përgjithësi, nuk u realizuan. Kjo krijon vështirësi serioze për ekonominë tonë. Ne jemi

---

<sup>1</sup> V. I. Lenin. Veprat, vëll. 19, f. 37.

të detyruar kështu të importojmë sivjet drithëra, pambuk e yndyrna sa asnjëherë. Viti që kaloi nuk ishte i mirë për bujqësinë, por dobësitë e theksuara që vërtetohen në këtë sektor rrjedhin edhe për faktin se kjo degë e rëndësishme e ekonomisë sonë drejtohet akoma në mënyrë të përciptë dhe burokratike. Detyrat që na dalin për realizimin e planit të vitit 1957 janë të mëdha e të rëndësishme. Duhet hequr dorë me vendosmëri nga drejtimi i përgjithshëm dhe të merremi konkretisht me problemet kardinale të ekonomisë, të fuqizojmë aparatin shtetëror, të luftojmë burokracinë dhe të gjitha të metat e tjera. Duhet të forcohet puna politiko-organizative e organizatave të Partisë e të masave, si edhe e të gjitha organeve të propagandës, për të siguruar mobilizimin efektiv të të gjitha masave punonjëse për realizimin e planit.

Partia jonë do të luftojë me të gjitha forcat e saja për të plotësuar këto detyra të mëdha. Besnike deri në fund e marksizëm-leninizmit, ajo do të vazhdojë me vendosmëri të ecë përpara në rrugën e socializmit.

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 41 (2628), 17 shkurt 1957*

*Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## **T'I VËMË RËNDËSI TË MADHE ÇËSHTJES SË PËRMIRËSIMIT TË RACËS SË DHENVE**

*Diskutim në lidhje me pikën e dytë të rendit të ditës  
të Plenumit III të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**16 shkurt 1957**

Edhe unë jam dakord me sa thanë shokët në lidhje me këto probleme të rëndësishme që u ngritën në këtë plenum. Është një fakt dhe të gjithë ne ndjejmë kënaqësi se Partia jonë po ngrihet çdo ditë. Ajo interesohet shumë dhe lufton vazhdimisht për përmirësimin e jetës së popullit, d.m.th. për realizimin e detyrave themelore që i ka vënë vetes përpara. Është kënaqësi e madhe se kuadrot që kanë pasur rastin të mbarojnë shkollat dhe universitetet në Bashkimin Sovjetik, në vendet e demokracisë popullore dhe në vendin tonë, po japin një kontribut të madh në zhvillimin e ekonomisë sonë, dhe

---

<sup>1</sup> Plenumi III i KQ të PPSH që zhvilloi punimet më 13 deri më 16 shkurt të vitit 1957, në pikën e dytë të rendit të ditës, diskutoi rreth raportit «Mbi disa çështje të bujqësisë: zhvillimin e pambukut, përmirësimin e deles dhe zgjerimin e kulturës së agrumeve», paraqitur nga sekretari i KQ të PPSH, shoku Hysni Kapo.



ajo më pozitivja është se po dalin me mijëra kuadro në bazë nga puna praktike, sepse natyrisht të gjithë me shkolla të larta nuk mund t'i bëjmë brenda një kohe kaq të shkurtër; por është inkurajues fakti se duke marrë parasysh zgjuarësinë e madhe të popullit tonë dhe përpjekjet e Partisë, shumë kuadro edhe pa ndjekur shkollat janë ngritur në një nivel mjaft të mirë agroteknik dhe i kuptojnë problemet e bujqësisë dhe të blegtorisë shumë mirë. Në qoftë se këto çështje ata nuk i dinë me rrënjë ashtu siç mund t'i dinë në mënyrë shkencore të thellë ata që mbarojnë shkollat e larta, sidoqoftë, kuadrot tanë, të dalë nga praktika, i njohin elementët e domosdoshëm dhe dinë të zgjidhin shumë probleme, bile në shumë raste mund të themi edhe pa pasur ndihmën e nevojshme nga lart.

Në përgjithësi, mendimi im është se në çdo plenum që bëjmë shohim që kuadrot tanë po rriten vazhdimisht. Edhe diskutimet në këtë plenum kanë qenë jashtëzakonisht të mira. Këtej ne mund të nxjerrim konkluzionin se me këta kuadro që ka rritur Partia mund t'ua arrijmë qëllimeve për problemet që ka vendosur Byroja Politike dhe që u shqyrtuan në këtë plenum.

Qëllimi i Byrosë Politike, kur vendosi të merreshin në shqyrtim këto çështje, ishte që ajo të shkonte edhe më përpara, pa marrë parasysh se plani që kemi vendosur është një plan që na ka bërë të hedhim hapa përpara. Por, po të kishim mundësi të pashfrytëzuara akoma ne mund të ecnim edhe më tutje. Por ne arritëm në konkluzionin që këto detyra që ka caktuar Partia me planin 5-vjeçar, me disa shtesa të vogla duhet të reali-

zohen plotësisht dhe për këtë janë të gjitha mundësitë, Çështja është që, pavarësisht se këtu nuk morëm masa për shtimin numerik të blegtorisë ose për shtimin e sipërfaqes së pambukut etj., ky plenum duhet të shërbejë që të bëjmë një kthesë rrënjësore nga kursi që po ndjekim tani në zhvillimin e pambukut, të deles dhe të agrumeve, pavarësisht se kemi përparime, për arësye se ne duhet të na preokupojë kurdoherë çështja e përmirësimit të jetës së popullit.

Ne mund të themi se niveli i jetesës së popullit tonë nuk ka qëndruar në vend. Përkundrazi, ai ka ecur vazhdimisht përpara. Populli është furnizuar më mirë, ushqehet dhe vishet më mirë, janë bërë disa ulje çmimesh etj. Por këto nuk janë të mjaftueshme dhe të gjithë ne e ndjejmë se ka akoma mungesa, se planet nuk realizohen ashtu si duhet, se nuk shfrytëzohen mundësitë e mëdha që kemi duke marrë parasysh edhe se vendi ynë nuk rron i veçuar po bën pjesë në gjirin e kampit tonë të socializmit dhe nga ana tjetër ai gjeografikisht është i rrethuar nga armiq.

Në krahasim me nivelin e jetesës në vendet e kampit të socializmit sigurisht ne jemi prapa. Por megjithatë ne dimë se nga ana e miqve ndihmat nuk na janë kursyer, ato na janë dhënë dhe do të na jepen vazhdimisht. Përveç atyre që na janë siguruar, miqtë na kanë premtuar se do të na japin edhe ndihma të tjera suplementare për të përmirësuar jetën e popullit tonë, sidomos me artikuj ushqimorë, në drejtim të heqjes së triskave etj. Duke pasur gjithë këto ndihma neve na vihet detyrë që të bëjmë përpjekje të mëdha për të realizuar planet, të shfrytë-

zojmë të gjitha mundësitë tona dhe t'i japim popullit të hajë më mirë dhe të vishet më mirë se deri sot.

Pra qëllimi i plenumit është që të bëhet kthesë në drejtim të rritjes së prodhimeve dhe veçanërisht të pambukut, të agrumeve dhe të përmirësimit të deles, të këtyre tri problemeve të rëndësishme për ekonominë e vendit tonë që u shqyrtuan në këtë plenum.

Por ne nuk duhet të kënaqemi vetëm me sa u tha këtu, por të përfitohet nga kuadrot kryesorë, nga eksperiencia e njerëzve tanë më të mirë, nga eksperiencia e prodhuesve tanë dhe të armatosur me mësimet që morën këtu, kuadrot kryesorë të shkojnë në bazë, të organizojnë mirë punën dhe të zbatojnë gjithë këto detyra që u shtruan.

\*  
\*      \*

Tani do të flas pak për çështjen e dhenve. Këtë çështje duhet ta shtrojmë kështu: populli ynë të ketë më shumë mish, qumësht, gjalpë e djathë për të ngrënë dhe më tepër lesh për t'u veshur e bile po të ketë mundësi edhe për të eksportuar.

Ne jemi një vend blegtoral. Këtë gjë na e kanë theksuar edhe miqtë. Ne do t'ju japim çdo ndihmë, na thanë ata, në këtë çështje, dhe në fakt, menjëherë, porsa kërkuam ndihmë për përmirësimin e racës së dhenve, na u dhanë me mijëra damazë dhe mjete të tjera të nevojshme. Çështja është se vendi ynë është vend blegtoral prandaj edhe ne duhet t'i japim rëndësi të madhe zhvillimit të blegtorisë e veçanërisht çështjes së përmirësimit të racës së deles. Prindërit tanë gjith-

një kanë rritur bagëti. Në vendet e tjera nuk gjen çobanë të tillë si te ne që të kenë një dashuri kaq të madhe për bagëtitë. Por po të marrim këto kushte të favorshme, d.m.th. dashurinë që ka populli ynë për blegtorinë si dhe mundësitë tona për t'i rritur dhe për t'i ushqyer mirë bagëtitë, ne shohim se rezultatet në këtë fushë nuk janë të kënaqshme. Prandaj kjo gjë duhet të na bëjë që të mendohemi shumë, t'i vëmë rëndësi të madhe çështjes së përmirësimit të racës së dhurve.

Të gjithë e theksuan se përmirësimi i racës së dhurve ka një rëndësi të madhe. Bukur e tha ministri i bujqësisë që shumë gjëra, si p.sh. kurset për pregatitjen e teknikëve dhe punë të tjera duhet t'i bëjë ministria. Ajo duhet t'i bëjë medoemos këto punë dhe të kontrollojë zbatimin e tyre, por Partia, duke filluar që nga kreu e deri në fund, si edhe qeveria, jo vetëm që duhet të bëjnë kujdes të madh që të kryhen këto detyra, por dhe të ndjekin e të kontrollojnë zbatimin e tyre, ndryshe nuk ecet. E them këtë se është i pakënaqshëm rezultati i detyrës së vënë në lidhje me rudëzimin e dhurve. Ne kemi kaq vjet që po flasim për këtë çështje. Të gjitha mundësitë i kemi në vendin tonë, por për fat të keq nuk është bërë ndonjë gjë e mirë dhe detyrat që janë vënë nuk janë realizuar; një pakicë jashtzakonisht e vogël e këtyre detyrave është realizuar, gjë që është për të ardhur keq.

Eksperienca e së kaluarës na bën të jemi të kujdesshëm, sepse, siç tha shoku Mehmet, tani ne jemi të detyruar që për përmirësimin e racës të importojmë gjithë këto mjete, të cilat përbëjnë një pasuri të madhe që e sjellim nga jashtë.

Ne edhe përpara kemi ndarë damazë për të përmirësuar racën e lopës, hapëm gjithë ato stacione ndërzimi, por arritëm deri atje saqë për këto stacione, shumë nga të cilat bile ishin bërë ndërtesa të bukura, të paguanim rroga për ata që rrinin e ruanin damazët, të harxhonim gjithë ato fonde dhe ushqime për damazë e më së fundi i mbyllëm. Kjo eksperiencë nuk është pozitive bile është një eksperiencë shumë e hidhur dhe duhet të na bëhet mësim i mirë tani që do të hapim gjithë këto stacione me kaq damazë të shumtë që duan një shërbim delikat, për të cilin u fol mjaft në diskutime.

Prandaj në rast se Ministria e Bujqësisë nuk tregohet rigorozë për zbatimin e këtyre detyrave, në rast se Partia, d.m.th. të gjithë funksionarët e Partisë dhe të shtetit nuk e marrin seriozisht këtë problem dhe nuk mendojnë se nga këto masa dhe nga zbatimi i tyre varet në një shkallë të gjerë përmirësimi i jetës së popullit, në rast se nuk i vënë rëndësi çështjes që në fillim, atëhere përsëri do të qëndrojmë në vend numëro, jeta e popullit nuk do të përmirësohet në shkallën e duhur dhe do të dëmtohet ndërtimi i socializmit në Shqipëri. Prandaj ne duhet t'i qëndrojmë më këmbë këtij problemi, duhet të ngremë kuadrot që do t'i bëjnë këto punë. Por edhe në këtë drejtim ne kemi një eksperiencë shumë të hidhur. Ministria e Bujqësisë ka rritur dhe ka mësuar deri tani me qindra dhe mijëra teknikë të mesëm për të gjitha kulturat, po se ku janë këta kuadro, askush nuk e di. Prandaj, në rast se nuk përfitojmë edhe nga kjo eksperiencë e hidhur, edhe me kuadrot e rinj që do të pregatim në të ardhshmen

kështu ka për të na ndodhur. Për këto çështje ka pasur kritika, por këto kritika ne duhet t'i bëjmë serioze.

Të marrim rritjen e deles. Këtu nuk është çështja si t'i futet shiringa deles, as t'i themi atij që mëson se si ta presë qengjin që lind, por ne në radhë të parë duhet t'i mësojmë çobanit që ata të bëhen mjeshtra të këtyre punëve, sepse nga ata varet nëse do të rrojë apo do të ngordhë qengji. Është thelluar vallë Ministria e Bujqësisë që ta bëjë një gjë të tillë me këta çobanë nga të cilët varet fati i bagëtisë sonë? Ministria e Bujqësisë duhet t'i hyjë në thellësi këtij problemi në mënyrë që këtyre njerëzve t'u shkojnë materiale të thjeshta, që këtyre djemve të thjeshtë dhe të mirë që kanë në dorë fatet e bujqësisë dhe të blegtorisë t'u bëhen sa më të kuptueshme këto gjëra. Çobanët tanë sigurisht kanë për të mësuar shumë gjëra, që nga fillimi e deri në fund, pavarësisht se disa prej tyre që janë djem blegtorësh kanë mësuar nga baballarët e tyre. Mirëpo shkenca është një fushë e gjerë dhe ato që thotë ajo duke u zbatuar janë në dobi të prodhimit. Propaganda e Partisë, lidhur me këto probleme nuk mund të bëhet duke shkruar disa gjëra, por duke i njohur punët, t'i studjosh çështjet, t'i aktivizosh dhe t'i dëgjosh specialistët për studimin e një problemi dhe të nxjerrësh konkluzione e detyra konkrete.

Duhet të bëhen leksione konkrete për çobanët, për brigadierët, duhet që këta të shtyhen t'i mësojnë këto gjëra, por ato duhet të pregatiten thjesht dhe duke ua mësuar njerëzve do të kemi përfitime shumë të mëdha. Kështu edhe ndërzimet artificiale të bagëtive do të bë-

hen më mirë, edhe qengjat do të rriten si duhet, edhe gumshtin do ta shfrytëzojmë si duhet. Po të gjitha këto nuk janë probleme aq të thjeshta dhe Ministria e Bujqësisë nuk duhet t'i marrë kaq thjeshtë çështjet, po t'u shkojë atyre deri në fund. Por që të bëhen këto gjëra kërkohen edhe shpenzime. Ne duhet të përpiqemi që të sigurojmë ca letër, shaptilografe dhe materiale të tjera që i duhen propagandës së prodhimit, e cila ka një rëndësi shumë të madhe, sepse nga një gjë që mund të duket e vogël dhe e thjeshtë, po të mos bëhet, mund të humbasësh prodhime të mëdha që dëmtojnë ekonominë. P.sh. nga një pakujdesi ose nga një ujitje jo në kohë humbet 5 kv. pambuk për ha.

Duke i gjykuar këto çështje në këtë prizëm shpenzimet janë fare të pakta. Prandaj t'i thellojmë mirë këto probleme, t'i bëjmë mirë planet dhe të marrim një sërë masash për t'i dalë në krye kësaj situate dhe të zbatohen këto detyra që shtron Komiteti Qendror të bazuara në planin pesëvjeçar.

Në drejtim të blegtorisë nuk mund të themi se kemi shumë kuadro të lartë. Nga këta ne kemi shumë pak. Por ne kemi shumë kuadro të mirë të prodhimit që kanë fituar një eksperiencë të madhe praktike. Njerëzit e qendrave tona shkencore janë gati të vijnë në çdo plenum dhe të na bëjnë autokritikë e të justifikohen se nuk jemi mirë të lidhur me bazën etj. Këto institute në rast se nuk do ta bëjnë mirë këtë punë atëhere më mirë t'i mbyllim. Ne nuk kemi nevojë që të na rritin atje një dele si nuse të bukur, po puna është që të japin të ardhura të mira, t'i shpërndajmë si duhet dhe t'i përhapim që të ketë përfitime ekonomia e ven-

dit. Por kjo mund të bëhet në rast se këta kuadro lidhen ngushtë me bazën.

Ç'pret Qendra e Zooteknisë në Shkodër? Mos vallë pret që të dalin kuadro nga universiteti dhe t'i bëjë korrespondentë? Korrespondenti më i mirë për shokun Tare Çelo duhet të bëhet Enver Haxhiu. Në rast se e do këtë specialist drejtori i këtij institucioni duhet t'i japë atij detyra, t'i japë damazët më të mirë, ta udhëzojë që të nxjerrë një plan punc duke e ndihmuar ta plotësojë dhe tejkalojë atë. Pastaj kush ka nevojë për të marrë eksperiencë nga këta njerëz të zot të shkojë atje ku punojnë ata dhe jo të bredhin ata nga të katër anët, megjithëse nuk them që edhe ata të mos lëvizin fare.

Përse të bredhë poshtë e lart kryetari i kooperativës së Maminasit? Kush dëshiron që të marrë eksperiencë për rritjen e rendimentit të pambukut të shkojë atje në vend, të shohë se si mbjell, si prashit, si ia bën çekankën dhe shërbimet e tjera kulturale kooperative e Maminasit pambukut dhe shoku i Maminasit së bashku me të gjithë shokët e tjerë të kooperativës që punojnë për të arritur këto rezultate të mira do t'ua japin këtë eksperiencë. Po kjo nuk do të thotë që edhe ai të mos shkojë në vende të tjera për t'u dhënë eksperiencë, të shkojë, por jo në mënyrën si është praktikuar deri sot me këta kuadro.

Kisha për të theksuar diçka edhe për çështjen e kuadrit në sektorin e bujqësisë. Gjithsecili duhet të bëjë detyrën që i është caktuar, sepse shikojmë nganjëherë që Partia merr të gjitha funksionet e pushtetit. Ky është gabim. Nga një anë shohim se sekretarët



e Partisë bëjnë një punë të përciptë, nga ana tjetër shikojmë nëpunësit e grumbullimit që ia kanë lënë të gjithë punën Partisë. Kjo nuk është e drejtë. Partia dhe qeveria i kanë ngarkuar organet e grumbullimit që të mbledhin detyrimet, gjë që nuk e bëjnë si duhet dhe në shkallën më të madhe këtë punë e bëjnë anëtarët e Partisë. Njerëzit e grumbullimit mund të na thonë këtu se kanë pak kuadro. Këtë çështje ne mund ta studjojmë, por në rast se Partia do të udhëheqë konkretisht, ajo për problemet e grumbullimit duhet vetëm të ndihmojë dhe të mos shkojë përditë në derë të fshatarëve. Në një konferencë p.sh. mund t'i bësh apel patriotizmit të fshatarëve që të dorëzojnë detyrimet, pastaj punën konkrete për grumbullimin e detyrimeve duhet ta bëjnë vetë organet përkatëse dhe jo të merren me këtë punë njerëzit e sektorëve të tjerë.

Pse vallë mos janë më pak të rëndësishme problemi i shkollave, i shëndetësisë etj? Drejtuesi i sektorit të shëndetësisë në Elbasan duhet të bëjë përpjekje për të organizuar punën për luftën kundër tuberkulozit që është një detyrë serioze, por nuk e lënë rehat të merret me punët e tija po e marrin dhe e dërgojnë për grumbullimin. Me këtë nuk dua të them se shokët e Partisë nuk duhet të bëjnë punë shoqërore, të bëjnë, por jo të transformohen në funksionarë të grumbullimeve.

Prandaj kuadrot që rrit Partia duhet t'i ndjekim në punë e sipër, t'i ndihmojmë, t'i edukojmë dhe të mos themi se çështjet e sektorëve janë aq të lehta.

Për çështjen e pambukut unë mendoj të qëndrojmë në shifrat që kemi caktuar në planin 5-vjeçar, pavarë-

sisht se ka ekonomi bujqësore që japin rendiment shumë të ulët. Është fare lehtë të zvogëlojmë sipërfaqet e mbjella me pambuk, po neve na duhet pambuk. Po të mos na bëhet në vend ne jemi të detyruar ta sjellim nga jashtë. Nga mosrealizimi i planit të vitit të kaluar në bujqësi jemi detyruar të importojmë me dhjetëra milion rubla sende ushqimore, pambuk e artikuj të tjerë. Po ku do t'i gjejmë ne të gjitha këto? Sigurisht neve për këto deficite na vjen festja vërdallë. Atëhere përse të mos marrim rrugën tjetër d.m.th. të mobilizohen Partia dhe pushteti që këto ekonomi të cilat na kanë dhënë pak dhe që mbjellin nga 2-3 ose 7 dynym, t'i bëjnë shërbime të mira pambukut, ashtu sikurse ia bëjnë edhe arës me misër, duke zbatuar të gjitha rregullat agroteknike që u fhanë këtu? Këtë gjë duhet ta bëjmë sidomos tani që po ecim drejt kolektivizimit të plotë të bujqësisë. Ndryshe do të gjendemi në vështirësi të mëdha.

Pambuku është një bimë shumë delikate, prandaj në rast se nuk ia mësojmë agroteknikën nuk do të kemi suksese ose po t'i bëjmë mirë shërbimet që parashikon agroteknika do të kemi suksese shumë më të mëdha sa dëri tani, që kemi një rendiment mesatar të pakënaqshëm.

Ne nuk duhet të jemi të kënaqur me rezultatet e arritura në kultivimin e kësaj kulture. Por ka edhe shembuj të mirë, ne kemi marrë 14-18 kv. pambuk për ha., kur i është bërë maksimumi i shërbimeve agroteknike. Kështu këto shërbime po të bëheshin edhe në vende të tjera, rezultatet do të ishin shumë të mira. Prandaj propaganda e prodhimit për pambukun dhe

edukimi i kuadrove që merren me kultivimin e kësaj kulture, dhe jo vetëm i kuadrove kryesorë sepse do të na duhet akoma një kohë e gjatë që të kemi nga një agronom të posaçëm për një sasi të caktuar hektarësh për pambuk, duhet të bëhen me kujdes të madh.

Duhet bërë një propagandë intensive me ata që merren me kultivimin e pambukut me qëllim që të përvetësojnë minimumin e rregullave agroteknike. Kështu do të shohim se edhe ata kultivues të pambukut që marrin rendimente të pakta do t'i rritin rendimentet. Pastaj nuk është e vërtetë që këto ekonomi nuk kanë leverdi për mbjelljen e pambukut, po sigurisht kur ai merr vetëm 1 kv. për ha. me një prodhim të tillë nuk ka leverdi. Puna është që ai të mos marrë 1 kv. për ha. por shumë më tepër.

Një rëndësi të madhe ka çështja e farës së pambukut. Mua më duket se Ministria e Bujqësisë dhe Instituti i bujqësisë nuk tregojnë kujdes të madh për këtë çështje megjithëse ata vetë e dinë që edhe fara e mirë pas tre-katër vjetësh degjenerohet. Prandaj ata duhet të ndjekin zhvillimin e farës dhe të merren vazhdimisht me përmirësimin e saj nëpërmjet seleksionimit, duke ecur përpara në shtimin e prodhimit, me mbjelljen e farërave të seleksionuara dhe më të mira.

Kjo punë kaq delikate duhet të vihet në binarë të shëndoshë, se deri sot nuk është marrë seriozisht. Nuk është e lejueshme që drejtori i Institutit të bujqësisë të mos shkelë asnjëherë në njërin nga parcelat e kooperativave bujqësore nga më kryesoret që merr rendimente më të mira nga pambuku. Ai duhet t'u hapë horizontin drejtuesve të kooperativave bujqësore, t'i dëgjojë për

eksperiencën e tyre dhe të ndjekë punën e tyre që nga fillimi i punimeve deri në vjeljen e prodhimeve. Gjatë gjithë kësaj periudhe ai duhet të ketë kontakt me ta, t'i ndihmojë, t'i kontrollojë dhe vetë të bëjë studime e të nxjerrë konkluzione. Një punë të tillë ai duhet ta bëjë jo me një po ta bëjë me dhjetëra e qindra kooperative të vendit tonë që merren me rritjen e kulturës së pambukut. Po kështu qeveria do të mendojë për të shtuar edhe një implant tjetër për tharjen e pambukut, po, derisa ne të krijojmë këtë mundësi, edhe kryetarët e kooperativave, si p.sh. shoku i kooperativës bujqësore të Shirgjanit, të mendojnë edhe vetë pak për mënyrën se si duhet të thahet pambuku që vilet i njomë në ara.

Prandaj duhet që Ministria e Bujqësisë dhe Instituti i Bujqësisë «Miçurin» të interesohen shumë për pambukun. Ata duhet të bëjnë që të gjithë kultivuesit e pambukut të mësojnë minimumin e agroteknikës dhe të jenë të preokupuar se si duhet të rritet kjo bimë në kushtet e vendit tonë. Duke u mësuar këtyre njerëzve minimumin e agroteknikës së pambukut duhet të kemi qëllim jo vetëm të marrim sa më shumë prodhim por të mësojmë edhe njerëzit që të përfitojnë sa më shumë nga puna e tyre. Këtu duhet të synojë më shumë kujdesi i Partisë poshtë dhe i Ministrisë së Bujqësisë që është caktuar të merret me këto probleme.

Për agrumet pak u fol. Duhej të ishin interesuar më tepër shokët për këtë kulturë, sidomos ata të Delvinës. Agrumeve u duhet vënë rëndësi e madhe, sepse ne kemi kushte të favorshme për kultivimin e tyre. Ne duhet t'i marrim të gjitha ato masa që caktohen në

vendim<sup>1</sup>, por duhet t'i lidhim mirë kultivuesit e agrumeve me punën e tyre. Na duket se favorizimet që u bëhen kultivuesve të agrumeve janë të mira dhe ato do t'i japin një hov të madh zhvillimit të agrumeve. Ne do të marrim masa për shtimin e prodhimit të agrumeve, por të mos pritët çdo gjë nga shteti, duhet që edhe vetë kultivuesit e agrumeve të marrin masat që janë në mundësitë e tyre. Kështu duhet menduar edhe për çështjen e ujitjes së agrumeve. Vetë prodhuesit të shfrytëzojnë të gjitha mundësitë, të bëjnë vetë depo të vogla, kanale të vogla që kështu të plotësojnë detyrat që u ngarkohen.

Ne kemi mundësi që jo vetëm t'i realizojmë këto detyra që na ka vënë Komiteti Qendror, por edhe t'i tejkalojmë. Prandaj na bie detyra ta organizojmë mirë punën. Kjo ka rëndësi të madhe por e rëndësishme është që Partia të mobilizohet vetë dhe pastaj të mobilizojë dhe masat e gjera të popullit dhe këtë duhet ta bëjë jo me fjalë të mëdha. Për këtë punë të punojnë njerëzit që dinë t'i flasin konkretisht popullit dhe ata që dinë të flasin me terminologji shkencore të mësojnë nga populli. Ju e patë shokun Abdul Hasani nga Kukësi, blegtor i dalluar, i cili foli për rritjen e deles rudë. Ai mezi fliste këtu, i kullonin djersë, po ai e di shumë mirë zanatin e rritjes së deles. Prandaj të shkojmë në kopënë e tij dhe të mësojmë prej tij. Duhet ta mësojmë

---

<sup>1</sup> Është fjala për vendimin e Plenumit III të KQ të PPSH, datë 16 shkurt 1957 «Mbi zhvillimin dhe përmirësimin e kulturës së agrumeve».

Partinë që të lidhet mirë me detyrat që i vihen përpara se ato janë të mëdha e duhen kryer.

Situata është në favorin tonë. Megjithatë duhet të mos harrojmë se armiku nuk fle. Imperialistët përpiqen me të gjitha mjetet që ta dëmtojnë dhe ta përçajjnë kampin e socializmit, të krijojnë situata të rënda, të ngrenë tensionin ndërkombëtar dhe të përgatitin një luftë të re botërore. Por ata mendojnë që edhe po të mos jenë në gjendje ta bëjnë këtë, të krijojnë të paktën fole të izoluara lufte dhe të punojnë kundër kampit tonë. Këto probleme u rrahën në pikën e parë të rendit të ditës së këtij plenumi. Ne pamë se në këto çështje një rol të madh luan udhëheqja antimarksiste dhe revizioniste jugosllave. Kundër vendit tonë ajo mban një qëndrim të hapët armiqësor, ajo nuk e do të mirën e Partisë dhe të popullit tonë, sepse Partia dhe pushteti ynë qëndrojnë të fortë si graniti dhe mbrojnë me besnikëri interesat e popullit e të atdheut në rrugën marksiste-leniniste. Mirëpo udhëheqjes jugosllave nuk i pëlqen ky qëndrim i tillë i drejtë i Partisë sonë.

Prandaj neve na vihet detyra ta forcojmë pushtetin popullor. Kjo do të thotë që njerëzit e pushtetit të sillen mirë me popullin ashtu si na mëson Partia, kurse me ata që janë armiq të jenë të ashpër. Njerëzit e lëkundshëm t'i bindim të vijnë në rrugën e Partisë. Të luftojmë që të zhdukim burokratizmin dhe brutalitetet, kur shfaqen në njerëzit e pushtetit. Nuk duhet të tregohemi oportunistë, por kurdoherë të kemi si qëllim t'i ndreqim njerëzit që gabojnë dhe t'i bashkojmë rreth Partisë dhe qeverisë, në mënyrë që armiku të mos gjejë asnjë të çarë ku të bëjë punën e tij. Siç dihet armiku

synon të përçajë unitetin e popullit dhe të Partisë, por ai e sheh se çfarë uniteti ka Partia dhe udhëheqja.

Prandaj ne duhet ta forcojmë gjithnjë e më shumë vigjilencën për të realizuar këto detyra të mëdha që na ngarkon ky plenum. Në plenum u tha se mundësi te ne ka, se kuadrot tanë janë të zot për t'i kryer këto detyra, se ata e marrin punën me zell, vetëm duhet që udhëheqja t'i japë një ndihmë të mirë bazës.

Në punët e tyre Komiteti Qendror dhe qeveria kanë të meta, por në drejtimet kryesore dhe në vijë ato nuk kanë qenë gabuar kurrë. Megjithatë të metat ne duhet t'i godasim dhe Partia të mos i mbyllë sytë, bile t'i kritikojë edhe më fort ata që gabojnë se nuk u bie autoriteti. Përkundrazi nga kritikrat njerëzit do të shkunden. Ai që ta do të mirën ta thotë të vërtetën hapët në sy, ndërsa armiku të flet prapa krahëve. Prandaj kur kritikohen anëtarët e Partisë duhet ta kuptojnë drejt. Edhe kur kritikohet një shok udhëheqës kjo nuk bëhet për ta ulur atë, por për t'ia vënë më mirë në dukje të metat dhe për ta ndihmuar.

Komiteti Qendror dhe Byroja Politike kanë besim të plotë se ky plenum do të shënojë një kthesë të madhe në këtë drejtim, se ne i kemi të gjitha mundësitë për t'i realizuar këto detyra të mëdha për popullin tonë.

Më vonë ne do t'ju dërgojmë edhe planin e punës se si do të punohen vendimet e këtij plenumi, bile së shpejti do të bëhet edhe një aktiv i madh në qendër për çështjet bujqësore ku do të analizohen të metat e vërtetuara në bujqësi dhe si janë realizuar detyrat e planit, do të caktohen detyrat për mbjelljet e pranverës. Për pambukun udhëzimet i morët dhe mund të fi-

lloni të punoni menjëherë, por në aktivin që do të bëhet në fillim të marsit do të ngrihet edhe një çështje tjetër e rëndësishme, problemi i misrit. Të gjitha këto materiale do të jenë një ndihmë e mirë dhe konkrete për të punuar.

Nga ana e Byrosë Politike ju rekomandojmë që tani që, kur të vini poshtë, të mblidhni plenumin e komitetit të Partisë (jo të zgjeruar) dhe t'i bëni një raport të shkurtër mbi problemet që u shqyrtuan në këtë Plenum të Komitetit Qendror. Të merrni vendim për mbledhjen e aktivit të Partisë, duke pasur parasysh se nga Byroja Politike mund t'ju vijë udhëzime që sekretari i parë ose sekretari që merret me çështjet ekonomike në komitetin e Partisë të dalë me një raport përpara aktivit, ose mund t'ju vijë një direktivë që sekretari i parë si dhe sekretari që merret me çështjet ekonomike të dalin përpara aktivit me dy diskutime kryesore me anë të të cilave të lidhen problemet politike dhe këto çështje ekonomike që shtroi plenumi si dhe me realizimin e detyrave dhe perspektivat e çdo rrethi.

Sekretariati do t'ju caktojë kur do të filloni punimet në aktive dhe kur në organizatat bazë. Çështja është që këto aktive t'i zhvillojnë punimet në mënyrë luftarake, pa u zvarrisur sepse presin punë të mëdha bujqësore. Në këtë kohë ne nuk duhet të merremi me shumë mbledhje, po këto që do të bëjmë janë të domosdoshme, vetëm se duhen bërë brenda një kohe të shkurtër që të mos gozhdojmë kuadrot nëpër mbledhje.

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*



**NGA FJALA NË MBLEDHJEN E AKTIVIT  
TË PARTISË TË QYTETIT TË TIRANËS  
ME RASTIN E PUNIMIT TË MATERIALEVE  
TË PLENUMIT III, SHKURT 1957, TË KQ TË  
PPSH «MBI GJENDJEN NDERKOMBËTARE  
DHE DETYRAT E PARTISË»**

1 mars 1957

Shokë,

Sikundër jeni në dijeni në 15-ditëshin e parë të muajit shkurt u mbledh Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë, i cili analizoi situatën ndërkombëtare dhe detyrat e Partisë. Gjithashtu mori në shqyrtim zhvillimin e kulturës së pambukut, përmirësimin e racës së dheneve si dhe shtimin e agrumeve, tri probleme ekonomike me rëndësi të madhe për vendin tonë. Unë mendoj se dokumentat e këtij plenumi, të cilat u botuan dhe që ju do t'i keni studjuar me kujdes, do të na ndihmojnë në zbërthimin e problemeve që u ngritën në plenum, se ju jeni në dijeni të çështjes. Megjithatë unë do të përiqem të theksoj disa gjëra që dihen nga Partia,

por nuk është keq që t'i përsëritim për t'i pasur edhe më të qarta.

Ju e dini se Partia është në udhëheqje të popullit dhe të shtetit tonë, jeni në korrent të ngjarjeve ndërkombëtare që janë zhvilluar dhe po zhvillohen. Forcat e paqes dhe të demokracisë luftojnë me vendosmëri kundër forcave agresive të kryesuar nga imperializmi amerikan për të mbrojtur demokracinë dhe paqen. Partia jonë, populli shqiptar kanë mbajtur gjatë kësaj periudhe një qëndrim të vendosur, të papërkulur, heroik, parimor ndaj agresorëve amerikanë, francezë, anglezë, izraelitë, ndaj elementëve trockistë dhe revizionistë. Armiqtë e vendit tonë nuk munguan të sulmonin me ashpërsi të madhe Partinë dhe regjimin e demokracisë sonë popullore. Por ne kemi qëndruar të papërkulur ndaj të gjitha këtyre sulmeve, prandaj armiku tërbohet kundër Partisë sonë. Qëndrimi ynë është i drejtë, ne demaskojmë planet e tyre, qëllimet e tyre të hapëta dhe të fshehta. Vendosmëria jonë marksiste-leniniste është një kontribut i çmueshëm për mbrojtjen e socializmit, për mbrojtjen e pastërtisë së marksizëm-leninizmit dhe të kampit tonë socialist. Punimet e këtij Plenumi të Komitetit Qendror kanë pasur dhe kanë një rëndësi të madhe, ato u japin një ndihmë të madhe Partisë, popullit dhe pushtetit popullor, i armatosin ata akoma më mirë që të mund të mbrojnë me sukses fitoret e popullit kundër lakmive dhe intrigave të armikut, të cilat jo vetëm që nuk kanë pushuar, por po shtohen.

Ulja e tensionit në marrëdhëniet ndërkombëtare është e kuptueshme që nuk u pëlqen dhe nuk u lever-

dis agresorëve imperialistë amerikanë, anglezë, francezë etj. Imperialistët mundohen të sjellin përsëri robërinë në vendet që janë çliruar nga sundimi i tyre. Bashkëpunimi dhe bashkekzistenca paqësore nuk u leverdis imperialistëve. Ata gjatë gjithë kësaj periudhe janë përpjekur të vazhdojnë luftën e ftohtë dhe vazhdojnë të zhvillojnë si përpara një politikë nga pozitat e forcës. Në këtë drejtim imperializmi amerikan dhe ai anglez e francez kanë forcuar jo vetëm propagandën e tyre kundër vendeve të kampit socialist por po shtojnë armatimet e tyre, buxhetet e tyre luftarake, po përpiqen, me gjithë kontradiktat që ekzistojnë në gjirin e tyre, të forcojnë paktet agresive dhe nga ana tjetër haptazi ose fshehurazi organizojnë komplete, akte diversioni, përgatitin sa të jetë e mundur dhe ku të gjejnë pikat e dobëta për të goditur vendet e demokracisë popullore. Nga ana tjetër ata përpiqen të hedhin nën robërinë e tyre vendet që kanë hedhur poshtë zgjedhën e kolonializmit. Nga propaganda dhe nga përgatitjet për luftë, imperialistët u hodhën në luftë të hapur; ata shpërthyen agresionin kundër Egjiptit dhe njëkohësisht në mënyrë të koordinuar organizuan edhe kundërrevolucionin në Hungari.

Siç e dini, çështja e popujve të shtypur dhe kolonialë tani ka hyrë në një fazë të re të rëndësishme për ta, d.m.th. një pjesë e tyre është çliruar dhe një pjesë tjetër po lufton për të fituar pavarësinë. Natyrisht kjo është një humbje kolosale për imperializmin, është periudha e shembjes së kolonializmit. Prandaj imperialistët përpiqen me të gjitha forcat të ruajnë privilegjet e tyre. Kur një palë nuk mund t'ia arrijë kësaj, atëhere:

partneri tjetër më i fuqishëm përpiqet t'i zërë vendin. Është e vërtetë se popujt e disa vendeve janë çliruar dhe kanë fituar pavarësinë e tyre, por kjo nuk do të thotë se ata janë çliruar krejtësisht nga kthetrat e kapitalit amerikan. Kurse në Algjeri po luftohet dhe kjo luftë ka përkrahjen e gjithë popullit francez dhe të gjithë botës. Në Algjeri francezët kanë çuar më se gjysmën e ushtrisë së tyre. Natyrisht kjo luftë ka zigzaget e saj edhe për arsye se partia komuniste atje ka bërë gabime që i kanë kushtuar lëvizjes.

Përsa i përket Egjiptit ai zë një pozitë të rëndësishme nga pikëpamja strategjike dhe ekonomike. Egjipti ishte çliruar prej kohësh, por imperializmi anglez, i cili mbante pozita të forta duke pasur në dorë kanalin e Suezit, e kishte lënë prapa në çdo sektor. Përfytyroni regjimin e Ahmet Zogut me njerëzit e tij; po ashtu ishte edhe regjimi i Farukut në shërbim të imperializmit anglez, kundrejt të cilit populli egjiptian ushqen një urrejtje të madhe. Lufta me sukses kundër imperializmit anglez dhe forcave ultrareaksionare u drejtua edhe kundër gjithë mbeturinave të kalbura të Egjiptit.

Komiteti Revolucionar i drejtuar nga Naseri u gjend në situata mjaft të vështira, sepse atij i mungonte eksperiencia. Si na mëson Lenini ai që merr fuqinë në fillim nuk është i mësuar, por gjatë luftës mëson, dhe kjo është dhe për ata që nuk janë komunistë. Kështu edhe egjiptianët filluan të merrnin masa për forcimin e sistemit të tyre. Ka pasur mjaft forca që në fillim kanë qenë nacionaliste, si organizata «vëllezërit muslimanë», e cila pastaj u bë vegla e anglezëve. Kjo organizatë re-

aksionare shkaktoi dëme të mëdha në Egjipt, pjesëtarët e saj vranë shumë komunistë kurse shumë të tjerë i burgosën. Por, në luftë, Naseri me komitetin e tij morën mjaft masa kundër imperializmit anglez dhe shtetëzuan kanalin e Suezit, që është një masë e drejtë, sepse ai i përket Egjiptit. Gjithë Lindja e Mesme ka një pasuri të madhe vajguri me të cilin imperialistët pregatitin luftën kundër kampit socialist. Nga ana tjetër, forcimi i Egjiptit, forcimi i pavarësisë së popujve paqedashës në këtë pellg u bë një rrezik i madh për imperializmin. Prandaj, imperialistët, për të mos i humbur këto pozita të mëdha ekonomike dhe strategjike, morën masa që t'u hidhnin këtyre popujve përsëri zgjedhën e imperializmit dhe prej andej të shtypnin lëvizjen nacional-çlirimtare të të gjithë popujve arabë. Kështu u zhvillua dhe sulmi kundër Egjiptit nga agresorët anglo-franko-izraelitë. Por dhe SHBA nuk janë të larë në këtë punë. Ato bënë sikur nuk ishin dakord me ndërhyrjen kundër Egjiptit, mirëpo kur plani i tyre dështoi u pa se kjo ishte një humbje kolosale për imperialistët. Nuk mund ta pranonte imperializmi këtë humbje, prandaj ai po bën përpjekje akoma të mëdha dhe të vazhdueshme për të forcuar pozitën e tija në këtë zonë. Këtë qëllim ka «doktrina Ajzenhauer» e cila kërkon të zëvendësojë imperializmin anglez me atë amerikan në Lindjen e Mesme, të rrëmbejë të gjitha pusët e vajgurit, gjë që ka një rëndësi të jashtzakonshme për qëllimet e imperialistëve, të cilët kërkojnë të krijojnë baza ushtarake dhe të sigurojnë sa më shumë vajguri. Këtë qëllim ka edhe përpjekja që bëjnë shërbëtorët e imperialistëve amerikanë, agresorët izraelitë,

të cilët nuk dëshirojnë të tërhiqen nga Akaba dhe rripi i Gazës që janë vende të njohura të Egjiptit. Sigurisht atje do të ketë përpjekje të mëdha, prandaj njerëzimi duhet t'i kuptojë mirë intrigat e imperializmit dhe t'u japë mbështetjen e plotë popujve arabë që luftojnë për të drejtat e tyre dhe paqen.

Njëkohësisht me luftën kundër Egjiptit imperialistët përgatitën kundërrevolucionin në Hungari. Ata kishin qëllim që me anë të këtij kundërrevolucioni ta kthenin Hungarinë në një regjim hortist, ta bënin Hungarinë një «place d'armes» të imperializmit amerikan për ta pasur kundra kampit socialist.

Kundërrevolucioni në Hungari u bë me plan. Lufta kundër Egjiptit u organizua me qëllim që imperialistët të fitonin gjithshka u nevojitej dhe kundërrevolucioni në Hungari për të bërë një propagandë shpifëse kundër kampit socialist. Për përgatitjen e kundërrevolucionit në Hungari imperialistët kanë zhvilluar një punë intensive me kohë. Ju e dini se haptazi anglo-amerikanët kanë investuar shuma të mëdha për t'i përdorur kundër kampit socialist për të ndihmuar të gjithë tradhëtarët, për t'i pasur ata si veglat e tyre. Janë krijuar qendra radiostacionesh në shumë vende dhe sidomos në Gjermaninë Perëndimore ku bëhet propagandë ditë e natë dhe jo vetëm propagandë por edhe organizim. Partia jonë i ka demaskuar këto sabotime dhe çështjen e ndërhyrjes brutale të imperializmit amerikan në përgatitjen e kundërrevolucioneve dhe sabotimeve, vendet tona e kanë ngritur pranë Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Por imperialistët amerikanë dhe të gjithë satelitët kanë mundur t'i hedhin poshtë këto me anën

e votës dhe tani së fundi kur vendet tona u ngritën përsëri që t'i pritët hovi kësaj pune armiqësore, Shtetet e Bashkuara të Amerikës me anën e mekanizmit të votës e hodhën poshtë.

Në organizimin e kundërrevolucionit në Hungari kanë luajtur rol gjithashtu edhe armiqtë e vendeve tona. Gjithashtu një rol jo të paktë ka luajtur dhe propaganda jugosllave. Jugosllavët përpiqen të fshehin dorën në çështjen e Hungarisë, por ndërhyrja jugosllave atje është e faktuar. Jugosllavia vazhdimisht ka zhvilluar një propagandë kundër Partisë së Punonjësve Hungarezë, me të gjitha fuqitë e me të gjitha mjetet dhe ne i njohim mirë këto mjete. Ata duke diskredituar regjimin popullor në Hungari kanë bërë që shumë elementë të përqafojnë propagandën shpifëse dhe revizioniste të tyre, të gënjen nga parullat pseudomarksiste të tyre dhe të përgatiten për sulmin që ata i drejtuan pushtetit popullor. Ne konstatojmë se që në ditët e para, kur filluan demonstratat në rrugët e Budapestit, të përgatitura nga elementët kundërrevolucionarë hortistë etj., ata dilnin me parulla tipike shoviniste, nacionaliste dhe nga ana ideologjike kishin po atë përmbajtje të parullave jugosllave dhe të formave të organizimit aktual jugosllav. Ne konstatojmë se gjatë kësaj kohe shtypi jugosllav i bënte një mbështetje të gjallë kundërrevolucionit në Hungari, e quanin atë «revolucion popullor», se gjoja nuk mund të duroheshin më burokratët stalinianë, regjimi shtypës etj. Pra gjithë shtypi jugosllav ishte vënë në shërbim të kundërrevolucionarëve hungarezë. Ne shohim se Imre Nagi ka qenë gjithmonë mbështetës i politikës jugosllave dhe se këta donin ta mbanin vetë

Nagin. Nagi bëri të gjitha përpjekjet për ta shkëputur Hungarinë nga kampi i socializmit, pikërisht në atë kohë atij iu dha strehë nga legata jugosllave.

Gjithashtu në ngjarjet e Hungarisë kanë luajtur rol edhe gabimet e rënda që bëri udhëheqja e Hungarisë. Imperializmi kishte kohë që punonte atje por vigjilenca ishte përtokë. Reaksioni organizoi komplotin, futi në dorë deri shefin e shtatmadhorisë dhe pastaj në momente të vështira partia pësoi disfatë, u lëkund, u trondit dhe u likuidua. Natyrisht në Hungari ishin vërtetuar gabime edhe në ekonomi, por ato mund të ndreqeshin duke marrë masa; niveli i jetesës në Hungari nuk ka qenë i ulët, por çështja është se udhëheqja e Hungarisë nuk ka ditur të ruajë pastërtinë e radhëve të partisë. Megjithatë reaksioni në Hungari nuk pati sukses, kundërrevolucioni u mposht. Por ajo që ndodhi në Hungari është një gjë e hidhur.

Në Poloni ndodhën gjëra jo të pëlqyeshme, jo marksiste; natyrisht jo si në Hungari, por megjithatë një shovinizëm i shfrenuar i elementëve reaksionarë. Nëpër qytetet e Polonisë u bënë demonstrata kundër Bashkimit Sovjetik dhe Ushtrisë Sovjetike. Atje elementë të shfrenuar, nacionalistë të tërbuar donin që t'i impononin edhe udhëheqjes së partisë poloneze drejtimin që ata kërkonin. Ne pamë se në Plenumin VIII të Partisë Punëtore të Bashkuar Poloneze, elementë kundërrevolucionarë që kërkonin të likuidonin diktaturën e proletariatit, influencuan në udhëheqjen e lëkundshme të partisë. Sidoqoftë, megjithëse atje ngjanë gjëra të papëlqyeshme kundër BS dhe vendeve të tjera socialiste, u morën mjaft masa të cilat na duken se nuk



janë të drejta, por këto mundën të ndreqen më vonë. Pas Kongresit XX të PK të BS elementët e lëkundshëm në Poloni filluan të shpërdorojnë fitoret, të hedhin poshtë të kaluarën e partisë punëtore poloneze, të dalin me parulla të shfrenuara, ashtu siç bënë me parullat e tyre «karagjozët» e Konferencës së Tiranës, për «krimet e mëdha» që kishte bërë Stalini dhe stalinizmi, të cilat Partia jonë nuk mund t'i pranonte dhe me të drejtë nuk i pranoi, sepse kjo ishte një punë armiqësore. Ne pamë të lëshoheshin edhe parulla politike dhe ekonomike që ishin në kundërshtim me doktrinën tonë, marksizëm-leninizmin. Ata mund ta ndërtojnë bujqësinë dhe industrinë si të duan, por ne kemi mendimet tona. Për likuidimin e industrisë së rëndë ose për dobësimin e industrisë së qymyrit ne nuk ishim dhe nuk jemi dakord; në një konferencë ekonomike në Moskë, ku morëm pjesë edhe ne, shokët polakë na u ankuan se do ta ulin prodhimin e qymyrit për arsye se jeta e minatorëve është e keqe. Atyre iu dha ndihma por këtu nuk qe fjala për minatorët polonezë se ishin në gjendje të keqe, por ata e kishin fjalën të dëmtonin industrinë e rëndë.

Nuk është e drejtë që industria e shtetëzuar pak nga pak t'u kthehet pronarëve. Përsa i përket bujqësisë ne nuk jemi dakord për likuidimin e kooperativave siç kërkojnë ata. Ata thonë se kooperativat nuk kanë pasur sukses, po pse te ne niveli i fshatarëve është ngritur në kooperativat bujqësore? Nuk është e drejtë që veglat e prodhimit, të cilat janë armët e bujqësisë, t'u jepen në dorë privatëve ose grupeve private, prandaj me këto situata nuk mund të pajtohemi. Ne nuk mund ta kuptojmë çështjen e fesë siç e kuptojnë ata. Na du-

ket gabim që në një shtet të demokracisë popullore ta futësh fenë dhe kishën në shkolla. Në rast se një parti marksiste-leniniste lejon gabime të tilla, ne themi se ajo ka pikëpamje oportuniste të theksuara, që janë në dëm të proletariatit. Kundrejt këtyre gabimeve partia duhet të jetë vigjilente pse do t'i shkaktojë dëme të mëdha Polonisë dhe vendeve tona.

Ne jemi për atë që në Poloni të zhduken vështirësitë dhe të forcohet Partia Punëtore e Bashkuar Poloneze dhe të likuidojë të gjithë elementët oportunistë, domethënë të kalitet në rrugën e marksizëm-leninizmit. Ka njerëz që mburren me të kaluarën e tyre, por marksizëm-leninizmi na mëson se duhet të jemi konsekuentë, të mbrojmë vijën e Partisë. Një shkarje e vogël nga marksizëm-leninizmi e dëmton shumë rëndë Partinë. Ne e pranojmë kritikën vetëm në rrugën e drejtë marksiste-leniniste. Vetëm të ashtuquajturit marksistë jugosllavë nuk e pranojnë kritikën marksiste-leniniste.

Ne kemi dhe do të kemi marrëdhënie tregëtare me shtetin polak, por çështjet ideologjike kanë një rëndësi të dorës së parë, kritikën ne e konsiderojmë ndihmë.

Ju keni lexuar në gazetë se edhe Toliati është ngatërruar në disa çështje të rëndësishme. Anëtarët e Partisë sonë nuk janë shumë të ngritur teorikisht, por ata i kuptojnë çështjet drejt dhe një gabim të tillë si Toliati ata nuk mund ta bëjnë. Rezultatet që nxori ai dhe Longua përsa i përket çështjes jugosllave nuk qenë të drejta. Fakti është se shumë gjëra shokët komunistë italianë nuk i kanë drejt.

Ngjarjet në Hungari, në Poloni dhe në Egjipt treguan se do të jetë gabim të mendohet se reaksioni ndër-

kombëtar i ka hedhur armët. Armët ai nuk i ka hedhur akoma; gjithashtu do të jetë gabim të mendohet se imperializmi ndërkombëtar i ka hedhur armët kundër demokracive popullore. Çfarë teorish u përdorën në kundërrevolucionin hungarez? Nga elementi kundërrevolucionar në Hungari u përdor nacionalizmi, shovinizmi; u nxit në elementët e borgjezisë së vogël krenaria shoviniste e Hungarisë së vjetër; u mobilizuan të gjithë oficerët fashistë të Hortit të cilët u dërmuan nga Ushtria Sovjetike gjatë Luftës së dytë botërore. Ata elementë në çdo moment kanë qenë gati të merrnin hakun për disfatën e turpshme që pësuan në Luftën e dytë botërore. Në kundërrevolucionin në Hungari u përdor demagogjia ndaj punëtorëve. Në këtë demagogji klasat e përmbysura si fabrikantët, pasanikët e çifligarët, pushtetin e të cilëve e mori populli dhe vendosi diktaturën e proletariatit, kishin në plan shturjen morale të punëtorëve. Ata gjetën momentet e sidomos në ato vende ku udhëheqja e partisë e kishte humbur vigjilencën revolucionare. Ata infiltruan në aparatet shtetërore, në ushtri shpeshherë u maskuan si punëtorë të thjeshtë dhe që nga këto pozita ata u përpoqën të shfrytëzonin «vështirësitë dhe gabimet që mund të ndodhin në pushtet gjatë ndërtimit socialist». Këta elementë kundërrevolucionarë në Hungari nuk dolën me parulla kundër socializmit sepse do të demaskoheshin, por shfrytëzuan këto dobësi dhe këto gabime për të dalë kundër partisë. Dhe kështu ata në fillim patën sukses, sepse fituan simpatinë jo vetëm të borgjezisë së vogël, por edhe të një pjese të punëtorëve. Është interesante se në fshat ku fshatarësia e varfër mori tokën nga pushteti popullor, gjatë kundërrevolu-

cionit nuk mori pjesë në të. Ç'parulla të tjera u përdorën nga kundërrevolucionarët? Parulla të tjera hodhën intelektualët. Ata luajtën një rol kundërrevolucionar dhe përkrahën me të gjitha forcat Nagin, ata përgatitën ofensivën ideologjike. Intelektualët mikroborgjezë u infektuan nga parullat e imperializmit, sepse nuk ishin edukuar si duhet nga partia. Ata spekulan haptazi mbi të drejtën e kritikës parimore për të goditur ndërtimin socialist dhe në përgjithësi regjimin socialist në Hungari. Gjithashtu ata spekulan mbi gabimet që në fakt ishin bërë dhe që mund të evitoheshin. Ka dhe gabime të paevitueshme, por në përgjithësi këto gabime mund të ndreqeshin. Ata me anën e kritikës kaluan në rrugën armiqësore duke thënë se kishin të drejtë të shkatërronin regjimin socialist, sepse gjoja ky pengonte lirinë individuale. Dhe këtë propagandojnë sidomos radiot reaksionare e aq më tepër radio «Evropa e lirë», e cila i quante intelektualët e klubit «Petëf» si shpëtimtarë. Kështu shumë intelektualë u gënjyen, u bashkuan me kundërrevolucionin. Kundërrevolucioni në Hungari na mëson shumë gjëra që Lenini i ka parashikuar me kohë e që nuk duhet t'i harrojmë kurrë. Unë dëshiroj të them se për komunistët dhe për patriotët nuk mjafton vetëm t'i shohin këto fakte dhe t'u bëjnë vetëm një analizë të sipërfaqshme, por duhet të thellohem se lufta politike ka ligjet revolucionare që nuk mund të kuptohen në rast se nuk i referohemi bazës, klasës, të analizojmë mirë forcat që ndeshen. Partia jonë ka theksuar vazhdimisht se duhet të edukohemi politikisht. Vetëm materializmi historik i lejon komunistët të gjejnë rrugën e vërtetë. Armiku, imperializmi, troc-

kistët, titistët, deviatorët, të gjithë ata e quajnë kundër-revolucionin hungarez një revolucion, por nuk mund të quhet revolucion çdo demonstratë, çdo lëvizje; revolucion është ndryshimi i raporteve të prodhimit në konformitet me forcat prodhuese.

Marksizëm-leninizmi na mëson se nuk mund të analizosh situatën shoqërore të një vendi po të kesh parasysh vetëm ekzistencën e dy klasave, d.m.th. të proletariatit dhe borgjezisë, sepse ekzistojnë shtresa të ndryshme shoqërore të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në diktaturën e proletariatit pas vendosjes së kësaj diktature në atë vend.

Ngjarjet në Hungari vërtetojnë thëniet e Leninit se diktatura e proletariatit duhet të zbatohet një violencë të pamëshirshme, të vendosur kundër kapitalistëve, çifligarëve e këlyshëve të tyre dhe jo vetëm në fillim, por dhe gjatë gjithë periudhës së ndërtimit socialist. Por Lenini, shokë, na tregon gjithashtu se «metoda e diktaturës së proletariatit nuk është vetëm violenca, ajo qëndron në shpirtin e organizimit të disiplinës së detashmentit të përparuar të punonjësve, të udhëheqjes së tyre të vetme»<sup>1</sup>. Proletariati është e vetmja klasë që është krejt e zhveshur nga prona private. Lufta e klasave kundër kapitalizmit e ka pajisur proletariatin me një eksperiencë jashtëzakonisht të madhe. Vetëm proletariati është në gjendje të kuptojë djallëzitë, padrejtësitë, shtypjet, ka cilësinë të nuhatë çdo të keqe të kapitalistëve. Vetëm proletariati është në gjendje ta dallojë

---

<sup>1</sup> Shih: V. I. Lenin. Veprat, vëll. 29, f. 430.

fytyrën e imperializmit nën çdo maskë që të fshihet, sepse ai e njeh mirë.

Vijmë tani te çështja e borgjezisë së vogël. Ajo nuk i ka ato të këqia që i ka borgjezia e madhe dhe kapitalistët, por në borgjezinë e vogël gjenden mbeturina të mëdha të së kaluarës dhe në periudhën e ndërtimit të socializmit ajo përpiket të depërtojë, të marrë drejtimin e punëve dhe t'i imponojë proletariatit pikëpamjet e veta; në Hungari borgjezia e vogël u përpoq t'i impononte pikëpamjet e veta klasës punëtore.

Borgjezia e vogël si punonjëse i afrohet proletaria-tit, por si pronare i afrohet kapitalizmit. Dhe kur shfaqen vështirësi në ndërtimin e socializmit ajo heziton dhe hidhet nga njëra anë në anën tjetër. Dhe kjo u vërtetua në Hungari. Në prodhuesin e vogël u shfaqën lëkundje në fushën politike për ndërtimin e socializmit, në industrializimin e vendit. Të gjitha këto tipare, që i ka analizuar Lenini, u shfaqën në kundërrevolucionin hungarez. Të mos harrojmë se kundërrevolucioni gjen baza të forta në zakonet e vjetra, të këqia, në fodullëkun, mendjemadhësinë etj. Prandaj nuk duhet harruar lufta kundër mbeturinave mikroborgjeze.

Ku qëndron forca e kapitalistëve te ne? Ata te ne nuk kanë as fuqi ekonomike as fuqi politike, ne këto ua kemi marrë me kohë, por forca e tyre këtu te ne qëndron në mbeturinat mikroborgjeze.

Duhet pasur parasysh se këto forca armiqësore gjejnë elementë të cilët nuk i kuptojnë si duhet ligjet e pushtetit të demokracisë popullore dhe ligjet e shtetit socialist, ashtu siç i kupton e i zbaton klasa punëtore, prandaj Partia këtu duhet të jetë e kujdesshme. Ne e

dimë nga eksperiencia se kapitalistët dhe borgjezia i dinë mirë të metat dhe vështirësitë tona. Ata e dinë se ku na dhëmb dhe e drejtojnë luftën e tyre pikërisht në ato pika ku ne jemi të dobët, presin që ne të gabojmë dhe këto gabime bashkë me mbeturinat e borgjezisë së vogël t'i përdorin kundër shtetit tonë popullor. Atëhere hidhen parullat dhe nuk hidhen kot, kapitalistët duan ta prekin borgjezinë e vogël nga ana shpirtërore. Ata duan të marrin pushtetin, por e marrin me parulla të majta ose të djathta kjo nuk u intereson atyre, fakti është se në Hungari borgjezia e vogël gaboi, por kur ajo erdhi në fuqi, u ngritën kapitalistët e mëdhenj dhe i thanë asaj se nuk shkohet më me të tilla parulla. Prandaj duhet të dihet që, në rast se borgjezia e vogël merr frenat e revolucionit, atëhere revolucioni është në buzë të greminës, sepse borgjezia e vogël nuk është e aftë të drejtojë asnjë revolucion, pra rezulton se kapitalizmi ka mbështetje kryesore lëkundjet e borgjezisë së vogël. Prandaj klasa punëtore duhet t'i zhdukë dhe t'i kapërcejë këto vështirësi, por këto lëkundje nuk janë kudo. Lenini thotë se duhet prerë nga rrënjët faktori i vështirësive ekonomike duke i siguruar në përgjithësi klasës punëtore dhe borgjezisë së vogël kushte të mira ekonomike. Këtu ne mund të kuptojmë pse në ato momente kritike borgjezia e vogël e vendit tonë mbajti një qëndrim konsekuent pro Partisë. Borgjezia e vogël, shokë, i sheh të mirat që i ka sjellë Partia. Ndryshimet që ka bërë Partia jonë në përmirësimin e jetës janë kolosale. Ne duhet të luftojmë kundër mbeturinave mikroborgjeze, prandaj mësimet e Leninit dhe eksperiencën duhet t'i kemi gjithmonë parasysh.

Lenini thotë:

*«Kur vdes shoqëria e vjetër, kufoma e saj nuk mund të futet në arkivol dhe të çohet në varr. Ajo dekompozohet midis nesh, kjo kufomë kalbet dhe na moleps edhe vetë ne»<sup>1</sup>.*

Prandaj duhet t'u vihet një barrierë e madhe këtyre erërave. Dhe ç'është kjo barrierë? Disiplina, organizimi. Gabime bëhen e nuk ka se si të mos bëhen, por çështja është që të përpiqemi të bëhen sa më pak gabime.

Lenini ka thënë se sikur intelektualët të vinin të gjitha dijenitë e tyre në shërbim të ndërtimit socialist, atëhere socializmi do të ndërtohej shumë shpejt. Partia jonë ka pasur një sukses të madh në këtë drejtim. Në vendin tonë rinia studenteske, intelektualët, në përgjithësi, kanë luajtur një rol të madh në kohën e luftës dhe këto kohët e fundit, në momentet e vështira, studentët dhe intelektualët në përgjithësi kanë mbajtur një qëndrim heroik kundër deviatorëve, ata kanë qenë të lidhur ngushtë me Partinë, pse Partia ka ditur që me politikën e saj të drejtë të mbajë qëndrim ndaj tyre. Ajo ka ditur të trajtojë jo vetëm intelektualët e rinj, por edhe intelektualët e vjetër. Ne kemi bërë gabime por ama duhet theksuar se në njëqind gabime janë bërë qindra mijëra heroizma. «Zëri i Amerikës», «Shqi-

---

<sup>1</sup> V. I. Lenin. Veprat, vëll. 27, f. 501.



përia e lirë» nuk i përmendin këto vepra që janë bërë në vendin tonë, por kapen vetëm pas disa gabimeve tona. Prandaj gabimet që bëhen natyrisht duhet dhe me i korrigjue. Duhet të respektohet parimet marksiste-leniniste të Partisë, duhet lidhur ngushtë me masat e popullit. Pastaj duhet pasur parasysh çështja e drejtimit kolektiv të bujqësisë, çështja e unitetit të Partisë dhe kritika e autokritika bolshevike e Partisë, prandaj të gjitha këto duhet t'i kemi parasysh. Ne duhet të nxjerrim mësim nga kundërrevolucioni hungarez. Imperialistët komplotojnë, sulmojnë, kjo na bën ne të mësojmë të jemi vigjilentë.

Çështja është te rreziku aktual i ringjalljes së fashizmit. Ajo që ngjau në Francë<sup>1</sup> dhe në Hungari vë në dukje kërcënimin e fashizmit. Dimitrovi ka thënë se fashizmi është diktatura më e hapët dhe më shoviniste e kapitalit financiar. Sa më tepër të humbasë tregje kapitali aq më tepër ashpërsohen forcat e kapitalizmit për të ngjallur fashizmin, sa më shumë popujt hedhin poshtë zgjedhën kapitaliste aq më tepër reaksionarët forcojnë shtetet e tyre për t'i zëvendësuar ato me diktatura terrori të hapëta dhe kjo po bëhet përpara syve tanë. Duhet të kemi parasysh se përbërja e fashizmit është e njëlojtë. Ata për përgatitjen e fashizmit përdorin masat e lëkundura të borgjezisë së vogël, kapitalistët e vegjël dhe në radhë të parë përdo-

---

<sup>1</sup> Është fjala për veprimet e reaksionit në Francë, i cili në këtë kohë filloi të krijojë një situatë mbytëse për komunistët duke organizuar akte terroriste dhe sulme kundër PKF dhe gazetave të saja. Këto veprime bëheshin me dijeninë dhe nxitjen e qeverisë që kryesohej nga socialisti Gi Mole.

rin elementët socialdemokratë. Kështu bënë ata me Musolinin, i cili më 1919 thoshte se do të shtetëzohen minierat, fabrikat etj. Po kështu bëri edhe Hitleri kur erdhi në fuqi. Pra duhet luftuar kundër përgatitjeve të fashizmit ashtu siç bëjnë partitë komuniste dhe përparimtare atje ku duken shenjat e lindjes së fashizmit, duhet goditur me rrënjë që kështu fashizmi të mos ngjallet më. Të shikojmë në Francë. Në Francë ecet drejt përgatitjes për ardhjen e fashizmit, drejt stabilizimit të qeverive reaksionare. Gjithashtu në Francë po bëhen përpjekje për të forcuar fuqinë e presidentit, po bëhet pikërisht ashtu sikurse po bën Ajzenhaueri që kërkon të rrëmbejë nga senati forcën e padiskutueshme.

Një çështje tjetër që vuri në dukje Plenumi i Komitetit Qendror dhe që ka rëndësi vendimtare për Partinë tonë është lufta ideologjike për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit nga armiqtë e tij dhe në radhë të parë nga revizionistët e nga trockistët. Siç u duk qartë, udhëheqja jugosllave mban flamurin për revizionimin e marksizëm-leninizmit. Në gjithë çështjet teorike dhe praktike të ndërtimit të socializmit ne shohim se udhëheqja jugosllave ka nxjerrë nga arsenali i trockistëve, buharinistëve dhe i gjithë revizionistëve, kundërshtarë të marksizëm-leninizmit, të gjitha teoritë e kalbura, të cilave u ka veshur rroba të reja dhe kërkon t'i shesë si marksizëm të vërtetë. Por që nga koha e prerjes së marrëdhënieve tona me jugosllavët, e sidomos pas plenumit që mbajtën ata pas prerjes së këtyre marrëdhënieve, u duk haptazi se pikëpamjet e udhëheqjes jugosllave, të cilat po zienin me një kazan të

mbyllur, ishin krejtësisht revizioniste. Ata atëhere gjetën momentin për t'u shkëputur nga doktrina e marksizëm-leninizmit. Dhe të dy kongreset që kanë bërë qysh atëhere e kanë vërtetuar këtë; ato dy kongrese janë quajtur nga jugosllavët gjoja si një kontribut në lëvizjen ndërkombëtare socialiste.

Në Kongresin I pas prerjes së marrëdhënieve me vendet tona udhëheqësit jugosllavë u shkëputën nga marksizëm-leninizmi; në Kongresin II shpallën pikëpamjet e tyre revizioniste dhe në Kongresin III, që do të bëhet së shpejti, do të afirmohet gjoja drejtësia e udhëheqjes jugosllave. Ata së shpejti do të bëjnë dhe një kongres të këshillave të punëtorëve, se «kjo, thonë ata, është forma më e mirë për ndërtimin e socializmit». Të gjitha këto përpjekje të udhëheqjes jugosllave kanë për qëllim likuidimin e partive tona komuniste dhe punëtorë në botë, sabotimin e ndërtimit socialist në vendet tona, denigrimin e marksizëm-leninizmit, sabotimin e lëvizjes internacionaliste të punëtorëve. Dhe të gjithë këtë punë ata e bëjnë me parullat gjoja marksiste-leniniste. Për këtë qëllim ata kanë mundur të gjejnë njerëz që natyrisht me forma demagogjike mburrin eksperiencën jugosllave.

Ne përfitojmë nga njëri-tjetri në ndërtimin e socializmit dhe eksperiencën e një vendi për një vend tjetër nuk është hedhur poshtë. Çdo vend mund t'i sjellë shtojcë të efektshme marksizëm-leninizmit, sepse marksizëm-leninizmi nuk është një dogmë. Këtu mbështeten shumë udhëheqësit jugosllavë, por është një fakt i vërtetuar me dokumenta që ka dhënë vetë udhëheqja jugosllave se ata e ulin rolin udhëheqës të partisë.

Partia e tyre, sipas thënieve të Kardelit dhe Titos, nuk duhet të ketë atë rol që duhet të ketë një parti marksiste-leniniste, d.m.th. të drejtojë shtetin dhe popullin, por partia sipas tyre duhet të ketë vetëm një rol edukativ. Ky natyrisht është një ndryshim i madh që i bëhet marksizëm-leninizmit, i cili thotë se partia është në udhëheqje të ndërtimit socialist. Por këtë çështje, jugosllavët nuk po e shtrojnë tani. Ata këtë gjë e filluan qysh pas çlirimit; që në atë kohë u munduan të ulnin rolin drejtues të partisë komuniste dhe këtë ta shtrinën në front. Ata nuk ua vunë veshin kritikave të drejta që iu bënë nga Partia Komuniste e BS dhe nga vetë Stalini. Sot në Jugosllavi partia nuk po e luan as rolin edukativ të popullit. Atje ekziston një komitet qendror, ekzistojnë edhe disa zyrtarë, kurse të gjitha aparatet e partisë janë zhdukur. Ata thonë se baza duhet të veprojë, por në fakt dhe në praktikë organizata bazë e tyre është pa jetë, pa shpirt. Atje normat leniniste të partisë nuk ekzistojnë fare. Janë fjalë ato që udhëheqësit jugosllavë bërtasin se gjoja në partitë e tjera komuniste nuk ekzistojnë normat leniniste. Sa për kritikën dhe autokritikën ato nuk mund t'i kërkosh. Atje kudo do të gjesh UDB-në. Ata flasin për burokracinë staliniane, për lloj-lloj gjërash të këqia staliniane, për mungesë të udhëheqjes kolegjiale në partitë tona, por te ne nuk ekziston asgjë prej atyre që ata pretendojnë t'i kemi. Autokritikën e drejtë që bëjmë ne në partitë tona ata e shfrytëzojnë, kurse atje shkelen të gjitha të drejtat e partisë; ata kanë arritur deri atje sa të thonë se edhe teoria e Leninit është vjetëruar.

Të flasim për diktaturën e proletariatit. Ata në fakt dhe në teori e mohojnë diktaturën e proletariatit, thonë se çështja e luftës së klasave tani është një gjë e kotë. Ata po e shpërdorjnë dhe po luftojnë në mënyrën më skandaloze dhe më të paturpshme kundër diktaturës së proletariatit. Pretendimi i tyre në këtë drejtim është krejtësisht i gabuar; ata thonë se në këtë kohë gjithë bota mund të ndërtojë socializmin pa partinë marksiste-leniniste dhe këto zbulime ata i quajnë si zbulime të reja në marksizëm-leninizëm. Ata mbështeten shumë në gjoja gabimet e Stalinit. Ata frikësojnë popujt duke thënë se po të mos vijnë partitë komuniste në rrugën jugosllave do t'i gjejë ashtu siç gjeti Hungarinë. Vetë Koça Popoviçi në fjalimin e fundit tha se gabimet e Stalinit i kanë sjellë socializmit dëme aq të mëdha-sa që nuk ia kanë sjellë deri sot të gjitha komplotet imperialiste. Por Partia jonë e njeh Stalinin, ajo e ka vlerësuar atë siç duhet për rolin e madh që ai ka luajtur në ndërtimin e shtetit socialist dhe në lëvizjen ndërkombëtare komuniste. Stalini ka qenë një armik i pamposhtur i imperializmit.

Orvatja e jugosllavëve për të bërë që të kuptohen së prapthi parimet e marksizëm-leninizmit është e kotë, megjithkëtë ata përpiqen që partitë marksiste-leniniste dhe udhëheqësit e këtyre partive që kanë mbrojtur me besnikëri vijën e partisë, t'i eliminojnë; ata bëjnë një luftë të rreptë kundër këtyre partive, mirëpo nuk ia arrijnë dot qëllimit, sepse Partia jonë dhe gjithë partitë e tjera dinë t'i kuptojnë mirë këto manevra antimarksiste.

Edhe për këshillat punëtore me të cilat ata mbu-

rren dhe kërkojnë t'i shesin si forma më të përshtatshme të ndërtimit të socializmit, ata nuk bëjnë gjë tjetër veçse krijojnë anarki. Këto këshilla shkojnë gjithnjë duke i likuiduar krejtësisht bashkimet profesionale. Bashkimet profesionale të ne bëjnë një punë të madhe, tjetër se ato mund të kenë dhe gabime, por në parim bashkimet profesionale të ne ndihmojnë në zbatimin e të drejtave që ka punëtori ndaj punës; punëtori në vendin tonë e ndjen veten zot të fabrikës. Ndërsa në Jugosllavi ndodh e kundërta, atje ka prova se shkohet drejt likuidimit të pronës socialiste.

Dua të theksoj dhe një çështje tjetër që ka shumë rëndësi. Dua të theksoj diçka për internacionalizmin proletar dhe nacionalizmin. Jugosllavët përdorin edhe komunizmin nacional, tezë që e mori me të madhe edhe propaganda e imperialistëve, prandaj duhet që këto probleme t'i kuptojmë drejt. Historia e gjithë kohëve, e gjithë shoqërisë nuk ka qenë gjë tjetër veçse historia e luftës së klasave.

Gjithë internacionalistët kanë kërkuar bashkëpunim ndërkombëtar me njëri-tjetrin dhe ky bashkëpunim nuk është një dogmë, por është parim i madh, nga parimet e veprimit shkencor dhe kusht i domosdoshëm për fitoren e proletariatit. Vetë jeta e popullit, lufta e popullit ka vërtetuar se proletarët duhet të bashkohen, duhet të veprojnë të bashkuar kundër kapitalizmit, pse kështu do të fitojnë; uniteti i proletariatit është i domosdoshëm.

A ka ndryshuar ndonjë gjë në çështjen e internacionalizmit proletar? Jo asgjë nuk ka ndryshuar, përkundrazi çështja e internacionalizmit proletar është

baza e doktrinës së proletariatit revolucionar, në rast se ky parim dobësohet atëhere dëmtohen partitë tona, dëmtohet i gjithë proletariati dhe për këtë përpiqen imperialistët, trockistët dhe gjithë revizionistët. Pra ndaj nga ana e gjithë partive komuniste dhe përparimtare duhet të forcohet uniteti internacionalist i punëtorëve, sepse është një bazë e shëndoshë e fuqishme e mbrojtjes së paqes; pra kundër këtij parimi lufton imperialismi dhe kur ky parim kuptohet mirë, kur zhvillohet drejt lufta e klasave, kur në partitë marksiste-leniniste zbatohet drejt centralizmi demokratik atëhere çdo gjë shkon në rregull.

Dy fjalë mbi nacionalizmin borgjez, shovinizmin dhe kozmopolitizmin. Kozmopolitizmi praktikohet nga imperialistët dhe nga intelektualët, ideologët e tyre, për të shfrytëzuar mallrat e tyre, për t'i ekspozuar ato në tregje të ndryshme që kështu të forcohet zinxhiri i roberisë mbi popujt. Imperialistët anglezë dhe më vonë të tjerët pretendojnë se nuk duhet të ekzistojnë kufi me shtetet e tjera dhe këtë natyrisht e bëjnë me qëllim që të shfrytëzojnë sa më shumë popujt. Edhe tani në këto situata të vështira kur Amerika mundohet të vendosë hegjemoninë e saj, ajo predikon kozmopolitizmin, d.m.th. të zhduket nocioni i sovranitetit kombëtar dhe të vendoset kapitalizmi amerikan. Por bashkë me këtë amerikanët nxisin në një shkallë të gjerë shovinizmin, racizmin që nuk është parë ndonjëherë.

Ju e dini se marrëdhëniet me Jugosllavinë kanë qenë të mira më përpara megjithëse gjatë luftës ka pasur kundërshtime, por nuk ishin të qarta se bëheshin me qëllim ose jo. Partia jonë i ka të qarta, kurse

propaganda e Jugosllavisë bën përpjekje të vërë në dukje se vetëm vendi ynë mban qëndrim jo të njëllojtë me vendet e tjera të demokracisë popullore ndaj udhëheqjes jugosllave. Por udhëheqja jugosllave kundër nesh ka bërë shumë gjëra, ne kemi shumë fakte që vërtetojnë se ajo nuk ka lënë asgjë pa përdorur kundër vendit dhe udhëheqjes sonë, që nga shantazhi e deri në veprime të hapëta.

Pas normalizimit të marrëdhënieve diplomatike me RFPJ ne u shprehëm për marrëdhënie fqinjësie të mira me Jugosllavinë por ata vazhduan një luftë të ashpër kundër Partisë dhe vendit tonë, dhe mund të themi se ata nuk kanë ndryshuar asnjë presje nga qëndrimi që mbanin qysh nga viti 1944 e deri tani. Ata menduan se do të pranohet që të gjitha fajet i kemi ne e se Jugosllavia nuk ka asnjë faj, por këtë ne nuk mund ta bënim. Të gjithë elementët armiq që dolën në Konferencën e Partisë të Tiranës pinin ujë në legatën jugosllave. Edhe rruga e Bedri Spahiut dhe e Tuk Jakovës ishte rruga e jugosllavëve, tjetër se kishin apo nuk kishin lidhje direkte me ta, por njerëzit e legatës jugosllave kanë mbajtur gjithmonë lidhje me njerëz të pakënaqur si me Liri Gegën, Dali Ndreun, Petro Bullatin e të tjerë. Disa shokë u gënjyen edhe në Konferencën e Partisë të Tiranës. Jugosllavët dhe agjentët e tyre kanë pëshpëritur sa andej-këtej kundër udhëheqjes së Partisë sonë.

Njerëzit e legatës jugosllave kanë punuar dhe vazhdimisht punojnë kundër regjimit tonë popullor. Vetë ministri i Jugosllavisë ka shkuar te të gjithë udhëheqësit tanë gjoja në formë diplomatike, natyrisht me qëllim



që të marrë mendimet e secilit, por ai s'ka gjetur asnjë të çarë. Jugosllavët mundohen të gjejnë në udhëheqjen tonë një të çarë, por në udhëheqjen tonë, shokë, nuk ka njerëz me pikëpyetje, ata janë të lidhur ngushtë rreth Komitetit Qendror të Partisë sonë. Punonjësit e legatës jugosllave në Tiranë kanë zhvilluar edhe punë agjenturale. Vetë ministri shkon në Vlorë. Në një kopshtare, së cilës i kërkoi t'i thoshte sa ushtri ka në Sazan, sa vaporë venë atje në ditë e të tjera; natyrisht gruaja i tha: «zotni unë i kam duart me kallo, unë jam punëto-re, prandaj po të kesh ardhur për të tilla punë ngreu e ik. Duke shkëlur rregullat diplomatike në mënyrë demonstrative nëpër rrugët e Beratit kërkonin Tuk Jakovën; ata kalojnë rrugës me makina, gjejnë udhëtarë dhe u thonë: «urdhëroni në makinë» dhe, kur udhëtojnë, u thonë udhëtarëve: «qeveria juaj na akuzon ne, jugosllavët, se kemi faj» etj. Po si mund të shpjegohet fakti i Dali Ndreut, Petro Bullatit, Liri Gegës etj. të cilët i pajisin me dokumenta jugosllave dhe tentojnë t'i nxjerrin jashtë kufirit? Po ata u kapën në kufi.

Ne me jugosllavët jemi sjellë shumë mirë, ne çdo gjë që kemi pasur ua kemi thënë drejtpërdrejt në sy, por ata nuk duan t'i çmojnë këto dhe nga ana tjetër të pushojnë luftën kundër vendit tonë.

Popoviçi na akuzon se kemi ndërhyrë në punët e brendshme të Jugosllavisë dhe këtë ata e shtrojnë pse ne kemi ngritur zërin për shqiptarët e Kosovës. Po, shokë, ne jemi interesuar dhe do të interesohemi akoma për shqiptarët e Kosovës, se ne e shohim që ata nuk po trajtohen mirë nga qeveria jugosllave, ata po i shpro-

nësojnë duke i dërguar në Turqi dhe tokat ua shesin serbëve. Ne kemi ndërhyrë dhe do të ndërhyjmë që të bëhet një politikë e drejtë shtetërore, t'u përcaktohen të gjitha të drejtat kombëtare të jetës së lirë, të ndjenjave të tyre dhe të pushohet propaganda kundër tyre.

E pse të mos interesohemi ne për njerëzit e gjallë kur ata interesohen edhe për njerëzit e vdekur duke protestuar në legatën tonë sepse janë prishur gurët e varreve të ushtarëve të krajlit të Serbisë, të vrrarë gjatë Luftës së parë botërore?

Shokë, ujëra të zeza po derdh shtypi jugosllav kundër vendit tonë, duke na akuzuar se ndërhyjmë në punët e tyre të brendshme; kjo nuk është e vërtetë, ne kemi dokumenta të gjalla që flasin se ata kërkonin të ndërhynin në punët e brendshme të vendit tonë, siç janë divizionet që do të sillnin në Korçë, por ne kemi dhe dokumenta që tregojnë se ata donin të na bënin republikë të shtatë të tyre etj. gjëra të poshtra. Për të gjitha këto Partia jonë ka mbajtur qëndrim të drejtë me të gjitha partitë komuniste dhe punëtore.

Çështja është këtu se ne akoma duhet të forcojmë radhët tona, të ruajmë unitetin e çelniktë të Partisë sonë dhe kjo është arritur sepse ne kemi zbatuar marksizëm-leninizmin. Shokët tanë të Partisë janë të kalitur në luftë e në përpjekje dhe fare thjeshtë anëtar i Partisë sonë dallon të keqen nga e mira, këtë nuk e them se dua por e them se është, sepse ne kemi një udhëheqje marksiste-leniniste.

*Më poshtë shoku Enver foli mbi rëndësinë e ven-*

*dimeve të Plenumit III të KQ të PPSH për «zhvillimin e pambukut, përmirësimin e deles dhe zgjerimin e kulturës së agrumeve».*

*Botohet për herë të parë me  
disa shkurtime sipas origjinalit  
që gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë*

**TË VËMË TË GJITHA FORCAT PËR  
KOLEKTIVIZIMIN E BUJQËSISË DHE  
TRANSFORMIMIN SOCIALIST  
TË FSHATIT**

*Letër dërguar organizatave të Partisë në terren dhe  
në ushtri*

**2 prill 1957**

**GJITHË KOMITETEVE TË PARTISË NË QARQE E  
RRETHE**

**GJITHË ORGANIZATAVE BAZË TË PARTISË NË  
QENDRAT E NDRYSHME TË PUNËS, NË ORGANET DHE NË  
INSTITUCIONET QENDRORE, NË REPARTET USHTARAKE  
TË MINISTRISË SË MBROJTJES POPULLORE DHE TË  
MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME**

Siç dihet një nga detyrat më të mëdha që shtroi Kongresi III i Partisë gjatë planit të dytë pesëvjeçar është zhvillimi i shpejtë i bujqësisë. Është e qartë se kolektivizimi i bujqësisë është kusht i domosdoshëm për zhvillimin e shpejtë të bujqësisë dhe për shtimin e prodhimit bujqësor, i cili ka një rëndësi të madhe për përmirësimin e konditave materiale dhe kulturele të punonjësve dhe për forcimin e ekonomisë popullore.

Si rezultat i zbatimit të drejtë të vijës që caktoi Kongresi III i Partisë për shpejtimin e ritmit të kolektivizimit të bujqësisë gjatë kësaj periudhe të shkurtër, janë arritur rezultate të dukshme. Nga 694 kooperativa bujqësore që ishin ngritur deri në Kongresin III të Partisë, të cilat përfaqësonin 18,94 për qind të ekonomive dhe 26,16 për qind të sipërfaqes së mbjellë në Republikë, deri më 1 prill janë organizuar 1 095 kooperativa bujqësore që përfaqësojnë 28,1 për qind të ekonomive dhe 36,1 për qind të sipërfaqes nën kulturë të Republikës. Këto rezultate dëshmojnë se organizatat e Partisë dhe komitetet e Partisë të qarqeve dhe rretheve, kanë bërë një punë të kënaqshme politike dhe edukative me fshatarësinë punonjëse për t'i bashkuar vullnetarisht ekonomitë e tyre në kooperativa bujqësore. Këto rezultate dëshmojnë, nga ana tjetër, se fshatarësia punonjëse, në radhë të parë fshatarët e varfër dhe fshatarët e mesëm, të bindur në rrugën e lavdishme që i udhëheq Partia, po organizohen me entuziazëm në kooperativa bujqësore të reja dhe shtojnë radhët e kooperativave ekzistuese. Është i rëndësishëm fakti se kolektivizimi ecën me një ritëm të shpejtë, jo vetëm në zonat fushore, por edhe në zonat gjysmëmalore dhe malore. Rezultatet e mira ekonomike që arritën vitin e kaluar kooperativat bujqësore, sidomos kooperativat e reja, kanë luajtur një rol të madh edukativ dhe bindës në fshatarësinë individuale, e cila çdo ditë po e kupton më mirë se vetëm me kolektivizimin e bujqësisë do të përmirësojë jetën e saj.

Por me gjithë sukseset e arritura deri tashti, duhet thënë se ka akoma shumë për të bërë për të realizuar

me sukses detyrat që shtroi Kongresi III i Partisë për kolektivizimin e bujqësisë. Dihet se kërkesat e masave punonjëse, kërkesat e industrisë dhe të ekonomisë popullore për prodhime bujqësore dhe blegtorale, për drithëra buke, për yndyrna, fruta, perime, qumësht, mish, gjalpë, lesh etj., janë të mëdha dhe të gjitha këto kërkesa gjithmonë në rritje duhet të sigurohen nga bujqësia. Dihet gjithashtu se me ekonomitë bujqësore individuale nuk mund të zhvillohet bujqësia, nuk mund të shtohen prodhimet bujqësore në atë masë që të plotësojnë në mënyrë të kënaqshme nevojat e vendit, as nuk mund të ndërtohet socializmi në fshat. Prandaj edukimi dhe bindja e fshatarësisë individuale për t'u organizuar vullnetarisht në kooperativa dhe kolektiva bujqësore ngel gjithmonë si një nga detyrat kryesore të të gjithë Partisë si në fshat ashtu dhe në qytet. Por megjithëse Komiteti Qendror e ka theksuar vazhdimisht se kolektivizimi i bujqësisë dhe ndërtimi i socializmit në fshat është një detyrë e madhe që ka të bëjë me zbatimin e vijës së Partisë dhe me vetë ndërtimin e socializmit në vendin tonë, që kërkon mobilizimin e të gjitha forcave të Partisë, të të gjithë komunistëve, të kolektivave punonjëse, të organeve shtetërore dhe organizatave shoqërore, jo vetëm në fshat por edhe në qytet, një mobilizim i tillë nuk shihet kudo sidomos në organizatat e Partisë dhe në komunistët që punojnë në qytet e qendra pune dhe prodhimi, në organet shtetërore ose në radhët e forcave të armatosura të Republikës sonë.

Një qëndrim i tillë tregon se detyra për kolektivizimin e bujqësisë dhe për transformimin socialist të

fshatit nuk është kuptuar ashtu siç e ka shtruar vazhdimisht Partia si detyrë që u takon të gjithë anëtarëve të Partisë, organizatave të Partisë dhe masave punonjëse, kudo që ndodhen. Fakti që mijëra anëtarë partie dhe punonjës të ndryshëm në aparatet shtetërore, në qendra të ndryshme pune dhe mijëra të tjerë, që ndodhen në radhët e forcave të armatosura, janë fshatarë, të cilët kanë në fshatrat e tyre familjet, fafesisin dhe miqtë e vet, kanë bërë fare pak përpjekje për t'i bindur ata të organizohen në kooperativa bujqësore, tregon se problemi i kolektivizimit nuk kuptohet nga të gjithë si detyrë e madhe partie dhe shtetërore për realizimin e së cilës duhet të punojë çdo anëtar partie, çdo punonjës, kudo që shërben, çdo patriot që lufton për ndërtimin socialist të vendit.

Me qëllim që të zgjidhet me sukses detyra historike që shtroi Kongresi III i Partisë për kolektivizimin e bujqësisë, Komiteti Qendror porositi edhe një herë gjithë organizatat e Partisë, gjithë komunistët dhe punonjësit e qendrave të ndryshme të punës, organet shtetërore dhe ndërmarrjet ekonomike shtetërore, gjithë organizatat shoqërore dhe forcat patriotike të vendit ta konsiderojnë kolektivizimin e bujqësisë si një detyrë që u takon të gjithëve, pse ka të bëjë me fitoren e vijës së Partisë në fshat, prandaj t'i kushtojnë vëmendje më të madhe.

Për këtë qëllim Komiteti Qendror porositi të merren këto masa:

1. — Problemi i kolektivizimit të bujqësisë të shtrohet edhe një herë në mënyrë të veçantë në të gjitha organizatat e Partisë në qytete, qendra pune dhe pro-

dhimi, në organizatat e Partisë dhe në organet politike të forcave të armatosura, në organet qendrore dhe lokale shtetërore, në kolektivat punonjëse, në Ushtrinë Popullore dhe në forcat e sigurimit, të kufirit dhe të policisë, si dhe në organizatat shoqërore ku të flitet mbi rëndësinë e kolektivizimit dhe punën që duhet të bëjë çdo punonjës, çdo anëtar partie dhe çdo qendër pune për kolektivizimin e bujqësisë. Në mënyrë të veçantë duhet t'u vihet në dukje anëtarëve të Partisë dhe punonjësve që janë fshatarë, të cilët kanë familjet, farefisën, miqtë dhe shokët e tyre në fshat të pafutur në kooperativa, t'u shkruajnë letra dhe po qe nevoja të shkojnë edhe vetë në fshat të punojnë dhe të bindin familjet, të afërmit dhe miqtë e tyre për t'u futur në kooperativat bujqësore. Organizatat e Partisë dhe kolektivat punonjëse të shqyrtojnë herë pas here punën që bëjnë dhe ndihmën që japin për kolektivizimin e bujqësisë të gjithë ata anëtarë partie dhe punonjës që janë nga fshati, sidomos punën që kanë bërë për futjen në kooperativa të familjeve dhe farefisit të tyre.

2. — Me qëllim që t'i jepet një ndihmë më e madhe fshatit, si për shpejtimin e ritmit të kolektivizimit, ashtu edhe për forcimin ekonomik dhe organizativ të kooperativave ekzistuese, për ngritjen në një nivel më të lartë të punës politike dhe kulturele të fshatit, organizatat e Partisë të institucioneve shtetërore, të qendrave të punës, organizatat shoqërore, si dhe institucionet kulturele, të dërgojnë herë pas here në fshat kuadro të njohur për të marrë kontakt me masat punonjëse të fshatit, ku t'u flitet për vijën politike dhe ekonomike të Partisë, për kolektivizimin e bujqësisë, të mbahen



konferenca politike me fshatarët, të dërgohen herë pas here brigada agjitacioni dhe brigada kulturele e shëndetësore për të ndihmuar në organizimin e jetës kulturele dhe në ruajtjen e shëndetit të popullit në fshat. Të dërgohen herë pas here filma dhe materiale propagandistike dhe edukative të përshtatshme për edukimin e masave punonjëse të fshatit.

Të shtrohet si detyrë që çdo organizatë bazë dhe kolektiv punonjës në ndërmarrjet ekonomike dhe në organet shtetërore të marrë në patronazh nga një kooperativë bujqësore, me qëllim që t'u sigurohet kooperativave bujqësore ndihmë organizative për forcimin e llogarisë dhe, në mënyrë të veçantë, për organizimin e jetës në kooperativë për punën kulturele, artistike dhe shoqërore. Qendrat e ndryshme të prodhimit të organizojnë kontakte dhe vizita të herëpashershme midis punonjësve dhe kooperativistëve. Këto kontakte, vizita dhe lidhje të shërbejnë për forcimin e aleancës midis klasës punëtore dhe fshatarësisë nën udhëheqjen e klasës punëtore, të shërbejnë për edukimin e kooperativistëve për të kryer detyrat që shtron Partia ndaj klasës punëtore.

3. — Organizatat e Partisë dhe kolektivat punonjëse të qendrave të punës dhe të prodhimit, të organeve shtetërore, ekonomike, kulturele dhe shoqërore, sidomos në organizatat kooperativiste të konsumit dhe të artizanatit, të marrin masa për të zbatuar me kohë detyrat që ka shtruar Partia dhe qeveria për bujqësinë dhe veçanërisht për sigurimin e mallrave të konsumit, veglave bujqësore dhe materialeve të ndërtimit të nevojshme për fshatin.

Komiteti Qendror ka besim se të gjithë komunistët, gjithë punonjësit e vendit tonë, punëtorë dhe nëpunës, ushtarakë, të rinj dhe të reja, intelektualë dhe patriotë, do të vënë të gjitha forcat e tyre për realizimin me sukses të detyrës së madhe që shtroi Kongresi III i Partisë për kolektivizimin e bujqësisë dhe transformimin socialist të fshatit që është konditë e domosdoshme për ndërtimin e socializmit në vendin tonë.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë st-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

# **TË SHQYRTOJMË GJITHMONË ME KUJDES DHE DREJT ANKESAT E PUNONJËSVE**

*Letër komiteteve të Partisë në qarqe e rrethe*

**2 prill 1957**

**GJITHË KOMITETEVE TË PARTISË**

Për njoftim:

**K R Y E M I N I S T R I S Ë dhe  
KËSHILLIT QENDROR TË BASHKIMEVE PROFESIONALE**

Komiteti Qendror i PPSH konstaton se gjatë vitit 1956, punonjës të ndryshëm janë ankuar se ndaj tyre janë marrë masa të padrejta si pushime nga puna, transferime dhe masa të tjera administrative. Gjithashtu vërehet se ndërmarrje ekonomike dhe dikastere po shkelin të drejtat e punonjësve, duke mos u dhënë lejet që u takojnë, i ulin pa kriter në kategori, bëjnë lëvizje të shpeshta dhe në mjaft raste vërtetohet që kritika e drejtë konstruktive zëvendësohet me qëndrime arrogante që marrin nëpër këmbë dinjitetin e punëtorit.

Disa kuadro drejtues në ndërmarrje dhe organe udhëheqëse, praktikojnë pushimin e menjëhershëm të punonjësve nga puna, si masa për të vendosur disziplinën, në vend që t'i kushtojnë më shumë kujdes edukimit dhe forcimit të ndërgjegjes socialiste ndaj punës. Po kështu vërehen raste të pushimit në vend nga puna edhe të komunistëve, pa e shqyrtuar çështjen e tyre më parë në organizatën e Partisë.

Këto veprime të padrejta, si dhe veprime të tjera të kësaj natyre, kanë bërë që punonjësit t'u drejtohen me të drejtë komisioneve të pajtimit në ndërmarrjet, organeve lokale dhe qendrore, me kërkesa të ndryshme për rivendosjen e të drejtave të shkelura, shumica e të cilave janë zgjidhur në favor të punonjësve. Kështu në qytetin e Tiranës gjatë 9-mujorit të vitit 1956, nga 435 ankesa u zgjidhën në favor të punonjësve 311. Vetëm në Kombinatin e Tekstileve «Stalin» nga 317 ankesa janë zgjidhur në favor të punonjësve 237, ndërsa në NTA-in Tiranë brenda 3 muajve u paraqitën 52 ankesa, 43 prej të cilave u zgjidhën në favor të punonjësve. Nga 210 ankesa të ndryshme që u janë paraqitur gjatë 9-mujorit të vitit 1956 seksioneve të mbrojtjes në punë të Durrësit, Elbasanit e Korçës, 182 janë zgjidhur në favor të punonjësve.

Shqyrtimi i ankesave tregon se mjaft kuadro drejtues nuk respektojnë dispozitat ligjore në fuqi dhe marrin nëpër këmbë të drejtat elementare të punonjësve, së në shumë prej tyre është përhapur gjerësisht tendenca e «pushimit në vend nga puna» dhe e marrjes së masave me karakter administrativ, se ekziston pikëpamja e gabuar, sipas së cilës shumë punëtorë konsidero-

hen «të pandreqshëm». Këto veprime tregojnë nga ana tjetër se mjaft kuadro drejtues të ekonomisë, nuk i përfillin organizatat e bashkimeve profesionale, të cilat kanë për mision mbrojtjen e të drejtave të punonjësve të caktuar me ligj. Ka pasur raste që edhe vendimet e komisioneve të posaçme të bashkimeve profesionale, megjithëse janë të drejta, nuk zbatohen, nën pretekstin se gjoja çënojnë «autoritetin» e drejtuesit. Drejtues të tillë nuk kuptojnë se në personin e tyre punonjësit shohin përfaqësuesin e pushtetit popullor dhe se kjo cilësi i detyron ata të shqyrtojnë gjithmonë me kujdes dhe drejt ankesat e punonjësve.

Këto tregojnë gjithashtu se organizatat e bashkimeve profesionale nuk po tregohen në lartësinë e duhur dhe nuk luftojnë me forcë për të mbrojtur të drejtat e ligjshme të punonjësve, pajtohen me vendimet e shtrembëra dhe të gabuara të administratës së ndërmarrjes dhe nuk bëjnë përpjekjet e nevojshme për të edukuar punëtorët me frymën e një qëndrimi të ndërgjegjshëm ndaj punës dhe rregullave të vendosura.

Organizatat e Partisë, nuk i konsiderojnë ankesat si sinjalizime në lidhje me shkeljen e ligjeve, nuk nxjerrin nga ato konkluzione mbi gjendjen e ligjshmërisë në të gjithë veprimtarinë e sektorit ku ato veprojnë, nuk ndalen për të analizuar thellë rastet e shkeljes së ligjeve dhe për t'i vënë përpara përgjegjësisë ata që i lejojnë këto. Shqyrtimi i drejtë dhe i shpejtë i ankesave nuk është parë nga organizatat e Partisë as në prizmin e rivendosjes së të drejtave të ligjshme të punonjësve, as në prizmin e ndreqjes me kohë të të metave serioze në punën e aparatit administrativ për të mos u dhënë

rast shfaqjeve të sëmura që kanë depërtuar në veprimtarinë e këtij aparati lidhur me mbrojtjen e ligjshmërisë socialiste.

Qëndrime të tilla janë në kundërshtim me udhëzimet e herëpashershme të Komitetit Qendror të PPSH, në të cilat theksohet se metoda e bindjes dhe puna edukative sqaruese me punonjësit është e vetmja rrugë e drejtë, është mjete kryesor për të fituar autoritetin në masat, për forcimin e mëtejshëm të lidhjeve të Partisë e të pushtetit me to.

Metoda e bindjes kërkon punë individuale me çdo njeri. Kjo kërkon takt, pjekuri dhe durim të madh. Çdo njeri ka karakterin e tij, shkallën e zhvillimit të tij, prirjet dhe veset e tij. Prandaj është shumë vështirë të punosh me njeriun, të studjosh anët e tija të mira dhe të dobëta dhe ta bësh atë të kuptojë çfarë nuk di ai kur tregohet i pakujdesshëm. Është shumë e ndërlikuar puna për të bindur njerëzit, për t'i mësuar dhe ndihmuar ata të kuptojnë drejt detyrat, gabimet dhe të metat.

Është pikërisht kjo arsye që mjaft kuadro e harrojnë këtë porosi të Partisë dhe përdorin metoda administrative, si rrugën më të shkurtër me më pak telashe, por që i sjell dëm të madh punës së Partisë.

Shkelja e të drejtave të punonjësve, të caktuara me ligj, duhet të konsiderohet nga organizatat e Partisë dhe nga bashkimet profesionale si një ngjarje e jashtzakonshme për të cilën ata duhet të ndërhyjnë dhe të marrin masa të menjëhershme për ndreqjen e gabimeve.

Organizatat e Partisë dhe bashkimet profesionale të nxjerrin nga kjo letër mësimet e duhura, të anali-

zojnë me hollësi këtë problem dhe të marrin masa për t'u dhënë fund shkeljeve të ligjeve që mbrojnë të drejtat e punonjësve.

Kjo letër të punohet në të gjitha organizatat bazë të Partisë (me përjashtim të fshatit) dhe në bashkimet profesionale, brenda muajit prill 1957. Konkluzionet e nxjerra nga punimi i letrës të analizohen në byrotë e komiteteve të Partisë dhe brenda datës 15 maj të informohet Komiteti Qendror mbi çështjet që dalin.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## **TË PËRMIRËSOJME MARRËDHËNIET MBI BAZËN E PARIMEVE TË MARKSIZËM-LENINIZMIT DHE TË INTERNACIONALIZMIT PROLETAR**

*Raport i mbajtur në mbledhjet e Byrosë Politike dhe  
të Plenumit të KQ të PPSH më 27 dhe 30 prill 1957 «Mbi  
vizitën e delegacionit të Partisë dhe të qeverisë në  
Bashkimin Sovjetik»*

**27 prill 1957**

Rezultatet e bisedimeve i keni marrë vesh, prandaj unë do të ndalem vetëm në disa prej tyre.

Në radhë të parë dua të flas për pritjen jashtëzakonisht të nxehtë, vëllazërore e shoqërore që na u bë kudo. Kjo pritje e përzemërt që tregon dashurinë e madhe që ka populli sovjetik për ne, u duk që në Odesë. Në portin e Odesës kishin dalë për të na pritur shumë njerëz.

Në Moskë në stacionin e trenit, përveç udhëheqësve sovjetikë, dolën të na prisnin një numër i madh punonjësish që mbushnin tërë stacionin. Atje pati shumë manifestime të zjarrta, plot entuziazëm. Zëvendësministri i punëve të jashtme të Bashkimit Sovjetik na tha se po në këtë stacion ishin pritur edhe përfaqësues



të tjerë të demokracive popullore, po atyre nuk u ishte bërë nga ana e popullit një pritje kaq e nxehtë sa iu bë delegacionit tonë.

Po atë ditë u bëmë vizitë Voroshillovit, Bulganinit dhe Hrushovit.

Që në takimin e parë Hrushovi, pasi bëri elozhe për vijën e Partisë sonë, na tha të jemi më gjakftohtë përsa i përket taktikës që duhet ndjekur ndaj Jugosllavisë, «sepse ju, tha ai, si popull i viseve të Jugut jeni gjaknxehtë, bile ka edhe shokë të partive të tjera që thonë se shqiptarët janë ca «grindavecë» në këtë çështje». Pastaj na premtoi se do të na ndihmojnë në çështjet ekonomike, por përsëri këshilloi që në marrëdhëniet me Jugosllavinë të kemi më shumë takt, të mos jemi gjaknxehtë.

Kjo ishte «përsëritja», por natyrisht ishte edhe një paralajmërim për ne. Ai na tha se në fjalimet dhe në deklaratat tona mund të flitej kundër revizionistëve, oportunistëve etj., por pa përmendur me emër revizionistët jugosllavë. Edhe në drekën që u shtrua të nesërmen në Kremlin, Hrushovi na tha që ta përmbajmë zemërimin ndaj udhëheqjes jugosllave dhe «të shtojmë përpjekjet për t'u afruar me ta».

Mbasditen e ditës së parë ne bëmë takimin e parë qeveritar. Sipas zakonit, të parët e morëm fjalën ne. Pas parashtrimit të problemeve nga ne, u krijuan komisionet që do të vazhdonin punën.

Pastaj delegacioni u nda në dy grupe. Njëri shkoi në Tashkent dhe tjetri në Leningrad. Pritja që na u bë në Leningrad nuk mund të përshkruhet. Kudo që shkonim, gjatë rrugës, në mënyrë të paorganizuar, populli, kur merrte vesh se kalonte delegacioni ynë, broho-

riste për Shqipërinë. Në Tashkent, kur shkoi Mehmeti, në të dy anët e rrugës për në qytet, në një gjatësi 18 km., kishte dalë shumë popull që brohoriste për delegacionin. Në të gjitha vendet që vizitua punonjësit sovjetikë flisnin me admirim për Shqipërinë dhe tregonin një dashuri të zjarrtë për Partinë dhe popullin tonë. Me një fjalë, kudo, populli dhe kuadrot na pritën jashtëzakonisht ngrohtë e në mënyrë të përzemërt.

Në Leningrad, në uzinën e turbinave «V. I. Lenin» u bë një miting ku merrnin pjesë rreth 4 000-5 000 vetë. Fjalimin tonë ata e pritën shumë mirë. Hrushovi që në takimin e parë e dha orientimin për çështjen e Jugosllavisë, por ne nuk mund të rrinim pa folur dhe në miting përsëri folëm. Në fjalën time unë thashë që jugosllavët janë antimarksistë, shovinistë, se kanë bërë punë armiqësore kundër nesh. Pas mitingut Pospjellovi më tha sikur ta rregullonim pak këtë pjesë të fjalimit, pasi iu duk e rëndë dhe nuk mund të botohej. Ne ramë dakord që të zbutej pak, por pa hequr fjalën antimarksistë. Kurse ata para se ta dërgonin në shtyp i kishin hequr të tëra. Kështu teksti i botuar në gazetën «Pravda» ishte i ndryshëm nga ai që fola unë në lidhje me Jugosllavinë.

Pas takimeve të para dhe vizitave u bë mbledhja e delegacioneve të Partisë sonë dhe të PK të BS. Projektet e deklaratave ne i kishim marrë më parë. Për deklaratën qeveritare ne nuk kishim ndonjë vërejtje esenciale. Për deklaratën e delegacioneve të partive kishim vërejtje vetëm për çështjen e Jugosllavisë. Ne ishim të preokupuar se si do të paraqitej kjo çështje në shtyp. Më parë se të shkonim në mbledhje diskutu-

am me shoku-shokun dhe ishim të mendimit që çështja jugosllave të figuronte në deklaratë. Prandaj në mbledhje shfaqëm mendimin që të ndaleshim në këtë çështje, të paraqitnim aktivitetin sabotues të udhëheqjes jugosllave gjatë kësaj periudhe dhe të jepnim disa konkluzione se si do të ecnim në të ardhshmen.

Unë u thashë shokëve sovjetikë se këto çështje ne i kishim biseduar edhe herë të tjera. Në marrëdhëniet me Jugosllavinë ne jemi përpjekur të mbajmë gjakftohtësinë, ashtu siç keni thënë edhe ju, por kemi disa gjëra të reja që tregojnë se udhëheqja jugosllave vazhdon kundër nesh punën agjenturale dhe armiqësore, ata vazhdojnë qëndrimet e tyre provokuese. Ne mendojmë se këto qëndrime, të vazhdueshme nga ana e udhëheqjes jugosllave, veçanërisht nga punonjësit e legatës së tyre, kanë për qëllim që t'i acarojnë marrëdhëniet me ne për të na vënë në një pozitë të vështirë ndaj miqve tanë, duke pretenduar se me çdo parti dhe me çdo vend tjetër mund të merren vesh, kurse me shqiptarët nuk është e mundur të merren vesh, se pala shqiptare gjoja nuk do. Ne ua vërtetuam këtë me fakte. U folëm për veprimet e ministrit dhe të sekretarit të legatës jugosllave në Tiranë, për punën agjenturale që bëjnë ata nëpërmjet organizimit të njerëzve antiparti dhe aktivizimit të tyre. U thamë se si ne e kemi thirrur ministrin jugosllav në Ministrinë e Jashtme, i kemi tërhequr vëmendjen për këto veprime dhe i kemi thënë se ato janë në dëm të marrëdhënieve të të dy vendeve tona.

Ne shprehëm mendimin se këto veprime nuk bëhen me inisiativën personale të punonjësve të legatës, se ato bëhen me pëlqimin e udhëheqjes jugosllave, në

këtë konkluzion të çojnë vetë veprimet e tyre. Ne vumë në dukje se në plenumin e fundit, duke ngritur çështjen e sjelljeve jonjerëzore të jugosllavëve ndaj kosovarëve, ne e parashikuam që ata do ta kthenin këtë çështje në një akuzë kundër nesh, dhe në fakt ata po na akuzojnë për ndërhyrje në punët e brendshme të Jugosllavisë. Ne ua theksuam shokëve sovjetikë se nuk e kemi një qëllim të tillë, por çështja e Kosovës është një çështje delikate dhe e rëndësishme për ne, sepse nga Kosova ata organizojnë një veprimtari armiqësore të dendur kundër vendit tonë. Ata po përpiqen të likuidojnë popullsinë shqiptare në Kosovë duke e dërguar në masë në Turqi. Çështja e Kosovës paraqit rreziqe për vendin jo vetëm në kuptimin se ata mund ta përdorin atë si bazë për të na sulmuar me armë, dhe po ta bëjnë këtë ata do të marrin përgjegjen e merituar, por se në Kosovë ata kanë grumbulluar reaksionarët dhe fashistët shqiptarë me qëllim që të shtojnë veprimtarinë e spiunazhit e të diversionit.

U folëm pastaj se jugosllavët vazhdojnë të nxisin armiqtë e Partisë dhe të shtetit me qëllim që të shkaktojnë turbullira në Parti dhe në pushtet. U folëm gjithashtu për çështjen e Tukut, për veprimtarinë e tij dhe për lidhjet e tija me legatën jugosllave, për të cilat ai dëshmon vetë me anën e letrës që i ka dërguar KQ të PPSH. Faktet dhe qëndrimi i këtij njeriu, si radhën e parë ashtu dhe të dytën, dëshmojnë qartë se ai është agjent i jugosllavëve. U folëm gjithashtu për përpjekjet e udhëheqësve jugosllavë për të organizuar një puç kundër vendit tonë si ai në Hungari, por që dështoi në sajë të vigjilencës së Partisë sonë. Këtë e dëshmon ve-

printaria e tyre që nga mbështetja dhe nxitja e Tuk Jakovës kundër Partisë sonë deri te Konferenca e Tiranës. Ne u theksuam shokëve sovjetikë se veprimet e udhëheqjes jugosllave nuk përbëjnë vetëm rrezik për vendin tonë, por edhe për kampin socialist. Mendimi ynë është se ata kanë devijuar nga marksizëm-leninizmi. Në gazetata e tyre ata shkruajnë se gjoja duan t'i përmirësojnë marrëdhëniet me Shqipërinë, por ne mendojmë se ato janë vetëm fjalë, faktet vërtetojnë të kundërtën.

U thamë pastaj se ne nuk jemi dakord me kritikën që na paska bërë «Skantea» dhe me vlerësimet e udhëheqësve rumunë. Ne nuk jemi grindavecë. Të jesh grindavec, vazhdova unë, do të thotë të sulmosh në mënyrë të paprincipitë, kurse ne luftojmë mbi bazën e parimeve. Gjithashtu ne nuk jemi dakord që të bëhen kritika në shtyp, sepse kështu i japim armë armikut, pavarësisht nëse janë të drejta ose jo këto kritika. Edhe ne nuk i aprovojmë shumë gjëra që ndodhin në Poloni, por në shtypin tonë ne nuk flasim kundër tyre. Ne gjithashtu, për disa gjëra, nuk jemi dakord me shokët italianë, por edhe për këto ne nuk bëjmë fjalë në shtyp. Me jugosllavët ne mbajmë këtë qëndrim se ata për 14 vjet me radhë kanë ecur po në këtë rrugë.

Pastaj theksuam se ne jemi dhe duam të kemi marrëdhënie të mira me Jugosllavinë, por, po të flasim haptazi, ne nuk kemi besim te udhëheqja jugosllave. Ata flasin dhe veprojnë kundër kampit tonë, ata janë kundër bazave të marksizëm-leninizmit dhe kundër Bashkimit Sovjetik që i çliroi nga pushtuesit fashistë. Në gjithë propagandën e tyre ata nuk thonë asnjë fjalë

kundër imperializmit. Ka fakte që kur u ashpërsuan marrëdhëniet tona, kryeministri grek shkoi në Beograd, që SHBA u japin miliarda dollarë jugosllavëve, që Titua kërkon të shkojë në SHBA. Gjatë 14 vjetëve ne nuk kemi parë që udhëheqja jugosllave të ketë bërë një farë kthese, në mënyrë që të krijojmë bindjen se ata diçka kanë realizuar nga gabimet dhe deviacionet e tyre. Prandaj derisa nuk shohim një gjë të tillë nuk mund të kemi besim te një udhëheqje e tillë. Ne i kemi bërë të gjitha përpjekjet kurse nga ata nuk shohim as përpjekjen më të vogël. Përkundrazi në letrën e fundit të KQ të LKJ drejtuar KQ të PK të BS shpifet kundër nesh, duke na akuzuar sikur ne organizojmë në Kosovë grupe spiunazhi dhe propagandë kundër Jugosllavisë.

Pastaj u fola për njerëzit e legatës sonë në Beograd, u thashë se ata nuk zhvillojnë asnjë punë agjenturale, kurse punonjësit e legatës jugosllave në Tiranë janë një rrjet agjental. Veprimet e udhëheqësve jugosllavë tregojnë se ata kanë dalë krejtësisht nga binarët e marksizëm-leninizmit. Po çfarë do të bëjmë ne ndaj tyre? Ne do të mbajmë gjakftohtësinë, do të kemi durim dhe do të jemi vigjilentë. Po edhe durimi ka një kufi. Ne nuk do të bëjmë asnjë hap që do të dëmtojë kampin tonë. Ne nuk do të bëjmë luftë me Jugosllavinë. Ne në marrëdhëniet me të do të udhëhiqemi nga vija jonë politike e përgjithshme marksiste-leniniste që kemi ndjekur kurdoherë.

Pastaj hymë në një konsideratë të përgjithshme duke thënë se qëndrimi i të gjithë kampit tonë e ka ndihmuar popullin jugosllav dhe ne shqiptarët kemi besim të madh te ai popull, kurse udhëheqja e sotme

ka krijuar kushte të tilla që pengojnë të arrihet forci i miqësisë së popujve tanë me ata të Jugosllavisë. Po të mbajmë qëndrimin që kemi mbajtur do ta ndihmojmë popullin jugosllav të shohë të vërtetën. Ne mendojmë se populli jugosllav nuk do të gënjëhet nga politika që ndiqet sot në Jugosllavi. Po përhapen zëra se në Jugosllavi populli është i pakënaqur nga udhëheqja. Fakti është se lufta e kampit tonë ka bërë që shumë komunistë dhe njerëz të thjeshtë në Jugosllavi të mendojnë për këto çështje. Ne gjithmonë kemi folur për gabimet e udhëheqjes jugosllave në tërësi dhe është fakt se udhëheqja jugosllave në tërësi nuk është dakord me tezat themelore të marksizëm-leninizmit.

Si konkluzion u thamë se ne i shtriam gjërat haptas ashtu si mendojmë sepse nuk duam t'i sjellim dëm as Partisë sonë dhe as PK të BS.

Pastaj shkurt u folëm për gjendjen në Partinë tonë. U thamë se gjendja në Parti është shumë e mirë. Në Parti ka shumë entuziazëm dhe unitet mendimi e veprimi. Edhe gjendja politike e vendit tonë është e mirë. Populli është i vendosur në vijën e Partisë.

Të gjithë parashtresën time shokët sovjetikë e dëgjuan me vëmendje të madhe.

Pastaj fjalën e mori Hrushovi. «Ne kishim mendimin, tha ai, se ky takim partie do të mbaronte më shpejt, nuk kishim menduar që çështjet do të shtroreshin në këtë mënyrë. Ne jemi dakord me vijën tuaj dhe ju mbështesim, por marrëdhëniet me Jugosllavinë ju i shikoni disi në mënyrë nervoze. Ju e paraqitni çështjen e marrëdhënieve me Jugosllavinë pa perspektivë. Pikëpamjet tuaja për udhëheqjen jugosllave të çojnë në

konkluzionin se ajo ka tradhëtuar, se nuk është fare në rrugën marksiste-leniniste dhe se duhet t'i presim marrëdhëniet me ta. Ne nuk mendojmë që ata të kenë tradhëtuar, por që ata kanë shkarë nga marksizëm-leninizmi kjo është e vërtetë. Sipas jush ne duhet të kthehemi në atë që bëri Stalini, i cili i bëri thirrje popullit jugosllav të mos e njihte Titon dhe si pasojë u shkaktoan të gjitha ato që dini. Sipas mendimit tuaj del se Jugosllavia është kundër kampit socialist, kundër Bashkimit Sovjetik dhe kundër jush». Pastaj Hrushovi tha: «Le të shohim se si sillen jugosllavët ndaj nesh. Ata na sulmojnë më shumë se grekët, turqit dhe italianët, por duhet pasur parasysh se jugosllavët kanë diçka të veçantë, proletare. A mundet ne t'i prishim marrëdhëniet me Jugosllavinë?» më pyeti ai.

«Ne nuk jemi për këtë» i thashë unë.

Hrushovi tha: «Ju nuk e thoni po duket se e mendoni, por duhet të kemi parasysh se Jugosllavia nuk ka për t'u bërë shkaktare për një luftë kundër kampit tonë ashtu sikurse u bënë Gjermania dhe Italia».

Unë përsëri ndërhyra dhe i thashë: «Atëhere çfarë duhet të bëjmë ne pas gjithë këtyre ndërhyrjeve që bëjnë ata?».

«Kjo është punë e tyre, tha ai, ju përpiquni të neutralizoni veprimtarinë e tyre. Ç'mund të bëni tjetër, të bëni luftë me ta?»

«Kjo nuk do të ndodhë, i thashë unë, por në rast se ministri jugosllav shkon dhe fotografon objekte ushtarake ç'duhet të bëjmë ne, të mbajmë sehir?»

Hrushovi u përgjegj: «Merrini filmin».

«Por masa të tilla, i thashë unë, ata do t'i përdorin



si pretekst për të prerë marrëdhëniet dhe për të na e lënë fajin neve».

«Atëhere, shoku Enver, tha Hrushovi, çfarë kërkoni nga ne? Ne kemi pikëpamje të kundërta me ju për këtë çështje. Ne nuk jemi dakord me ju dhe nuk e kuptojmë çështjen ashtu si e kuptoni ju. Adenaueri dhe Kishi nuk janë më të mirë se Titua, po megjithatë ne kemi bërë çmos që t'i afrojmë».

Unë ndërhyra dhe i thashë: «Nuk është tamam kështu. Kur flitet për Titon nënkuptohet përmirësimi i marrëdhënieve në rrugë partie, kurse ai është anti-marksist. Megjithëse udhëheqja jugosllave nuk është korrekte as në marrëdhëniet shtetërore. Ç'qëndrim do të mbajmë ne në rast se jugosllavët do të vazhdojnë të na organizojnë komplete?»

«Shoku Enver, tha ai, ju po më ndërhyni vazhdimisht në fjalën time. Ne ju dëgjuam një orë dhe ju as 15 minuta nuk më latë të flas, prandaj nuk kam ç'të flas».

Situata u bë e rëndë. Unë ndërhyra përsëri dhe i thashë se ne kemi ardhur për të shkëmbyer mendime dhe për të ndihmuar njëri-tjetrin.

«Unë ju dëgjova një orë, tha ai, kurse ju nuk po më lini të flas. Ju doni ta ndërtoni politikën mbi sentimente. Ju mendoni se ndërmjet Titos, Rankoviçit, Kardelit, Popoviçit etj. nuk ka ndryshime. Mirëpo ata janë njerëz dhe ndryshojnë nga njëri-tjetri, ka nuanca midis njerëzve. Edhe ne në Byronë (Politike) kemi unanimitet, po dhe këtu ka nuanca të ndryshme. Le të marrim p.sh. edhe Ajzenhauerin me Dallesin. Të dy ata janë reaksionarë, po nuk mund t'i futim në një thes të dy. Dallesi

është njeri i egër, luftënxitës, kurse Ajzenhaueri, megjithëse është reaksionar, është më njerëzor. Nuk janë njëlloj të gjithë njerëzit. Në Jugosllavi ka njerëz si Kardeli, Popoviçi, Todoroviçi, që janë armiq të vendosur, por te Rankoviçi dhe Titua shihen qëndrime më të arësyeshme, ata e duan një farë afrimi me ne, kurse Tempo është një gomar. Prandaj të përpiqemi t'i afrojmë ata që tregohen më të arësyeshëm». Hrushovi vazhdoi: «Ne po bëjmë përpjekje për të arritur një takim në mes të partisë sonë dhe LKJ. Jugosllavët pranuan, po nuk duhet menduar se nga një takim i tillë do të dalë gjithshka. Po të mendojmë si ju del se ky takim nuk u dashka bërë. Unë mendoj se nuk na e mbushni dot mendjen për drejtësinë e qëndrimit tuaj. Qëndrimi juaj nuk është në interes të kampit tonë. Taktika që ndiqni ju në marrëdhëniet me Jugosllavinë është e gabuar. Unë mendoj se ju duhet të takoheni edhe me ambasadorin jugosllav në Moskë, jo për t'i acaruar, po për t'i përmirësuar marrëdhëniet, se me këtë qëndrim që mbani ju nuk del gjë. Ju folët për veprimtarinë e ministrit jugosllav në Tiranë, edhe te ne atasheu jugosllav shkoi të merrte fotografi në një objekt, po milicioneri ynë me një farë mënyre e ktheu nga ajo rrugë.

Unë po e përsëris, ne do të ndjekim vijën e përmirësimit të marrëdhënieve me Jugosllavinë si në rrugë partie ashtu edhe në çështje shtetërore. Shokët rumunë kanë të drejtë në përcaktimin që ju kanë quajtur ju si «grindavecë»».

Unë pastaj i thashë se ndërhyrjet e mia kishin për qëllim të sqaronin problemin. «Edhe ne, vazhdova unë, nuk jemi në asnjë mënyrë për prishjen e marrëdhë-

nieve, po këto duhet t'i përmirësojmë mbi bazën e marksizëm-leninizmit dhe të internacionalizmit proletar.

Për çështjet parimore ne nuk do të bëjmë lëshime. Ne do të udhëhiqemi gjithnjë nga teoria marksiste-leniniste dhe nga interesat e kampit socialist».

Pastaj Hrushovi tha: «Ju duhet të kuptoni që të gjithë njerëzit mendojnë sikur jemi ne që ju shtyjmë kundër jugosllavëve, duke u nisur nga artikulli që botoi shoku Enver në gazetën «Pravda»». Pastaj ai pyeti nëse kishte ndonjë shok tjetër për të folur. Nga ana jonë s'kishte njeri, të gjithë ishim të një mendimi për ato që thamë atje dhe takimi u mbyll.

Në bisedimet përfundimtare ne i falenderuam shokët sovjetikë për pritjen e ngrohtë që na u bë dhe për ndihmën që na ofruan. Pastaj foli edhe Hrushovi, i cili për të zbutur atmosferën e aëuar që u krijua ditët e fundit, duke iu përgjegjur falenderimeve tona tha se Bashkimi Sovjetik e ka për detyrë që ta ndihmojë popullin shqiptar se është një popull heroik dhe besnik. «Ne, tha ai, do ta bëjmë Shqipërinë një kopësht të lulëzuar». Pastaj shtoi: «Marksizëm-leninizmi ka shumë motive. Po nuk i dhe tjetrit të hajë, folë sa të duash për marksizëm-leninizmin. Te ne, nuk bëhet fjalë nëse do ta sigurojmë bukën apo jo. Ne bukë dhe qumësht kemi me sasi të mëdha; këtë vit ne do të sigurojmë të gjitha nevojat edhe me mish. Po edhe popujt e tjerë nuk rrojnë dot me fjalët e marksizëm-leninizmit, njeriu do bukë, ushqim dhe veshje. Drithi që ne do t'i japim Shqipërisë, është sa sasia që prodhojnë dy sovko

ze tonat të marrë së bashku, ose sa sasia «që na hanë minjtë»<sup>1</sup>.

Në pritjen e fundit që u dha për ne në Kremlin, Hrushovi më sugjeroi që të bisedoja me ambasadorin jugosllav. Miçunoviçi rrinte pak larg, por, pasi mbaruan ceremonitë e para, Hrushovi e ftoi afër nesh dhe filluam kështu bisedimet. Unë i thashë ambasadorit jugosllav: «Ne po përpiqemi t'i përmirësojmë marrëdhëniet, prandaj dëshiroj t'ju them disa gjëra me qëllim që të vini në dijeni udhëheqjen tuaj. Këto që po ju themi mos i merrni si sulme kundër jush, por si vërejtje shoqërore. Ja, për shëmbull ministri juaj në Tiranë bën shumë gjëra të papëlqyera. Ne kemi midis nesh mosmarrëveshje të thella ideologjike, por ato që na bën ministri juaj dalin jashtë këtij kuadri dhe çojnë në acarimin edhe të marrëdhënieve shtetërore, kurse ne duam që të mos krijohet një situatë e tillë». Me këtë rast i thashë mendimet tona.

Ai tha: «Ne mbahemi të informuar mbi çdo gjë nga Ministria e Jashtme, po për këto nuk di gjë. Ne kemi

---

<sup>1</sup> Në këtë kohë udhëheqja sovjetike me në krye Hrushovin përdori të gjitha format për ta shmangur PPSH nga rruga e vet marksiste-leniniste. Pasi dështuan në përpjekjet për t'u imponuar me anën e diktatit, ata përdorën rrugën e lajkave dhe të premtimeve për ndihmë të gjithanshme. Koha e tregoi se premtimet për ndihmë, për të shndërruar Shqipërinë «në një kopsht të lulëzuar» ishin vetëm një mashtrim. Pas Mbledhjes së Bukureshtit në qershor 1960, ku Partia jonë kundërshtoi kompletet e tyre kundër lëvizjes komuniste botërore, ata jo vetëm që sulmuan pa princip PPSH, por dhe i prenë popullit shqiptar të gjitha ndihmat ekonomike me qëllim që ta thyenin dhe nënshtronin me anën e forcës dhe të urisë.

direktiva që të mos bëjmë veprimtari spiunazhi në vendet tuaja».

«Kurse në Tiranë, i thashë unë, këto gjëra po bëhen».

«Detyra e ambasadorit, tha ai, është të përmirësojë marrëdhëniet midis vendit të tij dhe vendit ku punon, por këto që po më thoni ju janë gjëra të vogla, midis nesh ka gjëra të mëdha që na ndajnë. Politika juaj dhe e sovjetikëve nuk kuptohet. Ju nga një anë luftoni me ashpërsinë më të madhe kundër oportunitizmit dhe revizionizmit, dhe gjithë bota e kupton që këtu bëhet fjalë për jugosllavët, kurse nga ana tjetër doni miqësi me ne. Kjo është e pakuptueshme. Me kë doni miqësi ju me revizionistët? Sa kohë që midis vendeve tona ka kontradikta nuk mund të ecet në rrugën e përmirësimit të marrëdhënieve.

Punët janë acaruar sepse qëndrimet tuaja në shtyp ndaj nesh janë shumë të ashpra dhe të egra. Tani në fund, kur ju jeni larguar nga Shqipëria, është botuar një artikull që e bën Jugosllavinë nxitëse lufte, bashkëpunëtore të imperializmit etj. Ju keni ngritur pastaj pa të drejtë çështjen e Kosovës, me këtë keni dashur të ndërhyjni në punët e brendshme të vendit tonë».

Unë i thashë: «Përsa i përket fushatës së shtypit fajin nuk e kemi ne. Qysh nga deklarata sovjeto-jugosllave e Beogradit ne nuk kemi ndërmarrë asnjë sulm në shtyp kundër Jugosllavisë. Në rast se ju do të gjeni një gjë të tillë ne jemi gati të bëjmë autokritikë, kurse ju keni vazhduar të shkruani pa ndërprerë artikuj jashtëzakonisht të poshtër kundër nesh. Prandaj në këtë çështje nuk keni si të na akuzoni ne. Është e vërtetë se

ne u jemi përgjegjur, bile ashpër, disa sulmeve të shtypit tuaj, por kur shtypi juaj ka shkruar shumë keq për ne.

Çështjen e Kosovës ne e kemi ngritur jo për rivendikim, po jemi shtyrë nga ndjenja humanitare për shqiptarët e Kosovës, ndaj të cilëve po mbahen qëndrime jonjerëzore nga ana juaj. Ju shumë kosovarë po i dërgoni në Turqi. Ju mund të mos i besoni këto që themi, por ne kemi dokumenta».

«Në Jugosllavi banojnë 150 mijë turq», tha ambasadori jugosllav.

«Nuk flasim për turqit, i thashë unë, po për shqiptarët. Ne e kemi ngritur çështjen e Kosovës sepse ju e keni përdorur atë në dëmin tonë. Propaganda që bëni tani ju në Kosovë drejtohet kundër nesh. Në kufirin shqiptaro-jugosllav ju keni sjellë fashistët e larguar nga Shqipëria që s'bëjnë gjë tjetër veçse flasin kundër Partisë dhe qeverisë sonë dhe u bëjnë thirrje njerëzve të brezit kufitar të shkojnë në Jugosllavi. Këto nuk janë gjëra të mira në marrëdhëniet tona, janë veprime armiqësore, prandaj duhet t'u jepet fund.

Kurse përsa u përket kontradiktave për të cilat folët ju ne do të luftojmë deri në fund kundër oportunitizmit dhe revizionimit të marksizëm-leninizmit dhe nga këto pozita nuk tërhiqemi».

«Këtu, tha Miçunoviçi, nuk keni të drejtë, tezat tuaja nuk kanë baza. Ne nuk jemi kundër rolit udhëheqës të partisë, kundër rolit të diktaturës së proletariatit».

«Tezat tona, i thashë unë, janë të bazuara në fjalimet e udhëheqësve tuaj dhe në praktikën tuaj të

ndërtimit të socializmit. Në këtë çështje ne nuk do të merremi dot vesh, sepse ne nuk do t'i lëshojmë pozitën tonë. Ne jemi kundër çdo lloj oportunitizmi dhe revizionizmi, qoftë ky edhe në vendin tonë. Veçse është fakt që në këto momente jeni ju që mbani bajrakun e revizionizmit. Prandaj kur flasim ne kundër revizionizmit, e përmendim ose jo Jugosllavinë, është realitet që flitet për ju».

Në këtë kohë erdhën afër nesh Molotovi dhe Hrushovi dhe e rrethuan ambasadorin jugosllav, i cili filloi të përsëritë thëniet e tija se si mund të pajtohen miqësia me luftën që zhvillohet kundër tyre? Kur Miçunoviçi vazhdoi të akuzonte Shqipërinë, Hrushovi i përmendi rastin kur kishte shkuar Titua në Korfuz dhe mbreti i Greqisë i kishte propozuar copëtimin e Shqipërisë. Titua nuk qe përgjegjës, ndërsa mbretëresha u tërhoqi vëmendjen të mos hapnin muhabete të tilla se këto janë delikate dhe shumë të rrezikshme. Miçunoviçi, kur u përmend kjo, e humbi toruan dhe tha se kjo ishte një shaka.

Ne i thamë: «Shaka të tilla, sidomos me Greqinë që ka tërë jetën që rivendikon Shqipërinë e Jugut nuk duhen bërë. Po «shaka» të tilla ju keni bërë edhe më parë. Ne kemi një dokument të Boris Kidriçit, në të cilin Shqipërinë e ka futur si republikë të shtatë të Jugosllavisë».

«Kjo është një gjë e bërë nga një njeri» tha Miçunoviçi.

Shoku Mehmet i tha: «Një njeri, po ai ishte anëtar i Byrosë Politike dhe kryetar i komisionit të planit të shtetit».

Miçunoviçi kërceu e tha se në atë kohë Jugosllavia e ka ndihmuar shumë Shqipërinë.

«Mos folni për ndihmat, i thashë unë, se ndihmë ju kemi dhënë edhe ne, këtu është çështja e pavarësisë sonë. Është tjetër ndihma dhe një çështje tjetër të cënosh pavarësinë e një vendi».

Deri në këtë pikë arriti kjo zallahi, vetëm se në fund ai tha që i përshëndetnin deklaratat sovjeto-shqiptare në lidhje me përpjekjet që duhen bërë për përmirësimin e marrëdhënieve tona.

Në përgjithësi këto ishin disa nga çështjet e rëndësishme të bisedimeve, për të cilat ne menduam t'ju informojmë; për bisedimet qeveritare dhe për çështjet e tjera ju jeni në dijeni nga deklaratat dhe materialet e botuara në shtyp.

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*



## MESAZH PUNONJËSVE HUNGAREZË ME RASTIN E 1 MAJIT

[Prill] 1957

Shokë dhe vëllezër hungarezë,

Me rastin e ditës së 1 Majit, ditë vëllazërimi dhe solidariteti ndërkombëtar e punonjësve të të gjithë botës, ju dërgojmë përshëndetjet më të nxehta e më miqësore të popullit shqiptar, të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe ju urojmë nga zemra lumturi e suksese të reja në punën tuaj paqësore për ndërtimin e socializmit në Hungari.

Populli shqiptar që është lidhur me miqësi të sinqertë me popullin hungarez, që është lidhur nga bashkësia e interesave për ndërtimin e socializmit, nga pjesëmarrja në familjen e madhe të vendeve socialiste me Bashkimin Sovjetik në krye, ashtu si gjithë popujt e vendeve socialiste dhe gjithë njerëzimi përparimtar, është gjithmonë pranë jush dhe gëzohet për çdo sukses tuajin, sepse çdo fitore juaja është edhe e jona.

Ne e dimë, të dashur shokë dhe vëllezër hungarezë, se sa dëme ju shkaktoi kundërrevolucioni. Por jemi të bindur se do t'i kapërceni me sukses vështirësitë dhe do

të ecni të sigurtë gjithmonë përpara në rrugën tonë të përbashkët të ndërtimit të socializmit. Populli shqiptar do ta forcojë çdo ditë e më shumë miqësinë e sinqertë me popullin vëlla hungarez.

Armiqtë e vendit tonë, ata që përpiqen të skllavërojnë popujt e vegjël si dhe të gjithë ata që përpiqen të dobësojnë unitetin e kampit tonë dhe të revizionojnë marksizëm-leninizmin, vjellin vrer kundër miqësisë sonë të pathyeshme, kundër çështjes sonë që është e drejtë dhe që do të triumfojë.

Bisedimet që u zhvilluan kohët e fundit në Moskë midis partive komuniste motra dhe qeverive të vendeve socialiste treguan edhe një herë se ne të gjithë jemi pjesëtarë të familjes së madhe socialiste, se jemi shokë lufte e pune që kemi të njëjtat qëllime e të njëjtat ideale, prandaj ne, së bashku, jemi të vendosur që edhe në të ardhshmen të forcojmë unitetin e kampit tonë socialist.

Rroftë miqësia e pathyeshme midis popullit shqiptar dhe popullit vëlla hungarez!

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**LETËR DREJTORISË SË MUZEUMIT «V. I. LENIN»  
TË LENINGRADIT**

**3 maj 1957**

**DREJTORISË SË MUZEUMIT «V. I. LENIN»**

*L e n i n g r a d*

I dashur shoku drejtor,

Pas kthimit tonë në atdhe nga vizita miqësore në Bashkimin Sovjetik, unë dhe shokët e mi nuk mund të harrojmë pritjen vëllazërore dhe shumë të përzemërt që na u bë neve, të dërguarve të popullit shqiptar, në muzeumin që ju keni nderin të drejtoni.

Duke plotësuar premtimin e dhënë, po ju dërgoj vëllimin 1 dhe 33 të veprave të plota të V. I. Leninit që janë botuar deri tani në gjuhën shqipe. Krahas me daljen e tyre nga shtypi do t'ju dërgoj gjithashtu në të ardhshmen edhe vëllimet e tjera.

Me këtë rast unë dëshiroj t'ju falenderoj edhe një herë ju personalisht, shoku drejtor, për kujdesin që treguat gjatë vizitës sonë në Muzeumin «V. I. Lenin».

Të fala të përzemërta shoqërore

*Enver Hoxha*

Sekretar i Parë i KQ të PPSH

*Botohet për herë të parë st-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

**LETËR KOMITETEVE TË PARTISË TË RRETHEVE  
VLORË DHE BILISHT ME RASTIN E NGRITJES SË  
KOOPERATIVAVE BUJQËSORE NË TË GJITHA  
FSHIATRAT E KËTYRE RRETHEVE**

**11 maj 1957**

**KOMITETIT TË PARTISË TË QARKUT TË KORÇËS  
PËR ORGANIZATËN E PARTISË TË RRETHIT TË  
BILISHTIT  
ORGANIZATËS SË PARTISË TË RRETHIT TË VLORËS**

Të dashur shokë,

Kolektivizimi i bujqësisë është një nga detyrat më të mëdha që ka shtruar Kongresi III i Partisë përpara komunistëve dhe gjithë punonjësve të vendit tonë. Besnike ndaj Partisë dhe traditave patriotike e revolucionare të së kaluarës organizatat e Partisë të rretheve tuaja, si dhe organet e pushtetit dhe organizatat e masave mobilizuan të gjitha forcat për zbatimin e kësaj direktive të madhe. Sot, në çdo fshat të rrethit të Vlorës, si dhe të rrethit të Bilishtit janë ngritur kooperativa bujqësore, ku janë bashkuar respektivisht 74 për qind dhe 81,2 për qind e ekonomive fshatare dhe është kolek-

tivizuar 83,5 për qind dhe 82,2 për qind e tokës së punuar. Ky është një sukses i madh për organizatat tuaja të Partisë dhe për të gjitha masat punonjëse të rrethit. Komiteti Qendror i Partisë konstaton me kënaqësi se në kolektivizimin e bujqësisë janë arritur rezultate të mira në të gjithë vendin. Nga 694 kooperativa bujqësore me 18,9 për qind të ekonomive dhe 26,16 për qind të tokës që ishte kolektivizuar, deri në Kongresin III të Partisë, në fund të prillit të këtij viti numëroheshin 1 285 kooperativa bujqësore me 33 për qind të ekonomive bujqësore dhe 40,8 për qind të tokës së kolektivizuar.

Këto suksese tregojnë edhe një herë sa e drejtë është vija e Partisë sonë për transformimin socialist të vendit, vijë e cila mbështetet në parimet e pavdekshme të marksizëm-leninizmit.

Komiteti Qendror i PPSH i përgëzon organizatat e Partisë të rrethit të Vlorës dhe të Bilishtit për rezultatet e arritura në kolektivizimin e bujqësisë dhe u uron të gjitha masave punonjëse të rretheve tuaja suksese edhe më të mëdha në punën për ndërtimin e bazave të socializmit në vendin tonë.

Përpara organizatave të Partisë dhe organeve të pushtetit të rretheve tuaja tani shtrohen detyra edhe më të mëdha në fushën e kolektivizimit të bujqësisë. Në radhë të parë, duhet të zhvillohet një punë e gjithanshme për forcimin organizativo-ekonomik të kooperativave bujqësore. Krahas me këto duhet të bëhet një punë e madhe sqaruese për shtimin e numrit të anëtarëve në kooperativat bujqësore ekzistuese. Tani organizatat e Partisë dhe organet e pushtetit duhet të mendojnë dhe

të preokupohen më shumë për problemet e bujqësisë. Ekonomia e madhe e kolektivizuar kërkon aftësi më të mëdha organizimi dhe drejtimi.

Që kooperativat bujqësore të bëhen më të forta nga ana organizative dhe ekonomikisht të pasura, është e nevojshme që çdo gjë të organizohet në bazë të statutit tip që aprovoi Kongresi i tretë i Kooperativave Bujqësore. Është e nevojshme që çdo kooperativë ta studjojë me kujdesin më të madh statutin dhe të vërë të gjitha forcat për zbatimin e tij me përpikmërinë më të madhe. Të ngrihet në lartësinë e duhur roli i mbledhjes së përgjithshme të anëtarëve, me qëllim që çdo anëtar i saj ta ndjejë veten zot në kooperativë dhe të marrë pjesë aktive në drejtimin e punëve. Të shtohet pjesëmarrja e anëtarëve në punët e përbashkëta dhe të pakësohen sa më shumë shpenzimet për nevojat e drejtimit. Ta zhvillojmë sa më gjerë blektorinë dhe frutikulturën, të hapim sa më shumë toka të reja, ta drejtojmë ekonominë e përbashkët në bazë të njohurive në mënyrë që për çdo ha, tokë të marrim sa më shumë prodhime dhe me shpenzime sa më të pakta.

Komiteti Qendror i Partisë është i bindur se, si gjithnjë ashtu edhe kësaj radhe, komunistët dhe tërë punonjësit e rretheve të Vlorës dhe të Bilishtit do ta mbajnë lart vendosmërinë e tyre për zbatimin e detyrave që ka shtruar Kongresi III i Partisë dhe Plenumi i Shkurtit 1957 i Komitetit Qendror të PPSH. Në shembullin tuaj duhet të ecin edhe të gjitha rrethet e tjera të Republikës.

Në aleancë të shëndoshë me klasën punëtore heroike, të mobilizuar për nder të 40-vjetorit të Revolu-

cionit të madh socialist të Tetorit, përpara shokë për  
suksese të mëtejshme në luftën fitimtare për transfor-  
mimin socialist të fshatit tonë!

Për Komitetin Qendror të PPSH  
Sekretari i Parë

*Enver Hoxha*

*Botuar për herë të parë në  
gazetën «Zëri i Popullit»,  
Nr. 115 (2702), 12 maj 1957*

*Botohet sipas origjinalit që  
gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë*



**LETËR DËRGUAR NXËNËSVE TË KLASËS SË 9-TË  
TË SHKOLLËS SË MESME SHENJÇENJ NË  
PROVINCËN ANJHUE**

*S h a n g a i*

**11 maj 1957**

Të dashur miq të rinj,

Porsa mora letrën tuaj. Jam shumë i prekur nga qëndrimi juaj kundrejt vendit tonë, nga interesimi që tregoni ju për sukseset e tij. Nxënësit e shkollave tona, sikurse i gjithë populli shqiptar, gjithashtu kanë një simpati të madhe dhe një respekt të madh ndaj vendit tuaj të madh dhe popullit tuaj të mrekullueshëm, sepse në Republikën Popullore të Kinës populli ynë sheh një mik besnik për jetë, një forcë të madhe të kampit tonë të demokracisë dhe socializmit.

Gjatë vizitës së fundit në atdheun tuaj të madh dhe heroik ne u bindëm edhe më tepër në faktin, që populli kinez 600 milionësh përfaqëson një forcë të madhe e të pamposhtur dhe se ai do të ndërtojë patjetër jetën e tij socialiste. Për këtë është garanci vendosmëria e tij për të shkuar përpara, është udhëheqja besnike marksiste-

-leniniste e Partisë Komuniste të Kinës me shokun e dashur Mao Ce Dun në krye.

Unë gëzohem shumë për sukseset tuaja në mësim dhe në lëvizjen sportive. Për ndërtimin e socializmit dhe të komunizmit nevojiten jo vetëm njerëz me kulturë të lartë, por edhe të fortë fizikisht, të aftë të kapërcejnë çdo pengesë në mbrojtjen e atdheut dhe në ndërtimin e së ardhshmes së lumtur.

Duke plotësuar dëshirën tuaj, unë do t'ia jap fëmijërin tuaj të nderit bashkë me fotografitë klasës së 8-të A të shkollës 11-vjeçare «Qemal Stafa» në Tiranë.

Ju uroj shëndet të mirë, shokë të dashur, suksese të shkëlqyera në mësim dhe në jetë, në mënyrë që të bëheni ndërtues të denjë të shoqërisë socialiste dhe komuniste në atdheun tuaj të madh e të mrekullueshëm!

I Juaji

*Enver Hoxha*

Sekretar i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Botuar për herë të parë në  
gazetën «Zëri i Rinisë»,  
Nr. 37 (907), 11 maj 1957*

*Botohet sipas tekstit të gazetës  
«Zëri i Rinisë», Nr. 37 (907),  
11 maj 1957*

# TË PËRFITOJMË NGA EKSPERIENCA E KINËS POPULLORE PËR FORCIMIN E SEKTORIT TË TREGËTISË

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

11 maj 1957

Pavarësisht nga sukseset e arritura në tregëti, duhet të luftojmë më me këmbëngulje kundër një pune rutine, kundër frazave boshe dhe studimeve që zvarriten për një kohë të gjatë në këtë sektor. Flitet shumë për eksperiencën, shkojnë edhe njerëz në Bashkimin Sovjetik e gjetkë, po kur vjen puna për ta zbatuar këtë eksperiencë në përshtatje me kushtet e vendit tonë, vihen re ngurrime në zbatimin e eksperiencës së marrë. Si rrjedhim vazhdohet me format e vjetra të punës.

Lidhur me çështjet që u ngritën këtu, dëshiroj edhe unë të them pak fjalë:

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje të Sekretariatit të KQ të PPSH u diskutua mbi eksperiencën që solli delegacioni i vendit tonë nga Republika Popullore e Kinës për forcimin e punës në sektorin e tregëtisë.

Për tregëtinë e vogël private Byroja Politike ka dhënë direktiva, por Ministria e Tregëtisë nuk është interesuar sa duhet për zbatimin e tyre. Shihet më shumë si të tatonen tregëtarët e vegjël dhe nuk veprohet në kompleks, ashtu si janë dhënë udhëzimet e Partisë.

Te ne ka mjaft tregëtarë të vegjël që kanë mallra industriale, por këta spekulojnë, prandaj duhet menduar si të organizohen ata, kështu do të frenohet spekulimi nga ana e tyre dhe ata do të edukohen në punë e sipër. Një formë e përshtatshme për këtë është kooperimi i tyre, gjë që do të influencojë në një farë shkalle për të luftuar kundër tendencave mikroborgjeze që kanë mjaft fshatarë, të cilët i shesin mallrat te këta tregëtarë. Po të kooperohen tregëtarët e vegjël atëherë fshatari nuk do të bredhë sa andej-këtej për të fituar sa më shumë. Prandaj është e drejtë që kjo formë të vihet në praktikë, veçse jo me urdhëra, po me bindje dhe, më parë, të fillohet këtu në Tiranë, me sektorë. Kjo ide jo vetëm të hidhet po edhe të punohet për ta konkretizuar e materializuar duke u dhënë mallra këtyre njerëzve për të shitur te konsumatorët. Krahas kësaj, të shihet edhe tatimi i tyre. Një punë e tillë duhet studjuar me ata që do të merren me mallrat ushqimore, të cilët të lejohen që të grumbullojnë duke parë edhe interesin e tyre. Nga ana tjetër këta të edukohen edhe me tiparet e ndërgjegjes socialiste.

Kooperativat e konsumit te ne kanë shumë të meta; format e punës së tyre nuk përpunohen sipas kushteve tona konkrete. Këto kooperativa nuk grumbullojnë artikuj kryesorë ushqimorë për popullin. Edhe kur grumbullohen këta artikuj prishen për mungesë transporti.

Në këtë drejtim duhet të përfitojmë nga eksperiencia e Kinës. Prandaj është e domosdoshme të organizohet meoemos edhe transporti primitiv. Kafshë kemi, po transporti me anë të tyre nuk organizohet si duhet nga ana e kooperativave të konsumit. Këtij problemi i duhet dalë përpara. Po të shohë interes fshatari, kafshët do t'i vërë në dispozicion për të organizuar transportin. Fitimet, kooperativat nuk i ndajnë, mallrat i blejnë një-lloj si ai që është anëtar i kooperativës së konsumit, ashtu dhe ai që s'është anëtar i saj. Shokët drejtues të tregëtisë në qendër, nuk marrin pjesë në mbledhjet e komiteteve ekzekutive të këshillave popullore për të shtruar problemet që preokupojnë këtë sektor dhe për të dëgjuar mendimet e tyre.

Ka edhe probleme të tjera që duhen zgjidhur më mirë dhe shpejt siç janë: ngritja e baxhove në zonat e Veriut, problemi i forcimit të kuadrove të tregëtisë dhe i edukimit të tyre, zgjerimi i tregëtisë kooperativiste dhe private në fshat, kooperimi i tregëtarëve të vegjël etj.

Duke mësuar nga eksperiencia e punës së shokëve kinezë, të kemi parasysh që të përfitojmë edhe nga vetë eksperiencia jonë dhe të luftohet për të zbatuar detyrat që janë caktuar për sektorin e tregëtisë. Lidhur me këtë, shumë gjëra mund të bëhen me vetë inisiativën e dikastereve përkatëse.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## NGA FJALA NË TAKIMIN ME USHTARAKËT SHEMBULLORË

11 maj 1957

Të dashur shokë ushtarë, nënoficerë dhe oficerë,

Është një gëzim i madh për mua që takohem sot me ju shokë të rinj, nga më të dalluarit e ushtrisë sonë heroike. Ju jeni të rinj nga mosha, por jeni të pjekur dhe të ngritur nga ana e kulturës e veçanërisht e kulturës ushtarake. Kjo është një çështje me rëndësi për vendin tonë, për Partinë tonë, që rrit dhe edukon djemtë e popullit, i pajis ata me shkencë të re, i bën të aftë për të luftuar për një jetë më të mirë dhe më të lumtur, i armatos për të kaluar vështirësitë e jetës, i edukon për mbrojtjen me nder të atdheut dhe të fitoreve të popullit tonë.

Shokë, kur populli ynë, i udhëhequr nga Partia, filloi Luftën nacional-çlirimtare, shumë prej jush kanë qenë kalamane. Luftën që bëri populli, d.m.th. prindërit, vëllezërit dhe motrat tuaja, edhe ju të vegjëlit e ndjetë thellë. Lufta nacional-çlirimtare e çliroi popullin tonë një herë e përgjithmonë nga robëria dhe nga vuajtjet shekullore dhe bëri që ju brezat e rinj të shihni

ditë të lumtura e të gëzuara. Gjatë Luftës nacional-çlirimtare u themelua ushtria jonë heroike. Ajo shkroi faqe të shkëlqyera në historinë e popullit tonë. Organizatorja e të gjitha fitoreve të popullit dhe të ushtrisë sonë heroike ishte Partia Komuniste, tani Partia e Punës. Ajo i kaliti partizanët trima, krijoi Ushtrinë Popullore, e bëri atë të fortë të shkatërrojë armiqtë fashistë italianë e gjermanë, se Partia jonë diti ta lidhë ngushtë ushtrinë me popullin. Sot ne kemi një ushtri të shkëlqyer nga çdo pikëpamje, një ushtri moderne, patriote të flaktë, të gatshme dhe vigjilente për të mbrojtur në çdo moment atdheun dhe popullin nga çdo rrezik.

Sot, ju shokë, në saje të udhëheqjes së drejtë të Partisë, në saje të pushtetit popullor, në saje të eksperiencës së lavdishme të Ushtrisë Sovjetike, mund të themi pa frikë dhe me mburrje se keni eksperiencë shumë më të madhe nga ç'kishim ne partizanët e parë. Ne, partizanët e parë, kishim ato virtyte të larta të popullit tonë, guximin, qëndrueshmërinë dhe vendosmërinë për të shkatërruar armikun dhe ajo që na ndihmoi aq shumë për të arritur fitoren ishte eksperiencia shekullore e luftërave për liri të popullit tonë, ishte dhe eksperiencia e luftërave të partizanëve sovjetikë. Pastaj, sikurse e dini, rëndësi të madhe për sukseset tona në Luftën nacional-çlirimtare kishte fitorja e Ushtrisë Sovjetike mbi hordhitë hitleriane.

Sot, ju shokë të Ushtrisë Popullore të Shqipërisë, përveç virtyteve të larta të popullit tonë, përveç eksperiencës së madhe të Luftës nacional-çlirimtare, keni një edukatë të lartë, të cilën e keni marrë në shkollat që ka krijuar Partia dhe pushteti popullor. Mundësitë që keni

ju sot, ne partizanët e parë nuk i kishim, po tash ju i keni, shokë ushtarë.

Ju që jeni mbledhur sot këtu, jeni nga më të shquarit e më të mirët e ushtrisë sonë. Por në ushtrinë tonë ka me qindra dhe me mijëra ushtarakë shembullorë që i janë përveshur punës për rritjen e aftësive ushtarake dhe për përvetësimin e artit ushtarak modern.

Është e domosdoshme që ushtria jonë të tregojë kujdesin më të madh për të kryer detyrat që i dalin përpara, sepse ne lirinë e fituam dhe kjo është fitorja më e madhe për popullin, por, sikurse e dini, sot ekzistojnë forca të errëta në botë që kërkojnë ta futin atë në një luftë tjetër. Dihet se me zbulimin e bombave atomike dhe me hidrogjen, një luftë e re do t'u shkaktonte popujve humbje të pallogaritshme. Prandaj ushtria jonë si gjithmonë, duhet të qëndrojë kurdoherë e gatshme në roje të atdheut dhe të paqes. Kjo na bën ne që të kemi një ushtri të fortë dhe të gatshme për mbrojtjen e atdheut. Ju e dini mirë se po të jesh i përgatitur dhe i fortë, armiku ta ka frikën se thyen kokën, kurse sa më i dobët të jesh aq më të mëdha janë rreziqet.

Imperialistët dëshirojnë ta hedhin botën në një luftë tjetër të re. Ata janë si kumarxhinjtë që hedhin zaret dhe aq u bën gjaku i miliona njerëzve që derdhet, veç ata të kenë fitime. Ata do ta kishin filluar luftën, por dhe ata bëjnë llogari e mendojnë se një luftë e tretë botërore e shkaktuar prej tyre do të sillte shkatërrimin e vetë imperializmit. Merreni me mend sikur shkencëtarët e lavdishëm sovjetikë të mos kishin zbuluar atomin dhe kjo forcë e madhe të kishte mbetur monopol i luftënxitësve imperialistë. Po tani këto armë s'janë ve-



tëm monopol i imperialistëve, ne jemi më përpara se ata, bile shumë më përpara.

Politika e kampit tonë me Bashkimin Sovjetik në krye është një politikë paqeje, vëllazërimi në mes popujve, kundër luftës. Me vite të tëra vendet tona të socializmit kanë kërkuar e do të kërkojnë që, të dy sistemet shoqërore që ekzistojnë sot në botë, socializmi dhe kapitalizmi të jetojnë në paqe. Ne duam të punojmë, të ngremë fabrika, shkolla, të zhvillojmë ekonominë tonë popullore, të lulëzojmë jetën e popujve tanë. Jo vetëm vendet socialiste, po të gjithë popujt e botës e shikojnë çdo ditë e më qartë se ku po e çon botën imperializmi, prandaj rezistenca e tyre bëhet çdo ditë më e fortë kundër këtyre luftënxitësve. Megjithkëtë neve nuk na lejohet, në asnjë mënyrë të dobësohemi, të flemë mbi dafina, përpara një situatë të tillë, pse sa më të fortë të jemi aq më të sigurtë do të jemi për të mbrojtur vendet tona të lira dhe paqen në botë.

Shokët më kanë njoftuar se ju vizituar qendrën e aviacionit tonë dhe u njohët me tipat e ndryshëm të aeroplanëve tanë nga më modernët. Ju vizituar portet dhe bregdetin tonë të bukur. U bindët se jo vetëm kryqëzorët armiq nuk do të guxojnë më të hyjnë në portet tona si më 1939, por as miza nuk do të kalojë se ruan me vigjilencë ushtria jonë e lavdishme. Sigurisht zemrat tuaja u kënaqën pa masë për këto. Detyra jonë është që të mirëmbajmë dhe të përvetësojmë teknikën e re ushtarake. Kaloi koha kur ne shkonim në mal me një mauzer të vjetër në dorë për të luftuar. Tani ushtria jonë është pajisur me armët më moderne. Duhet të jeni, pra, shumë të zellshëm në mësim, d.m.th. të mobilizo-

heni dhe të ndiqni me kujdes programet mësimore dhe stërvitjen ushtarake.

Ne, shokë, kënaqemi kur shohim se sot në Ushtrinë tonë Popullore nuk ka analfabetë dhe kjo tregon përparimin e madh që është bërë. Ushtarët tanë sot nuk janë vetëm me shkollë fillore, por ka me qindra e me mijëra që kanë mbaruar shkollat shtatëvjeçare dhe shumë të tjerë shkollat e mesme. Prandaj ne mendojmë që ushtarakët tanë, përveç zgjuarësisë, mprehtësisë, gatishmërisë dhe besimit për kauzën e fitores së socializmit që vlon në zemrat e tyre, kanë edhe kulturën për ta zotëruar sa më shpejt dhe më lehtë teknikën moderne. Vendosmëria juaj, shpirti i sakrificës, plus armët më moderne që keni në dorë, përbëjnë një forcë të madhe për mbrojtjen e paqes e të socializmit, për mbrojtjen e atdheut. Prandaj, shokë, çështjen e perfeksionimit në përdorimin e këtyre armëve moderne duhet ta shikojmë si një detyrë me rëndësi jetike për mbrojtjen e atdheut, të kampit tonë dhe të paqes. Përveç që ju duhet t'i përdorni dhe t'i mbani mirë ato, duhet t'i ruani si sytë e ballit, sepse ato janë armët tuaja të destinuara për qëllime të larta siç janë mbrojtja e fabrikave, e kombinateve, e punës paqësore të fshatarëve, si dhe e të gjitha fitoreve të tjera të shumta të popullit tonë. Pa këto armë, vihen në rrezik të gjitha fitoret që me gjak e sakrifica i realizoi populli me punën e tij të palodhur dhe me ndihmën e miqve tanë.

Ushtria jonë është njëkohësisht një shkollë e madhe. Ju, shokë, ta përvetësoni teknikën moderne se do ta keni më lehtë nesër kur të ktheheni në jetën civile e të shkonj në fabrikë, ose në zanat me një kurs të

shkurtër, do të jeni në gjendje të punoni me sukses atje ku e kërkon interesi i popullit. Ju këtë ta konsideroni si një profesion, si një detyrë patriotike dhe si një shkollë të madhe, në mënyrë që edhe të forcohet ushtria jonë edhe të shkojë më përpara ekonomia jonë popullore.

Të tregoni kujdes të madh për mësimet që merrni mbi elementet kryesore të energjisë atomike dhe mbi mbrojtjen kundër bombave atomike e me hidrogjen. Në qoftë se ne arrijmë qëllimin që energjia atomike të mos përdoret për luftë, por për të mirën e popujve, ju do të jeni nga ata të parët në vendin tonë që do të ndërtoni centralet elektrike me energji atomike, ju do të jeni nga të parët që do të mësoni shfrytëzimin e energjisë atomike në mjekësi për të shëruar njerëzit nga sëmundjet, ju do të jeni nga të parët që do të mësoni se si përdoret energjia atomike në fushën e bujqësisë e në degët e tjera të prodhimit paqësor për të mirën e popullit.

Ashtu si në kombinatet, fabrika e kooperativa që ka emulacion socialist edhe te ju duhet të ketë emulacion për t'i mbajtur sa më mirë këto armë kaq moderne dhe të bëni racionalizime lidhur me mirëmbajtjen dhe përdorimin e tyre. Ju vizituar aeroplanët modernë dhe e shikoni se këto mjete çdo ditë vijnë duke u perfeksionuar. Prandaj te ju duhet të rritet emulacioni për këto maqina të arta, që t'i zotëroni më shpejt, t'i mbani dhe t'i shfrytëzoni më mirë, të bëni racionalizime në përdorimin e tyre. Shokët e Shtabit të Përgjithshëm më raportojnë vazhdimisht se te ju ka njerëz të shkëlqyer, që kanë bërë racionalizime në këtë drejtim me të cilat i kanë sjellë të mira ekonomisë popullore.

Shokë, ju e dini se një vend mund të ketë armë moderne sa të dojë, por ajo që ka rëndësi të madhe është njeriu që do t'i përdorë këto armë, kur ta lypë nevoja. Prandaj në radhë të parë, kujdesi i Partisë dhe i pushtetit tonë ka qenë dhe do të jetë kurdoherë jeta e njeriut, jeta e ushtarit, që në ushtrinë tonë të bëhet një jetë sa më e mirë, që ushtarakët të jenë të shëndoshë fizikisht dhe të kulturuar nga çdo pikëpamje. Ne kemi suksese të mëdha, shikoni, fytyrat tuaja skuqin si molla, sytë tuaj shkëlqejnë nga gëzimi dhe shprehin kënaqësinë e shpirtit dhe të trupit tuaj. Në ushtrinë tonë s'ka më sëmundje, kjo tregon jo vetëm kujdesin që tregohet në ushtri për shëndetin e ushtarit, por tregon njëkohësisht kujdesin e regjimit tonë për shëndetin e popullit. Të meta në këtë sektor, sigurisht ka akoma, prandaj mundësitë që juve ju ka dhënë Partia dhe pushteti duhet t'i shfrytëzoni në maksimum.

Në radhë të parë ju duhet të interesoheni vazhdimisht për pastërtinë, pse në një vend jo të pastër bëjnë fole mikrobet. Pastaj duhet t'i jepni rëndësi kulturës fizike. Kjo është një gjë e rëndësishme pse «mendja e shëndoshë gjendet në një trup të shëndoshë». Me rëndësi për ju është pra shëndeti, po krahas këtij duhet të kujdeseni edhe për ushqimin e mendjes me shkencën e pararojës, me marksizëm-leninizmin që ka bërë të ndryshojë krejtësisht fati i Shqipërisë. Ne e dimë mirë si ka qenë vendi ynë përpara, si është sot dhe sa i bukur do të jetë ai nesër.

Partia vë si detyrë nga më të rëndësishmet edukimin marksist-leninist të kuadrove të ushtrisë, duke filluar që nga ushtari i thjeshtë e deri te oficeri më i lartë.

Kështu ju do të kaloni çdo vështirësi dhe do të zgjidhni çdo problem, sepse marksizëm-leninizmi do t'ju japë kyçet për të hapur të gjitha dyert. Kishin të drejtë për anën e tyre, të gjithë ata elementë të borgjezisë që, kur ne filluam luftën thoshin: «Ç'janë këta kalamanë që luftojnë kundër Italisë që ka gjithë këta topa, aeroplanë etj.». Ata as kishin besim në forcën e popullit dhe as nuk mund ta kuptonin forcën e madhe të marksizëm-leninizmit që ndrinte rrugën tonë. Po këta elementë s'kishin fare besim se Shqipëria do ta ndërronte faqen siç e ndërroi, prandaj e atakonin Partinë tonë. Po të mos kishim Partinë që udhëhiqet nga shkenca marksiste-leniniste nuk do të bëheshin të gjitha këto që janë bërë në vendin tonë. Disa çuditen si mundi Partia jonë e re, pa eksperiencë, që qysh në krye e filloi mbarë, si u bënë të gjitha këto gjëra të mëdha nën udhëheqjen e saj?

Këto u bënë sepse Partia bëri të sajën eksperiencën më të mirë dhe shekullore të popullit të vuajtur dhe trim. Këto u bënë sepse Partia eci në rrugën e Leninit duke e pasur të qartë se vetëm kështu do të vinte fitorja dhe nuk do të gabonim kurrë. Çfarë nuk thoshin armiqtë për ne në atë kohë. Po këto i thoshin armiqtë dhe jo populli. Populli i deshi me gjithë shpirt bijtë e tij që binin heroikisht në malet dhe në rrugët e qyteteve në luftë kundër pushtuesve fashistë italianë dhe gjermanë.

Kush e bëri vendin tonë të ndryshojë kështu? Lufta heroike e popullit, heroizmat e tij, Partia jonë e lavdishme që udhëhiqet nga shkenca marksiste-leniniste. Me çfarë energjie e patriotizëm të shkëlqyer e ka edukuar popullin Partia! Kur shpërtheu kundërrevolucioni

në Hungari, me qindra oficerë të çmobilizuar nga ushtria, të cilët tani punojnë në ekonomi, u drejtuan në komitetet e Partisë duke thënë: «Jemi gati në çdo moment kur të na thërresë Partia të mbrojmë interesat e atdheut dhe të popullit». Në ato momente të turbullta nuk lejohej që Partia të mos merrte masa për sigurimin e vendit nga çdo e papritur dhe kur ushtarëve të vjetër iu bë thirrje që të qëndronin edhe dy muaj më tepër në shërbimin ushtarak, ata u përgjegjën me entuziazëm: «jo dy muaj por edhe dy vjet po të jetë nevoja». Ja ku qëndron, pra, besnikëria dhe patriotizmi i zjarrtë i ushtrisë sonë që edukohet nga Partia në frymën e marksizëm-leninizmit për të mbrojtur interesat e popullit.

Prandaj çështjes së edukimit ideologjik, krahas me stërvitjen tuaj luftarake, duhet t'i kushtoni rëndësi të dorës së parë, sepse sa më të ngritur të jeni ideologjikisht, aq më të mëdha do të jenë përparimet tona dhe aq më shumë fitore do të kemi. Ju e dini që ne kemi armiq të egër të cilët përpiqen të godasin kampin tonë. Ata bënë tentativa që të rrëzojnë pushtetin popullor në Hungari dhe të pushtojnë Egjiptin, por dështuan me turp. Ushtria Sovjetike e ndihmoi popullin vëlla hungarez të dërmonte kundërrevolucionin në Hungari. Imperialistët dështuan në përpjekjet e tyre dhe kjo ishte një paralajmërim për ata.

Juve, si të gjithë popullit dhe në radhë të parë komunistëve, ju bien detyra të rëndësishme për të kryer. Dua të them se ne jetojmë në një kohë që vlen të jetohet. Neve na takon nderi i madh që të kryejmë jo vetëm detyrën për epokën aktuale, të hedhim bazat e ndërtimit

të socializmit në vendin tonë, por të punojmë edhe për brezat e ardhshëm. Çfarë thoni ju të rinjtë për Partinë? Lavdi Partisë që na nxori në dritë! Çfarë do të thonë brezat e ardhshëm të popullit? Ata do t'i këndojnë hymne Partisë dhe do të thonë se prindërit tanë, të udhëhequr nga Partia, kanë punuar për të lulëzuar jeta jonë. Prandaj të gjithë duhet të mobilizohemi për të realizuar detyrat që na dalin përpara, për mbrojtjen e paqes. Por në rast se do të kemi luftë, në rast se armiku do të na provokojë luftën, populli ynë si anëtar i kampit socialist me Bashkimin Sovjetik në krye, do të jetë gati t'i japë grushtin vdekjeprurës armikut.

Tani, të dashur shokë, ju e dini sa miq të fortë ka vendi ynë i vogël, sa respektohet nga të gjithë popujt e botës. Armiqtë janë përpjekur ta diskreditojnë dhe ta dëmtojnë vendin tonë, por ata nuk kanë mundur. Në sajë të udhëheqjes së drejtë të Partisë dhe përkrahjes së madhe të Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të tjera të kampit socialist është forcuar shumë Republika Popullore e Shqipërisë, është rritur prestigji ndërkombëtar i atdheut tonë. Duan ose nuk duan armiqtë ata detyrohen të na respektojnë. Asnjë e drejtë nuk i jepej përpara Shqipërisë në lëmin ndërkombëtar, ajo tani i fitoi të gjitha të drejtat në sajë të rrugës që i tregoi Partia. Asnjë shtet nuk guxon të prejë lirinë e pavarësinë e Shqipërisë, asnjë shtet nuk lejohet të bëjë shaka me pavarësinë dhe sovranitetin e atdheut tonë se Shqipëria tani s'është e vetmuar. Politika e Partisë dhe e qeverisë sonë në marrëdhëniet me të gjitha shtetet fqinj dhe të botës, ka qenë kurdoherë një politikë paqësore, fqinjësie të mirë dhe bashkëpunimi me përfitime reciproke

duke respektuar nga të dy palët pavarësinë, lirinë, sovranitetin dhe mosndërhyrjen në punët e brendshme të njëri-tjetrit. Këtë politikë të drejtë do të vazhdojmë ta ndjekim edhe pas kësaj.

Ne kemi mosmarrëveshje me Jugosllavinë dhe këto mosmarrëveshje janë në çështjet ideologjike. Këto janë çështje kryesore dhe jetike. Ne si të gjitha partitë e tjera marksiste-leniniste mendojmë se udhëheqësit jugosllavë gabojnë rëndë në këto çështje. Revizionizmi është i rrezikshëm për partitë e klasës punëtore dhe marksizëm-leninizmin. Prandaj ne nuk do ta shuajmë për asnjë çast luftën kundër atyre që kërkojnë të revizionojnë idetë e marksizëm-leninizmit, qofshin këta jugosllavë, shqiptarë ose të tjerë. Ne do të luftojmë deri në fund për mbrojtjen e parimeve marksiste-leniniste, për ruajtjen e pastërtisë së ideologjisë të Partisë sonë.

Ne, shokë, jetojmë në shekullin kur po fitojnë përditë idetë ngadhënjimtare të Leninit, në shekullin kur është zbuluar energjia atomike; ne jetojmë në momente vendimtare për fatet e mbrojtjes së paqes. Prandaj nën drejtimin e Partisë, klasa jonë heroike punëtore dhe fshatarësia, nën udhëheqjen e saj, duhet të ecin me vendosmëri përpara. Në radhë të parë ne duhet që radhët e Partisë t'i mbajmë të pastra sepse vetëm kështu do ta kemi të fortë Partinë dhe do të kalojmë me siguri nga sukcesi në sukses. Kjo kërkon që ne të forcojmë vigjilencën kundër armiqve, të mos na dehin sukseset dhe perspektivat e shkëlqyera që na hapen përpara. Ne duhet të dimë se armiqtë nuk i kanë hedhur armët, se ata bëjnë çdo ditë përpjekje për të na goditur dhe po të na gjejnë ndonjë të çarë vërsulen të na vënë shqelmin.



Prandaj, për të arritur suksese të reja, duhet të luftojmë që të çelnikosim akoma më shumë unitetin e Partisë dhe unitetin e popullit rreth saj.

Ju, shokë ushtarë, nënoficerë dhe oficerë, mos harroni detyrat tuaja speciale e të shenjta që të kemi një ushtri të fortë, besnike ndaj popullit dhe Partisë. T'i doni me gjithë shpirt oficerët tuaj që kanë bërë Luftën e madhe nacional-çlirimtare, që kanë sakrifikuar jetën e tyre dhe të familjeve të tyre për të mirën e atdheut. Duhet të ruani dhe të forconi disiplinën dhe unitetin politik, sepse vetëm kështu ushtria jonë do të mbetet një ushtri e tipit leninist, se vetëm kështu e do populli atë. Ju keni dashuri të pakufishme për popullin prandaj populli, Partia, Komiteti Qendror i saj dhe qeveria janë të bindur se ju do t'i kryeni me nder detyrat tuaja.

Edhe një herë, ju lutem, shokë, t'u transmetoni të gjithë shokëve tuaj përsëritjet më të zjarra dhe të përzemërta të Komitetit Qendror të Partisë, të qeverisë dhe të miat personale!

Rroftë ushtria jonë heroike!

Rroftë Partia jonë e lavdishme e Punës!

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 116 (2703), 14 maj 1957*

*Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i Popullit», Nr. 116 (2703), 14 maj 1957*

## NGA FJALA NË TAKIMIN ME PUNËTORËT E KOMBINATIT TË TEKSTILEVE «STALIN»

11 maj 1957

Të dashur shokë dhe shoqe punëto-re,

Është me të vërtetë një gëzim dhe një kënaqësi e madhe për mua të jem në mes jush, punëtorëve pararojë të njërës nga veprat e reja dhe të mëdha të industrisë sonë të re që po i sjell shërbime të mëdha popullit shqiptar.

Tani është bërë zakon për të gjithë popullin, si për tiranasit ashtu edhe për të gjithë qytetarët e tjerë të Shqipërisë, që, kur vijnë në Tiranë, nuk mungojnë të kalojnë nga qyteti i ri, nga Kombinati i Tekstileve «Stalin». Ata vijnë për të parë këtë vepër të madhe të pushtetit tonë popullor, të shohin klasën tonë të re heroike punëto-re që punon pa u lodhur për të mirën e të gjithë popullit, vijnë për të parë djemtë dhe vajzat e tyre, që kanë ardhur këtu që në fillim, nga të katër anët e Shqipërisë, që kur u hodhën themelet e kësaj vepre të madhe, e pastaj kanë qëndruar dhe kanë mësuar të vënë në lëvizje këto maqineri nga më modernet. Shumë nga ju kanë ardhur këtu të rinj, kanë krijuar

këtu familjet e tani kanë edhe kalamanë dhe rrojnë të gëzuar. Populli ynë kur vjen në Tiranë nga krahinat më të largëta të vendit e viziton këtë vepër dhe gëzohet për gjithshka që ka krijuar Partia e Punës për të mirën e të gjithë popullit.

Përpara 7 ose 8 vjetësh, shumë prej jush e mbajnë mend mirë se ç'ka qenë ky vend. Këtu kanë qenë kënetat e disa ara që me mundime të mëdha i punonin fshatarët e kësaj zone. Tani këtu është ngritur një qytet i ri, një qytet i bukur, ku rreh një zemër e çelniqtë, kombinati juaj i tekstileve, ku punojnë, studjojnë dhe përparojnë çdo ditë punëtorët dhe punëtorët e kësaj veprë, pjesë heroike e klasës sonë punëtore. Pa llogaritur vitet e para të çlirimit, kur i gjithë populli u hodh me vrull për rindërtimin e vendit nga shkatërrimet e mëdha të luftës, brenda një kohë të shkurtër në vendin tonë u ndërtua jo vetëm kombinati i tekstileve, por edhe një numër i madh fabrikash e veprash të tjera të mëdha, u ngrit kultura e re e popullit, u zhduk analfabetizmi deri në moshën 40-vjeçare. Ju vetë po e shihni se si është mbushur vendi ynë me shkollë, si u mësuan djemtë e vajzat e popullit fukara dhe si u edukuan nga Partia me një patriotizëm të shkëlqyer. Armiqtë e popullit nuk besonin për ato që thoshte Partia në fillim, ata u munduan si në luftë ashtu edhe më vonë të vjellin vrer kundër Partisë, por kanë dështuar kurdoherë, sepse kush vepron sot kundër popullit është i destinuar të shkatërrohet. Në Shqipëri, si kudo, kanë ardhur në fuqi satrapë si Ahmet Zogolli me shokë, po të gjithë janë futur në dhé dhe popullit ka mbetur i pavdekshëm, ai ka qëndruar i fortë si çeliku dhe më në fund triumfoi përgjithmonë mbi

armiqtë e tij shekullorë e u bë zot i fateve të veta. Sot djemtë dhe vajzat e popullit kanë marrë në dorë fatet e popullit dhe e çojnë këtë drejt lumturisë, drejt socializmit. E gjithë kjo punë e madhe dhe e pashembullt në historinë e popullit tonë, shokë, i detyrohet Partisë sonë të lavdishme.

Ju po e shihni sa është zhvilluar bujqësia te ne. Përpara bujku ishte rob i tokës, i beut dhe i agait. Atëhere fshatarit i vdisnin fëmijët nga sëmundjet si zogjtë e pulës, ata mbeteshin analfabetë dhe të zhveshur. Por sot në vendin tonë po përparon bujqësia, fshatari është i kënaqur, i lumtur dhe i gëzuar, ai tani punon jo më për të tjerët por për veten e tij dhe për të mirën e të gjithë popullit.

Këto vepra të mëdha i krijoi populli në një kohë të shkurtër, po e ardhshmja e tij është akoma më e shkëlqyer.

Për 10-15 vjet, duke bërë krahasim me të tashmen, ne do të themi: «sa prapa kemi qenë!», ashtu sikurse themi tani për të kaluarën tonë këtu e 10-12 vjet përpara. Sa mburreshim para disa vjetësh me këtë kombinat kur ishte duke u ndërtuar. Ne thoshim se ai do të prodhojë 20 milion metra tekstile në vit. Dhe ai tash i prodhon. Por po të shohim të ardhshmen, kombinatet tjera tekstili do të ngrihen dhe të mos ju vijë keq, ato do të jenë më të bukura dhe me kapacitet shumë më të madh se ky (të qeshura të gëzuara). Po megjithkëtë mos u dëshpëroni, se ky kombinat është dhe do të mbetet pionieri i atyre që do të ngrihen, do të jetë, si me thënë, babai i tyre (të qeshura dhe gëzim në sallë). Në këtë kombinat u rritën kuadrot e parë të tekstilit; ky do të

bëhet shkollë për kombinatet e tjera që do të ngrihen në të ardhshmen.

Sa e drejtë ka qenë dhe është vija e Partisë. Në fillim, kur Partia i bëri thirrje popullit për luftë, ai u ngrit i tëri, rroku armët dhe i kuptoi drejt fjalët e Partisë se kishte ardhur momenti i çlirimit përfundimtar për të. Partia që në fillim e mësoi popullin tonë që ta dojë Bashkimin Sovjetik, i cili po luftonte për shkatërrimin e fashizmit. Por tradhëtarët dhe armiqtë e popullit tonë, Partinë Komuniste e quanin parti tradhëtare dhe komunistët të shitur. Mirëpo populli nuk u shkoi pas atyre. Ai i deshë komunistët me gjithë shpirt se i pa që ata, bijtë e tij, ishin njerëzit më të mirë, më të guximshmit, ishin ata që, duke sakrifikuar çdo gjë, hidheshin në zjarrin e luftës për çlirimin e tij, prandaj u lidh me ta si mishi me thoin.

Pas luftës, Bashkimi Sovjetik na ndihmoi për të shëruar plagët e luftës dhe për të ndërtuar jetën e re të lumtur. Duke filluar që prej ditëve të para pas çlirimit e deri tani ndihma materiale dhe morale e Bashkimit Sovjetik ka qenë e paçmueshme.

Sigurisht, shokë, ne kemi bërë përparime të mëdha, jeta e popullit tonë është përmirësuar, po megjithatë ne kemi akoma vështirësi, pengesa dhe nevoja, prandaj në asnjë mënyrë nuk mund të kënaqemi me këto që kemi bërë. Ekonomia jonë ka ecur shumë përpara kur e krahasojmë me të kaluarën, tani te ne janë krijuar mundësi për përparimin e mëtejshëm të ekonomisë dhe të kulturës sonë, po kjo ecje varet si ta kuptosh. Mund të ecësh si deri tani, po në ndërtimin e socializmit mund të ecësh edhe me ritme akoma më

të shpejta, d.m.th. të krijosh një situatë të tillë ekonomike që populli të shohë më mirë dhe më shpejt të mirat e regjimit tonë socialist. Sa më shpejt t'i shohë populli këto mundësi dhe në një shkallë më të madhe, aq më shumë ai do të lidhet me Partinë, aq më shumë do të jetë i vendosur deri në fund për komunizmin. Vetëm fjalët dhe parullat nuk të ngopin, populli do të shikojë që të krijohet bollëku, d.m.th. të ketë stofra, bukë, zarzavate, mish, qumësht dhe banesa më shumë dhe më të mira etj. Ja, kjo rrugë që na tregoi Partia, është e mirë, thotë populli, prandaj ta ndjekim se ajo është shpëtimi për ne.

Prandaj Partia jonë nuk kënaqet me sukseset e arritura. Komunizmi që po ndërtohet, i udhëhequr nga doktrina e pavdekshme e Marksit dhe e Leninit, është jeta e lulëzuar për popullin, është e reja. Një komunist i shquar francez ka thënë se komunizmi është rinia e botës. Prandaj edhe Partia jonë si parti marksiste shikon përpara, me besim dhe nuk kënaqet me ato që janë arritur.

Janë në mbarim e sipër studimet për zhvillimin perspektiv të ekonomisë së vendit tonë. Kjo është një punë e madhe tekniko-shkencore.

Po ç'përfaqësojnë në vija të përgjithshme këto studime?

Ato parashikojnë në radhë të parë zhvillimin me një hov të madh të bujqësisë në vendin tonë. Brenda këtij pesëvjeçari kënetat e vendit tonë që kanë mbetur do të thahen dhe do të kthehen në toka prodhuese. Realizimi i kësaj detyre do të shtojë sipërfaqen e tokave të punueshme tej shifrave që janë parashikuar në pla-

nin e dytë pesëvjeçar. Ne do të shtojmë akoma më shumë sipërfaqen e tokave të ujtitshme, që të mos mbetemi më në mëshirën e qiellit, do të sistemojmë më mirë fushat dhe do të rritim rendimentin e kulturave bujqësore, në mënyrë që në të ardhshmen e afërt të mos marrim nga 5 dhe 6 kv. pambuk për hektar, po 20 dhe 22 kv. për hektar, ose misër e grurë të arrijmë të marrim nga 20 kv. për hektar, panxhar sheqeri nga 250 deri në 300 kv. për hektar. etj. Këto rezultate do të na japin mundësinë që ne ta prodhojmë bukën në vend dhe të zhduket kështu një herë e përgjithmonë te populli ynë frika e bukës. Kjo sigurisht ka arësyet e veta. Populli shqiptar, për shekuj me radhë ka luftuar për të siguruar kafshatën e gojës, ai punonte tërë vitin dhe kur i bëhej bereqeti, shumicën ia rrëmbente, me njëqindmijë dredhi, kapitalisti ose çifligari. Po sot është ndryshe. Kjo situatë tani ka ndryshuar. Qarku i Korçës, për shembull, ekonomikisht është më i ngritur nga krahinat e tjera të vendit. Fshatarët atje e punojnë më mirë tokën, ata kanë një bujqësi më të përparuar. Tani atje shihet se fshatarët kanë filluar t'u futen kulturave ndihmëse që japin rendimente të larta dhe sjellin fitime më të mëdha. Mirëpo në zonat e tjera kjo çështje është lënë mënjanë. Në Korçë tani fshatarët nuk mbjellin më një e dy rrënjë mollë ose hardhi në kopshtet e tyre personale, po me dhjetëra dhe qindra mijëra rrënjë mollë dhe hardhi në tokat e kolektivizuara, sepse shohin që ato kanë interes të madh për ta dhe për ekonominë popullore. Kjo ndodh gjithashtu se problemin e bukës në Korçë nuk e kanë si në rrethet e tjera, sepse edhe në këtë drejtim ata janë më të përparuar dhe marrin më shumë drithë për

hektar. Një fenomen i tillë si në Korçë me siguri do të duket edhe në viset e tjera të atdheut tonë. Ky fenomen ka filluar dhe do të ecë më shpejt në planet e ardhshme pesëvjeçare.

Vendi ynë është zbukuruar dhe do të zbukurohet edhe më shumë. Kjo gjë do të bëhet me siguri, po me punë. Këtu mund të ndodhet ndonjë plak që ka dëgjuar fjalë të tilla edhe nga goja e Mehdi Bej Frashërit. Po ne, komunistët, nuk jemi si Mehdi Beu me shokë, që kishte vetëm fjalë dhe njëqind flamurë në xhep e kur erdhi koha që atdheut iu kërcënua pavarësia dhe liria i ktheu jo vetëm krahët popullit, por i ktheu edhe pushkën, e gjakosi dhe më në fund, si tradhëtar që ishte, iku bashkë me anglezët. Komunistët në krye të popullit, të gjithë së bashku, punojnë dhe do të punojnë pa u lodhur që Shqipëria të lulëzojë, që kodrat e buta kudo në vendin tonë të mbushen me pemë frutore, sidomos me agrume dhe rrush, ullinj etj., që populli ynë të ketë me bollëk dhe të eksportojë për të nxjerrë fitime të mëdha.

Pra, masat që do të merren për të mekanizuar gjithë këto punime, duke filluar që këtë pesëvjeçar, do të bëhen të mundshme me punën e vazhdueshme, të palodhur të popullit tonë dhe me ndihmën që do të na japin Bashkimi Sovjetik dhe të gjitha vendet e tjera socialiste.

Zhvillimi i bujqësisë, dhe si pasojë edhe prodhimi i lëndëve të para industriale me shumicë, do të sjellë me vete edhe zhvillimin e mëtejshëm e më të madh të industrisë sonë të lehtë. Derisa prodhimi i pambukut do të shtohet shumë më tepër se tani kjo do të bëjë të



mundshme, siç e thashë edhe në fillim, që në të ardhshmen e afërt të ngrihen në vendin tonë kombinate të reja tekstili. Pas disa vjetësh prodhimi i sheqerit që nxjerr Fabrika «8 Nëntori» në Korçë nuk do të mjaftojë, kështu që do të na duhet të marrim masa për të ngritur një tjetër fabrikë sheqeri. Pra në të ardhshmen do të bëhen shumë punime me vlerë për ta çuar përpara ekonominë popullore në drejtim të zhvillimit të bujqësisë, të industrisë, të veshmbathjes dhe të asaj ushqimore.

Por, një pasuri e madhe për vendin tonë janë e do të jenë minierat. Në bazë të studimeve është vërtetuar se vendi ynë ka shumë naftë. Kjo është një kënaqësi e madhe për popullin. Unë mund t'ju them se perspektiva e nxjerrjes së naftës është e madhe. Natyrisht nafta është brenda në tokë dhe ajo duhet nxjerrë. Prandaj janë dashur dhe duhen shpenzime, po kur del nga toka atëhere «kullon muslluku se erdhi ujët e Sopotit» thonë gjirokastritët. Kjo është një gjë e bukur. Pra edhe industria e naftës ka perspektivë të madhe përpara.

Rëndësi të madhe për ekonominë tonë ka nxjerrja e kromit. Nëntoka jonë ka rezerva shumë të mëdha industriale nga ky mineral. Natyrisht në të ardhshmen do të marrim masa që kromin ta pasurojmë në fabrika, në mënyrë që të mos e transportojmë ashtu si tani bashkë me gurë dhe lëndë të tjera të panevojshme. Për këtë qëllim do të ngremë fabrika pasurimi që do t'i sjellin ekonomisë popullore të ardhura të mëdha.

Përsa i përket bakrit, për një moment situata në këtë mineral ishte e vështirë, bile e errët, pasi na thuhej se kishin mbaruar rezervat. Po për fat të mirë këto

rezerva jo vetëm nuk kanë mbaruar, po duket se kemi shtresa të mëdha nga ky mineral i vlefshëm. Këtë e tregojnë rezultatet e para dhe të vërtetuara. Pra ne kemi bakër, po minerali i bakrit ka edhe flori e metale të tjera. Deri tani industria e përpunimit të bakrit e Rubikut ka qenë e vogël ndërsa tani atje do të ngrihet një industri më e fuqishme, ku neve do të na duhet ta përpunojmë mirë bakrin.

Për zhvillimin e bujqësisë dhe për rritjen e rendimenteve të saj një rëndësi të madhe ka sigurimi i plehrave kimike. Rendimentet e larta që parashikojmë të arrijmë në prodhimet bujqësore në të vërtetë varen nga të gjitha masat që do të merren, por në një shkallë të konsiderueshme ato varen edhe nga shfrytëzimi në mënyrë sa më racional i plehrave organike dhe sidomos nga përdorimi i plehrave kimike. Për këtë qëllim janë bërë kërkime për lëndë të parë për industrinë e plehrave kimike dhe rezulton se në vendin tonë kemi fosforite. Mirëpo kërkimet e deritanishme kanë vërtetuar se shtresat e para të mineralit nuk janë edhe kaq të pasura. Mundet që, duke shpuar më në thellësi, shtresat e brendshme të jenë më të pasura. Natyrisht kjo kërkon akoma dhe ca kohë për t'u studjuar. Por, sidoqoftë, edhe në këtë drejtim do të merren masa që me fosforitet që ekzistojnë, duke i përzier me disa lëndë të tjera që do t'i sjellim nga jashtë, do të mund të fabrikojmë në vendin tonë një pjesë të plehrave kimike, kurse pjesën tjetër që do të na nevojitet do ta importojmë. Kështu do të mund të arrijmë rendimente më të larta në kulturat bujqësore.

Në këtë mënyrë do të veprohet edhe për prodhimin

e mineraleve të tjera që janë zbuluar ose që do të zbulohen në të ardhshmen në vendin tonë.

Pra, në këto drejtime janë bërë studime paraprake. Tani mbetet nga ana e Komisionit të Planit të Shtetit të bëhen studime me hollësi për të bërë përcaktimet.

Shokë e shoqe,

Ju nuk jeni nga ata që rrinë në hije të fikut dhe presin t'u hyjë fiku në gojë, sepse jeni vetë punëtorë, armiq të përtacisë dhe e kuptoni se populli shqiptar për të realizuar gjithë këto detyra kaq të mëdha e fisnike që i vihen përpara për të mirën e tij, duhet të derdhë djersë, mundim dhe dituri, ndryshe pa punë këto vepra nuk realizohen, ashtu sikurse nuk janë realizuar pa punë, pa përpjekje dhe vështirësi ato që janë ngritur deri tani. Ne kemi hasur në shumë vështirësi për realizimin e të gjitha këtyre veprave që janë ndërtuar në Shqipëri. Edhe në të ardhshmen sigurisht në punë do të hasim vështirësi të reja, po ne këtyre nuk u trembemi. Ne nuk u jemi trembur vështirësive në kohën e luftës kur vihej në balancë koka e secilit e jo më tani që çdo gjë është në duart e popullit dhe bëhet vetëm për të zbukuruar jetën e tij. Partia jonë është një Parti e tillë që njerëzit i edukon të jenë të vendosur për të kapërcyer vështirësitë që u dalin përpara. Po për t'i kapërcyer vështirësitë duhet bërë një punë sa më e organizuar dhe më e studjuar nga ana e Partisë dhe njerëzit që do t'i kryejnë të gjitha këto punë kaq të mëdha duhet të jenë sa më shumë të mësuar.

Nuk është kot fjala që thotë Partia se socializmi nuk ndërtohet pa dituri, sidomos në këto momente kur shkenca ecën përpara me hapa viganë, d.m.th. kur krijohen mjete të tilla që zëvendësojnë forca të mëdha krahu. Mirëpo këto mjete nuk janë aq të thjeshta, ato lypin një punë të madhe dhe dituri, për t'i vënë në përdorim. Pra nga secili prej nesh kërkohet që të mësojë. Kjo na ngarkon të gjithëve detyrën që me etje, pasion dhe durim të mësojmë, të mësojmë dhe të mësojmë. Ju keni eksperiencën tuaj. Sa më mirë të keni mësuar, sa më të vëmendshëm të jeni në mësim dhe në punë aq më shumë rezultate do të jepni. Ata që mbeten në bisht, me vështirësi e kalojnë jetën dhe puna nga dora e tyre nuk del e mirë.

Ne duam të pregatisim të tillë kuadro në vendin tonë që me këto mundësi dhe mjete të mëdha që na jepen të kryejmë sa më shumë punë. Këtë mundësi ne e kemi, se kemi njerëz të mirë, se populli ynë i porsadalë nga prapambetja ka një etje të jashtzakonshme për të mësuar. Edhe shokët specialistë të huaj që punojnë në vendin tonë na thonë se punëtorët tanë kanë vullnet të madh për të mësuar dhe kapin shpejt çdo gjë. Partia jonë, që në vitet e para pas çlirimit e deri tani, ka ngritur gjithfarë shkollash siç janë gjimnazet, teknikumet, institutet e larta si edhe universitetin që do të ngrihet këtë vit. Por, përveç këtyre, në vendin tonë edhe çdo fabrikë e kombinat ka shkollën e vet. Prandaj punëtorët duhet të vënë të gjitha forcat që të mësojnë. Sigurisht kjo punë ka vështirësi, po mendoni sa ndryshim ka tani me kohën kur mësonim ne. Përpara, nuk ekzistonte Partia dhe njerëzit që donin të mësonin kishin

shumë vështirësi. Në ato kohë bijtë dhe bijat e popullit nuk i kishin mundësitë materiale për të ndjekur shkollat dhe veç asaj edhe ndonjërit që i qëllonte të ndiqte shkollën mendonte shumë ngushtë, vetëm të sigurate jetesën e tij. Por sot njerëzit ndryshojnë në pikëpamjet e tyre, shumica nuk janë të mbyllur në vetëvete dhe nuk mendojnë vetëm për familjen e tyre. Çdonjëri nga ne e di se ç'ndodhte në të kaluarën. Të edukuar nga Partia tani ne e dimë se e mira për familjen e secilit varet nga e mira e përgjithshme. Vetëm kjo ide e lartë duhet t'i nxitë njerëzit të kapërcejnë më lehtë vështirësitë dhe të bëhen më të vlefshëm për popullin dhe për veten e tyre. Të gjitha këto vepra dhe kombinata të ngritura në vendin tonë nuk u bënë vetëm me punën e një ose të dy njerëzve, por nga forca e bashkuar e gjithë popullit që bën të çahen malet dhe të lulëzojë Shqipëria.

Po sikur populli ynë të mos kishte fatin të merrte frenat e drejtimit në duart e tija sa do të vuanim ne nga bejlerët, nga Ahmet Zogollët me shokë, nga spekulatorët dhe fajdexhinjtë etj. Sa njerëz do të ishin pa punë dhe do të vuanin për kafshatën e gojës, sa dhjetëra mijëra fëmijë e të rinj do të endeshin poshtë e lart pa bukë e pa shkollë. Po sa të gëzuar janë tani fëmijët dhe me ç'perspektivë rriten ata. Asnjë perspektivë nuk kishte njeriu në të kaluarën, kur mbretëronte frika e papunësisë, analfabetizmi dhe kërbaci i kapitalistit, i çifligarit dhe i xhandarit. Po ne sot jemi të sigurtë dhe e nesërmja i qesh popullit. Ne e dimë që vitin e ardhshëm do të jemi më mirë se tani dhe çdo vit vendi ynë do të ecë dhe do të ecë gjithnjë përpara.

Kjo është e mundshme se Partia e ka lidhur popullin me miq të tillë besnikë që armiqtë nuk do të guxojnë më ta prekin lirinë dhe pavarësinë e Shqipërisë. Me miq të tillë të fortë, të mëdhenj dhe të singertë siç janë Bashkimi Sovjetik, Kina e madhe dhe vendet e tjera socialiste, populli ynë ecën përpara, punon me entuziazëm dhe çdo vit ngjitet një këmbë më lart në shkallët që do ta çojnë në socializëm dhe më vonë në komunizëm.

Tani shokë, detyra e secilit nga ne është t'i përvishemi punës për të arritur suksese të reja, sepse ne vetëm me punë do të mund ta transformojmë në të mira materiale ndihmën që na jepet nga vendet socialiste.

Në gjendjen e sotme ndërkombëtare ne duhet të jemi kurdoherë vigjilentë, të gjithë, punëtorët, fshatarët, kufitarët, studentët, i gjithë populli, sepse armiku nuk fle, prandaj të punojmë që të jemi në gjendje të mbrojmë popullin nga çdo kërcënim, të mbrojmë fitoret e tija, pavarësinë, lirinë, kufitë tanë, socializmin dhe të vazhdojmë të ndërtojmë, të ndërtojmë dhe të ndërtojmë për lumturinë e popullit tonë.

Ne duhet të dimë, dhe këtë e dimë mirë nga eksperiencia, se sa më i fortë të jesh, aq më tepër frikë të ka armiku dhe përpara se të fillojë të të sulmojë i vë gishtin kokës, mendohet shumë, por në rast se je i dobët ai të shpartallon. Por që të jesh i fortë, në radhë të parë, duhet të kesh Partinë të fortë. Prandaj na vihet detyrë që Partinë ta kalitim çdo ditë më shumë. Partia gjatë gjithë jetës së saj është kalitur vazhdimisht, ajo është bërë e çelniktë, sepse ka lidhje të forta me popullin i cili e sheh që Partia është zemra e tij, që ajo nuk ka qëllime të tjera përveç asaj që ta bëjë popullin të lum-

tur dhe ta mbrojë nga çdo e keqe. Pra, kur të kemi Partinë të fortë, të kalitur, kapërcehet lehtë çdo rrezik dhe vështirësi. Kjo kërkon që komunistët të jenë kudo në ballë të luftës për kapërcimin e vështirësive të punës dhe të sakrificave, sepse vetëm kështu populli do të ecë në shembullin e tyre.

Duke qenë e tillë, Partia jonë i ka mbetur dhe do t'i mbetet kurdoherë besnike parimeve marksiste-leniniste. Duke qenë në luftë të pandërprerë me oportunistët, revizionistët, deviatorët, trockistët, ajo ka dalë kurdoherë më e fortë dhe ka arritur të gjitha këto suksese që numëruam.

Në të gjithë, shokë, jemi në dijeni ç'ndodhi në Hungari vjeshtën e kaluar. Atje kundërrevolucioni për një moment pati disa suksese, por megjithëse i ndihmuar prej vitesh nga imperialistët dhe revizionistët, u shpartallua brenda pak ditësh.

Po pse ndodhën këto gjëra në Hungari? Këto ndodhën se partia atje nuk ishte kalitur si duhet, se atje u lejua të depërtojnë rrymat antimarksiste dhe oportuniste, kështu partia u dobësua, armiqtë përfituan nga këto rrethana dhe e shkatërruan. Po tani gjendja në Hungari shkon mirë, partia është mëkëmbur, klasa punëtore është më e fortë, më e vendosur. Armiku po e merr vesh se punëtorët nuk lejojnë më që me gjakun e djersën e tyre të kthehen përsëri në fuqi çifligarët, borqjezia dhe imperialistët të sundojnë sipas qejfit të tyre dhe të vendosin doktrina të tilla që u ka dalë boja siç është, për shembull, «doktrina Ajzenhauer» që amerikanët po përpiqen ta vendosin në Lindjen e Mesme.

A e dini ç'është «doktrina Ajzenhauer»? Po jua

them me pak fjalë: Unë di një fshatarin tonë që kishte në atë kohë një ekonomi të mirë, me shtëpi dhe me bagëti. Një herë iu sëmur djali dhe u detyrua të merrte hua dy napolona flori te një fajdexhi. Brenda tetë vjetëve nga kamata jashtëzakonisht e madhe e këtij gjakpirësi, këtij fshatari i ikën jo vetëm toka, po edhe shtëpia, qetë, dhentë dhe më në fund i mbeti fajdexhiut edhe 150 napolona flori borxh. E tillë është «doktrina Ajzenhauer». I tillë është edhe Riçardi<sup>1</sup> që dërgoi presidenti Ajzenhauer në vendet e Lindjes së Mesme, me qëllim që t'u hedhë zinxhirin në grykë popujve. Po fajdexhiu ynë përpara miliarderëve amerikanë ishte vetëm një shushunjë shumë e vogël, kurse në një proporcion kolosal janë ata që kërkojnë t'i hedhin popujt e Lindjes së Mesme dhe popujt e tjerë në grackë, t'u grabitin lirinë dhe pasurinë. Sigurisht të gjithë e kuptojnë se imperialistët anglo-francezë në Port-Said dhe në qytetet e tjera të Egjiptit nuk u nisën për t'u larguar kaq shpejt, ata shkuan për të vendosur mirë sundimin e tyre të egër kolonial, për të cilin bënë çdo gjë edhe agresion të hapët, po u detyruan të kthehen menjëherë duke marrë me vete përveç turpit edhe zemërimin e tmerrshëm të popujve të të gjithë botës. Kjo ndodhi se populli egjiptian luftoi heroikisht, se ekzistojnë vendet socialiste dhe dëshira për paqe e të gjithë popujve të botës. Por megjithatë, siç e thashë, duhet të jemi vigjilentë, të punojmë po edhe të jemi në roje për të ruajtur fitoret e popullit.

Ne, siç e ka thënë kurdoherë Partia jonë, duam të

---

<sup>1</sup> Riçard Nikson, në atë kohë nënpresident i SHBA-së.



jetojmë në miqësi me të gjitha shtetet, me fqinjët tanë në radhë të parë.

Shokë dhe shoqe,

Edhe ju këtu, në kombinatin tuaj, keni shumë për të bërë. Ju, shokë dhe shoqe punëtorë, keni bërë shumë deri tani dhe populli këto jua njeh, populli ynë i njeh meritat e punonjësve të dalluar të kombinatit, sepse ju brenda një kohe të shkurtër keni arritur të vishni popullin dhe të bëni që kombinati juaj, kjo qendër e madhe prodhimi, të bëhet njëkohësisht edhe një shkollë e madhe teknike, kulture dhe ideologjike për të gjithë Shqipërinë. Kur ju them se rezultatet tuaja janë të kënaqshme, për këtë sigurisht juve nuk do t'ju rritet mendja. Ju planin tani po e realizoni dhe e tejkaloni, dhe me gjithë disa dobësi që keni brenda për brenda edhe kualiteti i stofrave që nxirrni nga duart tuaja po përmirësohet çdo ditë.

Me këtë rast më lejoni t'ju flas pak edhe për të metat që keni. Po të bëhen akoma më shumë përpjekje nga ana juaj, po të keni kujdes më të madh për perfeksionimin tuaj të mëtejshëm, për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin sa më shumë të maqinerisë, për kursimin e lëndës së parë, ju do të keni me siguri suksese akoma më të mëdha. Këto detyra janë të gjitha të mundshme të realizohen nga ju, sepse këtu jeton dhe punon një kolektiv i shëndoshë, prej mijëra punëtorësh, mekanikësh, mjeshtrish dhe inxhinierësh të zgjuar dhe të vendosur për t'i shërbyer popullit.

Në radhë të parë dëshiroj t'ju them që të bëni përpjekje më të mëdha për të arritur treguesit tekniko-ekonomikë të projektit teknik, sepse filatura te ju ka arritur të japë tani vetëm deri në 91 për qind të asaj që është parashikuar në projekt, ndërsa te zgjahu 90 për qind. Pra këtu ka mundësi që këta tregues të shkojnë më përpara gjë që arrihet vetëm duke bërë përpjekje për t'u kualifikuar. Prandaj një nga detyrat tuaja kryesore është që të tregoni kujdesin më të madh për kualifikimin tuaj, ashtu sikurse duhet të bëjë përpjekje e gjithë klasa jonë punëtore. Ka rezerva të mëdha për arritjen e treguesve të projektit teknik, tani puna është që të arrini qind për qind këta tregues dhe kjo do të thotë një e ardhur e konsiderueshme për ekonominë popullore. Bile faktet tregojnë se maqineritë që keni mundet edhe t'i tejkalojnë këta tregues sepse te ju ka shembuj të tillë, prandaj të vini të gjitha forcat për kualifikim.

Një tjetër detyrë si për gjithë klasën punëtore ashtu edhe për ju është të stabilizoheni definitivisht në ndërmarrjen tuaj të mrekullueshme. Sigurisht në krahasim me të kaluarën tani në kombinat ka shumë më pak lëvizje. Por sidoqoftë, punëtorët dhe punëtoret e kombinatit sidomos punëtoret sa të jetë e mundur të stabilizohen përgjithnjë. Ka sot midis jush që në fillim kanë ardhur vajza të reja. Po jeta ecën përpara, u rritët, dhe shumë nga ju janë njohur këtu me shokët e tyre punëtorë, janë dashuruar, janë martuar e tani janë bërë edhe me fëmijë. Puna është që këtë shembull të tyre ta ndjekin të gjitha vajzat që punojnë këtu, të stabilizoheni përgjithnjë, ta doni kombinatin si shtëpinë tuaj

dhe të bëni që jeta këtu të lulëzojë. Qëndroni pra, vendosuni këtu me familjen e madhe ku ju u rritët bashkë me fabrikat, u edukuat dhe u bëtë punëtorë, teknike, mjeshtrë, se kështu do të perfeksionoheni çdo ditë më shumë në punë dhe rendimenti i prodhimit në sasi dhe në cilësi do të rritet vazhdimisht. Partia ju bën thirrje juve, punëtorëve dhe punëtorëve të vjetër të kombinatit, që të stabilizoheni përgjithnjë dhe të mos largoheni nga kombinati. Në qoftë se e sjell rasti që ndonjëra të mar-tohet me ndonjë njeri jashtë kombinatit, tërhiqeni ju këtu dhe mos shkoni ju pas tyre. Mund të ketë midis jush vajza që t'u pëlqejë një djalë që punon në dikaster ose nëpër vende të tjera, kjo është puna e tyre, po çështja është që të mos të shkoni ju pas tyre, i sillni këtu, se tani ka ardhur koha që edhe gratë të tërheqin burrat dhe nuk është më si dikur që vetëm burrat i tërhiqnin gratë kudo që shkonin me punë (të qeshura në sallë). Tani kombinati ka nevojë për zotësinë tuaj se ju jeni punëtorët më me eksperiencë, ju do të jeni mjeshtrit e brezave të ardhshëm të tekstilit.

Një çështje tjetër që duhet të keni parasysh shokë, dhe shoqe punëtorë të kombinatit, është rritja e shpejtësisë së maqinave. Natyrisht, kjo kërkon që edhe materialet të jenë të mira, edhe pambuku të jetë i mirë. Unë di se maqinat e tjerrjes në filaturë mund të arrijnë deri në 10 000 xhiro boshti në minutë, kurse ju keni arritur 8 000 deri 9 000 xhiro në minutë. Prandaj duhet të bëni përpjekje që të arrihen treguesit edhe në këtë drejtim. Po të bëni përpjekje të mëdha që të arrihen plotësisht këta tregues kjo do të bëjë të mundshme që t'i jepni më shumë basmë popullit, sepse me gjithë për-

mirësimet që kemi, populli ynë merr akoma pak metra stof. Prandaj të shtojmë shpejtësinë në mënyrë që të arrihen 10 000 xhiro boshti në minutë, bile po të mundni edhe ta tejkaloni këtë kufi dhe populli do t'ju lavdërojë.

Pastaj një problem me rëndësi kudo në vendin tonë është mirëmbajtja e maqinerisë nga ana e klasës sonë punëtore. Maqina për punëtorin është si pushka për ushtarin. Ushtari me pushkë në dorë ruan lirinë dhe pavarësinë e atdheut. Kështu edhe ju duhet t'i mbani mirë maqineritë, sepse populli pret prej jush basma dhe stofra sa më të mira, sa më shumë dhe sa më të lira. Ju keni një plan të ndalesave të maqinave. Tani kjo normë e planifikuar është 6 për qind, kurse ju në shumë sektorë aktualisht e keni 10 përqindjen e ndalesave. Kjo përqindje është e madhe në krahasim me planifikimin dhe me ndalesat e maqinave, duhet të bëni përpjekje për t'i ulur ato në minimum. Pra e shihni sa rezerva të mëdha fshihen këtu te ju. Prandaj të kenë kujdesin më të madh në këtë drejtim si punëtorët e shfrytëzimit, ashtu edhe ata që bëjnë remontin, të tregoni kujdesin më të madh për t'i mbajtur dhe për t'i nxjerrë maqinat sa më mirë dhe gjithnjë të merrni notën shkëlqyeshëm.

Edhe çështja e kursimeve të lëndës së parë ka rëndësi të madhe për ekonominë e vendit tonë. Ju deri tani keni përdorur afër 84 për qind të pambukut, d.m.th. se 16 për qind e tij del firo. Mirëpo punëtorët duhet të luftojnë që firo të ketë sa më pak. Sa për ju, çështja nuk është vetëm që pambuku të jetë i mirë, kjo është një arësye, por nga një interesim i imtë i çështjeve ju mundet dhe duhet të keni më pak firo, sepse në vitin 1956 p.sh., sipas raporteve që kemi marrë, del se ju keni bërë

përpyekje në këtë drejtim. Ky është një fitim i madh mbi planifikimin që i keni sjellë arkës së shtetit. Po ju këtu keni akoma shumë rezerva dhe mundësi për t'i sjellë edhe më shumë kursime shtetit. Nga një llogari konkrete që bëjmë del se nga një gram fill sikur të kurseni për çdo metër që prodhoni do të fitoheshin rreth 150 mijë metra tekstil mbi planin e lëndës së parë. Gjithashtu, siç e dini, filatura e ka sot rrezën e shfrytëzimit të pambukut 84. Sikur ta ngrinit këtë rreze dhe ta bëni 85, d.m.th. një gram më shumë atëhere do të fitohen 40 ton pambuk që kanë një vleftë rreth 7 milion lekë në vit; vetëm nga ky gram i vogël, pra, kursehet aq sa do të duheshin për të ndërtuar 40 apartamente ku do të hynin 40 familje nga tuajat që akoma janë pa u strehuar. Prandaj kujdesi juaj më i madh në drejtim të kursimit të lëndës së parë i sjell fitime kolosale ekonomisë popullore. Mendoni çfarë fitimesh të mëdha do të ketë ekonomia jonë popullore po të bëjnë përpjekje të tilla të gjithë punëtorët e vendit tonë. Prandaj mos i lini asnjëherë pasdore këto detyra kaq të rëndësishme se populli thotë: «pika-pika bëhet lumi dhe nga lumenjtë mbushen detrat». Në rast se të gjithë punëtorët e vendit tonë do t'i shohin këto gjëra realisht, me ekonomi, ne do të ecim përpara drejt përmirësimit më të shpejtë të ekonomisë popullore, pra drejt rritjes së mirëqenies materiale dhe kulturele të punonjësve. Prandaj i vini kujdes kursimit të lëndës së parë se ky është një problem themelor.

Po ju duhet të tregoni kujdes edhe për kursimin e materialeve të tjera siç janë pjesët e këmbimit, bojrat, kimikatet etj. që kanë një rëndësi të madhe. Sa më pak

t'i thyeni veglat e këmbimit, d.m.th. që t'u zgjatni jetën për të punuar për një kohë sa më të gjatë, sa më shumë të kurseni bojrat dhe kimikatet, aq më shumë fitime do të ketë ekonomia popullore nga kombinati.

Në drejtim të përmirësimit të kualitetit dhe të shtimit të asortimenteve të ju ka suksese, po duhet të bëni përpjekje për të arritur suksese akoma më të mëdha në mënyrë që kualiteti i prodhimeve që dalin nga dora juaj të jetë më i mirë. Kur filluan të dalin prodhimet e para të kombinatit, këtu e 5-6 vjet përpara, disa thoshin këto nuk qenkan gjë. Po Partia u tha atyre: ngadalë, mos u nxitoni se një vit dhe dy kanë që punojnë këta punëtorë të rinj, mos kërkoni menjëherë një punë të perfeksionuar se ata nuk e kanë akoma eksperiencën e nevojshme. Dhe tani populli sheh se stofrat janë më të mira, më të bukura. Megjithatë ju nuk duhet të kënaqeni me këto që keni arritur se edhe në këtë drejtim ju keni rezerva të shumta, prandaj bëni përpjekje që të përmirësoni në të gjithë zërat kualitetin dhe të shtoni asortimentet e prodhimit.

Kisha disa fjalë edhe për tekstil-leshin. Ju e dini politikën e Partisë në lidhje me përmirësimin e racës së deleve. Ne tani kemi një prodhim jo aq të madh të leshit rudë dhe të llojeve të tjera të leshit më të hollë. Po Partia po merr masa që në të ardhshmen të keni më shumë nga këto lloje leshi me cilësi më të mirë. Përmirësimi i cilësisë së leshit ka perspektiva të mëdha në vendin tonë, prandaj edhe ju që tani duhet të perfeksionoheni që të punoni me fill leshi sa më të hollë. Bile unë mendoj se ju keni mundësi që tani që fillin e leshit ta punoni me numra edhe më të hollë. Natyrisht ju nuk

keni akoma maqina të reja të krehjes së lartë, po sidoqoftë bëni përpjekje që duke filluar nga numri 12 të arrini në numrat 18 dhe 20. Pra derisa të kemi filaturë leshi me krehje të lartë përpiqueni edhe në këtë drejtim dhe atëhere kur të na vijnë maqineritë do të arrijmë të prodhojmë edhe në Shqipëri stofra shumë të holla për të kënaqur edhe më mirë guston e popullit tonë. Në planin e ardhshëm pesëvjeçar, në kombinatin tuaj do të sjellim filaturë leshi me krehje të lartë që të punojnë deri në numrat 50, 60, bile edhe më shumë.

Rëndësinë e kadifesë dhe kërkesat e popullit për këtë lloj stofi ju i dini mirë. Drejtorja, organizata e Partisë dhe ju, shokë dhe shoqe punëtorë, duhet të vini të gjitha përpjekjet që në këtë fazë të ndërtoni, të montoni maqineritë e fabrikës së kadifesë dhe njëkohësisht të përpiqeni edhe për përgatitjen e kuadrove që do të drejtojnë këtë fabrikë të re, sepse, siç e dini, kuadrot zgjidhin çdo gjë. Prandaj nga ana e shokëve drejtues të kombinatit sidomos nga ana e teknikëve duhet të bëhen përpjekje që kuadrot e rinj që po përgatiten për fabrikën e kadifesë të dalin të perfeksionuar. Këto rezultate mund të arrihen kur të ketë organizim të mirë dhe disiplinë në punë.

E gjithë puna juaj ka të bëjë me pambukun, prandaj gjithë kolektivit të kombinatit i bie detyra të forcojë lidhjet me fshatarësinë që prodhon pambuk. Kjo nuk është një detyrë vetëm e drejtorit ose e teknikëve të kombinatit, por kjo është një detyrë edhe për të gjithë punëtorët dhe punëtorët. Shumica juaj jeni bij dhe bija fshatarësh. Në fshat në mos keni prindërit, se disa mund t'i kenë marrë me vete, keni të afër-

mit tuaj. Prandaj ju duhet të interesoheni bashkërisht për çështjen e pambukut dhe në mënyrë individuale, të keni vazhdimisht kontakte me fshatarët që prodhojnë pambuk qoftë direkt kur shkoni atje për pushime ose edhe me letra. Ju e dini mirë rëndësinë që ka cilësia e pambukut për prodhimin e stofrave. Prandaj t'i ndihmoni prodhuesit në këtë drejtim që të prodhojnë pambuk të cilësisë sa më të lartë. Kombinati bile duhet të ketë nën patronazhin e vet disa kooperativa bujqësore që prodhojnë pambuk. Kooperativës më të mirë që prodhon sasi të mëdha pambuku të cilësisë së lartë, kombinati mund t'i bëjë edhe disa favorizime p.sh. mund të prodhojë apostafat disa asortimente sipas kërkesës dhe shijes së kooperativistëve që bëjnë përpjekje për të nxjerrë pambuk shumë të mirë nga ana e cilësisë e njëkohësisht mund të kërkojnë p.sh. shami për vajzat, basma me ngjyra dhe me lule që u pëlqejnë etj. Ua bëni këto se edhe do të kënaqen edhe do të nxiten ata dhe kooperativa të tjera për të përmirësuar cilësinë e pambukut. Kështu do të ndihmoheni reciprokisht. Një punë e tillë, mendojmë ne, duhet bërë se është e nevojshme për gjithë popullin dhe për vetë fshatarësinë.

Kultura e pambukut, siç e dini, është mjaft delikate, e zorshme duke filluar që nga çështja e farës dhe deri në proceset e rritjes, të zhvillimit dhe të vjeljes së bimës. Fshatarësia jonë tani ka filluar ta dojë pambukun, po ajo është akoma larg nga kuptimi dhe zbatimi i drejtë i të gjitha metodave agroteknike të pambukut. Bile, edhe stacioni ynë eksperimental është prapa në këtë çështje, nuk u jep ndihmën e duhur fshatarëve. Prandaj të gjithë ata që janë të lidhur me pambukun,



duke ju përfshirë këtu edhe ju, duhet t'u japin ndihmë fshatarëve në këtë drejtim. Po si kudo edhe këtu te ju ka njerëz që kanë njohuri nga kultura e pambukut, ka njerëz të zgjuar, por edhe të tjerë nga ju kanë mundësi të studjojnë agroteknikën e rritjes së pambukut kështu që po t'ju takojë të shkoni në fshat e të dini t'u flitni fshatarëve se si të punojnë për t'i shërbyer sa më mirë kësaj kulture të vlefshme në mënyrë që ata të binden nga këshilla të tilla, do t'ju falenderojnë dhe do të veprojnë ashtu si do t'u thuhet për të mirën e tyre dhe për të mirën e përgjithshme të popullit.

Në kombinat ju do të korrni suksese edhe në të ardhshmen se këtu ka shumë shokë dhe shoqe në pararojë të prodhimit siç është për shembull Drita Prizreni në tezgjah që punon me 16 maqina. 464 mijë metra tekstile kanë dalë nga duart e saja të arta që nga viti 1954 dhe deri tani, dhe po t'i llogaritim nga 3 metra që duhet për një fustan vajze, del se me duart e saja ajo ka veshur dhe ka gëzuar rreth 154 mijë vajza. Kështu i shikon Partia punët. Vajzat e gratë gëzohen kur veshin fustane të reja dhe njëqind urime u dërgojnë këtyre vajzave dhe djemve, nga duart e të cilëve dalin të gjitha këto gjëra kaq të bukura.

Si Drita duhet të jenë në pararojë edhe shumë të tjerë dhe jo vetëm në kombinatin tuaj, po në radhët e të gjithë klasës punëtore heroike. Si ajo, te ju janë për t'u marrë shembull shoqet që punojnë për llogari të vitit 1958 si Mezaia Meçe, Rukie Karafili e shumë e shumë vajza e gra të tjera punëtore të tekstilit. Po këtu ka edhe burra të dalluar siç është për shembull tekniku i dalluar Pirro Stathi që ka nën kujdesin e vet 31 maqina fane-

llate dhe që e realizon planin 122 për qind. Të lumtë shoku Pirro! Është për t'u përmendur gjithashtu rimontieri Llambi Deçka që kryen me nder punën dhe i dorëzon maqinat me cilësi të lartë. Kështu si këta shokë e shoqe punëtorë ka edhe shumë e shumë të tjerë.

Po shokë, në kolektivin tuaj ka qindra vajza e djem të dalluar që me punën e tyre të palodhur kanë bërë që kombinati të arrijë të gjitha këto suksese. Këtu ka inxhinierë që punojnë mirë dhe me zell, që drejtojnë gjithë këto maqineri dhe i ndihmojnë përditë punëtorët tanë të ecin përpara në përvetësimin e teknikës.

Prandaj, shokë, unë ju përshëndes për këtë punë të madhe që po bëni dhe jam i bindur se do ta realizoni plotësisht, do ta tejkaloni planin e shtetit dhe do ta mbani kurdoherë lart flamurin e Partisë.

Le ta forcojmë Partinë tonë heroike të Punës që e udhëheq popullin tonë kurdoherë në fitore! Ne jemi të sigurtë se punëtorët e kombinatit tuaj do të jenë një nga shtyllat e forcës së madhe të Partisë, sepse ju jeni klasa punëtore që udhëheq fatet e popullit tonë, që udhëheq me siguri popullin tonë në rrugën e socializmit. Mos harroni se detyrat që keni përpara janë të mëdha, se ato kanë të bëjnë me jetën e popullit tonë. Prandaj në punën tuaj mendoni kurdoherë popullin që ju lindi dhe ju rriti. Çdo njeri me ndërgjegje këtë gjë duhet ta ketë kurdoherë në mendje dhe në zemër, në mënyrë që populli të jetë kurdoherë i gëzuar, i lumtur dhe i kënaqur. Çdo mbrëmje njeriu i ndërgjegjshëm të bëjë analizën e punës dhe t'i bëjë pyetjen vetes nëse e ka kryer detyrën, nëse i ka shërbyer me ndërgjegje popullit dhe atdheut, nëse i ka zbatuar me ndërgjegje

dhe përpikëri këshillat e Partisë dhe në rast se i ka lënë mangut, atëhere të bëjë përpjekje që të nesërmen këtë boshllëk ta plotësojë medoemos. Partia ka besim te ju punëtoare dhe punëtorë të kombinatit se do t'i kryeni me nder detyrat që ju janë ngarkuar.

Rroftë klasa jonë heroike punëtoare!

Rroftë Partia e Punës e Shqipërisë, organizatorja e të gjitha fitoreve të popullit tonë!

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 117 (2704), 15 maj 1957*

*Botohet me shkurtime sipas tekstit të gazetës «Zëri i Popullit», Nr. 117 (2704), 15 maj 1957*

## **DUIHET TË FORCOHET MË TEPËR PUNA POLITIKE PËR KOLEKTIVIZIMIN E BUJQËSISË**

*Letër dërguar komiteteve të Partisë në qarqe  
e rrethe*

**15 maj 1957**

**KOMITETEVE TË PARTISË NË QARQE E RRETHE  
DREJTORISË POLITIKE TË USHTRISË POPULLORE  
DEGËS POLITIKE TË REPARTEVE TË KUFIRIT**

Kohët e fundit vihet re se në disa raste nga disa komitete partie mbahen qëndrime të pamatura dhe të nxituara ndaj komunistëve, sidomos lidhur me çështjen e kolektivizimit të bujqësisë. Kështu p.sh. në aktivin e Partisë të rrethit të Fierit, në muajin shkurt 1957 u krijua një atmosferë e rëndë për shokët që nuk ishin futur akoma në kooperativa. U kërkua me insistim që në aktiv të flitnin të gjithë shokët, sidomos sekretarët e organizatave bazë të fshatrave, ku akoma nuk është ngritur kooperativa. Për më tepër, kur sekretari i organizatës bazë të fshatit Drizaj refuzoi të diskutojë, se-

pse «ishte i sëmurë», aktivi e nxori jashtë, duke i marrë dhe taserën e Partisë. Një veprim i tillë, jo vetëm që është në kundërshtim me rregullat organizative, sepse aktivi, si organ konsultativ, s'ka të drejtë të marrë vendime për të përjashtuar komunistët nga Partia, por ai është krejt i padrejtë dhe i pastudjuar. Çështjet e anëtarësisë në Parti janë çështje shumë delikate dhe nuk mund të gjykohen kurrë me gjaknxehësi dhe mendjelehtësi. Komiteti Qendror e anuloi masën ndaj këtij shoku dhe e ktheu atë përsëri në Parti.

Një veprim i ngjashëm me atë të Fierit u bë dhe në konferencën e Partisë të rrethit të Beratit, që u zhvillua gjatë muajit prill 1957. Konferenca u hoqi mandatin, i përjashtoi edhe nga Partia kryetarin e kooperativës bujqësore të Uznovës dhe sekretarin e organizatës bazë në këtë kooperativë. Një veprim i tillë u bë pasi delegatët e organizatës bazë të kooperativës bujqësore të Uznovës, në diskutimin e tyre kritikuan, në shumë raste pa të drejtë, komitetin e Partisë të rrethit. Të gjithë përgjegjësinë për gjendjen e keqe që është krijuar në organizatën bazë dhe në kooperativën bujqësore të Uznovës, ata ia ngarkuan komitetit të Partisë, ndërsa gabimet e tyre shumë të rënda u përpoqën t'i paraqitin gjoja se ishin në të mirën e punës.

Pavarësisht nga gabimet dhe të metat e këtyre dy komunistëve, veprimi për përjashtimin e tyre nga konferenca ishte ca i shpejtuar. S'ka dyshim se konferenca e Partisë, si organi më i lartë i Partisë në rreth, ka të drejtë të marrë një masë të tillë. Por a ishin përpara një rasti të tillë që konferenca duhej ta përdorte këtë të

drejtë të saj? Neve na duket se jo! Vitin që kaloi në Konferencën e Tiranës elementë armiq të Partisë goditën vijën e Partisë, unitetin e saj, Komitetin Qendror të Partisë, shfaqën pikëpamje armiqësore dhe megjithatë nuk u përjashtuan në konferencë. Konferenca i dërmoi pikëpamjet e tyre dhe ua rekomandoi organizatave bazë, ku ata bënë pjesë, që të shqyrtonin hollësisht çështjen e tyre. Kjo bën që të studjohen më imtësisht çështjet e komunistëve dhe njëkohësisht të edukohet më mirë edhe baza nga gabimet e shokëve.

Përsëritim se, si në rastin e parë dhe në rastin e dytë, nuk ka qenë vendi për t'u marrë masa të tilla. Akoma më tepër qëndrime të tilla nuk ndihmojnë aspak në zhvillimin e punimeve të aktiveve dhe të konferencave të Partisë, përkundrazi krijojnë situata jo të mira dhe shpien në masa të nxituara, të pamatura, administrative, të cilat jo vetëm nuk mund të zgjidhin problemet por dëmtojnë punën. Kjo është edhe më serioze, po të kemi parasysh se qëndrime të tilla mbahen pikërisht lidhur me problemin e kolektivizimit të bujqësisë që kërkon një punë të kujdesshme, të palodhur dhe me durim nga ana e organizatave të Partisë. Në fakt, siç është vërtetuar në disa aktive dhe konferenca të Partisë, shokët e fshatrave ku nuk janë ngritur kooperativat bujqësore, ngurrojnë të diskutojnë, të thonë fjalën e tyre, të marrin angazhime etj.

Me këtë rast ju vëmë edhe një herë në dukje se shpeshherë kundrejt komunistëve që tregohen të lëkundur për t'iu përgjegjur vendimeve të Partisë për ngritjen e kooperativave bujqësore, nuk bëhet diferen-

çimi i duhur, nuk shqyrtohet me kujdes e konkretisht çdo rast, por veprohet menjëherë në marrjen e masave të rënda, në përjashtime të shumta e shpeshherë pa vend nga Partia. Në mjaft raste puna për edukimin e komunistëve, për t'i sqaruar e bindur ata me durim, si edhe puna për forcimin e jetës së brendshme, e frymës luftarake të organizatave bazë jo vetëm që është e dobët por zëvendësohet me masa ndëshkimore, administrative. Mjafton të përmendim se Fieri, Vlora dhe ndonjë rreth tjetër gjatë vitit 1956 dhe gjatë 3-mujorit të parë të këtij viti kanë përjashtuar nga Partia më shumë shokë se sa kanë pranuar të rinj në Parti. Dhe në një pjesë të madhe të përjashtuarit janë për çështjen e kolektivizimit të bujqësisë.

Duhet pasur mirë parasysh se lidhur me transformimet e mëdha socialiste që bëhen në fshat, merr forma më të acaruara edhe lufta midis së resë dhe të vjetrës. Një gjë e tillë nuk mund të mos reflektohet në jetën e organizatave bazë të Partisë, në lëkundjet që vërtetohen në disa anëtarë e kandidatë për anëtarë partie. Por duhet të tregohet kujdes i madh që kjo luftë midis së resë dhe të vjetrës të mos marrë në asnjë mënyrë karakter politik, ashtu siç përpiqet në fakt t'ia japë armiku. Në disa organizata të Gjirokastrës p.sh. vërehen në këtë drejtim qëndrime jo të drejta dhe krejtësisht të gabuara dhe të dëmshme, ndahen komunistët në partizanë e «ballistë», ata që janë për kolektivizimin konsiderohen si partizanët gjatë luftës, kurse ata që akoma s'kanë vendosur të futen në kooperativa konsiderohen kundër Partisë, «ballistë» etj. Është e vërtetë se disa komunistë nuk janë treguar aspak në lartësinë e

detyrës lidhur me kolektivizimin e bujqësisë, kanë hezituar dhe hezitojnë të futen në kooperativa. Patjetër me qëndrimin e tyre këta shokë e kanë dëmtuar punën e Partisë në fshat. Por do të ishte e padrejtë dhe gabim që menjëherë këta shokë të flakeshin jashtë Partisë, të konsiderohen kundër saj. Fakti që ka komunistë të cilët nuk janë treguar të gatshëm për kolektivizimin, tregon para së gjithash se në Parti janë pranuar njerëz të papregatitur si duhet dhe të paaftë për të mbajtur barrën e anëtarit të Partisë, por sidomos kjo tregon se puna për edukimin, për kalitjen e komunistëve ka qenë e pamjaftueshme. Duke pasur një nivel të ulët politik e ideologjik, këta anëtarë ose kandidatë për anëtarë partie, me vështirësi binden për kolektivizimin, me zor e kuptojnë të renë që po ndërtohet në fshatin tonë. Mjaft nga këta jetojnë nën presionin e së vjetrës, nën presionin e mbeturinave të së kaluarës, të zakoneve, të ideologjisë e të moralit borgjez. Ata akoma nuk janë shkëputur nga prona private ose nga presioni i familjes apo i farefisit, janë të pabindur akoma për kolektivizimin etj. Nuk duhet harruar se edhe elementi armik mundohet të përfitojë sa më tepër nga këto dobësi. Kuptohet nga të gjitha këto që u thanë më lart se rruga që duhet ndjekur nuk mund të jetë marrja e masave për përjashtimin nga Partia në masë për gjithë ata komunistë që akoma nuk janë bindur për kolektivizimin; i vetmi konkluzion i drejtë që mund të nxirret është se duhet të forcohet shumë më tepër puna politike për kolektivizimin duke filluar që nga organizatat bazë të Partisë. Por, në kundërshtim me këtë, vihet re se jo vetëm nuk ndihmohen kurdoherë me kujdes komunistët, por për-



jashtohen nga Partia bile dhe komunistë, të cilët vetë janë të gatshëm për kolektivizimin por akoma nuk kanë mundur të bindin familjet e tyre. Në disa raste si p.sh. në rrethin e Peshkopisë, jo vetëm që janë përjashtuar disa shokë nga Partia për shkak se s'kanë mundur të bindin familjen e tyre për t'u futur në kooperativë por njëkohësisht janë pushuar edhe nga puna. Veprime të tilla janë të palejueshme dhe të dëmshme prandaj menjëherë të merren masa për ndreqjen e tyre.

Ashtu siç ka porositur vazhdimisht Komiteti Qendror i Partisë, çështjet që kanë të bëjnë me qëndrimin e sjelljet e komunistëve duhet të shqyrtohen me kujdes, në frymën më shoqërore, duke analizuar hollësisht gabimet dhe fajet e tyre. Duhet të merren të gjitha masat që të rritet ndërgjegjia dhe veprimtaria e komunistëve, para së gjithash, duke forcuar jetën e organizatave bazë të Partisë, duke i vënë ato në pozita luftarake për zbatimin e vendimeve të Partisë.

Gabimet e bëra në këtë drejtim në rrethin e Fierit e të Beratit dhe në rrethet e tjera duhet të vlejnë si një mësim për të gjitha komitetet e tjera të Partisë dhe të mos lejohet që ato të përsëriten.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## TE POPULLI ESHTË BURIMI MË I MADH I FRYMËZIMIT

*Nga biseda e zhvilluar me një grup shkrimtarësh dhe  
artistësh në prak të Kongresit të parë të Shkrimtarëve  
dhe të Artistëve<sup>1</sup>*

15 maj 1957

*Pasi u krijohet të ftuarve një ambient i ngrohtë,  
e merr fjalën shoku Enver Hoxha.*

SHOKU ENVER: Nesër do të kemi kongresin tuaj  
që do të ketë rëndësi të madhe për vendin tonë. Si kanë  
shkuar përgatitjet?

Keni bërë përgatitje shoku Dhimitër?

DHIMITËR SHUTERIQI: Përgatitjet janë të shum-  
anshme. U bënë dhjetë vjet që po punojmë si shkrimtar-  
rë. Por përgatitjet mund të ishin bërë edhe më të mira po  
të kishim punuar në mënyrë edhe më të organizuar.

SHOKU ENVER: Po kush nga ju është më përpara

---

<sup>1</sup> Në këtë takim marrin pjesë edhe shokët Spiro Koleka,  
Ilaki Toska, Ramiz Alia si dhe shokë të tjerë.

në krijimtari, po në mënyrë realiste na thoni, shkrimtarët, kompozitorët, apo piktorët?

**DHIMITËR SHUTERIQI:** Punë të mirë kanë bërë kompozitorët. Edhe piktorët, megjithëse janë më pak nga ne shkrimtarët. Megjithatë edhe ne nuk biem poshtë, afër e afër njëri-tjetrit jemi. Ne jemi shumë mirë, kur krahasohemi me të kaluarën, sidomos në poezi dhe në dramë. Kushtet bënë që këto të zhvilloheshin pak në të kaluarën. Poetët, edhe si punë edhe si prodhim, kanë bërë më shumë, sepse edhe vetë poezia i tërheq më shumë njerëzit. Letërsia jonë është akoma e re dhe ka edhe dobësi. Po me gjithë dobësitë ne kemi një gjë të mirë. Unë kam qenë edhe në Çekoslovaki dhe në Hungari. Në krahasim me këto vende ne kemi një letërsi shumë më kompakte ideologjike. Ne kemi akoma dobësi profesionale, por letërsia jonë është unanime dhe kompakte. Unanimiteti i letërsisë sonë për problemet që shtrohen është i dukshëm sidomos në lidhje me mbrojtjen e realizmit socialist. Megjithëse edhe te disa nga ne, aty para ca kohësh, u shfaqën simptoma të huaja, por ato nuk kanë rrezikuar letërsinë tonë. E kam fjalën këtu për njerëz si Mark Ndoja me disa të tjerë.

**SHOKU ENVER:** Çfarë keni në dorë tani ju shkrimtarët?

**DHIMITËR SHUTERIQI:** Këtë vit do të ketë shumë prodhime letrare.

**LLAZAR SILIQI:** Këto dy vitet që vijnë do të jenë vite ngritjeje. Siç dihet, një numër veprash te ne përfunduan në vitin 1954, kurse më 1955 dhe 1956 njerëzit tanë kanë bërë edhe më shumë përgatitje dhe tani do të fillojë prodhimi i ri.

SHOKU ENVER: Tani edhe shteti është në një periudhë që ka më shumë mundësi për t'ju ndihmuar. Ju keni edhe disa arësye të qaheni. Unë di se përveç veprave tuaja në të shumtën e rasteve janë shtypur edhe veprat e shkrimtarëve më të rinj, por të rinjtë duhet të inkurajohen edhe më shumë. Siç më kanë thënë mua ka mjaft prodhime nga të rinjtë, megjithëse jo të gjitha ato kanë vlerë të madhe. Sidoqoftë, po të kishim më shumë mundësi, mirë do të ishte të botoheshin mjaft dhe prej tyre. Kjo ka rëndësi se edhe botimi i një vjershe në gazetë e shtyn njeriun të ecë përpara. Siç e dini, tani në këtë drejtim është përmirësuar gjendja dhe shpresojmë se në të ardhshmen do të përmirësohet edhe më shumë. Të shkruash romane e drama ka rëndësi, por rëndësi kanë edhe krijimet muzikore.

Ju, Preng, muzikën e operës për Skënderbeun e keni bërë shumë të bukur. Besoj se tani e keni mbaruar atë.

PRENG JAKOVA: Në mbarim jam, kam vetëm aktin e fundit.

SHOKU ENVER: Unë nuk jam kompetent po më pëlqen muzika. Nga muzika vetëm guri nuk preket.

Po ju piktorët ç'po bëni? Ja, këtu, kemi Vangjush Mion si më plakun e piktorëve, «plak» se ka eksperiencë të madhe.

FOTO STAMO: Pas kongresit ne do të organizojmë një ekspozitë me vepra të Vangjush Mios.

SHOKU ENVER: Besoj se shumë nga pikturat e vjetra i keni shitur edhe në privatët, po ajo që është kryesore për ju është se nxitës duhet të jetë shteti.

FOTO STAMO: Tani për piktura ka interes nga organet shtetërore, nga organizatat e masave, kurse nga individët interesimi është i paktë.

SHOKU ENVER: Për shitjen e veprave artistike edhe shteti do t'ju ndihmojë.

*Shoku Spiro Koleka bën vërejtje se shokët e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve nuk kishin sjellë në takim asnjë arkitekt.*

SHOKU ENVER: Shoku Spiro kritikon se këtu nuk keni sjellë asnjë arkitekt. Artistët tanë që duhet t'u japin ndërtimeve të reja ngjyrën kombëtare më duket se kanë një fushë të gjerë veprimi dhe mendoj se nuk i ka penguar njeri të shohin realitetin, stilin e popullit tonë, karakteristikat e artit tonë popullor të cilat i gjeni në qytetet e Shqipërisë si në Shkodër, Berat, Gjirokastrë etj. Po këtë nuk e kanë mbajtur shumë parasysh arkitektët tanë. Përveç kësaj, ata edhe nuk bashkëpunojnë ngushtë me piktorët e skulptorët; mendimi im është se këta si në të gjitha zhanret u kanë dhënë e po u japin një material të pasur edhe arkitektëve. Le të marrim për shembull veprat e shokut Vangjush Mio se atë e njoh si të vjetër, bashkë me Nondën e kemi pasur mësues. Ai ka mjaft tablo dhe skica ku kanë dalë mirë në dukje karakteristikat e stilit tonë popullor. Prandaj formalisht ne nuk i duam në këtë takim arkitektët. Ne konkretisht duam që ti vetë, si inxhinier, t'i nxitësh ata të bashkëpunojnë ngushtë me piktorët dhe kur të venë poshtë të shohin në vend jetën e popullit e ta futin këtë frymë në skicat e tyre. Ata të mos punojnë vetëm sipas librave. Të keni parasysh edhe anën ekonomike, por kjo të mos ju çojë në krijimin e

bloqeve pa shumë shije dhe bukuri. Unë mendoj se karakteristikat nacionale të ndërtimeve tona nuk janë të tilla që i kushtojnë shumë ndërtimit. Në të gjitha fushat si në letërsi, art, arkitekturë duhet të punohet dhe të krijohen vepra që t'i dojë, t'i kuptojë e t'i ndjejë populli.

KRISTINA HOSHI: Ka mundësi të flas edhe unë pak?

SHOKU ENVER: Urdhëroni!

KRISTINA HOSHI: Unë dëshiroj të bisedoj mbi këtë çështje. Mendoj se faj kanë jo vetëm arkitektët po edhe ne piktorët e skulptorët. Megjithëse ata në radhë të parë duhet të interesohen më shumë sepse ata kanë në dorë anën ekonomike. Po të na njoftojnë ne kur bëhet një ndërtesë kjo do të kishte leverdi, sepse së bashku do të mendonim për dekoracionet dhe do të dilnin shumë gjëra të bukura. Po çështja është se vetë arkitektët përpiqen të nxjerrin vepra me shumë pak shpenzime dhe kështu bëjnë dekoracione pa vlerë arkitektonike. Prandaj, mendojmë ne, duhet që arkitektët të parashikojnë edhe çështjen e dekoracioneve, skulpturave etj.

Duhet të shfrytëzohet më mirë përvoja e popullit e të punohet kështu për një arkitekturë nacionale.

DHIMITËR SHUTERIQI: Ne kemi një arkitekturë shumë të thjeshtë, akoma të pazhvilluar. Përgjithësisht arkitektura jonë e fshatit dhe e qytetit është shumë e thjeshtë, prandaj nga kjo anë nuk do të kishim vështirësi shumë të madhe. Por unë mendoj se nuk pengon vetëm ana financiare, kanë munguar edhe guximi i artistit dhe tradita artistike në arkitekturën tonë.

SHOKU SPIRO KOLEKA: Desha të shtroja diçka

po të më lejoni. Përpara te ne ka pasur vetëm dy-tre arkitektë, prandaj puna e tyre ishte e zorshme të linte gjurmë, sepse ku të linte arkitektura italiane. Tani ka filluar diçka të bëhet te ne. Por edhe skulptorët duhet të kërkojnë bashkëpunimin me arkitektët. Anën ekonomike të ndërtimeve ne do ta kemi parasysh edhe në të ardhshmen, po kur bashkëpunojnë skulptorët me arkitektët, kjo arkitektin do ta bëjë patjetër të mendojë se në ç'stil do ta bëjë veprën që i ngarkohet njëkohësisht dhe do të ndihmohet, se inxhinierit po t'i jepet ideja gjen vend ku të futë një dekoracion ose një kornizë, çesmë ose diçka karakteristike. Po Lidhja e Artistëve shumë pak ka bërë në këtë drejtim. Unë kam gjetur disa gjëra karakteristike, disa korniza në gurë, nga ndërtimet në Qafë Murr, ose nga Dibra etj., i kam marrë në fotografi dhe ua kam çuar artistëve tanë. Prandaj edhe ju artistët më shumë duhet të bëni sepse skulpturën ne e kemi vështirë ta aplikojmë në një shkallë të gjerë. Ja p.sh. këtu në pallatin e Komitetit Qendror mund të kishim diçka më të goditur. Në këtë ndërtesë ne nuk i kemi kursyer të hollat po edhe ju nuk jeni ofruar për bashkëpunim. Skulptura për vendin tonë është një gjë e re, kurse arkitektura është më e pasur, denbabaden, tjetër është se nuk kemi krijuar stilin nacional, prandaj në këtë fushë ka shumë vend për ju.

**FOTO STAMO:** Për këtë gjë ne kemi bërë disa biseda me radhë, kemi bërë raporte të veçanta për zhvillimin e arkitekturës sonë duke futur në përdorim motive nacionale, tani kemi filluar të futim shumë ornamente. Këtë çështje ne do ta diskutojmë në kongres, po

arkitektët tanë ndikohen nga motivet e huaja, kurse ne kemi shumë gjëra të bukura, tonat, që mund t'i marrim. Në këtë drejtim edhe nga ana e Institutit të Shkencave duhet të bëhen studime të veçanta. Në muzeumin e artizanatit kam parë me dhjetëra albume që kishin shumë ornamente në të cilat mbështeteshin artizanët e rinj. Mjetet nuk mungojnë dhe tani dëshira ekziston.

**SHOKU ENVER:** Pra mundësi ka, janë krijuar dhe do të krijohen akoma më shumë. Zhvillimi i artit dhe i kulturës duhet të shkojë progresivisht me ndërtimin e socializmit. Shumë gjëra po ecin përpara, por edhe ne duhet të bëjmë hapa në të gjitha drejtimet. Bashkë me ndërtimin e uzinave, fabrikave, me përparimin e bujqësisë do të përparojnë edhe njerëzit dhe ju e dini që kultura dhe arti, të gjitha zhanret e letërsisë e të artit do të luajnë një rol vendimtar në zbukurimin e shpirtit të njerëzve dhe të jetës së tyre. Për këto çështje Komiteti Qendror i Partisë sonë është kujdesur kurdoherë që t'i ndihmojë artet e letërsinë dhe në rast se nuk është bërë sa duhet ju duhet të kuptoni se situatat kanë qenë të vështira. Ne, shokët e Komitetit Qendror, kemi qenë për atë që të ndihmohen shkrimtarët, kompozitorët, piktorët, artistët, artizanët tanë për të pasur minimumin e kushteve që të krijojnë sa më shumë. Është e vërtetë se ka pasur pengesa dhe nuk mund të themi se nuk ka, por sidoqoftë masa janë marrë e do të përpiqemi të marrim edhe të tjera.

Në përgjithësi pikëpamja jonë është se ju keni bërë përpjekje në zhvillimin tuaj dhe i keni dhënë popullit.

E kuptojmë që të gjithë se për të qenë shkrimtar,



piktor apo kompozitor dhe të afirmohesh për një kohë të shkurtër është e vështirë, për këtë duhet kohë. Mjeshtria në të gjitha degët është shumë e gjerë dhe kurrë të mos arrijmë në konkluzionin se e zotërojmë plotësisht atë dhe mundet fare lehtë të nxjerrim ç'të duam se jemi të përsosur. Kjo pikëpamje të luftohet, por në rrugë të drejtë dhe jo me masa. Ndaj shkrimtarëve e poetëve duhet të jemi të matur se edhe natyra e punës është e tillë. Po kjo nuk do të thotë se këta nuk duhen ndihmuar. Është realitet që, pavarësisht se në vendin tonë nuk kemi ndonjë autoritet të madh në këto degë, artet dhe letërsia, të udhëhequra nga marksizëm-leninizmi dhe nga puna e drejtë e Partisë, siç tha shoku Shuteriqi, kanë pasur kompaktësi ideologjike në kuptimin që çdo krijim të jetë në rrugën e popullit. Dhe nuk ka satisfaksion më të madh për të gjithë ne dhe për ju kur veprat dhe mendimet tuaja bien në dorën e popullit dhe i shërbejnë atij.

Tani ne duhet të ecim dhe do të ecim në këtë rrugë. Ju do të keni çdo ditë ndihmën e Partisë dhe të qeverisë. Përpjekjet tuaja për të marrë pjesë në ndërtimin e jetës së re të popullit janë për t'u lavdëruar. Kongresi juaj duhet të bëhet një ngjarje me rëndësi në jetën e popullit tonë, d.m.th. ai të mos mbetet vetëm një çështje juaja, e një grupi shkrimtarësh, artistësh apo kompozitorësh po të ndikojë thellë në të gjithë jetën kulturele të vendit. Këtë ta marrë seriozisht Partia. Kongresi juaj të bëhet i tillë që masat punonjëse të shohin te ju një hov për të ecur përpara dhe një dëshirë të zjarrtë për t'u mbështetur e për të zhvilluar edhe më tej vijën e drejtë që kemi ndjekur. Ne ju themi se do të keni

për krahejën e madhe të Partisë, se çështja e artit dhe e kulturës është e lidhur me jetën e popullit. Ne kemi konstatuar se përsa u përket romaneve, dramave, tregimeve, novelave keni nxjerrë mjaft gjëra dhe sipas mendimit tim disa romane, si të Shuteriqit, të Sterjo Spasses, ose të Fatmir Gjatës etj., janë shumë të mira. Tani nuk duhet të bëjmë krahasime se do të gabonim po të bënim krahasim me romancierët më të mirë të BRSS ose të Francës. Unë kam rast ta ndjek letërsinë frënge, atje ka edhe gjëra që nuk vlejné fare dhe shumë prej këtyre nuk dalin vetëm nga penda e autorëve dekadentë; ka të tillë të cilëve edhe gazetatat e partisë u bëjnë recensione të mira. Ka nga këto vepra që nuk më kanë bërë asnjë përshtypje dhe po t'i krahasojmë me shumë romane të shkrimtarëve shqiptarë nuk janë gjë. Po sigurisht nuk mund të bëjmë krahasime me shkrimtarët e mëdhenj francezë. Çështja është se romanet e shkrimtarëve tanë kanë fituar simpatinë e popullit dhe populli i ka lexuar me zell ato, prandaj duhet të ecet në këtë rrugë pse po të ecet kështu ne do të kemi rezultate. Një roman, që të dalë i mirë, duhet të pasqyrojë realitetin e kohës, po një roman i tillë nuk mund të bëhet duke u mbyllur brenda. Nuk është fjala vetëm për ju, Komiteti Qendror rreh çekatin që të gjithë shkrimtarët e artistët të venë poshtë. Mund të ketë disa shkrimtarë që u është mbushur mendja se mjafton të rrinë në dhomë, të zgjedhin ndonjë temë dhe kështu e kryejné punën. Pastaj mendojnë ata: «Sa për ta mbushur atë unë jam psikolog i madh, unë i di korrentet letrare, pikëpamjet, luftën e njerëzve poshtë, mund të vete edhe një muaj në bazë dhe e rregulloj

këtë». Po që të dalë me të vërtetë një roman edukativ që të pasqyrojë luftën e njerëzve me ndjenjat, sentimentet është e domosdoshme të jetohet me popullin, ndryshe nuk mund të bëhet.

Pse pëlqehen aq shumë poetët tanë të mëdhenj, si Naimi, Çajupi etj. që janë kolosët e letërsisë sonë? Edhe ju duhet të mësoni shumë prej tyre. Naimi ka jetuar jashtë, në vuajtje, i sëmurë, me një nëpunësi të vogël, po me sa zjarr e mall, me sa art e dashuri ka shkruar për atdheun. Të gjithë i dimë dhe i kemi në zemër vjershat e tija. D.m.th. atë e shtynte dëshira për çlirim e atdheut që vuante nën zgjedhën e turqve, kurse ne që çlirim e atdheut të dashur e bëmë vetë dhe e shohim të rritet i kemi të gjitha mundësitë, më shumë nga sa ka pasur Naimi, për të shkruar vepra të bukura. Por për këtë është e nevojshme të vemi në burimin e pastër të popullit e të frymëzohemi dhe me siguri do të dalin vepra që do të frymëzojnë njerëzit tanë dhe brezat e ardhshëm për të ndërtuar komunizmin.

Më kishin dërguar disa shokë ca disqe nga Çekoslovakia dhe vura një pjesë të Bedrzhi Smetanës. Atë ditë kisha në duar «Nëntorin» ku ishte shkruar një pjesë e Çajupit e cila fliste për grykat heroike të Kurveleshit, për rrepat e atij vendi; të them të drejtën m'u ngritën leshrat përpjetë se më shkoi mendja te lufta që ka bërë kjo krahinë që në kohët e kaluara, te lufta partizane, lufta e grave të Kurveleshit që kanë luftuar me shishane<sup>1</sup>, me shamitë e zeza në kokë e dyfekun në krahë dhe të dhjetëra shokëve tanë këtu dhe në të

<sup>1</sup> Shishane — një lloj pushke e vjetër dhe e gjatë.

gjitha anët e Shqipërisë. Një frymëzim i tillë, një burim i tillë është shumë i madh sa nuk mund të thuhet, populli ynë i pëlqen këto se ka luftuar tërë jetën. Të tilla tema mund të zgjidhen edhe sot se e kaluara e popullit tonë është e shkëlqyer dhe nuk duhet harruar se Lufta nacional-çlirimtare është e lidhur me luftërat e kaluara të popullit tonë. Këtë luftë e bëri po ai popull që ka bërë dhe luftërat e para dhe komunistët që udhëhoqën Luftën nacional-çlirimtare të popullit ishin djemtë e popullit, prandaj nuk duhet të shkëputet e kaluara nga e tashmja. Në jetën e popullit, pra, ka tema të tilla që mund të frymëzojnë shkrimtarët tanë, piktorët, kompozitorët etj. dhe të nxjerrin vepra me të vërtetë të shkëlqyera. Në këtë drejtim duhet të ketë edhe bashkëpunim, p.sh. shoku Kristo Kono ka bërë një vepër për Labërinë, po sikur të ekzistonte një poemë e mirë për Labërinë do të dilte me të vërtetë një muzikë heroike për popullin tonë.

Ne kemi bindje se po të lidheni edhe më shumë me popullin, veprat tuaja do të dalin me të vërtetë realiste. Edhe këto që keni bërë janë realiste po puna është të shprehet me të vërtetë situata, lufta, kontradiktat me të cilat ndeshen njerëzit dhe të ndihmohet për t'u hapur atyre rrugën e zgjidhjes. Pra në këtë drejtim duhet nga të gjithë ju, sidomos nga ju që keni eksperiencë, që me veprat tuaja të frymëzoni brezat e ardhshëm që të krijojnë për popullin. Prandaj të keni kurajën për të kritikuar edhe dobësitë e veprave tuaja, sigurisht jo në mënyrë denigruese, por ashtu siç na mëson Partia dhe të mos ju mbetet qejfi nga kritikrat e njëri-tjetrit duke pasur parasysh që ato t'ju vlejné të bëni vepra të mira.

Ne kemi besim në këtë drejtim se ju si të gjithë ne jeni të popullit, ju dhimbset jeta dhe mirëqenia e tij dhe keni parasysh se puna juaj ka rëndësi të jashtzakonshme.

Mundet që shumë konferenca t'u bëjmë ne punëtorëve të Hidrocentralit të Matit, po kur të dalë një roman i mirë atëhere ai do t'i mobilizojë në shembullin e personazheve pozitive. Unë kam lexuar romanin sovjetik «Çimentua», i cili është roman i mirë, por flet për një vend tjetër e kjo mund të mos tërheqë sa duhet masat tona punonjëse. Po sikur një shkrimtar, yni, të vejë të jetojë dhe të punojë në gjirin e masës jo me qëllim që të ndërtojë hidrocentralin, por të bashkohet me jetën e punëtorëve dhe të shkruajë roman për ta, mendoni sa do t'i shërbejë ai ndërtimit të socializmit në Shqipëri. Këto janë hidrocentralet e para, në planet e ardhshme do të ndërtohen të tjera po aq të mëdha bile edhe më të mëdha. Prandaj me veprat tona letrare e artistike ne të kalitim kuadro të tillë të klasës punëtore që t'i ndërtojnë ato. Pra të futemi në jetën e klasës punëtore.

Le të marrim punëtorët e tekstilit. Atje ka gjëra të prekshme, të mahnitshme. Përpara ato kanë qenë vajza të mbyllura ose baresha, shumë nga ato nuk dinin as shkrim, kurse tani kanë marrë në dorë maqina moderne. Ndiqni me kujdes një plak kur vjen nga fshati në kombinat dhe dëgjoni ç'thotë kur vete të takojë të bijën që punon me gjithë ato maqina dhe në gjithë atë zhurmë. Pra shihni si i ka ndryshuar Partia njerëzit.

Industria jonë do të zhvillohet edhe më shumë në të ardhshmen. Do të bëhen kombinatë shumë më të mëdhenj nga ky, do të zmadhohet fabrika e tekstilit të

Shkodrës, do të ngremë fabrika për punimin e mëndafshit, të leshit etj. Këto nuk janë ëndrra, këto janë plane, realitet dhe do të bëhen medoemos. Ju e dini ç'perspektiva ka nafta te ne, atje ne do të rritim kuadro të rinj. Kuadrot që kemi janë heroikë, ata punojnë, kanë mësuar zanatin, po sa të tjerë do të na duhen akoma. Ne duhet t'ju gëzojmë ju se me miliona rezerva ton naftë janë zbuluar në vendin tonë. E ç'është një rafineri? Do të ngrihen 4 rafineri në të ardhshmen edhe më të mëdha se këto që kemi. Në të gjithë Shqipërinë ka naftë, deri në Shkodër, Korçë e Gjirokastrë. Prandaj e vlen barra qiranë që shkrimtarët tanë, piktorët, kompozitorët të futen në zemrën e klasës punëtore dhe andej të nxjerrin të tilla vepra që të zëvendësojnë konferencat e tepërta që bëhen e që nganjëherë e mërzhitin popullin. Një roman ka një rëndësi të madhe dhe konferencierët tanë, po të lexojnë mirë romanet tuaja, do të jenë në gjendje t'i frymëzojnë njerëzit më mirë për punë.

Edhe bujqësia jonë ka një perspektivë shumë të madhe. Kolektivizimi, kjo temë është kapur nga disa, të shohim tani ç'na ka bërë Fatmiri që është futur në fermën e Maliqit. Po me një lule nuk vjen behari, thotë populli. Çështja e bujqësisë duhet t'i preokupojë të gjithë se po bëhet një revolucion i madh në fshatin tonë me kolektivizimin. Pastaj ka kontradikta të mëdha në fshat përveç të metave dhe gabimeve. Ne po qortojmë njerëzit e Partisë, udhëheqësit e komiteteve të Partisë se në disa raste nuk zbatohet drejt dhe mirë vija e Partisë. Ka kontradikta jo vetëm në mes të fshatarëve po edhe në mes të komunistëve. Janë futur në Parti

shumë fshatarë të vendosur, po akoma ka shumë që nuk janë edukuar mirë. Komunistët e fshatit duhet ta kuptonin se duhej të ishin të parët që të futeshin në kooperativën bujqësore po disa prej tyre nuk janë bindur. Ka ndikuar edhe çështja e traditave dhe e lidhjeve familjare. Ka udhëheqës partie që u thonë komunistëve: ose me babanë ose me kooperativën. Mirëpo babai atij i ka bërë kokën, familja është familje, thotë Partia, prandaj kjo ka rëndësi, por ata s'i marrin parasysh këto dhe gjejnë rastin e i përjashtojnë nga Partia. Pra, në fshat ka luftë, ka kontradikta.

Një nga armët e Partisë sonë për zgjidhjen e këtyre kontradiktave janë shkrimet tuaja. Komiteti Qendror, shokë, mendon sa detyrë të lartë keni ju të letërsisë dhe të arteve në mobilizimin e masave për ndërtimin e bazave të socializmit. Prandaj ne këtu dalim edhe me autokritikë se, megjithëse e kemi kuptuar rëndësinë e arteve e të letërsisë, duhet akoma më thellë ta kuptojmë këtë rëndësi dhe të bëjmë përpjekje që t'u lehtësojmë punën shokëve që kryejnë këtë detyrë kaq të madhe.

Shokët shkrimtarë dhe artistë e kuptojnë së rrojmë në Shqipëri dhe nuk kanë pikëpamje ekstravagante, nuk kërkojnë gjëra të tepruara. Por që të mundin piktoret tanë të zhvillojnë artin e tyre duhet t'u sigurohen penela, bojra, vende pune e të tjera. Mund të punohet edhe në odaçkën e Vangjush Mios që i ka lënë plaku, një furriçkë të vogël, dhe ai në këtë odë më ka bërë edhe mua një portret si shokë që ishim. E kam fjalën që artistët të kenë edhe një vend ku të punojnë dhe të ekspozojnë veprat e tyre, t'u krijohet një atelie ku

të punojnë këta shokë më lirisht, pastaj më vonë do të bëjmë edhe gjëra të tjera.

SHOKU SPIRO KOLEKA: Këta shokë duhet të luftojnë më shumë, nuk është se këta na kanë ardhur dhe ne nuk i kemi ndihmuar.

SHOKU ENVER: Me këtë besoj se nuk jemi dakord. Kërkesat për nevojat e këtyre na kanë ardhur me anë të raporteve që kemi lexuar.

FOTO STAMO: Që nga viti 1947 ne kemi bërë relacione për këto gjëra.

SHOKU ENVER: Nuk bëhet vetëm me relacione, këta të ekonomisë tani kanë marrë direktiva edhe për këto çështje.

SHOKU SPIRO KOLEKA: Ne impcrtojmë me qindra milion rubla mallra dhe të mos sjellim këto që u duhen piktorëve, duhet të na vijë turp për burokracinë tonë.

*Duke iu përgjegjur mendimit të shprehur që të luftohet burokracia me anën e satirës, shoku Enver tha:* Ja p.sh. Nonda Bulka bën disa satira shumë të mira, prandaj shoku Nonda mos e lër të të trashet maja e penës (të qeshura). Sigurisht ju merreni edhe me gjëra të tjera. Nonda është një talent i vjetër, po ku ta shprehte përpara atë? Tani i ka të gjitha mundësitë. Kështu edhe Sterjo Spasse që tani po nxjerr romane që i pëlqen populli. Pra ka shumë mundësi në vendin tonë në këtë drejtim. Sa të jetë e mundur ne do t'ju ndihmojmë më shumë për interesin e popullit.

Shokët piktorë nuk kanë si të bëjnë pa qenë të lidhur me natyrën dhe jetën, ata janë pak më përpara në këtë drejtim, është pastaj edhe zanati i tyre që i çon



jashtë mureve të shtëpisë. Megjithatë pak bëjnë. Edhe këta duhet të tregojnë hovin e madh të klasës punë-tore dhe të fshatarësisë. Kjo duhet të shprehet në veprat e tyre megjithëse dhe peisazhet kanë rëndësi të madhe. Proporcionin ta ruajmë. Shoku Mio mund të trajtojë edhe zhanre të tjera, po më duket se ai e ka peisazhin në gjak. Mendimi im është se pikturat e tija janë shumë të mira, kanë shumë vlerë dhe kur i shoh ato, shoh dritën dhe ngjyrat e maleve të Korçës, sepse unë atje kam jetuar mjaft kohë. Në veprat e tija gjen realizëm.

SHOKU SPIRO KOLEKA: Po duhet të mos nxjerrë vetëm pamje nga të Korçës po edhe nga të zonave të bregdetit.

SHOKU ENVER: Mirë, le të nxjerrë, po ju nuk keni nxjerrë vetë ndonjë piktor andej, vetëm piratë keni nxjerrë (të qeshura të gëzuara). Kapitenët e Himarës kanë qenë të dëgjuar për të qethur delet e Korfuzit. Ka pasur edhe nga Shkodra kapitenë të zot për anije tregëtare. Ne edhe flotën detare tregëtare do ta zhvillojmë, edhe artin duhet ta zhvillojmë në të gjitha drejtimet.

VANGJUSH MIO: Natyrën duhet ta shohësh, ta ndjesh mirë, të shihet në momentin kur është më e bukur. Po ta ndjesh nxjerr gjëra të mira. Më përpara unë isha në rrethin e Korçës, po nuk mjafton, duhet të dilet edhe jashtë se pa dalë nuk bën dot gjë. Piktorët duhet të punojnë po ne duhet të mblidhemi edhe dy-tri vetë së bashku, të vemi në malësi dhe atje të lidhemi me popullin.

SHOKU ENVER: Mirë është, ju mund të nxirrni edhe vepra në bashkëpunim me njëri-tjetrin.

FOTO STAMO: Kjo ndihmon se kritikojmë edhe të metat e njëri-tjetrit.

SHOKU ENVER: Te ne ka mjaft vepra të mira që paraqitin vendin tonë, përpjekjet tona. Edhe shokëve sovjetikë që kanë ardhur u kanë pëlqyer veprat tuaja, kanë qenë të entuziazmuar dhe kanë thënë se këta njerëz janë me perspektivë të madhe.

Në pikturë ne nuk kemi pasur tradita dhe mbështetje, prandaj përpjekjet e shokëve tanë janë për t'u lavdëruar. Po përsa u përket letërsisë, poezisë, muzikës, ne kemi edhe traditat tona. Poetët dhe dramaturgët tanë duhet t'i mbështetim dhe të kërkojmë më tepër nga ata. P.sh. në dramaturgji kemi gjëra të mira që na kanë pëlqyer jashtëzakonisht shumë siç janë veprat e Kolë Jakovës që janë vepra të forta dhe edukative. Edhe romanet që janë bërë janë të mira, po mos harroni edhe novelat. Këto janë të bukura dhe kuptohen e lexohen nga masat e gjera. Me to mund t'i emocionosh e t'i mobilizosh njerëzit. Duhet të marrësh parasysh edhe nivelin kultural të njerëzve tanë.

Unë kam lexuar romanin e Shuteriqit dhe e kam pëlqyer po kjo varet edhe nga dispozicioni i momentit. «Fyelli i Tanës» gjithashtu më pëlqeu shumë. Dua të them që këto zhanre të mos lihen pasdore. Romanet janë të mira sidomos për nivelin tonë. Ja edhe Aragoni shkruan romane, po subjektet që trajton janë të rënda për masën, ai nuk ka mundur të fiksojë si duhet karakteristikat e luftës. Prandaj sa të jetë e mundur të kemi parasysh edhe nivelin e popullit kur shkruajmë.

Edhe për muzikën jam dakord se duhet të shkruaj-

më edhe opera, edhe simfoni, patjetër, po edhe zhanret e tjera që mobilizojnë masat si kompozimet e Trakos, Gaqo Avrazit etj. janë të mira. Të gjitha këto gjëra kongresi t'i trajtojë, të mos i lëmë në heshtje. Pra, të krijoni simfoni, ju edhe të tjerët, të shfrytëzohen të gjitha zhanret; në këtë drejtim nuk duhet të neglizhohet se mund të shkruash edhe një lumë veprash, po nganjëherë për një gjë mjafton edhe një satirë me 5 radhë për të bërë efektin e duhur. Kjo vlen shumë se njeriu e mban në kokë.

Ju jeni në gjendje ta kuptoni më mirë rëndësinë që kanë lidhjet me popullin, atje është burimi më i madh i frymëzimit. Po të mos marrësh eksperiencën dhe mendimet e popullit nuk ecën dot përpara. Dhe ruani frymën e pastër të marksizmit në veprat tuaja, frymën e lavdisë së popullit. Partia do t'ju ndihmojë, fuqimisht, se ka marrë një hov të madh gjithë kjo çështje. Në të ardhshmen, në vitet që vijnë, kemi bindjen dhe besimin që mundësi akoma më të mëdha do t'ju jepen dhe këto që themi do të bëhen jo vetëm çështje të romaneve po edhe të muzikës, skulpturës etj. Edhe skulptura do të bëhet me të vërtetë e nevojshme. Po pse? Sepse do të ngrihen fabrika të reja, shtëpi të reja, do të hapen parqe të reja dhe medoemos këto do të zbukurojnë vendin. Deri tani nuk kemi pasur mundësi të mendonim për gjëra të tilla.

Tani mundësitë do të krijohen medoemos dhe ju do të keni fushë të gjerë për të shprehur ndjenjat patriotike dhe zotësitë tuaja dhe nuk do të jenë të mjafta ato që keni bërë. Prandaj duhet të keni kujdes për ngritjen e brezave të rinj, ju, pionierët e kulturës së re të vendit

tonë, sepse në të ardhshmen forcat tuaja nuk do të jenë të mjaftueshme.

Me masat që do të merren ne do t'i rritim jashtë-zakonisht prodhimet tona dhe nuk do të mbetemi me parullën që planin ta realizojmë çdo 28 ose 29 Nëntor, por të marrim masa të tilla që plani pesëvjeçar të realizohet para afatit. Kjo do të krijojë mundësi që t'i jepen popullit sa më shumë prodhime. Pra ka mundësi shumë të mëdha te ne. Por duhet të ndryshojë edhe mentaliteti i fshatarit, sidomos i atij të Tiranës që e mbjell misrin me vonesë të madhe, «ka kohë more burra», thotë ai. Po pse nuk e mbjell? Sepse secili merr atë mataranë me një kile qumësht dhe shportën me 10 vezë dhe vjen në qytet. Në disa vende të tjera në janar do të gjesh misrin akoma në arë dhe kashta që është një ushqim i mirë për lopët për shtimin e prodhimit të qumështit, i humbet kështu shumë cilësitë e veta ushqyese. Vetëm korrja e bimës, jo kur e bën tiranasi, po pak më përpara, dhe silazhimi i tyre, jo në gropa me çimento ose me gropa të zakonshme, por mbi tokë, e bën kashtën që të ruajë cilësitë ushqimore dhe menjëherë lopa, ajo që tiranasi i merr 300 litra, e rrit prodhimin në 800 litra. Po të llogaritësh vetëm këtë sa do të rritej prodhimi në të gjithë vendin.

Vjet na erdhi në Sekretariat sekretari i parë i Komitetit të Partisë të rrethit të Peshkopisë dhe filloi të qahej se po i ngordhnin bagëtitë e këtij rrethi. Nuk është e mundur, thoshte, t'i mbajmë bagëtitë për dimër. Kurse Lushnja, Kavaja etj. nuk na lënë të kullosim në këto zona në të cilat fshatarët tanë kanë ardhur për shekuj me radhë. Ne ia premë, i thamë bëni ç'të doni,

bagëtitë tuaja do të qëndrojnë në Peshkopi. Mblodhi mendjen, shkoi në Peshkopi, mblodhi Partinë, popullin dhe rininë që nuk i kishte mbledhur dhe u tha si ta zgjidhnin këtë problem. Dhe zgjidhja u gjet për bukuri, ata u mobilizuan në verë dhe krijuan rezerva shumë të mëdha për dimër në mal, dhe Peshkopia që i vetmi vend në Shqipëri që nuk i pësuan asgjë bagëtitë këtë dimër. Po sa mundësi të tilla ka. Unë fola vetëm për mundësitë në një sektor, kështu do të mundim të krijojmë bollëkun dhe këto masa do t'i marrim sa më parë, të luftojmë burokratizmin dhe të ecim sa më shpejt përpara.

Perspektiva kemi edhe në drejtime të tjera. Do të thajmë moçale bile që këtë pesëvjeçar. Në Maliq atë liqenin e vogël që ka mbetur do ta bëjmë tokë prodhuese. Pastaj pemë e fruta do të bëhen nga të katër anët se Shqipëria është vendi më i pasur që mund të jetë në këtë drejtim. Përmeti tënd (*i drejtohet Nonda Bulkës*) do të bëhet një mrekulli plot me qershi, mollë, rrush etj. Këto janë gjëra të thjeshta e të mundshme, po duhet menduar. Fushat në asnjë mënyrë nuk do të zihen me pemë po do të bëhen tarraca, do të gcejmë brezin ku e do çdo pemë klimën. Po pse janë lënë pasdore? Se populli ka synuar më parë për bukën. Bukën ne do ta bëjmë po duhet të kuptojmë që frutat kanë një vlerë të madhe, përveç ushqimit për popullin. Ç'bëjnë çekët? Ata na blejnë gështenjat tona të Tropojës, se ç'u bëjnë, i mbështjellin me nga një letër të ndritur dhe i eksportojnë në Argjentinë dhe marrin valutë. Po pse nuk e bëjmë dot edhe ne këtë punë? Neve ka raste bile që edhe na kalben. Prandaj duhet t'i vlerësojmë të

gjitha gjërat. Për të tharë kënetat do të vijnë mekanizma të fuqishme. Pastaj këto do të sjellin zhvillimin e industrisë ushqimore, të tekstilit, të veshmbathjes, artizanati do të marrë një pamje tjetër. Artizanët tanë kanë braktisur punën e bukur dhe presin që çdo gjë t'ua japë shteti. Kjo nuk është e drejtë sepse humbasim shumë të ardhura. Ne çojmë në Çekosllovakia shqopën dhe sjellim andej lodra shahu, çibuqe, po përse të mos i bëjmë vetë këto gjëra? Dru kemi, koska e brirë kemi, përse të mos i bëjmë vetë shumë gjëra të bukura e të nevojshme për popullin e për eksport? Të gjitha do t'i bëjmë dhe kjo do të thotë të shtohen të ardhurat e popullit dhe në vend të gjithë këtyre të blejmë gjëra të tjera që do të krijojnë bollëkun.

Pastaj rëndësi të madhe ka për ne çështja e minierave, nafta, kromi, sidomos bakri për të cilin kishim frikë se na u mbarua, po kjo frikë tani na iku sepse Mirdita është tërë bakër. Po bakri ka edhe flori edhe kobalt. Një gjë e madhe për ne është ferro-kromi që do të ketë vlerë të madhe. Kështu janë gjetur sasi të mëdha hekuri, nikeli etj. Malet tona fshehin xhevahire brenda. Prandaj duhet t'i përvishemi punës. Për të gjitha këto, për t'i shfrytëzuar, do të na duhet të bëjmë hidrocentrale të tjera.

**SHOKU SPIRO KOLEKA:** Bujqësia është bazë, buka e popullit dhe e industrisë. Të gjitha këto mrekulli, i gjithë ky kopësht i lulëzuar që duhet kuptuar në mënyrë figurative, do të bëhet me punën tonë.

**SHOKU ENVER:** Ne ndërtojmë hidrocentrale, po atje është klasa punëtore, vijnë maqineri, atje mbeten pak njerëz dhe kjo punë ecën, po në fshat nuk ecin

punët kështu. Këto janë detyra të mëdha po të realizueshme, sepse fshatarësinë e kemi të mirë, patriote, të gatshme të përqafojë çdo gjë. Përpara ne flisnim për kolektivizimin, po njerëzit nuk e kuptonin, por duke u folur vazhdimisht njerëzit i shohin dhe i kapin më shpejt çështjet e reja dhe puna ka arritur tani që kolektivizimin në malësi ta frenojmë, por shokët e Partisë na thonë: «nuk kemi ç'të bëjmë, ata duan vetë, nuk kemi si t'i ndalim». E pra, një situatë e tillë nuk ishte kështu 3-4 vjet përpara.

Edhe për pambukun i është futur dëshira fshatarësisë, kurse përpara ata nuk e njihnin, po kështu edhe për panxharin. Kush e mbillte përpara në Korçë? Fshatari nuk e njihnte dhe nuk ia dinte leverdinë prandaj edhe rezistonte. Tani e reja në bujqësi kudo ka çarë dhe po ecën përpara.

Po ju tani ç'po bëni? Ja tani porsa ka ardhur Çesku [Zadeja], është plot energji të reja.

FATMIR GJATA: Ai ka ndërmend të bëjë një opera për Skënderbeun.

SHOKU ENVER: Unë jam shumë dakord për një gjë të tillë, mund të bëhet diçka e mbështetur në poemën e Naimit. Po Kolë Jakova ç'punon?

KOLË JAKOVA: Tani po punoj një dramë me temë sociale mbi familjen, mbi të drejtën e gruas dhe të burrit, mbi disharmoninë familjare, dëmin që i sjell kjo kolektivitet dhe rrugën si mendoj unë të zgjidhet ky problem.

SHOKU ENVER: Po ti Llazar?

LLAZAR SILIQI: Jam duke bërë një poemë. Unë me hidrocentralet jam lidhur diçka, se ato simbolizojnë

të renë në vendin tonë. Këtë besoj se do ta mbaroj nga fundi i vitit.

SHOKU ENVER: Po ti Sterjo?

STERJO SPASSE: Kam një temë që ka të bëjë me rininë.

SHOKU ENVER: Të shohim tani ç'do të na nxjerrë Fatmiri. Po shikojeni, megjithëse ka vajtur në fusha, nuk ka marrë hiç pamjen e fshatarit, as është nxirë fare (të qeshura).

*Shoku Enver, duke folur për kritikën letrare, shtoi:* Dhimitri edhe kur vjen këtu në Komitetin Qendror nuk ndruhet, e lëshon pallën, po duhet të luftojë që edhe kritika letrare të zhvillohet më me gjallëri, vetëm të jetë kurdoherë e drejtë, objektive, parimore.

DHIMITËR SHUTERIQI: Kritika kërkon shumë kohë e punë që të marrë zhvillimin e duhur.

SHOKU ENVER: Ne do të vijmë me kënaqësi në kongresin tuaj dhe do t'ju dëgjojmë me kujdesin më të madh se kjo do të jetë një ngjarje me rëndësi në zhvillimin e artit dhe të kulturës në vendin tonë.

Nuk dua t'ju mbaj më shumë, sepse keni edhe pregatitjet e «dasmës»<sup>1</sup>, ju kanë ardhur edhe miq të huaj. Përpiquni t'i vini në dijeni për realitetin tonë që të munden të na ndihmojnë dhe përfitoni prej tyre.

Në emër të të gjithë shokëve ju falenderojmë shumë për mirësinë që patët që erdhët dhe u takuat me ne. Kjo është një ndihmë jo vetëm për ju, po edhe për ne që morëm takim me përfaqësues të letërsisë

---

<sup>1</sup> Është fjala për Kongresin e parë të Shkrimtarëve dhe të Artistëve.



dhe të arteve dhe ju sigurojmë se ne do t'ju ndihmojmë më shumë se deri tani jo për t'ju bërë qejfin, po se e do interesi i popullit, se kjo çështje është e lidhur ngushtë me përmirësimin e jetës së popullit. Prandaj ju urojmë suksese në punën tuaj!

*Botohet për herë të parë sipas  
procesverbalit të mbajtur në  
këtë takim që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

**LETËR DËRGUAR ORGANIZATAVE TË PARTISË  
NË TERREN DHE NË USHTRI NË LIDHJE ME  
ARRATISJEN E TRADHËTARIT  
PANAJOT PLAKU**

17 maj 1957

**GJITHË KOMITETEVE TË PARTISË TË QARQEVE DHE  
TË RRETHEVE**

**DREJTORISË POLITIKE TË USHTRISË POPULLORE  
DEGËS POLITIKE TË REPARTEVE TË KUFIRIT PRANË  
MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME**

Më 15 maj 1957 u arratis për në Jugosllavi Panajot Plaku. Tradhëtia e tij tregon se ai ka qenë një agjent i vjetër i jugosllavëve, por ka ditur ta maskonte mirë veten, të fshihej për një kohë të gjatë prapa tesserës së Partisë dhe të mundte të arrinte në poste me përgjegjësi në pushtet e në Parti.

Është një ngjarje e keqe që në radhët tona qëndronte një armik i tillë, po çdo e keqe ka edhe anën e saj pozitive. Partia u pastrua kështu nga një tradhëtar që kishte depërtuar në radhët e saja dhe kishte mundur të arrinte deri në Komitetin Qendror. Pastrimi i Partisë nga të tillë elementë armiq nuk e dobëson,

po përkundrazi e forcon më shumë Partinë, unitetin e saj dhe e bën më të fortë për realizimin e detyrave të saja të shenjta në interes të popullit tonë.

Nga ky rast Partia jonë duhet të nxjerrë mësimet e dhura për të forcuar akoma më shumë vigjilencën revolucionare kundër armiqve të saj dhe të pushtetit tonë popullor në të gjitha hallkat e Partisë dhe të pushtetit dhe të mos mendohet për asnjë moment se armiku ka lidhur duart, sepse ai, me gjithë goditjet që ka ngrënë, vazhdon dhe do të vazhdojë të punojë me të gjitha mjetet dhe mënyrat për të na penguar e dëmtuar në punën tonë. Prandaj, ashtu siç na ka mësuar kurdoherë Partia, ta forcojmë edhe më shumë konspiracionin dhe të ruajmë me kujdesin më të madh sekretin e Partisë dhe të shtetit në detyrat që jemi ngarkuar.

Përmbajtja e kësaj letre t'u komunikohet organizatave bazë të Partisë në mbledhjet e tyre të zakonshme duke theksuar në to edhe një herë rëndësinë e forcimit të vazhdueshëm të vigjilencës, të konspiracionit dhe të unitetit të radhëve të Partisë.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## SECILI TË REALIZOJË DETYRAT E VETA DHE PUNA TË MATET ME REZULTATE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

24 maj 1957

Ardhja juaj këtu<sup>2</sup> duhet t'u shërbejë komiteteve të Partisë të rretheve që përfaqësoni për të realizuar më mirë në të ardhshmen detyrat që keni përpara. Eksperiencia e hidhur e vitit të kaluar duhet t'ju shërbejë për të nxjerrë mësim në organizimin e punës dhe në arritjen e rezultateve më të mëdha në bujqësi, për të mos përsëritur gabimet që janë dukur në metodën e drejtimit.

Ky vit bujqësor paraqitet më i mbarë se viti i kaluar, gruri në përgjithësi është mirë, pambuku u mboll

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje të Sekretariatit të KQ të PPSH u diskutua mbi realizimin e fushatës korrje-shirje-grumbullim në qarqet Shkodër e Gjirokastrë dhe mbjelljen e pambukut në rrethet Durrës, Fier e Lushnjë.

<sup>2</sup> U drejtohet sekretarëve të komiteteve të Partisë të qarqeve e të rretheve që ishin thirrur në këtë mbledhje të Sekretariatit.

brenda afatit, frutat nuk janë keq, për mbjelljen e misrit duhen marrë masa që të shpejtohet puna.

Shira sivjet kanë rënë mirë, bari është rritur. Po shirat edhe na kanë dëmtuar. Këto dëme nuk janë aq të mëdha sa të krijohet psikoza e pasigurisë dhe e alarmit. Dëmet t'i vlerësojmë aq sa janë dhe të përpiqemi t'i plotësojmë e jo të kërkohet zbritja e detyrimeve. Kjo do të thotë që pambuku i dëmtuar të rimbillet dhe, po i kaloi afati, të mbillet misër. Pra gjendja dhe detyrat në bujqësi kërkojnë një mobilizim më të madh.

Në radhë të parë duhet të mobilizohet Partia. Partia dhe udhëheqja e saj të vënë mirë përpara përgjegjësisë jo vetëm komunistët në fshat për të mobilizuar masat, po edhe komunistët e njerëzit pa parti që punojnë në pushtet, me qëllim që të gjithë të realizojnë detyrat e ngarkuara. Teknikët dhe specialistët e bujqësisë të venë të gjithë në fushë dhe jo të merren me formularë e statistika duke qëndruar nëpër zyra. Puna konkrete në terren, mobilizimi i njerëzve, kjo është kryesorja.

Mua më duket se forcimi i punës në kooperativat bujqësore u është lënë më shumë komiteleve të Partisë, ndërsa organet shtetërore nuk interesohen sa duhet. Kështu për shembull Komiteti Ekzekutiv i KP të Gjirokastrës nuk bën detajimin e pesëvjeçarit në çdo kooperativë, ndërsa ai duhet jo vetëm ta bëjë kütë plan, por të ndjekë edhe realizimin e tij. Prandaj Partia të kërkojë llogari për kryerjen e detyrave nga ana e organeve të pushtetit, të forcojë edukimin, disiplinën dhe mobilizimin e tyre në punë. Komiteti ekzekutiv të kujdeset për të forcuar punën në SMT e të ndjekë kurset e traktoristëve, programin, disiplinën në punë etj.

Partia të mos pajtohet me çdo shfaqje të burokratizmit në veprimtarinë e aparateve të pushtetit.

Në lidhje me grumbullimin duhet gjithashtu të tregohet më shumë kujdes. Nuk është puna që organet e pushtetit të pregatitin vetëm planin, por të vënë mirë dorë në realizimin e grumbullimit. Kjo punë nuk duhet bërë nga komitetet e Partisë, po të mobilizohen mirë njerëzit që janë ngarkuar me këtë përgjegjësi. Realizimi i detyrave nga secili të bëhet metodë pune dhe puna të matet me rezultate.

Edhe dezinfektimi i depove ka rëndësi dhe kjo detyrë duhet kryer, po kryesorja është që bereqeti të prodhohet e të grumbullohet. Këtu duhet të përqëndrohet vëmendja kryesore, pse ta marrësh bereqetin nga toka dhe ta grumbullosh atë në depo, është më vështirë se sa të bësh dezinfektimin e këtyre të fundit. Kontraktimet janë fillimi, realizimi i tyre ka rëndësi të madhe dhe kjo duhet të ngrejë në këmbë organet përgjegjëse. Në këtë drejtim duhet shumë punë, durim dhe kujdes, pse detyrat nuk plotësohen duke marrë masa administrative ose duke përjashtuar komunistë nga Partia.

Një nga sektorët ku pushteti duhet të punojë më mirë është ai i tregëtisë. Kooperativat e shitblerjes në fshat të konsiderohen si mjet i rëndësishëm për forcimin e aleancës midis klasës punëtore dhe fshatarësisë punonjëse. Kjo të mos jetë një parullë boshe, por të përbëjë një program konkret pune për të gjithë njerëzit, komunistë e pa parti. Është e domosdoshme që në shumë hallka të pushtetit, sidomos në lokalitete të forcohet më tej puna e komiteteve ekzekutive, të cilat shpesh-

herë janë kthyer në shpërndarës lajmërimesh ose në zyra që pregatitin shifra e statistika dhe i dërgojnë në rreth. Teknikët dhe agronomët nuk aktivizohen si duhet nga komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të lokalitetit. Të kuptohet drejt se pushteti në lokalitet nuk është vetëm kryetari, po në radhë të parë njerëzit e zgjedhur, janë dhe të gjithë teknikët, arësimtarët, punonjësit e shëndetësisë etj. Pa u aktivizuar i tërë ky aktiv njerëzish, punët nuk kryhen si duhet. Për këto çështje nuk tregon interesimin e nevojshëm as komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të rrethit, i cili duhet të merret seriozisht me forcimin e organeve të tij vartëse në të gjitha hallkat, me qëllim që këto të edukohen e të mësohen për të drejtuar gjithnjë e më mirë. Nga ana tjetër, disa njerëz që punojnë në organet e pushtetit interesohen vetëm për sektorin e tyre dhe jo sa duhet për sektorët e tjerë. Është e vërtetë që secili duhet të përgjigjet për detyrat që ka në sektorin e vet, por, kur e lyp nevoja, është e domosdoshme që të përqëndrohet atje ku gjendja është e dobët dhe kërkon të forcohet. Prandaj drejtues i mirë është ai që mobilizohet jo vetëm për të plotësuar detyrat në sektorin e tij por kudo që puna nuk ecën.

Partia çdo vit fiton eksperiencë, mëson dhe perfeksionohet për të udhëhequr gjithmonë e më mirë. Por punë më të mëdha na presin, mobilizimi duhet të vejë duke u rritur kudo. Ne e dimë që ju nuk ju zë gjumi për të kryer detyrat e Partisë, por mos harroni që të organizoni punën duke rritur më tepër mobilizimin total të të gjithë punonjësve. Ndryshe punët nuk mund të realizohen si duhet.

Partinë e kemi të fortë, pavarësisht se del një tradhëtar si Panajot Plaku, i cili ka ditur mirë të maskojë punën e tij armiqësore duke punuar nën rrogëz. Kjo është luftë, armiku punon, ai e di se edhe Partia nuk fle, ajo i ka mposhtur dhe i mposht armiqtë e vet. Partia ka pasur edhe armiq më të mëdhenj dhe ka luftuar e fituar mbi ta. Megjithkëtë detyra jonë është që të jemi shumë vigjilentë ndaj armikut, të mbrojmë Partinë, ta bëjmë atë sa më luftarake, që t'ua bëjmë të pamundur armiqve veprimtarinë e tyre reaksionare. Sa më luftarake të jetë Partia, aq më shumë fitore do të kemi. Të mbajmë parasysh edhe detyra të tjera siç janë: lufta kundër familjaritetit, kërkesa e llogarisë për zbatimin e detyrave, të mos lejohen neglizhenca në punë, të kryhen detyrat deri në fund. Të kërkosh llogari nuk do të thotë të jesh i ashpër me kuadrot, por të kërkosh që të realizohen detyrat. Përpara gabimeve nuk duhen mbyllur sytë. Është e domosdoshme që gabimet të luftohen me guxim. Të dimë të dallojmë armikun nga njeriu ynë që gabon, por që s'është armik. Kështu nuk do të lejohen situata të sëmurë. Më shumë vigjilencë edhe për mbrojtjen e sekreteve shtetërore. Ndjenja e ruajtjes së sekretit duhet të jetë te çdo njeri. Secili të dijë atë që i intereson, të cilën s'ka pse ta dijë ai tjetri. Kjo jo vetëm për dokumentat, po edhe në bisdat që zhvillohen. Armiku i mbledh fjalët një nga një. Prandaj çështjet e punës nuk duhen bërë muhabete jashtë. Të gjitha këto të futen në gjak dhe te njerëzit të bëhen edukatë, sepse të tëra duhen, edhe ekonomia, edhe vigjilencia, edhe edukimi i kuadrove, edhe puna ideologjike e Partisë.



Kërkesat që u bënë këtu për kombajna apo traktorë, t'i kenë parasysh shokët e bujqësisë, po kryesorja është që ju, shokë të rretheve, të mobilizoheni tërësisht, ndihma nuk do t'ju mungojë dhe mos harroni që të shfrytëzohen si duhet edhe mjetet e veglat që kemi.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

**LETËR NGUSHULLIMI DËRGUAR NË EMËR TË  
KOMITETIT QENDROR PRINDËRVE TË USHTARIT  
GOR TRIFONI**

25 maj 1957

PRINDËRVE TË USHTARIT GOR TRIFONI,  
DHIMITËR DHE FOTINA TRIFONI

*F i e r*

Të dashur prindër të ushtarit Gor Trifoni,

Morëm letrën tuaj në të cilën shprehni ndjenjat tuaja më të thella të besnikërisë ndaj Partisë dhe qeverisë sonë, me rastin e vdekjes së parakohshme të birit tuaj, ushtarit të popullit tonë, Gorit, në krye të punës për ndërtimin e Hidrocentralit «Enver».

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë, ju dërgon ngushullimet e tij më të përzemërta për vdekjen e birit tuaj të shtrenjtë dhe ndërtuesit të socializmit në atdheun tonë, Gor Trifoni.

Kjo ngjarje e hidhur ka prekur thellë zemrat tona. Ashtu sikurse shkruani ju, djali juaj dha jetën e tij në

frontin e punës, për lulëzimin e atdheut, për ndërtimin e jetës së re dhe të lumtur. Qëllimi i shenjtë i Partisë sonë është ndërtimi i socializmit dhe i komunizmit, për t'i siguruar popullit tonë një jetë të lumtur e të begatshme dhe për këtë qëllim punoi dhe vdiq biri juaj i shtrenjtë, Gori.

Partia jonë e Punës duke u mbështetur në vullnetin dhe besimin e patundur të masave punonjëse për ndërtimin e socializmit, ashtu siç shkruani edhe ju, me siguri do ta bëjë atdheun tonë të dashur, në një kohë sa më të afërt, një kopësht të lulëzuar, në luftë të paprerë kundër armiqve që do të na pengojnë në këtë rrugë të lavdishme.

Vendosmëria, vullneti në punë dhe patriotizmi i birit tuaj, do të na mbeten të paharrueshëm, ata do të frymëzojnë brezin tonë të ri për ndërtimin e socializmit dhe mbrojtjen e paqes.

Për Komitetin Qendror të PPSH

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## **NË LIDHJE ME PREGATITJEN E KUADROVE PËR KOOPERATIVAT BUJQËSORE**

*Letër dërguar komiteteve të Partisë në qarqe e rrethe*

27 maj 1957

**KOMITETEVE TË PARTISË TË QARQEVE  
DHE TË RRETHEVE**

Detyrat që shtroi Kongresi III i PPSH për kolektivizimin e bujqësisë po realizohen me sukses. Fshatarësia jonë punonjëse, e bindur në drejtësinë e vijës së Partisë, po futet gjithnjë e më shumë në rrugën e kolektivizimit.

Partia vazhdimisht ka theksuar se organizatat e Partisë dhe organet shtetërore duhet të preokupohen gjithnjë e më tepër për problemin e kolektivizimit të fshatit dhe për forcimin e gjithanshëm të kooperativave bujqësore ekzistuese. Faktori kryesor në këtë drejtim është kuadri. Duke marrë parasysh se kolektivizimi i bujqësisë sot po merr proporcione të gjera, del shumë e nevojshme përgatitja në mënyrë sistematike e kuadrit

drejtues dhe specialist. Për këto arsye është e nevojshme që në shkollat tona bujqësore, në radhë të parë, të përgatiten kadro për kooperativat bujqësore. Prandaj nga ana juaj, përveç seminareve dhe kurseve të shkurtëra që do të organizoni, të bëhet problem i organizatave bazë të Partisë në kooperativat bujqësore, që gjithë kadrot kryesorë drejtues të kooperativave bujqësore, të cilët kanë kryer të paktën shkollën 7-vjeçare, të ndjekin teknikumet bujqësore me korrespondencë (teknikumet më të afërta). Ndërsa ata që s'kanë mbaruar as shkollën 7-vjeçare të regjistrohen e të vazhdojnë këto shkolla. Njëkohësisht duhet të merren masa, që, qysh nga viti shkollor 1957-1958, të dërgohen në teknikumet bujqësore djemtë ose vajzat e kooperativistëve me fondet e vetë kooperativave, me konditë që këta të përgatiten kadro specialistë për vetë kooperativën që i ka dërguar. Për këtë t'u vihet detyrë organeve shtetërore që sipas planit të dërguar nga Ministria e Bujqësisë, kontingjenti i planifikuar me pagesë, të jetë kryesisht nga kooperativat bujqësore. Një planifikim i tillë i përgatitjes së kadrit do të sjellë si rezultat që kooperativat bujqësore në një të ardhshme të afërt të kenë kadrot e tyre të nevojshëm.

Për realizimin e kësaj direktive do të dalin edhe vështirësi. Mjaft nga kooperativistët nuk janë të qartë lidhur me këtë problem. Ata kërkojnë që fëmijët e tyre t'i vënë në punë për të fituar më tepër ditë-punë dhe hezitojnë t'i dërgojnë në shkolla. Për këtë komitetet e Partisë duhet të bëjnë një punë të madhe sqaruese në radhë të parë me organizatat bazë të Partisë, të ngrihet çështja në seminare të ndryshme që organizohen, në

mbledhjet e asambleve etj. T'u tregohen perspektivat e kolektivizimit të bujqësisë në vendin tonë, detyrat e mëdha që dalin përpara bujqësisë sonë, realizimi i të cilave kërkon kuadër të mjaftueshëm dhe të kualifikuar.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## FJALA NË KONFERENCËN NACIONALE PËR ZHVILLIMIN DHE PËRMIRËSIMIN E BLEGTORISË DHE PROBLEMIN E BONIFIKIMIT TË TOKAVE

2 qershor 1957

Shokë,

Vendimi që mori Plenumi i Shkurtit i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë në lidhje me zhvillimin e mëtejshëm dhe përmirësimin e blegtorisë<sup>1</sup>, ka ushtruar një influencë të rëndësishme në ekonominë e vendit tonë. Është fakt se ky vendim i Komitetit Qendror ka ngjallur në masat e gjera të popullit dhe veçanërisht në njerëzit e blegtorisë një interesim shumë më të madh.

Në këtë konferencë u muar në studim vetëm çështja e deles. Këtu diskutuan shumë shokë të bazës që merren drejtpërsëdrejti me rritjen e deles, si brigadierë, kryetarë kooperativash blegtorale, specialistë veterinerë, zooteknikë etj. Kjo tregon se për këtë problem kaq të rëndësishëm është i interesuar populli ynë për arsye se zhvillimi i mëtejshëm i blegtorisë dhe veçanërisht i deles, përbën një pasuri të madhe. Ne i kemi të gjitha

---

<sup>1</sup> Është fjala për Plenumin III të KQ të PPSH.

mundësitë që traditat shekullore dhe dashurinë që ka populli ynë për bagëtinë e veçanërisht për delen t'i shfrytëzojmë si një bazë të shëndoshë për të hedhur hapa akoma më të mëdhenj përpara. Mirë e theksuan shumë shokë këtë çështje, se populli ka jetuar me delen, kjo e ka ushqyer, e ka veshur, ka qenë një nga burimet kryesore të jetesës.

Dashurinë e popullit tonë për bagëtinë e kanë kënduar poetët tanë të mëdhenj të Rilindjes:

«O, sa bukuri ka tufa! sa gas bije bagëtia!  
Vijnë posi blet' e plotë, i bekoftë Perëndija!»<sup>1</sup>

ka kënduar Naimi.

Regjimet antipopullore e kanë përbuzur këtë sektor kaq të rëndësishëm, e kanë lënë zhvillimin e delës në spontaneitet, kanë përbuzur përparimin, shkencën, që do t'i jepte një hov më të madh kësaj degë të ekonomisë së vendit tonë. Lufta na shkaktoi dëme kolosale në këtë sektor. Por ju e dini se në saje të pushtetit popullor edhe në këtë sektor janë kapërcyer vështirësitë; të dhënat e vitit 1938 si në numrin ashtu edhe në prodhimtarinë e blegtorisë janë tejkaluar.

Me gjithë eksperiencën shekullore të blegtorëve tanë, në të kaluarën, gjendja e bagëtisë ishte shumë prapa. Sa për agallarët, që kishin tufa të mëdha, që kishin gjithë avantazhet e regjimit të tyre, i rritnin ato, në mënyrë primitive, shumë rrallë gjeje ndonjë

---

<sup>1</sup> Naim Frashëri. «Bagëti e Bujqësi», f. 4, bot. i tretë, vitit 1961.



gjysmëtechnik, pa le veteriner ose zooteknik, të cilët numëroheshin me gisht në gjithë Shqipërinë. Po fshatarësia jonë që përbënte masën dërmuese të popullit në ç'gjendje e kishte bagëtinë? Kuptohet lehtë, ajo ishte pa bagëti, ose kishte shumë pak dhe në gjendje të vajtueshme.

Ju e dini se blegtoria nuk mund të ecë e veçuar nga bujqësia, por, në gjendjen që e kishte lënë këtë regjimi i agallarëve dhe i bejlerëve, ishte e pamundur që fshatarësia jonë të rriste bagëti të shëndoshë dhe prodhuese. Është e ditur se për të pasur një blegtori të mirë dhe prodhuese duhet medocemos të sigurohet ushqim, strehim, të depistohen dhe të luftohen sëmundjet. Për të gjitha këto duhen kuadro, mjete etj. Këto gjëra në të kaluarën nuk ekzistonin, bile as në tufat e mëdha që kishin agallarët, pa lëre pastaj ç'bëhej me bagëtitë e pakta të fshatarëve. Fshatari nuk kishte as tokën e tij ku të mbillte misrin ose tërshërën pa le kullotën, pse kjo në shumicën dërmuese ishte prona e agallarëve ose e bejlerëve dhe kur do ta blente, do ta paguante si «frëngu pulën». Fshatari shumë herë nuk kishte as kasolle ku të fuste kokën dhe jo më pastaj të mendonte për të strehuar bagëtinë. Sa për të depistuar dhe shëruar sëmundjet e bagëtive nuk bëhej fjalë në një kohë kur regjimi i agallarëve nuk interesohet as për shëndetin e popullit. Kështu kushtet për fshatarësinë në ato kohë ishin shumë të vështira.

E kaluara e hidhur u kapërcye. Populli u çlirua, u bë zot i pasurisë së tokës së vet, pasuria e agallarëve dhe e bejlerëve u bë pronë e fshatarëve punonjës, të cilët jo vetëm u bënë me bagëti, por e shtuan atë dhe tani

janë shumë të interesuar ta shtojnë dhe ta përmirësojnë edhe më tej.

Rëndësi të madhe për rritjen dhe përmirësimin e blegtorisë ka eksperiencia e popullit tonë, praktika shekullore e tij, por kësaj eksperiencie duhet t'i shtojmë përparimet e shkencës, metodat e reja dhe të zhdukim çdo gjë që është prapanike, e vjetëruar, e dëmshme.

Ne e dimë se sa përpara kanë ecur shumë vende të tjera të botës në lidhje me zhvillimin e blegtorisë. Prandaj për ne vihen detyra të mëdha që të mos qëndrojmë në gjendjen ku kemi qenë ose ku jemi sot. Do të jetë gabim i madh të kënaqemi me kaq dhe të mendojmë se ne jemi në gjendje të mirë përse i përket numrit e sidomos prodhimit të bagëtive tona në mish, qumësht, lesh etj. Përkundrazi jemi shumë prapa. Partisë, pushtetit dhe popullit tonë u vihet detyrë që në drejtim të blegtorisë të bëhet një revolucion i vërtetë, ashtu sikurse bëme revolucionin popullor, që i ndërroi krejt faqen vendit tonë, që shkatërroi bejlerët dhe feudalët, dëboi okupatorët dhe solli popullin në fuqi, ashtu duhet dhe në blegtori, së cilës duhet t'i përmirësojmë racat, të shtojmë numrin e bagëtive dhe sidomos prodhueshmërinë.

Revolucioni i madh që bëri populli, i kushtoi shumë gjak, por ai u çlirua përgjithmonë dhe përgjithmonë mposhti regjimin e feudalëve e të borgjezisë dhe nën udhëheqjen e Partisë së tij marksiste-leniniste filloi ndërtimin e veprave të mëdha në të gjitha lëmet. Më përpara në vendin tonë kishte 86 për qind analfabetë, ndërsa sot është zhdukur analfabetizmi deri në moshën 40 vjeç. Sot vendi ynë është mbushur me shkolla fillore, shtatëvjeçare, të mesme, teknikume, institute të larta,

në të gjitha anët e vendit ka kinema, teatro, shtëpi kulture, biblioteka etj. Kësaj i thonë revolucion në lëmin e kulturës.

Gjithashtu edhe në industri vendi ynë ka bërë një revolucion të vërtetë. Të mos zgjatem. Ne krijuam një industri moderne të zhvilluar. Edhe në bujqësi po ecim përpara, fshatrat po kolektivizohen, jeta zbukurohet dhe është duke u bërë edhe këtu një revolucion i madh. Por ne jemi akoma prapa në shumë sektorë të bujqësisë, prandaj duhet t'i vëmë krahët kësaj pune. Prapa jemi në zhvillimin dhe përmirësimin e blegtorisë sonë, të deleve, lopëve, derrave, shpendëve etj. Prandaj na vihen detyra të mëdha, se ky revolucion do të bëhet me punë, me djersë dhe me dituri. Këtu nuk duhet gjak.

Populli ynë është në gjendje të bëjë mrekullira edhe në këtë sektor, të ecë përpara, sepse ai bëri të gjitha këto sakrifica, nuk kurseu as jetën për të fituar lirinë dhe pavarësinë. Tash ai nuk kursen as mundin as djersën për të ndërtuar me sukses socializmin, jetën e tij të begatshme.

Përparimi i shpejtë në këtë sektor të blegtorisë do të na ndihmojë që të përmirësojmë akoma më mirë edhe më shpejt jetën e popullit. Ju e dini mirë se populli nuk do vetëm bukë po do edhe shumë gjëra të tjera. Plotësimi i nevojave të popullit varët nga ritmi i zhvillimit të ekonomisë sonë e veçanërisht nga ritmi i zhvillimit të blegtorisë, pra nuk varet aq shumë nga llogaritë që bëjnë shumë specialistë nga zyra se sa nga vrullí revolucionar i popullit. Këtë e vërtetojnë të dhënat në bujqësinë tonë. Këtë e vërtetoi në mënyrë të shkëlqyer Lufta jonë nacional-çlirimtare, që e udhëhoqi Partia

jonë heroike. Kur filluam luftën, po të kishim vajtur me llogari se si do t'u bënim ballë fashistëve italianë që kishin tanksa, topa, aeroplanë etj., ose gjermanëve që ishin të armatosur deri në dhëmbë, nuk do ta kishim bërë luftën. Por Partia i bëri ndryshe dhe drejt llogaritë, populli doli më i fortë se tanksat e armikut, vullneti i tij ishte i tillë që i theu armët e gjermanëve, kuraja e popullit ishte një armë që i kalonte mjetet moderne të luftës së armikut. Forca e Partisë që udhëhiqte luftën ishte e pakufishme dhe e pamposhtur. Prandaj u shkatërruan të gjitha llogaritë, edhe të atyre që ishin me armikun dhe që mendonin se «kishin forca të mëdha, dituri dhe eksperiencën e madhe të luftërave që kishin bërë klasat sunduese», si edhe llogaritë e atyre që lëkundeshin e nuk besonin se populli ishte një forcë e madhe që çante rrugën me sukses nëpërmjet çdo furtune.

Kështu është edhe çështja në zhvillimin tonë ekonomik. Këto probleme, natyrisht, duhet të bëhen me llogari, se pa llogari nuk mund të ecet kurrë. Por, mbi këto duhet të llogaritet fryma e madhe revolucionare që karakterizon popullin dhe Partinë tonë marksiste-leniniste. Disa shokë specialistë të shifrave, të cilëve Byroja Politike u kishte dhënë detyrë të hartonin një plan se sa qumësht duhet të merrnin nga një dele në vitin 1975, si pa gjë të keqe caktuan 42 litra. Kurse ne shohim kooperativat bujqësore dhe shumë blegtorë individualë që folën këtu se kanë arritur që tani 50, 52 e deri në 55 litra me gjithë këto të meta që ekzistojnë dhe me këtë bazë të paktë ushqimore. Nuk ecet kështu. Jeta, lufta, tregojnë se këto parashikime nuk janë me baza reale. Prandaj në të gjitha problemet nga kuadrot tanë

duhet llogari, por edhe më shumë guxim, pse guximi edhe forca revolucionare e popullit janë aq të mëdha saqë ne do të kemi medoemos suksese në të gjitha veprimet që do të ndërmarim, planet do t'i hartojmë në këtë frymë, duke shfrytëzuar të gjitha mundësitë.

Ju theksuat këtu, shokë, me të drejtë, se në këtë revolucion që po bëjmë për blegtorinë çështja e ndërzimeve artificiale zë një vend të rëndësishëm dhe vendimtar. Kjo punë që do të ndryshojë dhe do të përmirësojë racën e bagëtisë sonë, do të kryhet me sukses po të krijohet besimi i plotë në të gjithë popullin dhe veçanërisht në rritësit e bagëtisë, se ky veprim është i drejtë, shkencor, i domosdoshëm.

Dua të theksoj se një faktor i rëndësishëm për zhvillimin e blegtorisë dhe përmirësimin e racës është dashuria e madhe që duhet të ketë i gjithë populli ynë për blegtorinë. Po të duam të përmirësojmë jetën e familjeve, të kalamanëve, duhet të rritet dashuria për bagëtinë. Ndryshe ti mund t'i duash shumë familjen dhe kalamanët po ata do të mbeten pa qumësht, pa mish dhe pa lesh në rast se s'përfillet çështja e përmirësimit të racës së blegtorisë. Ti do që ata t'i veshësh ngrohtë në dimër, që të kenë këpucë të mira, që të mos u lagen këmbët dhe të mos ftohen. Po si do t'ia arrish kësaj? Këto kryesisht sigurohen nga bagëtia. Prandaj jo vetëm blegtorët, jo vetëm komunistët, por i gjithë populli duhet t'i duan kafshët dhe në radhë të parë kafshët prodhuese si delet, lopët, dhitë, derrat, shpendët etj.

Po a kemi ne mundësi të bëjmë një revolucion të tillë në blegtori? Ne i kemi këto mundësi. Së pari ne kemi popullin që e do bagëtinë, që ka tradita në këtë

sektor. Pastaj kemi racën e deles sonë, ku do të mbështetemi. Kjo racë është shumë e përshtatshme për të krijuar raca të reja. Edhe në vendet e tjera kanë ndërmarrë aksionin e madh të ndërzimit artificial për krijimin e racave të reja, por atje ka pasur lloj-lloj delesh dhe kur është bërë ndërzimi, kanë dalë një numër i madh racash të reja, kurse te ne është ndryshe. Ne nuk kemi lloje të përziera, ne përgjithësisht kemi një lloj deleje që ka fituar imunitet e rezistencë, por që ka degjeneruar në lidhje me prodhimtarinë. Prandaj kur të bëjmë ndërzimin me këtë lloj deleje, jemi të sigurtë se do të arrijmë rezultate shumë të kënaqshme, homogjene dhe jo brenda 10 vjetëve si u është dashur të tjerëve për të përmirësuar racën, por brenda një kohe shumë të shkurtër. Pra ne i kemi këto mundësi.

Pastaj ne kemi eksperiencën e Bashkimit Sovjetik në këtë drejtim, ku janë rritur dhe sprovuar të tilla raca delesh dhe kafshë të tjera që na japin mundësi të mos kalojmë nga eksperimente të kota, po ta shfrytëzojmë këtë eksperiencë drejt, me sukses dhe në një kohë të shkurtër.

Siç e dini, me qindra desh të racës kanë ardhur dhe vijnë nga Bashkimi Sovjetik, gjithashtu edhe mjete me të cilat do të bëhen këto ndërzime artificiale. Mirë e ngritën disa shokë, veçanërisht përgjegjësi i sektorit të blegtorisë në fermën e Levanit dhe unë dua të theksoj, edhe një herë, se për këta damazë që na kanë ardhur nga jashtë duhet të kemi shumë kujdes. Mundet fare lehtë që nga pakujdesia të sëmuren, prandaj edhe për ata të interesoheni që të jenë të shëndoshë, të mos sëmuren. Sidomos kujdes i madh të tregohet për kafshët

dhe damazët e racës, në radhë të parë nga Ministria e Bujqësisë, e cila nuk duhet të mjaftohet me urdhëra dhe me fjalë për t'i mbrojtur këto kafshë.

Edhe ata që i marrin në dorëzim duhet të kenë shumë kujdes për strehimin, ushqimin, mirëmbajtjen e tyre etj. Këto norma duhet të zbatohen në kohë dhe me regjimin e çaktuar. Nuk lejohet që në kohë me shi të transportohen me automobila të hapët nga Durrësi në Vlorë desh të racës dhe të sëmuren. Nga dashuria e madhe që kanë për këto kafshë, disa njerëz, të cilët i marrin në dorëzim, kapërcejnë çdo normë dhe këshillë dhe u japin të hanë jashtë masës duke i rrezikuar ato. Kjo nuk lejohet. Ato janë kafshë shumë të vlefshme dhe nga këto kafshë varet fati i të ardhshmes së blegtorisë sonë. Këto gjëra që janë krejt të mundshme, t'i bëjmë medoemos, sepse, në qoftë se nuk i mbajmë me kujdes, komprometojmë të ardhshmen e blegtorisë sonë. Prandaj përgjegjësit, blegtorët dhe gjithë populli duhet të kujdesen jashtëzakonisht për to. Siç shihet, pra, materialin për të filluar luftën e përmirësimit të dhenvë ne e kemi.

Tani që i hymë kësaj pune kemi edhe kuadrot. Pikësëpari ne kemi gjithë blegtorët tanë që kanë eksperiencën e madhe shekullore, gjë që nuk duhet ta nënvleftësojmë. Blegtorët tanë kanë eksperiencë të madhe dhe janë të gatshëm të dëgjojnë vërejtjet e teknikëve tanë. Ne kemi specialistë të vjetër, të talentuar, kemi kuadro, që kanë mbaruar shkolla të larta në Bashkimin Sovjetik e gjetkë. Kemi krijuar një numër të madh ndihmësspecialistësh për këto probleme, kemi institutet e larta agrozooveterinere që nxjerrin vazhdimisht kuadro, po hapim edhe kurse të ndryshme për sektorë

të veçantë. Të gjithë këta janë një ushtri e madhe që do të ndihmojnë për të kryer me sukses detyrat, prandaj duhet të mobilizohemi tërësisht.

Shokë, duke pasur këto mundësi ne duhet t'i vëmë kujdes të jashtëzakonshëm problemit të bazës ushqimore. Për këtë folën të gjithë shokët, po prapë edhe unë po e theksoj se kjo duhet të bëhet një çështje e madhe e Partisë dhe e popullit. Veçanërisht ju blegtorët që jetoni me bagëtitë, që i rritni dhe i përmirësoni ato, të jeni sa më afër çështjeve të bujqësisë dhe jo vetëm të pritni ç't'ju japë bujqësia, po t'u rritni mbi kokë gjithë atyre që merren me bujqësinë, sepse një pjesë e madhe e ushqimit të bagëtisë nuk duhet të sigurohet vetëm nga livadhet e kullotat, por edhe nga prodhimet e bujqësisë, nga drithërat, nga silazhimi.

Të gjitha këto do të bëhen se Partia na udhëheq drejt dhe drejtësia e vijës së saj përkrahet nga i gjithë populli. Partia duhet t'i kuptojë mirë dhe thellë çështjet e blegtorisë dhe e drejtë është kritika që bënë disa për shokët e Partisë, të cilët u janë përveshur mirë punëve për shumë kultura bujqësore, kurse çështjes së blegtorisë nuk po i vënë rëndësinë e duhur. Disa i vënë rëndësi vetëm ndarjes së kullotave. Po nuk është vetëm kjo çështja e blegtorisë. Pa i siguruar ushqim bagëtisë s'mund të bëjmë hapa përpara për përmirësimin e racës dhe si konsekuencë për shtimin e prodhimit. Sa t'i japësh për të ngrënë bagëtisë aq do të japë dhe ajo të hash prej saj. Baza ushqimore tani duhet konsideruar shumë e dobët. Mundësitë i kemi ta përmirësojmë. Në radhë të parë, duhet kuptuar që bagëtia s'mund të mjaftohet duke kullotur vetëm jashtë. Duhet t'i përgatitet



edhe ushqim për stallë, duhet t'i përgatitet ushqimi i mjaftueshëm për dimër. Kullotat medoemos duhet të spastrohen totalisht. Dhe kjo të bëhet një aksion i madh i Partisë, i rinisë, i të gjithë popullit. Këto kullota duhet të përtërihen e të pasurohen me florë të ushqyeshme. Në radhë të dytë kudo duhet të mbillen hasëllet në shkallë më të gjerë e sidomos misër foragjer. Të përgatitet kudo silazh për të cilin të shfrytëzohet çdo bimë që nga ferrat e deri te gjembi i gomarit i cili i silazhuar është shumë i ushqyeshëm. Silazhi i fletës së dushkut është një ushqim i mrekullueshëm, kot s'e përdor populli, por vetëm duhet silazhuar. Duhet t'i kushtohet kujdes i veçantë jonxhës.

Me një fjalë, ju e rrahët dhe e ilustruat kaq mirë këtë problem vendimtar sa tani na mbetet t'i përvishemi punës me të gjitha fuqitë tona.

Kryqëzimi i deles së vendit me racat merinos, cigaja e rudë do të bëjë që të përmirësohet delja jonë dhe të rritet kështu prodhimtaria e saj në lesh, qumësht dhe mish. Delja jonë e vendit, recka si e quajnë zakonisht, që peshon mesatarisht 26 kg., jep 40 kg. qumësht dhe 1,05 kg. lesh. Duke e përmirësuar delen e vendit me racat e lartpërmendura parashikohet që pesha të arrijë mesatarisht në 33 kg. dhe të japë 42 kg. e lart qumësht dhe 2,8 kg. lesh. Provat që janë bërë në këtë drejtim nga ndërmarrjet tona bujqësore tregojnë se në vendin tonë ekzistojnë të gjitha mundësitë për arritjen e këtyre rezultateve.

Përmirësimi i racës së deles, dhe si rrjedhim shtimi i prodhimeve blegtorale, do të jetë një tjetër fitore e madhe për popullin tonë, prandaj Partisë i bie detyra

ta marrë vetë në duar këtë aksion dhe në krye të popullit, tok me të të dalim me sukses.

Po të flasësh për delen do të bësh gabim ta shkëputësh nga bagëtitë e tjera. Ju thashë edhe më përpara se do t'ju jepja disa shifra për të pasur një ide se sa prapa jemi ne me prodhimet blegtorale. P.sh. në vendin tonë për çdo frymë prodhohet 10-11 kilogram mish në vit. E ç'është kjo? Asgjë. Qumësht prodhohet 90-95 litra, kurse vezë 70-75 kokrra në vit. Merreni me mend si ka qenë situata e vendit tonë përpara çlirimit. Prandaj na vihet detyrë që, për të shtuar këto norma, të bëhet një luftë shumë e madhe.

Ne themi se në vendin tonë kemi shumë bagëti. Por nuk është kështu. Për çdo 12 banorë ne kemi një lopë, çdo banori i bie 1 e 1/4 e deles. Kjo është shumë pak, sidomos kur mendojmë se popullsia e vendit tonë shkon duke u shtuar me hapa të mëdhenj dhe mirë është që ngjet kështu. Ky shtim i shpejtë i popullsisë ndodh në saje të përmirësimit të jetesës së punonjësve. Llogaritet se, duke ecur me këtë ritëm, në vitin 1975 ne do të arrijmë afër dy milion e gjysmë njerëz. Po të gjithë këta duhet të ushqehen dhe bile të ushqehen mirë, të vishen mirë dhe të bëjnë një jetë të kulturuar. Prandaj, duke marrë parasysh këto, duhet t'i përvishemi një pune jashtëzakonisht serioze që të arrijmë një nivel shumë më të lartë nga ai që kemi sot, sepse prodhueshmëria e kafshëve tona është shumë e ulët.

Nga llogaritja del se rrethi i Tiranës për çdo njeri merr 35 litra qumësht, i Durrësit — 57, i Beratit — 66 etj. Kjo sasi qumshti merret te ne nga lopët, nga delet dhe nga dhitë së bashku. Në rrethin e Tiranës merret

11 kilogram qumësht lope për çdo njeri, në Berat — 15, në Vlorë — 26, në Durrës — 25, në Lushnjë — 35, në Skrapar — 34 dhe vetëm në Tropojë prodhohet 108 kilogram qumësht për frymë që është sasia më e madhe në vendin tonë.

Po pse ndodh kështu? Kështu ndodh për arsye të atyre që thamë dhe për shkak të mungesës së bazës ushqimore. Kryetari i komitetit ekzekutiv i rrethit të Peshkopisë solli këtu një shembull në lidhje me sigurimin e ushqimit të bagëtisë në vend, për dimër. Ata krijuan mundësinë që nga 20 mijë kokë dele që shtegëtonin gjithmonë, vjet shtegëtuan vetëm 5 mijë dhe ky shembull i mirë duhet të merret nga të gjithë e të zbatohet, jo vetëm në vendet që nuk kanë kullota dimërore, por edhe në ato që kanë, si për shembull në Gjirokastrë. Mos kërkonin nga qeveria dhe nga Komiteti Qendror, shokë të Gjirokastrës, që «sa të jetë e mundur të na dërgohen më pak bagëti për dimër, sepse kemi kullota sa për bagëtitë tona». Atje do t'ju vijnë bagëti edhe nga vende të tjera, prandaj duhet të merren po ato masa që kanë marrë Peshkopia dhe Kukësi, me të cilat kanë rregulluar situatën. Kjo ka shumë rëndësi.

Flitet shumë te ne për prodhueshmërinë e ulët të blegtorisë. Ne kemi bërë një program të gjerë për përmirësimin e racave të bagëtisë, por për ta realizuar këtë duhet siguruar para së gjithash baza ushqimore, pa ushqim asnjë lloj bagëtie nuk mund të përmirësohet. Nuk jam plotësisht dakord me atë shokun që e vuri në radhë të tretë problemin e bazës ushqimore. Pa ushqim si njerëzit ashtu edhe bagëtitë treten, hollohen, bëhen fole mikrobesh. Ne kemi shembuj që tregojnë se atje

ku ka interesim për sigurimin e ushqimit të bagëtisë ka prodhime më të mëdha. Për shembull në kooperativën bujqësore të Cakranit është përmirësuar gjendja ushqimore e blegtorisë. Kjo solli si rezultat që në vitin 1956 atje u morën 845 litra qumësht nga çdo lopë, nga lopët tona të vogla që nuk t'i zë syri. Instituti i zoteknisë, nga lopët e vendit, raca shkodrane, ka marrë mesatarisht 1 800 litra qumësht në vit. Të mos flasim këtu për lopët me prodhim rekord që kanë arritur të japin 3 000-4 000 litra në vit. Kjo tregon se kur përmirësohet baza ushqimore, dhe kushtet ekzistojnë për këtë, ne mund të marrim prodhime shumë më të mëdha.

Atëhere pse të mos mendojmë që në vitin 1958 të realizojmë planin e dytë pesëvjeçar përsa i përket prodhueshmërisë së bagëtive? Pse të mos e studjojmë dhe ta marrim këtë vendim, pse të frikësohemi derisa kemi këta shembuj konkretë si në blegtorët privatë ashtu dhe në kooperativat bujqësore? Kjo do të thotë që ne ta realizojmë planin pesëvjeçar jo në vitin 1960, po të luftojmë për ta realizuar që më 1958. Ç'do të thotë kjo? Po të marrim këtë inisiativë, kjo do të thotë të marrim mesatarisht si Republikë jo më pak se 700 kilogram qumësht nga çdo lopë, në kooperativat bujqësore — 1 000-1 200 kilogram dhe në ndërmarrjet bujqësore shtetërore deri 2 500 kilogram.

Shumë shokë hapin sytë për këto gjëra, tremben. Po nuk duhet të tremben. Në rast se lidhim duart, në rast se ecim me ritmet e deritanishme dhe nuk luftojmë paragjykimet dhe ngathtësinë, natyrisht nuk mund t'i arrijmë këto shifra. Por Partia që udhëheq masat e popullit, si edhe blegtorët tanë janë në gjendje t'i krijojnë

këto kushte dhe të arrijnë këto rezultate. Ne mendojmë se këto janë reale. Prandaj jo vetëm për çështjen e deleve, por edhe për atë të lopëve. dhe kjo ka rëndësi të madhe, në planet e ardhshme ne duhet të bëjmë një hap të madh në këtë drejtim që të sigurojmë sasinë më të madhe të qumshtit nga lopët.

Kisha edhe disa vërejtje.

Që të marrim më shumë qumësht prej lopëve, duhet t'u sigurojmë më shumë bar të njomë. Kjo mund të arrihet fare lehtë në qoftë se në çdo ndërmarrje dhe kooperativë bujqësore sigurohet ajo që quhet konvejer i gjelbër. Në qoftë se në çdo kooperativë e ndërmarrje bujqësore mbillen në afate të ndryshme, pas 10-15 ditësh, tërshëra vjeshtake për hasëll me mollëz, buxhak etj., jonxha, misri, sudangrasi, barërat e tjera njëvjeçare dhe shumëvjeçare, kulturat foragjere bostanore etj., bagëtitë do të kenë të siguar vazhdimisht barin e gjelbër dhe të freskët. Sa më shumë të kemi barëra të tillë, aq më shumë do të kemi edhe qumësht. Lopët mund të hanë brenda ditës 20-25 kilogram bar të njomë ose 30-35 kilogram misër foragjer, sepse ky ka më shumë sheqer. Ushqimi i gjelbër është ushqimi më i vlefshëm për bagëtitë. Ne kemi mundësi t'i furnizojmë tërësisht bagëtitë me këtë lloj ushqimi të vlefshëm.

Ne kemi eksperiencë pozitive në sigurimin e bagëtitive, në kohë dimri me bar të njomë nga mbjelljet e tërshërës në vjeshtë, në formë hasëlli. Për këtë duhen zgjeruar në maksimum sipërfaqet e mbjella me hasëlle për ushqim të gjelbër. Veç kësaj nevojiten edhe ushqime të tjera. Gjithashtu lopët në periudhën e dimrit veç ushqimeve të gjelbëra kanë nevojë edhe për silazh, sidomos

prej misri foragjer. Prandaj duhet ta shtrojmë si detyrë që për vitin 1957-1958 të sigurojmë mesatarisht për çdo lopë jo 0,7 ton silazh, siç parashikohet në planin e këtij viti, por të paktën 2,3 ton dhe në ndërmarrjet shtetërore, në kooperativat e përparuara nga 4,5 e më shumë ton për çdo lopë.

Për këtë qëllim duhet zgjeruar në mënyrë të gjithanshme mbjellja në hamullore e misrit foragjer; duhet të silazhohen kashtrat e misrit pas vjeljes së prodhimit, duke mos lejuar që ky ushqim i vlefshëm të priset, të kalbet pa u shfrytëzuar në dobi të prodhimit.

Këto detyra ka mundësi të realizohen se vendi ynë i ka kushtet për këto gjëra, si nga pikëpamja e klimës, ashtu dhe nga toka. Por, shokë, ne duhet të marrim masa serioze në këtë drejtim, p.sh. të sigurojmë sa më shumë mbjellje në hamullore. Kështu si deri tani nuk mund të ecet, dhe kjo çështje nuk mund të lihet në mëshirën e fatit aq sa të vijë puna që të mos realizohet as plani që kemi caktuar.

Po si të bëhet atëhere? Unë mendoj të veprohet kështu: Të korret gruri sa më shpejt, të punohet toka dhe të mbillen menjëherë hamulloret, sidomos sivjet që klima na ka favorizuar, në mënyrë që t'i kapërcejmë tri herë më shumë sipërfaqet e mbjella me hamullore. Prandaj pas grurit duhet të fillojmë të mbjellim menjëherë misër, jo vetëm për kokërr, por edhe për foragjer. Këtë kemi mundësi ta bëjmë. Në qoftë se ka vend ku mund të merren 2-3 prodhime në vit nga toka, ky është vendi ynë. Prandaj pse të mos i shfrytëzojmë këto mundësi? Këtë duhet ta kuptojmë mirë, sidomos fshatari ynë dhe SMT-të, të cilat duhet të jenë në ga-

tishmëri të plotë që pas korrjes së grurit të punojnë menjëherë tokat për mbjelljen e misrit foragjer. Të thyhet rezistenca dhe dembelizmi i disa fshatarëve që e korrin grurin dhe nuk kujtohen ta ngrenë shpejt, po e lënë në arë, ku një pjesë shkundet ose e hanë zogjtë dhe përveç kësaj pengohet edhe punimi i tokës menjëherë pas korrjes.

Edhe vjet dhamë direktiva të tilla po nuk u realizuan si duhet. Tani, do apo nuk do ndonjë fshatar, toka të punohet dhe misri të mbillet; ai do të shohë se ky detyrim do t'i sjellë të ardhura. Por ne kemi shumë besim se fshatarët do ta kuptojnë këtë, prandaj duhet të marrim masa të tilla.

Kur marrim një vendim për të ngritur planin e prodhimit të blegtorisë për kokë, duhet t'i sigurojmë lopës normat ushqimore të planifikuara dhe për këtë qëllim duhet të bëjmë që foragjeret të mbillen. Po ç'ndodh në fakt? Të marrim për shembull rrethin e Tiranës. Këtu, në vend që të zbatohen format që u thanë, misri të këputet përpara se të bjerë në dyllë dhe kashta të silazhohet me kujdes, tiranasve nuk u bëhet vonë ta mbjellin misrin në kohë. Kështu, kur vjen puna për ta vjelë, i bëjnë togje-togje dhe ka raste që mund të shkosh edhe në janar e këto t'i gjesh akoma në arë, në vend që atë kashtë të vlefshme fshatari ta silazhojë sa më parë për të siguruar ushqim për lopët që të prodhojnë qumësht sa më shumë. Kështu fshatari i sjell dëm ekonomisë së tij dhe gjithë ekonomisë popullore. Fshatari i Tiranës vjen përditë në pazar për të shitur dy litra qumësht në vend që t'i vihet më me forcë bujqësisë që këto dy litra t'i bëjë gjashtë,

se duke e ushqyer më mirë, bagëtia do t'i japë më shumë. Prandaj mbjellja e hamulloreve dhe silazhimi i misrit kanë rëndësi shumë të madhe për ushqimin e bagëtisë.

Shumë njerëz mendojnë se silazhi duhet të bëhet medoemos në kullota ose në kanalet e gropat e veshura mirë anash, silazh transhe. Të tilla ndërtime janë të nevojshme, se ato japin një cilësi të lartë silazhi. Por në të gjitha vendet e demokracisë popullore dhe në Bashkimin Sovjetik janë përhapur herët mënyrat e ndryshme të silazhimit mbi tokë, që përjashtojnë nevojën e ndërtimit të objekteve për këtë qëllim. Ushqimet silazhohen direkt në gropat ose i veshin ato me mburojë prej dërrasash e mjete të tjera dhe mbi to vendosen mbulesa. Te ne, atje ku ka mundësi, këto gropa le të bëhen edhe me çimento, po, atje ku nuk ka, mund të bëhen me gurë, me tulla, me thupra etj.

Shokët drejtues dhe specialistë duhet të jenë pak më elastikë në kërkesat, të jenë të lidhur me jetën dhe praktikën dhe të mos rekomandojnë gjëra që nuk jemi në gjendje t'i bëjmë tani. Në Kore, për shembull, e kanë zgjidhur çështjen e ushqimit të bagëtive vetëm me misër foragjer. Kur shkuam vjet atje ne nuk pamë asnjë pëllëmbë tokë të papunuar. Në shumë anë pamë ara të mëdha me misër deri në dy metra të lartë. Nga toka koreanët marrin 2-3 prodhime në vit, por punojnë. Ju e dini se lufta i shkatërroi ata e si pasojë fshatarët rrojnë akoma në kasolle me kashtë. Merreni me mend si po rindërtohet gjithë ai vend, prandaj përpara nevojave të ngutshme ku t'i gjejnë gjithë ata hekura dhe çimento për të bërë edhe gropa silazhi? Tani për tani



atje hapin gropa në tokë ku hedhin ushqimet e silazhuara e njëkohësisht marrin edhe masa t'i mbulojnë me kujdesin më të madh që të mos prishen. Pra, çështja e misrit foragjer dhe për kokërr, ka rëndësi të madhe, prandaj menjëherë edhe te ne të mbillet sa më shumë ky misër pas korrjes së grurit, veçanërisht atje ku tokat janë të ujtitshme. Kjo të bëhet në shkallë të gjerë. Po qe se edhe ne do të mund ta organizojmë punën, në mënyrë që e gjithë kashta e misrit të mblidhet dhe të silazhohet me kohë, të mblidhet dhe të silazhohet kashta e të lashtave së bashku me ushqimet e lëngshme, të shfrytëzohen për silazh edhe mbeturinat e kulturave të perimeve, ne do të kemi mundësi t'u sigurojmë lopëve mesatarisht 7-10 ton silazh me cilësi të lartë.

Midis problemeve që kanë të bëjnë me shtimin dhe përmirësimin e blegtorisë nuk duhet lënë në harresë edhe çështja e strehimeve, veçanërisht për kafshët e racës dhe ato të përmirësuara. Ndërtesat për kafshët duhet të jenë të thjeshta dhe të bazuara në zhvillimin perspektiv të blegtorisë gjatë 10-15 vjetëve të ardhshëm. Këtu nuk duhen teprime, sikurse ndodh në ndërtimet e kushtueshme. Ndërtesat duhet të jenë të tilla që t'i mbrojnë kafshët nga moti i keq, të kenë mjaft dritë, të jenë pa lagështi, të bollshme dhe të lira.

Këtu u tha që për të arritur rezultate të mira është e domosdoshme të organizojmë garat socialiste ndërmjet kooperativave dhe ndërmarrjeve bujqësore, për realizimin e planit të dytë pesëvjeçar që në vitin 1958, sidomos përsa i përket prodhimtarisë së blegtorisë. Në blegtori nuk shihet një aktivitet i gjallë si në shumë sektorë të tjerë, prandaj këto gjëra të mos nënvleftëso-

hen. Unë propozoj të merren angazhime edhe për këtë sektor. Për ç'arësye kooperativat bujqësore të mos lidhin që tani kontrata dhe të mos hyjnë në gara duke parashikuar në to zotime për të marrë që këtë vit jo më pak se 1 000 - 2 000 kilogram qumësht për çdo lopë, kurse ndërmarrjet bujqësore shtetërore 2 500 - 3 000 kilogram qumësht në vit dhe kjo vetëm duke silazhuar nga 3-5 ton mesatarisht për çdo lopë në kooperativat dhe nga 5-7 ton në ndërmarrjet bujqësore shtetërore. Ne do t'i propozojmë qeverisë që për këto masa nxitëse të caktohen edhe stimuj për të gjithë blegtorët që do të arrijnë rendimente të larta.

Një e metë e rëndësishme, që ne duhet ta zhdukim, është mungesa e bagëtive në kooperativat bujqësore. Kështu p.sh. kooperativa e Zojzit në qarkun e Shkodrës, rrethi i Lezhës dhe kooperativa e Shtërbegut që kanë nga 115-116 hektarë tokë, nuk kanë asnjë lopë, asnjë dele ose asnjë dhi. 53 kooperativa të Republikës nuk kanë fare bagëti dhe kooperativat e tjera kanë nga 4,4 lopë për çdo 100 ha. tokë. Kuptohet se nga një sasi e tillë bagëtish nuk mund të merren prodhime të shumta.

Zhdukja e prapambetjes në zhvillimin e blegtorisë, krijimi i fermave të lopëve dhe të bagëtive të tjera duhet të jetë një nga detyrat themelore për kooperativat tona bujqësore, ndryshe nuk mund të ecet përpara.

Duhet krijuar të gjitha kushtet për rritjen e plotë të të gjithë të vegjëlve që do të lindin në vitin 1957, në mënyrë që fermat blegtorale të kooperativave bujqësore të mos krijohen vetëm nga kafshët që furnizon grumbullimi me kredit agrar, por duhet praktikuar gjë-rësisht edhe mënyra e blerjes së kafshëve të reja nga

anëtarët e kooperativave dhe nga ekonomitë individuale, duke përdorur për këtë qëllim edhe fondet e paprekshme të kooperativës. Natyrisht duhet shpëtuar nga thika çdo kokë bagëti e përshtatshme për riprodhim. Por në radhë të parë duhet treguar kujdes për rritjen e kafshëve të reja të kooperativës, sidomos të atyre të përmirësuarra me anën e damazëve të racës.

Këtu u tha se qengjat duhen mbajtur 100 ditë pa u ndarë nga delet ose diçka më pak. Sigurisht ne kemi nevojë edhe për qumësht, por nuk duhet harruar çështja e së ardhshmes. Në rast se marrim masa të tilla që qengjat t'i ndajmë nga delet më përpara nga sa duhet, racat tona do të dobësohen dhe nuk do të dalë ajo që kërkojmë. Prandaj çështja e 100 ditëve të shihet mirë nga blegtorët, me qëllim që të sigurohen kushte për të nxjerrë një racë të shëndoshë. Në këtë drejtim të bëhet shumë kujdes, sepse kafshët e reja janë e ardhshmja e blegtorisë sonë. Kjo kërkon që ato të rriten në kushte të mira sepse këtej varet përmirësimi i blegtorisë.

Këtu u theksua se shumë herë fshatarët përpara se të hyjnë në kooperativat bujqësore i shesin ose i therin bagëtitë. Kjo është shumë e dëmshme. Ata nuk e kuptojnë se kështu dëmtojnë veten dhe ekonominë kolektive, ku do të kalojnë gjithë jetën e tyre, brez pas brezi. Prandaj Partia të punojë mirë në këtë drejtim që të ndërpritet shitja e bagëtisë, sepse një sasi e madhe që kemi humbur në vitin 1956, ka ardhur si rezultat i këtij qëndrimi jo të drejtë. Shumë kooperativa kanë mundësi të paguajnë vleftën e kafshëve të kolektivizuara gjatë formimit të kooperativës shumë më parë nga sa parashikohet në statutin e tyre.

Ne mund të arrijmë shtimin e prodhimeve blegtorale duke krijuar blegtorinë e fuqishme kolektive në kooperativat dhe në fermat shtetërore. Blegtoria kolektive socialiste është ajo që duhet të furnizojë kryesisht tregun me prodhime blegtorale.

Dua të flas pak edhe për shpendët, se edhe prej tyre mund të sigurohen sasi të konsiderueshme mishi. Në rast se duhet të ruajmë bagëtinë, duhet që ushqimet e popullit të plotësohen edhe me mish pulash, rosash dhe patash. Thëksoj se kooperativat bujqësore dhe ekonomitë individuale nuk u vënë kujdesin e duhur këtyre gjërave. Ne kemi mjaft kënetë në vendin tonë siç janë p.sh. ato të Lezhës, ku shkojnë njerëzit në dimër për të gjuajtur rosa. Po pse venë atje me mijëra rosa të egra? Atje venë sigurisht pse ka ushqim. Atëherë nuk do të ishte më mirë që ne të krijojmë ferma të mëdha ku të rriten dhjetëra mijëra rosa dhe pata të buta në këto kënetë? Kështu, duke llogaritur që rosat e reja brenda dy muajve bëhen gati për therje me një peshë të gjallë prej një kilogram, ne mund të përfitojmë më tepër se një ton mish të vlefshëm për çdo 100 shpendë. Natyrisht që të rriten këta shpendë duan edhe ushqime të tjera, por në kënetat ne mund t'u japim vetëm gjysmën e ushqimit dhe do të sigurojmë kështu mish me shumicë nga rosat dhe patat. Si kënetat e Lezhës ka edhe të tjera në breg të detit ose pranë lumënjeve, që ne nuk i shfrytëzojmë. Prandaj t'u japim hov të madh gjithë këtyre sektorëve të tjerë ndihmës të ekonomisë sonë dhe të blegtorisë.

Kooperativat dhe ndërmarrjet bujqësore shtetërore, si edhe ekonomitë individuale do të mund të mbanin

dhe të kursenin më tepër kafshë, në qoftë se për detyrimet në mish do të dorëzonin kafshë të ushqyera mirë e të shëndosha. Sot për sot më shumë se 70 për qind e tyre dorëzohet në gjendje të dobët.

Një çështje tjetër që doja të theksoja është ajo e bonifikimeve. Shkurtimisht do t'ju them se për të ngritur bujqësinë është e nevojshme, jo vetëm të përmirësohet agroteknika në punimin e kulturave, por njëkohësisht duhet të kryejmë edhe një numër të konsiderueshëm bonifikimesh. Siç e dini, gjatë viteve të kaluara, qeveria nën drejtimin e Partisë, ka bërë një sërë bonifikimesh të mëdha. Në 1 janar 1957 ne kemi pasur 57 mijë hektarë toka të përmirësuara nga bonifikimet dhe rreth 93 mijë hektarë toka të ujtitshme. Por megjithkëtë këto toka nuk janë të mjaftueshme. Ne kemi mjaft kënetë që duhet t'i thajmë dhe do t'i thajmë. Për këtë qëllim do të na japë ndihmë në maqineri Bashkimi Sovjetik. Por nuk është vetëm maqineria me anën e së cilës do të realizohen gjithë këto punime. Shirat e dimrit kanë bërë që ujërat të qëndrojnë shumë kohë në sipërfaqe, gjë që ngadalëson vazhdimisht mbjelljet në vendin tonë. Ky është një nga shkaqet që kemi rendimente të ulëta. Pastaj duhet të kemi parasysh se tokat tona nuk janë shumë të pasura dhe plehërimi i tyre, si me pleh organik ashtu dhe me pleh kimik, është jashtëzakonisht i ulët. Prandaj duhet të marrim masa që t'i përmirësojmë tokat dhe për këtë qëllim duhet të mobilizohet i gjithë populli. Që fshatari të dalë në punë për kanalizimin dhe kullimin e tokave, duhet të bëhet një propagandë e madhe dhe e vazhdueshme. Këtë e them se

fshatarët tanë dalin me zor në këto lloj punësh që kanë interes të përbashkët, pa le pastaj për të pastruar kanalet, për të cilat shteti ynë ka derdhur miliona e miliona lekë. Po atëhere kush do t'i bëjë këto? Ne mendojmë se këto do të bëhen në shkallën më të madhe me kra-hun e punës sonë. Ne do të kemi edhe maqineri, por kjo nuk do të thotë se me to mund të pastrohen të gjitha kanalet, shumë prej të cilave tani i ka mbuluar bari. Fshatarët tanë nuk mendojnë se këto janë bërë për ata, se ujët e kanaleve shkon në arat e tyre që ata të marrin prodhime sa më të mëdha, si për vetë ashtu edhe për gjithë Republikën.

Mos vallë fshatari ynë është zënë gjithë vitin me punë saqë nuk ka kohë për të bërë edhe këto punime të domosdoshme? Jo, ai kohë ka, prandaj Partia këtë çështje ta ngrejë përpara fshatarësisë, jo vetëm me propagandë, por konkretisht. E gjithë fshatarësia, të gjithë anëtarët e kooperativave bujqësore, një muaj në vit, në periudhat kur nuk kanë shumë punime bujqësore, të venë të punojnë me qëllim që të pastrohen rregullisht kanalet ujitëse dhe kulluese. Ndryshe nuk mund të ngrihet prodhimtaria e kulturave tona.

Shokë, çështja e fuqisë punëtore dhe e punës vullnetare të popullit duhet të praktikohet dhe të mos kërkohet gjithnjë maqina. Unë do t'ju jap disa shembuj. Në Bashkimin Sovjetik, fshatarësia, nën udhëheqjen e Partisë Komuniste, në vitet e paraluftës, ndërtoi një numër të madh kanalesh në një kohë shumë të shkurtër. P.sh. kanali i madh i Ferganit në Uzbekistan nuk u bë me maqina por me punën e me forcën e fshatarëve brenda 45 ditëve. Dhe sa tokë gërmuan e lëvizën, thoni ju? Tetë-

mbëdhjetë milion metra kub. Të marrim një shembull tjetër. Në Kinë është bërë një punë e madhe për bonifikimet dhe kanalizimet, si dhe shumë vepra të tjera, të realizuara me krahun e popullit. Gjatë vitit 1956 Republika Popullore e Kinës arriti të ujitë deri në dhjetë milion e gjysmë hektarë tokë. Të gjitha këto vepra ujitëse atje nuk u bënë me maqina, por me fuqi punëtore. Ne pamë vetë me sytë tanë se si punonin atje. Me dhjetëra e dhjetëra kilometra rrugë i ndërtonin dhe i asfaltin vetëm me forcën e krahut. Po mund të thuhet se në Kinë ka shumë fuqi punëtore. Po, kjo është e vërtetë, por edhe në vendin tonë ka rezerva në fshat për të bërë punime të kësaj natyre që janë në interesin e vetë fshatarësisë. Prandaj detyra e Partisë dhe e Ministrisë së Bujqësisë në këtë çështje është që të organizojë mirë punën e fshatarësisë për të kryer punime të tilla. Pastrimi i kanaleve duhet të jetë objekt i kujdesit të përhershëm si nga ana e kooperativave bujqësore, ashtu edhe nga ana e ekonomive individuale. Unë dëshiroj të vë në dukje gjithashtu edhe nevojën e punimit në mënyrë të drejtë të tokës. Toka duhet të punohet duke pasur parasysh shpejtimin e kullimit të ujërave të shiut, evitimin e shpërlarjes së tokës dhe krijimin e kushteve për ujitjen e saj. Në lidhje me këtë çështje organet tona bujqësore nuk tregojnë kujdesin e duhur dhe këtë të metë duhet ta ndreqin.

Desha të theksoj edhe një çështje tjetër të rëndësishme për vendin tonë, çështjen e kulturave shumëvjeçare të pemëve frutore, perimeve dhe patateve.

Në radhë të parë do të flas për pemët. Fshatari ynë

në të kaluarën rrinte me frikë se a do të mund ta siguronte bukën, dhe, përsa u përket kulturave të tjera ndihmëse e sidomos frutave, ai i kishte lënë pasdore. Si rezultat tani pemët janë në gjendje të keqe, rendimenti i tyre është përtokë. Çështja e frutave ka rëndësi të madhe për ekonominë e vendit tonë, sepse kushtet janë të përshtatshme për zhvillimin e tyre. Këtë ne duhet ta marrim mirë në dorë dhe të bëhet një çështje e madhe e popullit, e Partisë, e rinisë, e Frontit dhe e të gjithë fshatarësisë, ndryshe nuk mund t'ia dalim. Ne kemi mundësi të mëdha që nga frutat të kemi të ardhura të mira, jo vetëm për të siguruar ushqimin e popullit, por edhe për të shitur. Po për këtë qëllim ne duhet të bëjmë një punë shumë të madhe.

Ne kemi një plan për rritjen e portokalleve, limonave, mandarinave, për shtimin e ullinjve dhe disa plane të tjera më të vogla, si për shtimin e fiqve, të arrave, vreshtave etj. Por këto plane nuk janë të mjaftueshme. Partisë dhe popullit u vihet detyra që këto plane jo vetëm t'i realizojnë, por edhe t'i tejkalojnë që në vjeshtën e ardhshme. Që të realizohet kjo gjë duhet të organizohet mirë puna dhe të nxitet inisiativa individuale e fshatarëve.

Në radhë të parë duhet t'i jepet një rëndësi e madhe zhvillimit të vreshtave. Ne duhet t'i shumëzojmë këto me anë fidanesh. Mirëpo fidanishtet që kemi janë të pamjaftueshme për një perspektivë të ardhshme, prandaj planin që kemi për fidanishtet shtetërore duhet ta tejkalojmë, duke krijuar fidanishte të reja. Por nuk është e mundshme që shteti të krijojë të gjitha fidanishtet për të cilat do të kemi nevojë. Për këtë qëllim



përveç fidanishteve shtetërore është e nevojshme që të gjitha kooperativat bujqësore që do të mbjellin vreshta dhe pemë të tjera frutore, të krijojnë fidanishtet e tyre për prodhimin e hardhive dhe të frutave të tjera. Duhet të fillohet menjëherë, pa humbur kohë, sepse sa vjet kalojnë pa i bërë këto punë, aq pasuri i humbasin popullit dhe aq lëndë të nevojshme ushqyese i hiqen nga goja popullit.

Pemët frutore të mos mbillen në tokat e bukës ose të bimëve industriale, por në vende të tjera, që neve nuk na mungojnë. Ne kemi kodra të mrekullueshme që i rreh dielli, që janë të buta. Këto toka të hapen dhe, Partia e gjithë populli në drejtim të hapjes së tokave të reja, të marrin vendime të tilla që plani i hapjes së këtyre tokave të mos realizohet më 1960, por që në vitin 1958 dhe e shumta më 1959. Në këto toka të zërë një vend me rëndësi mbjellja e pemëve frutore dhe e vreshtave.

Ne kemi bërë gabim që kemi mbjellë plepa në anët e rrugëve automobilistike. Gjithë këto rrugë që përfshijnë qindra dhe mijëra kilometra mund të ishin mbushur me pemë frutore. Gjithashtu duhet të kemi parasysh që një sasi tokash në anë të rrugëve të rezervohen për mbjelljen e pemëve frutore dhe të vreshtave, sepse kështu krijohen mundësitë për t'i transportuar pa vështirësi dhe të freskëta nëpër qytete dhe në qendra të mëdha të punës këto prodhime kaq të vlefshme. Kjo nuk do të thotë që të mos mbillen vreshta edhe në thellësi. Rekomandohet që pemët frutore dhe vreshtat të mbillen sa të jetë e mundur nëpër kodra, por sipas një rajonizimi të detyrueshëm të llojeve të pe-

mëve frutore, duke i ndarë këto sipas zonave në mënyrë vertikale. Gjatë kësaj ndarjeje të pemëve frutore duhet të kihen parasysh veçoritë kryesore biologjike dhe vlera ekonomike e grupeve të veçanta, e llojeve dhe e varieteteve të këtyre pemëve frutore. Në këtë drejtim, pra, të mos kalohet vetëm në gjerësi, por të shfrytëzohet i gjithë territori duke e ndarë me breza. Mund të ketë kodra të cilat në brezin e parë të mbillen me fiq dhe ullinj, pastaj me vreshta, më sipër me mollë e kështu me radhë.

Çështjes së ullirit duhet t'i vëmë rëndësi më shumë se deri tani. Në Jug kemi shumë ullinj të egër, sidomos në Mallakastër. Atje fshatarët kanë bërë një punë të madhe, duke i shartuar ullinjtë e egër; por duhen shartuar të gjithë ullinjtë e egër që janë në vendin tonë dhe të realizohet e të tejkalohet plani i mbjelljeve të fidaneve të reja.

Pastaj ndërmjet ullinjve ne mund të mbjellim edhe fiq si dhe vreshta në ullishtat e reja. Në Vlorë dhe në Elbasan stërgjyshërit tanë kanë mbjellë fiq nëpër ullishta, por ata që ekzistojnë janë fare të paktë. Nëpër ullishtat tona ka akoma sipërfaqe të mëdha, të cilat mund të shfrytëzohen fare mirë për të mbjellë midis ullinjve pemë të shumta frutore. Le të marrim dhe të përhapim shembullin e Beratit. Shokët e Beratit kanë bërë një punë të madhe, duke krijuar një brez të tërë me fiq nga llojet më të mira që preferohen jo vetëm në vendin tonë, por që kërkohen shumë edhe jashtë. Në Berat kanë krijuar dhe fidanishte dhe do t'i zhvillojnë mirë këto kultura.

Një tjetër kulturë me rëndësi është kumbulla. Në

malësitë tona kumbulla bëhet shumë. Atëhere përse nuk e shtojnë këtë kulturë malësorët tanë? Po të këtë më shumë fruta në malësi mund të krijohen edhe industri të vogla për tharjen e kumbullave, që të krijohen rezerva, si për nevojat e popullit dhe aq më tepër për eksport.

Për zhvillimin e frutikulturës le të merret si shembull rrethi i Korçës. Tani ka filluar një lëvizje në të gjithë Shqipërinë përse u përket pemëve frutore, por Korça është më mirë dhe më përpara nga krahinat e tjera. Korça në drithëra ka rezultate të kënaqshme dhe po punohet për përhapjen e disa kulturave të tjera të cilave deri tani nuk u është dhënë rëndësia e duhur. Kështu në Korçë i janë futur punës për zgjerimin e vreshtave, pjergullave, për shtimin e mollëve, dardhave dhe pemëve të tjera. Kjo punë ka marrë një hov të madh dhe po ecet shumë mirë. Prandaj shembullin e Korçës duhet ta marrë e gjithë Shqipëria. Pikërisht për këto kushte që kemi dhe për punën e madhe që do të bëhet në të ardhshmen në drejtim të bujqësisë ne themi se Shqipëria do të bëhet një kopësht i lulëzuar sepse frutikultura është një pasuri e madhe për popullin. Shtimi numerik i pemëve frutore dhe i vreshtave ka rëndësi të madhe për shtimin e prodhimit të tyre. Por ne nuk duhet të harrojmë dhe ngritjen e rendimentit nga çdo rrënjë pemë, pse, sikundër dihet, zbatimi i masave agroteknike në pemët frutore te ne është i dobët dhe nuk siguron marrjen çdo vit të rendimenteve të qëndrueshme dhe të larta. Prandaj është shumë e nevojshme kryerja e të gjitha shërbimeve kulturore në pemët ekzistuese: punimi i tokës midis rreshtave, pra-

shitja, vendosja e plehut rreth trungjeve të pemëve, krasitja e rregullt dhe rrallimi i degëve të pemëve e i rrënjëve të hardhive, plehërimi, ngritja e rrënjëve të hardhive mbi mbështetëset. Po kështu është i domosdoshëm dhe organizimi i punës për luftimin e dëmtuesve dhe sëmundjeve të pemëve frutore e të vreshtave. Kështu gjatë 2-3 vjetëve më të afërt të përmirësohet në një mënyrë të konsiderueshme gjendja e pemëve frutore, e vreshtave, ullinjeve etj. dhe të shtohet rendimenti i tyre.

U diskutua këtu që edhe në malësi të ngrihen kooperativa bujqësore, po si kudo të kihet kujdes që kjo të bëhet kur të duan vetë fshatarët. Rëndësi ka në këtë çështje orientimi që duhet t'u jepet këtyre kooperativave në malësi. Në rast se atyre nuk u jepet drejtimi i blegtorisë dhe zhvillimi i frutikulturës sipas vendit, ato nuk do të kenë suksesin e dëshiruar. Këto kooperativa malore duhet të mendojnë se blegtoria dhe frutikultura do të kompensojnë prodhimin e ulët të drithërave. Le të kemi parasysh eksperiencën e Bullgarisë, ku shumë kooperativa bujqësore atje, nëpër malësi, sigurojnë të ardhura më të shumta nga ato të fushave. Këtë duhet ta bëjmë edhe ne, vetëm duhet të jepet orientimi i mirë dhe të punohet që ai të zbatohet. Prandaj e theksoj edhe një herë që çështjes së frutikulturës duhet t'i kushtohet vëmendje e madhe nga Partia dhe nga i gjithë populli.

Ju e dini se një vend shumë të rëndësishëm në ushqimin e përditshëm të punonjësve zënë perimet dhe

patatet. Kjo ka një rëndësi jashtëzakonisht të madhe veçanërisht për popullin tonë, për të mbuluar deficitet në prodhime të tilla siç janë mishi etj. Për zgjidhjen e këtij problemi me kaq rëndësi të madhe, përveç zgjerimit të sipërfaqeve dhe shtimit të rendimentit të këtyre kulturave, duhet të merren masa vendimtare për shfrytëzimin e kushteve të favorshme natyrore të zonave jugore dhe qendrore të vendit për prodhimin e perimeve të hershme, për mbjelljet e dyta të perimeve dhe për të organizuar në një shkallë të gjerë prodhimin e patateve të hershme dhe mbjelljen verore të patateve me tubera të porsavjelura.

Përsa u përket kuadrove, në sektorin e bujqësisë, me këto perspektiva të mëdha që na hapen, me gjithë sukseset e mëdha që kemi, ata i kemi akoma shumë të paktë. Prandaj nuk është e mjaftueshme që komitetet ekzekutive dhe ato të Partisë të sigurojnë kontingjentet që kërkohen për kurset, për teknikumet, universitetin ose për Institutin e Lartë Bujqësor, dhe që tani i plotësojnë me zor, por në të ardhshmen duhet të mendohet më seriozisht në këtë drejtim dhe jo vetëm nga komitetet ekzekutive, por edhe nga vetë kooperativat bujqësore. Shteti dhe Partia do të krijojnë të tilla mundësi që të zgjerohen këto shkolla në rast se kooperativat bujqësore do të mendojnë seriozisht për përgatitjen e kuadrove të tyre teknikë të lartë dhe të mesëm në të gjitha degët.

Prandaj në planin e kooperativave bujqësore duhet të vihet si një pikë me shumë rëndësi çështja e krijimit të kuadrove teknikë për nevojat e tyre në shkolla, uni-

versitet, institute, teknikume dhe kurse. Për këtë çështje duhet të jetë e gatshme e gjithë fshatarësia dhe me vullnet të madh të venë djemtë dhe vajzat e fshatarëve në këto kurse dhe shkolla që hapen. Ndryshe të gjitha këto detyra kaq të mëdha që na vihen përpara do të realizohen me vështirësi dhe jo shpejt.

Shokë,

Për të kryer me sukses gjithë këto detyra si dhe detyrat shumë të rëndësishme që kanë të bëjnë me fushatën e madhe të korrjeve, shirjeve dhe grumbullimit të të lashtave, duhet të mobilizohen e gjithë Partia, organet e pushtetit dhe në radhë të parë punonjësit e sektorit të bujqësisë e të grumbullimit. Puna e Partisë të ngrihet në një shkallë të tillë që të mobilizojë gjithë masat kooperativiste, fshatarët individualë, punonjësit e SMT-ve, NBSH-ve, agronomët, zooveterinerët dhe gjithë specialistët e tjerë të bujqësisë për t'i realizuar detyrat e mëdha që dalin përpara. Të konsiderohet i palejueshëm qëndrimi në zyra i kuadrove të bujqësisë në kohën kur kooperativat bujqësore dhe fshatarët individualë presin ndihmën konkrete teknike dhe organizative për të kryer punimet e shumta, të mëdha e delikate që kërkojnë shërbimet kulturore të bimëve industriale, korrjet, shirjet dhe grumbullimi i të lashtave, kositja, grumbullimi dhe depozitimi i ushqimit të bagëtisë për dimër, si dhe fushata e ndërzimit artificial.

Tani jemi në prakun e korrjeve dhe shirjes së të lashtave. Kjo është një nga fazat më vendimtare të pu-

nimeve bujqësore nga e cila varet sigurimi i bukës së popullit. Të korrin shpejt dhe sipas rregullave agroteknike dhe, nga ana e organeve të Partisë dhe të pushtetit, të merren të gjitha masat për të bërë në kohën e duhur shirjen e të lashtave që asnjë kokërr bereqet të mos vejë dëm. Detyra me rëndësi gjithashtu për kooperativat bujqësore dhe fshatarësinë patriotike të vendit tonë janë shlyerja e menjëhershme e detyrimeve ndaj shtetit, si dhe dorëzimi i sa më shumë tepricave.

Realizimi i këtyre detyrave shumë aktuale dhe urgjente të këtij viti, si dhe i të gjitha detyrave të tjera shumë të rëndësishme që përmenda për zhvillimin dhe përparimin e shpejtë të bujqësisë sonë, i hapin perspektiva të bukura popullit tonë në rrugën e ndërtimit të socializmit, në përmirësimin dhe ngritjen sa më të shpejtë të nivelit të jetesës së punonjësve, në lulëzimin e atdheut tonë.

Ne kemi bindje se populli, i udhëhequr nga Partia, i sheh qartë këto perspektiva, ditët e lumtura që e presin në të ardhshmen, dhe populli ka besim të patundur në vijën e drejtë të Partisë. Populli e pa Partinë në luftë si e udhëhoqi ajo, si u sakrifikuan anëtarët më të mirë të Partisë për interesat e popullit, si i kapërceu Partia me heroizma vështirësitë që i nxorën përpara armiqtë e brendshëm dhe të jashtëm dhe si në bazë të kësaj udhëheqje të Partisë, populli ynë arriti këto rezultate kolosale.

Populli pa se si Partia në një kohë kaq të shkurtër e ndryshoi faqen e Shqipërisë, krijoi industrinë e re moderne, po fut në rrugë të mbarë bujqësinë dhe blegtorinë dhe po zhvillon në shkallë të gjerë kulturën e po-

pullit. Populli gjithashtu e shikon se Partia nuk është e kënaqur nga këto rezultate, prandaj duhet akoma dhe akoma të punojmë më të organizuar dhe të mësojmë më shumë, në mënyrë që të arrijmë rezultate më të mëdha për të mirën e popullit dhe të ecim akoma më shpejt përpara në ritmin e zhvillimit ekonomik dhe kultural.

Prandaj Partia jonë është e sigurtë se populli do t'i përqafojë këto plane dhe do t'i realizojë me entuziazëm siç ka bërë kurdoherë. Partia dhe populli ynë janë të lidhur si mishi me thoin. Nuk kanë ç't'i bëjnë Partisë dhe popullit as armiqtë e jashtëm dhe as tradhëtarët si Panajot Plaku. Populli kur del ndonjë tradhëtar si Panajot Plaku thotë: «U pastrua edhe një ndyrësirë». Fitoret e mëdha të popullit dhe të Partisë fshijnë nga mesi i tyre ndyrësirat.

Prandaj, shokë, populli e shikon me besim të madh të ardhshmen. Nuk ka forcë në botë që ta pengojë atë. Të gjithë armiqtë e kampit të socializmit kanë thyer dhe do të dërmojnë kokën e tyre në rrugën që na kanë caktuar mësuesit tanë të mëdhenj Marksisi dhe Lenini. Ne do të ecim përpara në rrugën tonë të lavdishme të socializmit dhe besimi i popullit në fitore është i madh. Ne na udhëheq në kryerjen e të gjitha këtyre detyrave Partia dhe ajo me siguri do t'i kryejë me sukses ashtu siç i ka kryer me nder edhe detyrat e deritanishme.

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 135 (2722), 5 qershor 1957*

*Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i Popullit», Nr. 135 (2722), 5 qershor 1957*



## SHËNIM MBI NJË RAPORT TË MINISTRISË SË BUJQËSISË

18 qershor 1957

Shoku Pirro Dodbiba<sup>1</sup>,

Duhet të marrësh masa pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe veçanërisht ndaj këtij që firmos këtë raport me një firmë të palexueshme. Në lidhje me interesimin për deshët ata janë fajtorë dhe do të marrim masa të rrepta. Ai që firmos këtë raport me kaq shpejtësi (e kam fjalën te firma) jam i bindur se edhe punën e bën me aq mendjehetësi sa me mendjehetësi hedh edhe firmën në këtë raport. Ai duhet ta dijë se nga faji i tij deshët janë qethur para kohe dhe shumë keq, plot plagë u janë bërë në trup, i kanë hipur në kamiona të hapur, i kanë çuar në vend nëpër shi dhe janë ftohur. Në Lushnjë, ku ai na këshillon të marrim masa, (masa që duhet t'i marrë ai vetë), kanë ngordhur e vazhdojnë të ngordhin. Deri tash më kanë informuar se kanë ngordhur 20 desh. I thuj atij të firmës së panjohur, nga

---

<sup>1</sup> Shoku Pirro Dodbiba në këtë kohë ishte drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë në aparatën e Komitetit Qendror të PPSH.

ana ime, se në rast se vazhdohet kështu, jo vetëm do ta pushojmë nga puna, (cilido që të jetë), por do t'ia japim dhe prokurorisë.

*Enver*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## L È N D A

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN 14 .....	V—IX
----------------------------------	------

1956

NGA FJALA NË MITINGUN E ORGANIZUAR NË VLORE ME RASTIN E VIZITËS SË DELEGACIONIT QEVERTAR TË RDP TË KORESË (30 qershor 1956)	1—6
LETËR FALENDERIMI KQ TË PK TË KINËS PËR AKORDIMIN E NJË KREDIE SUPLEMENTARE RP TË SHQIPËRISË (10 korrik 1956) .....	7—8
LETËR KOMITETEVE TË PARTISË NË LIDHJE MË KONTRAKTIMIN DHE GRUMBULLIMIN E TEPRI-CAVE TË DRITHËRAVE TË BUKËS (21 korrik 1956)	9—13
MARRËDHËNIE TË SHËNDOSHA MIDIS DY PO-PUJVE MUND TË VENDOSËN VETËM MBI BAZËN E PARIMEVE MARKSISTE-LENINISTE — Bisedë me të dërguarin e jashtëzakonshëm dhe ministër fuqi-plotë të RFP të Jugosllavisë (4 gusht 1956) .....	19—25
DISA VËREJTJE RRETH KAPITULLIT 41 «RENDI EKONOMIK I VENDEVE EVROPIANE TË DEMO-KRACISË POPULLORE» — Tekst i «Ekonomisë Poli-tike», botim i dytë rus., i plotësuar (20 gusht 1956)...	26—31

UDHËHEQJA E PARTISË NË QARKUN E ELBASANIT DUHET TË ORGANIZOJË MË MIRË PUNËN PËR TË ZBATUAR SI DUHET DIREKTIVAT DHE UDHËZIMET E KOMITETIT QENDROR — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (23 gusht 1956) .....	32—36
NGA FJALA NË PRITJEN E DHËNË NGA AMBASADA E RP TË SHQIPËRISË NË PHENIAN (13 shtator 1956) .....	37—41
NGA PËRSHËNDETJA NË KONGRESIN VIII TË PARTISË KOMUNISTE TË KINËS (18 shtator 1956) .....	42—46
FJALA NË MITINGUN E ORGANIZUAR NË TIRANË ME RASTIN E K'THIMIT TË DELEGACIONIT TË PPSH QË MORI PJESË NË KONGRESIN VIII TË PK TË KINËS (7 tetor 1956) .....	47—51
TË THELLOJMË MË SHUMË PËRMBAJTJEN E PUNËS IDEO-POLITIKE TË PARTISË PËR EDUKIMIN E KOMUNISTËVE DHE TË MASAVE — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (13 tetor 1956) .....	52—58
LETËR DËRGUAR SHOKUT MARSEL KASHEN (Tetor 1956) .....	59—61
DISA ÇËSHTJE NË LIDHJE ME MARRËDHËNIET MIDIS VENDEVE TË KAMPIT SOCIALIST — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (3 nëntor 1956) .....	62—71
MBI NGJARJET NË HUNGARI — Teza për artikull (4 nëntor 1956) .....	72—74
PARTIA E PUNËS E SHQIPËRISË MBUSH 15 VJET (8 Nëntor 1956) .....	75—82

FJALA ME RASTIN E 15 - VJETORIT TË THEME-LIMIT TË PPSH (8 Nëntor 1956) .....	83—130
NË ASNJË MËNYRË NE NUK DO TË LËSHOJMË NË PARIMET — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (13 nëntor 1956) .....	131—146
PËR FJALIMIN E TITOS NË PËULA — Teza për artikull (19 nëntor 1956) .....	147—153
LETËR DY KOMPOZITORËVE AZERBAJXHANAS (15 dhjetor 1956) .....	154—155
TEZA TË KQ TË PPSH MBI BAZËN E TË CILAVE U ZHVILLUAN BISEDIMET ME UDHËHEQËSIT SO-VJETIKË NË MOSKË NË TAKIMET E BËRA MË 25 DHE 26 DHJETOR 1956 (25 dhjetor 1956) .....	156—171

## 1957

TA RUAJMË UNITETIN TONË TË FORTË, PSE KY ËSHTË JETIK — Nga raporti i mbajtur në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi bisedimet që u zhvilluan në Moskë midis delegacionit të PPSH dhe udhëheqësve të PK të BS» (3 janar 1957) .....	172—197
NGA FJALA NË MITINGUN E ORGANIZUAR NË SHKODËR ME RASTIN E VIZITËS SË DELEGACIONIT QEVERTAR TË REPUBLIKËS POPULLORE TË BULLGARISË (24 janar 1957) .....	198—204
FJALA NË PRITJEN E DHËNË NGA AMBASADA E RP TË BULLGARISË ME RASTIN E VIZITËS SË DELEGACIONIT QEVERTAR BULLGAR (29 janar 1957) .....	205—209

MBI ZBATIMIN E ZOTIMEVE TË MARRURA NË KONGRESIN III TË PPSH — Letër dërguar komiteve të Partisë në qarqe e rrethe (11 shkurt 1957) ..	210—213
«MBI GJENDJEN NDËRKOMBËTARE DHE DETYRAT E PARTISË» — Nga raporti i mbajtur në Plenumin III të KQ të PPSH (13 shkurt 1957) .....	214—293
1. — AGRESIONI IMPERIALIST KUNDËR EGJIPTIT .....	218
2. — DËSHTIMI I KUNDËRREVOLUCIONIT FASHIST NË HUENGARI .....	225
3. — NGJARJET NË POLONI .....	232
4. — LUFTA IDEOLOGJIKE DHE SULMET FASHISTE KUNDËR PARTIVE KOMUNISTE TË VENDEVE KAPITALISTE .....	237
I. MBI UNITETIN E KAMPIT SOCIALIST ....	241—248
1. — ROLI NDERKOMBETAR I BASHKIMIT SOVJETIK DHE I EKSPERIENCËS SOVJETIKE .....	241
2. — MBI MARRËDHENIET MIDIS VENDEVE SOCIALISTE, MIDIS PARTIVE MARKSISTE-LENINISTE DHE MBI INTERNACIONALIZMIN PROLETAR .....	244
II. MBI NEVOJËN E LUFTËS IDEOLOGJIKE PËR MBROJTJEN E MARKSIZËM-LENINIZMIT NGA ORVATJET E OPORTUNISTËVE DHE TË REVIZIONISTËVE .....	249—274
1. — MBI ROLIN E PARTISË SË KLASËS PUNËTORE NE REVOLUCIONIN SOCIALIST DHE NE NDERTIMIN E SOCIALIZMIT. ....	269

2. — MBI ROLIN E DIKTATURES SE PROLETARIATIT NE FAZEN E KALIMIT NGA KAPITALIZMI NE SOCIALIZEM	264
3. — MBI LUFTEN E KLASAVE NE FAZEN E KALIMIT NGA KAPITALIZMI NE SOCIALIZEM .....	271
<b>III. MBI MARRËDHËNIET TONA ME JUGOSLLAVINË .....</b>	<b>274—293</b>
<b>TI VËMË RËNDËSI TË MADHE ÇËSHTJES SË PËRMIRËSIMIT TË RACËS SË DIENVE — Diskutim në lidhje me pikën e dytë të rendit të ditës të Plenumit III të KQ të PPSH (16 shkurt 1957) .....</b>	<b>294—310</b>
<b>NGA FJALA NË MBLEDHJEN E AKTIVIT TË PARTISË TË QYTETIT TË TIRANËS ME RASTIN E PUNIMIT TË MATERIALEVE TË PLENUMIT III, SHKURT 1957, TË KQ TË PPSH «MBI GJENDJEN NDËRKOMBËTARE DHE DETYRAT E PARTISË» (1 mars 1957) .....</b>	<b>311—337</b>
<b>TË VËMË TË GJITHA FORCAT PËR KOLEKTIVIZIMIN E BUJQËSISË DHE TRANSFORMIMIN SOCIALIST TË FSHATIT — Letër dërguar organizatave të Partisë në terren dhe në ushtri (2 prill 1957) .....</b>	<b>338—344</b>
<b>TË SHQYRTOJMË GJITHMONË ME KUJDES DHE DREJT ANKESAT E PUNONJËSVE — Letër komiteve të Partisë në qarqe e rrethe (2 prill 1957) ....</b>	<b>345—349</b>
<b>TË PËRMIRËSOJMË MARRËDHËNIET MBI BAZËN E PARIMEVE TË MARKSIZËM-LENINIZMIT DHE TË INTERNACIONALIZMIT PROLETAR — Raport i mbajtur në mbledhjet e Byrosë Politike dhe të Plenumit të KQ të PPSH më 27 dhe 30 prill 1957 «Mbi vizitën e delegacionit të Partisë dhe të qeverisë në Bashkimin Sovjetik» (27 prill 1957) .....</b>	<b>350—366</b>

MESAZH PUNONJËSVE HUNGAREZË ME RASTIN E 1 MAJIT (Prill 1957) .....	367—368
LETËR DREJTORISË SË MUZEUMIT «V.I. LENIN» TË LENINGRADIT (3 maj 1957) .....	369—370
LETËR KOMITETEVE TË PARTISË TË RRETHEVE VLORE DHE BILISHT ME RASTIN E NGRITJES SË KOOPERATIVAVE BUJQËSORE NË TË GJITHA FSHATRAT E KËTYRE RRETHEVE (11 maj 1957)	371—374
LETËR DËRGUAR NXËNËSVE TË KLASËS SË 9-të TË SHKOLLËS SË MESME SHENJÇENJ NË PRO- VINCEN ANJHUE (11 maj 1957) .....	375—376
TË PËRFITOJMË NGA EKSPERIENCA E KINËS POPULLORE PËR FORCIMIN E SEKTORIT TË TREGËTISË — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (11 maj 1957) .....	377—379
NGA FJALA NË TAKIMIN ME USHTARAKËT SHEMBULLORË (11 maj 1957) .....	380—391
NGA FJALA NË TAKIMIN ME PUNËTORËT E KOMBINATIT TË TEKSTILEVE «STALIN» (11 maj 1957) .....	392—417
DUHET TË FORCOHET MË TEPËR PUNA POLI- TIKE PËR KOLEKTIVIZIMIN E BUJQËSISË — Le- tër dërguar komiteteve të Partisë në qarqe e rrethe (15 maj 1957) .....	418—423
TE POPULLI ËSHTË BURIMI MË I MADH I FRY- MËZIMIT — Nga biseda e zhvilluar me një grup shkrimtarësh dhe artistësh në prak të Kongresit të parë të Shkrimtarëve dhe të Artistëve (15 maj 1957)	424—447



LETËR DËRGUAR ORGANIZATAVE TË PARTISË NË TERREN DHE NË USHTRI NË LIDHJE ME ARRATISJEN E TRADHËTARIT PANAJOT PLA- KU (17 maj 1957) .....	443—449
SECILI TË REALIZOJË DETYRAT E VETA DHE PUNA TË MATET ME REZULTATE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (24 maj 1957)	450—455
LETËR NGUSHULLIMI DËRGUAR NË EMËR TË KOMITETIT QENDROR PRINDËRVE TË USHTARIT GOR TRIFONI (25 maj 1957) .....	456—457
NË LIDHJE ME PREGATITJEN E KUADROVE PËR KOOPERATIVAT BUJQËSORE — Letër dërguar ko- miteteve të Partisë në qarqe e rrethë (27 maj 1957)	458—460
FJALA NË KONFERENCËN NACIONALE PËR ZHVI- LLIMIN DHE PËRMIRËSIMIN E BLEGTORISË DHE PROBLEMIN E BONIFIKIMIT TË TOKAVE (2 qer- shor 1957) .....	461—494
SHËNIM MBI NJË RAPORT TË MINISTRISË SË BUJQËSISË (18 qershor 1957) .....	495—496